

Konferenca e Tretë Shkencore



AUDITIMI

KOMBËTAR

NË SHËRBIM

TË QEVERISJES

KOMBËTARE

29-30 X 2014



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare

Konferenca e III-të Shkencore vjetore e KLSH-së
29-30 Tetor 2014

Seria: botime KLSH - 13/2014/34
© Kontrolli i Lartë i Shtetit
ISBN: 978-9928-159-27-4

Tiranë, 2014

Titulli:

*Konferenca e III-të Shkencore vjetore e KLSH-së:
“Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes Kombëtare”*

Redaktore: Alma Shehu; Irena Islami

Art Design: Elisa Metaj

Përkthimi në gjuhën shqipe u realizua nga Audituesit e
KLSH-së: A.Sollaku, A.Shehu, A.Patozi, B.Haka,
E.Metaj, E.Kabashi, I.Dervishi, J.Zhegu, M.Kabo

Ky botim do të realizohet edhe në gjuhën angleze

në vitin 2015

Seria: botime KLSH - 13/2014/34

ISBN: 978-9928-159-27-4

Shtypur në Shtypshkronjën” Mirgeeralb”

Tiranë 2014

Drejtuesit e Konferencës së III-të Shkencore të KLSH-së :

- Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së
- Robert Gielisse, Këshilltarit Kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të DG Budget
- Jacek Jezierski, ish-President i SAI-t Polak

Njësia Teknike e Drejtimit të Konferencës :

- Dr. Bujar Leskaj
- Irena Islami

PËRMBAJTJA	Faqe
HYRJE	9
KREU I – Përshëndetje të Personaliteteve për Konferencën e III-të Shkencore të KLSH-së	11
Fjala e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij, Zoti Bujar NISHANI	13
Fjala e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Zotit Bujar LESKAJ	19
Përshëndetja e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Shkëlqesisë së Tij, Zoti Aleksandër ARVIZU	25
Përshëndetja e Deputetit të Parlamentit Evropian, Zotit Igor SOLTES	28
Përshëndetja e Nënkryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Zotit Edmond SPAHO	30
Përshëndetja e Kryetarit në detyrë të Prezencës së OSBE në Shqipëri, Zotit Robert WILTON	32
Përshëndetja e Anëtarit të Akademisë së Shkencave dhe Sekretarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Anastas ANGJELI	34
Përshëndetja e Këshilltarit Kryesor të Drejtorit të Përgjithshëm të DG-Budget, Zotit Robert GIELISSE	39
Fjala e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, Zotit Shkëlqim GANAJ	41
Përshëndetja e Audituesit të Përgjithshëm të SAI-t të Kroacisë, Zotit Ivan KLESIÇ	44
Përshëndetja e Presidentit të Senatit të SAI-t të Malit të Zi, Zotit Milan DABOVIÇ	46
Përshëndetja e Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t & Presidentit të Gjykatës Austriake të Auditimit, Zotit Josef MOSER	48
Fjala përshëndetëse për Konferencën e 3 ^{të} Shkencore të Kontrollit të Lartë të Shtetit e Ekspertit të SIGMA, Zotit Joop VROLIJK	54
KREU II – Punime të prezantuara në Konferencë	59
<i>“Mënyrat se si duhet të operojë Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe çështjet që duhet të mbahen parasysh në qasjen me dokumentacionin që trajton tatimin mbi të ardhurat dhe statusi i rekomandimeve të auditimit”- Z. Robert GIELISSE, DG-Budget</i>	61

“ <i>Auditimi në shërbim të qeverisjes kombëtare</i> ”- Z. Igor SOLTES, Deputet i Parlamentit Evropian	65
“ <i>Lidhja midis pavarësisë së SAI-eve, performancës dhe mirëqeverisjes</i> ”,- Phd. Milan DABOVIÇ, President i Senatit, SAI i Malit të Zi	69
“ <i>Arritja e rezultateve dhe qëllimeve të biznesit në ndërmarrjet publike</i> ”, Zj. Verica AKRAP, SAI i Kroacisë	88
“ <i>Roli i SAI-t për implementimin e llogaridhënies dhe transparencës dhe efekti në mirëqeverisje</i> ”, Z. İsmail Cengiz EREK, SAI i Turqisë	101
“ <i>Zvogëlimi i riskut, një potencial i mundshëm i zhvillimit të vendit</i> ”, Prof. Dr. Skënder OSMANI, Universiteti Politeknik i Tiranës & Dr. Bujar LESKAJ, Kryetar i KLSH-së	115
“ <i>Roli i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë në luftën kundër korrupsionit</i> ”, Z. Wojciech KUTYLA, Zv/President, SAI i Polonisë	145
“ <i>Pavarësia e SAI-t dhe si e forcon kjo mirëqeverisjen</i> ”, Z.Turan Yasar, SAI i Turqisë	154
“ <i>Roli i Audituesve në Mirëqeverisjen Kombëtare – Përqasje Strategjike</i> ”, Prof. Dr.Omer STRINGA, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	167
“ <i>Etika si një mjet për sigurimin e llogaridhënies</i> ”, Z. Jacek Jezierski, SAI i Polonisë	178
“ <i>Instrumentet për përmirësimin e qeverisjes publike</i> ”, Prof. Dr.Lindita LATI & Msc.Pajtim MELANI, Autoriteti i Konkurrencës	197
“ <i>Reduktimi i ekonomisë informale kërkon një sistem tatimor efektiv dhe përpjekje të përbashkëta nga shume aktorë</i> ”, Prof. Assoc. Dr.Hysen Çela, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar	209
“ <i>KLSH midis pavarësisë dhe të qenit lojtar kryesor në sigurimin e mirëqeverisjes</i> ”, Prof. Assoc. Dr. Manjola Naço (KLSH) & Dr.Blerta Zilja & Dr. Greta Angjeli, Universiteti Mesdhetar i Tiranës	220
“ <i>Pavarësia, ngritja e kapaciteteve të SAI-t dhe përmirësimi i sistemeve të llogaridhënies publike për një zhvillim të qëndrueshëm</i> ”, Z.Wolfgang WIKLICKY, Gjykata Austriake e Audituesve & Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t	236
“ <i>Një rishqyrtim i çështjeve të kontraktimit të organizatave jofitimprurëse për shërbimet sociale</i> ”, Prof.Dr.Aurela ANASTASI, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës	258
“ <i>Metodologjia e kërkimit dhe auditimi i performancës</i> ”, Dr.Reinald MUÇA, KLSH	268
“ <i>Prokurimet publike dhe pajtueshmëria me ligjin e prokurimeve</i> ”, Prof. Dr. Vjollca IBRAHIMI& Msc. Anxhela ÇELA& Msc. Elton KARAPICI, Universiteti i Tiranës	278

“Raportimi Financiar në evoluim të vazhdueshëm”, Prof.Dr. Jorgji BOLLANO, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.	304
“E drejta e mjedisit midis të Drejtës Kushtetuese, Penale dhe asaj Administrative”, Prof. Assoc. Dr.Sazan GURI, “G&G Group” Institut & Msc. Marianthi GURI, Shoqata Mjedisore ”MENV Group” & PhD. Artan MANUSHAQE, Jurist	316
“Risitë e Auditimit në ZAP Kosovë “, Z.Lars Lage OLOFSSON, Auditor i Përgjithshëm i ZAP Kosovë	333
“Institucionet Supreme të Auditimit si katalizatore të inovacionit në Sektorin Publik”, Zj. Luljeta NANO & Znj. Irena ISLAMI, KLSH	336
“Auditimi mbi bazë Sistemi- një qasje që mbështet ndryshimin pozitiv “, Zj.Albana GJINOPULLI & Z. Kozma KONDAKÇIU, KLSH.	342
“Efikasiteti i auditimit të brendshëm në Shqipëri”, Zj.Kesjana HALILI, Ministria e Financave	378
“Roli i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit, në kontekstin e praktikave më të mira të disa vendeve Europiane“, Zj.Albana AGOLLI & Znj. Brunilda ZENELI & Z.Ermal YZEIRAJ, KLSH.	392
“Auditimi kombëtar dhe mirë administrimi i aseteve në interes të publikut”, Z. Bajram LAMAJ & Zj. Helga VUKAJ	412
“Auditimi Performances ne funksion te mirëqeverisjes-Analize krahasuese ne KESH sh.a “, Z.Gjovalin PREÇI & Z.Fatos ÇOÇOLI.	422
KONKLUZIONE – B.Leskaj, R.Gielisse, J.Jeziarski	437
KREU III – Të Ndryshme	441
Aktivitetet social-kulturore që shoqëruan Konferencës	448
Axhenda e Konferencës	462
Referuesit në Konferencë	468
Pjesmarrësit në Konferencë	469
Falenderime	475

HYRJE

Konferenca e Tretë shkencore e KLSH, e mbajtur në datat 29-30 tetor 2014 ishte njëpërpjekje e suksesshme për të analizuar problemet aktuale dhe perspektive të auditit, si një nga faktorët themelorë të mirëqeverisjes së vendit. Kjo konferencë tregoi edhe njëherë se KLSH ka organizuar dhe punuar për të krijuar një bashkëveprim të frytshëm me të gjitha institucionet simotra të saj (institucionet supreme të auditit në Evropë), si dhe ka ngritur në një shkallë më të lartë bashkëpunimin me grupet e interesit në vendin tonë. Në konferencë morën pjesë mjaft personalitete evropiane të auditit më të lartë publik, të cilat jo vetëm i dhanë hijeshi dhe bukuri aktivitetit, por me kumtesat dhe diskutimet e tyre ishin një kontribut i rëndësishëm për detajimin e detyrave të KLSH-së, për rritjen e performancës së auditimit në Shqipëri. Gjithashtu, ia vlen të theksohet pjesëmarrja e gjerë e personaliteteve të grupeve të interesit, si akademikët, profesorati shqiptar, përfaqësues të organizatave profesionale, të cilët sollën eksperiencën e tyre, por gjithashtu hapën horizonte të reja për kërkime të mëtejshme në fushën e auditit, të cilat u sintetizuan në fjalën përmbyllëse të Kryetarit të KLSH, Bujar Leskaj. Konferenca forcoi edhe njëherë mendimin se performanca e qeverisjes asnjëherë nuk mund të ekzistojë pa performancën e auditit. Institucionet supreme të auditit kanë pranuar se qeverisja kombëtare efektive është faktori kryesor për ruajtjen e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe të progresit social, si dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së qytetarëve. Auditimi kombëtar është një forcë e rëndësishme në demokraci dhe në shtetin e së drejtës, për mbrojtjen e interesit publik, duke raportuar mbi përdorimin e burimeve publike dhe promovuar zbatimin e ligjit dhe të rregullave.

Konferenca deklaroi se nuk mund të rregullojmë performancën e auditit pa rregulluar performancën e informacionit. Nga punimet e konferencës dhe analiza në diskutime rezultoi që si performanca e auditit, edhe ajo e informacionit varen nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Meqë Konferenca ishte e organizuar nga KLSH, u dhanë drejtimet dhe detyrat që duhet të kryejë KLSH në lidhje me faktorin e brendshëm. Përsa i përket ndikimit të faktorit të jashtëm, sikurse e deklaroi me forcë dhe përpara mediave shqiptare Eurodeputeti Igor Soltes, i ftuar dhe referues në Konferencë, nëse institucionit suprem të auditimit nuk i jepet qasje e plotë në informacion, atëherë më mirë të mos jetë një institucion i tillë kushtetues. Aktiviteti solli eksperiencë, gjetje dhe rekomandime në fushën e përpjekjeve të auditit publik evropian për përmirësimin e qeverisjes dhe thellimin e luftës kundër korrupsionit, Dobia e konferencës në planin teorik dhe praktik të menaxhimit të financave publike, u pa dhe në faktin se, nga shumica e 27 kumtesave të paraqitura, përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një mjet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtarë të zhvillimit strategjik, u prezantua si sfida kryesore në shumë vende. Forumi dha mesazhin se, duke përmirësuar proceset dhe institucionet buxhetore, cilësia e financave publike rritet, ndërkohë që efizienz, efektiviteti dhe transparenca përbëjnë sot tre objektivat themelore të buxhetimit modern. Rregullat fiskale, planet dhe kornizat afat-mesme, si dhe buxhetimi i performancës kanë provuar të jenë efektivë në arritjen e këtyre objektivave. KLSH ka dhënë kontributin e tij në vijimësi në përmirësimin dhe forcimin e këtyre rregullave fiskale. Nga ky forum shkencor doli po ashtu i fortë mesazhi se Institucionet Supreme të Auditimit mund të kontribuojnë në efizienzën qeveritare, me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e aktiviteteve qeveritare dhe zbulimin e mangësive në qeverisjen dhe kontrollin kombëtar. Ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e mashtrimeve financiare, duke ruajtur interesat kombëtare, nëpërmjet sigurimit të informacionit objektiv, të besueshëm dhe në kohë, për të zbuluar risqet në funksionimin ekonomik dhe social kombëtar. Si institucione të mandatuara nga

Kushtetuta, ato (ndër të cilat edhe KLSH) mund dhe duhet të luajnë rolin e sistemit imunitar për qeverisjen publike kombëtare. Vetëm duke e pranuar këtë sfidë dhe përmbushur këtë rol parësor, këto institucione do të jenë në gjendje të vazhdojnë të kontribuojnë për të ruajtur demokracinë dhe shtetin ligjor, duke promovuar administrim dhe një qeverisje të ndershme dhe të pastër, duke mbajtur rregull ligjor, duke zbuluar paligjshmërinë, duke kufizuar abuzimet me pushtetin, nëpërmjet mbikëqyrjes së rreptë të pushtetit publik.

Rëndësia e Konferencës qëndron dhe në planin se ajo përbën një mjet të rëndësishëm për modernizimin e Institucionit. Kryetari i KLSH Bujar Leskaj u shpreh se formimi shkencor për KLSH është institucionalizuar tashmë dhe është fryt i bashkëpunimit me homologët, si anëtarë të EUROSAI-t, me profesoratin shqiptar, me organizatat profesionale të fushës dhe me OJF-të aktive në luftën për transparencë në administratën publike. Ky forum konkludoi se Institucionet Supreme të Auditimit mund të nxisin më tej përmirësimin e jetesës së qytetarëve, duke ndihmuar për të siguruar që fondet dhe projektet publike që kanë të bëjnë me jetesën e tyre, të jenë nën mbikëqyrje të rreptë dhe të arrijnë efektin e dëshiruar. Ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e mashtrimeve financiare, duke ruajtur interesat kombëtare, nëpërmjet sigurimit të informacionit objektiv, të besueshëm dhe në kohë, për të zbuluar risqet në funksionimin ekonomik dhe social kombëtar. Ndër konkluzionet dhe propozimet konkrete të Konferencës ishin theksimi se baza e të dhënave është themelore për njehsimin e riskut. Konferenca e ardhshme shkencore e KLSH duhet të përqendrohet në analizën e riskut për auditimin në sektorë tëndryshëm ekonomik-socialë, si në burimet energjitike, drejtësi, financë, arsim, minerale, shëndetësi, rend, mjedis, etj. Konferenca propozoi ngritjen e një institucioni që të merret me standartet e burimeve njerëzore, natyrore, energjisë, mineraleve, etj, duke përfshirë rezervat, klasifikimin etj., deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e tyre, kontratat, etj. Sektori publik duhet të adoptojë për raportimin financiar parimin e të drejtave e detyrimeve të konstatuara, pasi kjo i

shërben mirëqeverisjes, transparencës e përgjegjshmërisë dhe rritjes së besimit publik. Konferenca propozoi gjithashtu që të bëhet një riklasifikim në rritje i kufijve të njësive ekonomike që ligjërisht i nënshtrohen detyrimit për t'u audituar. Si dhe zhvillimin e mekanizmave dhe procedurave që lehtësojnë punën e secilit prej aktorëve në auditimin e jashtëm publik. Planifikimi i veprimtarisë dhe aktiviteteve, ndërtimi i strategjive të qarta dhe realiste, si dhe ndërtimi dhe zbatimi me rigorozitet i proceseve dhe kontrolleve ndihmojnë institucionet të përqëndrojnë energjitë dhe resurset në përmbushjen me efikasitet të objektivave afatgjate. Kjo mundëson që auditet, me punën e tyre të sjellin vlerë të shtuar në funksion të arritjes së objektivave të institucioneve publike.

Është hera e parë që në Shqipëri KLSH ka hapur një debat të rëndësishëm, atë të analizës së riskut për auditin. Diskutuesit tentuan të kontrollojnë edhe rrezikun, si një nga faktorët më të rëndësishëm të financave dhe investimeve publike. Mund të themi me modesti që tre kumtesa në Konferencë hapën siparin e studimeve për formalizimin e auditit të riskut. Me të drejtë në fjalën mbyllëse, Kryetari i KLSH caktoi tematikën e Konferencës së Katërt Shkencore të KLSH, e cila do të ketë dy drejtime kyçe, analizën e riskut dhe formalizimin e tij deri në nivel standardi, dhe krijimi i disa standardeve për të kontrolluar performancën. Tashmë mund të flasim me siguri se KLSH ka krijuar një institucion, i cili studion, hulumton dhe zhvillon kërkimin shkencor në audit. Dua t'i uroj të gjithë organizatorët për kontributin e tyre në këtë forum, i cili dha mesazhin qendror se pa një audit të zhvilluar dhe eficient, nuk ka mirëqeverisje.

Prof. Dr. Omer Stringa

Ish-Dekan i Fakultetit Ekonomik

Kryetar i Bordit të Revistës Shkencore "Auditimi Publik"

KREU I

**Përshëndetje të
Personaliteteve për
Konferencën e III-të
Shkencore të KLSH-së**

Përshëndetja e SHTZ. Bujar Nishani, President i Republikës së Shqipërisë



Së pari unë dëshiroj që ti adresoj ambasadorit të SHBA, z. Arvizu, përfaqësuesit të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Bashkimit Evropian, z. Gielisse, deputetit të Parlamentit Evropian dhe ish presidentit të Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë, z. Wilton, përfaqësuesit të OSBE, presidentëve të Institucioneve Supreme të Auditimit të Kroacisë, Malit të Zi, por edhe mjaft personaliteteve, të larta që janë këtu, ish presidentit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë dhe do të desha që ti përmendja me radhë të gjithë të pranishmit, së pari për ti falënderuar dhe për ti vlerësuar për praninë e tyre, po mbi të gjitha për të evidentuar edhe njëherë rëndësinë e madhe që ka kjo konferencë qoftë për organizatorët, për Kontrollin e Lartë të Shtetit Shqiptar por njëkohësisht dhe për të gjithë këta partnerë dhe miq të Shqipërisë që na kanë nderuar me prezencën dhe praninë e tyre. Prandaj për mua ishte shumë e rëndësishme që ti përmendja gjithë secilin prej tyre për të kuptuar se përtej rëndësisë së madhe që ka diskutimi, trajtimi, ndarja e këndvështrimeve, ndarja e eksperiencave në çështjet e auditimit, është jashtëzakonisht e rëndësishme mbajtja e një partneriteti dhe komunikimi veçanërisht në proceset që Shqipëria është duke ecur. Është e qartë, nuk ka më dyzime, nuk ka alternativë tjetër për Shqipërinë, nuk ka një plan B, një plan C, një plan D për Shqipërinë. Ka vetëm një rrugë e cila është ajo e integritit në Bashkimin Evropian. Natyrisht që shoqëria shqiptare, institucionet tashmë janë të ndërgjegjshëm që ky është një proces i cili nuk do të jetë i shkurtër, por ne kemi një detyrë dhe një përgjegjësi shumë të madhe dhe kjo është të

përfshihemi në proces, të angazhohemi në proces dhe të kontribuojmë në këtë proces. Do të ishte fatale nëse ne do ta humbisnim procesin.

Shqipëria vjen jo pa eksperiencë në rrugën e këtij procesi. Më së pari ajo vjen pas dy dekadash të angazhimeve, të arritjeve, të konsolidimit të demokracisë së saj, të institucioneve të shtetit të saj, të përparimit ekonomik dhe përditimit të zhvillimit të maturisë dhe pjekurisë së shoqërisë në tërësi, emancipimit të saj. Shqipëria vjen dhe ecën në këtë proces tashmë si një anëtare e NATO-s, mbërritja në tryezën e të cilës ka pasur arritje, angazhime, performancë, e cila e ka përgatitur Shqipërinë dhe e ka bërë të zonjën që të tregojë që si partnere në koalicione të tilla, në aleanca të tilla, në familje të tilla me përmasa globale jo vetëm të formimit por edhe të kontributeve, di të japë kontributin e saj, di të japë eksperiencën e saj.

Por ky është një proces i cili ka standarde, ka kërkesa dhe njëkohësisht ka detyrime dhe obligime për gjithsecilin prej nesh, Institucionet e shtetit në radhë të parë, për gjithë aktorët e shoqërisë dhe unë dëshiroj që të ndalem pak tek kjo e aktorëve të shoqërisë sepse dua që të bëj një vlerësim të veçantë për akademikët, për profesorët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile që janë sot në këtë tryezë, krahas profesionistëve, krahas specialistëve, krahas politikanëve, krahas përfaqësuesve të institucioneve mike dhe partnere për të fokusuar atë që është koncepti i gjithë përfshirjes në angazhime të tilla, gjithmonë në funksion të atij procesi dhe dua të mbetem tek procesi.

Procesi i integritit të Shqipërisë në BE nuk është një çështje vetëm e një vendimmarrje të caktuar politike. Vendimmarrja politike përmbyll procesin formal. Është çështja e arritjes së atyre standardeve për të cilat mbi bazën vetëm të një ekonomie, të një demokracie funksionale dhe të një shoqërie të emancipuar në tërë kuptimin e fjalës dhe të gjithë elementeve të jetës së përditshme të qytetarit do të bëjë të mundur të arrijmë atë detyrë dhe përgjegjësi që kemi karshi qytetarëve

shqiptarë, ndaj vetes tonë, por dhe duke pasur një partneritet harmonik me partnerët.

Unë dëshiroj njëkohësisht të vlerësoj në mënyrë shumë të hapur dhe shumë të sinqertë arritjet e dallueshme qoftë në dinamikë qoftë dhe në cilësi të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë viteve të fundit, ashtu siç dëshiroj të vlerësoj eksperiencën e vyer që mbledhi gjatë gjithë viteve te funksionimit të këtij institucioni që nga krijimi i tij. Fakti që ky institucion ka në objektin e punës së tij paranë publike por njëkohësisht dhe mënyrën e trajtimit ligjor të saj na bën të gjithë të përgjegjshëm dhe të angazhuar, jo vetëm për të qenë pjesë e këtyre tryezave të kësaj konference, si pjesë e ndarjes së përgjegjësive të përbashkëta, por njëkohësisht për të qenë të qartë në objektivat e gjithsecilit prej nesh për të pasur angazhime konkrete të bashkëveprimit dhe ndërveprimit midis institucioneve, njëkohësisht për të qenë të qartë në raport me publikun, me qytetarin në raport me jetën e përditshme të Shqiptarëve.

Paraja publike në momentin që bëhet e tillë nuk është më pronë e askujt, e asnjë individi, ajo është pronë vetëm e shtetit shqiptar. Sjellja ndaj parasë publike, alokimi i saj, menaxhimi i saj, efiçenca prej saj ka të bëjë me raportin e sjelljes ndaj shtetit, me përgjegjësinë ndaj shtetit, me respektin ndaj shtetit dhe vlerësimin e ecurisë së shtetit. Raporti me shtetin është një detyrim që nga Presidenti i Republikës dhe deri tek qytetari më i thjeshtë i këtij vendi, detyrime të cilat janë strikte dhe të rregulluara vetëm përmes ligjit dhe legjislacionit, raport, i cili nuk le vend për dilema, dyzime apo standarte të dyfishta, trefishta, apo katërfishta, prandaj unë besoj se këtë eksperiencë të mirë që auditi i shtetit shqiptar ka mbledhur deri më sot duhet ta shikojë çdo ditë në aktivitetin e tij si një përgjegjësi dhe raport që ka si individ, si përfaqësues institucional, në raport me shtetin shqiptar dhe përgjegjësia ndaj shtetit është përgjegjësia më e madhe që obligon qytetarin e thjeshtë dhe akoma më shumë nëpunësin e institucioneve. Të gjithë parafolësit përmendën me të drejtë çështjen e

besimit dhe të mirëbesimit tek besimi veçanërisht me qytetarin shqiptar, besimi në raport me opinionin publik, besimi në raport me perceptimin, i cili pastaj sjell në tërësi angazhimin e shoqërisë shqiptare në raport me institucionet, shtetin, shoqërinë, me vetveten, është një element shumë i rëndësishëm i cili nuk arrihet lehtë. Është një proces, i cili nuk arrihet me interesa ligjore dhe antiligjore nga grupe të ndryshme të interesit, të cilat kanë qasje pozitive ndaj shtetit dhe grupe të cilat kanë qasje për të anashkaluar rregullat e shtetit dhe natyrisht, pa dyshim, zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve shtetërore. Por krahas besimit që duhet të arrihet tek opinionin publik, po aq e rëndësishme është çështja e mirëbesimit, e mirëbesimit ndaj subjekteve që janë objekt i kontrollit nga ana e auditit në mënyrë të tillë që puna, investimi i gjithsecilit prej jush jo vetëm të kontribuojë tek e mira e fondeve, tek e mira institucionale, tek e mira e legjislacionit, por njëkohësisht të kontribuojë edhe në përmirësimin në fund të fundit në punën e mëtejshme të institucionit, të subjekteve që janë objekt i veprimtarisë së KLSH-së. Vetëm duke i parë me të njëjtën përgjegjësi këto dy parime: arritjen e besimit dhe të mirëbesimit dhe në harmoni me njëri-tjetrin do të kemi një kontribut të jashtëzakonshëm, por besoj gjithashtu se tek besimi dhe mirëbesimi shkohet përmes standardesh të caktuara. Më së pari do të gjykoja pavarësinë dhe paanshmërinë, të cilat janë elemente të domosdoshëm për të arritur tek besimi dhe mirëbesimi .

Pavarësia e institucionit tuaj është themelore, për të vajtur aty ku është problemi, për ta gjetur problemin përmes profesionalizmit, për ta bërë prezent dhe për të mos e kamufluar problemin, për të mos e minimizuar atë dhe njëkohësisht për të sjellë një “outcome”, një produkt të punës reale dhe kontribuese.

Natyrisht kjo është pjesa e mesit e udhëtimit sepse kërkon dhe paanshmërinë përveç se pavarësinë. Paanshmëria në një shoqëri me dinamizëm të admirueshëm siç është shoqëria shqiptare është gjithashtu një sfidë sepse interesa të ndryshme ndërthuren, por shpeshherë presioni i padrejtë, i paligjshëm, bën që nëse e tejkalojmë provën,

sfidën e pavarësisë, mund të mos e tejkalojmë atë të paanshmërisë, e cila pastaj përsëri do të sjellë një ngërç, apo një thyerje të një mekanizmi, të një dhëmbi të këtij mekanizmi, dhe përsëri nuk do të shkojmë dhe nuk do të kemi besim të plotë dhe mirëbesim të plotë të të gjithë kontributeve që ndoshta janë arritur për shkak të investimeve të mëdha profesionale të bëra ndër vite, nga resurset njerëzore të cilat janë të trajnuara, janë me eksperiencë, janë të angazhuara, janë të motivuara.

Prandaj unë do të dëshiroja që këto elemente nga ana e audituesve shqiptarë të ishin dhe të mbeten parime të pacënueshme dhe të patjetërsueshme, të shëndetshme mbi të gjitha. Do të dëshiroja të përfitoja nga rasti i pranisë së mjaft prej partnerëve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të vlerësuar, pasi për të qenë i sinqertë e kam ndjekur nga afër angazhimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si institucion shumë të rëndësishëm të vendit, të këtyre partnerëve për të ofruar në vijimësi mundësi të trajnimit dhe rritjes së profesionalizmit të audituesve shqiptarë.

Unë dëshiroj të vlerësoj shumë praninë e ambasadorit të SHBA Z. Arvizu, përfaqësuesit të zyrës së OSBE Z.Wilton për të treguar se sa e rëndësishme është njëkohësisht për miqtë e Shqipërisë, për partneret e Shqipërisë performanca evropiane e institucioneve Shqiptare, e shoqërisë shqiptare. Institucioneve shqiptare nuk u mungon asgjë, nuk janë të kufizuara nga asgjë për të pasur absolutisht performancën e merituar evropiane në mënyrën e funksionimit të tyre, në mënyrën e të menduarit, që nis tek draftimi i legjislacionit, në mënyrën e të sjellurit, që nis dhe konkludohet me zbatimin e legjislacionit. Në mënyrë të veçantë, Z.Leskaj, do të desha që të vlerësoja punën tuaj personale në tërësi dhe të bashkëpunëtorëve tuaj, por dhe të gjithë partnerëve që ju kane asistuar për një produkt ambicioz të ligjit të ri që është draftuar dhe keni diskutuar dhe jam i bindur që Parlamenti shqiptar do të ketë të gjithë mirëkuptimin e duhur për t'u mbështetur, pasi legjislacioni nuk është një mekanizëm i momentit që mund t'i shërbejë vetëm një institucioni apo drejtuesve apo anëtarëve të një institucioni në një periudhë kohe të caktuar, për disa objektiva të caktuara dhe specifike.

Legjislacioni është mekanizmi i vetëm, i cili do të ketë nevojë gjithmonë për përmirësime, avancime në varësi të sfidave që na dalin përpara, por është i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm. Ne kemi një shans si vend për të marrë eksperiencat më të mira që të tjerët i kanë kaluar para nesh dhe i kanë mbledhur në rrugën e gjatë të integritit të përgatitjes dhe të arritjes të standardeve. Në këtë kontekst unë besoj se marrja e eksperiencave më të mira të mundshme, jo vetëm na inkurajon për atë çka kemi humbur në kontekstin e kohës në të shkuarën dhe mund të na përshpejtojë procesin. Kështu që duke e mbyllur përsëri tek procesi, dëshiroj që dhe ky proces ku është përfshirë Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri përmes përmirësimit të legjislacionit, trajnimeve të audituesve, partneritetit, transparencës dhe ambicies që ka, ridinamizimit të marrëdhënieve ndër-institucionale, me Prokurorinë, pse jo me Inspektoratin e Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, me shoqërinë civile, e cila është e angazhuar në fushën investigative, si dhe besoj me botën akademike, për të gjeneruar gjithmonë e më shumë një produkt që të na sjellë besimin dhe mirëbesimin.

Ju Faleminderit dhe Suksese!

Fjala e Kryetarit të KLSH-së , Dr.Bujar Leskaj



Të nderuar pjesëmarrës,

Sikurse ka theksuar Deklarata e Pekinit e Kongresit të XXI të INTOSAI-t, **“Auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare për përmirësimin e menaxhimit publik financiar”**, kemi menduar që këtë orientim themelor të organizatës botërore të institucioneve të auditimit të jashtëm publik, ta vendosim si temën dhe mesazhin qendror të Konferencës sonë të Tretë Shkencore.

Në Kongresin e fundit të INTOSAI-t, institucionet supreme të auditimit(SAI-t) kanë pranuar se qeverisja kombëtare efektive është faktori kryesor për ruajtjen e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe të progresit social të një vendi, për përmirësimin e jetës së qytetarëve. INCOSAI XXI theksoi se, duke pasur një lidhje të ngushte korelative me qeverisjen kombëtare, auditimi kombëtar është një forcë e rëndësishme në demokraci dhe në shtetin e së drejtës, për mbrojtjen e interesit publik, duke raportuar mbi përdorimin e burimeve publike dhe promovuar zbatimin e ligjit dhe të rregulloreve.

Në këtë mision besojmë se qëndron dobishmëria e forumit tonë për këtë vit, në bazë dhe të standardit ISSAI 12, i cili shprehet se *“Shkalla në të cilën një institucion suprem i auditimit është në gjendje të bëjë një ndryshim në jetën e qytetarëve varet nga roli i*

tij në forcimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe të sektorit publik”.

Më lejoni të falënderoj SAI-t partnere të Polonisë(NIK), të Turqisë, Kroacisë dhe në veçanti Presidentet e këtyre SAI-ve, Ish-Presidentin e NIK, z.Jeziński dhe Presidentin e sotëm z.Kwiatkowski, zv.Presidentin z.Kutyla, Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive z. Recai Akyel, Presidentin e SAI-t Kroat z.Ivan Klesić dhe Presidentin e Senatit të SAI-t të Malit të Zi z. Milan Dabović, si për praninë e tyre dhe kumtesat në Konferencë, ashtu edhe për kontributin e qenësishëm dhe bujar që kanë dhënë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH, nëpërmjet trajnimeve të shumta, të organizuara nga ekspertët e tyre në Varshavë, Ankara dhe Zagreb për auditimin financiar, auditimin e performances, auditimin e teknologjisë së informacionit, të prokurimeve publike, etj.

Falënderoj po ashtu Euro deputetin z. Igor Soltes, për praninë e tij sot në Konferencë dhe për kontributin për ngritjen e dijeve të audituesve shqiptare, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë.

Më lejoni të falënderoj, në mënyrë të veçantë Këshilltarin Kryesor të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian (DG-Budget) dhe Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, z. Robert Gielisse, për bashkë-drejtimin e kësaj konference dhe për kumtesat e tij shume cilësore të këtyre dy viteve të fundit në këtë konferencë, por edhe për ndihmesën e jashtëzakonshme që ka dhënë në pajisjen e KLSH me një ligj të ri modern, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Konferenca shkencore e KLSH njohu një ecuri në rritje, duke qenë në vitin e parë të saj në dhjetor 2012, një aktivitet kushtuar historikut të institucionit, me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar. Në vitin e dytë, më 2013-ën, konferenca iu kushtua rolit të institucioneve supreme të auditimit për një menaxhim financiar të përgjegjshëm në sfidat e sotme, për të ardhur sot me temën qendrore të auditimit kombëtar në

shërbim të qeverisjes kombëtare. Bashkëpunimi i realizuar mes audituesve të KLSH-se dhe eksperteve të SAI-ve partnere, të Gjykatës Evropiane të Audituesve si dhe me përfaqësuesit e botës akademike dhe profesionale shqiptare, vërteton dobinë e motos së Organizatës së institucioneve të auditimit të jashtëm publik INTOSAI “Experientia mutua Omnibus prodest”.

Si institucione supreme të auditimit, SAI, sikurse e rekomandon edhe Deklarata e Pekinit, mund dhe duhet të luajë rolin e sistemit imunitar për qeverisjen publike kombëtare. Vetëm duke e pranuar këtë sfidë dhe përmbushur këtë rol parësor, ne do të jemi në gjendje të vazhdojmë të kontribuojmë për të ruajtur demokracinë dhe shtetin ligjor, duke promovuar administrim dhe një qeverisje të ndershme dhe të pastër, duke mbajtur rregull ligjor, duke zbuluar paligjshmërinë, duke kufizuar abuzimet me pushtetin, nëpërmjet mbikëqyrjes së rreptë të pushtetit publik. Në shumë raste veprojmë si këshilltarë, duke luajtur një rol konstruktiv nëpërmjet sugjerimeve për përmirësime në sistemin ligjor, nëpërmjet auditimeve të performances. Si SAI, mund të ndihmojmë fort në ndërtimin e komunikimit dhe besimit midis sektorit publik dhe qytetarëve, duke promovuar qeverisje të hapur dhe bërë të mundur që qytetarët të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes publike.

Me këto përgjegjësi, jemi përpjekur gjatë këtyre tre viteve të zbatojmë objektivat tona strategjike, në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik 2011-2017 të INTOSAI-t. Ato janë ndërtimi i kapaciteteve të plota për kryerjen e auditimeve cilësore, të përputhshmërisë, financiare dhe të performances, si dhe kontributi në mirëqeverisjen publike, duke luftuar me përparësi abuzimet me pronën shtetërore, mashtrimet financiare dhe korrupsionin.

Të nderuar pjesëmarrës në Konferencë,

Sikundër kudo në komunitetin INTOSAI dhe në EUROSAI, edhe ne besojmë se auditimi kombëtar luan një rol të rëndësishëm në promovimin e performancës së

qeverisjes kombëtare, veçanërisht përmes rritjes së ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës së përdorimit të fondeve publike, përmirësimit të mekanizmit operacional të organizatave qeveritare, promovimit të integritetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës, si dhe promovimit të praktikave më të mira të sektorit publik, duke shkëmbyer eksperiencën, metoda dhe informacionin.

Për të krahasuar punën që kemi bërë me standardet INTOSAI dhe me eksperiencat e mira të SAI-ve Evropiane, për të realizuar shkëmbimin e këtyre eksperiencave të qasjeve në auditim dhe në përdorimin e informacionit, një objektiv ky që buron nga Strategjia e INTOSAI-t dhe standardet ISSAI të fushës, për t'u përgatitur me një përjasje sa më profesionale ndaj sfidave të sotme për shëndoshjen e financave publike, menduam të organizojmë këtë konferencë të tretë shkencore vjetore, të përqendruar në rolin dhe përgjegjësinë tonë si SAI në përmirësimin e qeverisjes kombëtare.

Me këtë rast, me lejon të falënderoj edhe personalitetet e kontabilitetit, financave publike dhe profesoratit shqiptar, si Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Dr. Omer Stringa, Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof.Ass.Dr.Sazan Guri, Prof.Ass.Dr. Hysen Çela, Prof. Dr. Aurela Anastasi, Prof.Dr.Vjollca Karapici dhe Prof.Dr.Lindita Lati, për kontributet e tyre.

E veçanta tjetër e Konferencës sonë të tretë është se kemi mesazhin dhe ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Dr. Josef Moser. Konferencat e ardhshme, mendojmë t'i organizojmë me mbështetjen dhe bashkëpunimin e strukturave drejtuese të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, për të pasur më shumë kontribute nga SAI-t partnerë dhe për të zgjeruar shkëmbimin e eksperiencave.

Gjate këtyre dy ditëve të Konferencës, prezantimet e studimeve, vrojtimeve dhe kumtesave cilësore, të përgatitura nga ekspertë ndërkombëtare të auditimit publik të jashtëm dhe nga ekspertë vendas të financave publike, kontabilitetit dhe auditimit, jam i bindur se do të ndihmojnë audituesit tanë dhe jo vetëm ata, por edhe vendim-

marrësit e administratës sonë publike, të gjejnë rrugët e duhura për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të financave publike dhe ekonomisë së vendit, drejt përmirësimit të ndjeshëm të qeverisjes kombëtare dhe shërbimeve publike ndaj qytetarit.

Së fundmi dëshiroj të theksoj dhe të falënderoj paraprakisht Presidentin e Republikës së Shqipërisë, SHTZ.Bujar Nishani, Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, z.Aleksandër Arvizu, Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z.Robert Wilton, të cilët do të marrin pjesë në punimet e kësaj Konference në ditën e dytë të zhvillimit të punimeve të saj, duke vlerësuar rëndësinë që ka Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucion i pavarur kushtetues.

Duke Ju uruar të gjithëve punë të mbarë!

Ju faleminderit!

Përshëndetja e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës z. Alexandër A. Arvizu



Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, faleminderit për prezantimin dhe që kujtuat vizitën e Sekretares së Shtetit Clinton në Shqipëri në nëntor të 2012-ës,

President Bujar Nishani, të dashur pjesëmarrës,

Ju premtoj që do të flas shkurt, por do ta nis me një histori. Thomas Dewey ishte një ish-Gubernator i Shtetit të Nju Jorkut. Në vitin 1944, ai kandidoi për President të Shteteve të Bashkuara kundër Harry Truman në një njëri prej garave me rezultat më të ngushtë në histori. Gara ishte kaq e ngushtë sa që njëri prej kryetitujve të gazetave sikurse dihet e shpalli atë fitues, por në fakt ai humbi kundrejt Trumanit. Thomas Dewey shkoi dhe u bë më pas partner në një firmë ligjore të vjetër dhe të respektuar të Nju Jorkut, e cila në 2009 quhej Dewey & LeBoef. Përgjatë viteve Dewey & LeBoef mbeti një firmë e mirënjohur për përfaqësimin e klientëve që ishin korporata të mëdha dhe në 2012 deklaroi rreth një miliardë dollarë të ardhura.

Në realitet, firma po humbiste para dhe do të falimentonte shpejt. Në fund të 2012, Zyrtaari Kryesor Financiar (CFO) i dërgoi një email Drejtorit Financiar dhe e pyeti: “A mund të gjeni një audit tjetër të paaftë për vitin tjetër?” Drejtori Financiar iu përgjigj: “Ky është plani. Dhe funksioni në mënyrë të përsosur këtë vit.”

Kjo ishte një firmë ligjore e fuqishme, shumë e respektuar, e cila mbante emrin e personit që gati u bë Presidenti i Shteteve të Bashkuara. Por, më 2013 ajo falimentoi. Më herët këtë vit, drejtuesit e saj u paditën në një gjykatë amerikane.

Kur u shkëmbyen ato dy mesazhe elektronike të 2012-ës, ata dy burra ishin në dijeni të rëndësisë së një audituesi të mirë. Por ata nuk donin një auditues të mirë – përkundrazi, ata donin një të paaftë. Përse? Sepse një auditues i mirë heton praktikat dhe kontabilitetin e biznesit për t’u siguruar që ato janë të ndershme. Një auditues i paaftë nuk e bën këtë.

Në një qeveri, një auditues i mirë është i pavarur dhe kujdesshëm. Një shoqëri demokratike duhet të veprojë me auditues të mirë. Ata janë “rojtaret” që hedhin dritë mbi prokurimet, punësimin dhe shpenzimet e qeverisë. Në luftën kundër korrupsionit, është vendimtare të pasurit e një zëri të ndershëm, të saktë, të kujdesshëm dhe – më e rëndësishmja – të pavarur për të ruajtur burimet e njerëzve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është një administrues i rëndësishëm për Shqipërinë, mbikëqyr proceset teknike dhe financat e agjencive të qeverisë për të zbuluar shpërdorimin, mashtrimin dhe abuzimin.

Në luftën kundër korrupsioni, Shqipëria ka vënë një shembull të mirë për rajonin duke krijuar Njësitë e Përbashkëta Hetimore (NJPH). NJPH-të ndërthurin prokurorët me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Shërbimin Informativ Shtetëror, Inspektoriatin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, dhe sigurisht me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë një partner i përkushtuar dhe jetik për Njësitë e Përbashkëta Hetimore. Në vitin 2012 ai iu referoi NJPH-ve 15 çështje. Më 2013 referimet u rritën në 25. Ndonëse viti 2014 nuk ka përfunduar ende, Kontrolli i Lartë i Shtetit iu ka referuar tanimë 29 çështje NJPH-ve.

Kjo rritje ndodh për shkak të punës së madhe të bërë nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit për zhvillimin e një audituesi profesional dhe modern. Por, të gjithë e dimë se mbetet ende shumë punë për t'u bërë. Audituesit kanë nevojë të jenë të mirë-trajnuar dhe t'u jepet hyrje e plotë në të gjitha procedurat e rëndësishme dhe kontabilitetin e qeverisë. Ata duhet të bashkëpunojnë edhe më ngushtësisht me NJPH-të dhe të marrin pjesë në trajnimet e tyre.

Ndonëse audituesit nuk janë oficerë policie, nuk janë prokurorë, referimet e tyre mund të shpien drejt provave që mund të dënojnë zyrtarë të korruptuar. Prandaj, audituesit duhet të përfshijnë më shumë hollësi dhe analizë më të mirë që mund të shpjerë në dënime ligjore.

Një auditues aktiv dhe i pavarur qeveritar është shenjë e një demokracie të shëndetshme dhe në lulëzim. Ndërsa Shqipëria i afrohet BE-së, është inkurajuese të shohësh që Kontrolli i Lartë i Shtetit të bëhet më aktiv dhe profesional dhe që bashkëpunon më shumë me të tjerët. Dhe sigurisht, të gjithë inkurajojmë një bashkëpunim më të madh dhe partneritete mes institucioneve audituese të shteteve të tjera, përfshirë ata që përfaqësuar në këtë konferencë këtë javë.

Ju faleminderit!

Përshëndetje e Dr.Igor Soltes, Anëtar i Parlamentit European



I nderuar President i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia juaj zoti Bujar Nishani,

I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr. Leskaj,

Të nderuar presidentë të Institucioneve Supreme të Auditimit,

Folës dhe kolegë të nderuar!

Jam tërësisht i nderuar t'ju drejtohem juve, Shkëlqesia juaj, Z. Bujar Nishani, i nderuar mik!

Si Nënkyetar i Komisionit të Kontrollit Buxhetor të Parlamentit European, shpreh mirënjohjen ndaj Dr. Leskaj, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për ftesën e tij dhe për mundësinë që më dha që t'ju përshëndes juve në Konferencën e Tretë Shkencore. Urimet e mia për këtë ngjarje të veçantë!

Si ish-president i Gjykatës Sllovene të Auditimit, kuptohet që doja të shfrytëzoja njohuritë dhe eksperiencat e mia në mënyrën më të mirë dhe ju bashkova Komisionit të Kontrollit të Buxhetit të Parlamentit European.

Është interesante që tani jam pjesë e linjës së marrjes së produkteve të Gjykatës Europiane të Audituesve si raporte, rekomandime, raporte speciale, prej të cilave merret nje informacion shumë i rëndësishëm, nga i cili varet puna e Komisionit. Një pozicion i veçantë dhe i përshtatshëm për mua sepse më jep mundësinë të shikoj dhe të ndjek politikisht punën e audituesve të Luksemburgut. Brenda komisionit më është dhënë përgjegjësia e veçantë e marrëdhënieve dhe mbikqyrjes së Gjykatës Europiane të Audituesve.

Të nderuar miq, është kënaqësi për mua t'ju informoj mbi një angazhim tjetër të rëndësishëm që unë kam si anëtar i Delegacionit të Komisionit Parlamentar të Stabilizimit dhe Asocimit, BE- Shqipëri.

Në vijim mund të them se kam besim që bashkëpunimi ynë do të jetë edhe më i fuqishëm në nivele të ndryshme dhe e ardhmja jonë do të na rezervojë shumë gjëra interesante! Do të jem i lumtur dhe i nderuar të bashkëpunoj me ju në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë të ndërsjellë!

Faleminderit për vëmëndjen!

Fjala e Zëvendëskryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Z. Edmond SPAHO



I nderuar zoti President i Republikës,

I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

Të nderuar pjesëmarrës dhe të ftuar.

Më lejoni të shpreh kënaqësinë dhe të falënderoj drejtuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit për organizimin e kësaj konference të rëndësishme si dhe për ftesën që më bënë për ta përshëndetur atë. E quaj të rëndësishme jo formalisht. Disa muaj më parë hezitonim deri në kundërshtim, lejimin e termit auditim në tekstin e projektligjit për KLSH të paraqitur nga ky institucion , projektligj që ende nuk ka marrë miratimin e Kuvendit.

Sot jemi te gjithë në këtë konference , madje me pjesëmarrje ndërkombëtare, për të diskutuar në detaje për Auditimin Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare. Ky është progres. Si pjesë e debatit që bëmë në Kuvend në lidhje me auditimin dhe rolin e tij në qeverisje, me ka mbetur në memorie nevoja dhe kërkesa për të mos vënë barriera ndaj tij. Përvoja që patëm me Bankën e Shqipërisë edhe një herë vërtetoi se nuk duhet të kemi institucione të mbyllura, që administrojnë para ose prona publike dhe nuk auditohen në mënyre periodike, nga të gjithë institucionet audituese që autorizon sistemi ynë legjislativ. Në të kundërt, rrezikojmë që edhe rregullat më të thjeshta të administrimit të pasurive publike të anashkalohehen dhe demit ndaj qytetareve të jetë i madh.

E solla këtë shembull për të kujtuar edhe një herë që asnjë institucion nuk duhet ta lemë jashtë vëmendjes dhe juridiksionit të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për çfarëdo arsye apo justifikimi , nëse vërtete duam të ngremë Shtet Ligjor. Dhe këtu ka se si mund të reflektojmë.

Për te rritur efektivitetin e përdorimit të pasurisë publike madje edhe të fondeve që çdo vit vëmë në dispozicion te Kontrollit të Lartë të Shtetit, mendoj se është i

domosdoshëm një raport më profesional me organe të tilla si Prokuroria dhe gjyqësori.

Kemi qenë dhe vazhdojmë të mbetemi në marrëdhënien që, Kontrolli i Lartë i Shtetit dërgon praktika të abuzimit me fonde publike dhe prokuroria në rastin më të mirë i rrezon ato ose në rastin më të keq nuk i shqyrton fare. Rrallëherë ndonjë dosje e Kontrollit të Lartë të Shtetit arrin dyert e gjykatave. Sigurisht problemi nuk është cilësia apo vërtetësia e fakteve të dërguara tek organet e hetimit.

Mendoj se konferenca të tilla do të ishin një rast i mirë për të dëgjuar edhe këndvështrimin e prokurorisë dhe përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, në mënyrë që të marrë fund praktika ku niveli i lartë i perceptimit të korrupsionit bashkëjeton me kulturën e mungesës së ndëshkueshmërisë.

Në përfundim të fjalës time të shkurtër do të desha të theksoja se Kontrolli i Lartë i Shtetit vitet e fundit ka mundur të ndryshojë për mirë në drejtim të forcimit institucional dhe rritjes së kapaciteteve të tij audituese .

Këto dhe fusha të tjera do të vazhdojnë të mbeten prioritet të punës së këtij institucioni sa kohë që vendi lëviz në drejtim të integritetit Evropian. Është e nevojshme të plotësojmë të gjithë standardet dhe kriteret për institucionet e auditimit ku vend të rëndësishëm do ti jepja llogaridhënies publike të institucionit për të cilën po jep kontributin e saj edhe kjo konferencë.

Edhe njëherë ju falënderoj për ftesën dhe ju uroj suksese.

Përshëndetja e Kryetarit në detyrë të Prezencës së OSBE në Shqipëri,

Zotit Robert WILTON



I nderuar Z. President,

Të nderuar kolegë dhe të ftuar,

Qeverisja e mirë dhe Institucioni Suprem i Auditimit janë thelbësore jo vetëm për Shqipërinë, por për çdo shoqëri demokratike. Nëse ky institucion e kryen punën e tij seriozisht, me rigorozitet dhe me integritet, puna e tij jo vetëm që siguron efikasitetin por gjithashtu siguron qytetarët se shteti i tyre funksionon si një demokraci normale. Pa këtë, një shoqëri nuk është me të vërtetë demokratike.

Prania e Presidentit të Republikës dhe Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë në aktivitetin e sotëm tregon qëndrimin e tyre të qartë të bashkëpunimit dhe përkushtimit për të parandaluar dhe luftuar keqpërdorimin e parave të taksapaguesve.

Qeverisja e dobët, veçanërisht për shkak të korrupsionit, i pakëson shtetit kapacitetin për të siguruar në mënyrë efektive zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor, si dhe minon bashkëpunimin social, stabilitetin dhe sigurinë.

Prania e OSBE vë theks në promovimin e qeverisjes së mirë në të gjitha nivelet. Qeverisja e mire publike, respektimi i shtetit ligjor dhe i institucioneve të forta janë themelet thelbësore për një ekonomi të shëndoshë. Prezenca e OSBE ka zhvilluar një program të qeverisjes së mirë që inkurajon transparencën, përgjegjshmërinë,

integritetin dhe zbatimin e masave antikorrupsion në institucionet qendrore dhe lokale.

Në Shqipëri, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë aktiv në auditimin e institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal dhe në bërjen transparente të rezultateve të tij. Numri i madh i masave administrative të propozuara ndaj zyrtarëve publikë për shpërdorim të fondeve publike, si dhe numri i rasteve të raportuara në Prokurorinë e Përgjithshme, është një tregues i angazhimit të këtij Institucioni.

Roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit si institucion i pavarur është thelbësor në zbulimin dhe sigurimin e praktikave abuzues. Është gjithashtu e rëndësishme që rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit të zbatohen nga institucionet publike përkatëse. Shkalla e ulët e zbatimit të masave të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë mbetet një shqetësim.

Ne inkurajojmë institucionet shqiptare që të marrin seriozisht rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit si një mënyrë për të përmirësuar përdorimin e fondeve publike nga ana e zyrtarëve në të gjitha nivelet. Të gjitha palët përfshirë Kuvendin dhe Qeverinë duhet të analizojnë pengesat për zbatimin e rekomandimeve dhe të identifikojnë mjetet e mundshme për të trajtimin e problemet në këtë fushë.

Shkëmbi i praktikave ndërkombëtare më të mira, sikurse kjo konferencë, janë të rëndësishme për të përmirësuar respektimin e pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare. Është gjithashtu jetësor forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel kombëtar. Kjo do të rrisë vlerën e auditimeve të Institucionit dhe raporteve të tij, për të siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse në luftën kundër korrupsionit.

Unë sinqerisht shpresoj se ky takim do të çojë në përmirësime të mëtejshme në punën e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Unë do të doja të përsëris angazhimin e Prezencës së OSBE-së për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për institucionet kombëtare në përpjekjet e tyre për të promovuar qeverisjen e mirë dhe funksionimin e mirë të demokracisë në Shqipëri.

Fjala e Akademik, Prof. Dr Anastas Angjeli, Deputet i kuvendit të Shqipërisë



I nderuar z. President,

i nderuar z. Leskaj,

i nderuar z. Ambasador Alexander Arvizu

i nderuar z. Ambasador Robert Wilton,

i nderuar z. Robert Gielisse,

të nderuar kolegë të Parlamentit Evropian dhe Shqiptar, pjesëmarrës, miq, të ftuar, Duke e konsideruar privilegj pjesëmarrjen time në këtë forum profesional e shkencor, tashmë të konsoliduar, për të sjellë e shkëmbyer përvojat dhe eksperiencat më të mira botërore dhe për të prezantuar në një format shkencor atë që është objektivi juaj kryesor, zhvillimi i një modeli institucional evropian të organit suprem të auditimit që do duhet të përballlet me sfidat që sjell ky transformim i rëndësishëm.

Me lejoni të them disa fjalë përshëndetëse dhe në mbështetje të këtij aktiviteti, jo vetëm si profesionist ekonomist e financier, por edhe në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe natyrisht si Sekretar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë, me të cilin bashkëpunon institucioni i KLSH.

Historia e 20 viteve të fundit të zhvillimit ekonomik, financiar dhe social, në kushtet e procesit të shpejtë të globalizimit dhe efienca e kërkuar në përdorimin e fondeve publike ka çuar në zhvillime dhe ndryshime të shumta e të mëdha. Dhe nuk ka se si të jetë ndryshe. Sepse *"një botë në globalizim, e cila ecën dhe zhvillohet shumë shpejtë, një botë në informacion që përsoset vazhdimisht e bën esencial auditimin për çdo*

qeveri që të jetë e mirë informuar rreth rreziqeve potenciale dhe atyre që ndodhin, më qëllim marrjen e masave, në kohën me të shpejtë të mundshme, për përmirësimet e nevojshme në menaxhimin me sukses të financave publike."

Këto ndryshime nuk kanë lënë jashtë vëmendjes edhe ndryshimet thelbësore në rolin e profesionit të audituesit. Ato janë të gjithanshme, konceptuale, teorike e praktike, ligjore dhe institucionale, etj.

Ato, gjithashtu vijnë edhe sepse, në prioritetet e qeverive sot, veç të tjerash, një vend të rëndësishëm zë përdorimi sa më i mirë i fondeve publike, duke rritur cilësinë e shërbimeve ndaj publikut. Kjo është e lidhur ngushtë me përmirësimin e qeverisjes, shoqëruar me rritjen e besimit të qytetarëve në të. Sekretari i Përgjithshëm i OKB, z. Ban Ki-Moon në Forumin Global të Qeverisjes së re në qershor 2007 ka theksuar se "Besimi ndërmjet qytetarëve, ndërmjet shteteve dhe në vetë konceptin e qeverisjes është një nga nevojat më vitale për paqen dhe prosperitetin e njerëzimit".

Zhvillimet e sotme ekonomike janë shoqëruar dhe me procese, operacione e sisteme "të sofistikuara" financiare, që krahas rritjes së shpejtësisë të veprimeve dhe operacioneve financiare, në shumë raste kanë stimuluar dhe fenomene abuzive deri në skandale të përmasave të mëdha, në përdorimin e fondeve publike, por jo vetëm, në institucione, tregje, kompani e korporata etj. Kësisoj ka dalë në pah edhe nevoja për më shumë vëmendje, kontroll e mbikëqyrje. Si rrjedhojë e krizës globale dhe e këtyre fenomeneve, sot në botë po vihet re një rënie e besimit ndaj qeverive dhe në këtë kuadër një auditim i mirë, duke kontribuar në rritjen e transparencës ka potencialin të rrisë besimin e qytetarëve tek qeveria e tyre, çka sjell një qeverisje të mirë, me transparente e më të përgjegjshme.

Besimi ndaj qeverisë varet nga tre faktorë:

- Integriteti
- Kompetenca
- Transparenca.

Një auditim cilësor që manifeston të tre këta tregues, ka potencialin të rrisë besimin e qytetarëve tek qeverisja.

Ndërkaq, promovimi i ndershmërisë dhe qeverisja kompetente është shumë i rëndësishëm, por kjo nuk mund të lihet vetëm në dorë të audituesve, por duhet të jetë detyrë dhe angazhim i të gjithë aktoreve dhe faktorëve, përfshi zyrtarët e zgjedhur, administratën publike, shoqërinë civile, median, përfaqësuesit e biznesit, etj.

Sot nevojiten institucione publike dhe agjenci auditimi që e bëjnë punën më mirë, për të promovuar ndershmërinë dhe qeverisjen kompetente. Kjo bëhet më e domosdoshme për të mirën e çdo vendi, për popullsinë e tij, për individin, fëmijët dhe nipërit tanë, për të ardhmen tonë.

Të nderuar pjesëmarrës.

Shqipëria, si pjese e këtyre zhvillimeve globale, si një vend që po ecën me vendosmëri drejt të ardhmes së saj evropiane, po përballet me një sërë sfidash, të cilat nuk mund të kapërcehen me sukses, veçse përmes një sërë reformash, në qendër të së cilave është mirëqeverisja. Mirëqeverisja dhe reformat janë një binom i përhershëm i së tashmes dhe së ardhmes. Veç të tjerash, ato janë të lidhura me reformat strukturore dhe të prioritizimit të ekonomisë që gjenerojnë punësim, të financave publike dhe sistemit financiar, reformat në sektorin energjetik, reformat në administratën publike dhe në drejtësi, etj , për të siguruar një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe përmirësim të jetës sociale në vend.

Përballja me këto sfida dhe realizimi me sukses i reformave dhe qeverisja e mire sjellin në vëmendje rritjen e efektivitetit të luftës kundër korrupsionit, evazionit dhe mashtrimit financiar. Kjo arrihet përmes forcimit të mbikëqyrjes mbi financat publike, si një mjet që ndikon fuqishëm në rritjen e përgjegjshmërisë qeverisëse. Në këtë proces, rolin kryesor, e kanë Institucionet Supreme të Auditimit. Padyshim që roli i këtij institucioni dhe funksionet e tij, në këtë kontekst janë shumë dimensionale, por veç sa theksova nuk mund të mos përmendim edhe një instrument tjetër të

rëndësishëm në manaxhimin e drejtë të financave publike, transparencën buxhetore, pasi kjo ndikon në ruajtjen e integritetit dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike, për një shpërndarje sa më të drejtë të burimeve publike në funksion të mirë administrimit nga ana e qeverisë. Edhe në këtë drejtim roli i institucioneve të larta të auditimit është i një rëndësie të veçantë.

Dihet jo vetëm nga ana teorike se ka një lidhje të rëndësishme dhe të drejtpërdrejtë midis auditimit të jashtëm, cilësisë së qeverisjes dhe një influence të tërthortë me performancën financiare të programeve qeverisëse. Pra në kontekstin e përgjithshëm, institucionet supreme të auditimit shikohen si një komponent kryesor i sistemit të kontrollit financiar dhe i rritjes së përgjegjshmërisë qeveritare për çështjet financiare.

Duke vlerësuar këtë forum profesional dhe shkencor, me lejon të shpreh vlerësimin dhe mbështetjen time duke besuar se kjo shërben njëherazi për të konsideruar drejtë rëndësinë e institucioneve të auditimit, reformat e ndërmarra në këtë drejtim për rritjen e efektivitetit të punës së tyre, efektivitet që kërkon jo vetëm konsolidim institucional por edhe nxitjen e bashkëpunimit ndër-institucional. Ndërkohë që institucionet supreme të auditimit duhet të zhvillojnë aktivitetin në mënyrë të pavarur, kanë nevojë të zhvillojnë marrëdhënie me ato institucione që kanë detyrën e zbatimit të përgjegjshmërisë qeveritare dhe bilanci i kësaj marrëdhënie është mjaft kompleks por dhe me ndikim në objektivat kryesore që kanë këto institucione.

Tre janë lidhjet më të rëndësishme, në bashkëpunimin ndër-institucional

- **me legjislativin**, për të imponuar përgjegjshmërinë politike
- **me gjyqësorin**, për të imponuar përgjegjshmërinë juridike
- **shoqërinë civile**, për të imponuar përgjegjshmërinë sociale.

Vetëm nëpërmjet këtyre lidhjeve ka mundësi të përmirësojë mbikëqyrjen e financave publike. Rëndësi të veçantë ka edhe lidhja midis institucioneve supreme të auditimit dhe komisioneve mbikëqyrëse parlamentare, sidomos ato që kanë të bëjnë me financat publike. Ka një lidhje të rëndësishme midis auditimit të jashtëm, mbikëqyrjes

legjislative dhe kontrollit gjyqësor. Ka një nevojë thelbësore për të rritur përgjegjshmërinë qeveritare nga institucionet zyrtare dhe ato jo-zyrtare, nga shoqëria civile dhe nga media, për të frenuar korrupsionin. Forcimi i institucioneve supreme të auditimit, i komisioneve legjislative për mbikëqyrjen e buxhetit, si dhe agjencive të integritetit publik financiar janë pa dyshim sfidat e mëdha për vendet në zhvillim, pse jo dhe për vendin tonë.

Në këtë këndvështrim është punuar dhe po finalizohet edhe nisma e përbashkët e KLSH me Parlamentin dhe Qeverinë për ndryshimet e reja ligjore. Në ligjin e ri për KLSH synohet një përjasje bashkëkohore dhe evropiane, bazuar në standardet e institucioneve ndërkombëtare të auditit, për auditimin e programeve dhe agjencive të qeverisë duke sjellë kalimin nga modeli i vjetër i kontrollit të bazuar në auditimin e pasqyrave financiare, përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së transaksioneve ekonomike, drejt ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të shpenzimeve publike, përmes auditimit të performancës apo atë që quhet “value-for-money audits”, apo të IT etj. Natyrisht, misioni i ri i synuar kërkon përkushtim por dhe angazhim të madhe të të gjithë trupës audituese. E rëndësishme është të vlerësohet se kjo përjasje e re nuk mund të lidhet vetëm me dëshirën e mirë, por duhet të shoqërohet me reforma edhe në drejtim të rritjes së profesionalizmit dhe forcimit të integritetit të audituesve të tij. Sfidat dhe kërkesat për një model institucional evropian shtrojnë përpara jush përgjegjësi të mëdha, të cilat gjykoj se do të keni vullnetin për ti kapërcyer me punë dhe duke u rritur bashkë me këtë institucion që po tregon se çdo vështirësi vetëm e përsos dhe e bën më të ndërgjegjshëm për vlerat që duhet të përçojnë në mirë administrimin dhe transparencën buxhetore. Këtë bindje timen e përforcon edhe kjo përpjekje e konsoliduar për të sjellë çdo përvojë të re dhe shkencore që do të mundësojnë kapacitete profesionale dhe me integritet për t'i bërë ballë sfidave të zhvillimit evropian.

SUKSESE!

Përshëndetja e Z. Gielisse, Këshilltar kryesor i Drejtorit të DG-Budget



I nderuar Presidentit i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Bujar Nishani,
Si një nga bashkëkryetarët e kësaj Konferencë Shkencore të KLSH-së, në emër të të gjithë pjesëmarrësve, më lejoni t'Ju falënderoj për fjalën Tuaj frymëzuese.
Prania juaj sot në këtë Konferencë është një nder i madh dhe është perceptuar nga të gjithë si një sinjal i rëndësishëm i besimit Tuaj ndaj Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ndaj vlerave thelbësore që ky institucion ka. Ndër këto vlera mund të përmendim në veçanti:

1. Pavarësinë
2. Objektivitetin dhe Paanshmërinë
3. Integritetin
4. Konfidencialitetin
5. Kompetencën

Këto vlera universale kryesore janë ato në të cilat mbështeten draft-ndryshimet në ligjin për KLSH-në, që do t'i sigurojnë institucionit të bëjë detyrën e tij, auditimin e jashtëm të të ardhurave dhe shpenzimeve publike, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare dhe ato të INTOSAI-t. Ky draft është mirëpritur pozitivisht nga të gjitha palët e përfshira, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, në veçanti nga Bashkimi Evropian dhe ka marrë miratimin e Komisionit kompetent në Parlament. Ai do të votohet në Parlament së shpejti.

Zoti President, ky vit ka qenë i shënuar për vendin tuaj, sepse Shqipëria u bë një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Rruga për këtë qëllim të përbashkët nuk do të jetë e lehtë. Shumë gjëra duhet të përshtaten, për të siguruar objektivat kryesore të tilla si qeverisja ekonomike.

Bashkimi Evropian e vë theksin në përmbushjen e këtyre objektivave dhe njih rolin e rëndësishëm që ka auditimi i jashtëm publik për arritjen e tyre.

Ne jemi të bindur se KLSH, po avancon në procesin e të qënurit një institucion që vepron në përputhje me standardet e INTOSAI, si mbrojtës i burimeve publike dhe unë kam besim që KLSH çdo herë është e gatshme ta përmbush këtë rol.

Më lejoni që edhe në emër të të gjithë pjesëmarrësve të kësaj Konference, të cilët vijnë nga Shqipëria dhe nga jashtë vendit, edhe një herë t'Ju falënderoj për praninë tuaj sot dhe mbështetjen që Ju i keni dhënë Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Fjala në Konferencën e III-të shkencore të KLSH-së

Mbi bashkëpunimin ILDKPKI- KLSH në funksion të përballjes me sfidat e luftës kundër korrupsionit



I nderuar Z. Kryetar,

Të nderuar pjesëmarrës,

Në emër të ILDKPKI ju uroj përfundimin me sukses të Konferencës së III-të shkencore të KLSH-së *“Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare”* në funksion të luftës kundër korrupsionit dhe përmirësimit të qeverisjes kombëtare.

Ftesën e vlerësojmë si vazhdim i një pune të nisur për një bashkëpunim institucional në funksion të përballimit të sfidave tona të përbashkëta.

ILDKPKI si institucion ligj zbatues, Autoritet qendror përgjegjës që administron dhe kontrollon saktësinë, vërtetësinë dhe burimin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë si dhe rastet e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, vlerëson bashkëpunimin me KLSH-në.

Në veprimtarinë institucionale KLSH-ILDKPKI, ka fushë bashkëpunimi për shkak se auditimi bëhet për asetet dhe fondet publike nga KLSH dhe asetetet dhe të ardhurat e zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta nga ILDKPKI.

Informacionet dhe raportet e auditimit të KLSH-së ndihmojnë në përcaktimin e sektorëve me risk më të lartë korrupsioni. Vlerësimi sektorëve me risk të lartë korrupsioni ndikon për vendosjen e prioriteteve në kontroll dhe hetim administrativ nga ana e ILDKPKI-së , duke përcaktuar një skemë kontrolli sa më efektive.

Është kjo arsyeja që me Marrëveshje bashkëpunim ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave janë përcaktuar objektiva bashkëpunimi reciprok me qëllimin e përbashkët për forcimin e luftës kundër korrupsionit, konfliktit të interesave, veprimeve që çenojnë mirëfunksionimin e administratës publike dhe në të njëjtën kohë mbrojtjen e interesave të shtetit dhe shtetasve.

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet dy institucioneve ka bërë të mundur që të jetë në rritje shkëmbimi i informacionit për rastet e abuzimit me vendimmarrjet e bëra në kushtet e konfliktit të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike dhe abuzimit me pushtetin .

Grupet e auditimit të KLSH-së në ato raste që kanë konstatuar se zyrtarë të institucionit që kontrollojnë kanë vepruar në kushtet e konflikti të interesave dhe në veçanti në fushën e prokurimeve publike, ankandeve dhe koncesioneve kanë njoftuar ILDKPKI-në.

Gjatë këtij viti në prioritetet e kontrollit që kryen ILDKPKI për vërtetësinë, saktësinë dhe burimin e asetet e zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es fëmijëve madhorë, janë vlerësuar informacionet e marra në veçanti nga KLSH, mbi bazën e të cilave janë miratuar nga titullari i institucionit grupet e kontrollit dhe hetimit administrativ duke rritur forcën goditëse ndaj abuzimit me pushtetin dhe përfitimit nga fondet dhe pasuria publike në kushtet e konfliktit të interesave.

Të dy institucionet kanë informuar reciprokisht njëri tjetrin për rezultatet e kontrollit të rasteve abuzive, korruptive apo arbitrare të denoncuar prej tyre.

Me amendimet e bëra nga Kuvendi i Shqipërisë në Prill të këtij viti, në dy ligjet bazë të deklarimit të pasurive dhe rasteve të konfliktit të interesave është krijuar fushë më e gjerë bashkëpunimi me institucionet audituese, kontrolluese dhe antikorrupsion.

Si rezultat i rritjes së pavarësisë së institucionit, kapaciteteve kontrolluese, transparencës dhe përmirësimit të standardeve të cilësisë së kontrollit për herë të parë këtë vit, depozitohet një numër i konsiderueshëm kallëzimesh penale, me pasuri të vëna në mënyrë abuzive në shuma mbi 0.5 - 2 milion Euro. Gjatë këtij viti janë

dërguar në organin e Prokurorisë 73 zyrtarë nga 56 që janë dërguar për periudhën 2004-2013, janë penalizuar administrativisht 323 zyrtarë dhe janë propozuar masa disiplinore për largim nga detyra. Synimi mbetet goditja e korrupsionit në të gjitha nivelet por me prioritet nivelet e larta drejtuese.

Eksperienca dhe përfundimet e kësaj konferencë do të na shërbejë edhe ne si institucion për të përmirësuar metodikën dhe instrumentet e kontrollit në funksion të rritjes së cilësisë së kontrollit dhe forcës goditëse ndaj abuzimit me fondet dhe asetet publike.

Përshendetja e Audituesit të Përgjithshëm të SAI-t të Kroacisë, Zotit Ivan Klesic



Shkëlqesia juaj, President i Republikës së Shqipërisë Zoti Bujar Nishani,
I dashur Zoti Leskaj,
Të nderuar Kolegë,

Unë së pari do të falënderoja personalisht dhe në emër të Zyrës së Auditimit të Shtetit Kroat Kontrollin e Lartë të Shtetit për ftesën në Konferencën e Tretë Shkencor. Raste të tilla si ky, na japin mundësi për ndërtimin e një ure që sjell që bashkon profesionistët profesionin në të gjitha aspektet e rëndësishme. Në këtë drejtim, unë së pari do të doja t'ju përgëzoj për përzgjedhjen e temave të Konferencës.

Proceset e zgjerimit të BE, efektet e krizës financiare globale, si dhe proceset e tjera që ndikojnë në aspektet politike, ekonomike dhe shoqërore ndikojnë dhe në punën e Institucioneve Supreme të Auditimit. Që prej fillimit të shekullit 21, SAI-ev po ju kërkohet një reflektim për rolin e tyre në sistemin e ri dhe së bashku me sektorët shtetërorë të punojnë për një konfigurim të ri për të avancuar drejt modeleve më të përshtatshme të organizimit dhe menaxhimit.

Pyetjet kryesore janë identifikimi i fushave të reja, sfidave të shumta dhe mundësive se si të përballen me to më të mirë. Ndoshta përgjigja më e mirë është dhënë në planin strategjik të EUROSAI: "zgjdhje të përbashkëta, sfidat të përbashkët."

Në frymën e kësaj Moto, kjo Konferencë ka mbledhur ekspertë nga SAI të ndryshme, dhe ofron një mundësi për të debatuar për sfidat moderne të auditimit të qeverisjes. Ajo tregoi se institucionet tona kërkojnë bashkëpunim të fortë brenda hapësirave të reja për veprim dhe filozofisë së re të auditimit, e cila çon në marrjen në konsideratë të strategjive të reja, për të gjeneruar procedura të reja, për të lejuar modele më të përshtatshme të organizimit, menaxhimit, por edhe parashikimin e bashkëpunimit.

Unë jam i sigurt se kjo Konferencë do të shërbejë për të krijuar një klimë të favorshme për nxitjen efektive të bashkëpunimit midis Institucioneve Supreme të Auditimit të rajonit dhe më gjerë. Unë jam gjithashtu i sigurt se ajo do të na frymëzojë të gjithë ne, se si ti perceptojmë zhvillimet e reja, si dhe ku dhe se si ne mund të ndihmojmë njëri-tjetrin.

Në 2012, SAI Kroat dhe ai Shqiptar kanë nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi, në përputhje me parimet e respektit reciprok, besimit dhe bashkëpunimit të përbashkët të dobishme, si dhe me parimet e aplikuara nga INTOSAI dhe EUROSAI . Përveç aktiviteteve të kryera deri tani, ne gjykojmë se kjo konferencë është një orientim i mirë për zgjedhjen e fushtave me dobi të përbashkët në drejtim të bashkëpunimit të ndërsjelltë. I uroj të gjithë pjesëmarrësve të SAI-ve si dhe organizatave donatore të jenë të frymëzuar në të njëjtën mënyrë për të njohur këtë konferencë jo vetëm si një platformë për zhvillimin e qasjeve shkencore të profesionit të audituesit, por edhe si një mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e bashkëpunimit tonë të përbashkët dhe miqësi.

Dhe së fundi, duke përfituar nga rasti i shpreh falënderimet e mia më të sinqerta Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe z. Bujar Leskaj, që organizoi këtë konferencë të madhe, si dhe të gjithë pjesëmarrësve për kontributin e tyre të vlefshme dhe punën kolektive gjatë këtyre 2 ditëve për të forcuar bashkëpunimin, pasuruar njohuritë tona dhe idetë e vlefshme për zhvillimet e ardhshme.

Ju faleminderit shumë dhe urime!

Përshëndetja e Z. Milan Dabovic, President i Senatit, SAI i Malit të Zi



Shkëlqësia juaj, Zoti President i Republikës së Shqipërisë,
I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë,
Të nderuar kolegë,
Zonja dhe zotërinj,

Do të doja të shfrytëzoja këtë mundësi për të shprehur mirënjohjen dhe vlerësim ndaj Presidentit të Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrjen në Konferencën e Tretë Shkencore, organizuar nga mikpritësi ynë, Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Prezenca juaj tregon një njohje të rëndësishme së rolit të pavarësisë dhe profesionalizmit të Institucioneve Supreme të Auditimit në kontekstin e mirëqeverisjes në sektorin publik. Më e rëndësishmja është prezenca juaj, Shkëlqësia juaj, që shpreh një mesazh të qartë të angazhimit dhe mbështetjes për të ardhmen e përbashkët evropiane të rajonit. Në të njëjtën kohë, vendosja në një fokus special e punës sonë, punën e institucioneve supreme të auditimit dhe rëndësia e rolit të tyre për përmirësimin e llogaridhënies publike dhe qeverisjes.

Vlerat dhe dobietë e punës së institucioneve supreme të auditimit, janë të dukshme dhe sigurojnë llogaridhënie, efektivitetet dhe transparencë të përdorimit të burimeve publike në përfitim të qytetarëve. Për të rritur vlerën e punës dhe rezultatet e institucioneve supreme të auditimit, ne duhet të theksojmë rëndësinë e

bashkëpunimit tonë rajonal dhe ndërkombëtar. Bota është duke ndryshuar shumë shpejt, kështu që Institucionet Supreme të Auditimit përballen me sfida të reja në përmirësimin e mirë-qeverisjes dhe llogaridhënies publike. Unë besoj se bashkëpunimi i mëtejshëm profesional midis institucioneve tona duhet të forcohet, në mënyrë që të realizohen sfidat me të cilat institucionet tona përballen në negociatat për në BE. Në procesin e negociatave me BE-në, institucionet supreme të auditimit duhet të japin mbështetje thelbësore në përmirësimin e qeverisjes, ndërkohë që zbatojnë standartet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat më të mira në punën e tyre.

Konferenca do të na ndihmojë të ndajmë praktikat dhe eksperiencat, me qëllim forcimin e besueshmërisë brenda sistemeve tona kombëtare; përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në cilësinë e punës që u ofrojmë qytetarëve.

Është privilegj për mua të jem së bashku me ju në këtë Konferencë.

I nderuar zoti President i Republikës së Shqipërisë, jam i lumtur t'ju uroj edhe një herë mirëseardhjen sot.

Përshëndetja e Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, dhe Presidentit të Gjykatës Austriake të Auditimit, Z. Josef Moser



I nderuar President i Republikës së Shqipërisë, Z. Bujar Nishani,

I nderuar Kryetari Kontrollit të lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj,

I nderuar Këshilltar Kryesor në Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm Publik të DG Budget, Z. Robert Gielisse,

I nderuar Z. Jezierski, Ish Presidenti Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë,

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Është një nder i madh dhe kënaqësi për mua që marr pjesë në Konferencën e 3^{të} Shkencor në Tiranë. Emri im është Wolfgang Wiklicky. Unë jam Drejtori i Përgjithshëm në Gjykatën Austriake të Auditimit, përgjegjës për çështjet e auditimit të Arsimit, Shkencës, Infrastrukturës dhe pasurive të patundshme.

Gjykata austriake e Auditimit përbën gjithashtu dhe Selinë e Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Organizatës ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Dr. Moser ishte i ftuar të merrte pjesë në këtë konferencë të rëndësishëm. Për shkak të disa obligimeve që kanë lidhje me parlamentin kombëtar si dhe disa angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të INTOSAI-t, ai nuk mund të marrë pjesë personalisht në këtë konferencë.

Ai më ngarkoi mua t'ju përcjell Ju urimet e tij më të mira për këtë organizim të suksesshëm dhe mjaft të vlefshëm dhe të ndaj me ju një historik të shkurtër të

bashkëpunimit dypalësh dhe ndërkombëtar, si dhe opinion për temat mbi të cilat INTOSAI ka punuar kohët e fundit.

Bashkëpunimi dypalësh

Institucioni Shqiptar i Auditimit dhe Gjykata Austriake e Auditimit (ACA) kanë bashkëpunuar ngushtë gjatë dekadave të fundit

Që prej themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Gjykata Austriake e Auditimit ka mbajtur kontakte të rregullta dhe të ngushta me këtë Institucion Suprem Auditimi të ri dhe me drejtuesit e tij. Takimi i parë me përfaqësuesit e tij u zhvilluan në ambientet e ACA në vitin 1992. Tema të tilla si mandati i auditimit i ACA, auditimi i pushtetit vendor, kontabilizimi i listës së pagave dhe të shpërblimeve si dhe auditimi i kompanive shtetërore ishin temat e diskutuara.

Gjatë fazës së tranzicionit ky shkëmbim u bë më intensiv. Kështu në vitin 1995 KLSH organizoi një seminar ndërkombëtar me temë “Roli i SAI-t në një demokraci moderne”. Ish presidenti i ACA, Dr. Fiedler kontribuoi në këtë seminar duke paraqitur pikëpamjet e tij si Sekretar i Përgjithshëm i ITOSAI-t duke vënë theksin tek normat e auditimit të Deklaratës së Limës, si dhe udhëzimet e përgjithshme për auditimin e jashtëm publik.

Kjo ekspertizë ishte gjithashtu e mirëpritur kur ACA në pozitën e Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t u ftua të jepte opinionet e saj për projektligjin e KLSH në vitin 1996. Kjo u bërë një praktikë e zakonshme ndërmjet institucioneve tona. ACA është ftuar disa herë për të dhënë opinionet e tilla gjatë dekadave të fundit.

Në vitin 1996, gjatë procesit të tranzicionit, KLSH ka pasur edhe mbështetjen teknike të ACA.

Auditues të KLSH u ftuan për një trajnim një javor ku u trajtuan tema si: mandati i ACA, qasjet e ACA në planifikimin e auditimeve dhe procesi i auditimit, metodat dhe manualët e auditimit, zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore dhe teknologjisë së informacionit dhe mjedisi në ACA.

Mbështetja teknike ka vazhduar gjatë gjithë këtyre viteve. P.sh. dy institucionet tona ranë dakord për organizimin e aktiviteteve të tjera që ndihmonin në ngritjen e kapaciteteve institucionale. Në vitet 2001 dhe 2002, tre përfaqësues të KLSH u trajnuan në ACA kryesisht për kontrollin dhe performancën e buxhetit, kërkesat për prokurim, kërkesat dhe zgjidhjet teknologjisë së informacionit në auditimin e performancës.

Në vitin 2013 ky bashkëpunim mori një kuptim të ri pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit, i cili fokusohet në bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh për çështjet e mëposhtme

- Shkëmbimi i eksperiencave për përmirësimin e metodologjive të auditimit të jashtëm publik.
- Trajnimet dhe përmirësimi i njohurive profesionale të anëtarëve të stafit të të dy institucioneve.
- Shkëmbimi i informacionit dhe dokumentacionit për aktivitetet profesionale të të dy palëve.
- Organizimi i projekteve kërkimore dhe audituese të përbashkëta sipas programeve për të cilat palët kanë rënë dakord më parë

Bashkëpunimi midis dy institucioneve tona ka qenë një bashkëpunim i hapur dhe i besueshëm i bazuar në vlerat e auditimit të jashtëm dhe besimin në vlerat dhe përfitimet e shkëmbimit të eksperiencës së ndërsjellë. Në këtë kontekst, unë do të doja i përcjell mirënjohjen e Dr. Moser, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj, për përpjekjet e tij të vazhdueshme për zhvillimin e mëtejshëm të KLSH.

Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Jo vetëm ACA ka mbajtur kontakte të ngushta me Institucionin Suprem të Auditimit të Shqipërisë por edhe Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, e cila ka dashur të informohet për situatën e auditimit publik në Shqipëri. Hapat e para të vendosjes së kontakteve janë regjistruar në vitin 1962.

Natyrisht që u desh pak kohë, por më në fund KLSH ju bashkua familjes së INTOSA-t në vitin 1984. Në vitin 1992, përfaqësues të KLSH morën pjesë për herë të parë në Kongresin e INTOSAI-t. Kjo shënoi fillimin e një bashkëpunimi frutdhënës sipas motos së INTOSAI-t “ Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit kohët e fundit është bërë anëtar i Komitetit të INTOSAI-t për shkëmbimin e eksperiencave dhe shërbimit të eksperiencave. Bazuar në planin strategjik të INTOSAI-t, mandati i këtij komiteti është “ Inkurajimi i bashkëpunimit midis SAI-eve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i këtij bashkëpunimi përmes shkëmbimit të njohurive duke përfshirë sigurimin e standardeve, kryerje e studimeve për praktikat më të mira, hartimi i materialeve udhëzuese të auditimit dhe kryerjen e hulumtimeve për çështje me interes të përbashkët”. Në kontekstin e INTOSAI-t, tema e pavarësisë së institucioneve është shumë e pranishme.

Rëndësia e pavarësisë së SAI-t për një zhvillim të qëndrueshëm.

Një nga arsyet e thirrjes së kongresit të fundit të INTOSAI-t zhvilluar në Pekin në Tetor të vitit 2013 ishte implementimi i Rezolutës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara A/66/209 për pavarësinë e SAI-eve. SAI-et mund të përmbushin objektivat e tyre vetëm nëse janë të pavarur nga entitetet që auditojnë dhe nga influenca e jashtme. Më tej pranohet roli i rëndësishëm i SAI-t për promovimin e eficiencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe roli i tyre vlerësohet si i paçmuar për arritjen e objektivave të zhvillimit përfshirë dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçare

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit duhet të zhvillohen më tej. Ato duhet të përfshijnë edhe zhvillimin aktual. Për këtë, komuniteti ndërkombëtar i SAI-ev dhe komuniteti ndërkombëtar i shteteve bëjnë thirrje për veprim për të qenë të përgatitur për sfida që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm.

Duhet patur gjithnjë parasysh se zhvillimi i qëndrueshëm mbarë botëror është i mundur vetëm nëse përdorimi i burimeve publike bëhet gjithnjë e më transparent dhe i përgjegjshëm. Rritja e përgjegjshmërisë për veprimet e kryera është një shans

për të ardhmen. Kjo sepse veprimet e sotme nuk duhet të kufizojnë dhe të vënë në rrezik mundësitë e brezave të ardhshëm.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies është gjithashtu e rëndësishme për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucionet. Prandaj qëllimi i përbashkët i SAI-eve duhet të jetë ngjallja e transparencës, rritja e llogaridhënies dhe lufta kundër korrupsionit për të kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm.

Për këtë arsye, INTOSAI ka hartuar një qëndrim për Agjendën e Zhvillimit Post 2015 në të cilën kërkohet përfshirja e pavarësisë, ngritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemit të llogaridhënies si elemente të rëndësishme të kësaj agjendë.

Në nivel global INTOSAI është aktualisht i përfshirë në procesin e përpunimit të Agjendës së Zhvillimit Post 2015 e cila do të përcaktojë të ardhmen e Objektivave për një Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Apeli dhe e ardhmja

Në këtë kontekst i gjithë komuniteti INTOSAI aktualisht po synon miratimin e një rezolute të re të OKB-së më të cilën të përfshihen pavarësia dhe ndërtimi i kapaciteteve të SAI-eve si dhe përmirësimi i llogaridhënies publike. Këto janë dhe objektivat kryesore të Agjendës së Zhvillimit Post-2015 që do të miratohet në vjeshtë 2014.

Tani është shumë e rëndësishme që drejtuesit e SAI-eve të ndërruarin veprime për të rritur ndërgjegjësimin e palëve të interesuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim që të nënvizonte rëndësia e pavarësisë së SAI-ve për një zhvillim të qëndrueshëm, veçanërisht në fushën e financave publike.

Më lejoni të përfundoj duke deklaruar se Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI është i bindur se Kontrolli i Lartë i Shtetit do të vazhdojë të kontribuojë në forcimin e transparencës dhe pavarësisë, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për një të ardhmen më të mirë të qytetarëve, me qëllim forcimin e besimit të tyre në efikasitetin dhe besueshmërinë e institucioneve shtetërore.

Ju faleminderit shumë!

Shënim: Përshëndetja e z.Moser u lexua ne Konferencë nga z.Wolfgang Wiklicky, Drejtor i Përgjithshëm në Gjykatën Austriake të Auditimit, përgjegjës për çështjet e auditimit të Arsimit, Shkencës, Infrastrukturës dhe pasurive të patundshme.

Përshëndetja e SIGMA në Konferencën e Tretë Shkencore të Kontrollit të Lartë të Shtetit



I nderuar zoti Kryetar,

Tema e konferencës së 3-të shkencore është "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare" dhe unë ju përgëzoj për këtë përzgjedhje të mirë të temës. Qeverisja është një koncept gjithëpërfshirës me shumë aspekte. Ajo ka të bëjë me ndërtimin e një mjedisi më të mirë kombëtar dhe rajonal, në të cilin njerëzit mund të jetojnë, mësojnë dhe punojnë, në të cilin sipërmarrësit mund të përtërijnë dhe të tregojnë rezultatet e krijimtarisë së tyre,

dhe në të cilin bizneset mund të investojnë për të krijuar pasuri dhe vende pune. Qeverisja e mirë ka të bëjë me rritjen e besimit tek qeveria, institucionet e saj, në cilësinë e shërbimeve dhe të vendimeve të saj, sepse ato perceptohen se po bëhen në interesin e përgjithshëm, publik.

Përvoja e OECD-se është se vendimmarrja, planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë dhe raportimi të mbështetura në të dhëna u jep qeverive informacionin e nevojshëm për të arritur mendim të thellë strategjik, duke përfshirë problemet e tanishme dhe të ardhme ashtu dhe kontekstin e tyre. Mbështetja për implementimin e strategjive largpamëse, pavarësisht shtrirjes së tyre në horizontin e planifikimit është efektiviteti dhe eficientia me të cilat qeveritë zhvillojnë dhe zbatojnë rregullat.

Rregullimi, dhe njëkohësisht kryera e shpenzimeve dhe vjelja e taksave, është një mjet kyç i qeverisë. Ai është veçanërisht shumë i rëndësishëm për zbatimin e strategjive të qeverisë: Legjislacioni i mirë-projektuar synon t'i ndihmojë qeveritë të arrijnë qëllimet e politikave të tyre. Legjislacioni i keq-projektuar tenton të minojë funksionimin e ekonomisë dhe të vështirësojë jetesën për publikun.

Përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një nga mjetet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtare të zhvillimit strategjik, është një sfidë kryesore në shumë vende. Duke përmirësuar proceset dhe institucionet buxhetore rritet cilësia e financave publike. Efiçenca, efektiviteti dhe transparencja janë tre objektivat themelore të buxhetimit modern. Rregullat fiskale, planet dhe kornizat afat-mesme dhe buxhetimi i performancës kanë treguar të jenë efektive në arritjen e këtyre objektivave.

Transparenca dhe të qëniti i hapur janë elemente themelore të një sistemi normativ që vazhdimisht rregullon duke u mbështetur në të dhëna dhe prova. Transparenca rregullatore është thelbësore për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm dhe të pranueshëm rregullator, i cili nxit konkurrencën, tregtinë dhe investimet, dhe ndihmon të sigurohesh kundrejt ndikimit të paligjshmërive. Transparenca përforcon legjitimitetin dhe drejtësinë e sistemit rregullator. Transparenca në këtë mënyrë shërben për të bërë rregulla lehtësisht të kuptueshme dhe të zbatueshme, dhe kontribuon në lehtësimin e zbatimit, qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë e proceseve ankimore.

Si pjesë e konceptit të qeverisjes kombëtare, Institucionet Supreme të Auditimit mund të luajnë një rol në promovimin e qeverisjes së mirë. Kongresi i XXI i INTOSAI-t e theksoi këtë, duke zgjedhur Auditimin Kombëtar dhe Qeverisjen Kombëtare si një prej dy çështjeve kryesore të Kongresit. Deklarata e Pekinit e INTOSAI-t e vitit 2013, me të drejtë nënvizoi se Institucionet Supreme të Auditimit mund të kontribuojnë në përpjekjet për të mbrojtur demokracinë dhe sundimin e ligjit, pikërisht duke nxitur administrim të ndershëm dhe të pastër të qeverisë apo duke zbuluar paligjshmërinë. Institucionet Supreme të Auditimit mund të kontribuojnë gjithashtu në efiçencën qeveritare, nëpërmjet mbikëqyrjes dhe vlerësimit të veprimtarive qeverisëse dhe zbulimin e mangësive në qeverisjen kombëtare dhe kontrollin. Ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e mashtrimeve financiare, duke ruajtur interesat kombëtare, nëpërmjet sigurimit te

informacionit objektiv, të besueshëm dhe në kohë, për të zbuluar risqet në funksionimin ekonomik dhe social kombëtar.

Institucionet Supreme të Auditimit mund të nxisin më tej përmirësimin e mirëqenies së popullit duke ndihmuar të sigurohet që fondet dhe projektet publike që kanë të bëjnë me jetesën e njerëzve, të jenë nën mbikëqyrje të rreptë dhe të arrijnë impaktin e dëshiruar.

E fundit por jo më e pakta në rëndësi, Institucionet Supreme të Auditimit mund të kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, duke audituar dhe duke publikuar rezultatet e auditimit, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë për të mbajtur sektorin publik të përgjegjshëm, si dhe për të inkurajuar qeverinë dhe organizatat publike që të përmbushin përgjegjësitë e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e burimeve publike.

Shqipëria po përballlet dhe do të përballlet me shumë nga sfidat e mësipërme në rrugën e saj për të përmbushur kërkesat e qeverisjes së mirë. Përvoja e SIGMA-s është që Institucioni Suprem i Auditimit të Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, është plotësisht i vetëdijshëm për rolin e tij për të kontribuar që politikat dhe veprimet e Qeverisë Shqiptare të përmbushin pritshmëritë. Por gjithashtu ai është i vetëdijshëm se i duhet të zhvillohet më tej si një organizatë auditimi profesionale të mirë-respektuar, në mënyrë që të përmbushë këtë rol. Gjatë viteve të fundit, KLSH ka treguar që ka forcën dhe vullnetin për ta bërë këtë. Institucioni Suprem i Auditimit i Shqipërisë ka miratuar Planin e Zhvillimit Strategjik 2013 -2017, i cili përcakton objektivat dhe masat që duhen marrë me qëllim që të jetë i aftë për të kontribuar në mirëqeverisje. Megjithatë, sikurse e deklaroi edhe Deklarata e Pekinit, Institucionet Supreme të Auditimit mund të nxisin qeverisjen e mirë, vetëm në qoftë se ato janë të pavarura nga njësitë që ato auditojnë dhe janë të mbrojtura kundrejt çdo forme të ndikimit të jashtëm. Në këtë drejtim, Institucioni Suprem i Auditimit i Shqipërisë ka propozuar amendamente për ligjin e tij në shtator 2013, të cilat për fat të keq ende nuk janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Deklarata e Pekinit gjithashtu theksoi se është e rëndësishme që metodat e auditimit të SAI-ve të jenë të bazuara në njohuritë aktuale shkencore dhe teknike, dhe që audituesit e tyre të kenë kualifikimin e nevojshëm profesional dhe integritetin moral. Institucioni Suprem i Auditimit të Shqipërisë ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim. Plani i Zhvillimit Strategjik njih qartë nevojën për përmirësimin e njohurive teorike dhe praktike për procesin e auditimit dhe proceseve mbështetëse si dhe aftësitë, përmes trajnimit profesional, por gjithashtu edhe nevojën për vendosjen e një komunikimi të hapur me publikun dhe botën shkencore. Kjo Konferencë e III –të Shkencore është një shembull shumë i mirë i vullnetit të KLSH për t’u hapur dhe për të diskutuar çështje me interes reciprok, nga diskutimet e të cilave të dy palët mund të përfitojnë në punën e tyre të përditshme.

I nderuar zoti Kryetar,

Ju uroj Ju dhe të gjithë pjesëmarrësve të Konferencës së III-të Shkencore të Institucionit Suprem të Auditimit të Shqipërisë diskutime të gjalla dhe të plota, si dhe një konferencë të suksesshme. Jam i sigurt se të gjitha kontributet do të jenë të përgatitura mirë, shumë interesante dhe shumë të frytshëm, në veçanti për stafin e institucionit tuaj të auditimit.

Sinqerisht i juaji,

Joop Vrolijk

OECD / SIGMA

Shënim : Përshëndetja në Konferencë e z.Joop Vrolijk u lexua nga z.Albert Thoma, Kryeaditues, KLSH

**Punime të
prezantuar
në Konferencë**

Konferenca e III-të Shkencore e KLSH-së

- Robert Gielisse, CIA, CGAP
 - Këshilltar Kryesor,
- pranë Drejtorit të Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
 - DG Budget, Komisioni European

PËRGËZIME
SHQIPËRI !

Statusi i vendit kandidat nuk është fundi, por vetëm fillimi ...

3

- **Strategjia e re e Zgjerimit e vendos në vijën e parë Qeverisjen Ekonomike**
- **KLSH si Audituesi i Jashtëm është gur themeltar**

4

Rolet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm

- Komplementariteti
- Rol special i institucionit suprem të auditimit si një trupë **realisht e pavarur**

5

A është KLSH i gatshëm për këtë rol?

A është i nevojshëm të kryhet një ndryshim?

6

Disa shqetësime u bënë prezente gjatë diskutimit të ligjit të KLSH-së në Parlament

- Qasja në dokumentacion
- Roli i KLSH-së ndaj autoriteteve tatimore
- Vlera e rekomandimeve të KLSH-së

Garancitë

- Standardet INTOSAI
- Kodi i Etikës
- Rishikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm i Cilësisë
- Raportimet e KLSH në Parlament
- KLSH ka shërbimin e vet të Auditimit të Brendshëm

8

Nga Igor SOLTES, Deputet i Parlamentit Evropian, **“Auditimi në shërbim të qeverisjes kombëtare”**



I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit , Dr.Leskaj, miku im i ngushtë, President të shquar dhe pjesëtar të delegacioneve të Institucioneve Supreme të Auditimit, kolegë, të nderuar moderatorë, folës, të nderuar miq! Gjatë javëve të fundit kam marrë pjesë në dy evente ndërkombëtare ku u trajtuan çështjet e përgjegjshmërisë publike, transparencës dhe luftës kundër korrupsionit. Konkluzioni i të gjithë debateve ishte se duhet të ndërmarrim veprime të menjëhershme sepse besimi i publikut po ulet ndjeshëm për shkak të keq menaxhimit, mashtrimeve, veprimeve neglizhente në financat publike. Lufta e ashpër kundrejt këtyre patologjive do të çojë në fitimin e besimit të taksapaguesve.

Në shkurt të këtij viti, për herë të parë Komisioni Evropian paraqiti Raportin mbi korrupsionin në 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian, ku ish-Komisioneria e Punëve të Brendshme, Cecilia Malmstrom theksoi *"Korrupsioni minon besimin e qytetarëve tek institucionet demokratike dhe shtetit ligjor, dëmton ekonominë evropiane dhe i privon shtetet nga përfitimet e të ardhurave nga taksat."*

Është një surprizë dhe fakt i pabesueshëm që korrupsioni në Evropë kushton 120 miliard euro në vit, afërsisht sa 1% e të ardhurave ekonomike, ky fakt është përmendur në Raportin e Komisionit Evropian. Gjetjet e Raportit të KE janë në përputhje me gjetjet e "Transparency International" në lidhje me indeksin e

perceptimit të korrupsionit. Forcimi i qeverisjes dhe përgjegjshmërisë në administratën publike dhe promovimi i praktikave më të mira në të gjithë nivelet e shpenzimeve publike është shumë i domosdoshëm.

Unë e kam theksuar në shumë raste, që çështjet e parandalimit të mashtrimeve dhe korrupsionit duhet të përfshihen në çdo kohë nga Institucionet e Auditimit. Raporti i Komisionit Evropian tregon se shumë qytetarë të BE mendojnë se korrupsioni është rritur si rezultat i krizës së thellë ekonomike dhe problemeve financiare, si pasojë e krizës së borxheve.

Kështu që është e qartë se në çdo kohë dhe në çdo situatë financiare përdorimi me eficiencë, efektivitet dhe në mënyrën e duhur i fondeve publike është bërë i domosdoshëm dhe janë mjete shumë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të Bashkimit Evropian. Institucionet Supreme të Auditimit luajnë rolin e mbikqyrësit dhe japin siguri që qëllimet e Bashkimit Evropian të bëhen realitet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Është e rëndësishme të theksohet se një nga temat kryesore të Kongresit të INCOSAI në vitin 1998 ishte : *"Institucionet Supreme të Auditimit në Parandalimin dhe Zbulimin e Korrupsionit dhe Mashtrimeve."*

Kjo pasqyrohet fuqimisht në rritjen e vetëdijes së anëtarëve të INTOSAI për këtë problem, i cili ekziston në shkallë dhe forma të ndryshme në shtetet anëtare.

Konkluzionet e debateve të Kongresit u përmblodhën në Marrëveshjen "INCOSAI URUGUAI të Vitit 1998". Që prej atëherë u evidentua që lufta kundër korrupsionit dhe mashtrimit duhet të jetë e qëndrueshme dhe të bëhen përpjekje kombëtare afatgjata. Vetëdija për situatën është hapi i parë për zgjidhjen e duhur dhe për një histori suksesi.

Gjatë dy dekadave të fundit ka pasur histori të konsiderueshme, kërkime shkencore, udhëzime, manuale dhe praktika të mira, me gjithë vlerësimin për rolin e SAI-ve në parandalimin e mashtrimeve dhe korrupsionit. Dhe emëruesi i përbashkët, i theksuar nga studimi i OECD i vitit 2011, është që Institucionet Supreme të Auditimit mund të

luajnë një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e shpërdorimit të parave publike dhe luftën kundër korrupsionit. Kjo gjetje u theksua dhe në studimet e kryera nga "Transparency International". Observimi i tyre nxjerr në pah rolin e rëndësishëm që luajnë Institucionet Supreme të Auditimit në luftën kundër korrupsionit dhe keqpërdorimit të resurseve publike.

Megjithatë një impakt të rëndësishëm në efektivitetin e SAI-ve jep pavarësia institucionale dhe financiare e Institucioneve Supreme të Auditimit. Z.Magnus Borge, ish-Drejtori i Përgjithshëm i "INTOSAI DEVELOPEMENT INITIATIVE" ka theksuar që roli qendror i SAI-ve në luftën kundër korrupsionit, është promovimi i mekanizmave të fuqishme të kontrollit të brendshëm në Institucionet Publike.

Zonja dhe Zotërinj,

Forcimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në arenën e financave publike mund të bëhet vetëm kur Institucionet Supreme të Auditimit janë themeluar mbi parimet kryesore të autonomisë, pavarësisë dhe transparencës.

Duhet theksuar përpjekjet e suksesshme të INTOSAI për promovimin e eficiencës, efektivitetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës në administratën publike duke forcuar SAI-it. Këto përpjekje janë të pasqyruara dhe në Rezolutën A/66/209 të Kombeve të Bashkuara në Asamblenë e Përgjithshme, të mbajtur në Dhjetor 2011.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm është dhe bashkëpunimi dhe koordinimi midis SAI-ve dhe institucioneve të tjera të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Institucionet Supreme të Auditimit duhet të përpiqen të krijojnë modele efektive bashkëpunimi me Drejtoritë e Auditit të Brendshëm të institucioneve publike.

Ndërtimi i rrjeteve midis organizatave dhe agjencive të zbatimit të ligjit është shumë rëndësishëm në parandalimin e korrupsionit dhe mashtrimeve.

Dhe e fundit po jo pak e rëndësishme, është se efektiviteti dhe efienca e këtyre iniciativave varen nga vullneti që ka klasa politike.

Më lini t'ju them se një temë tjetër komplekse është presioni që vendoset nga publiku dhe mediat ndaj Institucioneve Supreme të Auditimit në parandalimin e

korrupsionit, edhe kur ai nuk ka lënë gjurmët e tij në dokumentacion. Pritshmëria e mediave është të eliminojnë korrupsionin e çdo lloj forme, por audituesit kanë detyrë të kontrollojnë dokumentacionin dhe evidencat fizike të ndodhura në dosjet, të cilat janë objekt kontrolli. Duke theksuar se shumë SAI janë shumë aktive në luftën kundër korrupsionit duke përdorur mjetet e duhura për të qenë më shumë efektivë në identifikimin e fushave me risk, duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera. Burime të tjera të cilat mund ti shërbejnë audituesve dhe SAI-ve janë ankesat e qytetarëve, të dhënat nga OJF-të dhe institucione të tjera të zbatimit të ligjit.

Zonja dhe Zotërinj,

Më duhet ta mbyll fjalimin tim me besimin se secili prej nesh do të luaj rolin e tij për t'i bërë të ditur publikut të gjerë që Institucionet Supreme të Auditimit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në luftën kundër abuzimeve me fondet publike. Ne kontrollojmë përputhjen me ligjet, fokusohemi tek performanca duke u bazuar në praktikat më të mira dhe rekomandojmë përmirësimet e nevojshme.

Jam i lumtur dhe i nderuar si pjesëtar i Komisionit të Kontrollit të Buxhetit në Parlamentin Evropian të bashkëpunoj me ju për të vendosur në zbatim strategjitë dhe praktikat më të mira.

Të nderuar kolegë ju uroj konferencë të mbarë!

Faleminderit për vëmendjen!

Marrëdhënia midis Pavarësisë, Performancës dhe Qeverisjes së Mirë në Institucionin Suprem të Auditimit

*Nga Dr. Milan Dabović, President i Senatit,
Institucioni Shtetëror i Auditimit në Malin e Zi,*

milan.dabovic@dri.co.me



Abstrakt:

Objektivi kryesor i këtij materiali është të vlerësojë dhe të shqyrtojë marrëdhënien dhe influencën e pavarësisë operative të Institucioneve Supreme të Auditimit në performancën e administratës publike. Institucioni Suprem i Auditimit duhet të japë shembullin e tij në mirë qeverisje. Në përgjithësi, ky material shtjellon idenë e përgjithshme të temës dhe bazohet në studimin e rastit të marrëdhënies midis pavarësisë dhe qeverisjes së mirë të Institucionit Suprem të Auditimit në Malin e Zi.

Fjalët Kyçe: *Pavarësi, Performancë, Treguesit e performancës, Të dhëna, Produkti, Programe, Aktivitete.*

Parathënie

Ky material është i organizuar në pesë paragrafë kryesore, titujt e të cilëve japin një ilustrim të shkurtër të elementëve të nevojshëm për konkluzionet që jepen në paragrafin përfundimtar të këtij materiali. Paragrafi i parë “*Koncepti i përgjithshëm i*

pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit” jep një shpjegim konçiz të komponentëve kryesorë të pavarësisë dhe i referohet standardeve ndërkombëtare. Duke shpjeguar parimet bazë, ky paragraf vë theksin tek rëndësia dhe roli i pavarësisë gjatë procesit të auditimit dhe tek angazhimi i komunitetit ndërkombëtar në çështjen esenciale që lidhet me funksionimin e qeverisjes së mirë audituese. Paragrafi i dytë *”Roli dhe rëndësia e qeverisjes së mirë”* merret me premisat që çojnë në një qeverisje të mirë në lidhje me buxhetimin modern. Praktika buxhetore duhet të përmirësohet me auditimin e mirë, i cili duhet të merret me analizën konstante në mënyrë që të zhvillojë një metodologji efektive gjatë procesit të planifikimit të shpenzimeve. Në lidhje me këtë, një referencë e shkurtër i është bërë elementëve të praktikës buxhetore e cila duhet të promovohet gjatë auditimit dhe të kërkohet nga institucionet të cilave i përshtatet. Paragrafi i tretë *”Roli dhe rëndësia e marrëdhënies midis auditimit, performancës dhe qeverisjes së mirë”* shpjegon rolin e institucioneve supreme të auditimit si një e tërë brenda sistemit të menaxhimit të mirë të fondeve publike. Roli dhe rëndësia e auditimit të qeverisë si një mekanizëm korrektues në parandalimin e veprimtarisë devijuese, analizohet brenda kontekstit të rregullshmërisë dhe efikasitetit të përdorimit të fondeve publike. Paragrafi i katërt *”Pavarësia e institucioneve supreme të auditimit dhe qeverisja e mirë”* merret me marrëdhënien dhe rolin e pavarësisë të institucioneve supreme të auditimit brenda kontekstit të qeverisjes së mirë në sektorin publik nëpërmjet procesit të planifikimit të përdorimit të fondeve publike. Procesi i kërkuar auditues ngre pikëpyetje që lidhen me financimin e institucioneve supreme të auditimit dhe sigurimin e një shkalle të nevojshme pavarësie për përmbushjen e objektivave të përcaktuara. Paragrafi i pestë *”Pavarësia e institucioneve supreme të auditimit-një shembull i qeverisjes së mirë”*, dëshmon detyrimet e institucioneve supreme të auditimit që lindin nga një koncept i pavarësisë. Institucionet supreme të auditimit duhet të përfaqësojnë një shembull të trajtimit të duhur të fondeve publike. Praktika e mirë e menaxhimit të fondeve

publike është një kërkesë thelbësore e institucioneve supreme të auditimit, për të krijuar besim publik në punën e tyre.

1. Koncepti i përgjithshëm i pavarësisë të Institucioneve Supreme të Auditimit

Parimet e përgjithshme të pavarësisë përshkruhen në Deklaratën e Limës, duke përfshirë përkufizimin e përgjithshëm të pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit, pavarësinë financiare dhe pavarësinë e anëtarëve dhe zyrtarëve të këtyre institucioneve. Pavarësia e institucionit suprem të auditimit i referohet pozicionit të tij brenda kuadrit ligjor të një vendi specifik. Ky fakt është i pranuar që institucionet supreme të auditimit nuk mund të jenë absolutisht të pavarur, sepse janë pjesë e shtetit si një i tërë. Institucionet Supreme të Auditimit duhet të kenë pavarësi organizative dhe funksionale në mënyrë që të përmbushin detyrat e tyre. Institucionet supreme të auditimit mund ti përmbushin detyrat e tyre në një mënyrë efektive dhe objektive vetëm nëse janë të pavarur nga enti i cili po auditohet dhe të mbrojtur nga influencat e jashtme. Për këtë arsye, themelimi i Institucioneve Supreme të Auditimit dhe shkalla e nevojshme e pavarësisë së tyre duhet të vendoset në kushtetutë, ndërkohë që detajet mund të përcaktohen në legjislacion.

Kushtet për një punë efektive dhe të funksionimit të institucioneve supreme të auditimit janë të përcaktuara në Deklaratën e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-ve, e cila përfshin parimet themelore të pavarësisë nëpërmjet një kuadri ligjor kushtetues të përshtatshëm dhe efektiv të aplikimeve de fakto të masave në këtë strukturë. Ekzistenca e pavarësisë së SAI-ve titullarët dhe anëtarët (e institucioneve kolegjiale), duke përfshirë sigurinë e zotërimit dhe imunitetin ligjor në shkarkimin e detyrave të tyre. Ekzistenca e një mandati të mjaftueshëm dhe të plotë dhe liria e veprimit në kryerjen e funksioneve në Institucionin Suprem të Auditimit, hyrje e pakufizuar në informacione, e drejta dhe detyrimi për të raportuar punën e tyre, liria për të vendosur për përmbajtjen dhe kohën e raportimit të auditimit për publikimin dhe

shpërndarjen e këtyre raporteve. Ekzistenca e mekanizmave përforcues të rekomandimeve dhe autonomia menaxheriale dhe financiare, gjithashtu dhe disponueshmëria e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare. Deklarata e Meksikës shtjellohet nëpërmjet udhëzimeve dhe praktikës së mirë që ka të bëjë me pavarësinë e SAI-ve, shembujt e të cilëve i referohen parimeve, siç përcaktohen në Deklaratën e Meksikës. Udhëzimet tregojnë mjetet që ndihmojnë institucionet supreme të auditimit që të arrijnë pavarësi.

Deklarata e Limës dhe e Meksikës theksohet më tej në Deklaratën e Pekinit mbi promovimin e qeverisjes së mirë nga Institucionet Supreme të Auditimit.

“Që nga fillimi, qëllimi kryesor i INTOSAI-T, ka qenë promovimi i qeverisjes së mirë. SAI-t mund të kryejnë mirë detyrat e tyre vetëm nëse janë të pavarur nga entet të cilat i auditojnë dhe nëse janë të mbrojtur nga influencat e jashtme. INTOSAI njohu gjithashtu se është thelbësore që metodat e auditimit të SAI-ve, bazohen në njohuritë shkencore dhe teknike dhe që audituesit e tyre duhet të kenë kualifikimet e duhura profesionale dhe integritetin moral.

Prandaj në vitin 1997 INTOSAI, adoptoi Deklaratën e Limës dhe me Deklaratën e Meksikës në vitin 2007 përcaktoi 8 parimet e pavarësisë së auditimit të jashtëm publik në terma metodologjike dhe profesionale”

Deklarata e Pekinit, paragrafi 24, nënvizon misionin e institucionit suprem të auditimit duke theksuar rolin e tij të qartë në promovimin e arritjeve demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

“Qeveritë dhe qytetarët e të gjithë shteteve kërkojnë promovimin dhe përmirësimin e qeverive kombëtare, në mënyrë që të mundësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit. Si një pjesë thelbësore e qeverisë kombëtare, auditimi kombëtar kryen funksionet e tij në përputhje me ligjet dhe rregullat dhe siguron, në një mënyrë objektive, mbikëqyrjen audituese, verifikimet, vlerësimet dhe rekomandimet që vendimmarrësit kombëtar përdorin për të bërë politikat dhe

programet vendimmarrëse. SAI-t duhet të përpiqen që të qëndrojnë si përkrahës të besimit, ndershmërisë dhe integritetit në jetën publike”

Roli i institucioneve supreme të auditimit theksohet në mbrojtjen e demokracisë dhe shtetit ligjor, gjithashtu dhe në rritjen e eficiencës qeveritare në luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e interesit kombëtar, promovimit të përmirësimit të mjeteve të jetesës së njerëzve dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së sektorit publik.

2. Roli dhe rëndësia e Qeverisjes së Mirë

Efektiviteti i administratës publike varet nga cilësia e planifikimit të shpenzimeve publike dhe përzgjedhjes së detyrave të programuara për tu financuar nga fondet buxhetore; ekzekutimi efikas i buxhetit brenda kuadrit ligjor; varet nga cilësia e shërbimeve ndaj qytetarëve; sigurimi i informacionit të besueshëm dhe të përshtatshëm ndaj publikut dhe përdorimi i përshtatshëm i fondeve publike. Rregullshmëria, saktësia dhe efica e sistemit të administratës publike dhe përdorimi i fondeve publike duhet të orientohet dhe të jetë në varësi të interesit më të mirë të qytetarëve dhe të zbulohet në një formë e cila mundëson sanksionimin e fenomenit negativ në një mënyrë koherente dhe transparente.

Procesi i planifikimit efektiv kërkon një buxhetim modern duke identifikuar qëllimet afatgjata të veprimtarive qeveritare, gjithashtu dhe masat e performancës dhe rezultatet në lidhje me objektivat e përcaktuara. Një element thelbësor në përcaktimin e qëllimeve afatgjata i referohet klasifikimit të shpenzimeve në “programe”, “nënprograme” dhe “aktivitete”, të cilat përcaktohen me detaje dhe specifikohen në lidhje me qartësimin e objektivave të përcaktuara. Klasifikimi i veprimtarive qeveritare në programe përdoret gjerësisht dhe implementimi i mëtejshëm i tyre do të ketë një influencë për një transparencë më të madhe. Megjithatë duhet të theksohet se klasifikimet e programeve janë një suplement dhe nuk zëvendësojnë klasifikimin tradicional administrative. Një numër shtetesh po zhvillojnë një sistem të sofistikuar të rezultateve (ose të performancës) të orientuar

të buxhetimit dhe mbajtjes së llogarive financiare. Këto aktivitete janë shumë të rëndësishme për të rritur nivelin e transparencës së zgjedhjeve strategjike dhe operacionale të kryera nëpërmjet buxheteve qeveritare. Është e mira që këto transaksione të klasifikohen sipas veprimtarisë apo produktit, dhe sipas programit apo të ardhurave. Çdo programim ka një ose më shumë objektiva të cilat përfaqësojnë një detyrë dhe një qëllim në planifikimin e një programi. Veç kësaj, çdo objektivi duhet të jetë specifik, i matshëm dhe i arritshëm brenda një kohe specifike dhe në përputhje me fondet e akorduara.

Treguesit e programit përfaqësojnë instrumente të cilat përdoren për të ndjekur rezultatet sipas realizimit të objektivave të programit. Këto janë lloje të ndryshme të treguesve të programeve midis të cilëve më të rëndësishmit janë ndjekja e: të dhënave, përfundimet, treguesit e performancës, rezultatet. Të dhënat përfaqësojnë burimet (faktorët e prodhimit) të nevojshme për përmbushjen e objektivave të programit. Roli i tyre është thelbësor për planifikimin e shpenzimeve aktuale. Përfundimet shërbejnë për të matur një sasi të mirash dhe shërbimesh që sigurohen nga implementimi i programimit të detyrave. Rëndësia e tyre lidhet me matjen e produktivitetit dhe nivelin e financimit të programeve. Eficienca tregon të ardhurat për njësi, të të mirave dhe shërbimeve, ose eficiencën mund të shprehet si një shpenzim për njësi ose shërbim ose si një shpenzim në lidhje me rezultatin e arritur. Rezultatet tregojnë eficientësinë e programeve në lidhje me arritjen e rezultateve të dëshiruara.

3. Roli dhe rëndësia e marrëdhënies midis auditimit, performancës dhe qeverisjes së mirë.

Në terma të përgjithshme, auditimi në sektorin publik përfaqëson një metodologji që përfshin rezultate të veprimtarive të kryera nga sektori publik të cilat financohen nga fondet publike. Tregu kontrollon, veprimtaritë e sektorit real dhe vlerëson përdorimin efektiv të kapitalit privat. Duke paguar taksat, sipërmarrësit pjesërisht

kanë të drejtën të përdorin kapitalin për një sipërmarrje individuale me qëllimin për të siguruar prodhimin e organizuar dhe shërbimet e nevojave të përgjithshme, të cilat përfshijnë objektiva ekonomike dhe politike të kombit, shtetit, qeveritë rajonale, lokale ose vetëqeverisjet.

Me qëllimin përmbushjen e nevojave të përgjithshme, përdorimi eficient i fondeve publike nuk mund të sigurohet nëpërmjet mekanizmave të tregut. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se përdorimi i këtyre fondeve mund të jetë joeficient. Sidoqoftë, kur fondet publike janë të limituara, ato duhet të planifikohen dhe të përdoren në një mënyrë të saktë dhe eficiente dhe duhet të sigurojnë informacion të besueshëm dhe të dobishëm për publikun rreth sasisë dhe cilësisë në përmbushjen e nevojave publike. Fondet publike të përdorura për nevojat publike, përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të sistemit ekonomik.

Prandaj, mekanizmat e përshtatshëm duhet të sigurohen për të ruajtur raportet e përdorimit të fondeve publike dhe normalitetit ekonomik. Veprimtaria e limituar e tregut që lidhet me sigurimin e shërbimeve publike, krijoi një nevojë për kontroll të vazhdueshëm administrativ mbi rregullshmërinë e përdorimit të fondeve dhe racionalizmin e menaxhimit të tyre nga shteti. Prandaj, sistemet e pavarura administrative u institucionalizuan dhe kanë për detyrë të kryejnë një auditim të vazhdueshëm të përdorimit të fondeve publike një mënyrë profesionale dhe objektive që të parandalojnë keqpërdorimin e tyre dhe abuzimet. Për këtë arsye, Deklarata e Limës që u hartua nga INTOSAI fillon me formulimin që vijon:

“Auditmi nuk përfaqëson një fund në vetvete, por një pjesë thelbësore të sistemit rregullator, qëllimi i të cilit është të shfaqë devijime nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, eficientë, efektivitetit, dhe ekonomisë të menaxhimit financiar, herët mjaftueshëm për të bërë të mundur marrjen e masave korrigjuese në raste individuale duke i detyruar ato të mbajnë dhe të pranojnë

përgjegjësi, të marrin kompensim, ose të ndërmarrin hapa për të parandaluar ose të paktën, t'ja bëjnë më të vështirë kryerjen e këtyre shkeljeve”

Përshtatja e subjekteve të sektorit publik sipas procedurave të përgjithshme ligjore, standardeve ndërkombëtare dhe përdorimi eficient i fondeve publike harmonizon dy interesa: interesin kolektiv dhe interesin e individëve që përmbushen gjatë punës në institucionet publike nëpërmjet të ardhurave personale. Natyra e nevojave të individëve është më e fortë sesa interesi kolektiv, si rrjedhojë kjo mosmarrëveshje zgjidhen nga një kërkesë për të respektuar vazhdimisht normat ligjore. Normat ligjore si parime të pranuar dhe të miratuara nga Parlamenti, mund të mos jenë ideale dhe aplikimi i tyre shpesh mund të jetë i dobët nga individët të cilët e implementojnë.

Ky devijim motivohet nga interesi individual i cili gjeneron devijime brenda sistemit të sektorit publik dhe si rrjedhojë auditimi ka një rol parandalues në zbulimin dhe eliminimin e këtyre devijimeve. Mosbindja ndaj normave ligjore mund të motivohet nga fitimet personale ose nga proceset e pamjaftueshme trajnuese. Procesi trajnues duhet të merret me përmirësimet e sistemeve financiare të sektorit publik. Modalitetet e devijimeve, për shkak të interesave personale ose proceseve të pamjaftueshme trajnuese, prodhojnë një rezultat të ngjashëm i cili mund të përcaktohet si një administrim jo efektiv publik. Auditimi në vetvete duhet të bëjë kërkime për të dhënë zgjidhje problemeve të qartësimit teorik të problemeve; parandalimin e devijimeve brenda sistemit dhe përdorimin e tyre për të fituar privilegje të gabuara personale ose kolektive. Auditimi në vetvete duhet të përmirësojë praktikën e mirë në sektorin publik.

Auditimi i performancës është një auditim pas faktit, megjithatë janë të paktën dy shembuj të qasjeve para faktit. Zyra Qeveritare e Kontabilitetit (GAO), mund të vlerësojë programin përpara implementimit të tij dhe mund të ekzaminojë dhe të përcaktojë planifikimet e performancës të një agjencie të veçantë, të aprovuar nga dega ekzekutive. Gjykata Federale e Llogarive Gjermane ka një rol specifik në

sigurimin e një shërbimi të pavarur në mënyrë që të ndihmojë Komisionin Parlamentar të Buxhetit gjatë diskutimit të propozimit të projektligjit të Buxhetit nga Qeveria. Për të siguruar këtë shërbim, gjetjet nga auditimet e performancës post faktit mund të përdoren , por gjithashtu mund të zhvillohen studime performance para faktit. Auditimi i performancës fillon nga veprimtaritë dhe vlerësimi nëse këto janë subjekt realizimi të objektivave të përcaktuara brenda kuadrit të programeve apo nënprogrameve për të vlerësuar performancën. Aktivitetet gjenerojnë shpenzime në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërkohë që programet dhe nën programet përfaqësojnë një grup sistematik, të integruar dhe të sinkronizuar aktivitete që sjellin rezultate. Për këtë arsye, verifikimi i shpenzimeve në nivel veprimtarish përfaqëson një tregues të përdorimit të arsyeshëm dhe ekonomik të burimeve. Verifikimi i veprimtarive fokuson vëmendjen e audituesëve në lidhjen midis subjekteve të audituara rreth fondeve publike, ose përshtatshmërinë e veprimeve që lidhen me përmbushjen e objektivave të përcaktuara në programe dhe nënprograme. Kushtet e përgjithshme të cilat duhet të përmbushen në auditim, kërkojnë një verifikim të lidhjes logjike të objektivave të përcaktuara nga nën programet, programet dhe objektivat e përgjithshme qeveritare; ekonominë e shpenzimeve që dalin nga aktivitete konkrete; saktësinë dhe vlefshmërinë e sasisë dhe cilësi së rezultateve të prezantuara nga një subjekt auditues; eficiencën e përdorimit të fondeve publike në lidhje me objektivat e përcaktuara, eficienta, gjithashtu edhe raporti midis objektivave të planifikuara dhe atyre të arritura.

4. Pavarësia e institucioneve supreme të auditimit dhe qeverisja e mirë.

Duke filluar nga elementët bazë të pavarësisë së Institucioneve supreme të Auditimit, si edhe të premisave për të siguruar një proces auditimi i cili kontribuon në një administratë publike, është e nevojshme që të konsiderojmë elementët bazë të pavarësisë në lidhje me përmbushjen e kësaj detyre. Në përgjithësi, cikli i shpenzimeve publike përfshin veprimtaritë qeveritare që kanë të bëjnë me procesin

e planifikimit buxhetor, realizimin e buxhetit dhe raportimin e tij. Mandati dhe liria e veprimit të Institucionit Suprem të Auditimit, referuar mandatit të tij dhe të drejtës për të vlerësuar dhe përcaktuar eficiencën e alokimit të fondeve publike në një mënyrë profesionale dhe objektive, konfirmojnë ose mohojnë politikat e shpenzimit gjithashtu dhe saktësinë e raportimit të shpenzimeve publike për një periudhë të caktuar.

Procesi planifikues i shpenzimeve publike, i përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit, përfaqëson një dokument strategjik i cili konkretizon të drejtat e qytetarëve që rrjedhin nga ligje specifike të sistemit, fondet e të cilëve janë të alokuara në programet dhe projektet për implementimin e prioriteteve dhe objektivave qeveritare. Plani real i buxhetit duhet të bazohet në vlerësimet e shëndosha makroekonomike dhe në procedurat analitike që garantojnë shpenzime të arsyeshme brenda sistemit të administratës publike. Gjatë fazës së planifikimit; mjedisi ekonomik shtetëror krijohet duke pasur parasysh se shpenzimet publike përbëjnë një komponent të rëndësishëm të sistemit ekonomik. Vlerësimet e paanshme dhe objektive të vlefshmërisë së premisave në të cilat buxheti dhe politikat qeveritare janë planifikuar dhe krijuar, kërkojnë një ekspertizë të pavarur; e cila vlerëson në një mënyrë ekzakte dhe metodologjike, saktësinë dhe objektivitetin e supozimeve makroekonomike dhe korrelacionet e testeve të përmbajtjes së programeve me objektivat bazë dhe politikat ekonomike të qeverisë. Prandaj, Institucionet Supreme të Auditimit, duhet të kenë pavarësi organizative dhe financiare e cila do të sigurojë kushtet për një vlerësim ekspertize të vlefshme dhe vëzhgime profesionale dhe kritike në lidhje me planifikimin buxhetor. Njësitë organizative të specializuara kanë nevojë të marrin mbështetje funksionale, duke pasur parasysh lirinë në përzgjedhjen e stafit, financimit dhe edukimit. Liria e Institucionit Suprem të Auditimit është jetësore, në mënyrë që të punësojë ekspertë të jashtëm pa pasur ndalesa që kanë të bëjnë me çështjet e kohës dhe çështjeve të planifikuara për të audituar. Kreativiteti i

auditimit nuk duhet të limitohet nga format e ngurta, përkundrazi duhet të zhvillohet, projektohet dhe promovohet

Procesi i realizimit të buxhetit duhet të përmbushet me rregullat e përshkuara në ligjin organik të buxhetit dhe ligjin vjetor të buxhetit, i cili përcakton strukturën dhe qëllimin e shpenzimeve publike. Kjo kërkon një kryerje konstante të auditimeve të rregullshmërisë, i cili i referohet ekzaminimit të përputhshmërisë së këtij veprimi sipas rregullave dhe standardeve të përgjithshme për mbledhjen e të hyrave publike, financimit të shpenzimeve, menaxhimi dhe dispozicioni i aseteve, implementimi i detyrimeve dhe dokumentimi i të hyrave dhe shpenzimeve publike. Vlerësimi i pavarur i raporteve të Institucionit Suprem të Auditimit nga qeveria, mund të jetë i besueshëm vetëm nëse bazohet në procedurat e sakta dhe gjetjet të cilat aprovohen nga publiku. Kjo do të thotë që Institucioni Suprem i Auditimit duhet të ketë lirinë për të informuar publikun rreth gjetjeve në raportet e tij të kuptueshme, të lexueshme dhe të thjeshta. Gjithashtu ngarkon edhe një detyrim ndaj Institucionit Suprem të Auditimit për të qenë sa më transparent në punën e tij dhe për të bërë punën e tij të vlefshme ndaj palëve të interesuara.

Përputhshmëria me ligjin është kushti i parë paraprak për një qeverisje të mirë, sepse siguron një disiplinë fiskale, transparencë dhe konsekuencë në pajtim me konceptet fiskale të aprovuara nga legjislativi. Veç kësaj, detyra e Institucionit Suprem të Auditimit i referohet ekzaminimit të ekonomisë, eficiencës dhe efektivitetit të entit të audituar, si tregues kryesor për ekzaminimin e përdorimin racional të fondeve publike. Auditimi i performancës nuk mund të standardizohet në një mënyrë metodologjike duke paraqitur rregulla të ngurta metodologjike, dhe është e nevojshme të përgatiten udhëzime elastike të cilat mund të përdoren dhe të rregullohen për një situatë, subjekt ose çështje specifike të auditimit. Teknikat e eficiencës në auditim mund të standardizohen gjatë procesit të drejtimit dhe planifikimit të auditimit. Pjesa më e madhe e teknikave të aplikueshme i referohen

njohurive të ndryshme të ekspertëve në mënyrë që treguesit që rrjedhin dhe që sigurohen gjatë procedurës audituese, përfaqësojnë një konkretizim dhe një sintezë të një numri të madh analizash në të cilat mund të bazohen konkluzionet e audituesit. Prandaj pavarësia e institucionit Suprem të Auditimit, është e nevojshme në procesin e përcaktimit të procedurave më të mira metodologjike. Pavarësia e institucionit suprem të auditimit, është jetësor në raportim sepse konfirmon në mënyrë të paanshme ose mohon observacionet apo konkluzionet e arritura gjatë procesit auditues në nivelin më të lartë profesional. Çështjet metodologjike të bazuara në praktikën e mirë të institucionit suprem të auditimit janë të lidhura ngushtë me pavarësinë e Institucioneve Suprem të Auditimit, të cilët kanë burime të mjaftueshme për të siguruar profesionalizmin e përshtatshëm në grupin e auditimit, cilësinë e planifikimit të auditimit, projektimi i procedurave dhe zgjedhja e teknikave të cilat do të arrijnë objektivin e dëshiruar nga një auditim specifik në një mënyrë efektive.

5. Pavarësia e institucioneve supreme të auditimit- një shembull i qeverisjes së mirë

Standartet ndërkombëtare , përfaqësojnë udhëzime, të cilat përgjithësisht përcaktojnë organizimin e institucioneve supreme të auditimit, mbarëvajtjen e procesit të auditimit si edhe cilësinë dhe vlefshmërinë e raporteve të auditimit në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Standardet ndërkombëtare ndryshohen dhe përditësohen në lidhje me konsekuencën e parimeve bazë që janë në fuqi në formën aktuale ose të ndryshuar. Marrëdhënia midis pavarësisë, performancës dhe qeverisjes së mirë është njohur si një parim themelor i praktikës së mirë e cila jep një integritet profesional dhe kompetencë institucionit suprem të auditimit të përmbushë kërkesat profesionale të auditimit në sektorin publik. Identiteti lokal i Institucioneve Supreme të Auditimit, kryesisht i referohet

infrastrukturës ligjore kombëtare. Infrastruktura ligjore kombëtare më së shumti respekton parimet kryesore të përcaktuara nga standardet ndërkombëtare.

Kuadri ligjor i Institucioneve Supreme të Auditimit ndryshon nga një vend në tjetrin dhe varet nga trashëgimia; kushtet politike dhe kapacitetet demokratike; njohja e misionit dhe rolit të auditimit qeveritar; kushtet ekonomike dhe ndërgjegjësimi i nevojës për të krijuar një sektor publik eficient dhe efektiv. Të gjithë këto elemente së bashku me standardet ndërkombëtare sigurojnë format dhe mënyrat e auditimit të sektorit publik me një kuptim më të zakonshëm se cilësia e punës së Institucioneve Supreme të Auditimit, varet nga pavarësia e tyre.

Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit nënkupton liri veprimi, e cila është e nënshtruar funksionalisht të drejtave themelore të qytetareve me qëllimin për të kuptuar më mirë sistemin e shpenzimeve publike gjithashtu edhe të drejtën për të pasur një influencë në sistemin e shpenzimeve publike nëpërmjet procesit të krijimit të një shërbimi publik efektiv. Çdo frenim i punës audituese të qeverisë mund të ndikojë drejtpërdrejtë ose indirekt në dobësimin e funksionimit të një auditimi të qëndrueshëm në sektorin publik.

Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit, gjithashtu përfaqëson detyrimin e tyre për të bërë punën e tyre më transparente, efektive dhe të besueshme profesionalisht. Detyrimi i tyre i korrespondon të drejtave themelore të Institucioneve Supreme të Auditimit. Idea e promovimit të shërbimeve efiçente lind nga themelimi dhe funksionimi i auditimeve qeveritare. Një shërbim auditimi publik është i besueshëm, vetëm sipas afatit në të cilin arrin objektivat duke siguruar një informacion transparent ndaj publikut rreth gjetjeve pa hedhur dyshime në objektivitetin, paanshmërinë, etikën dhe profesionalizmin e tij.

Administrimi efektiv publik kërkon një auditim efektiv, dhe një auditim efektiv kërkon një veprimtari auditimesh të cilat mund të sigurohen nëse institucionet supreme të auditimit kanë një shkallë të lartë pavarësie financiare dhe organizative si edhe

autonomi në marrjen e vendimeve. Institucioni Suprem i Auditimit duhet të japë shembullin e tij në qeverisje të mirë. Nga ana tjetër, pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit, kërkon një shkallë të lartë përgjegjësie. *"Pavarësia, llogaridhënia dhe transparenca e SAI-ve janë parakushte themelore në një demokraci të bazuar në sundimin e ligjit dhe i mundëson SAI-ve të ndjekin një shembull dhe të shtojnë besueshmërinë e tyre"*¹ Në këtë linjë, Institucionet Supreme të Auditimit, duhet të udhëhiqen nga parimet të cilat sigurojnë:

- Transparencën dhe llogaridhënien në shpenzimin e fondeve të alokuara;
- Buxhetimi; prej të cilit kufizimet e përgjithshme respektohen brenda sistemeve të arsyeshme , por që nuk do të dëmtojnë zhvillimin e tij ose limtojnë qëllimin dhe cilësinë e auditimeve;
- Rekomandimet frutdhënëse që do të përmirësojnë vazhdimisht sistemin e administratës publike dhe do të sigurojnë një shpenzim publik racional;
- Zbatimi konsekuent i ligjit brenda sistemit të administratës publike, dhe
- Transparencë të gjetjeve për të cilat publiku është i informuar në një mënyrë konsekuente dhe efektive.
- Treguesit e efektivitetit të punës së Institucioneve Supreme të Auditimit, mund të shprehet si një përpjesëtim i fondeve buxhetore të shpenzuara nga Institucionet Supreme të Auditimit dhe numrit të auditimeve. Ky tregues mund të luajë një rol kyç në fazën e hershme të zhvillimit të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe në një fazë më të vonë të zhvillimit, ky tregues duhet të shprehet në përpjesëtim me shkallën e mbulimit të shpenzimeve publike nëpërmjet auditimit dhe numrit të rekomandimeve të aprovuara nga legjislativi të implementuara nga ekzekutivi. Cilësia e shërbimeve të Institucioneve Supreme të Auditimit, duhet të jetë ekzakte, transparente dhe e matshme në lidhje me fondet e caktuara buxhetore.

¹ ISSAI 20 – *Principet e transparencës dhe llogaridhënies*;
http://www.issai.org/media/12930/issai_20_e_.pdf

6. Pavarësia dhe qeverisja e mirë- Institucioni Shtetëror i Auditimit në Malin e Zi

Parlamenti i Republikës së Malit të Zi, në Prill të vitit 2004, në sesionin e tij të 21-të miratoi Ligjin e Institucionit Shtetëror të Auditimit në Malin e Zi, i cili përcaktoi themelimin e institucionit shtetëror të Malit të Zi. Institucioni Shtetëror i Auditimit u pozicionua ligjërisht brenda Kushtetutës së Malit të Zi, në Tetor të vitit 2007, neni 144 i Kushtetutës së Malit të Zi parashikon: *“Institucioni Shtetëror i Auditimit në Malin e Zi, do të jetë i pavarur dhe autoriteti më i lartë i auditimit kombëtar. Institucioni i Auditimit Kombëtar do të auditojë ligjshmërinë dhe performancën e aseteve shtetërore dhe të hyrave publike, buxhetet dhe të gjitha transaksionet financiare të enteve , burimet e të cilave janë publike ose të krijuar nëpërmjet përdorimit të pronës publike. Institucioni i Auditimit Kombëtar do t’i paraqesë një raport vjetor parlamentit. Senati do të menaxhojë Institucionin Kombëtar të Auditimit”*. Pozicioni kushtetues i Institucionit Kombëtar të Auditimit garanton një pavarësi institucionale dhe një menaxhim kolegjal po aq të gjatë sa mandati i këtij institucioni. Senati menaxhon punën e Institucionit Shtetëror Auditues të Malit të Zi. Veçmas nga Senati, ligji mbi SAI-n përshkruan organet e institucionit si Borda Auditimi. Në këtë mënyrë, çështja e menaxhimit horizontal dhe vertikal të institucionit u zgjidh duke ruajtur një nivel të lartë teknik gjatë përgatitjes së raporteve të auditimit dhe kryerjes së procesit të auditimit. Menaxhimi horizontal i referohet punës së Bordit të Auditimit, i cili është në krye të procedurave audituese dhe i mbikëqyr ato, si edhe është përgjegjës për rezultatet e auditimit. Bordi i Auditimit është i përbërë nga dy anëtarë të Senatit, njëri prej të cilëve është drejtuesi i sektorit të kryerjes së auditimit. Bordi i Auditimit siguron paanshmëri në procesin auditues dhe garanton mbrojtje gjatë formimit të opinionit auditues të bazuar në gjetje të shëndosha dhe të vlefshme. Në rastin kur Bordi i Auditimit nuk mund të arrijë në një vendim, atëherë Senati e merr vendimin.

Institucioni shtetëror i auditimit të Malit të Zi, është një organ i pavarur dhe autonom shtetëror dhe askush nuk mund të influencojë anëtarët e Senatit të këtij institucioni në kryerjen e detyrave të tyre. Pavarësia e institucionit nënkupton pavarësi funksionale; pavarësi organizative; pavarësi financiare dhe qëndrueshmëri të zyrtarëve anëtarë të Senatit. Pavarësia dhe autonomia e punës së institucionit sigurohet nga pavarësia e anëtarëve të Senatit në fushën e llojeve të planifikimeve dhe numrit të auditimeve, çështjet themelore të auditimit dhe formimi i opinionit auditues në përputhje me gjetjet e auditimit.

Fondet për punën e institucionit sigurohen nga Buxheti i Malit të Zi. Institucioni shtetëror i auditimit i propozon një projekt buxhet organit kompetent të Parlamentit, i cili ka për detyrë të përcaktojë projekt buxhetin e këtij institucioni. Kur organi kompetent i Parlamentit përcakton projekt buxhetin e institucionit, ja paraqet Qeverisë, e cila është e detyruar për të përcaktuar dhe për t'ja paraqitur propozimin e këtij ligji në buxhetin vjetor shtetëror parlamentit të Malit të Zi në përputhje me ligjin organik të buxhetit. Nëse Qeveria bën ndonjë ndryshim në projektligjin e paraqitur nga Institucioni Shtetëror i Auditimit, atëherë Qeveria është e detyruar të paraqesë Parlamentit, një shpjegim të shkruar për ndryshimet në projektbuxhet. Në këtë mënyrë, sigurohet pozicioni kushtetues i Qeverisë në propozimin e buxhetit të shtetit. Pavarësia financiare e institucionit garanton pavarësinë e tij nga impakti i degës së ekzekutivit. Nëse Qeveria bën ndonjë ndryshim tek projektbuxheti i Institucionit, Parlamenti merr një vendim përfundimtar në vlerën e fondeve për financimin e detyrave që ka Institucioni, duke miratuar ligjin e propozuar në buxhetin vjetor shtetëror

Mandati i Institucionit përfshin të gjitha segmentet e interesit publik, nëse i referohet pronës shtetërore ose , të ardhurat e siguruara nga forca e ligjit ose përdorimi i pronës shtetërore. Në këtë mënyrë, nuk ka asnjë mënyrë për të mënjanuar auditimet e organeve të cilat mbledhin të hyrat publike nga tregu dhe përdorimi i pronës

publike shtetërore, ose që janë të përjashtuara nga mbikëqyrja e sistemit buxhetor dhe të hyrat publike që sigurohen nga forca e ligjit.

Planifikimi i auditimit fillon me një plan vjetor, i cili përcakton elementët bazë për përzgjedhjen e enteve që do të auditohen, çështjet që do të auditohen dhe afatet për kryerjen e këtyre auditimeve. Planifikimi bazohet fillimisht në nevojat për të përfshirë fondet e planifikuara për sistemin e shpenzimeve publike; gjetjet e marra nga auditimet e mëparshme; gjithashtu informacionet e marra në terren. Zgjedhja e enteve publike për tu audituar planifikohet nga fundi në fillim, në mënyrë që propozimet të formulohen nga audituesi shtetëror duke u bazuar në njohuritë dhe eksperiencën për probleme potenciale, të marra gjatë punës në terren. Pas përfundimit të auditimit, Institucioni Shtetëror i Auditimit, përgatit një raport auditimit i cili përfshin: gjendjen faktike, vlerësimin, konkluzionet, dhe rekomandimet për eliminimin e devijimeve dhe parregullsitë të gjetura gjatë auditimit. Raportet e auditimit i paraqiten enteve të audituara dhe organeve të tjera, kur Institucioni Shtetëror i Auditimit e shikon të arsyeshme.

Raportet e Institucionit Shtetëror të Auditimit i raporton Parlamentit dhe Qeverisë duke paraqitur një raport vjetor, raporte të veçanta dhe duke dhënë këshilla. Një pjesë integrale e raportit vjetor është raporti i auditimit mbi llogaritë përfundimtare të buxhetit, i cili është një detyrim ligjor i institucionit dhe raporti mbi aktivitetet e kryera të institucionit, i cili i paraqitet Parlamentit të Malit të Zi. MP dhe organet kompetente të punës, marrin informacion mbi aktivitetet e Institucionit të Auditimit Shtetëror, që kanë të bëjnë me numrin e auditimeve të planifikuara, numrin e auditimeve të kryera, informacionet rreth strukturës organizative dhe burimeve të përdorura, kryerjen e planit financiar, informacione mbi trajnimet dhe aktivitetet ndërkombëtare.

Konkluzion

Administrata efektive publike përfaqëson një grup të vazhdueshëm aktiviteteve që inkurajojnë përdorimin racional dhe ligjor të fondeve publike. Në këtë proces, rolin kyç e ka Institucioni Suprem i Auditimit. Veprimtaritë e Institucionit Suprem të Auditimit duhet të jenë të pavarura, profesionale dhe të bazuara në praktikën e mirë audituese dhe sjelljen e përshtatshme në përdorimin e fondit të tij buxhetor. Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit të përshkruara nga kushtetuta dhe ligji, duhet të sigurojë lirinë dhe maturinë e të drejtës së institucioneve që kanë për qëllim të planifikojnë dhe të kryejnë auditime në një mënyrë profesionale, trajnimet e stafit auditues dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve. Prandaj Institucioni Suprem i Auditimit jep shembullin e tij në menaxhimin e financave publike nëpërmjet punës në termat e shpenzimit të buxhetit dhe gjetjeve të auditimit. Është thelbësore që Institucionet Supreme të Auditimit të përmirësojnë vazhdimisht sistemin e treguesve, prej të cilit do të matet efica dhe efektiviteti i veprimeve të tij në një mënyrë transparente dhe të qartë. Institucioni Suprem i Auditimit, duhet të përpiqet drejt përmirësimit të përdorimit të fondeve publike.

Referenca:

- EUROSAI [Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit] (2013), *Konkluzione dhe Rekomandime të Kongresit IX EUROSAI, e vlefshme në website: <http://www.eurosai2014.nl/neës-conclusions-and-recommendations>;*
- IMF [Fondi Monetar Ndërkombëtar] (2001), *Manuali mbi Transparencën Fiskale, Departamenti i Punëve Fiskale, ISBN 1-58906-055-5;*
- INTOSAI [Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit] (1998), *Deklarata e Limës Udhëzime mbi Perceptime Auditimi, e vlefshme në website: <http://www.issai.org/1-founding-principles/>;*

-INTOSAI [Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit] (2007), Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, e vlefshme në Website:

http://www.issai.org/media/12922/issai_10_e.pdf,

-INTOSAI [Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit] (2007), INTOSAI Udhëzimet dhe Praktika e Mirë e Lidhur me Pavarësinë e SAI t, e vlefshme në website: http://www.issai.org/media/12918/issai_11_e.pdf;

-INTOSAI [Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit] (2010), Parimet e transparencës dhe llogaridhënies; e vlefshme në website: [http://www.issai.org/media/12930/issai_20_e .pdf](http://www.issai.org/media/12930/issai_20_e.pdf);

INTOSAI [Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit] (2013), Deklarata e Pekinit e vlefshme në website [http://www.intosai.org/congresses/EN Beijing Declaration plus Annexes.pdf](http://www.intosai.org/congresses/EN_Beijing_Declaration_plus_Annexes.pdf);

Shand D, (2007), Auditimi Performancës and Buxhetimi Performancës

Arritja e rezultateve dhe e objektivave të biznesit në institucionet publike

Ph.D. Verica Akrap

Zyra Shtetërore e Auditimit e Republikës së Kroacisë

Verica.Akrap@revizija.hr



Vitet e fundit, Kroacia gjithnjë e më shumë po ndjek praktikën e shteteve me traditë të zhvilluar në auditimin e sektorit publik, ku auditimit të performancës i jepet vëmendje dhe rëndësi më e madhe. Autori përshkruan praktikën e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Kroacisë, në rastin e auditimeve të performancës në arritjen e rezultateve dhe objektivave të institucioneve publike në pronësi të qeverive lokale dhe territoriale (rajonale). Gjatë kerkimeve për të gjetur praktika më të mira për të menaxhuar fondet publike, është vlerësuar se praktikatat e kontroleve rutinë të transaksioneve individuale janë të paefektshme sepse nuk ka gjasa gjasa që zbulimi i parregullsive do të parandalojë ndodhjen e dështimeve të ngjashme në të ardhmen. Prandaj, Zyra Shtetërore e Auditimit të Republikës së Kroacisë gjithnjë fokusohet në vlerësimin me efektivitetin dhe përputhshmëri në kontrollet e menaxhimit. Duke dhënë rekomandime ajo kërkon të inkurajojë menaxhimin e institucioneve publike për të matur performancën e tyre kundrejt objektivave të përcaktuara qartë dhe treguesve të performancës. Të vepruarit në këtë mënyrë mund të ndihmojë në rritjen e llogaridhënies dhe për rrjedhojë përmirësimin e qeverisjes.

Fjalë kyçe: *auditim performance, mirë qeverisje, institucione (ndërmarrje) publike.*

Ligji i zyrës së Auditimit¹ përcakton se objekt i auditimit janë: të ardhurat dhe shpenzimet shtetërore, pasqyrat financiare dhe transaksionet financiare të subjekteve juridike të themeluara nga Republika e Kroacisë apo qeveritë lokale dhe rajonale, ndërmarrjet (kompanitë) dhe subjektet e tjera, në të cilat Republika e Kroacisë apo qeveritë lokale dhe rajonale kanë në pronësi shumicën e aksioneve. Sipas ligjit, auditimi i ndërmarrjeve publike nuk është i kufizuar vetëm për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, por gjithashtu përfshin një vlerësim me efikasitetin dhe efektivitetin të veprimtarive, si dhe një vlerësim të efektivitetit në drejtim të arritjes së objektivave të biznesit dhe transaksioneve financiare individuale, programeve dhe projekteve. Zyra Shtetërore e Auditimit planifikon dhe kryen auditimin në masën e parashikuar nga programi vjetor dhe plani i punës, si dhe me kërkesë të Parlamentit kroat nëse Auditori i Përgjithshëm konstaton se kërkesa është e justifikuar. Fushat e programit dhe planit vjetor të punës përcaktohen në bazë të: - dispozitave të Ligjit, vlerësimit të riskut, rëndësisë financiare të objektivave të kontrollit, rezultateve të auditimit të mëparshëm, mbledhjes së informacionit në lidhje me veprimtarinë e biznesit, si dhe kritereve të tjera, siç përcaktohet me aktin e brendshëm të Zyrës së Auditimit të Shtetit. Auditimet janë kryer në mënyrën dhe sipas procedurave të përcaktuara në standartet e auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe Kodit të Etikës për Audituesit e Shtetit.

Aplikimi i parimeve të mirë qeverisjes

Mirë qeverisja përfshin aplikimin e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies. Për këtë arsye, në vitet e fundit

¹ Zakon o Državnom uredu za reviziju, Narodne novine 80/2011.

Kroacia ka forcuar kuadrin institucional, nëpërmjet të cilit synon të arrijë një menaxhim efikas të financave publike, dhe rregulloret që shprehimisht kërkojnë aplikimin e parimeve të mirë qeverisjes. Ligji i Buxhetit parashikon që buxheti duhet të përdoret në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar, veçanërisht në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit. Aktet e përgjegjësive fiskale përcaktojnë rregullat që kufizojnë shpenzimet qeveritare, rrisin përgjegjësinë për përdorimin ligjor dhe funksional të burimeve publike, dhe forcojnë sistemin e kontroleve dhe mbikëqyrjes për të siguruar përgjegjësinë fiskale. Në gusht 2006 Qeveria Kroate adoptoi planin e zhvillimit strategjik për 2006-2013 me qëllim për të afirmuar standardet më të larta të qeverisjes korporative, duke mos u kufizuar vetëm në kompanitë, aksionet e të cilëve janë të listuara në bursa. Është konsideruar i nevojshëm forcimi i Drejtorisë së Ministrisë së Financave, që është përgjegjëse për monitorimin e rezultateve të institucioneve publike, në mënyrë që rezultatet e menaxhimit të këtyre institucioneve të përmirësohen. Menaxhimi duhet, ndër të tjera, të konsiderojë zbatimin e parimeve të OECD-së për qeverisjen korporative në institucionet shtetërore dhe të sigurojë mbështetje për futjen e parimeve të njëjta të biznesit në kompanitë në pronësi të qeverive lokale². Të gjitha format e mësipërme janë pikënisja dhe baza për kryerjen e auditimeve të performancës, kjo është arsyeja pse ky lloj auditimi meriton një vëmendje të veçantë. Kontrolli efektiv i menaxhimit në të gjitha nivelet është një parakusht për demokracinë e mirëfilltë dhe mirë qeverisjen, që do të thotë menaxhim transparent dhe i përgjegjshëm i burimeve njerëzore, natyrore, ekonomike dhe financiare në mënyrë që të arrihet një zhvillim i balancuar. Për këtë, Institucionet Supreme të Auditimit kanë një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm³. Pothuajse të gjithë SAI-t e shteteve anëtare të BE-së auditojnë

² Vlada Republike Hrvatske: *Strateški okvir za razvoj 2006.-2013.*, Središnji državni ured za razvoju strategiju i koordinaciju fondova EU

³ De Sousa, A.J.: Roli i SAI-t në mirë qeverisjen, Revista EUROSAI, Tribunal de Cuentas, No. 9, Madrid, 2002, str. 42.

institucionet publike⁴. Megjithatë, kjo nuk është e deklaruar në mënyrë specifike në rregulloret e tyre. Megjithatë, ata të gjithë janë dakord se Institucionet Supreme të Auditimit duhet të inkurajojnë menaxhimin e institucioneve publike për të matur performancën e tyre kundrejt objektivave të përcaktuara qartë dhe treguesve të performancës. Ata gjithashtu janë dakord se institucionet publike duhet të sigurojnë informacion të plotë mbi pasqyrat financiare dhe të sigurojnë informacion të mjaftueshëm mbi ecurinë dhe rezultatet, për të siguruar në mënyrë të përshtatshme llogaridhëniën publike. Në përputhje me rekomandimet për krijimin dhe funksionimin e duhur, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të përqëndrohen në zhvillimin e cilësisë së lartë dhe sistemeve të efektshme të menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucionet e përzgjedhura për të audituar.

Auditimi i performancës për arritjen e rezultateve dhe objektivave të biznesit

Në Republikën e Kroacisë, qëllimi dhe objektivi i krijimit të një institucioni publik në nivel lokal është arritja e një interesi të veçantë në komunitetin lokal (rajon), i cili është themeluar me vendim nga organi përfaqësues (këshillat e qytetit, të komunës apo asambleja e qarkut). Arsyet për themelimin e ndërmarrjeve publike mund të bazohen në arritjen e objektivave të fushëveprimit të vetëqeverisjes me rëndësi lokale dhe/ose rajonale ose rregulloreve të veçanta. Aktivitetet e bizneseve në interesin publik, ndër të tjera, janë ato realizime të cilat nuk do të sjellin fitim në ndërmarrjet publike (të ardhurat nga aktivitete të tilla nuk i mbulojnë kostot dhe sjellin humbje) dhe që kanë ndikim në ngritjen e standardit të jetesës së qytetarëve, si dhe arritjen e objektivave të fushave vetëqeverisëse që kanë të bëjnë me kulturën, kulturën fizike, sportin, përmirësimin e mjedisit, etj. Për më tepër, rregulla të veçanta mbi të cilat janë themeluar institucionet publike janë: Akte për Menaxhimin e nevojave të qënësishme (Fletorja Zyrtare 26/03 (teksti i konsoliduar), 82/04, 110/04,

⁴ Bën përjashtim Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar. Ato deklaruan se auditimi i institucioneve publike nuk është në kuadër të mandatit të tyre. (Burimi: Auditimi në Bashkimin Evropian, 2005, fq.9)

178/04, 38/09, 79/09, 153/09 dhe 144/12), Ligji mbi ujin (Fletorja Zyrtare 153/09, 63/11, 130/11 dhe 56/13), Ligji për Zhvillimin Rajonal të Republikës së Kroacisë (Fletorja Zyrtare 153/09), Ligji për Mbeturinat (Fletorja Zyrtare 178/04, 111/06, 60/08 dhe 87/09), Ligji për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Mbetjeve (Fletorja Zyrtare 94/13), Ligji për Median (Fletorja Zyrtare 59/04, 84/11 dhe 81/13), Ligji për media-n elektronike (Fletorja Zyrtare 153/09, 84/11 dhe 94/13) dhe rregulloret e tjera. Gjatë vitin 2014, Zyra Shtetërore e Auditimit të Republikës së Kroacisë kryen auditime të performancës për arritjen e rezultateve dhe objektivave të biznesit të 92 institucioneve publike në pronësi të pushteteve lokale dhe rajonale bazuar në 20 qarqe. Këto ndërmarrje publike janë zgjedhur kryesisht për shkak se kanë marrë nga buxheti fonde të konsiderueshme për operacione të rregullta në formën e mbështetjes nga themeluesit. Për këtë arsye ata operuan me mbështetjen financiare të themeluesit sepse të ardhurat e tyre nuk ishin të mjaftueshme për të financuar operacionet e biznesit në arritjen e objektivave dhe detyrave. Që prej periudhës 2010 – 2012 janë gjeneruar të ardhura prej themeluesve në shumën 244,645,214.00 KN, të cilat përbëjnë 23,2% të të ardhurave totale. Ndër këto, 14 institucione publike nga 92 të përfshira në auditim, vepronin pa mbështetjen financiare të themeluesit. Objekt i auditimit ishin aktivitetet e këtyre institucioneve publike që lidhen me përcaktimin e objektivave të biznesit, matjen e rezultateve të biznesit si dhe arritjen e qëllimeve të planifikuara që nga themelimi i institucioneve publike. Proçedurat e auditimit përfshijnë operacionet e biznesit për vitet 2010-2012.

Aktivitetet e biznesit për ndërmarrjet publike të audituara janë të lidhura me inkurajimin e zhvillimit rajonal, menaxhimin e zonave të biznesit, tërheqjen e shërbimeve për investimet, zhvillimin e projektit, përgatitjen e biznesit, zhvillimin, investimet dhe planet e tjera, ndërmjetësimin tregtar, menaxhimin e mbeturinave, të kulturës fizike, menaxhimin e pasurive të njësisë vendore, unifikimin e faturimit për shërbimet, prodhimin dhe transmetimin e programit të radios , publikimit dhe printimit.

Objektivat e auditimit ishin:

- Të verifikojë nëse objektivat e biznesit janë të vendosura në përputhje me planet dhe pritshmëritë e themeluesve
- Të verifikojë nëse institucionet publike kanë arritur objektivat e planifikuara për biznesin.
- Të përcaktojë nëse është hartuar në mënyrë të përshtatshme matja e rezultateve dhe monitorimit të biznesit
- Të verifikojë nëse institucionet publike kanë arritur rezultate të kënaqshme për bizneset
- Të vlerësojë se sa është arritur qëllimi i synuar fillimisht.

Shtylla e auditimit ishte e përbërë nga pyetjet kryesore: A janë arritur rezultatet dhe qëllimet e planifikuara të biznesit, për të cilat janë krijuar këto institucione publike në pronësi të pushtetit lokal dhe rajonal të bazuara në 20 qarqe? Kjo pyetje është vlerësuar në tri nën-pyetje, ku secila vazhdon në një seri të nën-pyetjeve më të hollësishme.

Nën-pyetjet kryesore ishin:

- A kanë vendosur institucionet publike objektivat e biznesit?
- A kanë matur institucionet publike rezultatet e biznesit?
- A është arritur qëllimi i synuar (i planifikuar) nga institucionet publike?

Auditimi përfshiu fushat e mëposhtme: vendosjen e objektivave të biznesit, matjen e rezultateve të biznesit dhe arritjen e qëllimit të planifikuar nga hartuesit e institucioneve publike. Përjasja e auditimit dhe metodat e zbatuara nga institucionet e larta të auditimit në masë të madhe varen nga njohuritë dhe përvoja e audituesit të shtetit, nga bilanci financiar dhe aktivitetet e subjekteve të audituara. Për të marrë dëshmi të mjaftueshme në auditim u përdorën metoda të ndryshme, të vlefshme dhe të përshtatshme në procedurat e auditimit. Në institucionet publike janë dërguar pyetësorë që përmban pyetje në lidhje me vendosjen e objektivave të biznesit,

matjen e performancës së biznesit dhe arritjen e qëllimit të synuar të hartuara prej tyre. Janë verifikuar dëshmitë e pohimeve individuale nga përgjigjet që janë marrë nga pyetjet përmes pyetësorëve. Janë ekzaminuar dhe analizuar akte, rregullore dhe ligje të tjera si dhe dokumente dhe informacione mbi operacionet dhe strategjitë e biznesit të institucioneve publike dhe artikuj të ekspertëve. U verifikua nëse institucionet publike kanë përcaktuar misionin e tyre, vizionin dhe objektivat strategjike në përputhje me objektivat strategjike të hartuesit. Për më tepër është verifikuar miratimi i planeve (afatgjat) strategjike të zhvillimit dhe miratimit të programeve të punës vjetore / planeve të operimit të biznesit, si dhe hartimi i një raporti të punës dhe raporti i hartuesit mbi rezultatet e arritura të biznesit. Është realizuar rishikimi i të dhënave të raportuara në pasqyrat financiare dhe librat e llogarive dhe është krahasuar me të dhënat e periudhave të mëparshme, planin, raportet e dorëzuara dhe pasqyrat financiare të hartuara. Për disa të ardhura dhe shpenzime materiale, janë përdorur metodat e mostrave për të verifikuar dokumentat e kontabilitetit që janë përdorur si dëshmi e ngjarjeve të transaksioneve të biznesit. Janë aplikuar procedurat e përshtatshme analitike në përcaktimin e strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve dhe llogaritjen dhe analizimin e treguesve të performancës në veprimet e biznesit. Drejtorët, punonjësit dhe themeluesit e institucioneve publike janë intervistuar dhe janë marrë nga personat përgjegjës shpjegimet e ngjarjeve individuale të biznesit.

Zyra Shtetërore e Auditimit ka vlerësuar se institucionet publike nuk ishin mjaft efektive në arritjen e rezultateve dhe objektivave të biznesit. Parregullsitë dhe neglizhenca që u zbuluan nga nevoja për të korrigjuar me qëllim arritjen e rezultateve për rritjen e efikasitetit dhe objektivat e biznesit. Janë bërë rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e operacioneve të biznesit në institucionet publike. Pritet që implementimi i rekomandimeve të kontribuojë në arritjen e përgjegjësive më të mëdha duke u fokusuar në objektivat strategjike në përputhje me planet e hartuara si dhe operacionet më të suksesshme të biznesit të institucioneve publike.

Gjithashtu, qëllimi i rekomandimeve është për të shmangur dobësitë dhe për zbatimin e parimeve të mirë qeverisjes. Gjetjet në auditim lidhen me vlerësimin e arritjes së rezultateve dhe objektivave të biznesit dhe pikërisht kanë të bëjnë me vendosjen e objektivave të biznesit, matjen e rezultateve të biznesit dhe arritjen e qëllimit të synuar nga institucionet publike.

Vendosja e objektivave të biznesit

Duke pasur parasysh se qëllimi dhe objektivi i krijimit të institucionit publik, të përfshirë nga auditimi, është realizimi i interesit publik në bashkësinë lokale dhe rajonale, objektivat e biznesit të institucioneve publike duhet të jenë të bazuara dhe të jenë në përputhje me objektivat e themeluesot të biznesit. Sipas nenit 61 të Ligjit të Buxhetit (Fletorja Zyrtare 136/12 dhe 87/08), për ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve publike në interes të publikut, shteti ose vetëqeverisja lokale ose rajonale mund të përdorin pasurinë e tyre për të krijuar institucionet, ndërmarrjet publike dhe subjektet e tjera ligjore. Sipas Nenit 35 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale dhe Rajonale (Fletorja zyrtare 33/01, 60/01, 129/05, 109/07 125/08 36/09, 36/09, 150/11, 144/12 dhe 19/13), organi përfaqësues përcakton institucionet publike dhe subjektet e tjera ligjore për operacionet ekonomike, sociale, shërbimet dhe aktivitetet e tjera në mënyrë që të arrihen objektivat e caktuara që janë në interes të njësisë së qeverisjes vendore ose rajonale.

Në përputhje me qëllimet dhe objektivat e krijimit të subjektit, një organ përfaqësues përcakton veprimtarinë, e cila shkruhet edhe në aktin themelues (deklaratë mbi themelimin, kontratë sociale) dhe rregjistrohet në regjistrin e subjekteve tregtare.

Vendosja e objektivave të biznesit dhe planifikimi është faza më e rëndësishme mbi të cilat realizohen qëllimet operacionale dhe rezultatet e biznesit. Plani strategjik (strategjia) është dokumenti bazë, nëpërmjet të të cilit përcaktohet misioni, vizioni, qëllimet e përgjithshme dhe specifike dhe mënyra për t'i arritur ato, janë vendosja e prioritetëve në punën dhe zhvillimin e shoqërisë, i cili synon të arrijë qëllimet themelore të biznesit dhe zhvillimin e aktiviteteve kyçe për shoqërinë. Strategjia

është një ide, një plan biznesi (mujo, vjetor, afatmesëm dhe afatgjatë), e cila përcakton, *si, kur, ku, çfarë do të thotë dhe pse duhet të bëjë diçka*. Planet e biznesit duhet të dalin nga strategjia. Planifikimi përfshin krijimin e zbatimit të qëllimeve përmes treguesve të përcaktuar të performancës për monitorimin dhe raportimin. Për treguesit e performancës së operacioneve të biznesit është e nevojshme të krijohet një bazë paraprake e vlerave të synuara dhe të inkorporohen brenda planit strategjik. Treguesit e performancës së operacioneve të biznesit duhet të jenë të qartë, të matshëm dhe të shprehur në mënyrë të qartë, në mënyrë që të mund të përdoren për të matur progresin. Nëse ato nuk janë të përcaktuara kështu, realizimi i matjeve dhe monitorimit nuk është i mundur.

Në 83 institucione publike nga 92 të përfshira në auditim, u gjenden parregullsi dhe mangësi lidhur me vendosjen e qëllimeve të biznesit. Institucionet publike nuk kanë përcaktuar misionin dhe vizionin, objektivat strategjike dhe ata nuk kanë miratuar një strategji (afatgjatë) për planet zhvillimore. Plani strategjik nuk ishte miratuar në 59 prej tyre. Programet vjetore të punës dhe plan veprimet e bizneseve nuk ishin miratuar në 16 prej tyre. Programet vjetore të punës dhe plan veprimi i biznesit të kompanive nuk përmbajnë tregues natyrore dhe indikatorët e performancës. Planet nuk kanë përfshirë treguesit e hartuar për matjen e performancës dhe monitorimin e realizimit të qëllimeve të përcaktuara. Është propozuar për të përcaktuar qëllimet strategjike, të miratimit të planit të zhvillimit strategjik, programet vjetore të punës dhe plan veprimin e biznesit në planet vjetore të treguesve natyrorë dhe duhen parashtruar treguesit e performancës, për të mundësuar matjen reale të performancës, monitorimin dhe arritjen e objektivave të përcaktuara të biznesit.

Matja e performancës së biznesit

Kompanitë e përfshira në auditim, mbajnë shënime dhe përgatisin pasqyrat financiare sipas kontabilitetit për sipërmarrësit. Përveç pasqyrave financiare, në përputhje me dispozitat e Standarteve të Kontabilitetit (Fletorja Zyrtare 54/13 dhe 109/07), ata hartojnë raporte vjetore në lidhje me punën e tyre, të cilat duhet të

japin një pamje të qartë të zhvillimit dhe rezultatet e punës së tyre, si dhe gjendjen e tyre, së bashku me një përshkrim të rreziqeve kryesore dhe pasigurive me të cilat përballen institucionet publike. Detyrimi për të dhënë informacion për biznesin tek themeluesit e tyre është përshkruar nga dispozitat e Ligjit të Buxhetit, në të cilat qeveritë vendore kanë të paktën 25,0% të kapitalit të të gjitha institucioneve publike. Për më tepër, detyrimi për të përgatitur raporte vjetore mbi punën ose raporte për periudha më të shkurtra është e përcaktuar nga nenet në deklaratën e themelimit. Duhet të monitorohen dhe maten rregullisht implementimet e planeve strategjike. Qëllimi i monitorimit është zbulimi në kohë i devijimeve nga plani, dhe vlerësimi nëse aktivitetet e planifikuara kanë dhënë efektet e dëshiruara në arritjen e objektivave të tyre. Një pjesë e rëndësishme e monitorimit është raportimi. Raportet duhet të përmbajnë analiza dhe pikëpamje të menaxhimit në lidhje me operacionet e biznesit në periudhën e mëparshme, si dhe shpjegime në lidhje me dallimet e mëdha midis qëllimeve të planifikuara dhe të arritura. Pika e fillimit të një sistemi efikas për monitorimin dhe raportimin përcakton në mënyrë të përshtatshme treguesit e performancës si bazë për përcaktimin nëse objektivat e biznesit do të arrihen siç janë planifikuar.

Në 86 nga 92 kompani të përfshira në auditim, janë gjetur parregullsi dhe neglizhenca të cilat janë të lidhura me matjen e rezultateve të biznesit. Shumica e institucioneve publike kanë përpiluar raporte vjetore për punën e tyre dhe kanë raportuar te themeluesit rreth rezultateve të operacioneve. Shtatë institucione publike nuk e kanë përpiluar raportin vjetor të biznesit. Neglizhencat më të zakonshme në raportet mbi performancën e institucioneve publike janë të lidhura me mungesën e treguesve të krahasueshëm. Raportet nuk përfshijnë krahasimin e arritur në lidhje me vlerat e planifikuara, krahasimi i treguesve natyrorë me periudhat e mëparshme, krahasimi i performancës me periudhat e mëparshme, të dhënat mbi kostot totale për njësi të shërbimit të ofruar, informacion mbi numrin e punonjësve për kryerjen e veprimtarive kryesore dhe numrin e punonjësve që kryejnë detyra administrative dhe

shpjegime të cilat evidentojnë pse është arritur një nivel i caktuar (ekzistuesi) i rezultateve. Rezultatet operative në librin e llogarive dhe pasqyrave financiare të disa institucioneve publike nuk janë reale sepse ata nuk kanë paraqitur siç duhet mbështetjen për shlyerjen e kredisë, amortizimi nuk është përlogaritur dhe mbledhja e arkëtimeve është nënvlerësuar. Është propozuar që të përgatiten raporte vjetore mbi punën, të cilat duhet të përfshijnë krahasimin e arritur në lidhje me vlerat e planifikuara, krahasimin e treguesve natyrorë me periudhat e mëparshme, krahasimi i treguesve të performancës me periudhat e mëparshme, të dhëna mbi kostot totale për njësi të shërbimeve të kryera, krahasimin e numrit bazë të të punësuarve që kryejnë një biznes me numrin e punonjësve që kryejnë detyra administrative, dhe të ofrojnë shpjegime nga të cilat duhet të jetë e qartë pse është arritur ky niveli i rezultatit. Është sugjeruar gjithashtu për të shprehur objektivisht rezultatet e operacioneve.

Arritja e qëllimeve të planifikuara të krijimit të institucioneve publike

Qëllimi dhe synimi i krijimit të institucioneve publike është përcaktuar në vendimin mbi krijimin nga ana e organit përfaqësues (këshillat bashkiakë dhe/ose këshillat e qarkut). Arsyet për krijimin e institucioneve publike janë bazuar në arritjen e objektivave të vetë-qeverisjes me rëndësi lokale dhe/ose rajonale ose rregulloreve të veçanta. Kështu, në interes të publikut, ndër të tjera, janë aktivitetet e kryera të cilat mund të ndikojnë në rritjen e aktivitetit ekonomik, standardeve të jetesës dhe kryerjen e detyrave vetë-qeverisëse. Për më tepër rregullat e veçanta për themelimin e çdo institucion publik janë: Menaxhimi i Akteve ligjore për aktivitet të dobishme (Fletorja Zyrtare 26/03-82/04, 110/04, 178/04, 38/09, 79/09, 153/09 and 144/12), Ligji i zhvillimit të Republikës Kroate (Fletorja Zyrtare 153/09), Akti i mbetjeve urbane (OG 178/04,111/06,60/08 dhe 87/09), Ligji për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve (Fletorja Zyrtare 94/13) dhe rregulla të tjera. Në përputhje me dispozitat e Ligjit të Buxhetit dhe rregulloreve të kontabilitetit dhe grafikët në Ligjin e Buxhetit (Fletorja Zyrtare 114/10 dhe 131/11), qeveritë lokale dhe rajonale, mund të

transferojnë fonde për ndërmarrjet publike (grante), për të inkurajuar prodhimin e mallrave të caktuara dhe shërbimeve (mund të përcaktohet në bazë të niveleve të prodhimit dhe / ose të shumës së prodhuar, shitur ose mallrave të importuara dhe shërbimeve) dhe ndihmën kapitale për blerjen e aktiveve jo-financiare, mbulimin e humbjeve që krijohen gjatë dy ose më shumë viteve dhe në bazë të një marrëveshjeje (kontratë) të reduktojnë borxhin me debitorin. Përveç kësaj, të ardhurat që marrin institucionet publike nga themeluesit e tyre për realizimin e aktiviteteve ekonomike kanë një ndikim të mundshëm në shtrembërimin e konkurrencës dhe tregtisë ndërmjet Republikës së Kroacisë dhe Shteteve Anëtare të BE, të cilat janë subjekte të rregullave të ndihmës shtetërore. Politikat e ndihmës shtetërore, të drejtat dhe detyrimet e granteve qeveritare janë të rregulluara me Ligjin për Ndhmën Shtetërore (Fletorja Zyrtare 49/11 dhe 140/05), e cila ishte ndërprerë më 30 qershor 2013, Akti i Ndhmës Shtetërore (Fletorja Zyrtare 72/13), i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2013 dhe rregulloret e zbatimit të saj. Ligji i ri për ndihmën shtetërore (Fletorja Zyrtare 47/14) hyri në fuqi në prill 2014.

Në 16 nga 92 kompani të përfshira në auditim, janë gjetur parregullsi dhe neglizhenca në lidhje me arritjen e qëllimeve të planifikuara për krijimin e kompanive dhe është konstatuar se ata nuk kanë arritur qëllimin për të cilin ato janë themeluar.

Nga 92 kompani të përfshira në auditim, 45 prej tyre nuk i kanë të rregulluara financat me themeluesit e tyre, dhe 36 nuk kanë arritur rezultate të kënaqshme operative dhe treguesit e performancës.

Shpenzimet e institucioneve publike të përfshira në auditim, ishin në pjesën më të madhe në funksion të arritjes së objektivave (qëllimeve) për të cilat institucionet publike u themeluan. Disa ndërmarrje publike nuk kanë shpenzuar grantet e kapitalit të marrë nga themeluesit për qëllimin e synuar. Disa kompani llogaritin dhe paguajnë pagat e drejtorëve sipas udhëzimeve të themeluesit, punonjësve u janë paguar tarifat pavarësisht propozimit të themeluesve, sipas të cilëve ata nuk duhet të ishin paguar. Është sugjeruar që të organizojnë aktivitete për financimin e biznesit me themeluesit,

të përcaktojnë shtrirjen dhe llojin e aktiviteteve që pritet për institucionet publike dhe të marrin parasysh numrin dhe strukturën e të punësuarve të nevojshëm për realizimin e këtyre aktiviteteve. Më tej u sugjerohet themeluesve të vendosin objektivat e biznesit dhe masat për përmbushjen e tyre të përcaktohen mirë, të monitorohen operacionet e kompanive dhe të vendoset raportimi dinamik për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Është propozuar që të ndërmerren aktivitete për të reduktuar dhe mbuluar humbjet në biznes dhe për të rritur të ardhurat e tyre, themeluesit vlerësojnë mundësitë për zgjerimin e biznesit dhe rritjen e të ardhurave në mënyrë që të zvogëlohet nevoja për mbështetje financiare ndaj tyre. Është sugjeruar gjithashtu që të përdorin grantet kapitale për qëllimin e synuar, për të rishikuar shumën e shpenzimeve për punonjësit dhe për të llogaritur dhe paguar pagat dhe përfitimet e punonjësve në përputhje me udhëzimet dhe sugjerimet e themeluesve.

Literatura:

1. De Sousa, A.J.: Roli i SAI-t në mirëqeverisje, Revista EUROSAI, Tribunal de Cuentas, No. 9, Madrid, 2002
2. *Auditimi Shtetëror në Bashkimin Europian*, 2005
3. Vlada Republike Hrvatske: *Strateški okvir za razvoj 2006.-2013.*, Središnji državni ured za razvojnu strategiju i koordinaciju fondova EU
4. *Upravljanje javnim izdacima – Priručnik za zemlje u tranziciji*, OECD, 2001.
5. Zakon o Državnom uredu za reviziju, Narodne novine 80/2011.
6. Zakon o lokalnoj i područnoj (regionalnoj) samoupravi, Narodne novine 33/01, 60/01, 129/05, 109/07, 125/08, 36/09, 36/09, 150/11, 144/12 i 19/13
7. Zakon o proračunu, Narodne novine 57/08 i 136/12
8. Zakon o računovodstvu, Narodne novine 109/07 i 54/13

Roli i SAI-eve për promovimin e qeverisjes së mirë përmes llogaridhënies dhe transparencës.

Nga *İsmail Cengiz EREK*¹



PËRMBLEDHJE

Koncepti i qeverisjes së mirë ka tërhequr vëmendjen e publikut, shoqërisë civile dhe qeverive gjatë dekadave të fundit. Ky koncept ka lidhje me transparencën, llogaridhënien dhe korrupsionin. Në një vend, qeverisja e mirë mund të arrihet kur drejtuesit japin llogari për veprimtarinë e tyre dhe ku publiku ka akses në të gjithë informacionin që dëshiron. Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-et) po luajnë një rol thelbësor për arritjen e qëllimit për një qeverisje të mirë, duke i udhëzuar qeveritë të veprojnë më mirë dhe duke informuar publikun për veprimtarinë e qeverive me ndihmën e raporteve të auditimit.

Fjalët kyçe: Qeverisje e mirë, Transparencë, Llogaridhënie, Korrupsion, Institucione Supreme Auditimi.

I. Hyrje

Mjedisi i sotëm demokratik në të gjithë globin nxit qeveritë që të ruajnë një kuadër të disiplinuar dhe të strukturuar të politikave demokratike. Qeverisja e mirë ka qenë një nga objektivat kryesor në këtë drejtim. Mungesa e qeverisjes së mirë dëmton demokracinë dhe është e pafavorshme për mirëqenien e qytetarëve. Është tronditëse që edhe qeveritë e vendeve më demokratike në botë nuk arrijnë të

¹ *Auditues i Lartë, Gjykata Turke e Llogarive – TCA*

sigurojnë një qeverisje të mirë për qytetarët e tyre dhe si rezultat i kësaj konstatohet gjenerimi i një atmosfere politike kaotike dhe të paqëndrueshme (Ara dhe Khan, 2006 fq. 91)

Zhvillimet në fushën e menaxhimit publik, reformat në sistemet buxhetore dhe financiare dhe perceptimi i nevojës për një menaxhim më transparent dhe demokratik janë shtuar veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20 dhe përbëjnë dinamikën themelore të zhvillimeve në fushën e auditimit publik (Köse, 2007: 2). Në kuadër të këtyre zhvillimeve, qasja tradicionale e auditimit është lënë pas dhe qasja në drejtim të auditimit të performancës ka filluar të gëzojë akceptancë më të madhe (Erkan, 2012, f: 95). Nevoja për këtë ndryshim lindi nga nevoja për sigurimin e një llogaridhënie më të mirë. Së fundmi ajo ka filluar të kërkojë efikasitet në punën e qeverisë dhe të kontribuojë që qeveritë të arrijnë objektivat për një qeverisje të mirë.

Në fenomenin e qeverisjes së mirë, SAI-et luajnë një rol të pamohueshëm. Me ndihmën e koncepteve të llogaridhënies dhe transparencës, me raportet e auditimit që janë të hapura për publikun dhe i lejojnë atij të gjykojë mbi veprimet e qeverisë, SAI-et i detyrojnë qeveritë të veprojnë më mirë.

II. Principet themelore të SAI-t

Çdo shtet demokratik, si një ndër komponentet e rëndësishme të strukturës demokratike ka dhe një institucion përgjegjës për auditimin e pavarur të qeverisjes. Si rregull dhe sipas përcaktimeve të INTOSAI-t të specifikuara në Deklaratën e Limës dhe në dokumente të tjerë, funksionet e tij janë të përcaktuara me ligj. Auditimi i pavarur i qeverisjes përcaktohet kryesish si një pozicion kushtetues ose ligjor. Sa më sipër, një vend mund të ketë vetëm një institucion përgjegjës për auditimin e pavarur të qeverisjes. (Ahlenius, 2000, fq:1).

SAI-et kryejnë auditime si institucione të pavarura të auditimit të jashtëm në emër të parlamentit dhe janë të autorizuar auditojnë veprimtarinë e qeverisë për përdorimin e parave publike si dhe politikat qeveritare. (Erkan, 2012, p:94).

SAI-et janë institucione të pavarura jo politike të cilat auditojnë veprimtarinë e qeverisë për të siguruar:

- përdorimin e duhur dhe efektiv të fondeve publike,
- zhvillimin e një menaxhimi të shëndetshëm financiar,
- përmbushjen e aktiviteteve administrative,
- komunikimin e informacionit autoriteteve publike dhe publikut të gjerë përmes publikimit të raporteve objektive (INTOSAI, 2007, fq.1).

SAI-et janë anëtare te Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). INTOSAI është një organizatë e pavarur jo politike me një status special konsultativ më Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) (INTOSAI, 2007, fq.1).

SAI-et si institucione, autonome, të pavarura dhe jo politike , auditojnë qeveritë për ti ndihmuar ato të përmirësojnë performancën, të rrisin transparencën, të sigurojnë llogaridhënien, të rrisin efikasitetin dhe efektivitetin, në mënyrë që burimet publike të përdoren në të mirë të qytetarëve të tyre (Erkan, 2012, fq.95). Kjo deklarohet edhe në Udhëzuesit e Normave të Auditimit të Deklaratës së Limës, të miratuara në Kongresin e IX të INTOSAIT, mbajtur në Lima-Peru, në vitin 1977.

Auditimi nuk është qëllim në vetvete, por pjesë e domosdoshme e një sistemi rregullator, qëllimi i të cilit është të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit në menaxhimin financiar sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të merren masa korigjuese për rastet e veçanta. Si dhe ti bërë menaxherët të përgjegjshëm për të hedhur hapa parandaluese ose për të kufizuar shkeljet. (ISSAI 1, fq.5).

Në përgjithësi, asistenca ndaj qeverisë për rritjen e performancës, sigurimi i llogaridhënies si dhe mbështetja e Parlamentit janë arsye kryesore të ekzistencës së SAI-t. Është e njohur dhe vlerësuar prej kohësh, se palët e interesit dhe SAI-et kanë kërkuar një rol më aktiv për auditimin e sektorit publik për të përmirësuar qeverisjen e mirë dhe për të menaxhuar risqet. (Karamollaoglu, p: 187)

III. Llogaridhënia dhe transparenca fiskale

Llogaridhënia është jetësore në një demokraci mirëfunktionale liberale, sepse mban në kontroll pushtetin e qeverisë dhe informon publikun. Edhe pse të gjithë pajtohen me rëndësinë dhe domosdoshmërinë e llogaridhënies, mungon një përkufizim universal për të. (Willems, fq. 2).

Bovens (2007) e përshkruan llogaridhënien si “një marrëdhënie ndërmjet një aktori dhe një forumi, në të cilën aktori ka detyrimin të shpjegojë dhe justifikojë sjelljet e tij dhe forumi mund të bëjë pyetje dhe të japë gjykime. Më pas aktori mund të përballet me konsekuenca për veprimet e tij”. Sipas Bovens, llogaridhënia përbëhet nga tre komponentë:

1. aktori duhet të jetë i detyruar për të informuar forumin për sjelljet e tij
2. forumi duhet të ketë mundësi të diskutojë me aktorin për sjelljen e tij dhe aktori duhet të ketë mundësi të justifikojë sjelljet e tij gjatë debatit
3. të dyja palët duhet ta kenë të qartë se forumi je vetëm mund të japë gjykime, por ai mund ti bëjë me dije aktorit edhe disa pasoja. (Willems and Van Dooren, p:6).

Llogaridhënia ka tre funksione të paracaktuara. E para, autoritetet publike janë përgjegjëse për vendosjen e rregullave dhe procedurave për të parandaluar padrejtësitë dhe keqpërdorimin e pushtetit (funksion kushtetues). Së dyti, qytetarët (ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur) duan të kenë fjalën e fundit, sepse autoriteti dhe pronësia mbi shtetin është e qytetarëve (funksion demokratik). Nuk mjafton që autoritetet publike të veprojnë drejtë dhe brenda kufijve ligjor. Qytetarët duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë dhe të zgjedhin autoritetet publike në një

mënyrë kuptimplotë. Këto dy dimensione përfshijnë shqetësimin se si funksionon qeveria. E treta, SAI gjithashtu kujdeser për atë çfarë realizon qeveria në të vërtetë. (funksioni i performancës)- (Willems dhe Van Dooren, p: 8).

Me shtimin e qeverisjes demokratike në vende të ndryshme të botës, veçanërisht në vendet perëndimore, është shfaqur një shqetësim se si ti bëjmë qeveritë më të përgjegjshme, çka ka çuar në paraqitjen dhe përdorimin e mjeteve dhe mekanizmave të ndryshëm për llogaridhënien publike. Disa nga mekanizmat e jashtëm të etabluar dhe të njohur gjerësisht në shoqëritë demokratike përfshijnë komitetet legislative, seancat dëgjimore me parlamentarët, auditimin financiar, kontrollet ministrore, komentet juridike, komitetet këshillues, avokatin e popullit, njësitë anti-korrupsion, dëgjimet publike, anketimet e opinionit dhe trajtimet e bëra nga media (Haque, 1994) (Aucoin dhe Jarvis 2005) (Kearns, 2003). Disa nga mjetet e llogaridhënies publike janë të përshkruara edhe në kushtetutat e vendeve të ndryshme. Duke parë përvojat e vendeve perëndimore, shumë nga mjetet e llogaridhënies janë përshtatur së fundmi zyrtarisht edhe nga vendet në zhvillim (Haque, 2007, p:439).

Transparenca në qeverisje është e lidhur ngushtë me konceptin e llogaridhënies. Transparenca në qeverisje arrihet kur çdokush arrin të marrë informacionin që i nevojitet. Prandaj llogaridhënia dhe transparenca janë të lidhura me njëra-tjetrën në konceptin reciprok dhe plotësues. Për transparencën në qeverisje duhet të bëhen publike si sistemi efektiv dhe mirë funksionues i llogaridhënies, ashtu edhe politikat transparente të llogaridhënies (Eryilmaz dhe Biricikoğlu, 2011, fq.24). Transparenca është instrumenti i llogaridhënies efektive ndërsa llogaridhënia është siguria për një qeverisje transparente. Prandaj ka një ndërlidhje midis tyre (Dubnic, 2005, f: 376). Edhe pse transparenca përbën kushtin themelor për llogaridhënie, është e qartë se ajo nuk mund të jetë i vetmi instrument efektiv i llogaridhënies efektive në sektorin publik, nëse nuk mbështetet nga sanksionet e forta (Peters, 2007, fq. 15).

Është pranuar se në konceptin e Menaxhimit të ri Publik, qëllimi kryesor i llogaridhënies është të rrisë performancën e sektorit publik, duke vendosur

përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të nëpunësve dhe qytetarëve përmes transparencës, në vend të zbulimit të shkeljeve dhe gabimeve (Tanner, 2012, f: 43).

IV. Çfarë është qeverisja e mirë?

Termat “qeverisje” dhe “qeverisje e mirë” po përdoren gjithnjë e më shumë. Qeverisja e keqe po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një nga shkaqet e të këqijave në shoqëritë tona. Shumica e donatorëve dhe institucioneve ndërkombëtare financiare po i kushtëzojnë ndihmat dhe kreditë e tyre në kryerjen e reformave që sigurojnë “qeverisje të mirë” (NAO, fq.12).

Ish Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, z. Kofi Annan është shprehur se “qeverisja e mirë është ndoshta faktori i vetëm më i rëndësishëm në zhdukjen e varfërisë dhe nxitjen e zhvillimit” (NAO, fq.12) .

Qeverisja e mirë është një proces ku burimet publike dhe problemet menaxhohen në mënyrë efektive dhe efikase, si dhe në përgjigje të nevojave kritike të shoqërisë. Kombet e Bashkuara kanë theksuar se, për një qeverisje të mirë janë të rëndësishme natyra pjesëmarrjes në qeverisje dhe shteti i të drejtës. Sipas këtij përkufizimi, qeverisja e mirë ka 8 karakteristikat kryesore . Ajo është gjithëpërfshirëse, e orientuar drejt konsensusit, transparente, efektive, efikase, e drejtë si dhe përfshin dhe ndjek parimet e sundimit të ligjit (Ara dhe Khan, 2006, f: 92).

Qeverisja e mirë sipas Bankës Botërore, përfshin karakteristikat e mëposhtme:

- Një shërbim publik eficient,
- Një sistem drejtësie të pavarur dhe kuadër ligjor që detyron zbatimin e kontratave.
- Administrimin e përgjegjshëm të fondeve publike.
- Auditues të pavarur publik që i përgjigjet një legjislature përfaqësuese.
- Respektimin e ligjit dhe të drejtave të individit në të gjitha nivelet e qeverisjes
- Një strukturë institucionale pluraliste
- Një media të lirë (Banka botërore, 1989)

Arritja e një qeverisje të mirë kërkon ekzistencën e një parlamenti të fortë, efektiv dhe efikas. Kjo sepse parlamentet luajnë një rol vendimtar në njësimin, krahasimin dhe ruajtjen e pikëpamjeve dhe nevojave të qytetarëve, duke artikuluar pritshmëritë dhe aspiratat e tyre në përcaktimin e axhendës së zhvillimit kombëtar. Parlamentet nuk janë institucione teknike. Prandaj për të arritur në një qeverisje të mirë, Parlamentet duan ndihmë teknike. Parlamentet mund të sigurojnë këtë vetëm me ndihmën e SAI-ve.

Udhëheqësit botërorë në Samitin Botëror të vitit 2005 arritën në përfundimin se qeverisja e mirë është pjesë integrale e rritjes ekonomike, çrrënjësjes së varfërisë dhe urisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Për të promovuar rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, një shtet efektiv duhet gjithashtu të jetë në gjendje të mobilizojë politikën për ardhurat, të jetë i kujdesshëm në marrjen e huave, të planifikojë dhe të menaxhojë shpenzimin e parave publike në mënyrë efektive dhe eficiente dhe të japë llogari për përdorimin e fondeve dhe rezultatet e arritura. Një menaxhim financiar publik i shëndetshëm kontribuon për arritjen e këtyre rezultateve përmes elementëve të transparencës, gjithëpërfshirës, përgjegjshmërisë, mbikëqyrjes, llogaridhënies dhe parashikimeve. Këto janë elementët për një qeverisje të mirë të financave publike dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik dhe social të një shteti. (NAO, fq. 12)

V. Roli i SAI-eve për promovimin e qeverisjes së mirë përmes llogaridhënies dhe transparencës

Sipas Liu Jiayi² (në përgjigje të pyetjes se cilat besoni ju se janë sfidat dhe mundësitë me të cilat përballen SAI-et aktualisht) pozicioni dhe roli i rëndësishëm i auditimit kombëtar në promovimin dhe përmirësimin e qeverisjes së mirë kombëtare demonstron në adresimin efektiv dhe parandalimin e krizave. Në të tashmen dhe në të ardhmen, SAI-et duhet që në përputhje me konceptin " auditimi kombëtar i

² Kryetar i Bordit Drejtues të INTOSAI-t

shërben qeverisjes kombëtare” të fokusohen fillimisht në përmbushjen serioze të përgjegjësiave të tyre audituese dhe intensifikimin e ngritjes së kapaciteteve institucionale. Kjo do tu mundësojë atyre që të luajë një rol më të madh në promovimin e politikave financiare të qëndrueshme afatgjata, përmirësimin e qeverisjes kombëtare, pjesëmarrjen aktive në qeverisjen e nivelit të lartë në nivel global dhe për të kuptuar në veçanti Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara.

Auditimi kombëtar luan një rol kryesor në llogaridhënien e qeverisë. Shumë SAI-e e përshkruajnë funksionin kryesor të auditimit kombëtar si një funksion sigurie të kryer nga një institucion i pavarur dhe i specializuar, i themeluar me ligj, me personelin e tij me kohë të plotë. Roli i SAI-t në sistemin e qeverisjes kombëtare është i ngjashme me atë të "sistemit imunitar" në trupin e njeriut, për të parandaluar ose për të zbutur dobësitë në qeverisjen kombëtare (Deklarata e Pekinit).

Shumë vende në botë kanë pranuar nevojën për një auditim kombëtar të pavarur me autoritetin e nevojshëm bazuar në kushtetutat e tyre respektive. Megjithatë, duhet të pranohet se ekzistenca e institucioneve të pavarura të auditimit varet në një masë të madhe nga qeverisja e mirë (Deklarata e Pekinit).

Ne e kuptojmë që SAI- ka një rol të rëndësishëm për përmirësimin e qeverisjes së mirë. Por si mund ta bëjë ato këtë? Unë mendoj se pika fillestare është transparenca dhe stacioni tjetër është llogaridhënia. Për të audituar në mënyrë efektive, së pari të gjitha SAI-et duhet të përvetësojnë njohuri të mjaftueshme që të mund të sigurohen nga transparenca. Me këto njohuri SAI-et mund të auditojnë institucionet publike dhe të kontribuojë në sigurimin e llogaridhënies. Detyrimi i qeverive në ndihmën e transparencës dhe llogaridhënies është të veprojnë më mirë dhe të kontribuojnë drejtpërdrejt në qeverisjen e mirë.

Në shekullin e 21, ka një interes në rritje në mbarë botën për çështjet që lidhen me demokracinë dhe qeverisjen e mirë. Ky është një reflektim ndaj faktit se, demokracia dhe qeverisja e mirë nuk janë luks, por një kërkesë themelore për

arritjen e një zhvillimit të qëndrueshëm. Parlamente si institucione kryesore në një sistem demokratik të qeverisjes, duhet të luajnë një rol kritik për promovimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë. Si përfaqësues të popullit, të zgjedhur në mënyrë demokratike parlamentarët kanë për detyrë të sigurojnë qeverisjen nga populli dhe për popullin. Në kryerjen e funksioneve të tyre kryesore atë të përfaqësimit dhe mbikëqyrjes, parlamentet mund të angazhohen në mënyrë aktive në zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve, politikave dhe praktikave që promovojnë demokracinë dhe qeverisjen e mirë (ECA, 2012, fq. 3). Gjithashtu ekziston një lidhje e ngushtë midis parlamenteve dhe SAI-eve. Parlamenti kryesisht kontribuon në qeverisjen e mirë me ndihmën e raporteve të SAI-t.

SAI-et janë të obliguara të kontribuojnë për një qeverisje të mirë dhe për ngritjen e një sistemi menaxhimi të shëndetshëm, i cili i shërben publikut dhe përdorimit në mënyrë efektive të burimeve publike si dhe që merr parasysh dëshirat dhe pritshmëritë e publikut. Qeverisja e mirë kërkon mbikëqyrje dhe kontroll të vazhdueshëm, për të garantuar zbatimin e politikave të caktuara, për të realizuar objektivat strategjik dhe për të përmbushur pritshmëritë.

SAI-et, të cilat janë garantuesit e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik, kontribuojnë për mbikëqyrjen e qeverive dhe kontrollin e veprimtarisë së tyre duke vlerësuar institucionet publike, nëse ata bëjnë atë që pritjet prej tyre apo jo, nëse ata shpenzojnë burimet e tyre financiare sipas qëllime të paracaktuara ose jo dhe nëse i gjithë aktiviteti i tyre përputhet me detyrimet ligjore (Akyel dhe Kose, 2011, fq. 7).

Qeverisja e mirë është e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente. Ai siguron që prioritetet politike, sociale dhe ekonomike janë të bazuara në një konsensus të gjerë në shoqëri dhe se zërat e më të varfërve dhe më të rrezikuarve janë marrë parasysh në alokimin e burimeve. Një nga shkaqet kryesore të "qeverisjes së keqe", është ekzistenca e korrupsionit (Dye dhe Stapenhurst, 1998, fq. 1).

Korrupsioni është përshkruar si një lloj kanceri. Kjo ndodh kur kryqëzohen interesat e sektorit publik me interesat e sektorit privat. Në vitin 1996, Klitgaard zhvilloi ekuacionin bazë që shpjegon dinamikën e korrupsionit (Özbaran, 2001, p:1) dhe ky është si më poshtë:

$K(\text{korrupsioni}) = PM(\text{pushteti i monopolit}) + PLV(\text{pushteti i lirisë për të vepruar}) - LI(\text{llogaridhënie})$

$[C(\text{Corruption}) = MP(\text{Monopolistic Power}) + DP(\text{discretionary power}) - A(\text{Accountability})]$

Pushteti i lirisë për të vepruar evidentohet edhe në vendet në zhvillim dhe në vendet me zhvillim ekonomik të ulët. Në këto vende ndoshta transparenca dhe llogaridhënia nuk janë të mjaftueshme si rezultat i sistemeve të dobta menaxheriale dhe financiare, agjencive jo efikente dhe standardeve të pamjaftueshme etike.

Transparenca ndihmojë llogaridhënien për të kyer detyrën e saj. Kjo është arsyeja pse ekuacion mund të rishkruhet për të treguar se llogaridhënia është në funksion të transparencës.

$K(\text{korrupsioni}) = PM(\text{pushteti i monopolit}) + PLV(\text{pushteti i lirisë për të vepruar}) - LI(\text{llogaridhënie}) T[\text{Transparencë}]$

$[C(\text{Corruption}) = MP(\text{Monopolistic Power}) + DP(\text{discretionary power}) - A(\text{Accountability})][T(\text{Transparency})]$

$K = PM + PLV - LI - A(T)$

$[C = MP + DP - A(T)]$

Arsyeja pse shtojmë transparencën në këtë ekuacion është se transparenca është një nga faktorët më të rëndësishëm që çon në llogaridhënie. Sistemet transparente japin njohuri të mjaftueshme për sasinë e parave të shpenzuara për një çështje të caktuar. Ato gjithashtu sigurojnë besimin tek qeveria dhe inkurajojnë eficiencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike (Özbaran, 2001, p:2).

Në të vërtetë, nëse ne do të shohim me vëmendje ekuacionin, mund të identifikojmë lidhjen midis transparencës, llogaridhënies, korrupsionit dhe qeverisjes së mirë. Kur një vend ka llogaridhënie absolute dhe transparencë, ne presim që të mos ketë korrupsion. Mungesa e korrupsionit është parakusht për një qeverisje të mirë. SAI-et luajnë një rol të rëndësishëm për arritjen e qeverisjes së mirë duke ofruar transparencë dhe llogaridhënie për eliminimin e korrupsionit.

Potenciali i auditimit për promovimin proaktiv të qeverisjes së mirë është pranuar përgjithësisht si një faktor i rëndësishëm në reformat e sektorit publik. Përveç marrjes së sigurisë se veprimtaria e ekzekutivit është në përputhje me vullnetin e Parlamentit, në përgjegjësitë e SAI-t tani përfshihen edhe promovimi i sjelljeve etike, efikasiteti dhe efektiviteti i kostove dhe inkurajimi i kontroleve të brendshme financiare për të zvogëluar mundësitë për korrupsion dhe për të rritur gjasat për zbulimin e tij. (Sahgal, 1996).

Një auditimi i kryer dhe i raportuar mirë shërben si një instrument thelbësor për zhvillimin dhe promovimin e qeverisjes së mirë i cili përmirëson menaxhimin e sektorit publik. Çdo SAI që ofron shërbime të auditimit me cilësi të lartë, qartësisht ka potencial për të ndihmuar legjislaturën e saj dhe organet e tjera drejtuese për përgjegjësitë e qeverisë për administrimin e burimeve publike. Aktualisht ka shumë risi në auditimin e sektorit publik. SAI kanadez ka studjuar organizatat me performancë të mirë dhe ka kryer studime mbi etikën dhe vlerat e këtyre organizatave. Në Evropë, SAI-et janë përqëndruar në auditimin e programeve që ndikojnë drejtpërdrejt në shqetësimet e publikut. SAI-et po bashkëpunojnë me faktorë të ndryshëm për kryerjen e këtyre auditimeve. Auditimet e bazuara në rezultate dhe auditimet e mjedisit kanë fituar popullaritet kohët e fundit, duke provuar se auditimi nuk është proces statik (Dye dhe Stapenhurst, 1998, fq. 10).

Në botën e zhvilluar, SAI-et po punojnë për një përfshirje proaktive për një llogaridhënie më të mirë dhe për veprime më efektive të qeverisë. Ndryshim është përshkruar si një lëvizje nga roli i vëzhguesit në rolin proaktiv të përmirësuesit.

Ekzekutivi merr përsipër disa risqe kur i lejon kritikëve të informuar të bëjnë komente mbi veprimtarinë e tij dhe mbi pasqyrat financiare. Nëse qeveria nuk është e gatshme të lejoj një ekspozim të tillë, mungesa e angazhimit në auditim mund të dobësojnë procesin e auditimit

Qeveritë duhet të përpiqen të sigurojnë një mandat të fortë, në mënyrë që të sigurojnë burimet financiare dhe njerëzore për të përmbushur mandatin e tyre. Gjithashtu ato duhet të lejojnë një qasje të pakufizuar në informacion (Dye dhe Stapenhurst, 1998, f: 11). Qeveritë në radhë të parë, duhet të jenë të gatshme për të ndihmuar SAI-et, në mënyrë që ti bindin qytetarët se "të gjitha transaksionet e qeverisë janë audituar" . Kjo ndihmon në arritjen e një niveli të lartë të transparencës.

Si përfundim mund të themi se një auditim i shëndetshëm mund të jetë një nga funksionet kryesore për arritjen e një qeverisje të mirë. Në mënyrë që puna e auditimit të jashtëm të jetë efektive nevojitet që qeveria ti vërë në dispozicion atij të gjithë informacionin që ka dhe të jetë e gatshme të auditohet edhe psikologjikisht.

Bibliography

Ahlenius, Inga-Britt. Performance Audits, Evaluations and Supreme Audit Institutions, International Journal Of Government Auditing, January 2000, p:1, Washington, D.C.

Akyel Recai and Köse H. Ömer, Kamu Mali Yönetiminde İyi Yönetişim İçin Sayıştayların İletişim Kapasitesinin Güçlendirilmesinin Önemi, Sayıştay Dergisi, V:82, 2012, Ankara

Ara Fardaus and Khan Md. Mostafizur Rahman, 2006, Good Governance: Bangladesh Perspective, The Social Sciences 1(2):91-97, Medwell Online, s:92

Aucoin, P. and M.D. Jarvis (2005). Modernizing Government Accountability: A Framework for Reform. Ontario, Canada: Canada School of Public Service.

Bovens, M. (2007). Analysing and Assessing Accountability: A Conceptual Framework. European Journal of Law, 13(4), 447-468.

Dubnic, Melvin (2005), "Accountability and the Promise of Performance: In Search of the Mechanisms", *Public Performance & Management Review*, Vol. 28, No. 3, p:376-377

Dye Kenneth M. and Stapenhurst Rick, "Pillars of Integrity: The Importance of Supreme Audit Institutions in Curbing Corruption", *The Economic Development Institute of the World Bank*, 1998.

Economic Commission for Africa (ECA), *The Role of Parliament in Promoting Good Governance*, Governance and Public Administration Division (GPAD).

Erkan, Berna. *Developing Role Of SAIs In Sustainable Development And Environmental Auditing*, *Journal Of Turkish Court Of Accounts*, Volume:84, January-March 2012, p:94, Ankara

Eryılmaz, Bilal Ve Hale, Bircikoğlu (2011), "Kamu Yönetiminde Hesap Verebilirlik Ve Etik", *İş Ahlakı Dergisi*, Cit.4, Sayı.4 s:24

Haque, M.S. (2007) *Limits Of Public Accountability Under The Reinvented State In Developing Nations*, Singapore, p:438-439)

Haque, M.S. (1994). "The Emerging Challenges To Bureaucratic Accountability: A Critical Perspective," In A. Farazmand (Ed.), *Handbook Of Bureaucracy*. New York: Marcel Dekker.

INTOSAI, "Evolution and Trends in Environmental Auditing", 2007, p:1, [http://www.environmental-](http://www.environmental-auditing.org/LinkClick.aspx?fileticket=91RsG1vxtGs%3d&tabid=128&mid=568)

[auditing.org/LinkClick.aspx?fileticket=91RsG1vxtGs%3d&tabid=128&mid=568](http://www.environmental-auditing.org/LinkClick.aspx?fileticket=91RsG1vxtGs%3d&tabid=128&mid=568)

ISSAI 1, *The Lima Declaration*, p:5

Karamollaoğlu A. Ömer, "The Role of ISSAI's in Helping SAI's to Fulfill Their Role", *Second ALSAI*, 2013.

Kearns, K.P. (2003). "Accountability in a Seamless Economy," in G. Peters and J. Pierre (eds.), *Handbook of Public Administration*. London: Sage Publications.

Köse, H. Ö. (2007), "Dünyada ve Türkiye'de Yüksek Denetim", T.C. Sayıştay Başkanlığı 145. Kuruluş Yıldönümü Yayınları, Mayıs 2007.

NAO-Importance of Supreme Audit Institutions In Good Public Financial Governance (<http://nao.gov.mu/English/ReportsandPublications/Documents/Mauritius%202010/03%20Importance%20of%20SAI%20INGood%20Public%20Financial%20Governance.doc>)

Özbaran M.Hakan, Şeffaflık Ve Hesap Verme Sorumluluğu Bağlamında Yolsuzlukla Mücadelede Sayıştayların Rolü, Sayıştay Dergisi, S:43, Ankara

Peters, B.Guy (2007) " Performance-Based Accountability", Performance Accountability And Combating Corruption, Edt. Anvar Shah, The World Bank, Washington D.C., p:15

Taner, Ahmet, Kamu Yönetiminde Yeniden Yapılanma Arayışları Ve Hesap Verme Sorumluluğuna Etkileri, Sayıştay Dergisi Sayı:85, Nisan-Haziran 2012, p:33

Sahgal, Vinod 1996. "Strengthening Legislative Audit Institutions: A Catalyst to Enhance Governance and Combat Corruption".

Willems Tom, Public Accountability and PPP's, p:2, <http://regulation.upf.edu/dublin-10-papers/511.pdf>

World Bank, 1989. Sub-Saharan Africa: From Crisis to Sustainable Growth, Washington D.C.

<http://www.intosaijournal.org/coverstory/coverstory01-2014.html>

http://www.intosai.org/fileadmin/downloads/downloads/5_events/congresses/EN_Beijing_Declaration_plus_Annexes.pdf

Zvoglimi i riskut, një potencial i mundshëm i zhvillimit të vendit

Nga Prof.Dr.Skënder Osmani, Departamenti i Burimeve të Energjisë, Fakulteti Gjeologji Miniera & Dr.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së



Prof.Dr.Skënder Osmani



Dr.Bujar Leskaj

Jeta është risk. Çdo veprimtari njerëzore duhet të jetë sa më e sigurtë dhe optimale

Abstrakt

Teoria e analizës së riskut është mjaft e gjerë dhe në përgjithësi jo aq e njohur nga qarqet publike. Kësisoj në punim është synuar që shumë informacione e ide të Analizës së Riskut “t’i largohen teorisë”, mundësisht të jenë në princip të kuptueshme dhe të zbatueshme (veçanërisht për sistemet ekonomike). Çdo sistem (institucion, projekt, reformë, kontratë, etj) është një strukturë që ka disa objekte (shiko më poshtë); psh : objektin fillestar ose inputet, objektin e proceseve ose procesorin, objektin final ose outputet (produktet), etj. Qëllimi i çdo sistemi është *produkti optimal dhe siguria e tij*, dmth sistemi duhet të realizojë kritere të caktuara : prodhimi maksimal, kosto minimale, kohë të limituar, njëherësh risk minimal, etj.

Në çdo veprimtari njerëzore risku është bashkëshoqërues i përhershëm i saj, dmth një barrierë, pengesë, etj., sepse ngërthen humbje, dëme, rreziqe, etj. Identifikimi i riskut: objektet me risk, proceset, faktorët, etj, janë instrumente që ndihmojnë në zvogëlimin e riskut. Në këtë këndvështrim në punim trajtohen çështjet e mëposhtme :

1. Hyrje
2. Objekti, identifikimi i riskut

3. Proçeset me risk
4. Faktorët e riskut, siguria
5. Individit, Ligji për riskun
6. Vlerësimi i riskut
7. Reforma e arsimit të lartë dhe risku
8. Reforma administrative territoriale
9. Reforma e Përgjithshme (Go to Growth) dhe bazat e të dhënave
10. Komunikimi, koha, risku
11. Pasuria Kombëtare dhe risku

Në fund jepen disa konsiderata, në të cilat theksohet që *identifikimi i objekteve me risk, (krahas vlerësimit të riskut dhe menaxhimi të tij që veçse ceken në punim) është një problem madhor dhe i rëndësishëm, një mundësi e zhvillimit në çdo "qelizë" të jetës së vendit.*

1. Hyrje

Shqipëria ka prapambetje që ngërthen risk relativisht të madh

Krizat e kohëve të fundit në shumë vende të botës kanë pasqyruar mjaft shqetësime dhe dilema serioze për zhvillimin e ekonomisë [1] deri edhe në botkuptime regresive me karakter lokal, regjional, etj, si në qarqe publike e politike, por dhe në ato studimore, shkencore, etj.

Në vendin tonë në shumë institucione, veçanërisht në median e shkruar, elektronike, në diskutime akademike, etj, janë pasqyruar situatat e vështira energjitike, financiare, mjedisore, etj, madje ka pasur edhe raste kur ata kanë reflektuar një frymë pesimiste psh:

A do të bëhet ndonjëherë Shqipëria? Sa e pasur është ajo dhe si shpjegohet prapambetja e nivelit relativisht të lartë të varfërisë? Po pabarazia ekonomike me miliarderë e milionerë që kanë në dorë një përqindje shumë të madhe të pasurisë? Si ka mundësi që duke filluar nga koha e çlirimit e deri më sot, Shqipëria me shumë tregues qëndron në fund të listës së vendeve evropiane, etj?

Pyetjet e mësipërme për çështjen e krizave, apo a do të bëhet Shqipëria? etj, kanë në thelb problemin e zhvillimit, përmasat, ritmet, qëndrueshmërinë dhe prespektivën, sigurinë dhe riskun, etj.

Çdo veprimtari njerëzore ka një qëllim, i cili mishërohet në praktikë nga një “projekt” që ka një produkt ose output me vlera ekonomike (sasi, cilësi, kohë, performancë, optimal, etj).

Krahas këtyre vlerave shoqëria është gjithmonë e interesuar që produkti të jetë “sa më i sigurtë”, dmth të ketë një standard që të përjashtojë humbjet, dëmet, rreziqet, krizat, prishjet, epidemitë, përmytjet, tërmetet, katastrofat, etj. Në një kuptim më rigoroz produkti duhet të jetë optimal dhe pa risk (problemi i optimalitetit del jashtë qëllimit të dhënë). Më poshtë po kufizohemi *vetëm te kuptimi i riskut*. Por çështje risku? Ky është një kuptim matematik që mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme që zenë fill në teorinë e probabilitetit (statistikës), teorinë fuzzy [7], etj.

Për thjeshtësi riskun në një veprimtari njerëzore po e konsiderojmë si mundësi për të humbur ose për t’u dëmtuar nga produkti që do të realizojë veprimtaria. Pak më ndryshe, risku në çdo veprimtari ka lidhje me humbjen, dëmtimin, rreziqet, etj të produktit që do të realizohet në të ardhmen. Që këtej:

-së pari, rrënjët e riskut duhen kërkuar tek veprimtaria njerëzore (për thjeshtësi dukuritë natyrore nuk po i konsiderojmë: tërmetet, cunamet, përmytjet, etj).


-së dyti, meqenëse kjo veprimtari “do të kryhet në të ardhmen” dhe shoqërohet me humbje, dëmtim, rrezik, etj nga produkti, risku duhet të parashikohet, vlerësohet; njëherësh edhe masat për kufizimin e zvoglimin e tij. Meqenëse çdo veprimtari njerëzore është një “ndryshim, atëherë rrënjët e riskut duhen kërkuar pikërisht në këte ndryshim (më saktë tek ndryshimi i vetisë, atributit, etj).

2.Objekti . Identifikimi i riskut

Njeriu është objekti dhe faktori numër 1 i riskut

Siç dihet [22], gjendja është një veti apo atribut i caktuar, ndërsa ndryshimin e gjendjes e thërrasim proces. Një bashkësi vetish do ta quajmë objekt, ndërsa gjendjen

Fig.1.Skemë e thjeshtuar menaxhimi



e ndryshuar të tij do ta quajmë zhvillim (ky mund të jetë pozitiv ose negativ). Në gjuhën e zakonshme fjala zhvillim nënkupton progres ose zhvillim pozitiv, ndërsa zhvillimi negativ quhet regres.

Proceset janë deterministike ose të rastit. Çdo proces i rastit ka riskun përkatës. Që këtë kur flasim për identifikim të riskut, duhet të përcaktojmë:

- procesin që e ngërthen këtë risk,
- objektin në të cilin zhvillohet procesi (ndodh ndryshimi),
- faktorët që çojnë në këtë ndryshim.

Në literaturë ka raste kur identifikimi i riskut [4] quhet analiza cilësore e riskut. Në përgjithësi, *Analiza e riskut* përmban edhe vlerësimin e tij dhe menaxhimin e riskut (shiko më poshtë).

Për identifikimin e objekteve me risk po shqyrtojmë një shembull të thjeshtë menaxhimi nga një veprimtari ekonomike (projekt, reformë, kontratë, praktikë, eksperiment, model, teknologji, etj).

Në këtë skemë dallojmë këto objekte kryesore:

1. Inputet (Burimet)
2. Infrastruktura hyrëse
3. Proçesimi (përpunimi i burimeve)
4. Infrastruktura dalëse
5. Logjistika e realizimit të produktit (outputi)

Në çdo njërin nga objektet ndodh një proces me riskun përkatës. Në tërësinë e saj kjo skemë është vetë një objekt (sepse përbehet nga një bashkësi objektivash (bashkim) dhe lidhjet përkatëse (struktura). Kjo bashkësi mund të jetë një fabrikë, uzinë, universitet, etj, një njësi pune, industriale, bujqësore, turistike, infrastrukurore, administrative, shoqërore, politike, etj. (Në këtë skemë edhe lidhjet e objekteve janë vetë objekte me risk. Këtë fakt po e kalojmë në heshtje).

3.Proçeset me risk

Proceset janë themeli i riskut

Në skemë objektet janë të çfarëdoshme, megjithatë për konkretizim të mëtejshëm, po supozojmë që ato (objektet) janë elementët e një universiteti, psh inputet janë studentët.

Këta regjistrohen në sekretari (infrastruktura hyrëse), në vijim ato u pajisen me dije në auditorë, laboratorë, praktika, etj (ose ndryshe procesohen) dhe pasi përfundon cikli i procesimit (përfundimi i studimeve) ata dalin në shoqëri si një output i gatshëm për të filluar punën si specialistë. Siç vërehet zhvillimi ka një numër të fundëm (pesë) procesesh. Kjo është bërë për thjeshtësi sepse realisht ky numër është shumë i madh, madje ka grupe procesesh që përsëriten nga koha në kohë (ditë, javë, etj).

Siç duhet këto procese mund të jenë deterministike (të sigurta) ose stokastike (të pasigurta) që varen nga faktorë të rastit. Psh regjistrimi i studentit në sekretari është vetëm një mundësi sepse ajo mund të mos realizohet nëse ai nuk ka një nga dokumentet, ose mungon sekretarja, më tej nuk punon programi i kompjuterit, ose studenti nuk paraqitet në kohën e duhur, etj. Natyrisht që çdo njëri nga proceset paraqet të paktën një ndryshim të gjendjes. Kjo e fundit përcaktohet nga një informacion i njohur më parë (të dhëna, njohuri, praktika, dije, etj). Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar në thelb procesin, vlerësimin e tij, etj.

P.sh, në qoftë se pyesim për procesin e regjistrimit të studentëve dhe marrim përgjigjen “që regjistrimi i tyre është i *mirë*,” nuk jemi të sigurtë që janë regjistruar të gjithë studentët. Ndryshe qëndron puna kur përgjigjja mund të ishte: “ u regjistruan 30% e studentëve.” Në rastin e parë procesi i regjistrimit është i pasigurtë, (pasiguria është e papërcaktuar dmth është fuzzy), ndërsa në rastin e dytë procesi është i sigurtë (deterministik) sepse janë regjistruar 30 %.

Në një rast të tretë kur njihet paraprakisht ligji probabilitar i regjistrimit të studentëve,(psh nga të dhëna eksperimentale), mund të përcaktohet probabiliteti që numri i studentëve të regjistruar të jetë një vlerë e caktuar psh 75% ose një interval p.sh 50-80% . Kuptohet që për të përcaktuar këto probabilitete procesi i regjistrimit është strukturuar, analizuar e përcaktuar më parë mbi bazën e të dhënave, situatave, etj

që varen nga faktorët e rastit: psh predispozita e studentit, koha, transporti, plotësimi e sigurimi i dokumenteve, gjendja financiare, shëndetësore, etj.

Nga sa më sipër del që *për të identifikuar riskun është paraprakisht e nevojshme* që të përcaktohet : **a)objekti ose asetë b) procesi c) faktorët e riskut**. Me marrëveshje këto tre elementë së bashku do ti quajmë hapësira e objektit me risk ose thjesht **objekt me risk**.

Kuptimi i objektit me risk (asete, procese, faktorë), jo shpesh herë haset si i tillë në literaturë, p.sh në [6]) flitet për asetë me risk, ose në raste të tjera vetëm për procese të rastit. Futja e këtij kuptimi në këtë shkrim është bërë me qëllim, sepse na duket më konkret, p.sh mund të flasësh kur nevojitet për hapësirë gjeometrike, diversitet risku, vlerë, humbje ose dëmtim, madje riskun vetë mund ta përkufizosh si “variabël rasti” të përcaktuar në hapësirën objekt që shqyrtojmë etj. Po kështu kuptimi objekt me risk mund të çojë në zgjerimin e tij teorik në trajtën e “kategorive me risk” [28]. Kjo është thjesht një hipotezë që kërkon një studim në të ardhmen duke u mbështetur në aksonometrinë, hipotezat dhe pohimet e teorisë së kategorive [12].

Gjithashtu objekti me risk mendojmë se është një kuptim praktik në ndërrmarjen e studimeve të ndryshme për analizën e riskut. Psh në qoftë se shqyrtohet risku në hapjen e një vendi pune, p.sh “Inxhinier risku” atëherë për trajtimin e riskut të këtij vendi pune, objekti njeri dhe procesi i përgatitjes së tij janë konkretë dhe shihen në simbiozë. Këto dy elementë janë në unitet. Më tej përgatitja është e lidhur me faktorin kohë, nivelin aktual të specialistëve konkurses, nivelin e shkollave të larta që përgatisin specialistë të “Analizës së riskut”, teknologjitë përkatëse, kurikula, literatura në vendin tonë, stafin akademik, burimet financiare, etj. Duke i analizuar të gjithë këta faktorë mund të arrihet në përfundimin që vendi i punës që kërkohet të hapet mund të jetë me risk të madh ose të vogël (cilësimet i madh, i vogël janë kuptime nga teoria fuzzy).

Kuptohet që për një vlerësim sasior të riskut të rastit që shqyrtojmë, kërkohen informacione të tjera (këtë argument po e ndajmë në heshtje sepse del jashtë qëllimit). Sido që të jetë, del në pah menjëherë që **identifikimi i objekteve me risk është hapi i**

parë i analizës së riskut, por nuk është vlerësimi i riskut (ky realizohet menjëherë pas identifikimit).

Në një analizë risku të një sistemi pyetja e parë që bëhet është : *cilat janë situatat, faktorët që bartin risk, pasojat që ata eventualisht mund të sjellin (dëmtime, dëme, rreziqe, kriza, paqëndrueshmëri, korrupsion, trafikë të paligjshme, krime, etj.) dhe që këtej edhe masat përkatëse.*

4.Faktorët e riskut. Siguria

Mënjanimi i faktorëve të riskut, një potencial sigurie

Përmbajtja e riskut dhe karakteri i tij (probabiliteti, humbjet,dëmi, etj) janë specifika të procesit. Kësisoj, çdo analizë risku përcaktohet nga fusha e studimit. Ajo krahas karakterit të përgjithshëm (objekte, procese, faktorë, dëmtim, etj) ka karakter specifik, në mënyrë të veçantë në studimin dhe vlerësimin e proceseve të rastit, të faktorëve, sigurisë dhe masave mbrojtëse për evitimin, kufizimin apo zvogëlimin e riskut (shkurt në menaxhimin e riskut).

Kuptohet që prapambetja në një fushë shoqërore, strategji, drejtësi, reforma, rend, diplomaci, media, arsim, politikë, shkencë, etj ose inxhinierike (energji, minerale, burime ujore e hidroenergji, ICT) ose financiare (tregu, tregu informal, biznes, vende pune, buxhet) banka qendrore të nivelit të II (sistem fiskal, pensione, kredi, hua, kontrata), etj, si rregull karakterizohet nga një risk relativisht i konsiderueshëm dhe për rrjedhim ***reduktimi i riskut: kufizimi, mënjanimi apo eliminimi i faktorëve që e prodhojnë atë janë njëherësh potenciale zhvillimi.***

Këta faktorë që mund të jenë shëndetësor, teknik, financiar, mjedisor, biologjik, komunikues, informativë, etj, çojnë në realizimin e sigurisë të proceseve përkatëse që njihet me emrin sigurimi shëndetësor, teknik, financiar, etj. Që këtej, ***një nga synimet themelore të Analizës së riskut, është rritja e sigurisë së veprimtarisë njerëzore*** (në çdo fushë e objekt të saj me anë të masave që "propozohen" prej saj. (Natyrisht që për sigurinë kombëtare ka instucione të posaçme [19] dhe ky kuptim është më i përgjithshëm se ai që përmendëm më sipër).

5. Individu. Ligji për riskun

Individi drejtues me kriter risku minimal

Në çdo veprimtari, faktori njeri (individi) është numri 1 (i parë) i ideimit të saj (strategjia, alternativat, projekti, zbatimi, outputi, marketingu) (shiko më poshtë), po kështu është përsëri njeriu ai që identifikon objektet me risk, bën vlerësimin e riskut e menaxhimin e tij. ***Që këtej risku i vetë individit është themelor në zhvillimin e veprimtarisë dhe në sigurinë (pasigurinë e saj).***

Përmendim kalimthi që risku i individit, veçanërisht paaftësia profesionale në pozicionet drejtuese, në strukturat e larta politike shtetërore, administrative, akademike, universitare, etj ka ndikuar negativisht në zhvillimet e veprimtarive përkatëse. Po kështu në disa raste edhe mungesa e strategjive shkencore në fushën e burimeve energjetike, buxhetit, vendeve të punës, të vlerësimit të aseteve, pronave publike, private e legalizimit të tyre, etj.

Nga kjo pikëpamje parandalimi, kufizimi apo mënjanimi i riskut në një vendim-marrje “jo të përshtatshme ” për zhvillimin e një projekti, reforme, kontrate, etj, është një vlerë e rritur e suksesit të veprimtarisë. Sot po flitet gjithnjë e më tepër për individin e riskun e tij ekzekutiv, shëndetësor, mendor, njohës, logjik, arsytues, psikik, jo më pak për riskun profesionalo- shkencor, shoqëror, etj. ***Që këtej në kushtet konkrete të zhvillimit të vendit përzgjedhja e individit në drejtimin e një veprimtarie merr një theks dhe rëndësi të veçantë.***

Individi në pozicione të larta drejtuese (Qeveri, Parlament, etj) zgjidhet mbi bazën e votës që sanksionohet në Kushtetutën e vendit. Natyrisht që kjo është shprehje e demokracisë. Sot njihet teorikisht dhe praktikisht vendi dhe roli i drejtuesit [26] në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë njerëzore, në mënjanimin e riskut por dhe në prodhimin e tij.

Ka sektorë strategjikë siç është energjia, shëndetësia, arsimi, legjislativi, rendi, etj që në pozicione drejtuese kërkohet edhe një përgatitje e shëndetshme profesionale, jo vetëm e drejtuesit më të lartë por edhe e bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë, psh këshilltarët, etj. Kuptohet që vota e popullit është kriter, por a mjafton kjo?

Në kontekstin e mësipërm natyrisht që do të ishte më e dobishme të vepronte edhe kriteri profesional i spikatur, pak më thjeshtë, jo çfarëdo deputeti mund të vendoset në

karrigen e Ministrisë apo në një pozicion të ngjashëm. Historikisht në Ministrinë e Energjisë asnjë ministër mendoj se nuk ka qenë me “profesionin e duhur”. Kjo natyrisht e rrit riskun e objektit “karrige Ministri” dhe akoma më tepër “karrige e sistemit të energjisë”. Risk ka patur kur edhe në institucione të tjera: psh jo rrallë herë në pozicione më të ulëta se Ministri janë vendosur titullarë me profil të largët, etj, ose gjatë 20 viteve lidhjet e këtij Institucioni pothuajse kanë munguar me Departamentin e burimeve të energjisë në Fakultetin e Gjeologjisë, i cili para 1990 ka qenë lider në projektet e naftës dhe sot e kësaj dite nuk i është marrë mendim për këto çështje. Më tej kur logoja e këtij Departamenti u vendos nga viti 1998 në dikasterin përkatës, fjala energji mungonte në logon e tij e vetëm pas disa viteve u vendos në këtë dikaster pas fjalëve ekonomi e tregti!! Po kështu ka patur drejtues që problemin e energjisë e kanë konsideruar të mbyllur, etj. Ndërsa sot del që energjia është problem i shumë i dikastereve!! ***Pra në pozicione drejtuese strategjike të shoqërisë, kërkohet jo vetëm votë popullore por edhe kritere të forta (të integritetit profesional, shkencor, etj).***

Aktualisht ne nuk kemi një ligj për riskun. Përmendim kalimthi që mungesa e nismës ligjore për vlerësimin e riskut e veçanërisht në fushën e investimeve, projekteve, kontratave, reformave, infrastrukturës, burimeve energjike, minerare, pasurive tokësore (e detare), mbrojtjes së mjedisit, etj, i ka sjellë dëme jo të vogla ekonomisë në energji, infrastrukturë, naftë, minerale, bujqësi, turizëm, etj.

Megjithëse propozimi për këtë nismë (ligji) është bërë që me hapjen e seksionit të Menaxhimit në vitin 2000 në Fakultetin e Gjeologjisë, sot e kësaj dite ky problem mbetet juridikisht i hapur. Pra ligji për riskun është tejet i domosdoshëm për tu miratuar, qoftë edhe në mënyrë të pjesshme për fusha më të rëndësishme e që kanë investime të larta dhe risk të madh.

Ligji për riskun është një standard dhe promotor që do të rrisë efektivitetin e investimeve

6.Vlerësimi i riskut

Vlerësimi i riskut, një instrument diagnostikues i zhvillimit të vendit

Identifikimi i objekteve me risk në një sistem është vetëm kusht i nevojshëm i Analizës së riskut. Vlerësimi i riskut [3] është hapi më i vështirë dhe më i rëndësishëm i analizës së riskut. Megjithëse ky subjekt del jashtë qëllimit të vënë po përmendim kalimthi disa konsiderata të thjeshta.

Vlerësimi i riskut ka në themel teori [5] të ndryshme si probabilitet, stokastikë, procese rasti, teori fuzzy, etj. Ky vlerësim mund të bëhet me instrumente të ndryshëm matematikë si p.sh integrale, ekuacione diferenciale stokastike, etj, të zbatuara në mënyra të ndryshme, psh:

a) për çdo objekt në veçanti (në mënyrë lokale) përfshi paraprakisht vetë studimin e objektit

b) për të gjithë sistemin (në mënyrë integrale ose globale)

Psh.për konkretizim, për të vlerësuar riskun në një zonë të ndotur, dmth vlerën e ndotësit ose siç thuhet pritiën e tij, mundet që zona në fjalë të ndahet në nën-zona elementare (elemente të fundme) dhe më pas pritija e ndotësit të llogaritet në çdo element (nënzonë). Pastaj për nën-zonat që tejkalojnë masën e ndotësit sipas kriterëve të caktuara, përcaktohen objektet me risk tashmë të vlerësuar si dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në vlerën e riskut, përmirësimin e tij, masat, etj.

Vlerësimi i riskut është një proces i vështirë që kushtëzohet nga shumë faktorë. Më poshtë po përmendim disa prej tyre:

- Lloji i procesit: i thjeshtë, i përbërë, i përzier, parësor, jo-parësor, homogjen, jo-homogjen, etj;
 - dinamika e procesit në hapësirë me një e shumë përmasa, kohë, etj;
 - tipi i objektit ku ndodh procesi pikësor, jo-pikësor, homogjen, jo-homogjen, i vazhdueshëm ose jo, izotop, anizotop, etj;
 - natyra e informacionit, të dhënat, lloji, saktësia, vëllimi e cilësia, struktura, etj.
- Bazat e të dhënave, magazinat e të dhënave, etj;
- metodikat e matjes, instrumentet e matjes, gabimet e matjes, etj;
 - metodikat e grumbullimit, seleksionimit dhe trajtimit të të dhënave;

- Modeli dhe metodikat matematikore, informatika, analiza e ndjeshmërisë, statistikë, fuzzy, metoda e kontrollit, rrjetat e Bejesit, etj .

Vlerësimi i riskut është i rëndësishëm në çdo fushë, por interes të veçantë paraqet ai në fushën e projekteve “strategjike” që lidhen me investime të konsiderueshme. Njehsimi i riskut dhe sigurisë “optimale” të investimeve është një problem kompleks, në zgjidhjen e të cilit marrin pjesë dhe zbatohen një bashkësi disiplinash matematikore, inxhinierike, financiare, modelim, metoda numerike, informatike, etj. Gjithashtu teori investimi, teori portofoli, inxhinieri financiare, statistikë, optimizim, ekuacione diferenciale stokastike, programim matematik, menaxhim shkencor e shumë disiplina të tjera që kushtëzohen nga specifikat e projektit, strategjia, alternativat, objektivat, zbatimi, dinamika e tyre, etj.

Kujtojmë që në analizën e riskut elementi i tretë është menaxhimi i riskut që në vetvete është një projekt. Meqenëse edhe reformat (që do të trajtohen më poshtë) janë projekte po paraqesim një vështrim të shkurtër menaxherial.

Vitet e fundit në vendin tonë janë ndërrmarë disa reforma për një zhvillim sa me të qëndrueshëm e efektivë të vendit, psh reforma në arsimimin e lartë, reforma administrative territoriale, etj. Reforma si një veprimtari njerëzore ka si synim realizimin në praktikë të një qëllimi të caktuar. Pra reforma ka një strategji [29] (bashkësia e alternativave për të realizuar qëllimin), çdo alternativë ka objektivat e saj (më saktë objektet përkatëse së bashku me kushtet, kufizimet, situatat, etj) të domosdoshme, etj. Nga bashkësia e alternativave, sipas kërkesave të caktuara, zgjidhet alternative më e mirë, dmth ajo optimale dhe me riskun më të vogël (më saktë optimal stokastike apo fuzzy). Më pas kjo alternativë hartohet në mënyrë të detajuar dhe zbatohet në praktikë. Në këtë alternativë që e quajmë projekt [26], gjejmë përgjigje pyetjet: kush e kryen aktivitetin, pse kryhet ai, e më tej si, me çfarë, kur, ku, cila është kosto, periudha e zbatimit të tij, e kështu me radhë deri në pyetjen, sa e sigurve është gjithë veprimtaria që analizohet, ose ndryshe cili është risku i veprimtarisë? Pra çdo reformë është projekt (madje dhe vetë menaxhimi i riskut) dhe produkti i saj “në një kuptim” duhet të jetë optimal.

Meqenëse aktualisht reformat janë në rendin e ditës, po paraqesim më poshtë disa konsiderata për rikun e tyre.

7. Reforma e arsimit të lartë dhe risku

Reforma e arsimit të lartë, shpresë e madhe me risk shumë të madh

Si në shumë reforma të mëparshme edhe në reformën e arsimit të lartë dhe në atë administrative – territoriale në punimet përkatëse [29], [18], [17], mungojnë të paktën fjalët kyçe të një projekti (gjë që cenon optimalitetin dhe riskun e veprimtarisë), po ndalemi paksa në këtë çështje dhe riskun.

Në punimin [26] tregohet vendi dhe roli i projektizimit në zhvillimin e shoqërisë, për rrjedhim edhe të reformave, kontratave etj. Në qoftë se në vijim, pranohet si përkufizim “ marrëveshja ” për strategjinë e reformës (bashkësia e alternativave në nivelin më të lartë të mendimit) del që strategjia e çdo reforme është objekt pune i institucioneve studimore, kërkimore etj, sepse ata merren edhe me idetë, e mendimet e nivelit të lartë që ngërthen strategjia.

Kësisoj në rastin e reformës së arsimit të lartë “pronarë” të strategjisë së saj në radhë të parë duhet të konsiderohen departamentet, fakultetet, institutet, akademitë, kolegjet, organizatat jo qeveritare me lektorë, specialistë, etj. Pak më ndryshe, politika dhe vendimi i saj për realizimin e reformës vjen pas strategjisë. Kjo është arsyeja, që në diskutimin e statusit të arsimit të lartë në vitet 92, etj, është kërkuar publikisht në mbledhjet përkatëse në mënyrë të shtjelluar (nga autori i shkrimit) pavarësia e arsimit të lartë nga politika, madje më pas në disa shkrime dhe tekste të tij është theksuar prej tij:

Strategjia e para, politika e dyta (First to mind, second to action).

Në hipotezën që reforma është projekt, analiza, studimi dhe realizimi i saj (reformës), duhet të ndjekë në përgjithësi në aspektin menaxherial, kuptimet (fjalët kyçe, etj), principet, pohimet, instrumentet, metodat, etj, të një projekti, pra edhe të analizës së riskut me karakter cilësor (objekte me risk).

Çdo departament ka një strategji të caktuar të aktivitetit të tij mësimor-shkencor, e për rrjedhim projektin përkatës. Që këtë projektin e reformës së arsimit të lartë është

bashkimi (unioni), i të gjithë projekteve universitare të departamenteve që bëjnë pjesë në sistemin e arsimit të lartë.

Projekti i reformës është objekt me risk (objekt, proces, faktor), pra reforma është një bashkësi (union) objektiv, procesesh, faktorësh që duhet të evidentohen të paktën cilësisht përpara fillimit të procesit të përgjithshëm të reformës. Këtu bëjnë pjesë inputet studimet, pedagogët, personeli, teknologjitë, burime të tjera të informacionit, burimet financiare, etj, metodat e instrumentet për laboratorë, praktika, lëndë ekzistuese, lëndë të reja e shumë asete të tjera që mund të jenë specifike për departamentin. Krahas këtyre, në projektin e çdo departamenti bëjnë pjesë edhe proceset mësimore didaktike, shkencore, aplikative, etj, në auditorë, laboratorë, praktika mësimore, detyra e projekte kursi, punë të pavarur kërkimore, punime sipas kontratave etj.

Përveç këtyre mund të parashikohen edhe procese suplementare mësimore me studentet që vijnë rishtaz në universitetet, kur niveli i formimit të tyre nuk do të përgjigjet kërkesave të departamenteve, po kështu ndoshta me kurset e reja të doktoraturave të ardhshme, etj. Gjithashtu mund të dalin situata të paparashikuara me fondet financiare suplementare, etj.

Duke pasur parasysh numrin e departamenteve të sistemit të arsimit të lartë, numrin e planeve mësimore dhe dhjetra lëndë mësimore (kurikula) që bëjnë pjesë në to, numrin e objekteve, proceseve, faktorëve në një lëndë, e cila në vetvete është projekt me rrishtim përkatës (cilësor dhe sasior), duket që risku i reformës arsimore të paktën nga ana cilësore është i konsiderueshëm. Kjo është arsyeja që në punimin [29] kam shkruar: ***reforma e arsimit të lartë “shpresa e madhe dhe risku i konsiderueshëm”***.

Vlerësimi i riskut të paktën cilësor (objekte, procese, fakte) kërkon një studim të hollësishëm e specifik për çdo projekt të departamenteve. Në këtë vështrim po përmendim që:

-Mungesa e kuptimit të riskut dhe e shumë koncepteve kyçe të menaxhimit, si në raportin e parë ashtu dhe në të dytin të reformës së arsimit të lartë [18] është një mundësi risku për zbatimin e reformës, të paktën në kohë.

-Mos formulimi i saktë i strategjisë së reformës, problemet themelore (çfarë jepet, kërkohet dhe si mendohet të përftohet zgjidhja, e cila do të jetë outputi i projektit të reformës, më pas cilat do të jenë variantet e zgjidhjeve, afatet etj. Të gjitha këto janë premisa që mund të sjellin risqe, psh nëse nuk përkufizohet saktë: në mënyrë të përgjithshme ose edhe në mënyrë lizy produkti i projektit, mund të ngrihen pyetje specifike “pa përgjigje”, psh cili do të jetë niveli i specialistit të ardhshëm të departamentit X në Politeknik, në qoftë se ky “produkt nuk përcaktohet“ ?

-Më tej, një risk tjetër lind kur bëhet një krahasim financiar për shpenzimet e investimet që bëhen për përgatitjen e një specialisti jashtë shtetit, të themi 600 U\$ për student dhe “aludohet” që po të investojmë këtë shumë, edhe ne mund të arrijmë një rezultat të tillë, pa marrë në konsideratë përgatitjen jo të mirë të “inputeve tona”, studentë, pedagogë, përvojë universitare, infrastrukturë, etj, shkurt ndryshimin jo të vogël të objekteve analoge të një Universiteti tonë me një të huaj.

Në qoftë se dëshirojmë që pas 8-10 vitesh studentët që përfundojnë studimet tek ne të krahasohen me ata të një universiteti evropian, për cilën kohë flasim për të sotmen apo për të ardhmen e Universitetit Evropian që ka bërë një zhvillim të konsiderueshëm gjatë kohës që do të krahasohemi? Duke mos marrë në konsideratë vlerën kohore të zhvillimit të vendeve të tjera në strukturën e në përmbajtje lind një risk tjetër për mangësi të njohurive (tona).

Në fakultetet inxhinjerie, etj, një risk jo i vogël mund të lind nga futja e lëndëve të reja të karakterit matematik, informativ, teknologjik, etj, ose nga ndryshimi thelbësor i raportit të lëndëve ekzistuese me lëndë të reja. Edhe sikur të mos këtë risk kjo do të jetë një detyrë e vështirë, në raste të caktuara edhe mjaft e vështirë.

Përvoja personale edhe e disa kolegëve ka treguar që lëndë të reja futen me shumë vështirësi në procesin mësimor, psh ka pasur raste që lëndë të reja janë futur në planin mësimor dhe vetëm pas disa vitesh, psh 7-8 vjet janë konsoliduar. Lënda e informatikës në një fakultet është futur që më 1974, megjithatë përvetësimi i lëndës nga studentët dhe përgatitja e programeve në kompjuter mendoj se mesatarisht nuk është e kënaqshme në mjaft “ raste inxhinjerie”.

Po kështu edhe në lëndë të tjera, p.sh *analiza e riskut*. Artikulli i parë në këtë subjekt është shkruar diku nga vitet 1997-98, leksionet e para filluan në 2003, kursi i plotë nga vitet 2008-2010, e sot e kësaj dite si lëndë e plotë nuk është futur ende në kursin pasuniversitar të Doktoraturës (mund të përmend që një kurs të pjesshëm kam zhvilluar edhe me punonjës të KLSH para një viti). Përveç kësaj duket që lëndët e reja, me karakter teknologjik do të duan edhe investime jo të vogla financiare. Risku financiar, në reformën e arsimit të lartë, të paktën në Inxhinieri duket mjaft i lartë kur “shikon sado pak investimet e të tjerëve”.

Përveç këtyre ka edhe risqe të tjera që lidhen në radhë të parë me gjeneratën e re të Profesoriatit që do të jetë baza e përgatitjes së reformës, po kështu niveli i bazës (financiare) nga shteti apo nga studentët, mungesa e vendeve të punës por specialitetet e ardhshme ose ndryshimi shumë i shpejtë i natyrës së vendeve të punës dhe amortizimi i parakohshëm i disa profileve të vendeve të punës, gjithashtu niveli i korrupsionit dhe i drejtësisë “përkatëse”, natyra informale e tregut, sistemi arsimor jo i qëndrueshëm dhe transparent, etj.

Pavarësisht nga këto, për një përshpejtim efektiv të reformës, përgatitja e bazës së të dhënave, ndoshta edhe i magazinave të tyre, i informacioneve të nevojshme për studimin paraprak të skemës së projektit të departamentit dhe më pas të vetë projektit është një sfidë që duhet të nisë sa më shpejt që të jetë e mundur, duke u mbështetur në raportet e Komisionit [18], përvojën e Departamenteve, përvojën analoge të huaj, literaturën e specialitetit, etj.

Reforma e arsimit të lartë bart edhe risqe të tjera që i referohen jo vetëm objekteve por edhe sistemit. Konkretisht ky risk ka filluar të ndjehet që tani me heqjen e licensave të disa universiteteve private, etj. Nga ana tjetër studentët e universiteteve private që duhet të regjistrohen në ato publike, por që nuk plotësojnë një apo disa kritere, janë një tjetër pengesë në mbarvajtjen e arsimit të lartë, shkurt një risk i shtuar i tij.

Siç kemi përmendur edhe më sipër për një strukturim sa më të mirë të reformës është i domosdoshëm studimi paraprak ose i fizibilitetit që mbështetet në një bazë të dhënash rigoroze dhe të shumanshme që kanë dalë nga analiza e veprimtarisë së institucionit dhe përvoja e tij në një periudhë të caktuar, përvoja e huaj, etj. Një studim i tillë do të

risë efektivitetin e projektit sepse do të mundësojë zvogëlimin e riskut dhe menaxhimin e tij.

8. Reforma administrative territoriale

Baza e përgjithshme e të dhënave dhe optimaliteti, kushte themelore të reformës

Më poshtë jepen, dy tre konsiderata risku edhe për reformën administrative territoriale (për të cilën janë bërë studime të veçanta e së shpejti do të fillojë zbatimi i saj, i mirëpritur dhe efektiv) që për mendimin tim është një “problem i hapur“ kur bëhet fjalë për një zhvillim të mëtejshëm në perspektivë.

Një nga parimet themelore të reformës ka qenë funksionaliteti, i cili është zbatuar edhe në reforma të vendeve të tjera të Evropës. Ky parim “duket“ se është parë kryesisht në aspektin administrativ e territorial duke synuar një lloj “optimizmi“ kryesisht administrativ që rezulton në “fitimet financiare“, nga analiza e dy tre varianteve. Këto variante janë shqyrtuar në kuptimin e zonës funksionale, por me sa dimë ne nuk cilësohet ndonjë zbatim matematik apo informatik, etj. Kjo vështirë se mund të bëhej në qoftë se ndarja në zona do të mbështetej në kuptimin jo të shtjelluar të zonës funksionale administrative.

Dhe ja sepse. Mendoj që zonë funksionale nënkupton një bashkësi sistemesh që procesojnë burime njerëzore, administrata (struktura) njësi mjekësore, shkollore, etj, burime financiare (taksa, rroga, shpenzime, investime, etj), burime ekonomike (energji, ujëra, ndotje urbane, toka, pyje, infrastruktura rrugore, ndërtimore, hidraulike, elektrike, elektronike, etj). Nëse një zonë funksionale nuk “kompozohet“ me sistemet apo nënsistemet përbërës, as që mund të bëhet fjalë për një optimizëm të administratës e të territorit në përgjithësi.

Për sa kohë vlen kjo ndarje dhe pse? Përsëri ky problem dhe zgjidhja e tij “ngec“ edhe tek mungesa e bazave të të dhënave. Dhe kjo ndodh jo sepse ato ekzistojnë dhe aktorët nuk i marrin në konsideratë por sepse ato në përgjithësi nuk ekzistojnë, ose nuk janë krijuar mirëfilli për problemin që shtrohet dhe për këtë duhet punuar shumë, duhet investuar. Që këtej del se problemi i ndarjes administrative është i hapur me prirje drejt kalimit në zona më të mëdha, më kompakte, me struktura më të spikatura të modeluara në aspektin matematik, informatik, statistik, etj [23], [30]. Kuptohet që

mungesa e bazave të të dhënave është risk (mungesë informacioni që e thellon pasurimin e tij), pra “risk mbi risk”.

Meqenëse risku i një reforme “integrale” është më i vogël se risku i bashkësisë së reformave (të paktën nga probabiliteti i produktit të ngjarjeve [22] që e përbëjnë), më poshtë paraqitet:

9.Reforma drejt zhvillimit *Go to Growth* dhe baza e të dhënave

Jo vetëm me reforma të pjesshme (madje boll!)

Vendet e Evropës perëndimore e qendrore, madje edhe shumë të tjera të Evropës juglindore kanë përfunduar shumë nga reformat strukturore në fushën e arsimit, ndarjes territoriale, etj, madje shume vite më parë. Aktualisht ato kanë strategji të përgjithshme zhvillimi për burimet njerëzore, teknologji të reja, komunikime e aktivitete elektronike në qeverisje, biznes, arsim, etj.

Kuptohet që në këtë mes jemi mbrapa, në shume tregues cilësor dhe sasior ekonomik, social, etj, në disa drejtime nuk krahasohemi as me vendet fqinje (ka punime që vendin tonë e fusin në një listë me emra vendesh në Afrike e Oqeani), jo më pastaj me disa vende të Ballkanit [11/1] e akoma më ndryshe kur krahasimi bëhet me Danimarkën, Estonin, etj. Natyrisht që bëjmë mirë të ndërtojmë strategji për reforma specifike “lokale” siç janë këto që po ndërmarrim [17], por çështja mund të shtrohet në një plan më të gjerë dmth duhet të përgatitemi jo vetëm për reforma specifike, por paralelisht edhe për një reformë të përgjithshme zhvillimi ashtu siç kanë bërë shumë vende të Evropës perëndimore e qendrore që nga viti 2005.

Kjo reformë që njihet në emrin e përgjithshëm GO TO GROWTH (drejt zhvillimit)[2] nga pikëpamja e informacionit përmban bazat e të dhënave të përgjithshme e specifike, strukturat e tyre, platforma të komunikimit elektronik e të aktiviteteve, metodat e ndryshme të teknologjive të informacionit, metoda të tjera të përparuara programimi, vlerësim të rrjeteve, etj. Në këtë kontekst mund të lindë mendimi ***“jo vetëm me reforma të pjesshme, madje ndoshta boll me to”***.

Natyrisht që shumë hapa zhvillimi të vendit nuk mund të kapërcehen (se duam Ne!!) e aq më pak të digjen. Megjithatë askush nuk na “pengon” që duhet të veprojmë fort dhe me shpejtësi për ndërtimin shkencor të bazave, magazinave) të të dhënave në

fusha të ndryshme të ekonomisë. Është e vërtetë që funksionaliteti i çdo sistemi “nis nga e dhëna”, dmth egzistenca dhe zhvillimi i një shteti të fortë përcaktohet nga natyra, struktura, etj, e bazave të të dhënave dhe e përdorimit demokratik të tyre, po aq e vërtetë është që dobësitë e shtetit (tonë) janë jo më pak të ndjeshme dhe me pasoja jo të vogla negative kur informacioni i mësipërm nuk është i plotë, për mos me thënë që në shumë fusha është i mangët.

Që puna paralele (me atë të reformave specifike [17],[18] mund e duhet të nisë për një reformë integrale zhvillimi, po rimarrim për konkretizim përsëri shëmbullin e reformës territoriale – administrative. Kjo siç do reformë tjetër është një aktivitet shkencor i mbështetur në strategjinë përkatëse, madje matematikisht optimal ose afërsisht i tillë që të parashikojë treguesit themelorë të zhvillimit të zonës së shoqërisë (së bashku me riskun përkatës) për një interval kohë 10-15 vjet. Shumë nga keto probleme janë edhe të vështira për t’u atakuar por kjo është një sfidë e rradhës kur më parë të jetë siguruar sasia e informacionit të nevojshëm e të mjaftueshëm (jo vetëm demografik, administrativ, apo i ndonjë lloji tjetër të pjesshëm), por ekonomik, financiar, teknologjik, mjedisor, etj, e në rradhë të parë të jetë i ndërtuar modeli i zhvillimit të zonës, komunës apo qarkut.

Të gjitha këto për fatin jo të mirë, (përgjithësisht) ne nuk e kemi, e për ti siguruar ato kërkohet kohë pune e madhe, etj (psh prej kohësh flitet për një model të zhvillimit optimal të vendit, i cili të paktën matematikisht, nuk është i përcaktuar në “trajtën eksperimentale“. Për të gjitha këto kërkohet kohë, përpjekje e punë e madhe, etj.

Akoma më e vështirë është sfida në qoftë se për “reformën e zhvillimit synohet të ndërtohet një algoritëm optimizimi [11], i cili krahas bazave të të dhënave “specifike”, etj, kërkon dhe përgatitjetet e nevojshme matematikë, informatikë, programuese, etj. Duke iu referuar përsëri reformës administrative, bazave të të dhënave egzistuese, etj, për të ardhmen do të duhet të shtohen edhe shumë struktura të tjera të të gjithë pasurive të zonës për çdo sistem e nënstrukturat e tij që mundësojnë ndërtimin e një modeli matematik të zhvillimit të përgjithshëm, madje optimal stokastik (me variante që shtrihen jo vetëm brenda zonës por edhe jashtë saj, etj).

Vështirë se me variantet egzistuese të reformës së ndarjes territoriale, Shqipëria për 10 vjet do të jetë po aq e “copëtuar” siç propozohet ndarja egzistuese, kur përveç të tjerave struktura të sistemeve të ndryshme mund të kenë zhvillime tashmë të reja (tregu i punës, mallrave, sistemi i arsimit, kulturës, etj me Kosovën, struktura demografike e turistike “të mëdha“, rrjete transporti kompakte madje demografi të ndryshuara nga vendet e punës, etj). Çështja është që në të ardhmen të mos braktisim struktura të vogla “se dalim jo efektivë“ e për këtë qëllim t’i prishim ato se duam të ndërtojmë struktura të mëdha “Europiane”.

Pavarësisht nga kjo, puna për një reformë të përgjithshme zhvillimi të vendit e shoqërisë duhet të nisë sepse zhvillimi i plotë është më efektiv dhe me më pak risk, është më i qëndrueshëm i integrueshëm dhe me perspektiv se të gjitha zhvillimet e pjesshme, ai e përcakton më mirë strategjinë kombëtare dhe integritetin e saj në atë Europiane. Natyrisht kjo sfidë GO TO GROWTH kërkon “me ngulm” institucionin përkatës që në fillimet e tij mund të jetë ai i Strategjisë Kombëtare, i cili që në fillim të synojë edhe përgatitjen për reformën GO TO GROWTH, madje pse jo edhe atë psikologjike, me referencën “Boll më me reforma të pjeshshme”.

10. Komunikimi, koha, risku

Si në çdo proces, edhe në komunikim, koha është një investim, një variabël i fortë dhe i qënësishëm i prodhimit të riskut

Në përgjithësi shoqëria jonë ka shumë humbje (risqe), në ndonjë rast këto kalojnë si pa u ndjerë, por kur shqyrtohen me kujdes, del që ato duhet të vlerësohen mirë. Dihet që faktori kohë është themelor në “prodhimin” e risqeve në çdo projekt, madje jo vetëm këtu. Në komunikime të ndryshme, biseda, fjalime, intervista, diskutime, veprimtari mediatike, akademike, etj ka raste që koha e humbur kalon pa u ndjerë, madje është e gjatë.

Kështu janë disa nga konstatimet, replikat, bisedat politike, etj, që kanë zgjatur e kanë mbërthyer opinionin publik me muaj e muaj (“sa të shkurton jetën”) p.sh projekti i Zogut të Zi, diskutimi për taksat, kohët e fundit edhe për reformat, etj. Të vjen keq që në shumë situata të tilla nuk formulohet problemi, çfarë jepet, çfarë kërkohet,

alternativat, argumentimi, metodat e zgjidhjes, rezultatet, zbatimi, interpretimi, risku, etj.

Mangësi të tilla ka edhe në materialet e reformave, [29], [17], [18] ose ka raste kur palët politike akuzojnë njëra tjetrën e akuzat vazhdon pa shkuar në drejtësi. Kujt i shërbejnë qëndrime e veprime të tilla? E raste të tilla me thes (pra edhe humbje, risqe) ka jo vetëm në politikë por edhe në fusha të tjera. Konstatimi publik për një çështje është një vlerë por, kur ai nuk të çon në zgjidhje dhe në rezultatin praktik (zbatues) është “vlerë pa vlerë“, shkurt shoqëria jonë prodhon risk me tepri në komunikim dhe kjo është një barrierë që përveç humbjeve të largon më tepër nga Standardet Europiane që janë synim i shpejtë i shoqërisë sonë.

11. Pasuria kombëtare dhe risku

Pasuria kombëtare duhet të jetë me risk minimal

Kur bëhet fjalë për zhvillimin ekonomik të vendit, mendja menjëherë të shkon tek sistemi ekonomik, tek pasuritë kombëtare, burimet njerëzore, burimet natyrore, burimet energjitike, mineralet e dobishme, burimet bujqësore, bregdetare (ujore e nënujore), burimet turistike, pozicioni i lakmueshëm gjeografik – strategjik, brezi mesdhetar, flora, fauna, klima, etj. Pasuria Kombëtare është baza ekonomike e shtetit. Në qoftë se sistemi ekonomik nuk shkon mirë, arsyet duhen kërkuar tek përmbajtja, dmth tek çdo nën-sistem (burimet, proceset, faktorët, infrastrukturat) ose/edhe në strukturën e sistemit dmth tek bashkësia e lidhjeve të nën -sistemeve. Këtëj del se faktorët themelorë në zhvillimin e Sistemit Ekonomik Kombëtar që kanë ndikim individual ose edhe të kombinuar janë :

1. Tërësia e inputeve të sistemit që me marrëveshje po e quajnë pasuri Kombëtare, me të gjitha burimet njerëzore, natyrore, etj, infrastrukturat, teknologjike (instrumentet e metodat), proceset përkatëse, shkurt tërësia e objekteve të sistemit.
2. Bashkësia e të gjitha nënstrukturave të Sistemit (administrative, politike, juridike, të rendit, të mbrojtjes, shëndetësore, arsimore, financiare, ekonomike, mjedisore, kulturore, etj).

Nëse për një rast do të mendonim që pasuria Kombëtare nuk ka qenë mjaftueshëm për një zhvillim normal të vendit (këtë kuptim po e pranojmë me marrëveshje apriori) lindin menjëherë këto nënpyetje:

e para ky mos zhvillim “i takon” burimeve njerëzore dhe përgatitjes së gjithanshme shoqërore, profesionale, shkencore, kulturore, etj;

e dyta, apo pjesës tjetër të pasurisë kombëtare siç janë burimet natyrore, enegjitike, burimet bujqësore, financiare;

e treta, apo veprimet të përbashkët të të dy nën-faktorëve të marrë së bashku?

Natyrisht këto çështje nuk janë të lehta për tu diskutuar e aq më pak nëse kërkohet të bëhet një vlerësim cilësor dhe sasior, përfshi këtu dhe vlerësimin e riskut. Nëqoftëse do pranohej pohimi që pasuria (burimet) Kombëtare dhe dinamika e tyre janë bazë e politikës shtetërore, del se vlerësimi i këtyre burimeve është kusht imperativ zhvillimi, pak më ndryshe kusht i nevojshëm i hartimit të strategjisë Kombëtare. Që këtë del nevoja e dy institucioneve: i atij të Vlerësimit të Pasurisë Kombëtare dhe të Strategjisë Kombëtare.

Kur flasim për institucionin e strategjisë kjo nuk do të thotë që vendi nuk ka strategji, parkun- razi ai ecën e zhvillohet sipas një strategjie (ka një institucion që merret me planifikimin e strategjisë!), e cila është më tepër afatshkurtër, në mjaft raste në nivel jo të mirë shkencor, hera herës me interesa politike, etj.

Më tepër, në dijenin time kjo strategji bëhet në shumë raste pa pjesëmarrjen e departamenteve, universiteteve, qendrave kërkimore shkencore e akademike të interesuara, etj. Ky problem është ngritur shpeshherë (veçanërisht pas vitit 2000) por ka ardhur koha që politika t’i japë mundësinë edhe hapësirën e mjaftueshme institucioneve mësimore e shkencore, etj (“pronarëve të ligjshëm”) të strategjive që të punojnë për hartimin e ligjeve në çdo fushë ku ata ushtrojnë aktivitetin përkatës.

Natyrisht strategjia nuk ka pavarësi absolute nga politika, si për fondet e projekteve e një sërë treguesish të tjerë menaxherial. Pra kur flasim për pavarësi të strategjisë nga politika, në radhë të parë mendohet që studimi dhe hartimi i saj për degën përkatëse të bëhet nga institucionet shkencore, departamentet, specialistët përkatës, etj.

Nuk mund të ketë strategji kombëtare (në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale), pra vlerësim të pasurisë kombëtare e të riskut të saj. Pasuria kombëtare është një nga çështjet më të rëndësishëm të çdo vendi dhe për vlerësimin e saj ka institucione, agjenci dhe mjaft organizma të tjerë, madje jo vetëm me karakter lokal, por edhe më gjerë. Meqenëse kjo çështje del jashtë qëllimit të vënë, më poshtë po paraqesim vetëm disa konsiderata të pjesshme në fushën e energjisë naftës e mineraleve të dobishme.

Dihet që prej vitesh sektori i energjisë (elektrike) ka patur shqetësime serioze veçanërisht në transmetimin e saj dhe të humbjeve në rrjet : edhe sot e kësaj dite ky sektor është deficitar psh në likuidimin e pagesave. Dihet nga menaxhimi i riskut që kur risku nuk “preket seriozisht” (monitorohet, menaxhohet), atëherë, ai mund të shtohet, aq sa mund të sjellë prapambetje të mëdha, deri edhe në kriza. Pra në këtë veprimtari me shumë risk, kanë ndikuar për vite me radhë shumë aktorë brenda dikasterit përkatës, i cili ka qenë njëherësh edhe “prodhues” i riskut, por edhe “kontrollues e vlerësues” i tij (konflikt interesi!). Përveç këtyre, humbje (risqe) ka pasur edhe në miniera, hidroenergji, etj.

Psh dhënia e liçensave “pa kriter” në minierat e kromit (ka sjellë një fragmentizim të nxjerrjes së mineraleve, humbje të tij nga shfrytëzimi, rezerva të mbetura të panxjerrshme, etj. Dikasteri përkatës ka qenë i interesuar për rritjen e prodhimit të kromit dhe njëherësh ka qene përgjegjës për kontrollin, vlerësimin e rezervave dhe të riskut. Përsëri “konflikt interesi”. Probleme të ngjashme ka pasur edhe në hidroenergji, për liçensat që janë dhënë hera herës në kushte të pastudiuara veçanërisht në aspektin hidrodinamik mjedisor, etj. Shfrytëzimi jo racional i energjisë hidrodinamike të pellgut (ujëmbajtës) ul efektivitetin, shkurt rrit “humbjet” (riskun). Edhe në këtë rast i njëjti problem; prodhohet risku dhe vlerësohet nga i njëjti institucion. Akoma më tej.

Siç dihet kontratat e Albpetrolit për shitjen e tij (në një vlerë 800.900 milion \$ u përgatit “me nxitim“ dhe u menaxhua nga vetë dikasteri ku ai bën pjesë. Përsëri “prodhimi i riskut dhe vlerësimi i tij” brenda të njëjtit dikaster, madje i shoqëruar me probleme kapitale siç janë rezervat, pusët, teknologjitë, etj. Shqetësime analoge lindin edhe në llogaritjen e rezervave të mineraleve të dobishme të tjera, shoqëruesve të tjerë,

të dinamikës së shfrytëzimit që zbatohet dhe të efektivitetit të tyre, veçanërisht në kompanitë private, etj.

Këta shembuj dhe të tjerë si këto, që lidhen me pasurinë shtetërore e private, konkretisht me rezervat e mineraleve të dobishme, me përkufizimin e tyre, klasifikimin, shfrytëzimin e deri në njehsimin e riskut, etj, duket se shtrojnë nevojën e një institucioni shtetëror të pavarur, i cili të përgjigjet për standardizimin e burimeve dhe mineraleve ashtu siç e kanë edhe shtete të tjera.[9], përmend që standardizimi i burimeve minerale, rezervave dhe riskut të tyre sipas standardeve bashkëkohore do të kërkojë investime veçanërisht në teknologjitë e matjeve, kontrollit [27] të metodikave përkatëse që do të përdoren për këtë qëllim.

Çështja e sigurimit të informacionit të nevojshëm e të dhënave përkatëse nuk është thjesht një problem që shfaqet vetëm në llogaritjen e rezervave e standardeve të tjera, por në çdo studim, projekt, reformë, etj. Në shumë universitete shikon shkrimin: “e dhëna është informacion, informacioni është njohuri, njohuria është dije, e thënë ndryshe funksionaliteti kudo, (por edhe i shtetit) fillon nga e dhëna (çdo funksion përcaktohet nga të dhënat e fushës së tij).

Baza e të dhënave është themelore edhe për njehsimin e riskut, pa këtë bazë dhe cilësitë përkatëse të saj as që mund të bëhet fjalë për njehsimin e riskut kudo qoftë. Më sipër kur u pohua që reforma e arsimit të lartë ka risk të madh, në mënyrë të heshtur u kalua fakti që ka një risk që i ka rrënjët në mungesën e bazave të nevojshme të të dhënave për projektet përkatëse të të gjithë departamenteve dhe të zbatimit të tyre.

Me sa di, problem i bazave të të dhënave ekziston në shumë e shumë sektorë të ekonomisë dhe në çdo qelizë të jetës shoqërore (individ, familje, komunitetit, etj) dhe është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në përmirësimin e zhvillimit të tyre.

12. Konsiderata të përgjithshme

Shqipëria ka risk relativisht të madh që është një problem i gjithanshëm kombëtar

1. Jeta është risk[22],[29]. Çdo veprimtari njerëzore (mendore, fizike) ka risk.

2. Individu është burimi, objekti dhe faktori nr 1 i prodhimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut.
3. Koha është investim, njëherësh një variabël i “fortë” i prodhimit të riskut.
4. Meqenëse individ (njeriu) është strumbullari i riskut kërkohet një përgatitje e spikatur e tij menaxheriale, veçanërisht kur ai është në pozita drejtuese (pavarësisht nga niveli i hierarkisë).
5. Analiza e Riskut është një instrument diagnostikues dhe potencial i mundshëm zhvillimi. Reforma në drejtësi shton shanset e rritjes së këtij potenciali.
6. Analiza e Riskut në projekt, etj është një standard europian dhe si e tillë ajo duhet të parashikohet në normë ligjore. Ligji për riskun duhet të veprojë në çdo fushë dhe me përparësi në fushat strategjike ku alokohen investime të rëndësishme.
7. Baza e të dhënave është themelore edhe për njehsimin e riskut, pa këtë bazë dhe cilësitë përkatëse të saj as që mund të bëhet fjalë për njehsimin e riskut kudo qoftë.
8. Në fushën studimore e aplikative të Analizës së Riskut është e ndjeshme mungesa e specialistëve. Që këtë, ngritja e kurseve të kualifikimit për specialistët dhe hartimi i kurrikulave përkatëse në nivel student, masteri dhe doktore, sigurimi i literaturës përkatëse, përfitimi nga përvoja e huaj, etj, janë një nevojë e ndjeshme për shumë sektorë si energji, gjeologji, financë, mbrojtje mjedisi, inxhinieri, matematikë, etj.
9. Meqenëse vendi ynë në shumë sektorë ka prapambetje dhe risk të madh (korrupsioni, krimi i organizuar, trafikimi, kohë me “bollëk”, padrejtësi në pronat, etj, pabarazia e theksuar shoqërore, varfëria, mungesa e vendeve të punës, papunësia (veçanërisht në radhët e të rinjve), mangësi në strategji e model zhvillimi, dobësi ekonomike në sektorë strategjik, si energji, miniera, arsim, shëndetësi, mbrojtje mjedisi, etj. Këto e bëjnë të domosdoshëm që sa më shpejt të bëhet, të paktën identifikimi i objekteve me risk dhe njëherësh edhe marrja e masave përkatëse për menaxhimin eventual të riskut (kufizimi dhe zvogëlimin e tij).
10. Kjo veprimtari paraprakisht mund të kërkojë fillimisht realizimin e një formulari që mund t’u dërgohet dikastereve, bashkive, komunave, etj dhe më pas me përgjigjet dhe informacionet përkatëse, të hartohet një material me problemet më të rëndësishme të

analizës së riskut, për institucionet e mësipërme, i cili mund të dërgohet në organin përkatës shtetëror për vendimet respektive.

11.Në një kohë të përshtatshme mund të filloj edhe përgatitja e organizimi i një Konference Kombëtare për problemet e riskut në sektorë të ndryshëm ekonomik shoqërorë, psh në atë të burimeve energjitike, drejtësisë, financës, arsimit, mineraleve, shëndetësisë, rendit, mjedisit, etj, etj.

12.Të shikohet mundësia për ngritjen e një institucioni që të merret më standardet e burimeve njerëzore, natyrore, energjisë, mineraleve, etj, duke përfshirë rezervat, klasifikimin, etj deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e tyre, kontratat, import-eksportin. Në ndërtimin e këtij institucioni duhet pasur mirë parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera.

13.Në shumë institucione europiane, agjenci, kompani, kabinete, dikastere, etj, kanë specialistë të mirëfilltë që përgjigjen juridikisht (me firmë) për analizën e riskut në projekte(kontrata, reforma, etj). Edhe në vendin tonë duhen bërë përgatitjet që të kemi specialistë të tillë deri në institucionet më të larta të qeverisë. Në institucione të rëndësishme mund të ngrihen edhe grupe të veçanta për auditimin e riskut të projekteve strategjike

14.Paralelisht me reformat specifike mund dhe duhet të fillojë puna për hartimin e një strategjie për zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë (GO TO GROWTH) dhe ndërtimin e bazave të të dhënave në të gjithë sistemet e ekonomisë duke parashikuar fondet përkatëse financiare (deri në buxhetin e shtetit).

15.Çdo reformë është projekt. Për të rritur efektivitetin e reformës së arsimit të lartë dhe për të zvogëluar riskun e konsiderueshëm të saj fillimi i punës për hartimin e projekteve paraprake nga departamentet përkatës në bazë të kritereve dhe standardeve të kërkuara nga Komisioni i Arsimit të Lartë është një nevojë e dorës së parë.

16.Reforma e ndarjes territoriale dhe e administrimit është një problem i hapur zhvillimi që në vazhdimësi duhet të pasurohet me baza të dhënash të reja, struktura e modele që do të bënin të mundur optimizimin e zhvillimit deri edhe në zgjerimin eventual të ndarjeve, në qoftë se kjo del nga studimi i modeleve matematike-ekonomike, financiare, etj. Në një plan me të përgjithshëm studimi dhe ndërtimi i

modelit të zhvillimit makroekonomik- matematik të vendit është një nevojë e ngutshme.

17.Risku karakterizon çdo veprimtari që kryen njeriu në shoqëri, ekonomi, politikë, arsim shkencë, shëndetësi, rend, turizëm, infrastrukturë, etj. Çdo risk është specifik dmth ka natyrën e tij: përmasat, densitetin (i lartë, i mesëm, i ulët), ndikimin, masën e humbjeve (dëmtimeve), etj. Risku në sistem përcaktohet nga natyra e proceseve, objekteve dhe struktura (infrastruktura). Psh në qoftë se në një sistem risku është i lartë, psh në atë politik, atëherë ai duhet kërkuar në objektin individ, parti, etj dhe menjëherë në strukturën e nënstrukturën përkatëse që lidhin këto objekte si statute, dokumenta, norma ligjore, etj. Pak më ndryshe për të menaxhuar riskun në sistem, duhet bërë menaxhimi i proceseve eventualisht në objekte ose/edhe në strukturat përkatëse. I njëjti problem edhe në sisteme të tjera arsimit, juridik, etj. Kjo do të thotë që në reforma të caktuara ndryshimet në sistem mund të jenë thelbësore, ndërkohë që në objekte mund të mos bëhen ndryshime të qenësishme. Psh në qoftë se shtrohet pyetja që haset në tekste [23]: Sa ministra duhet të ketë Kabineti Qeveritar? Këtu problem i sistemit është “më tepër” strukturor se sa i objekteve që do të përmbajë Kabineti Qeveritar.

18.Vlerësimi i riskut është një problem që përcaktohet nga hapësirat përkatëse dhe kushtet e tyre që po i quajmë (si në matematikë) kushte fillestare dhe kufitare. Kushti më i parë fillestar është transparenca, ndërsa kushti kufitar është “prekja”, kanosja, cënimi (threat), e kushteve fillestare. Pak më ndryshe, drejtësia dhe zbatimi i saj janë kushte të domosdoshëm për vlerësimin e riskut dhe njëherësh edhe për penalitetin eventual.

Nga ana tjetër, risku është masë që karakterizon një proces të caktuar i cili “ndodh” në objekt si rezultat i veprimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, pra risku gjithmonë i referohet objektit me risk, i cili është hapi i parë i Analizës së Riskut. Natyrisht, ky identifikim në fazën e parë nuk është matematik, etj (sepse nuk është bërë vlerësimi), por praktik, vizual, intuitiv, eksperimental, perspektiv, induktiv, arsyetues, etj. Kuptohet që kur identifikimi i objekteve me risk mund të bëhet në rrugë

“jo matematikore”, vizuale, eksperimentale, etj, atëherë ai mund të jetë instrument plotësues i dobishëm për hapat e mëtejshëm të analizës së riskut dhe të zbatimit të tij.

19. Në natyrën e shoqërisë objektet janë të lidhur dhe bashkëveprojnë me njëri tjetrin. Nga ky bashkëveprim lindin ndryshime, risqe, etj. Psh, në një varg objektesh, nga veprimi i objektit të parë mund të lindë “një risk në objektin e dytë” ky i fundit vepron dhe “shkakton” një risk në objektin e tretë, e kështu me radhë. Formohet në këtë mënyrë një varg risqesh të kushtëzuar (që kanë në themel probabilitetin me kushte) ose ndryshe një zinxhir risqesh (probabilitetesh). Mund të ndodhë që risk pas risku këto të kalojnë në “rezonancë” aq sa bëjnë final të jetë i konsiderueshëm. Që këtej shprehja e popullit: *“po filloi e keqja, hapi derën”*.

20. Në jetë për këto “lojëra me risqe” duhet bërë kujdes veçanërisht kur pasojat janë të ndjeshme sepse shoqërohen me humbje deri në kriza, në të kundërt në qoftëse ato mënjahen mund të sjellin potenciale zhvillimi. Psh, në marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy shteteve (Shqipëri – Kosovë) lojëra kontradiktore mund të sjellin dëme të dyanshme, ndërsa loja e bashkëpunimit përfitime të dyanshme. Pra, politikat diplomatike ose politika në përgjithësi mund të bëhet instrument zhvillimi ose barrierë e tij. Kuptohet që në raste të tilla, krahas kujdesit e hetimit të gjithanshëm të objekteve me risk, ka rëndësi koha, shpejtësia e vendimeve dhe realizimi i tyre.

21. Në bashkësinë e shumëllojshmërisë së risqeve ka edhe risqe të heshtur, pasiv, etj, por që me kalimin e kohës bëhen shumë aktiv. Psh, sipas planit rregullues prishen disa ndërtesa, biznese, etj sepse janë të paligjshme. Zbatohet ligji dhe natyrisht bëhet mirë. Në qytet apo njësi të vogla ku papunësia është e madhe, kjo rritet edhe më tej, më pas njerëzit e papunë kanë shanse të riskojnë duke u marrë me veprimtari të tjera të paligjshme, psh grupe të caktuara mund të formojnë struktura të paligjshme më të mëdha, etj. Pra mënjanimi i një risku mund të “pjellë” një risk të ri që në kushte të caktuara mund të bëhet më i rrezikshëm se i pari.

22. Në një rrethanë të tillë çduhet të bëjmë? Pa tjetër që zbatimi i ligjit nuk diskutohet, veçse në qoftë se situata pret, psh në zonat e prishura nuk do të bëhet asnjë ndërhyrje e re, mundet që zbatimi i ligjit të bëhet me pak vonesë, që njerëzit të mund ta shfrytëzojnë këtë kohë për t’u sistemuar, për të gjetur punë, etj. Në literaturë [1] shtimi

i papunësisë, veçanërisht për moshat e reja është aq i rrezikshëm sa mund të kalojë në krizë.

23. Risqe “të heshtura” ndodhin edhe në rotacionet politike, akademike, etj ose kur problemet shtrohen në auditore të Universitetit, psh i reformave[23] dhe nuk dëgjon njeri. Psh Partia në pushtet, apo stafi akademik drejtues premton një projekt infrastrukture (rrugë), në fakultet për një punim (veprimtari) tjetër, etj. Më pas nis puna për projektet (veprimtaritë) në fjalë, kryhet rotacioni dhe fillojnë veprimtari të tjera, që i lenë “në një anë” projektet e mëparshme sepse nisin projekte të rinj. Mund të ndodhë që rotacioni të argumentojë “ndryshimin” e ri, por në qoftë se jo, kjo do të thotë që risqet në projektet e lëna në qetësi flenë, shumohen, e për rrjedhim vazhdojnë humbjet nga investimet tashmë të kryera. Që këtë del se rotacionet politike (akademike) që nuk parashikojnë vazhdimin e politikave adekuate efektive e perspektive, mbi bazë të një strategjie kombëtare (që vepron për shumë vite) shoqërohen edhe me risqe. E që të mos ndodhë kjo duhet të kemi norma ligjore. Psh nuk duhet lejuar që, pa argument “objekti i nisur” të flejë i papërfunduar” e për këtë të mos i gjendet shkaktari.

23. Risku në Shqipëri është aq i madh [22] sa për studimin e tij do të duheshin “punime të

tëra”. Veçanërisht në sektorë të rëndësishëm ekonomik, ndoshta jo vetëm për objektet por

edhe për sistemet përkatës (shpesh diskutohet që “fajin e ka sistemi”).

Kjo është arsyeja pse në ballinën (kopertinën) e tekstit “*Optimizimi, Hyrje në Stokastikë*”

[22] kam shkruar:

“Shqipëria ka prapambetje(të mëdha), ka risk të konsiderueshëm”.

Ndryshe, risku është një problem i gjithanshëm kombëtar.

Literatura

1.-World Bank (2014)

Risk and Opportunity. Managing Risk for Development

2.-European Commission (2012)

Europe 2020. Europes Growth Strategy. Brussels , BELGIQUE

3.-*A practical guide to risk assessment* pvc. Com /us/grc (2008)

4.-Threat and Hazard. Identification and Risk Assesment Guide (2013)

<http://www.dhs.gov/xlibrary/asset/rma-astrategig--national-risk-assesment/ppde.pdg>

5.-L. Stetner (20011) Introduction to risk theory and Mathematical finance Polish Academy Science, Warsav ,POLAND

6.-M.Capinski, T.Zastavniak (2003)

Mathematics for Finance An Introduetion to Financial Engineering, Springer , GERMANY

7.-H.J. Zimmermann(1996) *Fuzzy set theory and its application* Kluwer. London/UK

8.- Data warehouse tutorial www. Tutorials point.com/dwh/dwh_tutorial.pdf

9.-Canadian Institute oh Mining, Metallurgy and Petroleum (2000)

CIM Standarts of Mineral Recources and Reserve, CANADA

10. *G.A.Hilton. Defining Risk. Financial Anakysis Journal Boston USA*

11.A.Ghencea, il.Ghiger(2010) Data Base optimizing services. Data Base Systems Journal, Bucharest ROMANIA.

11/1 A.Matei, C. Savulescu. E-Government in Balcan.Comparative study.National school of political Studies and Public administration. Bucharest , ROMANIA

12. (1990) M. Bars C. Wells. Category theory for Computer Science nNew York USA

13.-*Project Risk Analysis and Management*, APM , UK

14.SPE (2008) Petroleum Resource Management System(internet)

15.*Risk Management Concepts and Methods* (2008). [_www .clasif.asso.fr](http://www.clasif.asso.fr)

16.-Risk Assesment of Pipeline Protection (DNV) ,2010 (internet)

17.-Ministri per çështje vendore (2014)*Reforma administrative territorial.Kriteret teknike per ndarjen e re administrative – territoriale*, Tianë

- 18.**Komisoni per arsimin e lartë dhe kërkim shkencor (2014)
Raporti i parë dhe Raporti përfundimtar, Per reformimin e arsimit te larte dhe kerkimin shkencor, Tiranë
- 19.**The Republik of Albania *The National Security Strategy of The REPUBLIC OF ALBANIA*
- 20** B.Leskaj(2013).Mireqeverisja –Paradigma e re ne administrimin Publik. “Auditimi Publik”, Nr 5,Tiranë
- 21-**S.Osmani (1999) *Disa konsiderata mbi analizen e riskut ne investimet e naftes, Nafta Shqiptare, (Ekonomia), Nr4, Patos, Fier.*
- 22.**S.Osmani (2012)*Optimizimi : Hyrje në Stokastikë. Pjesa e tretë. Shtëpia Botuese Filara, Tiranë*
- 23.**S.Osmani (2008) *Optimizimi : Programimi linear me zgjerime. Pjesa e parë. Shtëpia Botuese Pegi,Tiranë*
- 24.**S.Osmani. S.Sukaj Dh.Gjovreku, N.Koja, N.Kodheli.(2003) *Disa Konsiderata për strategjinë e vendit tonë dhe zhvillimin e qendrueshë, Konferenca Italo Shqiptare, Tiranë*
- 25** S.Osmani (2013), Imazhe dhe vizione per projektizimin.Quo Vadis ? Revista “Auditimi Publik”, Nr 5, Tiranë
- 26.-**S.Osmani P.Hoxha (2012)*Management , Strategy and Project. Leadership, Leader and Manager, International Confernece, GCMM Aucland , NEW ZELAND*
- 27.-**S.Osmani,F.Kazazi ,M.Lakrori ,B.Nepravishta (1983, 1984), Matja dhe kontrolli i proceseve teknologjike, vol 1,2 Tiranë
- 28.**S.Osmani(2014)A view on Management and Category Theory
Intenational Conference : Informations Systems and Technology Innovation. Tiranë, Albania
- 29.**S.Osmani (2014), *Një vështrim menaxherial për reformat (Kumtese me pedagogë dhe pasuniversitarë). Fakulteti Gjeologji-Miniera.Tiranë*
- 30.**S.Osmani (2004), Modele matematike në menaxhim, Shtëpia Botuese PEGI, Tiranë

Roli i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë në luftën kundër korrupsionit

Nga Z. Wojciech Kutyla, Zëvendës-Presidenti i NIK



Roli i Zyrës supreme të Auditimit të Polonisë në luftën kundër korrupsionit

- **Niveli i kërcënimit të korrupsionit në Poloni dhe vendet e tjera**
- **Aktivitetet antikorrupsion të NIK**



Kërcënimi I korrupsionit në 177 vende CPI (nga 0 në 100 pikë)

Sipas transparencës ndërkombëtare
CPI –Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit

Vendi	Pozita në renditje	Numri i pikëve në 2013	Numri i pikëve në 2012
Danimark	1	91	90
Poloni	38	60	58
Gjeorgji	55	49	52
Moldavi	102	35	36
Bjellorusi	123	29	31
Ukrainë	144	25	26
Somali	175	8	8



Kërcënimi i korrupsionit në sondazhet e opinionit


- Raporti Anti Korrupsion i BE i publikuar nga Komisioni European në 2014, thekson se 82% e Polakë-ve, në krahasim me mesataren e qytetarëve të marrë në studim të BE-së (75%) e konsiderojnë korrupsionin si të përbashkët. 65% e Polakëve mendojnë se korrupsioni kërcënon procedurën e prokurimit publik
- Sipas analizave të Qendrës për Kërkime të Opinionit Publik nga qershori i 2013, numri i peronave që deklarojnë se ata e dinë se dikush merr ryshfet është ulur me 13 pikë (në 2000-29% dhe në 2013-16%)
- 84% e pjesëmarrësve Polak te studimit, vlersojnë ryshfetin të dënueshem maksimalisht dhe të pamoralshëm

Source: www.antykorupcja.gov.pl




Kërcenimi I korrupsionit në Poloni (Sondazhet)


Të dhënat tregojnë se në vitet 2003-2004 numri I krimeve të konfirmuara te korrupsionit është rritur me 3,5 herë (ryshfeti pasiv dhe aktiv, mbrojtje e paguar, përvetësimi I pushteteve, korrupsioni ekonomik, korrupsioni electoral dhe korrupsioni ne sport).




Përcaktimi I Korrupsionit



Roli I SAI-ve në luftën kundër korrupsionit



Roli I NIK në luftën kundër korrupsionit



Masat parandaluese të NIK

- Fushat me tendencë korrupsioni
- Mekanizmat korruptive
- Propozime De lege ferenda
- Rekomandime të rregullta post-auditim



Përmirësimi I metodologjisë së auditimit


- Nga viti 2003 e mbas, metodologjia e auditimit antikorrupsion është i detyrueshëm në auditim – Manuali i Auditorit
- Mjetet e IT
- Trajnimet



Kontaktet me qytetarët



Ankesat dhe propozimet



Informimi I opinionit publik për funksionimin e shtetit

- Informimi rreth gjetjeve të auditimit NIK
- Mbi 2 milion shikues të faqes zyrtare të NIK –ut
- Raporti vjetor I Aktivitetit
- Media sociale: Facebook, Twitter, Google+, Youtube
- Publikime për korrupsionin
- Në 2013 media botoi në total 14.256 materiale në NIK, 6% më shumë se në vitin 2012 (13.426 publikime)
- Seminare dhe konferenca
- Leksione edukimi

Informimi I opinionit publik



- “ Auditimi I shtetit ” dy mujor
- Artikuj shkencorë mbi patologjinë në organizatat publike
- Neni i të punësuarit NIK i renditur si një nga më të mirët e INTOSAIT dhe Kombeve të Bashkuara në 2013



Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Ne vitet 2003-2013 Nik dorëzon 1596 njoftime, autoriteteve të zbatimit të ligjit

Përcaktimi	Totali në vitet 2003-2013
Njoftimet për verifikimin e informacioneve të rremë të dokumentave, falsifikimi i dokumentave dhe përdorimi i dokumentave të falsifikuara	276
Mashtrime	32
Ryshfeti pasiv	5
Përvetësimi i kompetencave apo neglizhencës së detyrave nga nje zyrtar publik duke vepruar kundër interesit publik apo privat	208



Bashkëpunimi me institucionet e tjera

- NIK ofron konsultime mbi strategjinë e qeverisë kundër korrupsionit
- Bashkëpunimi me prokurorët
- Bashkëpunimi me Zyrën e Konkurrencës dhe Mbrojtjen e Konsumatorit
- Bashkëpunimi me Shkollen Kombëtare Juridike dhe Prokurorisë Publike




Bashkëpunimi me institucionet e tjera

- Prioritetet e INTOSAI –t në 2011-2016; lufta kundër korrupsionit
- Pjesmarrja e NIK ne aktivitetet e grupit të punës të INTOSAI-t ne Luftën Kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave
- Grupi Visegrad
- Trajnime, Seminare, Konferenca, Auditime



Suksesi I NIK

- Transparenca Ndërkombëtare, në 2012 përshkruan normat më të larta në krahasim me të gjithë institucionet shtetërore në Poloni
- Bordi drejtues I INTOSAI
- Auditori I brendshëm dhe Këshilli I Europës
- IBAN



Faleminderit për vëmendjen tuaj!

Shënim : Kjo kumtesë paraqitet ne Power Point, në pamundësi për të pasur materialin në word



Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe mënyrat se si ato mbështesin qeverisjen e mire.

Nga: Turan Yasar, TCA



Abstrakt

Kjo kumtesë ekzaminon rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në mbështetjen efektive ose mirëqeverisjen në sektorin publik. Në këtë kuadër përmendet rëndësia e SAI-ve dhe përmirësimeve për rritjen e pavarësisë së tyre përmes disa principeve themelore të pranuar nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Më tej duhet marrë në konsideratë se çfarë nënkuptohet me mirëqeverisje dhe cilat janë principet që e mbështesin atë. Në përfundim duhet vënë theksi tek mënyra se si auditimi i jashtëm i sektorin publik promovon mirëqeverisje dhe siguron një regjim të fuqishëm auditues në sektorin publik.

Hyrje

Institucionet Supreme të Auditimit janë pjesë e administratës publike e çdo shteti sovran. Megjithatë, auditimi suprem, i cili nga disa autorë është quajtur gjithashtu auditim shtetëror, ndryshon nga një shtet në tjetrin si rezultat i së shkuarës historike që lidhen me shtetin, po ashtu me klimën e tij politike, ligjore dhe kulturore. Prandaj,

emri, struktura, fuqia dhe funksioni i SAI-t të secilit shtet ndryshon nga njeri tjetri. Ky spektër i varieteteve të ndryshme duhet të konsiderohet si pasuri e botës së auditimit.

Pavarsia e SAI-ve

SAI-t luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e transparencës së veprimeve të qeverisë, garantojnë përgjegjësi efektive në fushat financiare dhe ekonomike dhe bëjnë të disponueshëm informacionin e performancës i cili është kusht për qeverisjen me pjesëmarrje dhe besim të qytetarëve tek qeveria. Roli për matjen, dobitë dhe publikimet e informacionit për performancën është themelor, çka çon në një reflektim të integritetit në administratën publike dhe në rolin e insitucionit.

Organizata mbikëqyrëse për komunitetin e auditimit të sektorit publik, Organizata Nderkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) ka punuar që nga viti 1953, për të promovuar mirëqeverisje duke bërë të mundur që SAI-t të ndihmojnë qeveritë e tyre respektive të përmirsojnë performancën, të rrisin transparencën, të sigurojnë llogaridhënie, të ruajnë besueshmërinë, të luftojnë korrupsionin, të promovojnë besimin publik dhe të ruajnë interesat e qytetarëve të saj.

Momente të shquara historike dhe arritjet e Organizatës Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) përfshijnë Deklaratën e Limës në 1977 e cila vendosi principet themelore të pavarsisë, efiçencës dhe efektivitetin e auditimit në sektorin publik. Përpunimin i planit të parë strategjik të INTOSAI-t (2005-2010) vendosi bazat strategjike të Organizatës si vendosjen e standarteve, ndërtimin e kapaciteteve, ndarjen e dijeve dhe zhvillimin si një organizat ndërkombëtare model. Deklarata e Meksikës në vitin 2007 mendosi themelet për Pavarsinë e SAI-ve dhe zhvillimin e strokturës së ISSAI-ve nga e cila do të përfitojë dhe rritet auditimi i sektorit publik në mbarë botën.

Njohja nga Rezolutat e Asambles së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/66/209 në 2011 është një rezultat logjik i punës së vështirë dhe të sukseshme të Organizatës

Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit gjatë viteve të fundit. Ajo e vendos INTOSAI-n në fokusin e shqetësimit të komunitetit ndërkombëtarë. Institucionet e auditimit të sektorit publik, cione të pavarura njihen si një pjesë esenciale e një qeverisje të mirë. SAI-t tashmë kanë në duart e tyre një mjet efektiv për të kërkuar që qeverisjet kombëtare të njohin efektin ekzekutiv dhe legjislativ të principeve bazë të pavarësisë të SAI. Sukseset konkrete janë tashmë të regjistruara nga SAI-t e të gjitha Institucioneve Supreme të Auditimit rajonale.

Rëndësia e Deklaratës së Limës

Deklarata e Limës është dokumenti i parë i INTOSAI që në mënyrë tërësore vë në dukje dukje rëndësinë e pavarësisë së SAI-t. Ajo i kujton antarët e INTOSAI-t se mund të jenë objektiv dhe efektiv vetëm nëse SAI-t janë të pavaruara nga subjektet që kontrollojnë dhe janë të mbrojtura nga ndikimet e jashtme.

Rëndësia e deklaratës së Meksikës

Institucionet Supreme të Auditimit duhet të mbrojnë vlerën e punës së tyre duke shtuar garancitë e duhura dhe duke hequr pengesat reale për perceptimin e pavarësisë së tyre. SAI-et mund të arrijnë pavarësinë përmes mjeteve të ndryshme dhe duke përdorur mbrojtje të ndryshme. Praktikrat e mira për arritjen e pavarësisë janë prezantuar në udhëzimet shoqëruese. Udhëzimet orjentojnë SAI-et drejt mjeteve dhe veprimeve për rritjen dhe përmirësimin e pavarësisë së SAI-t.

Të dyja këto deklarata përfshijnë rëndësinë e pavarësisë duke deklaruar se:

- SAI-t mund të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe me efektivitet vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjektet që kontrollojnë dhe janë të mbrojtura nga ndikimi i jashtëm.
- Pavarësia i SAI-t është e lidhur në mënyrë të pandashme me pavarësinë e anëtarëve të tij
- Stafi i auditimit nuk duhet të influencohet nga organizmat që auditon
- SAI-t do duhet të kenë në dispozicion mjete financiare të mjaftueshme për të mundësuar realizimin e detyrimeve të tyre

- Institucionet e auditimit të sektorit publik, duke qenë të pavarura janë pjesë thelbësore e mirëqeverisjes.
- Mungesa e pavarësisë së SAI-t do ta kufizonte atë në kontributi e tyre për qeverisjen kombëtare

Disa nga dokumentet e tjera që lidhen me pavarësinë në nivel global janë:

- INTOSAI Plani Stradegjik 2011-2016
- Deklarata e Pekinit
- ISSAI-t p.sh ISSAI 12, 100,200,300,1260,3000,4100)
- Rezoluta e OKBs A/66/209
- Revista ndërkombëtare e auditimit të qeverisjes
- Baza e të dhënave të SAI-ve, baza e të dhënave informuese

Pas Deklaratës së Meksikës në 2007-n, INTOSAI përcaktoi 8 principet e pavarësisë për auditimin e jashtëm në terma profesional dhe metodologjik

Tetë shtyllat që përcaktojnë Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit

Parimi 1 – **Statusi ligjor:** Në mënyrë që të garantohet pozicioni i duhur dhe efektiv i statusit ligjor të SAI-t brenda shtetit, pavarësia e tij duhet të jetë e përcaktuar qartë në Kushtetutë dhe në lëgjislacion.

Parimi 2 – **Kryetari i SAI-t:** Kushtet për emërimin e Kryetarit të SAI-t dhe të anëtarëve të institucioneve kolegjinale duhet të përcaktohen në legjislacion. Pavarësia e kryetarit të SAI-t dhe të anëtarëve të institucioneve kolegjinale mund të sigurohen vetëm nëqoftëse ata janë emëruar me një afat mjaftueshmë të gjatë dhe të ohen qartë arsyet e largimit, procedurë kjo e pavaruar nga ekzekutivi. Kjo i lejon ata të kryejnë mandatin pa patur frikën nga shpagimi.

Parimi 3 – **Veprimtaritë :** Me qëllim që ta përmbushin mandatin e tyre në mënyrë efektive, SAI-t duhet të jenë të pavarura në zgjedhjen e çështjeve për auditimi, në planin e tyre për auditim dhe në implementimin e metodave të auditimit, si edhe në

kryerjen e auditimeve të tyre dhe në organizimin dhe menaxhimin e zyrave të tyre. Prandaj SAI-t duhet të jëne të lira nga drejtimi ose interferimi nga legjislacioni ose ekzekutivi ndërkohë që përmbushin detyrat e tyre audituese.

Parimi 4 – *Qasja në informacion*: Audituesit kanë të aksesojnë, në kohë dhe pakufizime të gjitha dokumentat të cilat mund t’u nevojiten për përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

Parimi 5 – *Raportimi i rezultateve të auditimit*: SAI-et duhet raportojnë rezultatet e punës së tyre të paktën një herë në vit. Megjithatë ata janë të lirë të raportojnë më shpesh, nëse e konsiderojnë të rëndësishme.

Parimi 6 - *Përmbajtja dhe koha e raporteve të auditimit*: SAI-et duhet të jenë të lira të vendosin për përmbajtjen e raporteve të auditimit dhe ti publikojnë e shpërnadjnë raportet e tyre pasi ata i janë paraqitur formalisht ose i janë dorëzuar entitetit të audituar.

Parimi 7- *Follow u* : SAI-t duhet të kenë procedura të pavarura të siguruar që subjektet e audituara kanë ndërmarë veprimet për rekomandimet e adresuara.

Principi 8- *Burimet*: SAI-t duhet të kenë në dispozicion burime monetare, material, dhe njerëzore të arsyeshme e të nevojshme dhe duhet të menaxhojnë buxhetet e tyre pa ndërhyrjen apo kontrollin e qeverisë dhe autoriteteve të saj.

Rëndësia e Qeverisjes

Qeverisja lidhet me institucionet, me sistemet dhe proceset prej të cilëve çdo organizatë apo vend qeveriset. Qeverisja ka të bëjë me strukturat dhe proceset për marrjen e vendimeve, përgjegjëshmërinë, kontrollin dhe sjelljen e drejtuesve të organizatave.

Koncepti i “efektivitetit apo “mirëqeverisjes” është zhvilluar dhe është vështruar si komponenti kyç në dhënien e rezultateve për palët e interesuara. Qeverisja efektive në sektorin publik mund të inkurajojë përdorimin eficient të burimeve, përmirësimin e menaxhimit dhe shërbimit të ofruar dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në

përmirësimin e jetës së qytetarëve. Qeverisja efektive është gjithashtu thelbësore për ndërtimin e besimit tek subjektet e sektorit publik, e cila është në vetvete e nevojshme nëse subjektet e sektorit publik do të jenë efektive në përmbushjen e detyrës së tyre.

Parimet e Mirëqeverisjes

Është e qartë se efektiviteti apo mirëqeverisja janë të rëndësishme për sektorin publik, megjithatë kjo nuk është e nevojshme për palët e interesuara për se çfarë është mirëqeverisja.

Egzistojnë përkufizime të ndryshme në lidhje me atë se cilët janë principet apo karakteristikat e mirëqeverisjes. Ato përfshinë

- Përgjegjësinë dhe transparencën,
- Sundimin e ligjit,
- Barazinë dhe performancën (efiçencën dhe efektivitetin)

Roli i sektorit publik në mbështetjen e mirëqeverisjes

Përgjegjësia dhe transparenca janë komponentët kyç në sigurimin e një kuadri të fuqishëm qeverisës në sektorin publik. Përmes rishkimit të këtyre dy parimeve hidhet dritë në një tjetër aspekt të kuadrit të mirëqeverisjes, atë të performancës.

Qeveritë kanë pushtet detyrues mbi qytetarët e tyre dhe bizneset, çka përfshin rritjen e të ardhurave, rregullimin, dhe zbatimin e ligjit dhe rendit. Në një shoqëri demokratike është thelbësore që për të ushtruar këtë pushtet detyrues, atyre tu kërkohet që të jenë të përgjegjshme për zgjedhjen p.sh të një ministri apo këshilltari, të punonjësve publik apo menaxherëve në shërbimin publik, sepse ata janë përgjegjës për ushtrimin e këtyre kompetencave dhe për ofrimin e shërbimeve publike, për ata që përdorin dhe paguajnë për shërbimet e ofruara, për zgjedhësit dhe përfaqësuesit e të zgjedhurve. Prandaj një princip themelor është që ata që janë përgjegjës për problemet e rëndësishme publike dhe përdorimin e parave publike

duhet të mbajnë përgjegjësi, për të siguruar që burimet publike:

- të mbrohen dhe të llogariten siç duhet
- të përdoren në përputhje me ligjin dhe standardet dhe
- të përdoren në mënyrë efektive, efikase dhe me ekonomicitet

Ministrat dhe punonjësit e shërbimit publik duhet të veprojnë në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara, dhe paratë publike duhet të trajtohen me integritet dhe shpenzohen në mënyrën e duhur. Megjithatë përgjegjshmëria kërkon që subjektet publike të jenë përgjegjëse për veprimet e tyre dhe të hapura për shqyrtimin e tyre efektiv nga të tjerët, duke u siguruar se kontrollet janë efektive

Në vendet më demokratike, ka një ndarje të qartë të pushteteve mes atij ekzekutiv dhe atij legjislativë. Legjislativi është përgjegjës për miratimin e buxhetit apo planeve të shpenzimeve të ekzekutivit dhe ekzekutivi është përgjegjës për ekzekutimin e këtyre planeve dhe burimeve të cilët legjislativi i ka deleguar, duke siguruar që këto bëhen në pajtim me ligjin dhe rregullat dhe duke siguruar që ato përdoren në mënyrë eficiente, në mënyrë ekonomike dhe me efektivitet. Organet ekzekutive janë përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin ditë për ditë të veprimeve dhe për të siguruar mirëpërdorimin e këtyre burimeve. Më së fundi është përgjegjësia e tyre që ta raportojnë këtë tek legjislativi.

Është më pas përgjegjësi e organit ligjvënës, si përfaqësues i qytetarëve të tij, për të riparë se si ekzekutivi i ka përdorur burimet që organi ligjvënës i ka deleguar për të kryer aktivitetet e tija. Është ushtrimi i kësaj përgjegjësie të organit ligjvënës që e bënë të qartë rolin e rëndësishëm që ka auditimi i jashtëm në sektorin publik.

Për të kryer rolin e tyre shqyrtues në mënyrë efektive, anëtarëve të legjislativit iu nevojiten informacione objektive dhe fakte-bazë për mënyrën se sa mirë Qeveria shpenzon fondet publike. Auditimi i jashtëm i sektorit publik përbën një lidhje kyçe në këtë zinxhir përgjegjësie midis Ekzekutivit dhe Organit Ligjvënës duke ofruar informacion të pavarur dhe të besueshëm për Organin Ligjvënës, dhe në fund të fundit për qytetarët dhe përdoruesit e shërbimeve publike. Për shembull, ku ka një

mungesë qartësie midis rolit të ekzekutivit dhe legjislativit ose ku rolet nuk janë kryer në mënyrë efektive, auditimi jashtëm i sektorit publik mund të ofroj një vlerësim të pavarur.

Disa mund ta konsiderojnë nevojën për auditimin e jashtëm të sektorit publik të rezultateve dhe të performancës të ekzekutivit si një barrë në marrëdhënien e llogaridhënies midis legjislativit dhe ekzekutivit. Megjithatë një auditim i jashtëm efektiv i sektorit publik është një element kyç në reduktimin e rrishtit të pandarë në marrëdhënien midis legjislativit dhe ekzekutivit. Në lidhje me rolin e Auditimit në Sektorin Publik mund të përmendimkatër faktor rrishtues të pandashmë në marrëdhënien midis një drejtuesi (legjislativit) dhe një operatori (ekzekutivit)

- *Konflikti i interesit: Operatori mund ti përdori burimet dhe autoritetin për të mirën e interesat e veta në vend të interesave kryesor;*
- *Largësia: operacionet mund të largohen fizikisht nga mbikqyrja direkte e drejtuesve;*
- *Kompleksiteti: Drejtuesit mund të mos posedojnë ekspertizën teknike për të mbikqyrur aktivitetin e operatorit*
- *Pasojat e gabimit: Gabimet mund të jenë të kushtueshme kur operatorët janë administratorë të sasive të mëdha të resurseve dhe janë përgjegjës për programe që prekin jetët dhe shëndetin e qytetarëve.*

Natyra e aktivitetit të auditimit të jashtëm është më e gjerë në sektorin publik se sa në sektorin privat për shkak të ndryshimeve në objektiva. Ndërsa sektori privat është i drejtuar nga motive përfitimi në një masë të madhe dhe performance financiare është një matës fundamental i performancës në një entitet privat. Ky nuk është rasti i qeverisë dhe i entiteteve të sektorit publik. Objektivat e tyre janë të spektrit të gjerë dhe përfshijnë objektiva politike, sociale dhe ekonomike, arritje e cila nuk mund të matet vetëm nga performanca financiare. Prandaj për të siguruar auditimin e sektorit publik janë të nevojshme informacionet objektive për performancën e ekzekutivit.

Fushëveprimi i punës së auditimit është më i gjerë se sa auditimi financiar i kërkuar në sektorin privat.

Efektiviteti i auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare të entiteteve të sektorit publik është ende një komponent themelor i regjimit të auditimit në sektorin publik për të mbështetur modelin e llogaridhënies, pasi kjo jep siguri që transaksionet financiare dhe aktivitetet janë llogaritur në mënyrë të përshtatshme.

- *Burimet janë përdorur për të kryer detyrat e qeverisë në pajtim me ligjin dhe rregullat, (auditimi i rregullshmërisë);*
- *Burimet janë përdorur me efikasitet, me ekonomicitet dhe me efektivitet në ofrimin e programeve të qeverisë dhe ofrimin e shërbimeve publike, (vlera për para ose auditimi i performancës).*

Afrësia për të kryer mirë punën audituese është e domosdoshme në mënyrë që auditimi i jashtëm i sektorin publik të mund të sigurojë legjislativit informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm për të mundësuar atij mbajtjen e ekzekutivit të përgjegjshëm për përdorimin e burimeve të veta.

Megjithatë auditimi në sektorin publik në këta vitet e fundit ka lëvizur përtej rolit tradicional të shqyrtimit dhe raportimit dhe ka nisur të shkojë tek mënyrat se si mund të ngrejë më tej vlerat e veta duke mbështetur subjektet e sektorit publik të përmirësohen.

Instituti i Audituesve të Brendshëm e përmbledh roli përmirësues të auditimit të sektorit publik në termat e kushteve të brendshëm dhe largpamësisë

- *Kushtet e brendshme:* Audituesit përshkak të njohjes në themel të çështjeve mund të ndihmojnë vendimmarrësit për të vlerësuar se cili nga programet dhe politikat janë duke funksionuar dhe cilat jo, duke ndarë praktikatat më të mira dhe duke krahasuar informacionin, duke kërkuar horizontalisht nëpër organizmat qeverisës dhe

vertikalisht mes niveleve të qeverisjes për të gjetur mundësitë për të huazuar, adaptuar, apo ri-fuqizuar praktikat menaxhuese.

- *Largëpamësia*: Audituesit ndihmojnë gjithashtu organizmat të shohin përpara duke identifikuar prirjen dhe duke e sjellur vemendjen tek sfidat emergjente përpara se të mbërrihet në kriza të mundshme. Funkzioni i auditimit mund të theksojë sfidat e mundëshme (të tilla si prirjet demografike, kushtet ekonomike, apo kërcënimet nga ndryshimi i sigurisë) dhe të identifikojë riskun, mundësitë që po shtohen nga evoluimi i shpejtë i shkencës dhe teknologjisë, kompleksitetet e shoqërisë modern dhe ndryshimet në natyrën e ekonomisë.

Është e qartë rëndësia e auditimit në sektorin public për të mbështetur mirëqeverisjen, përgjegjshmërinë dhe transparencën në përdorimin e burimeve publike. Është mëse e qartë se përmes këtij roli ofrohet gjithashtu një mbështetje e qartë për principe të tjera në kuadrin e mirëqeverisjes, të shtetit ligjor si dhe në mbështetje të efikasitetit dhe efektivitetit.

Sigurimi i një regjimi të fortë në auditin e sektorit publik

Ekzistenca e një regjimi të auditimit të sektorit publik është një element kyç për përgjegjshmërinë dhe transparencën e sektorit public. Megjithatë ai nuk është i mjaftueshëm që të mund të ofrojë përgjegjshmëri dhe mirëqeverisje. Rregjimi ka nevojë të jetë i fuqishëm dhe të operojë me efektivitet. Kjo përfshinë:

- Institucionet e auditit në sektorin publik duhet të jenë të pavarura nga subjektet që ato auditojnë, të kenë një mandate të gjërë, të drejtën për të raportuar punën e tyre në mënyrë të hapur dhe kapacitete për të ofruar legjislativitet informacione objektive se si ekzekutivi ka përdorur burimet e tija.
- Mekanizmat e duhur për vendimmarrësit apo trupat ekzekutive të subjekteve në sektorin publik, për të rishikuar dhe ndjekur gjetjet dhe rekomandimet e institucioneve të auditimit të sektori publik, duke orjentuar drejt veprimeve të duhura korrigjuese apo sanksioneve të duhura,

Këto kërkesa parashikohen edhe nga Deklarata e Mexicos e INTOSAI-t për pavarësinë e SAI-eve të vitit 2007 në të cilën deklarohen tetë parimet thelbësor si kërkesa esenciale për auditimin e sektorit publik

Aftësia e institucionit të auditimit të sektorit publik për të raportuar në mënyrë të hapur tek të zgjedhurit ose trupat qeverisëse të entiteteve publike, dhe tek publiku i gjerë është një lidhje kyçe në zinxhirin e llogaridhënies. Pa këtë, zinxhiri i llogaridhënies është i këputur, nuk ka transparencë dhe është e pamundur që qeveria apo entitetet publike tu japin llogari atyre që jua ofrojnë përdorimin e këtyre burimeve.

Megjithatë e gjitha kjo është e dyshimtë nëse auditimi nuk ka burime apo kapacitet për të realizuar mandatin e vet. Pa marrë parasysh se cili është mandati i tij ose aftësia e tij për të raportuar në mënyrë të hapur, në qoftëse ai nuk ka aftësitë apo burime të mjaftueshme, SAI nuk do të arrij objektivat e tij për të dhënë legjislaturës dhe elektoratit të gjerë evidenca të mjaftueshme dhe të bazuara për të bërë të përgjegjshme entitetet publike dhe qeverinë.

Veprimtaria e mekanizmave të legjislativit ose e trupës qeverisëse të një entiti në sektorin publik, për të rishikuar dhe për të ndjekur më tej gjetjet dhe rekomandimet e institucionit të auditimit të sektorit publik, cojnë në veprime korrigjuese dhe sanksionet e duhura. Nëse kjo nuk ekziston apo nuk operon në mënyrë efektive pavarësisht atyre çfarë raportojnë institucionet e auditimit të sektorit publik, këto do kenë një efekt të dëmshëm në përgjegjëshmërinë e qeverisjes dhe subjekteve të sektorit publik, veçanërisht në qoftëse institucionet e auditimit të sektorit publik nuk e kanë të drejtën për të raportuar në mënyrë të hapur në publik, apo nëse kjo e drejtë është e kompromentuar nga veprimet joefektive të mekanizmave legjislative. Për shembull, nëse legjislativi nuk ka një mekanizëm efektive të vëzhgje ministrit, zyrtarët apo menaxherët se si ata i përdorin burimet

publike, bazuar në raportet e sektorit publik dhe institucioneve të auditimit, gjetjet dhe rekomandimet e institucioneve të auditimit të sektorit publik, do të kenë një influencë të kufizuar dhe ka më pak të ngjarë të çojë në veprime të duhura korrigjuese ose vënien e sanksioneve.

Konkluzione

Nuk është e lehtë të artikulohet drejtpërdrejtë ose të përcaktohet se çfarë përcaktohet si qeverisje e mirë e sektorit publik. Përcaktimet apo modelet e ndryshme ofrojnë një konsensë mbi disa nga parimet kryesore që e theksojnë atë. Ndër këto parimet thelbësore janë ato të llogaridhënies dhe transparencës së qeverisë dhe subjekteve të sektorit publik i mbështesin ato në përdorimin e burimeve publike më dispozicion të tyre për të realizuar objektivat e vendosura.

Është legjislativi ai që autorizon burimet që qeveria dhe subjektet e sektorit publik kanë në dispozicion, për të dorëzuar planet dhe programet dhe për të arritur objektivat e tyre. Si pjesë e kësaj marrëdhënie, roli i legjislativit për të siguruar autoritetin për përdorimin e burimeve publike përfshinë edhe përgjegjësinë e Qeverisë për të dhënë llogari për mënyrën se si i ka përdorur këto burime dhe nëse e ka bërë këtë në mënyrë efikase dhe efektive.

Ky kuadër llogaridhënie ofronë baza të qarta për një regjim auditimi të pavarur dhe të fuqishëm të sektorit publik për të ofruar evidenca objektive dhe të pavarura për performancën e qeverisjes dhe për ti mundësuar legjislativit që ti kërkojë llogari ekzekutivit. Kjo do të mbështeste qeverisjen e mirë në përdorimin e fondeve publike. Pa këtë kuadër, do të kishim një hendek të qartë në aftësinë e legjislativit dhe elektoratit, për të ekzaminuar në mënyrë sa ë efektive si qeveria ka përdorur burimet publike.

Referencat

- Deklarata e Pekinit (2013) Promovimi i Mirëqeverisjes nga Institucionet Supreme të Auditimit
- Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (2001) – Qeverisje në sektorin publik: Organizma Rregullatore
- Instituti për qeverisje (2003)- Principet për Mirëqeverisjen në shekullin e 21, Politika Përmbledhëse
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/66/209 in (2011)
- Komisioni i Pavarur për Mirëqeverisjen në Shërbimet Publike (2005)- Standartet e Mirëqeverisjes për Shërbimet Publike
- Instituti i Audituesve të Brendshëm (2006) – Roli i Auditimit në qeverisjen e sektorit publik
- OECD Politikë Përmbledhëse (2005) – Modernizimi i Sektorit Publik: Qeversija e Hapur
- OECD (2009) – Qeverisja në një vështrim të shpejt
- INTOSAI (2007) – ISSAI 10 Deklarata e Meksikës për Pavarësinë e SAI-t
- INTOSAI (2007) –ISSAI 11 Udhëzimet dhe Praktikat e mira në lidhje me Pavarësinë e SAI-t

Roli i Audituesve në Mirëqeverisjen Kombëtare – Përfaqse Strategjike

Nga Prof. Dr. Omer Stringa



Hyrje

Mirëqeverisja kombëtare ka në themel të saj marrëdhënien efikase dhe koordinimin e ngushtë ndërmjet ligjvënësve, qeverisë, drejtuesve të institucioneve publike, auditimit dhe shoqërisë civile. Ngritja e një strukture që nxit mirëqeverisjen në të gjitha nivelet siguron identifikimin e objektivave strategjike, mjetet e përshtatshme për përmbushjen e tyre dhe monitorimin e performancës. Ndërtimi dhe zbatimi me efikasitet i të gjithë këtyre komponentëve, mbështetur në koordinimin e ngushtë të punës së grupeve të interesit, do të mundësonte një platformë për përmirësimin e qeverisjes kombëtare duke rritur vlerën e shtuar për qytetarët.

Në mbështetje të mirëqeverisjes, audituesit kanë një rol unik dhe duhet të veprojnë në dy kapacitete kryesore. Së pari, audituesit duhet të sigurojnë një vlerësim të pavarur dhe objektiv mbi përshtatshmërinë e veprimtarisë së institucioneve publike. Së dyti, ata duhet të veprojnë si katalizator për ndryshim, duke këshilluar apo rekomanduar përmirësime në strukturën dhe veprimtarinë e institucioneve në përmbushje të objektivave afatgjatë. Shpesh puna e auditimit fokusohet ose perceptohet si e lidhur veçanërisht me vlerësimin e pavarur dhe objektiv mbi përshtatshmërinë e veprimtarisë së institucioneve publike. Auditimi mund të sjellë një vlerë të shtuar në përmirësimin e qeverisjes vetëm duke përmbushur me efikasitet rolin e tij si katalizator për ndryshime pozitive në institucionet publike. Auditimi duhet të fokusohet dhe të jetë i aftë të nxisë zbatimin e praktikave më të mira mbi administrimin e rrezikut, efikasitetin e proceseve të punës, si dhe rritjen e

efektivitetit ekonomik në përmbushje me objektivat strategjike të institucioneve publike dhe qeverisjes kombëtare.

Në përmbushje të objektivave të lartpërmendur, audituesit duhet të sigurojnë që mbikëqyrësit, drejtuesit dhe punonjësit e institucioneve publike ti shohin si partner strategjikë në mirëqeverisjen e institucionit, si dhe njëkohësisht të sigurojnë që veprimtaria e tyre të jetë dhe të perceptohet nga grupet e interesit si e pavarur dhe objektive. Për të garantuar pozicionimin si një partner i pavarur dhe objektiv i institucioneve publike, audituesit përballën me sfida të brendshme dhe të jashtme. Sfidat e jashtme të cilat kanë të bëjnë me qëndrimin e ligjvënësve dhe drejtuesve ndaj funksionit të auditit, ndonëse janë më pak në kontrollin e audituesve, do të mund të adresohen gradualisht nëse audituesit i përgjigjen me sukses sfidave që kanë të bëjnë me **përqasjen strategjike ndaj administrimit të burimeve njerëzore, garantimin e pavarësisë dhe objektivitetit të auditimit në kryerjen e funksionit të tij, bashkëpunimin strategjik të audituesit me grupet e interesit.** Vëmendja e mirëkoordinuar dhe e vazhdueshme në adresimin e tre prioriteteve të mësipërme mundëson që audituesit të kontribuojnë pozitivisht në mirëqeverisjen kombëtare.

Përqasje strategjike ndaj administrimit të burimeve njerëzore

Patja e audituesve të një niveli të lartë është e një rëndësie të veçantë për mirëqeverisjen e institucioneve publike. Shteti dhe institucionet publike përballen çdo ditë me sfida të reja dhe me komplekse që kërkojnë një rol gjithnjë e më aktiv të audituesve. Rritja e sfidave dhe kompleksitetit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore kërkon vëmendje të vazhdueshme mbi performancën dhe eficientësinë në përdorimin e burimeve ekonomike nga ana e tyre. Në këto kushte, rritja e presionit nga grupet e interesit, veçanërisht taksapaguesit, për më shumë llogaridhënie dhe transparencë në përdorimin e fondeve publike është sinjal i përgjegjësive dhe pritshmërisë në rritje edhe ndaj audituesve.

Për këtë arsye është e një rëndësie të veçantë për audituesit që të zhvillojnë dhe rishikojnë periodikisht strategjinë për identifikimin, rekrutimin dhe mbajtjen e një

fuqie punëtore profesioniste dhe të talentuar. Për të bërë të mundur diçka të tillë kërkohet identifikimi i kapaciteteve dhe aftësive kritike që janë të nevojshme për përmbushjen e objektivave strategjik të auditimit. Drejtuesit e këtyre institucioneve duhet të kenë një rol parësor në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e politikave të burimeve njerëzore si themeli që garanton vlerë të shtuar për qytetaret, duke kontribuar në mirëqeverisjen kombëtare.

Planifikimi strategjik në administrimin e kapitalit njerëzor është hapi i parë që siguron vazhdueshmërinë dhe përmirësimin e funksionit të audituesit. Në këtë fazë duhen identifikuar qartë nevojat dhe boshllëqet në fuqinë punëtore të cilat mund të cenojnë punën dhe imazhin e audituesit si partner i pavarur dhe objektiv i institucioneve publike. Planifikimi strategjik duhet shtrihet në një periudhë 3-5 vjeçare dhe të identifikojë sfidat në garantimin e një fuqi pune të përshtatshme për volumin e punës, rekrutimin e talenteve të reja, edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve, si dhe mjetet financiare ose rritjes profesionale të nevojshme për motivimin e tyre.

Në aspektin e rekrutimit të talenteve, vlen të theksohet përpjekja që duhet bërë nga audituesit që profesioni në përgjithësi dhe institucioni i tyre, në veçanti, të ngjallë interes dhe tërheqë talentet më të mira që ka vendi. Kjo është një sfidë e madhe duke pasur parasysh ndryshimet demografike, konkurrencën në treg për talente dhe sfidat reputacionale që mund të ketë punësimi në një institucion publik. Për këtë arsye, audituesit duhet të fokusohen që për 3-5 vitet në vazhdim të ofrojnë paketa atraktive punësimi ku të kombinohen stimuj profesional, reputacional, dhe financiar të cilat bëjnë të mundur thithjen e kapaciteteve njerëzore të përkushtuara dhe të afta. Drejtuesit e institucioneve audituese dhe organizatat profesionale në fushën e auditimit duhet të fokusohen që puna si auditues të shihet nga gjenerata e re si interesante dhe ata të besojnë vërtetë që kanë një rol parësor dhe të prekshëm në përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve publike dhe jetën e qytetarëve.

Gjithashtu institucionet audituese duhet të sigurojnë edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të tyre. Ndryshimet gjithnjë e më të shpeshta në ambientin rregullator, kompleksiteti i aktiviteteve dhe veprimtarive të subjekteve nën auditim, roli gjithnjë e më i madh i teknologjisë së informacionit janë disa nga sfidat me të cilat përballen audituesit në përmbushje të detyrave të tyre.

Me qëllim sjelljen e vlerës së shtuar si partner strategjik për institucionet të cilat auditojnë, kapacitetet profesionale të audituesve duhet të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Nëse audituesit nuk arrijnë të sigurojnë që njohuritë e tyre të jenë në hap me kohën, ata jo vetëm që nuk do të mund të sjellin vlerë të shtuar, por edhe rrezikojnë të perceptohen nga grupet e interesit si element pengues në mirëqeverisje.

Për të bërë të mundur që audituesit të kenë aftësi dhe njohuritë të përditësuara konform praktikave më të mira të profesionit, institucionet përkatëse duhet të fokusohen në krijimin e marrëdhënieve për shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave me institucione homologe ndërkombëtare, aksesin e punonjësve në literature dhe studimet më bashkëkohore, trajnime periodike për të gjithë audituesit mbi zhvillimet kryesore në këtë profesion të përshtatura për institucionet përkatëse ku ato shërbejnë, si dhe nxitjen e edukimit të punonjësve jashtë institucionit. Në lidhje me këtë të fundit, institucionet e auditimit duhet të krijojnë lehtësira, brenda mundësive financiare dhe operacionale, që shtojnë punonjësit e tyre të ndjekin me kohë të plotë ose të pjesshme programe specializimi ose studime master në fusha të vlerësuara si me vlerë për profesionin e tyre. Në shumë vende të botës, institucione të ngjashme mirëpresin ndjekjen e programeve MBA nga punonjësit e tyre. Në shume raste ato mbulojnë një pjesë ose të gjithë kostot e këtyre studimeve, me kusht që në përfundim të tyre punonjësi të kthehet në punë tek institucioni. Ndërsa zbatimi i strategjisë së edukimit të vazhdueshëm të punonjësve mund të variojë nga institucioni në institucion, ai duhet të mbetet gjithnjë në fokus të drejtuesve të këtyre institucioneve.

Siç shihet, zbatimi i një strategjie efikase të administrimit të burimeve njerëzore është i një rëndësie parësore që audituesit të shihen nga grupet e interesit si partner strategjikë në mirëqeverisjen e institucioneve publike. Zbatimi me efikasitet i strategjisë përbën një sfidë duke pasur në konsideratë kufizimet në burimet financiare dhe kapacitetet me të cilat përballen audituesit e sektorit publik. Për këtë arsye është e rëndësishme që kjo fushë të jetë në krye të listës së drejtuesve të institucioneve dhe ligjvënësve, të cilët janë përgjegjës për garantimin e burimeve të nevojshme financiare dhe të kapaciteteve në funksion të rritjes së vlerës së shtuar për qytetarët dhe taksapaguesit.

Garantimi pavarësisë dhe objektivitetit të auditit në kryerjen e funksionit të tij.

Pavarësia dhe objektiviteti janë shtyllat mbi të cilat mbështetet besimi i grupeve të interesit për veprimtarinë e audituesve. Prandaj është e domosdoshme që audituesit të punojnë ngushtë me ligjvënësit, institucionet kushtetuese dhe institucionet shtetërore me qëllim garantimin në çdo kohë të pavarësisë në realitet dhe dukje të audituesve duke mundësuar, auditime të cilësisë së lartë dhe që i shërbejnë interesave të qytetarëve. Dyshimet mbi mungesën e objektivitetit do të cenonin rendë objektivat e auditimit, do të zhvlerësonin gjetjet dhe rekomandimet e audituesit dhe do të zbehnin rolin e tij në mirëqeverisjen e institucioneve shtetërore. Për këto arsye audituesit duhet të jenë jashtëzakonisht të vendosur dhe të zbatojnë procedurat për të garantuar që ata, në nivel institucional dhe personal, të mos kenë konflikte interesi me subjektet të cilat auditojnë dhe të kryejnë detyrat e tyre me objektivitet.

Audituesi ose anëtarë të veçantë të skuadrës së auditimit mund të përballen me konflikt interesi dhe mungesë pavarësie në kryerjen e funksioneve të tyre. Me qëllim vlerësimin e këtyre rasteve, audituesi duhet të ushtroj gjykim profesional, duke marrë në konsideratë edhe perceptimin që do të kishin grupet e interesit mbi objektivitetin e punës e audituesit po të njiheshin me rastin në fjalë. Me qëllim garantimin e pavarësisë dhe objektivitetit, audituesit duhet të ndërtojnë dhe

zbatojnë procedura dhe kontrole që mundësojnë identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e konfliktit të interesit.

Parandalimi i konfliktit të interesit fillon në momentin e punësimit të audituesve dhe është një proces që vazhdon në mënyrë të pandërprerë. Institucionet audituese duhet të sigurohen që të kenë krijuar dhe zbatojnë politika të cilat minimizojnë marrëdhëniet që mund të krijojnë konflikt interesi për punonjësit e tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tij. Një vlerësim i pajtueshmërisë së me këto politika duhet të kryhet në momentin e punësimit të një audituesi. Gjithashtu në mënyrë periodike me frekuence jo me të gjatë se një herë në vit, institucioni auditues duhet të rivlerësojë përputhshmërinë me politikat e parandalimit të konfliktit të interesit nga ana e të gjithë audituesve. Drejtimi duhet të jetë drejtpërsëdrejti i angazhuar për të garantuar me përpikmëri zbatimin e politikës së lartpërmendur.

Në momentin e fillimit të punës për auditimin e një subjekti, audituesi duhet të marrë masa të arsyeshme për të identifikuar çështje të konfliktit të interesit që përfshinë pjesëtar të skuadrës së auditimit. Çështja duhet të identifikohet qartë dhe të mblidhen të gjitha informacionet e nevojshme që do të mundësonin një vlerësim të saj nga audituesi. Me qëllim identifikimin e konfliktit të interesit dhe marrëdhënieve që mund të krijojnë konflikt interesi, është e rëndësishme pasja e një procesi efikas për identifikimin e konflikteve të cilat përbejnë rrezik në përmbushjen e objektivave të auditimit. Këto procese duhet të përfshinë mbledhjen e informacionit nga pjesëtari i skuadrës së auditimit, nga brenda institucionit auditues dhe palë të treta. Identifikimi i hershëm i rasteve të mundshme të konfliktit të interesit do të mundësonte adresimin në kohë të tij dhe minimizimin e ndikimit negativ që mund të ketë në përmbushjen me sukses të objektivave të auditimit.

Nëse identifikohen raste të konfliktit të interesit, audituesi duhet të vlerësoj rrezikun që krijon ky konflikt dhe të përcaktojë nëse dhe si duhet adresuar ai. Në kryerjen e vlerësimit audituesi duhet të konsideroj si faktorët sasior dhe ato cilësor, si dhe masat që mund të merren në administrimin e rrezikut që krijohet. Duke patur në

konsideratë natyrën e rëndësishme që vlerësime të tilla mund të kenë në reputacionin dhe objektivat e audituesit, është i domosdoshëm krijimi i një strukture të specializuar brenda institucionit, e cila të jetë përgjegjëse për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lindin nga konflikti i interesit. Nëse struktura përgjegjëse vlerëson që rreziku mund të adresohet pa larguar pjesëtarin ose skuadrën në konflikt interesi nga kryeja e auditimit, ajo duhet të sigurohet që të mirëarsyetohej vlerësimi dhe të mirëdetajohen masat që duhen ndërmarrë për adresimin e rrezikut. Këto masa mund të përfshinë rishikimin e procedurave të auditimit me qëllim garantimin e objektivitetit, angazhimin e palëve të treta në rishikimin e punës së bërë nga skuadra e auditimit, si dhe rritjen e mbikëqyrjes së procesit të auditimit nga drejtuesit e lartë të audituesit. Nëse struktura përgjegjëse vlerëson që rreziku është i papranueshëm, ajo duhet të sigurohet që pjesëtari i skuadrës ose e gjithë skuadra e auditimit që është në konflikt interesi të zëvendësohet në kryerjen e auditimit të institucionit shtetëror.

Bashkëpunim në nivel strategjik më grupet e interesit

Mirëqeverisja kombëtare kërkon domosdoshmërisht bashkëpunimin e ngushtë të aktorëve kushtetues dhe grupeve të interesit. Mund të theksojmë si shembull sfidat fiskale të vendit, të cilat kërkojnë identifikimin dhe zbatimin e strategjive efikase në kushtet e nevojave në rritje dhe burimeve financiare të kufizuara. Bashkëpunimi mund të përkufizohet gjerësisht si çdo aktivitet i përbashkët që ka për qëllim të prodhojë më shumë vlerë për qytetarët se sa do të mund të prodhohej nëse aktorët vepronjë të vetëm. Institucionet shtetërore, ligjvënësit dhe auditimi mund të koordinojnë përpjekjet e tyre në funksion të mirëqeverisjes duke u fokusuar në përcaktimin dhe artikullimin e objektivave të qeverisjes dhe administrimit të fondeve publike; të bien dakord, të pranojnë dhe të respektojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilit aktor në përmbushje të objektivave, të zhvillojnë mekanizma dhe procedura që lehtësojnë punën e secilit prej aktorëve si dhe të zbatojnë sisteme të vlerësimit të performancës së secilit aktor në funksion të mirëqeverisjes publike.

Ndërsa audituesi i shtetit nuk mund të ketë nevojë të marrë aprovimin e ligjvënësit, qeverisë dhe drejtuesve të institucioneve publike për kryerjen e auditimit, mungesa e bashkëpunimit, koordinimit dhe vendosjes së objektivave do e ulte ndjeshëm efektivitetin e auditimit në funksion të mirëqeverisjes. Audituesi, me qëllim përmbushjen me efektivitet të objektivave të tij, duhet balancojë me efikasitet aspektin bashkëpunues dhe atë sfidues të auditimit kundrejt drejtimit. Vendosja e balancës ndryshon nga rasti në rast, por e rëndësishme është të punohet në drejtim të vendosjes së tyre. Mungesa e besimit dhe bashkëpunimit, do e bënte të pamundur përmbushjen e detyrave nga palët e angazhuara në mirëqeverisjen kombëtare. Audituesi do ta kishte shumë të vështirë kryerjen e një punë cilësore, nëse nuk ka bashkëpunimin e drejtimit të institucioneve shtetërore. Pavarësisht gjetjeve të auditimit, institucionet përgjegjëse për qeverisjen mund ti refuzojnë ato dhe mund të mos angazhohen aktivisht në zbatimin e rekomandimeve. Nga ana tjetër ligjvënësit do e kishin të pamundur të vlerësonin dhe mbikëqyrnin veprimtarinë e qeverisë dhe institucioneve shtetërore. Në fund, të humbur nga kjo marrëdhënie e cunguar midis palëve do të ishin qytetarët.

Koordinimi i punës së mbikëqyrësve, drejtuesit të institucioneve publike dhe audituesit është vërtetuar të jetë pozitive në administrimin e rreziqeve, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, dhe nxitjen e përmirësimeve në veprimtarinë e institucioneve publike. Kjo siç e kemi detajuar më lart duhet kryer duke pasur në vëmendje mosçenimin e pavarësisë dhe objektivitetit të auditimit. Edhe pse mekanizmat e koordinimit ndryshojnë në kompleksitetin dhe objektivat e tyre në varësi të natyrës së auditimit, faktorëve jashtë kontrollit të audituesit dhe natyrës së auditimit, është e rëndësishme që në koordinimin e punës me aktorët e tjerë, audituesi të fokusohet në aspektet e mëposhtme:

- Përcaktimin dhe artikullimin e objektivave të qeverisjes dhe administrimit të fondeve publike:

Identifikimi i objektivave të qeverisjes bazohet në parimin, që për çdo veprimtari ose aktivitet të institucioneve publike nevojitet ekzistenca e një qëllimi të mirëpërcaktuar dhe mirëartikulluar. Janë objektivat ato që mundësojnë që qeverisja të lëviz në drejtimin e duhur, në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Ekzistenca e objektivave të qarta po ashtu mundëson që audituesit të sjellin vlerë të shtuar, duke kontribuar në përmbushjen me efikasitet të tyre.

- Pranimin dhe respektimin e roleve dhe përgjegjësitë e secilit aktor në përmbushje të objektivave:

Për të siguruar përmbushjen e objektivave për mirëqeverisje kombëtare kërkohet që aktorët të përcaktojnë dhe të angazhohen në respektimin e roleve dhe përgjegjësi të drejtimit, mbikëqyrësve dhe kontrollorëve. Ky është një angazhim gjithëpërfshirës për të cilin audituesit duhet të fokusojnë energjitë e tyre. Veçanërisht mosrespektimi i roleve dhe pritshmëritë e pabazuara mbi përgjegjësitë e audituesve nga mbikëqyrësit ose drejtimi i institucioneve kanë treguar që ndikojnë negativisht në realizimin e objektivit të auditimit për të rritur efikasitetin dhe mirëqeverisjen e institucionale.

- Zhvillimin e mekanizmave dhe procedura që lehtësojnë punën e secilit prej aktorëve:

Planifikimi i veprimtarisë dhe aktiviteteve, ndërtimi i strategjive të qarta dhe realiste, si dhe ndërtimi dhe zbatimi me rigorozitet i proceseve dhe kontrolleve ndihmojnë institucionet të përqendrojnë energjitë dhe resurset në përmbushjen me efikasitet të objektivave afatgjatë. Gjithashtu, kjo mundëson që audituesit me punën e tyre të sjellin një vlerë të shtuar në funksion të arritjes së objektivave të institucioneve publike. Nga ana e tyre, audituesit duhet të fokusohen në hartimin dhe zbatimin e një plani auditimi që garanton objektivitet dhe vlerësime të sakta mbi veprimtarinë e institucionit që auditohet.

- Zbatimin e sistemeve të vlerësimit të performancës së secilit aktor në mirëqeverisjen publike:

Identifikimi paraprak dhe dakortësia mbi treguesit ku bazohet matja e performancës së institucioneve është e një rëndësie parësorë në nxitjen e institucioneve që të përqendrojnë energjitë dhe resurset e tyre në përmbushjen me efikasitet të objektivave afatgjate. Kjo është e vërtetë edhe për performancën e audituesve në funksion të objektivave të tyre. Vlen të përmendet rëndësia që ka mbajtja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave të sakta nga institucionet në mundësimin e vendimmarrjes strategjike nga drejtimi, rritjen e përgjegjshmërisë nga strukturat zbatuese, vlerësimin e veprimtarisë së institucioneve nga audituesit dhe mbikëqyrjen efektive nga ligjvënësit dhe qeveria. Mosekzistenca e treguesve të qartë si dhe mungesa e të dhënave të sakta që përdoren për matjen e performancës, e bënë të vështirë vlerësimin e kontributit të së secilit aktor në mirëqeverisjen publike.

Përmbledhje

Mirëqeverisja e institucioneve publike kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim strategjik të aktorëve kryesor. Audituesit duhet të zbatojnë një përjasje strategjike me qëllim sigurimin e vlerës së shtuar për qytetarët dhe taksapaguesit. Për këtë, ata duhet të fokusohen në tre shtylla kryesore, të cilat janë:

- administrimi i burimeve njerëzore,
- garantimi i pavarësisë dhe objektivitetit të auditimit në kryerjen e funksionit të tij,
- bashkëpunimi strategjik me grupet e interesit.

Një përjasje e tillë do të mundësonte dhënien e një kontributi efektiv në mirëqeverisjen kombëtare në kushtet e realiteti gjithnjë e më kompleks e sfidues për institucionet publike.

Referenca

ERENCE, SARAH. "Independence Is in the Eye of the Beholder." *Journal of Accountancy* 1 June 2013.

ALMER, ELIZABETH, and ANN OLAZABAL. "Independence and Public Perception: Why We Need to Care." *Journal of Accountancy* 1 Apr. 2001.

"Transforming Federal Recruiting and Hiring Efforts." *United States Government Accountability Office* (2008).

"Sustained Attention to Strategic Human Capital Management Needed." *United States Government Accountability Office* (2009).

"Practices That Can Help Enhance and Sustain Collaboration among Federal Agencies." *United States Government Accountability Office* (2005).

"Key Considerations for Implementing Interagency Collaborative Mechanisms." *United States Government Accountability Office* (2012).

"The Broken Triangle? Improving the Relationship between Internal Audit, Management, and the Audit Committee." *Deloitte* (2010).

"Guidance on Risk Management, Internal Control and Related Financial and Business Reporting." *Financial Reporting Council* (2014).

"ENHANCING THE DIALOGUE BETWEEN BANK AUDITORS AND AUDIT COMMITTEES." *ICAEW Financial Services Faculty* (2012). Print.

"The Role of Internal Audit in Strengthening Corporate Governance." *Abu Dhabi Center for Corporate Governance* (2010).

Përdorimi i Etikës si mjet për të përfituar Llogaridhënien

Jacek Jezierski

*Këshilltar i vecantë (special) për
Bashkëpunimin Ndërkombëtar
pranë, Kryetarit të Zyrës Supreme të
Auditimit të Polonisë*

ISSAI 30

- ISSAI 30 është Kodi i Etikës nga INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).
- 16 vjet që nga miratimi i ISSAI-it 30.
- Është koha që kodi të përditësohet.
- Sfidat e reja gjatë krizës globale.



Dy shtyllat kyçe të punës të një audituesi

- Profesionalizmi
- Etika – A mundemi ne që të auditojmë të tjerët ndërkohë që jemi vetë joetik?



S A I (Institucioni Suprem i Auditimit)

- Nuk duhet të mbyllë sytë përballë një veprimi dashakeq ose një sjelljeje negative.
- Audituesit duhet të shihen në sensin e besimit, sigurisë dhe besueshmërisë.
- Audituesit duhet të sillen në bazë të një kodi të qartë vlerash dhe principesh.
- Morali të jetë në krye.



Çfarë është Dilema Etike?

- **E drejta kundër të gabuarës** – një mundësi është kundra ligjit – tundimi moral.
 - A reagojmë kundër ligjit apo kundër vlerave/normave të brëndëshme?
- **E drejta kundër të drejtës** – dy veprime janë të mundshme, por nuk mund ti bëjmë të dyja njëkohësisht; këto dy vlera janë në konflikt me njëra- tjetrën dhe ne mund të zgjedhim vetëm njërën prej tyre . Kjo është dilema etike.
 - E vërteta kundër besnikërisë?
 - Interesi personal kundrejt interesit të komunitetit/grupit/shoqërisë?
 - Synimet afatshkurtra kundrejt synimeve afatgjata?



Pse njerëzit sillen në një mënyrë joetike?

- “Genet Egoiste”
- Mungesa e qartë dhe e rrënjosur e standarteve të etikës.
- Miratimi i heshtur i sjelljeve joetike.
- Mosdashja e zbulimit të problemeve.
- Indiferenca kundrejt detyrave me performancë të dobët dhe të pavend.
- Mbrojtja kundrejt ndëshkimit të merituar.



Mekanizmat psikologjike të sjelljeve joetike (1)

Arsyetimi

Referuar vlerave në mënyrë që sjellja të jetë më pak e dhimbshme, shëmbull:

- E bëj për fëmijët e mi, jo për vete!
- Nuk ka rrugë tjetër për ta bërë!
- Nuk më paguajnë mjaftueshëm për punën që bëj!
- Është një rast i vecantë!
- Nuk është puna ime!



Mekanizmat psikologjike të sjelljeve joetike (2)

Justifikimi, Shfajsimi

Referuar sjelljes të personave të tjerë në raste të njëjta pa i vendosur në mëdyshje ato, shëmbull:

- Çdokush e bën!
- Nuk dua të jem i ndryshëm!
- E bën përgjegjësi im!
- Nuk mundesh ta thyesh sistemin!



Etika profesionale

Duhet të mësojmë profesionet tona në të njëjtën mënyrë si mësojmë normat morale për profesionet tona.

Etika profesionale duhet të mësohet dhe përmirsohet përmes praktikës.



Objektivat e etikës

Etikë nuk do të thotë ti bësh njerëzit “etik”. Etika ndihmon njerëzit për të marrë vendime më të mira.

- Marrja e vendimeve që janë të drejta nga pikëpamja organizacionale/institucionale.
- Zgjidhja e konflikteve etike që vijnë si rezultat i performancës organizacionale.
- Sigurimi i një “sistemi navigimi” që të tregon se në cilën rrugë të shkosh.
- Përqasja e rregullave të përbashkëta për zgjidhjen e konflikteve.
- Nevojat për bashkërendimin organizacional dhe vlerave personale.



Detyrimet që lidhen me etikën zyrtare

- Përputhshmëria me Kushtetutën dhe ligjet e tjera.
- Mbrojtja e autoritetit të shtetit dhe lufta për të ndërtuar besimin e qytetarëve në shtet.
- Përdorimi i arsyeshëm dhe racional i burimeve publike.
- Objektiviteti.
- Performanca e detyrave në kohën e duhur.
- Fshehtësia.
- Transparenca dhe sinqeriteti.
- Profesionalizmi dhe zhvillimi profesional.
- Sjellja korrekte në punë dhe në jetën private.
- Kufizimet e punëve shtesë.
- Altruizmi.



Audituesit – një rast i vecantë

Si Auditues, jemi të detyruar të auditojmë dhe vlerësojmë të tjerët, për këtë arsye duhet të përmbushim dhe plotësojmë standartet më të larta të nevojshme.



Dilemat etike të Audituesve (1)

Të lidhura me kushtet ose mjedisin e jashtëm, shëmbull:

- Objektiviteti/Pavorsia.
lidhjet familjare/shoqërore.
Lidhjet e mëparshme profesionale.
Të krijosh miqësi.
Punë shtesë.
Pranimi i dhuratave/ftesave/favoreve.
- Neutraliteti politik.
- Keqardhja.
- Mbrojtja e sekretit/transparencës.
- Përdorimi i pozicionit për interesa personale.



Dilemat Etike të Audituesve (2)


Të lidhura me kushtet ose mjedisin e brëndshëm, shëmbull:

- Performancë e pakënaqshme e detyrave.
- Ndikimin në rrjedhën dhe rezultatet e auditimit.
- Përdorimi i asetëve ose pronës së punëdhënësit për qëllime personale.
- Abuzimi me dietat, kompensimet e udhëtimeve etj.
- Marrëdhënie jo korrekte me punonjësit e tjerë, përgjegjësit dhe/ose me vartësit.



A mundet që audituesit të ndodhen në një dilemë etike për përputhshmërinë e kërkesave?

- Bindje absolute?
- Po sikur kërkesat të jenë të paqarta dhe të paarsyeshme?
- Prioriteti ndaj interesit publik?



Vlerat etike të audituesve

- Integriteti.
- Pavorsia dhe Objektiviteti.
- Kompetecat dhe Përkujdesi.
- Sekreti profesional.
- Sjellja profesionale.



Pavarsia dhe Objektiviteti

Audituesit duhet:

- Të jenë gjithmonë të pavarur dhe objektiv gjatë përshkrimit të statuskuos, vlerësimeve dhe prezantimit të gjetjeve gjatë auditimit.
- Të vlerësonjë, të mbledhin dhe të transmetojë informacion në mënyrë objektive, gjatë procesit të auditimit.
- Të shmangin konfliktet e interesit real, të mundshmëm dhe të dukshëm.
- Të informojnë përgjegjësit për çdo përpjekje të bërë dhe që mund të ndikojë në pavarësinë e tyre.



Pavarsia dhe Objektiviteti

Audituesit duhet:

- Të jenë gjithmonë të pavarur dhe objektiv gjatë përshkrimit të statuskuos, vlerësimeve dhe prezantimit të gjetjeve gjatë auditimit.
- Të vlerësonjë, të mbledhin dhe të transmetojë informacion në mënyrë objektive, gjatë procesit të auditimit.
- Të shmangin konfliktet e interesit real, të mundshmëm dhe të dukshëm.
- Të informojnë përgjegjësit për çdo përpjekje të bërë dhe që mund të ndikojë në pavarësinë e tyre.



Kompetencat

- Gjykim profesional/skepticizëm(dyshim) profesional.
- Përkujdes.



Sekreti Profesional

Audituesi duhet:

- Të ruajnë sekretin dhe fshehtësinë e informacionit të përfituar gjatë kryerjes së detyrës.
- Të ruajnë fshehtësinë në mënyrë që të ruajë interesat e Shtetit, qytetarëve dhe subjekteve të tjera.



Sjellja Profesionale

- Nevoja për tu sjellë në mënyrën e duhur në punë dhe në jetën private.
- Audituesit duhet të sillen në mënyrën më të mirë, për të patur një opinion pozitiv në profesionin që ushtron dhe të përmbahet në kryerjen e ndonjë sjellje jo korrekte dhe jo etike.



23

Sjellja Profesionale

- Nevoja për tu sjellë në mënyrën e duhur në punë dhe në jetën private.
- Audituesit duhet të sillen në mënyrën më të mirë, për të patur një opinion pozitiv në profesionin që ushtron dhe të përmbahet në kryerjen e ndonjë sjellje jo korrekte dhe jo etike.



23

Etika dhe Korrupsioni

- Ndërgjegjësimi ndaj korrupsionit.
- Zyrtarë të përceptuar si të korruptuar.
- Roli i SAI-it është të formëzojë opinionin publik.



Zgjidhja e dilemave etike

- Zgjidhja ime.
- Zgjidhje alternative.
- Analizimi i zgjidhjeve të mundshme.
- Veprimet.



Zgjidhja ime

- Prej nga rezulton dilema? Me cilat vlera është e lidhur ajo?
- A e kam të gjithë informacionin që më nevojitet?
- Çfarë zgjidhjesh kam?
- Në çfarë niveli zgjidhja përputhet me vlerat?
 - A është mekanizmi racional/i justifikueshëm i përfshirë?
- A do ja vlente të pyesje dikë për këshilla?



Zgjidhje Alternative

Bazar për përzgjedhjen e zgjidhjeve:

- **Ligjet, standartet, normat** – çfarë duhet të bëj në përputhje me kërkesat?
- **Vlerat e Institucionit/profesionit** – çfarë është vërtetë e rëndësishme për institucionin/profesionin tim?
- **Rezultati/impakti** – përfitimi maksimal për grupin më të madh të mundshëm, me një dozë të vogël gjërash të këqia për një grup të vogël.
- **Lehtësira** – bëj sikur nuk e shikoj problemin.



Analizimi i zgjidhjeve të mundshme

- **Testi i përputhshmërisë:** “ Cila zgjidhje do të ishte në përputhje me rregullat/principet e organizatës time dhe dhe e pritur nga përgjegjësi im?”
- **Testi i mbajtjes së aksioneve:** “ Kush tjetër do të përfshihet? Çfarë mendojnë ata? A mundet që ata të kenë opinione të kundërta?”
- **Testi i pasojave:**
Pasojat afatshkurtra/afatgjata?
Për mua? Për të tjerët? Për subjektin tim? Për shtetin?
- **Testi Pasqyrë:** “ Mund të jetoj me vendimin që po marr?”
- **Testi reklamues:** “ A jam i gatshëm të lexoj rreth kësaj në gazetë? Po sikur familja ime/shoqëria/ komshijtë/ kolegët do të mësojnë rreth kësaj ngjarje”



Testi i rëndësishëm

A dëshiron që kjo zgjidhje të bëhet një praktikë e zakonshme?



Shëmbuj të dilemave



Shëmbull 1: *Të denoncosh apo mos të denoncosh?*

Kolegu juaj, me të cilin jeni duke kryer auditimin, nuk paraqitet në subjektin e auditimit dhe mbledh të gjitha gjetjet në bazë të shpjegimeve të auditimit. Çfarë bëni ju?

- a. Asgjë. Nuk është puna ime.
- b. Informoni përgjegjësin.
- c. Përpiqeni ta bindni kolegun që ta kryejë auditin në mënyrën e duhur dhe në qoftë se ai/ajo refuzon – informoni përgjegjësin.
- d. I tregoni të tjerëve rreth saj, duke shpresuar që ndokush tjetër mund të bëjë diçka.



Shëmbulli 2: *Të gënjesh apo mos të gënjesh?*

Kolegu nga skuadra juaj është një person i vështirë /nazeqar dhe një punonjës shumë i keq. Të është dashur që të përfundosh dhe korigjosh shumë herë punën e tij. Një tjetër koleg nga një skuadër tjetër, thotë që ai person dëshiron të shkojë tek skuadra e tij dhe ju pyet ju për një opinion rreth tij. Çfarë do ti thonit ju?

- a. Një gënjeshtër.
- b. Do ti tregonit gjysëm të vërtetën.
- c. Do ti tragonit të vërtetën dhe do ti drejtoheshit përgjegjësit që të merrte masa disiplinore ndaj tij ose ta hiqte atë nga skuadra.



Shëmbulli 3: *Fshehja e shkeljeve?*

Gjatë auditimit ju zbuloni një parregullshmëri të rëndë që ka qënë e pranishme për vite me rradhë dhe nuk është kapur nga auditimet e mëparshme. Përgjegjësi juaj thotë që do të ishte më mirë që mos ta ekspozonit këtë gjetje, sepse mund ta nxirrte institucionin tuaj në një pozicion të keq, për mos gjetjen e shkeljes më përpara. Çfarë do bënit ju?

- a. Bini dakort.
- b. Bini dakort por sygjeroni që të informohet i audituari për gjetjen ose parregullsinë në mënyrë jo zyrtare në mënyrë që të parandalohet përsëritja e parregullsisë.
- c. Bini dakort, por kërkoni që të ndëshkohen ata persona që kanë bërë auditimet e mëparshme.
- d. Nuk bini dakort.



Zgjidhjet më të mira – shmangiet e dilemave

- Hartimi i rregullave të qarta të administrimit – çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar.
- Analizimi i çështjeve në grupe dhe vendimet e përbashkëta.
- Mështetja e administrimit.
- Të mësosh nga gabimet.
- Nxjerrja e konkluzioneve për të ardhmen.



Rregulli i artë

Sjellja në një mënyrë të tillë siç do të doje që
të tjerët të silleshin me ty/

Shmangia e sjelljeve që nuk do të doje ti
provoje



Shembuj të eksperiencave të tjera. Administrimi i etikës (1)

- Rritja e rrezikut në etikën profesionale (shëmbull. Dakortësia mbi detyrimin për një sjellje në përputhje me kodin e etikës; trajnime bazuar në shëmbuj nga jeta e përditshme, vetëvlerësimi, testimi i rregullt online).
- Skuadra/persona të specializuara, përgjegjës për etikën (komitetit i etikës, koordinatorët e etikës, këshilltarët) të ngarkuara me detyrën e analizës së riskut dhe dhënien e këshillave.
- Rishikimet periodike të lidhura me etikën ose sistemeve mbështetëse të etikës, përfshirë analizimin e sjelljeve joetike dhe pormovimin e masave parandaluese.



36

Shembuj të eksperiencave të tjera. Administrimi i etikës

- Rrotacioni i personelit.
- Deklaratat mbi paanësinë dhe objektivitetin.
- Kontrolli i përputhshmërisë me principet (p.sh ato që lidhen me konfliktin e interesit, neutralitetin politik, sekretin profesional).
- Vlerësimet (vetëvlerësimi, rishikimi i përafërt).
- Duke lejuar të audituarin që të japë opinione rreth etikës së audituesit.
- Mundësia për tu informuar në mënyrë anonime rreth shkeljes së etikës.



37

Rrugët e mundshme për t'u përmirësuar

- Çfarë mund të bëj?
- Çfarë mund të bëjë institucioni im?

Shënim : Kjo kumtesë paraqitet ne Power Point, në pamundësi për të pasur materialin në word



Instrumentat per permiresimin e qeverisjes publike

Prof.Dr. Lindita Milo(Lati) dhe MBA, PhD cand. Pajtim Melani

Autoriteti i Konkurencës



Abstrakt

Koncepti i qeverisjes ka qenë subjekt studimi i vazhdueshëm nga shumë hulumtues të shkencave ekonomike, sociologjike e politike pasi, mirëqeverisja është një fenomen dinamik në funksion të shumë faktorëve që nuk lidhen thjeshtë edhe vetëm me kushtet dhe performancën ekonomike e sociale por ndikohet dhe ka ndikim shume të rëndësishëm edhe nga modeli politik. Kjo e fundit është e vërtetuar si nga pikëpamja teorike edhe empirike e teorisë së problemit midis agentit dhe principalit ashtu edhe nga teoria e përzgjedhjes publike.

Punimi synon që nëpërmjet analizës së faktorëve që ndikojnë në nivelin e qeverisjes së mire publike të adresoj, se cilat janë instrument që ndikojnë për përmirësimin e qeverisjes publike. Tregu nga njëra anë dhe përgjegjshmëria e transparenca përbëjnë instrumentet kryesor që synojnë të garantojnë që menaxherët e pronës publike performojnë në interes të publikut, pra të pronarit. Këto instrumente nuk mund të japin rezultatin e synuar pa një bashkëpunim të ngushtë ndërinstytucional midis institucioneve përgjegjëse për mirëfunksionimin e tregut dhe për auditimin e përdorimit të pronës publike.

Nëpërmjet analizës së rastit të bashkëpunimit ndërinstitucional midis Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është audituesi i përdorimit të pasurisë publike dhe Autoritetit të Konkurrencës, si mbikëqyrësi i lojës së lirë midis lojtarëve të tregut, duke identifikuar aspektet e bashkëpunimit dhe vlerën e shtuar për një treg sa më eficient në prokurimit publik të shërbimeve dhe produkteve.

Fjalët kyçe: qeverisja, qeverisja publike, standardet e qeverisjes së mirë, marrëveshjet e ndaluara në prokurimet publike

HYRJE

Qeverisja dhe mekanizmat e saj

Qeverisja është një koncept shumë kompleks dhe si e tillë nuk mund të shprehet nëpërmjet një përkufizimi. Filozofia e këtij punimi bazohet në trajtimin e qeverisjes dhe të teorive bazë që argumentojnë faktorët që kushtëzojnë aktorët e përfshirë në qeverisjen e një njësie ekonomike duke argumentuar përqsasjen me qeverisjen publike. Ekonomiksi modern institucional që e ka zanafillën e vetë pas Luftës së Dytë Botërore, përdor teoritë ekonomike neo-liberale të shkollës Austriake, teoria e së drejtës së pronës, teoria e agentit të principalit dhe teoria e kostos së transaksioneve, të cilat marrin kuptim të gërshetuara me teorinë e përzgjedhjes së publikut (Hayek, 1960)

Qeverisja i referohet gjerësisht mekanizmave me anë të të cilave entitetet kontrollohen, drejtohen dhe bëhen transparente. Sistemi i qeverisjes së entitetit konsiston në të drejtat dhe detyrat e drejtorëve, rregullat e marrjes së vendimeve dhe përgjegjësi. Siç ka treguar edhe Keasey (1997), përgjithësisht, nuk ka ndonjë marrëveshje në lidhje me përkufizimin e qeverisjes. Megjithatë, autorë të ndryshëm janë përpjekur të hedhin dritë mbi aspekte të ndryshme të kësaj qeverisjeje.

Studiues të ndryshëm (si Blair, 1995; Banka Botërore, 1996) e kanë përkufizuar qeverisjen e korporatave si monitorimi dhe kontrolli kryesisht nga ana e pronarëve mbi menaxhimin dhe performancën e njësisë ekonomike. Kjo ka të bëjë me

vendosjen e rregullave për të ndarë vendimet dhe të drejtat e kontrollit midis palëve që janë të motivuar dhe disponojnë informacionin e nevojshëm për të përdorur burimet në mënyrën më eficientë të mundur. Nga kjo pikëpamje qeverisja e korporatës i referohet rrugëve për të siguruar që si veprimet, aktivet (asetet) dhe agjentët e korporatës synojnë arritjen e objektivave të korporatës të vendosura nga aksionarët.

Mekanismat e qeverisjes i adresohen problemit të agjencisë, që lidhet me karakteristikën e ndarjes së pronësisë nga kontrolli. Prandaj Boot dhe Macey (1999) argumentojnë që qeverisja e entitetit duhet të kërkojë të zvogëlojë kostot e kontratës duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të pronësisë së aksionarëve, e cila duhet të jetë e përcaktuar qartë, të aktivizojnë zbatimin e detyrueshëm të rregullave. Për më tepër sistemi i qeverisjes duhet të promovojë aktivitetet investuese dhe sipërmarrëse, të cilat duhet të kenë një ndikim pozitiv në performancë si rezultat i motivimit për të minimizuar kostot dhe një reagim më të shpejtë kundrejt ndryshimeve të kushteve të tregjeve.

Pavarësisht punës kërkimore në lidhje me teoritë alternative të mekanizmave të qeverisjes është gjerësisht e pranuar teorikisht dhe nga të dhënat empirike se, mekanizmat kryesorë të qeverisjes që detyrojnë administratorët të mos ndjekin interesin e tyre të ngushtë por interesin e pronarit janë konkurrenca në tregjet e produkteve, në tregjet e punës manaxheriale, mekanizmat e votës dhe të daljes nga biznesi. Përveç këtyre mekanizmave që i adresohen problemit të agjencisë, auditimi i pavarur dhe standardet e kontabilitetit janë thelbësore për të identifikuar marrëveshjet e mundshme të mashtrimit dhe shpërdorimet e ngjashme të aseteve të aksionarëve nga menaxherët e korporatës. Informacioni që menaxherët duhet t'u sigurojnë aksionarëve duhet të rregullohet në mënyrë shumë strikte nëpërmjet standardeve të detyruara nga ligji dhe rregulloret sektoriale (Lati, 2010)

Qeverisja publike dhe instrumentat e mirëqeverisjes

Në vijim të paraqitjes së konceptit të qeverisjes dhe të mekanizmave që garantojnë që administratorët performojnë në interes të tyre personal dhe jo në përputhje me objektivat e pronarit, në këtë seksion do të trajtohet qeverisja publike jo vetëm si përcaktim por edhe karakteristikat e saj si dhe parimet e mirë-qeverisjes.

Qeverisja si koncept përcakton kush ka fuqinë, kush merr vendime, mënyrën se si dëgjohen aktorët e tjerë dhe se si kontrollohet përgjegjshmëria. Në këtë kontekst, sipas Bankës Botërore qeverisja është mënyra se si “ushtrohet autoriteti ekonomik, politik dhe administrativ për të menaxhuar vendin në të gjitha nivelet”. Ndërsa UNDP e përkufizon atë si tërësia e mekanizmave, proceseve dhe institucionet nëpërmjet të cilave grupet shprehin interesin e tyre, ushtrojnë të drejtat ligjore, realizojnë detyrimet e veta dhe pasqyrojnë diferencat e tyre.

Komisioni Evropian argumenton se cilësia e lartë, shërbimet publike dhe siguria juridike kanë qenë historikisht një parakusht i rëndësishëm për suksesin ekonomik të vendeve. Prandaj, organizatat ndërkombëtare si Banka Botërore, Komisioni Europian, UNDP etj, kanë investuar në studime dhe kanë identifikuar praktikat më të mira të qeverisjes publike duke draftuar edhe standardet dhe udhëzues për mirë-qeverisjen. Guida për qeverisje të mirë është një referencë e vlefshme për të punësuarit e sektorit me përgjegjësitë e drejtimit të korporatave për të siguruar që administrimi dhe obligimet e agjencisë janë identifikuar dhe adresuar.

Sektori publik luan një rol jetik për shoqërinë. Në shumicën e ekonomive, shpenzimet publike përbëjnë një pjesë të rëndësishme të produktit të përgjigjëm bruto, ndërsa entitetet e sektorit publik janë pjesëmarrës të rëndësishëm në tregun e kapitaleve, të mallrave –shërbimeve, si dhe në tregun e punës (IFAC, 2013). Sektori publik përcakton, nëpërmjet procesit politik, rezultatet që synohen të arrihen dhe formën e ndërhyrjes në treg. Format e ndërhyrjes në treg përfshijnë vendosjen e bazës ligjore dhe rregullatorë; ofertën e mallrave dhe shërbimeve; rishpërndarjen e të ardhurave nëpërmjet mekanizmave të tillë si tatimet e taksat.

Një qeverisje e mirë sjell menaxhim të mirë, performancë të mirë, një kujdesie të mirë për parat publike, përfshirje të publikut dhe si rrjedhojë një rezultat të përgjithshëm të mirë. Mekanizmat që garantojnë një qeverisje të mirë përbëhen nga tre element kyç:

- rregullat e brendshme dhe kufizimet, të tilla si: sistemet e auditimit të brendshëm dhe të kontabilitetit, pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe të bankës qendrore, rregullat për shërbimin civil dhe buxhetin;
- “zëri” e drejta e votës dhe partnership, si p.sh. këshilli i konsultimit me pjesëmarrjen e biznesit privat, përdorimi i instrumentit të feedback-ut për vlerësimin e performancës së shërbimit të publikut;
- konkurrenca, për shembull, sisteme konkurruese në ofrimin e shërbimit për publikun, pjesëmarrja e biznesit privat në ndërtimin e infrastrukturës, përdorimi i mekanizmave alternative si dhe realizimi i privatizimit për disa aktivitete të cilat performohen më mirë në kushtet e tregut.

Instrumentet e qeverisjes së mirë, bazuar në studimin e praktikave më të mira nga organizatat ndërkombëtare të cilat janë absorbuar dhe paraqitur nga vende të ndryshme, p.sh. Austria janë: strategjia, e cila përfshin planifikimin dhe strukturat, si p.sh planifikimin strategjik dhe operacional, struktura organizative dhe me rregulla dhe përgjegjësi të përcaktuara qartësisht; kultura, që i referohet lidërsipit dhe integritetit duke e demonstruar lidërsipin në sjellje, vendimmarrjen strategjike duke reflektuar parimet e lidërsipit, sjelljen dhe vlerat, angazhimet e punonjësve për të ofruar shërbimin; performance, e cila i referohet efektivitetit dhe eficiencës nëpërmjet monitorimit të performancës dhe evoluimit të sistemeve dhe proceseve, si në nivel individual ashtu dhe organizativ, si dhe raportimit për performancë, si dhe; përputhshmëria dhe llogaridhëni që përfshin realizimin e detyrave statutore dhe angazhimeve të tjera, nëpërmjet auditit, delegimit të autoritetit, pasjen e politikave,

procese dhe planit të menaxhimit të financës, riskut, burimet njerëzore si dhe etikës, mundësive të barabarta, sigurisë dhe mbajtjes së shënimeve për detyrimet.

Marrëveshjet në oferta

Të gjitha shkollat e administrimit publik kanë argumentuar se ulja në shpenzimet e qeverisjes dhe rritja e standartit të cilësisë të shërbimit publik mund të arrihet nëpërmjet funksionimit të tregut dhe konkurrencës. Në këtë këndvështrim në këtë seksion do të trajtohen aspekte të përdorimit të mekanizmave të qeverisjes dhe konkretisht të auditimit, pra të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të identifikuar rastet kur tregjet nuk funksionojnë mire për shkak të sjelljes oportuniste të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike, sjellje të cilat bien në kundërshtim dhe janë objekt trajtimi nga mbikëqyrsi i tregut, pra Autoriteti i Konkurrencës.

Koordinimi i sjelljes së ofertuesve në një procedurë të prokurimit publik konsiderohet si forma më e rëndë e shkeljes së ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Sipas të dhënave nga studime të ndryshme, kryesisht në vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim-OECD, demig që i shkaktohet buxhetit në rastet e marrëveshjeve në oferta është mesatarisht 20 % e fondit limit. Të dhënat tregojnë se në rastet kur tregu i produktit apo shërbimit të prokuruar ka konkurrencë nëpërmjet ofertave, mesatarja e ofertës fituese zbrit në 80 % të fondit limit. Në rastet kur mes firmave ka “*collusion*”, marrëveshje atëherë jemi në kushtet e mungesës së konkurrencës dhe për pasojë oferta fituese është afër fondit limit.

Mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit ka pasur raste të zbatimit në praktikë të materialeve të diskutimit të OECD-së mbi korrupsionin dhe marrëveshjet në oferta. Kështu në një rast të fundit nga identifikimi i konstatuar gjatë auditivit të KLSH rezultoi se në një prokurim me tre lote shfaqeshin të njëjtat firma konkurruese, kishte një ndarje të tregut mes tyre dhe ofertat fituese ishin mbi 99 % të fondit të prokuruar. Për këtë rast në zbatim të ligjit Komisioni i Konkurrencës hapi

procedurën e hetimit paraprak për të evidentuar shkallën e konkurrencës në tregun përkatës (Autoriteti i Konkurrencës, 2014).

Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të një informacioni të administruar në rrugë administrative, mbi mundësinë e një marrëveshje në oferta në procedurat e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit)”, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik ka administruar informacionin e kërkuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Rast praktik-marrëveshje e mundshme në prokurimet publike

Me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.333 , datë 21.10.2014 është vendosur “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ofertues në procedurën e prokurimit publik të realizuar në vitin 2013, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, vërehet se:

- Vlera e ofertave fituese në të tre lotet e procedurës së prokurimit është mbi 99% të fondit limit.

- Operatorë ofertues janë vetëm tre ndërmarrje.

- Fituese të loteve janë secila prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse, duke krijuar një skemë rotacioni për shoqërinë që do shpallej fituese.

Nga vlerësimi ligjor i rastit sipas nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” rezulton se ofertat në rotacion mes tre konkurrentëve dhe afërsia e vlerës së ofertës fituese në raport me fondin limit janë shenja të kufizimit të konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit në oferta në prokurimet publike.

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit, vendosi:

I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës;

II. Periudha e hetimit do të jetë Janar-Dhjetor 2013.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se dy muaj nga dalja e këtij vendimi.

Një rast tjetër të identifikuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, identifikimi i ofertave fituese mesatarisht në rreth 80 % të fondit limit dhe numri i madh i ofertuesve në procedura prokurimi të hapura dhe ndërkombëtare, nuk rezultuan evidenca të mjaftueshme për hapjen e procedurës së hetimit. **Rritja kapaciteteve të organizatave**

Autoriteti i Konkurrencës ka kryer trajnimin e oficerëve të kreditimit me metodologjinë e OECD për evidentimin e marrëveshjeve në oferta për llojet kryesore të marrëveshjeve si: rotacioni, oferta e mbuluar, nën kontraktimi tek konkurrenti direkt).

Qëllimi i trajnimit lidhet me promovimin e konkurrencës nëpërmjet maksimizimit të pjesëmarrjes së blerësve potencial nëpërmjet: (i) procedurave transparente, jo diskriminuese dhe që nuk e kufizojnë konkurrencën , (ii) përcaktimin sa më të gjerë të mundshëm të specifikimeve teknike, duke u fokusuar në performancën funksionale për të tërhequr numrin më të madh të mundshëm të ofertuesve, duke përfshirë dhe ofruesit e produkteve ose shërbimeve zëvendësuese, (iii) lejimin e firmave nga vende të tjera ose rajone të tjera të marrin pjesë në procedurat e prokurimit kur kjo është e përshtatshme; si dhe (iv) kur është e mundur lejimi i

pjesëmarrjes së firmave të vogla edhe në rast se ato nuk paraqesin dot ofertë për gjithë fondin limit.

Objektivi për tu arritur nëpërmjet rritjes së kapaciteteve administrative dhe përdorimit të instrumenteve modern për evidentimin e praktikave korruptive dhe marrëveshjeve të ndaluara, ka lidhet me rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike. Për të gjithë nëpunësit e ngarkuar me prokurimin e fondeve publike, është synuar përcaktimi i procedurave të prokurimit duke reduktuar mundësitë e komunikimit mes ofertuesve si para ashtu dje gjatë procesit.

Bashkëpunimi synon përforcimin e përpjekjeve të Agjencisë së Prokurimit dhe KLSH për të luftuar marrëveshjet në oferta nëpërmjet bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës duke inkurajuar prokurimin elektronik dhe duke mbajtur të dhënat për të analizuar sjelljen e ofertuesve.

Praktikat më të mira ndërkombëtare rekomandojnë se duhet të ketë kërkesë paraprake për çdo ofertues që të firmosë Certifikatën e Ofertës së pavarur ose një deklaratë ekuivalente se oferta e tij është individuale, jo në bashkëpunim me konkurrentët. Kjo rrit shkallën e ndërgjegjësimit të ofertuesve dhe i paralajmëron ato se përfshirja në marrëveshje ka sanksione të rënda që parashikon ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Në dokumentet e tenderit gjithashtu mund të përfshihet një paralajmërim për pjesëmarrësit në marrëveshje të ndaluara se do të ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore, pezullimin nga procedurat publike (tashmë e përfshirë në legjislacionin e prokurimeve) dhe dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar agjencisë/shtetit).

Shenjat e bashkëpunimit

Ndër shenjat kryesore të identifikuara në rastet e marrëveshjeve në oferta mund të përmenden për shembull:

- i njëjti ofertues është shpesh me vlerën më të vogël të ofertës,
- ka ndarje gjeografike të fituesve ndërmjet rajoneve,

- në mënyrë të vazhdueshme një ofertues dështon të fitojë një kontratë por vazhdon të ofrojë për procedura të tjera
- disa ofertues tërhiqen në mënyrë të papritur nga tenderi.

Metodologjia e OECD sqaron se ka raste kur dy ose me shumë firma paraqesin ofertë të përbashkët pavarësisht se një prej tyre i ka kapacitetet të ketë ofertë individuale. Shenjat e bashkëpunimit mund të verifikohen edhe pas shpalljes së fituesve, pasi për shembull fituesi i tenderit në mënyrë të përsëritur e nënkontraktton kontratën ose në rastet kur fituesi nuk pranon të lidhë kontratën dhe më vonë shfaqet si nënkontraktor.

Nga rastet e identifikuara rezulton se konkurrentët në mënyrë të rregullt janë të socializuar me njëri-tjetrin dhe zhvillojnë takime pak para afatit të tenderit p.sh qëndrime në të njëjtin hotel, në të njëjtin ambient, në aeroporte apo destinacione të njëjta, në të njëjtat restorante etj. Gjatë procedurave të hartimit të dokumenteve shpesh herë vihen re gabime identike në dokumentet e dërguara, kryesisht gabime ortografike ndërkohë që mund të vihet re se ofertat nga kompani të ndryshme përmbajnë të njëjtin shkrim ose formate të njëjta.

Ndërkohë që në dokumentet e dorëzuar në rastet e marrëveshjeve jo rrallë mund rezultojnë referenca te oferta e një konkurenti tjetër ose janë të njëjtat gabime ne llogaritje, oferta të ndryshme përmbajnë një numër domethënës për kostot e llogaritura, paketime postare të njëjta, përshtatje të ofertave në minutën e fundit nga më shumë se një kompani, oferta të përgjithshme dhe pa detaje-oferta mbushëse) si dhe çmime identike në oferta.

Qëllimi final është rritja e performances se investimeve publike, kursimi i shpenzimeve buxhetore; rritja e konkurrencës dhe eficiencës në treg nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të bashkëpunimit sipas ligjit dhe Memorandumit të Bashkëpunimit, ndjekjes së procedurave hetimore me gjetjet dhe konkluzionet përkatëse në fazën e dytë, si dhe konstatimi i dëmit dhe rikthimi i dëmit të

taksapaguesit nëpërmjet gjobës dhe arkëtimit në buxhet në konkludim të procedurave gjyqësore.

KONKLUZIONE

Tregu si një instrument rregullator për sektorin publik dhe nxitjen e bashkëpunimit midis institucioneve bazohet në teorinë se këto mekanizma promovojnë përgjegjësinë e institucioneve ndaj shoqërisë për përdorimin me më tepër eficiencë të fondeve publike.

Megjithatë, bashkëpunimi i institucioneve të pavarura që kanë përgjegjësinë për kushtet e funksionimit të tregjeve dhe për parandalimin e korrupsionit dhe të sjelljes oportunistike të administratorëve të pronës publike merr një rëndësi të veçantë në kushtet e kufizimit të rritjes ekonomike.

Përdorimi me efencë i burimeve financiare publike është qëllimi kryesor i ndërveprimit institucional mes KLSH dhe Autoritetit të Konkurrencës inter allias dhe zbatimi i metodologjive bashkëkohore për evidentimin e marrëveshjeve në oferta si praktika antikonkurruese përbën instrumentin për matjen e dëmit të shkaktuar buxhetit dhe kthimin e fitimeve të pamerituara në buxhetin e shtetit.

BIBLOGRAFIA

Albert Sánchez Graells, *“Competitive neutrality in public procurement and competition policy: an ongoing challenge analised in view of the proposed new directive”*

Blair, M. M. (1995) *Ownership and Control - Rethinking Corporate Governance for the Twenty-First Century*, Washington D.C., The Brooking Institution.

Boot, A. W and Macey, J. R. (1999) ‘Objectivity, Proximity and Adaptability in Corporate Governance’, University of Amsterdam Working Paper No.266, Amsterdam.

Gruening, G. (2001) Origin and theoretical basis of New Public Management International Public Management Journal 4 (2001) 1–25

Hayek, F. A. von. (1960). *The constitution of liberty*. Chicago: University of Chicago Press

IFAC dhe CIPFA (2013) *Good Governance* in the Public Sector, (Consultation Draft for an International Framework)

Kaufman, H. (1969). Administrative decentralization and political power. *Public Administration Review*, 29, 3–15.

Keasey, K., Thomson, S. and Wright, M. (1997) 'Introduction: The Corporate Governance Problem - Competing Diagnoses and Solutions' in Keasey, K., Thomson, S. and Wright, M. (eds) *Corporate Governance - Economic, Management, and Financial Issues*, Oxford, Oxford University Press

Lati, L. (2010) *The causes and consequences of corporate restructuring in Albania: Privatisation and managerial behaviour in Albania*, LAP Lambert Academic Publishing

World Bank (1994), *Governance: The World Bank's Experience*.

Autoriteti i Konkurrencës (2014), <http://caa.gov.al/decisions/read/id/528>

OECD,

<http://www.oecd.org/competition/cartels/fightingbidrigginginpublicprocurement.htm>

Ligji nr. 9121 "Per Mbrojtjen e Konkurrencës".

<http://www.commissioningportal.co.uk/procurement-intro/>

<http://www.economag.com/en/antitrust-law/antritrust-law-and-public-procurement>

Reduktimi i ekonomisë informale kërkon një sistem tatimor efektiv dhe përpjekje të përbashkëta të shumë aktorëve.

Nga : Prof.Asc.Dr.Hysen Cela, Kryetar, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar



(i) Pse është i nevojshëm një sistem tatimor efektiv?

Hartimi dhe zbatimi i një sistemi të duhur tatimor është i rëndësishëm për cdo vend, pasi përmes tij rregullohen marrëdhëniet, të drejtat dhe detyrimet reciproke që lindin midis organizatave të biznesit nga njëra anë dhe qeverisë nga ana tjetër. Nga pikëpamja etike këto marrëdhënie e kanë zanafillën tek parimi i dobishmërisë, sipas të cilit organizatat e biznesit kanë përgjegjësinë sociale t'i kthejnë shoqërisë disa nga përfitimet e tyre, për faktin e thjeshtë që këto përfitime janë rrjedhojë jo vetëm e përdorimit të resurseve materiale e njerëzore, por edhe i infrastrukturës që ofron shoqëria. Kthimi i përfitimeve për publikun realizohet përmes qeverisë, e cila ndërton instrumentet e nevojshme të administrimit dhe kontrollit, pikërisht nëpërmjet sistemit të tatimeve dhe taksave. Përmes këtyre mekanizmave garantohej edhe drejtësia shoqërore por edhe mbrohen të drejtat e individit, të cilat janë të drejta me karakter universal. Pra, duke respektuar parimet bazë etike dhe morale, shoqëria garanton stabilitetin, pa të cilin asnjë veprimtari biznesi, politike apo sociale nuk mund të zhvillohet.

Dihet që objektivi kryesor i një sistemi tatimor është mbledhja e tatimeve dhe taksave, të cilat shërbejnë si të ardhura për qeverinë dhe përdoren nga kjo e fundit

për të garantuar drejtësi sociale dhe mbrojtje të individit. Qeveria, si administruese dhe mbikëqyrëse e veprimtarisë së një vendi, ka detyrimin t'i kthejë paratë e taksapaguesve në shërbime dhe të mira publike për ta. Matësi që përdoret nga taksapaguesit dhe publiku i gjerë, për të vlerësuar drejtësinë e sistemit tatimor që zbatohet, në analizë të fundit është cilësia dhe dobia e shërbimeve publike. Në këtë kuptim, grumbullimi i të ardhurave nga taksat dhe tatimet, që realizohet përmes një sistemi tatimor efektiv, shihet i lidhur ngushtë me llogaridhënien publike dhe përgjegjshmërinë e administrimit.

Pra, që një sistem tatimor të jetë efektiv, ai duhet të arrijë objektivin e tij kryesor, që do të thotë, të kontribuojë direkt në rritjen dhe forcimin e besimit të publikut. Kjo nënkupton që nga njëra anë autoritetet tatimore (qeveria) mbledhin ato shuma që janë të duhura dhe të pagueshme, dhe nga ana tjetër, organizatat/entitetet e biznesit, por edhe individët të cilët kanë detyrimin të paguajnë, paguajnë ato shuma që kërkohen sipas legjislacionit dhe rregullave. Arritja e këtij objekti të rëndësishëm kërkon që të gjitha palët, si qeveria ashtu edhe taksapaguesit të bien dakord me shumatat dhe të kuptojnë e të përmbushin detyrimin për të paguar në kohë dhe në shumën e duhur. Natyrisht, qeveria në kuadër të mirëqeverisjes në interes të publikut, kërkohet që shumatat e mbledhura t'i përdorë në pajtim me buxhetet e aprovuara, të cilat nuk mund të hartohen pa marrë parasysh pritshmëritë e publikut.

(ii) Cili është detyrimi apo shuma që duhet të paguhet?

Në një paraqitje të thjeshtë, ajo çka duhet paguar përfaqëson shumën që llogaritet në pajtim me kërkesat e legjislacionit tatimor të zbatueshëm. Për entitetet e biznesit, në mënyrë direkte, kjo shumë përfshin tatimin mbi vlerën që i shtohet biznesit, tatimin mbi fitimin apo edhe tatime të tjera të lidhura, ndërsa për individët, ajo përfshin tatimet mbi të ardhurat nga paga dhe mbi të ardhura të tjera personale, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, etj. Ndonëse për shumicën e bizneseve të vogla dhe të mesme përcaktimi i drejtë i detyrimeve nuk është dhe aq i

vështirë, kjo çështje nuk është dhe aq e lehtë kur llogaritjet duhet të bëhen për pjesën tjetër të bizneseve, të cilat janë më komplekse si për nga natyra e mjedisit të brendshëm ashtu edhe e mjedisit të jashtëm të tyre. Përveç shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe operacioneve, kjo kategori entitetesh ka shumë të ngjarë të veprojë edhe në një mjedis ekonomik global, që si rregull i kalon kufijtë kombëtarë.

Në rrafshin kombëtar e atë ndërkombëtar aktualisht debatohet shumë lidhur me çështjet e tatimeve dhe taksave. Në mënyrë indirekte debati shtrihet në efektivitetin e sistemit, në drejtësinë që mbart planifikimi i taksave e tatimeve, si edhe në sjelljen e tatimpaguesve. Në rrafshin ndërkombëtar, në fokus të këtij debati janë entitetet e mëdha, kryesisht kompanitë shumëkombëshe ose ato që veprojnë në disa shtete, të cilat përmes një “planifikimi të përshtatshëm” të taksave e tatimeve, që mbi të gjitha është edhe i ligjshëm, e kanë të mundur të minimizojnë detyrimet tatimore. Ato mund të transferojnë fitimet e tyre të tatueshme nga njëri vend në tjetrin, në varësi të normave respektive të tatimeve që zbatohen në vende të ndryshme. Debati aktual mbi tatimet përfshin edhe këshilltarët tatimorë dhe profesionistët kontabël, për rolin që ata luajnë në çështje të tilla siç janë pajtueshmëria me legjislacionin tatimor, planifikimi efektiv i tatimeve, përcaktimi i duhur i detyrimeve, trajtimi i kërkesave që burojnë nga marrëveshjet, etj.

Pavarësisht se sjellja dhe etika e këtyre kompanive dhe e këshilltarëve të tyre janë faktorë qartësisht të rëndësishëm për të përcaktuar shumën që kërkohet dhe synohet të paguhet prej tyre në zbatim të kërkesave ligjore; përsëri, qeveritë nuk mund të qëndrojnë indiferente, pasi ato kanë një rol jo të vogël për të luajtur. Ato kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për hartimin/miratimin dhe zbatimin e ligjeve tatimore dhe për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi tatimet. I takon qeverive, të cilat para se të ndërmarrin iniciativat për ndryshime në ligje dhe rregulla, të vlerësojnë me kujdes dhe të mbajnë mirë parasysh edhe pasojat e vendimeve të tyre për këto ndryshime, me qëllim që ndryshimet t'i bëjnë në funksion të përmbushjes së objektivave të tyre të synuara. Për shembull, në rastet e rritjes së

normave tatimore, kompanitë e mëdha shumëkombëshe mund të lëvizin apo transferojnë një pjesë të aktivitetit të tyre nga një vend, që për këtë shkak bëhet jo atraktiv, në një vend tjetër ku normat tatimore janë apo bëhen më atraktive.

Nga sa analizohet më lartë, në një ekonomi të ndërlidhur dhe globale, vënia në zbatim e një sistemi tatimor efektiv nuk është një detyrë e lehtë për qeveritë, rregullatorët dhe po kështu edhe për agjencitë zbatuese. Vështirësia lidhet midis të tjerash edhe me aspektet e mëposhtme:

- Së pari, parimet mbi të cilat mbështeten kodet bazë tatimore dhe legjislacioni tatimor kombëtar në përgjithësi, janë shkruar e miratuar shumë herët në kohë dhe kanë mbetur pothuaj të pandryshuara për dekada të tëra. Këto kode janë hartuar shumë vite më parë, kur pjesa më e madhe e transaksioneve, veçanërisht e atyre në nivel ndërkombëtar ishin kryesisht në formën e shkëmbimeve fizike të mallrave. Fakti që parimet dhe kodet tatimore kanë mbetur të pandryshuara, i bën ato të mos jenë domosdoshmërisht të përshtatshme për mjedisin e sotëm të kompanive, që kanë shtrirje dhe sjellje globale, dhe ku pjesa më e konsiderueshme e vlerës që ato krijojnë rrjedh apo vjen nga aktivet jo-materiale (të patrupëzuara fizikisht).

- Së dyti kodet tatimore, por edhe legjislacioni tatimor kombëtar, ndonëse janë rishikuar e kanë prirjen të ndryshohen në vazhdimësi, zakonisht e kanë bërë këtë evoluim në mënyrë pjesore, përmes një modeli që ka prekur vetëm disa aspekte dhe ka lënë të pandryshuara mjaft aspekte të tjera, çka i ka bërë kodet dhe ligjet tatimore të paintegruara dhe të paharmonizuara me njëra tjetrën, tejet komplekse, e shpesh herë të shoqëruara edhe me shumë burokraci. Mjafton të shikojmë praktikën e vendit tonë ku çdo vit miratimit të buxhetit, i paraprihet me ndryshimet tatimore të pagëzuara nën termin “paketa e re fiskale”, e cila ndonëse përmbledh ndryshime në taksat dhe tatime në disa ligje tatimore, në të vërtetë bëhet paketë “e vjetër” brenda

harkut kohor të një viti. Këto ndryshime janë shumë të shpeshta dhe jo rrallë, ndodh që ato të bëhen edhe disa herë brenda një viti.

- Së treti në një ekonomi globale, çështjet që lidhen me politikën e taksave dhe të tatimeve, me gjithë pretendimet e qeverive për t'i konsideruar si çështje të brendshme të çdo vendi, nuk mund të kufizohen më në kufijtë kombëtarë, pasi edhe pse vendet përdorin legjislacione tatimore të përshtatura, të përafruara me një benchmark ndërkombëtar, përsëri ato nuk mund ti largohen zgjidhjeve lokale. Kjo, pasi qeveritë i përdorin sistemet e tyre tatimore si instrumente të potencialit të tyre konkurrues për rajonin e më gjerë, dhe në funksion të tërheqjes e mbajtjes së investimeve të huaja. Nga këto veprime jo rrallë ndodh që një stimulim tatimor i një vendi të jetë në të njëjtën kohë një lloj shmangie nga pagesa e taksave e tatimeve në një vend tjetër.

Këtyre vështirësive ju shtohen edhe dallimet që ekzistojnë midis ritmeve të zhvillimeve në raportimin financiar për qëllime të përgjithshme dhe raportimit për qëllime thjesht tatimore/fiskale. I pari ka avancuar dukshëm, duke tentuar drejt përdorimit të një gjuhe të përbashkët globale të komunikimit, ndërsa i dyti duket se ka mbetur prapa. Shtrirja e përdorimit të SNRF-ve, apo edhe rishkrimi global i tyre, përmes bashkëpunimit midis IASB-së dhe FASB-së, si edhe përdorimi apo adoptimi në shumë vende i SNRF-së për SME-të, janë tregues të drejtpërdrejtë të progresit që është bërë në drejtim të përmirësimit të besueshmërisë së raportimit financiar. Ndonëse këto zhvillime kanë tendencën të përdoren edhe nga sektori publik, përsëri progresi në këtë sektor paraqitet i vogël dhe i ngadaltë, pasi qeveritë në këtë drejtim vazhdojnë të jenë konservatore. Nisur pikërisht nga këto zhvillime, por edhe nga dallimet që ekzistojnë në sistemet e tatimeve dhe të taksave që përdorin vende të ndryshme, vendet e G-20, sot po diskutojnë për domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ngushtë midis tyre, dhe për këtë arsye kanë vendosur në agjendë çështjet që

lidhen me ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese për sistemet e tatimeve dhe taksave. Një koordinim i tillë i veprimeve synon përshtatimin e ritmeve të ndryshimeve dhe përshtatjen e sistemeve të taksave e tatimeve me qëllim që ato t'ju përgjigjen kërkesave të mjedisit të sotëm ekonomik global.

Pjesë e rëndësishme e këtij bashkëpunimi janë iniciativat që promovojnë transparencën e informacionit midis autoriteteve tatimore. Gjithashtu, e një rëndësie të veçantë është edhe puna për përmirësimin e sistemeve tatimore, që ka bërë Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), me kërkesë të G-20, e cila ka evidentuar si nevojën për të ardhura të sigurta për qeverinë ashtu edhe nevojën për të pasur qëndrueshmëri fiskale.

(iii) Përmirësimi i sistemit tatimor dhe lufta kundër informalitetit

Zhvillimet në përmirësimin e sistemeve tatimore nuk mund të lënë jashtë as vendin tonë, i cili sot është më shumë se kurrë i orientuar dhe i vendosur për t'u integruar në familjen natyrore të vendeve të zhvilluara Evropiane.

Ndonëse gjatë dy dekadave të fundit janë shënuar përmirësime të dukshme në sistemin e taksave dhe të tatimeve, përsëri duhet thënë se ato kanë qënë të pamjaftueshme për të reduktuar nivelin e informalitetit në ekonomi. Ende shkalla e ekonomisë informale vazhdon të mbetet aq e lartë, sa që çdo aksion përmirësues, do të duhet të nisët nga objektiva edhe më të thjeshta. Përmirësimi i sistemit duhet të shihet i pashkëputur nga lufta frontale që duhet të bëhet ndaj informalitetit. Ekonomia informale, e cila në fazën e parë të pas viteve 90-të, shërbeu si një instrument i zvogëlimit të presionit të papunësisë së lartë të trashëguar kryesisht nga sistemi i mëparshëm, sot pas gati çerek shekulli tranzicioni, nuk mund të vazhdojë të mbetet në këto nivele. Edhe pse për ekonominë informale dhe për formalizimin e saj, debatohet fort midis aktorëve të ndryshëm, siç janë autoritetet qeveritare,

organizatat e biznesit, autoritetet tatimore, dhe rregullatorë të tjerë, përfshirë këtu edhe profesionin kontabël (kontabilistët dhe audituesit), mendoj se ka ardhur koha për t'i thënë me forcë stop këtij fenomeni.

Ekzistenca dhe shkalla e shtrirjes së ekonomisë informale mund të konstatohet me një analizë farë të thjeshtë. Në vendin tonë ajo ekziston në disa forma, të cilat nisin që nga veprimtaritë e biznesit të paregjistruara, këto më shumë të përhapura në bizneset e vogla dhe me natyrë familjare; për të vijuar më tej tek informaliteti përmes angazhimit të punonjësve të paregjistruar në bizneset që janë të regjistruar, apo me mos-deklarimin e pagave reale për punonjësit e regjistruar, duke i paguar punonjësit e regjistruar për diferencën midis pagës reale dhe asaj të deklaruar jashtë kanaleve bankare, me para në dorë (që në fakt janë para informale që përdoren për të shmangur detyrimet tatimore dhe kontributet shoqërore) – dhe finalizohet me informalitetin që lidhet me raportimet financiare të paplota, nganjëherë edhe mashtruese që bëhen nga entitetet e regjistruara, të cilat shmangin pagesën e taksave e tatimeve, dhe në këtë mënyrë, mbulojnë shuma të konsiderueshme të të ardhurave të tyre. Vlerësohet se përqindja e ekonomisë informale është në shifra shumë të larta.

Formalizimi i ekonomisë ka qenë një çështje e shumë diskutuar nga qeveritë gjatë këtyre viteve, shpesh e shoqëruar me masa si me natyrë edukuese, ashtu edhe shtrënguese e penalizuese. Mjafton të përmenden fushatat sensibilizuese dhe penalizuese për vendosjen dhe përdorimin e kasave regjistruese, kontrollet e bizneseve në terren, inspektimet në punë, etj. Megjithatë, rezultatet kanë qenë të vogla. Qeveria aktuale e ka vendosur në agjendën e saj si prioritet luftën kundër ekonomisë informale, me target të qartë formalizimin. Formalizimi i bizneseve shikohet si një mundësi jo thjesht dhe vetëm për të shtuar të ardhurat në buxhetin e shtetit (të ardhurat nga taksat dhe tatimet), por mbi të gjitha, si një instrument për të rritur konkurrencën, zvogëluar korrupsionin dhe në këtë mënyrë, si një mjet për të

krijuar mundësi dhe trajtim të njëjtë për bizneset, çka do të përkthehej në më shumë investime vendase dhe të huaja.

Pavarësisht dëshirës, apo aksioneve të ndërmarra, jam i mendimit se kjo është dhe mbetet një çështje shumë komplekse dhe si e tillë kërkon përpjekje të përbashkëta dhe përfshirje të shumë aktorëve, siç janë autoritetet qeveritare dhe rregullatore, autoritetet tatimore, organizatat e biznesit dhe natyrisht, një rol shumë të rëndësishëm për të luajtur ka edhe profesioni kontabël (kontabilistët, fiskalistët, audituesit, etj). Deri tani çështja e luftës ndaj informalitetit rezulton të jetë parë si një çështje që në pamje të parë duket se i takon vetëm qeverisë, respektivisht autoriteteteve të taksave e tatimeve dhe rregullatorëve, të cilët kanë autoritetin të vendosin rregullat dhe në këtë mënyrë sistemin dhe jo si një çështje me një lidhje të drejtpërdrejtë me profesionin kontabël.

(iv) Profesionistët kontabël dhe roli i tyre në lutën kundër informalitetit

Kontabilistët me ekspertizën teknike dhe profesionale që zotërojnë dhe me edukimin e trajnimin e tyre etik, luajnë një rol kyç në ndihmën që ata ju japin klientëve dhe punëdhënësve të tyre tatimpagues, lidhur me detyrimet tatimore. Një raport i vitit 2007 i Forumit për Administratën Tatimore (në përbërje të të cilit marrin pjesë komisionerë tatimorë nga 45 vende të botës) pranon rolin vendimtar që luajnë këta ndërmjetësues (profesionistët kontabël, fiskalistët, etj.) në dhënien e sigurisë dhe të garancisë se sistemet tatimore funksionojnë si duhet. Pra, që sistemet të funksionojnë si duhet, kërkohet përfshirja në rolin e duhur e profesionistëve kontabël, të këtyre “ndërmjetësuesve” dhe lehtësuesve, që qëndrojnë në mes të bizneseve nga njëra anë dhe shtetit e publikut nga ana tjetër.

Duke ndihmuar dhe këshilluar punëdhënësit dhe klientët e tyre që të kuptojnë detyrimet tatimore, profesionistët kontabël kontribuojnë në funksionimin e sistemeve tatimore të shëndosha dhe efektive dhe luajnë një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë dhe stabilitetin ekonomik të vendit.

Profesionistët kontabël sigurojnë që punëdhënësit dhe klientët e tyre kuptojnë opsionet e mundshme tatimore që parashikohen në kodet tatimore dhe i ndihmojnë ata që të jenë konkurrenës në pagesën e detyrimeve tatimore;

Profesionistët kontabël kanë detyrimin të respektojnë parimet strikte etike (siç është p.sh., Kodi Ndërkombëtar i Etikës ose kodet e organizatave kombëtare profesionale dhe rregullatore), dhe të udhëhiqen nga parimet themelore të integritetit, objektivitetit dhe sjelljes profesionale;

Detyrimi për të zbatuar kërkesat e standardeve cilësore profesionale dhe etike, bën që profesionistët kontabël të tregojnë kujdes maksimal, dhe të shmangin përfshirjen e tyre në përgatitjen e informacioneve financiare mashtruese apo që çorientojnë përdoruesit. Duke përmbushur këto role, anëtarët e profesionit kontribuojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi në luftën ndaj evazionit fiskal. Megjithatë, që të luftohet evazoni, nuk mjafton vetëm kontributi i profesionistëve të fushës kontabël. Është e nevojshme që roli i tyre të harmonizohet me përdorimin e instrumenteve të stimulimit (incentivave) tatimor, në mënyrë që ajo çka pritët të merret për qeveritë të jetë e përshtatshme (të kënaqë/bindë edhe palën paguese).

Megjithatë, midis të dy këtyre ekstremeve ka edhe një çështje tjetër e cila është më komplekse, pasi lidhet me "shmangien nga taksat e tatimet, që vjen nga një proces planifikimi i tatimeve i përshtatshëm", i cili për më tepër nuk mund të konsiderohet jo ligjor. Kjo çështje paraqet një dilemë të vështirë për tatimpaguesit dhe po kështu, edhe për profesionin kontabël.

Çështjet e përmirësimit të sistemeve janë të lidhura ngushtë me përpjekjet që duhen bërë për formalizimin e ekonomisë. Është më se e qartë se ky objektiv nuk do të mund të arrihet pa rikonsideruar rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë profesionistët kontabël, veçanërisht në funksionimin efektiv të sistemeve tatimore. Këta ndërmjetësues, që e përdorin ekspertizën e tyre për edukimin e punëdhënësve dhe klientëve të tyre, japin këshilla për bizneset, por dhe më shumë se kaq. Megjithatë, në fund të fundit përgjegjësia direkte e zbatimit të sistemeve ju mbetet

tatimpaguesve, të cilët duhet të ndërmarrin vendimet dhe veprimet përfundimtare në lidhje me aktivitetet dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore e rregullatore.

Por, përdorimi eficient i kontributit të profesionistëve kontabël kërkon që ai të harmonizohet sa më mirë me rolin e aktorëve të tjerë. Natyrisht, rëndësi të dorës së parë ka roli që duhet të luajnë shtetet (qeveritë), të cilat janë përgjegjëse për nxjerrjen dhe zbatimin e ligjeve tatimore të qarta, të drejta, dhe të përshtatshme për ekonominë tonë dhe më gjerë. Qeveria duhet të konsiderojë me kujdes pasojat e vendimeve të saj për ligjet tatimore dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme kurdoherë që rezultatet nuk janë ato të dëshiruara.

Përfundime/Rekomandime:

Lufta ndaj ekonomisë informale kërkon përdorimin e instrumenteve të përshtatshme dhe përpjekje të përbashkëta jo vetëm të qeverise e rregullatorëve, por edhe të kontabilistëve dhe audituesve, të cilët luajnë rolin e ndërmjetësuesit midis bizneseve dhe autoriteteve të shtetit e publikut në përgjithësi.

Formalizimi i ekonomisë lidhet ngushtë me vendosjen dhe zbatimin e sistemeve tatimore efektive stabile, që kanë në themel drejtësinë në përcaktimin të detyrimeve, trajtimin e padiferencuar të bizneseve dhe mbajnë mirë parasysh si kërkesat lokale ashtu edhe ato ndërkombëtare.

Në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe rritjes së besimit publik, sektori publik sot kërkohet të adoptojë për raportimin financiar parimin e të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Ky adoptim ka pasojë të drejtpërdrejtë në mirëqeverisje. Është e rëndësishme të vlerësohet se qeveritë, taksapaguesit dhe profesionistët kontabël, kanë secili përgjegjësi të rëndësishme dhe role vendimtare për të luajtur në vendosjen dhe funksionimin efektiv të sistemeve tatimore.

Përfshirja e profesionit kontabël në luftën kundër informalitetit dhe në formalizimin e ekonomisë, i shërben drejtpërdrejt përmirësimit të raportimit financiar. Në këtë aspekt ky rol konsiderohet i rëndësishëm për shumë përdorues, pasi rrit besimin e tyre dhe kontribuon në qëndrueshmërinë ekonomike e sociale. Përveç kësaj, nevoja

për një raportim financiar të besueshëm do të rritë konkurrencën dhe për pasojë do të zhvillojë më tej edhe tregun për kontabilistë dhe auditues të kualifikuar. Ajo gjithashtu, do të shërbejë si një instrument për të zvogëluar informalitetin edhe midis vetë profesionistëve.

Sektori publik mendojmë se duhet të ndjekë zhvillimet në sektorin privat dhe të adoptojë për raportimin financiar të drejtat dhe detyrimet e konstatuara, pasi kjo i shërben mirëqeverisjes, transparencës e përgjegjshmërisë dhe rrit besimin publik.

Ndryshimet e shpeshta në ligjet dhe rregullat tatimore – çorientojnë biznesin dhe nuk i kontribuojnë formalizimit.

Literatura e përdorur

- <http://www.oecd.org/tax/>
- Brooks I Dunn - Business & Professional Ethics for Directors, Executives and Accountants 6th edition
- Taxes in Europe- 2013 , published by EuraAuditInternational 21st edition
- <http://www.oecd.org/tax/transparency/abouttheglobalforum.htm>
- Manuali i Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cllësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurive të tjera dhe Shërbimeve të Lidhura – botim i IEKAs -2012
- Legjislacioni tatimor ne republiken e Shqipërisë (www.tatime.gov.al)
- Rittenberg, Johnstone, Gramling - Auditing – A business Risk Approach 7th edition
- IFAC articles on the development of pulic sector accounting
- Russell Guthrie, Executive Director, Professional Relations, and CFO, IFAC “Governments Can't Expect Others to Do What Only They Can—They Must Step Up and Cooperate on Taxation”

KLSH në një pozicion të vështirë midis pavarësisë dhe të qënit agjent kyc në sigurimin e mirëqeverisjes.

Nga: Prof.Asc. Dr. Manjola NAÇO, mnaco@ksh.org.al

Dr.Blerta ZILJA, blerta.zilja@yahoo.com

Dr. Greta ANGJELI, gretaa@hotmail.com



Prof.Asc.Dr. Manjola Naço



Dr.Blerta Zilja



Dr. Greta Angjeli

Abstrakt

Institucionet e auditimit konsiderohen si faktor i rëndësishëm për të siguruar përgjegjshmëri në një linjë horizontale dhe ndër këto institucione, roli i Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) është i një rëndësie të veçantë. Institucionet Supreme të Auditimit ngrihen në bazë të një kornize kushtetuese dhe ligjore dhe ndihmojnë në mbikëqyrjen e përgjegjshmërisë së institucioneve publike, zvogëlimin e rrezikut të keqadministrimit apo shpërdorimit të fondeve dhe vlerësimin e performancës së programeve të ndryshme.

Edhe pse kërkohet dhe mendohet se këto institucione janë "të pavarura" nga të gjitha llojet e presionit politik, gjatë kryerjes së funksioneve dhe përgjegjësisë të tyre, atyre ju duhet të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me aktorë të ndryshëm politikë. Si pasojë e këtij bashkëveprimi, sidomos në vlerësimin e performancës së programeve qeveritare dhe agjencive të saj, SAI-et kanë rritur jo vetëm prezencën, por edhe rolin e tyre në arenën politike të vendit, duke nxjerrë në skenë sfidat e SAI-ve në sferën politike.

Në këto kushte shfaqet dilema kryesore në funksionimin e SAI-ve: të jenë plotësisht të pavarur nga aktorët politikë apo të përshtaten me një mënyrë të re bashkëveprimi me aktorët e tjerë, në mënyrë që rekomandimet e lëna mbi aspekte të rëndësishme të aktivitetit qeverisës të vihen në zbatim, gjë që do të siguronte realizimin e funksionit për të cilin këto institucione janë krijuar dhe vijojnë të funksionojnë. Çdo institucion duhet të gjejë të mesmen e artë për të balancuar qëndrimin midis asaj që quhet e rëndësishme për të siguruar pavarësinë e tyre dhe rëndësisë për të bërë aktorët e ndryshëm të realizojnë apo zbatojnë rekomandimet e lëna. Në këtë këndvështrim, nuk duhet të ketë një shkëputje të plotë të tyre nën kornizën e pavarësisë, por as edhe të vihen nën pushtetin e politikës për të qenë protagonist kryesor duke bashkëvepruar me aktorë politik, pasi kjo do të rrezikonte plotësisht pavarësinë. Kjo dilemë, e cila nuk është një simptomë me të cilën ballafaqohet vetëm KLSH, por është një sindromë e trajtuar gjerësisht në punimet e dekadës së fundit në këtë fushë, do të jetë në fokusin e punimit tonë. Pasi prezantohet se çfarë rezulton në literaturën e vendeve të tjera mbi këtë çështje, do të japim qëndrimin tonë lidhur me sfidat e KLSH-së për të arritur të mbajë në ekuilibër nga një anë pavarësinë e saj dhe nga ana tjetër statusin e mbrojtësit kryesor të fondeve publike dhe zbulimit të skemave të keqadministrimit.

Fjalët kyçe: Institucione Supreme Auditimi, Pavarësi, Relevancë, Llogaridhënie

Hyrje

Kur flasim për një qeverisje të mirë dhe demokratike menjëherë mendja të shkon tek llogaridhënia dhe përgjegjshmëria. Fillimisht, llogaridhënia si koncept lidhej me kontabilitetin dhe ishte mjet në duar të qeverive për t'i mbajtur subjektet nën kontroll, por me përsosjen dhe rritjen e strukturave të shtetit, kuptimi i llogaridhënies ka evoluar. Llogaridhënia tregon nivelin e përgjegjshmërisë së shtetarëve ndaj qytetarëve të tyre (Bovens, 2005). Lëvizja përtej konceptit të ngushtë të kontabilitetit, i ka dhënë një përjasje të re konceptit të llogaridhënies duke e

lidhur me një qeverisje të mirë për të cilën asnjëherë nuk mund të themi që është e mjaftueshme (Posner, 2011). Llogaridhënia është një element i rëndësishëm "i mirëqeverisjes" pasi ajo u lejon qytetarëve të kërkojnë të drejtat e tyre në një kohë që nëpërmjet mekanizmave të saj luan rol efektiv për të parandaluar korrupsionin, duke e lejuar shtetin të eci në rrugën e zhvillimit. Njihet nga të gjithë marrëdhënia midis llogaridhënies dhe parandalimit të korrupsionit. Nëse konstatohet mungesa e mekanizmave të llogaridhënies, situata mund të rezultojë fatale në përdorimin e fondeve publike apo në suksesin e objektivave lidhur me përdorimin e këtyre fondeve, pa lënë mënjanë performancën e dobët të ofruesit të shërbimit dhe përfituesve të tij.

Sa më shumë rritet fokusi drejt llogaridhënies, aq më shumë ekziston rreziku i ngatërimit të këtij koncepti nga përdorimi i pakujdesshëm. Për qëllime të punimit tonë tentuam të gjenim një koncept sa më të thjeshtë dhe për këtë ju referuam Schedler (1999), i cili e përkufizon llogaridhënien si *"procesin e mbajtjes nën rregulla, mbikëqyrje dhe kontroll të atyre personave të cilëve ju janë besuar përgjegjësi publike në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre"*. Nga shfletimi i literaturës kemi gjetur që vetë koncepti ka dy nivele. I pari lidhet me një kërkesë për llogari, *"... që të sigurojë një shpjegim të asaj që është bërë apo ka mbetur pa bërë për shkak të çfarë apo kujt"* dhe së dyti është procesi i përgjegjësisë, që shprehet si *"...vendosja e sanksioneve dhe përcaktimi i masave përmirësuese nëse diçka nuk ka shkuar mirë"* (Jones & Stewart, 2009).

Kur flasim për mekanizma llogaridhënës të institucionalizuar nënkuptojmë vendosjen e marrëdhënieve në mes të dy ose më shumë aktorëve, ku një prej tyre është i detyruar të shpjegojë dhe justifikojë veprimet e tij dhe më pas të përballet me pasojat. Identifikimi i kësaj marrëdhënie përqëndrohet në dy dimensione. Dimensioi i parë e konsideron si një marrëdhënie midis qytetarëve dhe qeverisë dhe njihet si përgjegjshmëri demokratike apo vertikale, pasi i lejon qytetarët të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët nga ana tjetër zgjedhin qeveritë. Në këtë rast, qytetarët

vlërësojnë performancën e përfaqësuesve të tyre dhe bëjnë gjykimin përmes votës. Dimensioni i dytë përqendrohet në marrëdhënien midis përfaqësuesve të zgjedhur dhe agjencive publike që kryejnë programe dhe politika të ndryshme, e cila njihet si përgjegjësi administrative apo horizontale. Përfaqësuesit e zgjedhur hartojnë një numër rregullash dhe procedurash për të drejtuar aktivitetet e agjencive të ndryshme, ata gjithashtu krijojnë një numër institucionesh që monitorojnë nëse veprimtaria e agjencive është në përputhje me këto rregulla apo procedura. Diamond (2008) shpjegon se llogaridhënia horizontale vesh disa agjenci të shtetit me përgjegjësinë për të monitoruar sjelljen e homologëve të tyre. Këto institucione njihen si "institucione të llogaridhënies" dhe ndër më të rëndësishmit e tyre janë Institucionet Supreme të Auditimit, që kanë përgjegjësinë e kontrollit dhe evidentimit të rasteve të shpërdorimit, abuzimit dhe mashtrimit nga agjencitë ekzekutive. Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) ngrihen në bazë të një kornize kushtetuese dhe ligjore dha kanë si mision kryesor të ndihmojnë legjislaturat për të zbatuar përgjegjshmërinë, për të siguruar që nuk ka rrezik të rënies së besimit dhe për të matur rezultatet e programeve të ndryshme. Roli kryesor i SAI-ve është të monitorojnë, duke shqyrtuar aktivitetet e agjencive të ndryshme qeveritare dhe të raportoje për konstatimet e këtij monitorimi.

Nga perspektiva e sigurimit të përgjegjshmërisë demokratike, Institucionet Supreme të Auditimit luajnë dy funksione kryesore. Së pari, analizojnë nëse agjencitë veprojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat ekzistuese, duke shqyrtuar besueshmërinë e të dhënave financiare të raportuara nga ana e tyre dhe ky ka qenë në fakt funksioni kryesor i këtyre institucioneve (Banka Botërore, 2001), por në dekadat e fundit, kërkesa në rritje për institucione në shërbim të publikut ka sjellë rritje të "presionit për llogaridhënie". Përgjithësisht, vendet e zhvilluara i janë përgjigjur kërkesave për llogaridhënie duke artikuluar reforma institucionale të fokusuar në performancën dhe rezultatet e aktiviteteve apo programeve të qeverisë, duke përmbushur edhe funksionin e dytë, atë të përgjegjshmërisë. Ky punim ka për synim të analizojë

problematikën që sjell kjo përjasje e re e cila i bën SAI-et lojtar në politikëbërjen e vendit. Synuam të sillnim literaturën më të fundit që tregon se si kalimi në këtë funksion të ri i përball këto institucione me tensione të një dileme të fortë, asaj midis të qenit i pavarur me të kthyerit në një institucion të rëndësishëm me ndikim politikëbërës. Kjo kornizë teorike do të na shërbejë për diskutimin se në çfarë niveli është ky tension për vendin tonë. Nëse do të shikojmë në thellësi këtë dilemë, të qenit i rëndësishëm në llogaridhënie kërkon një studim të gjerë për të vendosur se cilët tregues janë të përshtatshëm për ta matur dhe më pas si do të lexoheshin ato, por në kontekstin e një punimi hyrës ju referuam matësve të thjeshtë, të cilët vërtetë mund të mos thonë shumë, por mund të shërbejnë si një hap i parë. Literatura e shfletuar të drejton në tregues që lidhen fillimisht me nivelin e pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna, të cilët do të përdoren edhe në analizën tonë.

Kuadri teorik i punimit

Në fund të viteve '60, demokracitë e zhvilluara, në përgjigje të gjendjes së përkeqësuar financiare vendosën *“shpërndarjen e burimeve të kufizuara financiare në mënyrë të arsyeshme dhe efikase për çdo politikë”* (Azuma, 2003). Ky ndryshim në aspektin e ofrimit të shërbimeve efikase i ka të detyruar SAI-et të përgjigjen në përputhje me rrethanat e reja, duke ndryshuar fokusin e tyre. Kështu, në një kohë që tradicionalisht aktivitetet e auditimit janë kryer për të siguruar përdorimin e përgjegjshëm të parasë publike, tashmë, ato përqëndrohen më shumë në vlerësimin e performancës së agjencive qeveritare, duke u shndërruar në qendrën e llogaridhënies publike. Në ditët e sotme, auditimi i performancës është bërë forma më e përhapur e auditimit dhe praktikohet gjerësisht nga shumica e demokracive të zhvilluara perëndimore. Për më tepër, vendet në zhvillim janë gjithashtu duke u investuar për të praktikuar këtë lloj auditimi.

Pavarësia institucionale ndër vite ka qenë sfida e Institucioneve Supreme të Auditimit. Deklarata e Limës përcakton se *“Institucionet Supreme të Auditimit mund të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm nëse ato janë të*

pavarura dhe subjektet e audituar mbrohen nga ndikimet e jashtme” (INTOSAI, 1977). Rëndësia e të qenit të pavarur është theksuar më pas në Deklaratën e Meksikës (INTOSAI, 2007). Në të nënvizohet se SAI duhet të mbetet i lirë nga ndikimi i fshehur i dy shtyllave të shtetit, legjislativit dhe ekzekutivit. Si qëllimi kryesor i SAI -ve është auditimi i aktiviteteve të organeve qeverisëse, i cili duhet të kryhet duke qëndruar jashtë ekzekutivit, që do të mbrojë veten nga ndikimi. Në këtë këndvështrim, pavarësia shikohet si pavarësi funksionale, organizative dhe financiare. Koncepti i pavarësisë funksionale përbëhet nga dy dimensione - SAI duhet të ketë aftësinë për të vendosur mbi aktivitetet e auditimit dhe metodologjitë dhe nga ana tjetër, të përcaktojë vetë nivelin e rëndësisë së paraqitur në raportet e saj. Nëse SAI-et nuk gëzojnë diskrecion në kryerjen e aktiviteteve të tyre të auditimit, ato do të varen nga organet e tjera të shtetit duke rrezikuar të kthehen në një mjet në dorë të politikës. Nga ana tjetër, nëse raportet dhe rekomandimet e tyre nuk konsiderojnë aspekte të rëndësishme, ato nuk do të mundësojnë përgjegjshmërinë e agjencive qeveritare duke rezultuar në nivele llogaridhënie jo të përshtatshme dhe duke dështuar në misionin e tyre parësor. Pavarësia organizative nënkupton që drejtuesit e SAI-ve duhet të kenë pavarësi të mjaftueshme në mënyrën e organizimit të brendshëm dhe ata nuk duhet të plotësojnë kushtet e vendosura nga qeveria. Ato duhet të kenë procedurat e veta të emërimit dhe largimit të Kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të çdo niveli, qartësisht të përcaktuara në kushtetutë dhe kornizën ligjore. Nga ana tjetër, SAI-et duhet të ketë pavarësi të mjaftueshme financiare në përcaktimin e nivelit të buxhetit dhe përdorimin e tyre në mënyrë të përshtatshme. Sfidat e viteve të fundit është rritja e rolit të institucioneve supreme në rritjen e përgjegjshmërisë së agjencive/programeve qeveritare, nëpërmjet matjes së performancës së aktivitetit të tyre. Power (2005) vë në dukje se si SAI-et tani janë duke lëvizur nga roli i tyre tradicional i auditimit të pajtueshmërisë drejt analizës së performancës së organizatave qeveritare me anë të auditimit të performancës. Këto institucione tani janë duke luajtur një rol në përcaktimin e politikave dhe *“bëhen*

instrumente të qarta të reformës të menaxhimit publik, me një rol kyç në monitorimin e aktiviteteve të shtetit dhe gjithnjë e më shumë në funksionet e mbikëqyrjes dhe rregullatore të shtetit” (Power, 2005). Ky fokus i ri përqendrimi në matjen e performancës së programeve qeveritare/agjencive, vijëzon një profil të rëndësishëm të këtyre institucioneve në arenën e politikëbërjes. Të qenit i rëndësishëm kërkon bashkëveprim me aktorët politik të cilët duhet të jenë bashkëpunues në realizimin e rekomandimeve të lëna.

Sa më shumë tentohet për të qenë të rëndësishëm, aq më shumë SAI-et rrezikojnë ta gjejnë veten të prekur nga kërkesat dhe presionet e politikës duke rrezikuar në këtë mënyrë pavarësinë e tyre, një nga shtyllat më të rëndësishme të mirëfunksionimit të SAI-ve, kjo si pasojë e rritjes së bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me aktorët e ndryshëm politikë. Për pasojë, SAI-et përballen me dilemën - ndërsa pavarësia i kërkon të jenë plotësisht të pavarur nga aktorët politik, ridimensionimi i funksioneve të tyre kërkon mbajtjen e lidhjeve të ngushta me aktorët politikë në mënyrë që këto rekomandime të vihen në zbatim.

Shfletimi i literaturës na tregon se të qenit i rëndësishëm për një SAI nënkupton prezencën e dy faktorëve themelor: (i) nivelit të presionit politik që ushtrohet ndaj SAI-t nga organet shtetërore, të cilave ai i kërkon ruajtjen e përgjegjshmërisë dhe (ii) shkallës së profesionalizmit të vetë SAI-t. Të dy këta faktorë përcaktojnë nivelin e dilemës pavarësi-rëndësi dhe literatura tregon se prania e tyre ndryshon në kohë. Kështu, kur aktorët politikë nuk e njohin rëndësinë institucionale të SAI-it, i cili shfaqet me profil të ulët, presioni politik është mjaft i dobët. Nga ana tjetër, ka raste në historinë e zhvillimit të këtyre institucioneve kur aktorët politikë jo vetëm njohin rëndësinë e institucionit, por përpiqen ta bëjnë institucionin përgjegjës për të plotësuar kërkesat e tyre. Kjo është shkalla e një presioni shumë të lartë politik. Elementi i dytë ka të bëjë më stafet e SAI-ve. Dihet se kur një SAI nuk ka burime njerëzore të mjaftueshme si dhe njerëzit që punojnë nuk kanë ekspertizë të kënaqshme për të kryer misionin e tyre, atëherë themi se për shkak të mungesës së

profesionalizmit, institucioni ka profil të ulët. Vetëm në fillime të funksionimit justifikohet një profil i ulët për shkak të shkallës së profesionalizmit. Me kalimin e kohës, duke u fokusuar në rekrutimin e personelit kompetent, trajnimin e tyre në mënyrën e duhur dhe zhvillimin e një bazë të njohurive institucionale, drejtuesi mund të luaj një rol të rëndësishëm në shkallën e formimit të kapaciteteve njerëzore duke sjellë dhe rritjen e profilit të vetë institucionit. Vetë profesionalizimi kërkon themelimin e një modeli të përbashkët institucional dhe për t'u sjellë si profesionist, një individ apo një institucion duhet të ndjekë normat e një investigimi shkencor, pra duhet të ndjekë një metodë racionale për punën që kryejnë, duhet të kenë kompetencën teknike, duhet të përqendrohen në specializime dhe në kryerjen e detyrave dhe nuk duhet të tregojnë asnjë shenjë paragjykimi (Parsons, 1939).

Bazuar në punimin e March dhe Olsen (1989) mbi pavarësinë institucionale, shkalla e lartë e profesionalizimit jo vetëm që përfshin kapacitetin e njerëzve që punojnë në këtë institucion për të kryer punën e tyre në mënyrë efektive, por në lojë hyjnë edhe procese përmes të cilëve vlerësohen rregullat dhe kryerja e detyrave. Njerëzit brenda institucionit zhvillojnë ndjenjën e tyre të detyrës, e cila krijon një "model bazë të mobilizimit politik", rregullat institucionale të lojës dhe madje mënyrën se si qytetarët mendojnë rreth botës politike" (Pierson, 2004). Vetëm të formuar dhe rritur në këto lloj kushtesh, institucionet mund të bëhen aq të fuqishëm në strukturimin e politikës që zhvillojnë, duke rritur aftësinë për të "rezistuar edhe në kushtet e përpjekjeve sistematike ... për të çrrënjësuar format paraprake dhe për të ndërtuar një ADN të re" (Gazibo, 2006).

Havens (1990) theksonte se suksesi i institucioneve të llogaridhënies varet në masë të madhe nga stafi i tij, i cili duhet të gëzojë norma institucionale të përbashkëta në lidhje me çështje të tilla si standardet e provave, procedurat operative dhe etikën e sjelljes. Kështu, trajnimi dhe funksioni i zhvillimit të stafit duhet të fiksojë në etikën e stafit saktësinë, pavarësinë dhe objektivitetin, në kuptim të asaj që këto koncepte të

thotë në mjedisin e vetë institucionit dhe në njohjen praktike se si t'i aplikojnë ato në punën e përditshme të zyrës (Havens,1990).

Ndërthurja e faktorëve të mësipërm shpie në identifikimin e tre niveleve kryesore të tensionit midis aktorëve pjesëmarrës. Në Nivelin 1, bashkëveprimi i dy faktorëve, presionit politik dhe shkallës së profesionalizimit përcakton shkallën e tensionit autonomi-rëndësi. Tensioni është i ulët kur niveli i presionit politik dhe shkalla e profesionalizimit janë të dyja të ulta. Në këtë situatë, institucioni bën përpjekje për të zhvilluar autonominë dhe roli i tij nuk është i njohur në arenën politike. Gjithashtu, Kuvendi nuk e ndien të nevojshme krijimin e presionit mbi institucionin dhe në këtë mënyrë, rrallë ndërveprohet me SAI-n. Në këtë pozicion, institucioni zhvillon identitetin e tij duke u përqendruar në auditime tradicionale dhe aktorët politikë nuk bëjnë asnjë përpjekje për t'u përfshirë brenda fushës së politikave, duke bërë që SAI të mos përballet në mënyrë shqetësuese me dilemën pavarësi-të qenit të rëndësishëm.

Rritja e kapaciteteve njerëzore rrit profesionalizimin e institucionit dhe kjo shoqërohet me rritje të profilit të tyre në arenën e politikëbërjes duke rezultuar në rritje të ndikimit politik. Nga ana tjetër mund të themi se nuk është e mundur për një SAI të bëhet një aktor i rëndësishëm pa çënuar statusin e të pavarurit.

Niveli 2 shfaqet kur institucioni rritet profesionalisht dhe kalon në auditime të performacës, pra fillon kryerja e vlerësimit të programeve si përgjigje e kërkesave për përgjegjshmëri të lartë në administrimin e financave publike, duke bërë që pozicionet të komplikohen dhe tensioni mes aktorëve të rritet. Në Nivelin 3, kur institucioni është rritur profesionalisht duke u konsoliduar në kapacitete njerëzore, ai ka arritur të mundësojë **pavarësi në përmbajtje** (të vendosë cilët programe do të vlerësojë) dhe **procedurë** (të vendosë metodat e auditimit që duhet të përdori). Në këto momente shfaqet niveli më i lartë i tensionit në dilemën pavarësi dhe të qenit një aktor kyç në mirëqeverisje, si dhe një zë i fuqishëm në politikëbërje. Huntington (1973) ka theksuar se është jashtëzakonisht e vështirë për çdo institucion që të jetë plotësisht i

pavarur edhe të ketë një profil të lartë rëndësie. Për këtë arsye dilema e shoqëron institucionin në rrugëtimin e tij duke u shfaqur në nivele të ndryshme tensioni.

Analiza e problemit në rastin e KLSH

Për një kërkim cilësor, studiuesi përpiqet "*...të shikojë botën të lidhur me njerëzit, situatën, ngjarjet dhe proceset që zhvillohen në të*" dhe është i interesuar për të kapur perspektivat e aktorëve mbi "*... përvojat dhe veprimet ku ata janë përfshirë, duke zhvilluar të kuptuarin nën një kontekst të veçantë*", në të cilin pjesëmarrësit vepronë duke parë influencën që ka ky kontekst në veprimet e tyre si dhe të kuptuarit e "*procesit përmes të cilit ngjarjet dhe veprimet zhvillohen*" (Maxwell, 2013). Ky është orientimi që kemi pasur parasysh në punimin tonë për të vlerësuar presionin e jashtëm me të cilin ballafaqohen SAI-et me kalimin e kohës dhe llojin e presionit, rolin e SAI-t në procesin e politikëbërjes dhe nëse e luan këtë rol në mënyrë formale apo informale si dhe perceptimin e njerëzve në lidhje me pavarësinë institucionale dhe aftësinë e SAI-ve në mbrojtjen e kësaj pavarësie.

Historia e KLSH në tranzicionin e vështirë për të konsoliduar demokracinë institucionale në vend ka përjetuar eksperiencën të ndryshme të konsolidimit të pavarësisë dhe autonomisë nga Kuvendi dhe aktorëve të tjerë. Megjithatë, në dy vitet e fundit konstatohet një përplasje e fuqishme me Kuvendin, e cila na çoi në trajtimin e këtij punimi mbi dilemën pavarësi-rëndësi.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar vlerësimit të nivelit të rëndësisë së institucionit në forcimin e llogaridhënies dhe kjo bazuar në dhënien e treguesve të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e realizuara, për ta pasuar me gjykimin e nivelit të tensionit që shfaqet në dilemën pavarësi-rëndësi në rastin tonë. Nga ana e tjetër në funksion të këtij punimi kemi tentuar edhe vlerësimin e pavarësisë institucionale por mbi bazë të perceptimit të marrë nga brenda institucionit, bazuar në pyetësorë me pyetje të strukturuar.


Ky punim ka karakter përshkrues dhe shpjegues dhe përdor dy lloj të dhënash: parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore u mblodhën nëpërmjet pyetësorëve, të

cilët iu drejtuan 50 audituesëve me më shumë eksperiencë në institucion, të cilët janë pjesë e rëndësishme në politikbërjen institucionale, pra janë në nivelet e mesme dhe të larta drejtuese të tij. Pyetëtorët përmbajnë seksionin e vlerësimit të pavarësisë institucionale me pyetje të mirë strukturuar mbi aspektet e pavarësisë funksionale, organizative dhe financiare, të intervistuarit i kërkohet të vlerësojë në shkallën Likert me 5 nivele vlerësimi, ku niveli më i lartë i pavarësisë është 1 dhe niveli më i ulët 5. Në pjesën e dytë të pyetëtorit janë pyetje të lidhura me kapacitetin e audituesve dhe ditë trajnimi të realizuara në tre vitet e fundit. Në vlerësimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, te intervistuarve u kërkohet vlerësimi me shkallën Likert me 5 nivele, ku niveli më i lartë është 5.


Për qëllime të punimit janë mbledhur dhe përpunuar të dhëna dytësore, si një kërkim të formës “desk research”, duke analizuar raportet vjetore të performancës së institucionit prodhuar në 3 vitet e fundit, për të identifikuar se si ka evoluar niveli i realizimit të rekomandimeve të lëna në vite, tregues i rëndësisë institucionale në funksion të llogaridhënies, fokusi në auditimet e performancës të kryera si pasojë e kërkesave nga aktorë politikë apo të ekzekutivit, kjo në funksion të vlerësimit të përgjegjshmërisë për nevojat që ka Kuvendi për gjykime profesionale për performancën e institucioneve/programeve të qeverisë. Këto të dhëna japin nivelin e rëndësisë së institucionit dhe matin profilin institucional element i rëndësishëm për të përcaktuar nivelin e tensionit të dilemës.

Nga të dhënat e përpunuara nga të 50 pyetëtorët e mbledhur, rezulton se ka një përmirësim të kapaciteteve referuar nivelit profesional. Nëse në vitin 2010, niveli i drejtuesve të mesëm dhe të lartë (drejtor departamenti, kryeauditues, auditues i lartë) vlerësohet në nivelin 2 lidhur me formimin dhe përgatitjen profesionale (në një shkallë vlerësimi nga 1 në 5, ku 5 është niveli më i lartë) niveli për fundin e vitit 2013 është vlerësuar respektivisht me 4, për drejtuesit e lartë (drejtor departamenti, drejtor drejtorie) dhe me nivelin 3 për kryeaudituesit dhe audituesit e lartë ndërkohë që edhe për grupin e audituesve të parë dhe të dytë nga niveli 1 (vlerësuar në 2010),

për vitin 2013, nivelin I formimit profesional vlerësimi është 3. Më poshtë paraqiten grafikisht të dhënat mbi nivelin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.



Numri i ditëve të trajnimit të stafit në tre vitet e fundit ka pësuar rritje të ndjeshme duke u bërë të krahasueshëm me treguesit të institucioneve partnere, në lidhje me këtë tregues. Kështu nga 2 ditë trajnimi të realizuara për drejtuesit e mesëm në vitin 2011, është kaluar në 21 ditë trajnimi në vit ndërsa për audituesit e thjeshtë nga 0 ditë trajnimi në vitin 2011, është arritur në 25 ditë trajnimi në vit. Rritje ka pësuar dhe numri mesatar i ditëve të trajnimit për nivelin e drejtuesve të lartë.




Ndërsa nga analiza e të dhënave mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve vëmë re se ka një përqendrim të nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga ana e qeverisë sidomos për vitin 2013. Kemi paraqitur këtë tregues të ndarë sipas llojit të rekomandimeve, përmirësimet ligjore, masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore. Shikojmë se në vitin 2013, niveli i zbatimit të rekomandimeve për

përmirësime ligjore është në nivelin 21% nga 43% që ishte në vitin 2012, për masat organizative për vitin 2013 niveli i zbatimit ishte 51% nga 805 të zbatuara në vitin 2012, për masat administrative kemi përmirësim të treguesit pasi në vitin 2013 janë zbatuar 87% të tyre përkundrejt 46% të vitit 2012 dhe së fundi për masat disiplinore niveli i realizimit në vitin 2013 është 77% përkundrejt 68% të vitit të mëparshëm.

Lloji i rekomandimit	2012		2013	
	Rekomandime të dhëna	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime të dhëna	Rekomandime të zbatuara
Propozime për ndryshim legjislativ	58	25	82	17
Masa Organizative	2194	1753	2003	1013
Masa Administrative	338	154	236	205
Masa Disiplinore	883	597	925	711


Viti 2012

■ Rekomandime ■ Zbatime




Viti 2013

■ Rekomandime ■ Zbatime



Lidhur me rastet e kryerjes së vlerësimit të programeve si përgjigje të kërkesave të anëtarëve të Kuvendit, sipas të dhënave të analizuara rezulton se 5% e auditimeve të realizuara në vitin e fundit janë në respekt të kërkesave dhe adresime të Kuvendit. Pavarësisht kësaj, presioni politik në drejtim të përzgjedhjes së auditimeve që do të realizohen mbetet i ulët, në një kohë që rilevanca e materialit të përpunuar nga auditimet është më e prekshme nga këto presione. Auditimet e performacës së aktivitetit të agjencie/programeve janë duke u rritur, duke sjellë rritjen e rolit të KLSH-së në arenën e politikëbërjes dhe bashkëpunimin me aktorët e ndryshëm politik. Nga grafiku lexohet se nga 3 auditime të realizuara në vitin 2008, duke analizuar performacën e 7 subjekteve është arritur në 8 auditime në vitin 2013, ku është analizuar aktiviteti i 35 subjekteve.

Ecuria e auditimeve të performancës KLSH



Përfundime

Nga të dhënat e mbledhura por dhe të analizuara arrijmë në përfundimin se dilema është shfaqur. Për sa kohë që institucioni rritet profesionalisht dhe kalon në auditime të performacës, duke vlerësuar programet si përgjigje e kërkesave për përgjegjshmëri të lartë në administrimin e financave publike, presioni rritet dhe situata komplikohet, karakteristikë kjo edhe për KLSH-në.

Vlerësohet se KLSH ka pasur sukses në konsolidimin e institucionit si i pavarur duke rritur aftësinë për të vendosur se çfarë programi do të vlerësojë dhe si do të kryejë vlerësimin e këtij programi. Është arritur konsolidimi i pavarësisë funksionale në përmbajtje (përcaktimi i programeve që do të vlerësohen) dhe procedurë (metodat e

auditimit që përdoret), pra mund të themi që institucioni ka një pavarësi funksionale të kënaqshme. Megjithatë, nuk paraqitet në të njëjtat nivele pavarësia organizative dhe akoma më tej ajo financiare referuar nivelit të buxhetit që varet nga qeveria dhe mënyrës së përdorimit dhe shpërndarjes së fondeve në dispozicion referuar përputhshmërisë së kërkuar me rregullat qeverisëse.

Jemi në momentin kur KLSH është duke përmirësuar Ligjin organik të funksionimit të saj në mënyrë që të arrijë të sanksionojë ato parime që mësojnë Deklarata e Limës dhe ajo e Meksikës në lidhje me pavarësinë në të gjitha drejtimet e saj, kjo si një kusht i rëndësishëm për mirëfunksionimin e këtyre institucioneve të rëndësishme, iniciativë që po ndeshet me një rezistencë të lartë të politike. Ky fakt lidhet me rritjen e kapaciteteve brënda institucionit dhe rritjen e profesionalizmit të burimeve njerëzore në dispozicion të tij por dhe me rritjen e performancës dhe rëndësisë së misioneve të realizuara në drejtim të rritjes së llogaridhënies dhe bërjes së institucioneve qeveritare më të përgjegjshme në përdorimin e fondeve publike. Rritja e angazhimit në misionet performance sidomos në fusha me ndjeshmëri të lartë publike por dhe politike flasin për një konfigurim të ri dhe profil më të lartë të institucionit. Aktorët politik e njohim tashmë rëndësinë dhe funksionin e institucionit të KLSH në drejtim të mirëqeverisjes dhe si pasojë dhe presioni i tyre mbi të është duke u vijëzuar qartësisht.

Huntington (1973) ka theksuar se është jashtëzakonisht e vështirë për çdo institucion që të jetë plotësisht i pavarur edhe të ketë një profil të lartë rëndësie e në fakt, zhvillimet e 2014-s janë një shembull i mirë i këtij qëndrimi. Edhe pse ndërveprimi me Kuvendin është forcuar dhe ka momente kur institucioni i është përgjigjur kërkesave të legjislativit, mund të themi me bindje se KLSH kryesisht ka vetë-iniciuar misionet auditimi dhe ka përcaktuar vetë nivelin e rëndësisë së raporteve të publikuara. Si rezultat, gjetjet dhe rekomandimet kanë dështuar për të tërhequr vëmendjen e plotë të aktorëve të përfshirë në fushën e politikës, niveli i përmirësimeve ligjore të realizuara janë vetën në nivelin 21%. Megjithatë, KLSH ka

qenë e ndërgjegjshme dhe e kujdesshme në shmangien e polemikave. Si një organizim profesional, ajo mbështetet në mënyrë rigorozë në një përjasje shkencore në kryerjen e studimeve dhe shumicën e kohës, me vetëdije nuk pranon të kryejë vlerësime të drejtuara politikisht.

Pra, jemi në Nivelin 2 të tensionit, kur institucioni rritet profesionalisht dhe kalon në auditime të performacës dhe fillon kryerja e vlerësimit të programeve si përgjigje e kërkesave për përgjegjshmëri të lartë në administrimin e financave publike, ku gjërat komplikohen. Dhe ky konstatim shtron problemin se si mund të trajtohet ky tension? A ka një strategji të vetme mbi të cilën mund të bazohemi për të treguar si kapërcehet kjo dilemë me kosto sa më të vogla për institucionin? A duhet të shikohet me risk të lartë humbja e pavarësisë funksionale lidhur me fushat e auditimit dhe me se duhet të balancohet ky devijim nga parimet mbi të cilat funksionojnë këto institucione?

Të gjitha këtyre pyetjeve është e vështirë ti përgjigjesh me saktësi. Literatura tregon se veprimet janë të ndryshme në kontekstin e kushteve ku vepron SAI që ballafaqohet me dilema të tilla. Ajo që kemi vënë re është se kërkimet e mirëfillta shkencore në këto fusha janë të pamjaftueshme për të adresuar përgjigje të plotë për modele të ndryshme të funksionimit të SAI-eve.

Literatura

Azuma, N. (2003). The Role of the Supreme Audit Institution in NPM. Assosai Journal .
Bovens, M. (2005). Public Accountability. The Oxford Handbook of Public Management.

Diamond, L. (2008). The spirit of Democracy: The struggle to Build Free Societies throughout the World. New York, USA.

Jones, G., & Stewart, J. (2009). New development: Accountability in public partnerships - The case of Local Strategic partnerships. CIPFA, Public Money & Management .

Posner, H.M. (2011, March 24). The Four Freedoms Turn 70. Washington, DC, USA.

Schedler, A. (1999). Conceptualizing Accountability . London: Lynne Rienner Publisher

**Pavarësia dhe ngritja e kapaciteteve të
SAI-ve dhe përmirësimi i sistemeve të
kontabilitetit publik për Zhvillim të
Qëndrueshëm**

Tiranë, 29 Tetor 2014

*Prezantim nga Wolfgang Wiklicky, Drejtor i Përgjithshëm,
Gjykata Austriake e Auditimit / Sekretariati i Përgjithshëm i
INTOSAI-t*

1

- Shikim i përgjithshëm: Çfarë kuptohet me pavarësi të SAI-ve?
- Vlerat dhe dobitë e pavarësisë së SAI-ve
 - Sfidat për zhvillim të qëndrueshëm
 - Masat e nevojshme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm
- Axhenda për Zhvillim, Post-2015 e OKB-së

Çfarë kuptohet me pavarësi të SAI-ve?


SAI_Albania_301014_FuWW

Çfarë do të thotë pavarësi e SAI-ve?

- eficiencë, efektivitet dhe performancë me cilësi të lartë e detyrave të auditimit publik
- mbrojtje nga çdo formë e ndikimit të jashtëm
 - besueshmëri e performancës
- pavarësia e SAI-ve nga qeveria, e garantuar me ligj dhe e sanksionuar në kushtetutë (shih Deklaratën e Limës (1977) dhe të Meksikos (2007)).

SAI_Albania_301014_FuWW

8 Shtyllat e Pavarësisë së SAI-t



SAI_Albania_301014_FuWW

8 Shtyllat - 1: statusi ligjor

Parimi 1:

Ekzistenca e një kuadri të përshtatshëm, efektiv ligjor që parashikon shtrirjen e pavarësisë së SAI-t

P.sh. Kushtetuta Federale Austriake (ACA-kapitulli VI i posaçëm) përcakton shprehimisht situatën juridike të ACA -s, e pavarur nga Qeveria Federale dhe Qeveria e Landeve (Laender) dhe i nënshtrohet vetëm dispozitave të ligjit.

SAI_Albania_301014_FuWWt

8 Shtyllat - 2: Kryetar i SAI-t

Parimi 2:

Pavarësia e Kryetarit të SAI-t dhe anëtarëve, duke përfshirë sigurinë e qëndrimit në detyrë dhe imunitetin ligjor në kryerjen e detyrave të tyre

P.sh. Presidenti i ACA-s zgjidhet nga Këshilli Kombëtar, për një mandat 12 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje; mund të shkarkohet vetëm me anë të një procedure të pavarur nga autoritetet qeveritare.

SAI_Albania_301014_FuWW

8 Shtyllat - 4: informacioni

Parimi 4:

qasje e pakufizuar ndaj informacionit

P.sh. në rastin e ACA-s: parimi i shprehur në Aktin Federal për Gjykatën Austriake të Auditimit - të gjitha subjektet e audituara duhet të bashkëpunojnë me ACA-n dhe t'i mundësojnë të gjithë informacionin e kërkuar për qëllime të ndonjë auditimi të veçantë (të dhënat, dokumentet e biznesit, kontratat, pjesë të korrespondencës .. .)

SAI_Albania_301014_FuWW

8 Shtyllat - 5: raportimi

Parimi 5:

e drejta dhe detyrimi për të raportuar mbi punën e SAI-ve

P.sh. në rastin e ACA-s: Kushtetuta Federale përcakton se ACA duhet të raportojë të paktën një herë në vit për rezultatet e auditimit; ACA ka të drejtën për të nxjerrë më shpesh raportin e auditimit (= praktika e tanishme) dhe të raportojë në çdo kohë (= praktika e tanishme) observacionet e saj në Këshillin Kombëtar

SAI_Albania_301014_FuWW

8 Shtyllat - 6: përmbajtja dhe afatet

Parimi 6:

liria për të vendosur mbi përmbajtjen dhe afatet e raporteve të auditimit si dhe të botimit dhe të shpërndarjes së tyre

P.sh. Siç është përcaktuar në Kushtetutën Federative, ACA ka të drejtë të paraqesë raportet e veta në kohën e duhur pranë Këshillit Kombëtar duke informuar njëkohësisht, Kancelarin Federal për çdo raport; Raportet duhet të publikohen pas dorëzimit në Këshillin Kombëtar

SAI_Albania_301014_FuWW

8 Shtyllat - 8: burimet

Parimet 8:

Autonomia financiare dhe administrative;
mundësia e të pasurit të burimeve të duhura
njerëzore, materiale dhe monetare

P.sh. Kushtetuta Federale përcakton: Presidenti i ACA-s ka të drejtë të marrë pjesë dhe të flasë në Këshillin Kombëtar (në lidhje me çështjet e buxhetit të ACA-s dhe nënndarjeve përkatëse të Ligjit mbi Financat Federale); të gjitha çështjet e personelit të ACA-s menaxhohen në mënyrë të pavarur: Presidenti i ACA-s mund të emërojë zyrtarët (Auditues) dhe personel ndihmës


SAI_Albania_301014_FuWW

Vlera dhe dobitë e Pavarësisë së SAI-t

SAI_Albania_301014_FuWW

Vlera dhe dobitë (1)

Pavarësia e SAI-ve është një koncept shumëdimensional - që përfshin aspektin



SAI_Albania_301014_FuWW

vlera dhe dobitë (2)

- SAI-t e pavarur shërbejnë si gurët e themelit në sistemet demokratike;
- "partneriteti i natyrshëm" i SAI-ve të pavarur me parlamentin, qeverinë dhe shoqërinë civile nëpërmjet auditimit të jashtëm dhe shërbimeve të konsulencës, çon në përmirësimin e:
 - përgjegjshmërisë
 - transparencës
 - Qeverisjes së mirë
 - besueshmërisë

SAI_Albania_301014_FuWW

kompetencat e SAI-ve (1)

Në mënyrë që vlerat dhe dobisë e auditimit të jashtëm publik të jenë të suksesshme, SAI duhet të ofrojë:

- informacion të pavarur dhe të besueshëm mbi shpenzimet dhe veprimtarinë qeveritare (*kompetencat*: planifikim i pavarur auditimi, cilësia e stafit të auditimit, trajnimi i stafit të auditimit, metodat e auditimit)
- forcimin e rolit të parlamentit në funksionet e tij të mbikëqyrjes dhe kontrollit, partneritetin me parlamentet (*kompetencat*: raportet e një SAI të pavarur, shqyrtimi në Komisionin e Llogarive publike, e drejta për të folur në seancën plenare të parlamentit)

SAI_Albania_301014_FuWW

Kompetencat e SAI-ve (2)

- Transparenca dhe përgjegjshmëria publike (*kompetencat*: qasje e SAI-ve në informacion, analizë e pavarur e dokumenteve, raporte të strukturuar mirë, vlerësime dhe rekomandime)
- marrëdhënie besueshmërie me subjektet e audituara (*kompetencat*: Proces i mirë përcaktuar auditimi, duke përfshirë procedurën për komente nga subjekti që auditohet, auditime të dhura periodike mbi transaksione të caktuara)
 - qeverisja e mirë dhe funksionimi i shtetit (*kompetencat* : Partneritet me parlamentin, marrëdhënie pune e SAI-t me publikun e gjerë, duke përfshirë median)

SAI_Albania_301014_FuWW

kalimi në nivel botëror

Nevoja për pavarësi e SAI-ve dhe parakushtet e kapaciteteve për auditim të jashtëm publik eficient dhe efektiv ---- një detyrë e vazhdueshme për INTOSAI-n, organizatat e saj anëtare dhe Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI-t për të komunikuar dhe për t'i bindur grupet ndërkombëtare të interesit, të tilla si OKB-ja.

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI- t (1)

Rezoluta A / 66/209 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në 22 dhjetor 2011:

"Promovimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike me anë të forcimit të institucioneve supreme të auditimit"

(Inisiativë e Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t 2008: mbështetur nga INT- Gov Bordit (2009), INCOSAI (2010), si dhe nga UN-CEPA, UN-ECOSOC, Paneli i Audituesve të Jashtëm të OKB-së)

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI-t (2)

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në mënyrë të qartë njeh:

- se SAI-t mund të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë objektive vetëm nëse janë të pavarur nga subjekti i audituar dhe të mbrojtur nga ndikime të jashtme;
 - Rolin e rëndësishëm të SAI-ve në promovimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administratën publike;
- se SAI-t ndihmojnë në arritjen e objektivave të zhvillimit, duke përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit;
 - Rëndësinë e punës së SAI-ve dhe të INTOSAI-t;
 - Rëndësinë e Deklaratave të Limës dhe Meksikos.

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI-t (3)

Shtetet anëtare të OKB-së nxiten që të:

- Aplikojnë parimet e përcaktuara në Deklaratat e Limës dhe Meksikës dhe
- Të vazhdojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin e tyre me INTOSAI-n, për të promovuar qeverisjen e mirë;

Rëndësia për donatorët:

- Bazë për programet e intensifikuara për zbatimin e parimeve të pavarësisë së SAI-ve

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI -t, Mesazhi kryesor (1)

Mesazhet kryesore të Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t (I):

- Rritja e transparencës së financave publike dhe përgjegjësisë së menaxhimit të financave publike është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm
- SAI-t mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm në këtë drejtim, por kanë nevojë për një kuadër të përshtatshëm
- Rezoluta e OKB-së A / 66/209 për forcimin e pavarësisë së SAI-t duhet të zbatohet, në mënyrë që të krijojë këtë kuadër të përshtatshëm në nivel kombëtar

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI - Mesazhi kryesor (2)

Mesazhet kryesore të Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI (II):

- INTOSAI është i gatshëm të kontribuojë në zhvillimin e Axhendës së Zhvillimit Post 2015 mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm në nivel të OKB-së
- SAI-t mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, në goftë se ata janë të pavarur nga subjektet e audituara
- Parakushtet mbi Pavarësinë të parashikuara në Deklaratat e Limës dhe Meksikos kanë nevojë ende që të zbatohen

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI – t Mesazhi kryesor (3)

Mesazhet kryesore të Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t (III):

- Zbatimi i parimeve të pavarësisë së SAI-t duhet të jetë element i Axhendës së Zhvillimit Post-2015 të OKB-së
- Prandaj, do të ishte e këshillueshme të përfshihet INTOSAI në hartimin e Axhendës së Zhvillimit Post-2015
- INTOSAI është i gatshëm dhe i aftë për të kontribuar duke sjellë përvojën e tij në lidhje me nevojat që SAI-t të përmbushin siç duhet detyrat e tyre të auditimit

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI – t Mesazhi kryesor (3)

Mesazhet kryesore të Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t (III):

- Zbatimi i parimeve të pavarësisë së SAI-t duhet të jetë element i Axhendës së Zhvillimit Post-2015 të OKB-së
- Prandaj, do të ishte e këshillueshme të përfshihet INTOSAI në hartimin e Axhendës së Zhvillimit Post-2015
- INTOSAI është i gatshëm dhe i aftë për të kontribuar duke sjellë përvojën e tij në lidhje me nevojat që SAI-t të përmbushin siç duhet detyrat e tyre të auditimit

SAI_Albania_301014_FuWW

Rezoluta e OKB-së për Pavarësinë e SAI -t - hapi tjetër

- INTOSAI ishte ftuar për të kontribuar në procesin e krijimit të Axhendës së Zhvillimit Post-2015 të OKB-së
- Mesazhi kryesor: Zbatimi i Rezolutës së OKB-së A / 66/209 dhe parakushtet për pavarësi të SAI-ve duhet të jenë elemente thelbësore të rendit të ditës të Axhendës së OKB-së Post-2015 për zhvillimin e qëndrueshëm

SAI_Albania_301014_FuWW

Sfidat për zhvillim të qëndrueshëm

SAI_Albania_301014_FuWW

zhvillimi i qëndrueshëm (1)

Rezoluta e OKB-së A / 66/209 dhe INCOSAI 2013 bëri thirrje veçanërisht për zbatimin e Rezolutës së OKB-së për pavarësi, në veçanti sepse

- SAI-t mund të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë objektive vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjekti i kontrolluar dhe të mbrojtur ndaj ndikimit të jashtëm,
- SAI-t kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e eficiencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit dhe
- SAI-t ndihmojnë në arritjen e objektivave të zhvillimit, duke përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

SAI_Albania_301014_FuWW

zhvillimi i qëndrueshëm (2)

Deklarata e Pekinit

- theksoi në mënyrë të qartë rëndësinë e forcimit të pavarësisë së SAI-ve dhe pranoi se mandatet e SAI-ve mund të duhet të zgjerohen për auditimet që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë e financave publike

Prandaj:

- Së bashku, komuniteti ndërkombëtar i SAI-ve, si edhe bashkësia ndërkombëtare e shteteve të thirrura për veprim, duhet që të jenë të përgatitur për sfidat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm

SAI_Albania_301014_FuWW

29

zhvillimi i qëndrueshëm (3)

- Mungesa e transparencës dhe përgjegjshmërisë shkaktojnë dëme të jashtëzakonshme për shtetet, paqja sociale rrezikohet dhe minon eficiencën e ndihmës për zhvillim
- Mungesa e pavarësisë ligjore, financiare dhe organizative të SAI-ve nga qeveria
 - Mungesa e një mandati të plotë të auditimit të SAI-ve
- Mungesa e mundësive për SAI-t që t'i japin Parlamentit një opinion formal gjithëpërfshirës të auditimit për llogaritë e Qeverisë
- Mungesa e kompetencave ligjore të SAI-ve për t'i kërkuar llogari qeverisë

Masat e nevojshme për të siguruar zhvillim të
qëndrueshëm

Masat e nevojshme (1)

Është e mundur vetëm në qoftë se :

Përdorimi i burimeve publike është bërë më transparent dhe i përgjegjshëm në mënyrë që të rrisin përgjegjësinë e veprimit për të dhënë një shans në të ardhmen

- Veprimet e sotme nuk duhet të kufizojnë dhe rrezikojnë mundësitë për brezat e ardhshëm
- Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë është thelbësore në mënyrë që të forcojnë besimin e qytetarëve në të gjitha institucionet shtetërore

SAI_Albania_301014_FuWW

Masat e nevojshme(2)

Qëllimi i përbashkët :

- Krijimi i transparencës
- Rritja e përgjegjshmërisë
- Lufta kundër korrupsionit
- Kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda për Zhvillim Post-2015 e Kombeve të Bashkuara

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post-2015 të OKB-së (1)

Pozicioni i INTOSAI-t për Axhendën për Zhvillim Post-2015 i OKB-së

Duke bërë thirrje për përfshirjen e :

- Pavarësisë
- Ngritjes së kapaciteteve
- Përmirësimin e sistemeve të kontabilitetit

si elemente të nevojshëm.

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post-2015 e OKB-së (2)

Vendos objektivat e INTOSAI-t në Axhendën e Zhvillimit Post-2015 të OKB-së

- me një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe intensiv të Presidentit aktual të ECOSOC dhe Nën-Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
- duke kontribuar nëpërmjet pprezencës së INTOSAI-t në forume të shumta të OKB-së
- Komiteti Ndërqeveritar i OKB-së i Ekspertëve mbi Financimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm
- diskutime on-line të OKB-së mbi "Matjen e progresit në arritjen e MDG (Objektivat e Zhvillimit të mijëvjeçarit) dhe më gjerë" dhe "Monitorimin me Pjesëmarrje dhe Përgjegjshmëri"

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post-2015 e OKB-së (4)

Nga pjesëmarrja në Forumin Politik të nivelit të lartë të ECOSOC për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Forumin e ECOSOC për Zhvillim dhe Bashkëpunim (DCF) me temën "Përafrimi i së ardhmes së bashkëpunimit për zhvillim në Post-2015" në selinë e OKB-së në Nju Jork, korrik 2014

Pjesëmarrja në panelin e:

- Dialogut Ministror mbi "Përgatitjen e forumit të nivelit të lartë politik për post 2015: zbatimin e axhendës së zhvillimit dhe procesit të shqyrtimit" dhe
- Forumi për Zhvillimin e Bashkëpunimit

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post-2015 e OKB-së (6)

Presidenti i ECOSOC Martin Sajdik

- "një kuadër i plotë mbi përgjegjshmërinë" si një element kyç për suksesin e Axhendës së Zhvillimit Post-2015
 - Roli i rëndësishëm i SAI-ve në këtë drejtim
 - CEPA (Komiteti i OKB-së për Ekspertët mbi Administratën Publike)
- Përfshirja e parimeve të Deklaratave të Limës dhe Meksikos, si dhe Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së A / 66/209
- Duke pranuar rëndësinë e forcimit të përgjegjshmërisë kombëtare përmes SAI-ve si dhe
 - Kapaciteti i SAI-ve kombëtare si elemente thelbësore të Axhendës së Zhvillimit Post-2015

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post-2015 e OKB-së (7)

Teksti i Rezolutës së dakordësuar nga ECOSOC, korrik 2014:

ECOSOC ... "pranon rolin e domosdoshëm të institucioneve supreme të auditimit dhe ngritjen e kapaciteteve në mënyrë që qeveritë të jenë të përgjegjshme në përdorimin e burimeve dhe të performojnë për arritjen e objektivave të zhvillimit, dhe u bën thirrje Shteteve Anëtare për të marrë parasysh rëndësinë e pavarësisë së institucioneve supreme të auditimit në hartimin e Axhendës së zhvillimit post-2015".

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post-2015 e OKB-së (8)

Deklarata Ministrore ECOSOC gjithashtu përmban një angazhim të qartë për rëndësinë e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, transparencës dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet

- Diskutimi dhe komentet përmbyllëse të Nën-Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Wu Hongbo dhe presidentit të ECOSOC Martin Sajdik, provojnë se INTOSAI-t është duke u përfshirë në mënyrë efektive në procesin e hartimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe se kjo do të ndikojë në diskutime të mëtejshme në sistemet e llogaridhënies

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post-2015 e OKB – së në vijim

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post 2015 e OKB-së – në vijim (1)

Vjeshtë 2014

Rezoluta e re e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së bën thirrje për përfshirjen e pavarësisë dhe ngritjen e kapaciteteve për SAI-t dhe përmirësimin e sistemeve të kontabilitetit publik në Axhendën e Zhvillimit Post-2015 të OKB-së

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post 2015 e OKB-së – në vijim (2)

2015

- Simpoziumi OKB / INTOSAI : 02-05 mars 2015 "Programi i zhvillimit Post-2015 i OKB-së : Roli i SAI-ve dhe Mënyrat e zbatimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm"
 - Negociatat e mëtejshme dhe
- Miratimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm Post-2015 të OKB-së, në fund të 2015

SAI_Albania_301014_FuWW

Axhenda e Zhvillimit Post 2015 e OKB-së – në vijim (3)

Përgjegjësitë dhe detyrat e të gjithëve ne si përfaqësues përgjegjës të SAI-ve për të rritur ndërgjegjësimin e grupeve të interesit për përfshirjen e

- Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit,
 - Ngritjen e kapaciteteve dhe
 - Përmirësimin e sistemeve të kontabilitetit
- si elementet thelbësore të Axhendës së Zhvillimit Post-2015 të OKB-së

SAI_Albania_301014_FuWW

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

Shënim : Kjo kumtesë paraqitet ne Power Point, në pamundësi për të pasur materialin në word

SAI_Albania_301014_FuWW

Një rishqyrtim i çështjeve të kontraktimit të organizatave jofitimprurëse për shërbimet sociale

Nga Prof. Dr. Aurela Anastasi¹



E shohim të nevojshme të rimarrim edhe njëherë në shqyrtim kontraktimin e organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) për shërbimet sociale, jo vetëm për të avancuar debatin në lidhje me këtë çështje, por edhe për shkak se kohët e fundit, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme ligjore. Kjo temë është trajtuar për herë të parë, në një nga revistat “Auditimi Publik” (Nr. 4 2013)², e cila solli në vëmendje disa probleme. Kryesisht, këto probleme lidheshin me identifikimin e saktë të bazës ligjore që duhet të zbatohet në procedurat e kontraktimit të OJF-ve për ofrimin e shërbimeve, nga organet qendrore e vendore. U evidentuan disa mungesa në ligj, të cilat duhet të rregullojnë specifikat që paraqesin prokurimet e “shërbimeve sociale”. Këto të fundit, nuk janë të njëjta as me “shërbimet e konsulencës”, as me veprimtaritë e tjera ekonomike, të rregulluara shprehimisht nga ligji “Për prokurimet”. Çështje specifike burojnë edhe nga fakti që subjektet kontraktuese do të jenë organizatat jofitimprurëse dhe jo operatorët e zakonshëm ekonomikë, siç janë shoqëritë tregtare.

¹ *Pedagoge e të Drejtës Kushtetuese, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe avokate në sektorin jofitimprurës.*

² *Shih: “Çështje të kontraktimit dhe prokurimit të organizatave jofitimprurëse për shërbimet sociale”, Revista “Auditimi Publik”, Nr. 4, Tiranë, 2013, fq.71-80*

Aktualisht, këto probleme mbeten për tu zgjidhur. Për më tepër, ka pasur përparime dhe koncepte të reja për hartimin politikave buxhetore në pushtetin vendor, duke rritur përvojat e delegimit të shërbimeve sociale. P.sh., në disa bashki, janë hedhur hapa të rëndësishëm për buxhetimin gjinor, gjë që ka sjellë nevojën e transferimit të fondeve për organizatat vendore që japin ndihmë shoqërore në këtë fushë. Po kështu, mundësi më të mëdha janë hapur për ofrimin e shërbimeve sociale ndaj fëmijëve. Nga ana tjetër, edhe numri i organizatave që kanë kapacitetet për të konkurruar po rritet. Nga monitorimet që kanë zhvilluar vetë organizatat e shoqërisë civile, është arritur në konkluzionin se organizatat jofitimprurëse janë të angazhuara të konkurrojnë për kontrata shtetërore, mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë³. Megjithatë, vitin e fundit, rezulton se 75% e të gjitha organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në nivel kombëtar, nuk kanë pasur të ardhura nga prokurimet publike, ndërkohë që vetëm 8% e tyre thonë se plotësojnë kushtet për të fituar shuma nga prokurimet publike⁴. Këto të fundit, janë organizata që operojnë në qytete të mëdha si Tirana, Elbasani, Shkodra dhe Fieri⁵. Është e qartë se bashkitë e mëdha kanë mundësi për të transferuar fonde publike për shërbimet sociale ndaj OJF-ve, gjë që paraqitet mjaft e vështirë në bashkitë e vogla dhe gati e pamundur në komuna. Qarqet, nuk janë përfshirë në këto procese, edhe pse logjika duhet të na çonte në përfundimin se, projekte të tilla do të shtriheshin më mirë në nivel qarku, sesa në nivel bashkie. Kjo, pasi qarqet mund të koordinojnë shtrirjen e këtyre shërbimeve në një juridiksion territorial më të gjerë.

³ Shih: “*Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile. Raporti për Shqipërinë*”, *Partnerët Shqipëri Qendra për ndryshim dhe menaxhim konflikti*, fq. 31.

⁴ Po aty. Nga konkluzionet e paraqitura në *Matricë*, nuk del qartë fakti se përse vetëm 8% e organizatave pranojnë se fitojnë kushtet për të kërkuar fonde përmes prokurimeve publike, kur 25% e tyre kanë pasur të ardhura nga prokurimet publike. Është e vështirë të japim një shpjegim përse është shkruar në studim, por duhet të mbajmë parasysh faktin që shumë organizata e konsiderojnë si prokurim edhe procesin e konkurrimit që zhvillohet bazuar në ligje të tjera për mbështetjen e shoqërisë civile.

⁵ Po aty.

Duke monitoruar procedurat dhe praktikat që disa bashki kanë ndjekur për transferimin e fondeve ndaj OJF-ve, rezulton se përvoja më e përhapur është transferimi i fondeve përmes miratimit nga Këshilli Bashkiak. Kështu, një monitorim i zhvilluar nga disa organizata të shoqërisë civile për periudhën 2011-2013, ka evidentuar vetëm një procedurë të plotë prokurimi për kontraktimin e OJF-ve për shërbimet sociale, pranë Bashkisë Shkodër⁶, kurse në të gjitha rastet e tjera, transferimi i fondeve është kryer me vendim të Këshillit Bashkiak. Kështu, janë kryer praktika të kontraktimit të OJF-ve përmes vendimeve të Këshillave Bashkiakë në bashkitë Vlorë, Pogradec, Korçë, Durrës⁷. Kjo ka ndodhur, si në rastet kur Bashkia ka akorduar fonde të vetat, edhe në rastet kur ajo ka transferuar fonde që vijnë nga burime të jashtme. Prandaj, është e nevojshme të diskutojmë nëse është një procedurë e rregullt, transferimi i fondeve bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak, apo jo. Për të analizuar këtë çështje, na vjen në ndihmë rasti i Bashkisë Korçë, për procedurat e së cilës, ka pasur një auditim publik nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). *Bashkia Korçë, ka kryer financime projektsh të përbashkëta me dy fondacione, të cilat ofrojnë shërbime sociale, falas. Ky bashkëfinancim është realizuar me vendim të Këshillit Bashkiak dhe është finalizuar me një marrëveshje bashkëpunimi të lidhur midis palëve, pa ndjekur ndonjë procedurë konkurrimi*⁸. Nga raporti i paraqitur pranë Bashkisë, audituesit e KLSH-së, konkludojnë se, këto pagesa janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 4, "Fusha e

⁶ Shih: Po aty.

⁷ Shih: "Analizë e kuadrit ligjor mbi nënkontraktimin e OJF-ve nga organet qendrore dhe vendore, për shërbimet e dhunës në familje", botuar në http://www.gag-al.org/WEB/publikime/kontraktimi_ojf.pdf, fq.6-7, vizituar për herë të fundit më 18.11.2014, si dhe në "Çështje të kontraktimit dhe prokurimit të organizatave jofitimprurëse për shërbimet sociale", Revista "Auditimi Publik", Nr. 4, vep.përm. fq.73.

⁸ Me vendimin e Këshillit Bashkiak 27 dt. 26.03.2012, "Për miratimin e buxhetit të bashkisë dhe institucioneve të varësisë", është miratuar projekti "Qendër komunitare për moshën e tretë" dhe është përcaktuar Fondacioni..., si implementues i projektit. Bazueshmëria ligjore e këtij akti është konfirmuar edhe Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

zbatimit”: “Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5,6,7,8 e 9 të këtij ligji që rregullohen me ligj tjetër”.

Pavarësisht nga konkluzioni i audituesve të KLSH-së, do të përqipemi të analizojmë më gjerësisht të gjitha rrethanat që lidhen me këtë rast, nga pikëvështrimi i një pale të tretë.

Në radhë të parë, duam të nxjerrim në pah arsyet që i kanë bërë bashkitë të besojnë se mund të transferojnë fonde drejtpërdrejt, me vendim të këshillit bashkiak. Ne mendojmë se kjo praktikë bazohet në disa parime, të cilat janë shtylla të rëndësishme për të justifikuar veprimet dhe masat e marra nga autoritetet vendore.

Po i përmbledhim ato, si vijon:

- **së pari**, shërbimet me karakter social bëjnë pjesë në funksionet e Bashkisë;
- **së dyti**, Këshilli Bashkiak është organi kompetent për të vendosur mbi buxhetin e Bashkisë dhe zbatimin e tij;
- **së treti**, vendimet e Këshillit Bashkiak kanë fuqi normative të barabartë me ligjin brenda juridiksionit territorial të Bashkisë.

Pavarësisht nga sa më sipër, për të dhënë një përgjigje të saktë, është e nevojshme të bëjmë dallimin midis asaj që e quajmë e drejta materiale e Këshillit Bashkiak për të marrë vendime për buxhetin vendor, nga e drejta procedurale që duhet të zbatohet për përmbushjen e detyrave buxhetore. Kështu, tre argumentet e mësipërme e bëjnë sjelljen e Këshillit Bashkiak të bazuar ligjërisht, si Autoritet Kontraktor për ofrimin e shërbimeve sociale. Por, nga ana tjetër, Këshilli nuk mund të vendoste *a priori* edhe për përzgjedhjen e operatorit që do të kontraktohej, pa u kryer procedurat e nevojshme të parashikuara nga ligji. Në këtë mënyrë është mënjanuar procesi i konkurrimit, që është parimi kryesor në transferimin e fondeve.

Ligji “Për Prokurimin Publik”, zbatohet si ligj procedural për kryerjen e prokurimeve publike. Ky ligj ka parashikuar në mënyrë të detajuar fushën e zbatimit të vetes së

vet, si dhe rastet që përjashtohen nga zbatimi i tij. Për këtë arsye, Audituesi Publik ka dashur të thotë se përderisa në nenet e referuara prej tij (nenet 5,6,7,8 e 9), nuk parashikohet shprehimisht, përjashtimi nga procedurat e prokurimit publik i OJF-ve, për ofrimin e shërbimeve sociale, atëherë për këtë qëllim, duhet të zbatohet pikërisht ky ligj. Ai është tërësisht një ligj me natyrë procedurale që nuk e cenon të drejtën materiale të autoritetit kontraktor për të përcaktuar zërat në buxhet. Kështu, të drejtat e pushtetit vendor për të deleguar fonde, nuk cenohen nga detyrimi i tyre për të ndjekur procedurat e konkurrimit sipas ligjit “Për prokurimin publik”. Realisht, zbatimi i tij u jep vlefshmëri vendimeve dhe akteve normative të Këshillit Bashkiak, të cilat nga ana materiale janë të drejta, por nga ana procedurale nuk kanë zbatuar ligjin. Është e vërtetë se, ligji “Për prokurimin publik”, ka parashikuar kriteret që duhet të përmbushë një operator ekonomik, për të fituar një kontratë publike. Gjithashtu, ai parashikon detyrimin që ka Autoriteti Kontraktor, të vendosë paraprakisht kërkesat që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë për t’u kualifikuar në procedurën e prokurimit (neni 45 dhe 46 i ligjit)⁹. Megjithatë, këto parashikime nuk e cenojnë aspak karakterin procedural të këtij ligji, në procesin e konkurrimit. Por a është ky akt, i vetmi ligj që mund të zbatohet për prokurimin e shërbimeve sociale?

Ne mendojmë se ka ende vend për analiza më të thelluara në këtë kuadër. Është e qartë që fondet publike duhet të transferohen sipas procedurave ligjore. Ky diskutim duket sikur mbyllet menjëherë nëse i referohemi edhe ligjit “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. Në bazë të tij “shërbimet e kujdesit shoqëror publik”, që financohen me fondet e buxhetit qendror apo vendor, duhet të prokurohen nga organet e pushtetit vendor tek ofruesit privatë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për

⁹ *Shih më gjerë: Reida Kashta (Shahollari), “Procesi administrativ i përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik; trajtimi i këtij procesi nga praktika gjyqësore”, botuar në revistën “Studime Juridike”, nr.1, 2014.*

prokurimin publik” (neni 18/2)¹⁰. Pra, kemi dy faktorë në favor të zbatimit të ligjit “Për prokurimin publik”. Ky i fundit, nuk përjashton shprehimisht nga fusha e zbatimit të tij organizatat jofitimprurëse, ndërsa ligji material i fushës, që rregullon ndihmën dhe shërbimet shoqërore, referohet tek “legjislacioni në fuqi për prokurimin publik”.

Në praktikë, procedurat e prokurimit publik të shërbimeve shoqërore për OJF-të, sikurse theksuam më lart, jo vetëm që nuk zbatohen në mënyrë ekskluzive, por përkundrazi, zbatohen në raste shumë të rralla. Një nga arsyt lidhet me faktin se, organet vendore i kanë anashkaluar këto procedura. Megjithatë, ka edhe arsye të tjera. P.sh., ka mjaft raste kur transferimi i fondeve për shërbimet sociale ndaj OJF-ve është kryer nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në bazë të procedurave të parashikuara nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”¹¹, i cili paraqitet njëkohësisht si një ligj material e procedural. Gjithashtu, raste të reja mund të krijohen edhe nga zbatimi i ligjeve të tjera.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, pritet të ketë raste ku të zbatohet ky i fundit. Nëse vendosim në një bazë krahasimore këtë ligj me atë për prokurimin publik, mendojmë se ata do të konkurrojnë me njëri-tjetrin dhe se, ligji për koncesionet dhe partneritetin publik-privat, do të zëvendësojë ligjin “Për prokurimin publik” në mjaft raste. Ky i fundit, nuk ka parashikuar prokurimin e shërbimeve sociale në mënyrë të shprehur, as OJF-të si subjekte që kontraktohen. Kryesisht, ai është i përqendruar në rregullimin e marrëdhënieve që kanë të bëjnë me procesin e prokurimit të mallrave, të punëve e të shërbimeve, ndaj operatorëve ekonomikë. Ky ligj nuk i ndalon OJF-të që të marrin pjesë në procesin e prokurimit, ose të paraqesin ofertat e tyre. Çështja shtrohet nëse kufizimi ligjor për pjesëmarrjen e OJF-ve në procesin e prokurimit, buron nga natyra e

¹⁰ Ligj Nr.9355, dt.10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 18/2.

¹¹ Ligj Nr.10093, dt. 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e axhencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”.

organizatave jofitimprurëse në raport me kuptimin e veprimtarisë sipërmarrëse. Është vlerësuar se, ligji i Prokurimit është më i orientuar nga biznesi. Ai përmban një numër dispozitash të cilat mund të shkaktojnë vështirësi financiare për organizatat jo- fitimprurëse. Kjo është evidentuar edhe nga rasti i prokurimeve të shërbimeve sociale në Bashkinë Shkodër, të cilit ne i kemi referuar¹². Madje, duke parashikuar “kontratat e konsulencës”, ky ligj u referohet shërbimeve të konsulencës “të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë” (neni3/2). Ky fakt është evidentuar edhe në vende të tjera, të cilat aktualisht, kanë miratuar dhe përdorin një procedurë ligjore të posaçme të “kontraktimit social”¹³. Edhe pse kontraktimi social, nga pikëpamja legislative paraqitet mjaft kompleks dhe ndërthur zbatimin e disa ligjeve, ka një tendencë të dukshme për të rregulluar posaçëm legjislacionin në fjalë. Nga përvojat e vëzhguara, vërejmë se legjislacioni po orientohet nga rregullimet ligjore të partneritetit publik-privat, me qëllim nxitjen e delegimit të shërbimeve sociale ndaj OJF-ve nga organet e pushtetit vendor. Këtë përvojë e pamë të ravijëzuar qartë në Bullgari¹⁴.

Në Shqipëri, ligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, parashikon shprehimisht në fushën e tij të zbatimit, mundësinë e përdorimit të një procedure partneriteti publik - privat për shërbimet sociale¹⁵. Autoritetet kontraktuese që mund të zhvillojnë procedura partneriteti publik-privat, midis të tjerave, janë edhe organet

¹² Çështje të kontraktimit dhe prokurimit të organizatave jofitimprurëse për shërbimet sociale”, Revista “Auditimi Publik”, Nr. 4, vep.përm. fq. 73-74

¹³ Shih: “Contracting Social Services Between the State and NGOs. A Comparative Analysis - England, Germany, Poland, Hungary, Czech Republic, and the Practice in Bulgaria” (2004). Rasti i Armenisë në: http://issuu.com/undp_in_europe_cis/docs/undp-econl_handbook_on_social_contracting_2012/68;

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Shih nenin 4, pika 1/g “Fusha e zbatimit të koncesioneve/partneritetit publik privat”, të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”.

e pushtetit vendor¹⁶. Në këtë mënyrë, mundësohet zhvillimi i procedurave të prokurimit publik për shërbimet sociale nga organet e pushtetit vendor, gjë që garanton decentralizimin e këtyre shërbimeve. Partneriteti publik-privat nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit kontraktues (partnerit publik) dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, domethënë partnerit privat. Ky i fundit, merr përsipër detyrimin për t'u ofruar shërbime publike përdoruesve të shërbimeve, brenda fushës së kompetencave të partnerit publik. Nga ana tjetër, ligji paraqitet si një ligj procedural, duke rregulluar kuptimin dhe procedurat e dhënies së partneriteteve, si dhe organet përkatëse. Megjithatë, nga pikëpamja e procedurave, ky ligj bën një rregullim të përgjithshëm, për të gjitha objektet e përfshira në fushën e zbatimit të tij dhe nuk i referohet një objekti konkret (siç është p.sh shërbimi social). Prandaj, për të specifikuar kërkesat konkrete që duhet të vendosen për operatorët ekonomikë ofertues, detyrimi rrjedh nga legjislacioni i posaçëm i fushës përkatëse.

Menduar se një prezantim i ligjit të ri për partneritetin publik-privat është i nevojshëm, për të vlerësuar mundësitë e zbatimit të tij në këtë kuadër, pasi na duket më i volitshëm sesa ligji 'Për prokurimin publik'. Megjithatë, nuk mund të përjashtojmë krejtësisht edhe veprimin e këtij të fundit në këtë aspekt. Më tej, me praktikatat që do të ndiqen mund të krijojmë koncepte të qarta se në ç'rast duhet të përdoret njëri apo tjetri ligj dhe se si autoritetet kontraktues do të zgjedhin ligjin e duhur. Aktualisht, kontraktimi social, po fillon të dallohet nga kontraktimet e tjera, për shkak të specifikave të tij. Ndoshta në të ardhmen nevojiten ndryshime të tjera ligjore për të qartësuar situatën e zbatimit të tyre dhe për të përmirësuar gjithë bazën ligjore të kontraktimit të shërbimeve sociale, si fjala vjen, për shërbimet që delegohen në favor të fëmijëve.

Nisur nga analiza e mësipërme, mund të japim edhe disa sugjerime që i gjykojmë të rëndësishme, të cilat po i përmbledhim si më poshtë:

¹⁶ *Shih nenin 13, pika 2/c "Autoritetet kontraktuese", të ligjit 125/2013.*

- **Së pari**, ka nevojë për një riformulim të nenit 18, pika 2, të ligjit Nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me qëllim që të zgjerohet baza ligjore e procedurave të prokurimit të shërbimeve sociale, duke përfshirë edhe procedurat e dhënies së partneriteteve publik-privat.
- **Së dyti**, nuk sugjerohet ndryshimi i ligjit ‘Për prokurimin publik’ me qëllim përjashtimin e organizatave jofitimprurëse si subjekte që mund të kontraktohen¹⁷. Kjo, do të krijonte një bazë më të gjerë ligjore për OJF-të dhe sidomos në rastin kur ato ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe mund të konkurrojnë krahas operatorëve të tjerë ekonomikë.
- **Së treti**, sugjerohet të rishikohet legjislacioni, për të nxitur dhe siguruar kontraktime të shpejta e cilësore që zgjidhin veçantitë e shërbimeve sociale në dobi të të miturve.
- **Së katërti**, sugjerohet të përgatiten përmbledhëse të legjislacionit me qëllim njohjen më të mirë dhe lehtësimin e procedurave për kontraktimin e shërbimeve sociale nga organet vendore.
- **Së pesti**, sugjerohet të përgatiten udhëzues praktikë për t’u ardhur në ndihmë organeve të pushtetit vendor, me qëllim respektimin e procedurave për kontraktimet sociale.
- **Së gjashti**, sugjerohet të organizohen trajnime kualifikuese për ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë.
- **Së shtati**, sugjerohet të punohet seriozisht për decentralizimin e shërbimeve sociale¹⁸.

¹⁷ Në debatet e ndryshme të zhvilluara nga shoqëria civile, është hedhur kjo ide, me qëllim që të shmanget zbatimi i këtij ligji për OJF-të, për shkak të disa problematikave që hasen në zbatimin e tij si për natyrën e OJF-ve, ashtu edhe për natyrën e shërbimeve sociale.

¹⁸ Kjo çështje nuk gjeti trajtim të zgjeruar në këtë kumtesë, por menduam ta trajtojmë pasi gjatë studimit konstatoam se në asnjë nga rastet e prokurimeve të shërbimeve sociale fondet nuk u ishin dhënë bashkive nga pushteti qendror. Ato kanë qenë fonde të veta, ose burime të jashtme. Ndërkohë, kemi vënë re kontraktime të shërbimeve sociale nga ana e pushtetit Qendror, siç është rasti i Strehëzës Kombëtare për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave.

LITERATURA:

Akte ligjore

- Ligji Nr. 9643, dt. 20.11.2006, “Për prokurimin Publik”
- Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”
- Ligji nr. 10039, dt. 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”
- Ligj Nr. 10093, dt. 09.03.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”.
- VKM, nr. 564, dt. 12.08.2005, “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”

Studime e publikime

- Çështje të kontraktimit dhe prokurimit të organizatave jofitimprurëse për shërbimet sociale”, Revista “Auditimi Publik”, Nr. 4, Tiranë, 2013
- “Analizë e kuadrit ligjor mbi nënkontraktimin e OJF-ve nga organet qendrore dhe vendore, për shërbimet e dhunës në familje”, botuar në http://www.qag-al.org/WEB/publikime/kontraktimi_ojf.pdf
- Reida Kashta (Shahollari), “Procesi administrativ i përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik; trajtimi i këtij procesi nga praktika gjyqësore”, botuar në revistën “Studime Juridike”, nr.1, 2014.
- “Contracting Social Services Between the State and NGOs. A Comparative Analysis - England, Germany, Poland, Hungary, Czech Republic, and the Practice in Bulgaria” (2004).
- “Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile. Raporti për Shqipërinë”., Partnerët Shqipëri Qendra për ndryshim dhe menaxhim konflikti
- E-përmbledhje e legjislacionit shqiptar mbi kontraktimin e ojf –ve nga organet qendrore dhe vendore për shërbimet e dhunës në familje http://www.qag-al.org/publikime/permbledhje_legjislacioni.pdf

Filozofia e kërkimit dhe auditimi i performancës

'Would you tell me, please, which way I ought to walk from here?'
'That depends a good deal on where you want to get to', said the Cat.
'I don't much care where', said Alice.
'Then it doesn't matter which way you walk', said the Cat.

Nga : Dr.Reinald Muça, KLSH



Hyrje

Jetojmë në epokën e informacionit, digjitalizimit, fibrave optike dhe Ëi-Fi. Secili prej nesh bie në kontakt me TV, Radion, Internetin, Celularin në mënyrë frenetike, duke komunikuar informacion e duke “blerë e shitur” ide, që shpeshherë justifikohen me argumente e fakte kërkimore apo shkencore. Një politikan që përpiqet të na bindë se pas studimeve të Bankës Botërore e FMN-së, është imperative rritja e çmimit të energjisë. Një Bankë Qendrore, që mbështetur në kërkim-studimin e Departamentit të Politikave Monetare, sugjeron uljen e normës bazë të interesit, një profesor që beson se kërkim është përkthimi i literaturës, një gazetare që opinionin e shefit të saj përpiqet ta marketojë me fakte e argumente nga Ëikipedia. Kërkimi sot është bërë “buka e përditshme” e pothuajse çdo profesioni, por pak e njohin rëndësinë e metodologjisë së kërkimit dhe filozofisë si pjesë esenciale e saj.

Me përkufizim, kërkimi është procesi që njerëzit ndërmarrin për të zbuluar gjëra të reja, në mënyrë sistematike, duke rritur kështu njohuritë e tyre dhe të tjerëve. Në këtë përkufizim, dy janë frazat kyçe: 1. Mënyrë sistematike, dhe 2. Zbulimi i gjërave të reja. Sistematike nënkupton mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave përmes lidhjeve logjike, jo besimeve individuale. Në këtë kontekst, kërkimi kërkon shpjegimin e metodave për mbledhjen e informacionit, diskutimin e kuptimit të rezultateve dhe kufizimet që rrjedhin prej metodave të përdorura.

Zbulimi i gjërave të reja nënkupton shumësinë e mundësive për të kryer kërkim. Ai nënkupton gjithashtu dhe ekzistencën e një qëllimi të qartë për realizimin e kërkimit.

Një nga sfidat më të mëdha të kërkimit qëndron në faktin se si ai mund të kapërcejë pengesën e dyfishtë, duke qenë njëkohësisht teorikisht e metodologjikisht rigoroz nga njëra anë dhe duke përqafuar realitetin e dhënë sugjerime praktike nga ana tjetër. Ka një debat të madh aktual se si krijohet dija në kohën e sotme. Modeli i parë i krijimit të diturisë e trajton kërkimin si proces të pozimit të pyetjeve dhe gjenerimit të përgjigjeve nga pozita ekskluzivisht akademike. Me fjalë të tjera, duke theksuar natyrën fundamentale dhe jo aplikative të kërkimit, ku dobia e rezultateve për prakticienët është mjaft e limituar. Modeli i dytë e trajton kërkimin në një kontekst aplikativ, duke nënvizuar bashkëpunimin me dhe për prakticienët. Në këtë drejtim, kërkimi duhet kryer jo vetëm nga universitetet dhe qendrat e tjera akademike, por në bashkëpunim të ngushtë me sipërmarrjet publike e ato private.¹


Ajo që vërehet rëndom në botë, por edhe në Shqipëri, është thellimi i hendekut midis prodhuesve të dijes dhe konsumatorëve të saj, jo vetëm sepse rezultatet e kërkimeve mund të mos jenë të aplikueshme në praktikë, por edhe sepse rezultatet mund të keq-aplikohen. Pikërisht në këtë hallkë të gjenerimit të dijes dhe vlerave aplikative të

¹ Në fakt, ekziston edhe një model i tretë i krijimit të dijes. Ai që niset nga fokusimi në perspektivën njerëzore të asaj që është dhe asaj që mund të bëhet. Qëllimi i një kërkimi të tillë është “garantimi i mirëqenies dhe promovimi i të mirës së përbashkët në nivele të ndryshme komunitare”. Pra nëse modeli i parë shuan kureshtjen e lindur njerëzore, i dyti ka implikime dhe përfitime praktike, i treti prek aspekte sociale, psikologjike e kulturore, të paparashikuara nga dy modelet e tjera.

saj, audituesit e performancës kanë një rol kritik jo vetëm për aktivitetin publik të cilit i shërbejnë, por edhe më gjerë.

Vetë auditimi i performancës përkufizohet si **një kërkim (studim) i pavarur mbi eficiencën dhe efektivitetin e sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizatave publike, duke iu përmbajtur ekonomicitetit dhe me synim identifikimin e përmirësimeve.**

Një skemë e kërimit, mjaft e aplikueshme edhe në auditimet e performancës, është si më poshtë:




Nga skema e mësipërme duket qartë se metodologjia e kërkimit në auditimin e performancës është e një rëndësie vitale dhe kjo për disa arsye:

1. Metodologjia e bën të aksesueshëm trajtimin e problemit social si problem performance;
2. Metodologjia specifikon perspektivën e trajtimit të problemit, në drejtim të kuptimit të tij nga audituesi dhe analizimit e interpretimit të informacionit.
3. Metodologjia përcakton supozimet bazë, të cilat janë njëkohësisht edhe kufizimet e studimit të problemit dhe si të tilla gjenerojnë risqet audituese.

Sikurse shprehen Guba dhe Lincoln: “Filozofia dhe qasja përcaktojnë sistemin e vlerave të kërkimit. Ato përbëjnë besimin e studiuesit, jo vetëm në drejtim të zgjedhjes së metodave, por ontologjisë dhe epistemologjisë së tij.”

Filozofia e kërkimit

Termi ka të bëjë me zhvillimin e dijes dhe natyrën e saj. Pavarësisht problemit kërkimor, filozofia e kërkimit është komponenti i parë që ndikon, i jep formë, gjithë metodologjisë kërkimore. Në mënyrë skematike kjo ilustron në figurën më poshtë:



Rëndësia praktike e njohjes dhe e deklarimit të filozofisë në procesin kërkimor lidhet me nxjerrjen në pah të supozimeve që do të merren për të mirëqena në vijim.

Ekzistojnë dy shkolla të mëdha mendimi lidhur me filozofinë kërkimore: ajo ontologjike dhe tjetra epistemologjike, secila me avantazhet e veta përse i përket ndikimit në mënyrën e të menduarit të kërkuesit-audituesit.

Llojet e filozofive kërkimore

Pragmatizmi: sipas kësaj filozofie, përcaktuesi kryesor i epistemologjisë, ontologjisë dhe aksiomatikës që kërkuesi do të adoptojë është **pyetja kërkimore** – pra është pyetja që përcakton rrymën filozofike të mendimit, duke qenë se një rrymë specifike mund të jetë më e përshtatshme për t’iu përgjigjur pyetjeve të caktuara. Edhe nëse pyetja e pozuar nuk sugjeron përdorimin e vetëm një rryme filozofike kërkimi, kjo shkon në dobi të këndvështrimit pragmatik, se kërkimi në vetvete ka vetëm një rregull: “duke parë e duke bërë”. Brenda kësaj filozofie, shumë studiues pohojnë se filozofia nuk është dhe nuk mund të jetë një bashkësi qëndrimesh të shkëputura,

diskrete, nga njëra-tjetra, por një spektër, një vazhdimësi, dhe si e tillë nuk ka një vijë të qartë ndarëse midis shkollave filozofike të kërkimit dhe metodave që rrjedhin prej tyre. Pragmatizmi në këtë sens është një filozofi personale kërkimi. Motori i saj është fokusimi në atë që i intereson dhe e kuriozon kërkuesin, pa hyrë në debate të kota mbi koncepte “të konsumuara” si e vërteta dhe realiteti.

Ontologjia: Merret me natyrën e realitetit, duke vënë në pikëpyetje supozimet mbi mënyrën se si funksionon sistemi dhe argumentat mbi të cilat mbështeten qëndrime të caktuara. Dy janë aspektet e ontologjisë: objektivizmi dhe subjektivizmi.

Objektivizmi: sipas këtij aspekti ontologjik, strukturat sociale ekzistojnë përtej aktorëve socialë. Le të marrim për shembull menaxhimin e një organizate publike. Sipas aspektit objektivist, menaxhimi është një entitet i shkëputur nga menaxheri, për faktin se detyrat menaxheriale, procedurat e punës, struktura formale, etj., janë të gjitha të parashikuara dhe përshkruara detajisht në rregulloren institucionale. Pra, në këtë këndvështrim mekanik, menaxhimi duhet të jetë i njëjtë për të gjitha organizatat ose të paktën boshti i tij.

Subjektivizmi: sipas këtij aspekti, dukuritë sociale krijohen nga perceptimet dhe veprimet që rrjedhin prej tyre nga aktorët socialë. Për më tepër, dukuritë sociale janë dinamike, në sensin që përmes ndërveprimit social, dukuritë janë një gjendje të vazhdueshme ndryshimi. Në aspektin subjektiv, rolin kryesor e marrin aktorët dhe dukuritë kalojnë në plan të dytë, pra duhen studiuar paraprakisht aktorët për të kuptuar më pas dukuritë dhe jo anasjelltas, sikurse ndodhte në aspektin objektiv. Në shembullin që sollëm më lart mbi menaxhimin e kompanisë, këndvështrimi subjektiv do të konkludonte se nuk ekziston në kohë një entitet i quajtur “menaxhim”. Janë drejtuesit dhe vartësit, të cilët përmes perceptimeve dhe ndërveprimeve të tyre, formësojnë vazhdimisht menaxhimin, duke e ndryshuar pareshtur atë. Në këtë sens, subjektivizmi është organik dhe jo mekanik.

Epistemologjia: fokuson dijen që do të konsiderohet si e tillë (pra e pranueshme) në një fushë studimi. Supozojmë se një auditues performance po trajton procesin prodhues në një kompani publike. Ka dy mundësi për ta bërë këtë, në varësi edhe të prirjeve personale e formimit të vet akademik. Njëra do të ishte të mblidhte të dhëna për burimet e prodhimit: njerëz, makineri, lëndë të para, etj. T'i përpunonte, analizonte dhe të konkludonte mbi to, duke bërë edhe prezantime me tabela e grafikë. Mundësia tjetër do të ishte të fokusohet në motivimin, perceptimin, ambiciet, pra ndjenjat e punonjësve që marrin pjesë në proces. Në këtë rast, audituesi nuk mund të jetë më një “matematicien” shifrash dhe faktesh të thata numerike, por një “matematicien” fjalësh, ngjyrimesh socio-organizative dhe psiko-kulturore. Të dyja mundësitë janë njësoj autoritative dhe të besueshme, nëse cilësia e kërkimit është e lartë. Edhe në këtë shkollë filozofie kërkimore, dy janë rrymat madhore: pozitivizmi dhe interpretizmi.

Pozitivizmi: kjo rrymë aplikohet në masë nga kërkuesit e shkencave ekzakte. Prirja e audituesit në këtë rast është observimi i dukurive të matshme, parametrizimi i objektivave, përgjithësimi i konkluzioneve. Supozimi bazë i kësaj filozofie kërkimore është mos-përfshirja e kërkuesit në subjektin e kërkimit, pra ai duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm në kërkimin e tij. Si rrjedhim i këtij supozimi, studiuesi në këtë rrymë aplikon metoda kërkimi që mundësojnë ripërsëritjen e kërkimit për të testuar konkluzionet e nxjerra prej tij.

Realizmi: sipas kësaj nën-rryme, realiteti është i pavarur nga mendja njerëzore. Për nga qasja shkencore që aplikon, kjo nën-rrymë është nën-bashkësi e pozitivizmit. Vetë realizimi fragmentohet në dy forma: realizimi pranues që presupozon se bota që perceptojmë përmes shqisave është realiteti dhe realizmi kritik që supozon se perceptimet tona nuk janë realiteti i vërtetë. Nëse një realist pranues do debatonte me një kritik, argumentimi do të ishte se ato që i dyti i quan iluzione të mendjes, nuk janë veçse holograma të paplota mentale për shkak të mungesës së informacionit. Pra në sensin kritik, kalimi i informacionit ka dy nivele. I pari është realiteti, i dyti

është perceptimi që realiteti indukon në mendjen njerëzore. Në sensin pranues ka vetëm një nivel, i cili mjafton, realiteti.

Interpretizimi: bota e ekonomisë, biznesit, administratës publike është shumë komplekse. Ndryshe nga shkencat ekzakte ku ekzistojnë variabla të varur e të pavarur, në aspektin social variablat këmbajnë vazhdimisht vendet me njëri-tjetrin dhe të bësh përgjithësime në një botë të tillë do të thotë të mbi-thjeshtosh dhe reduktosh realitetin. Në këtë sfond lind dhe interpretizimi, i cili e vë theksin tek aktorët socialë dhe diferencat mes tyre. Pra është mënyra se si secili prej nesh e interpreton botën, veten e tij dhe të tjerët, që ndikon performancën personale dhe në grup. Kjo rrymë filozofike buron nga dy tradita intelektuale: fenomenologjia dhe ndërveprimi simbolik.

Kritike në interpretizëm është “qëndrimi empatik”, pra aplikimi i perspektivës së subjektit kur realizohet kërkimi-auditimi. Në fusha të tilla si marketingu, sjellja organizative dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, filozofia interpretuese është e pazëvendësueshme.

Aksiologjia: është degë e filozofisë që studion gjykimet mbi vlerat. Nëse duam që auditimi i performancës të jetë i besueshëm, vlerat që mbart audituesi që e kryen atë janë të një rëndësie të padiskutueshme. Tek e fundit janë vlerat ato që na udhëheqin në veprimet tona. Në çdo fazë të kërkimit vlerat janë të pranishme. Nëse dikush zgjedh intervistat në vend të pyetësorëve, atëherë është e qartë që ky person vlerëson ndër të tjera komunikimin interaktiv, “body language” dhe të qenit prezent. Aksiologjia është shoqëruese e të gjitha filozofive të kërkimit që një auditues mund të zgjedhë. Në mjaft raste sugjerohet që audituesi të shkruajë vlerat personale në lidhje me çështjen që auditon, përveç atyre të sanksionuara në ligj dhe rregulloren institucionale.

Tabela 1 – Krahasimi i 4 filozofive bazë të kërkimit në auditimin e performancës

	Pozitivizmi	Realizmi	Interpretizmi	Pragmatizmi
Ontologjia: këndvështrimi i audituesit mbi natyrën e realitetit	Objektiv, i pavarur, përtej subjektit nën auditim	Objektiv, i pavarur (pranues) ose i kushtëzuar (kritik)	Subjektiv, fleksibel, i shumëfishtë, i kushtëzuar.	Përtej subjektit nën auditim, në varësi të pyetjes kryesore.
Epistemologjia: këndvështrimi i audituesit se çfarë konsiderohet dije e pranueshme	Vetëm dukuritë e vrojtueshme mund të ofrojnë fakte dhe të dhëna të besueshme. Audituesi fokusohet mbi përgjithësimet, duke thjeshtuar në maksimum realitetin.	Dukuritë e vrojtueshme ofrojnë fakte dhe të dhëna të besueshme. Të dhënat e munguara apo të pamjaftueshme nënkuptojnë pasaktësi të instrumentave matës (realizmi pranues). Nga ana tjetër, dukuritë mund të maten, por keqinterpretohen (realizmi kritik). Fokusohet në shpjegimin brenda një apo disa konteksteve.	Kuptim subjektiv dhe dukuri sociale. Fokusohet në detajet e një situate, sepse “djalli qëndron në detaje”. Veprimet e subjektit motivohen subjektivisht.	Dukuritë e vrojtueshme dhe/ose qëndrimet subjektive mund të gjenerojnë dije të pranueshme, në varësi kjo të pyetjes audituese. Fokusohet në kërkimin e aplikuar (praktik), duke integruar perspektiva të ndryshme për të ndihmuar në interpretimin e të dhënave.
Aksiologjia: këndvështrimi i audituesit për rolin e vlerave në auditim	Auditimi kryhet i lirë nga vlerat. Audituesi është i pavarur nga të dhënat dhe qëndron i distancuar nga subjekti, pra është objektiv.	Auditimi është i mbarsur me vlera. Audituesi priret nga opinioni, kultura dhe eksperiencat e mëparshme. Në mënyrë implicite apo eksplicite, auditimi do të ndikohet nga to.	Auditimi është i kufizuar nga vlerat. Audituesi aplikon këndvështrimin e subjektit e për pasojë do të jetë subjektiv.	Vlerat luajnë një rol të rëndësishëm në interpretimin e rezultateve. Audituesi do të adoptojë këndvështrime objektive, sikurse dhe subjektive.
Teknikat audituese më shpesh të përdorshme	Thelësisht i strukturuar, kampionim në sasi të mëdha, matje dhe parametrizim, sasior dhe shumë pak cilësor.	Në varësi të subjektit apo temës audituese. Sa cilësor aq edhe sasior.	Kampionim në sasi të vogla, intervista, cilësor.	Metoda mikse dhe të shumëfishta. Sasior dhe cilësor.

Prokurimet publike dhe pajtueshmëria me ligjin e prokurimeve

*Prof. Dr. Vjollca **IBRAHIMI**, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës*

*Msc. Anxhela **ÇELA***

*Kand. ne Dok. Msc. Elton **KARAPICI**, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektor Kontrolli, Tatim Paguesit e Mëdhenj*



*Prof. Dr. Vjollca **Ibrahim***



*Msc. Anxhela **Çela***

Abstrakt

Dekada e fundit ka dëshmuar një revolucion global masiv në prokurimin publik në shumicën e vendeve qofshin këto të zhvilluara si dhe të pazhvilluara. Gati një dekadë pas ligjit të prokurimit publik ka ende sfida me të cilat përballet procesi i prokurimit. Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit adresuar sfidave, monitorimi efektiv dhe vlerësimi i aktiviteteve të prokurimit në entitetet publike si edhe aplikimi i sanksioneve për të ndëshkuar sjelljet joetike dhe ndërhyrjet politike në proceset e prokurimit, do të përmirësojë nivelin e pajtueshmërisë me ligjet.

Qëllimi i kësaj kumtese është të vlerësojë procesin e prokurimit në sektorin publik, të vërehej nëse procesi i prokurimit publik arrin performancën e dëshiruar, duke pasur pajtueshmëri me ligjin e prokurimeve. Kumtesa përmbledh karakteristikat e prokurimeve publike që çojnë në pajtueshmërinë e tyre me ligjin e prokurimeve dhe auditimin e tyre. Një mostër prej 55 të anketuarish u përdor për kumtesën, ku mjetet kryesore të përdorura për mbledhjen e të dhënave ishin pyetësorët dhe intervistat. Kumtesa zbulon se ligji i prokurimit publik dhe auditimi i prokurimeve publike, kanë pasur sukses në harmonizimin e procesit të prokurimit në subjektet publike duke siguruar transparencën fiskale, efikasitetin, konkurrencën. Megjithatë sfida e krijimit

të strukturave të prokurimit dhe rekrutimi i personelit të përshtatshëm për të menaxhuar procesin e prokurimit kufizon qëllimin për eficiencë dhe vlerën e parasë.

Hyrje

Gjatë dekadave të fundit, prokurimi publik ka fituar shumë vëmendje në vendet në zhvillim. Buxheti i prokurimeve në vendet në zhvillim përbën rreth 20% të shpenzimeve qeveritare në nivel global (Milinga, 2009). Shumë qeveri kanë nisur reformat në sistemet e tyre të prokurimit për të modernizuar dhe harmonizuar kuadrin ligjor dhe institucional.

Përmirësimi i sistemit të prokurimit publik do të ndikojë ndjeshëm në ekonominë shqiptare, e cila do të rezultojë në kursime dhe eficiencë të shpenzimeve buxhetore qeveritare duke krijuar pasuri dhe reduktuar varfërinë. Përpjekje të vazhdueshme bëhen për të rregulluar dobësitë e procesit të prokurimit publik me anë të instrumentave financiare dhe ligjore. Në vitin 2006 qeveria miratoi ligjin për prokurimet publike i cili më pas u pasua nga ndryshime dhe udhëzime të ndryshme. Të gjitha këto ligje, dekrete dhe instrumente kanë për qëllim të sigurojnë një kuadër të plotë të kompetencave administrative për të rregulluar veprimtaritë e prokurimit brenda sektorit publik.

Megjithatë, shqyrtimi i vazhdueshëm i procesit të prokurimit publik zbuloi mungesë thelbësore të eficiencës, korrupsion dhe mungesë të transparencës në procesin e prokurimit të institucioneve publike si rezultat i kuadrit ligjor të paqartë dhe mungesës së procedurave të harmonizuara dhe rregulloreve. Kishte mungesë në zhvillimin e kapaciteteve të praktikuesve të prokurimit dhe mungesë të karrierës së tyre në prokurimet publike. Kjo çoi në mos arritjen e vlerës së parasë në procesin e prokurimeve. Nuk ishte nevoja për të shqyrtuar në mënyrë kritike proceset dhe procedurat e prokurimit të sektorit publik për të siguruar efikasitetin operacional dhe kapacitetet institucionale për të adresuar çështjet e prokurimit.

Kjo kumtese shqyrton çështjet e mëdha të përfshirë në prokurimin publik dhe analizon pajtueshmërinë e procesit të prokurimit me ligjin dhe rregulloret në fuqi. Objektivi kryesor i kësaj kumtese është vlerësojë nivelin e pajtueshmërisë me ligjin prokurimeve nga subjektet publike. Për të arritur këtë qëllim, objektivat specifike u realizuan në këto drejtime: vlerësimi i strukturave dhe procedurave të prokurimit publik, përcaktimi i shkallës së pajtueshmërisë me ligjin e prokurimeve nga subjektet publike, identifikimi i faktorëve që ndikojnë pajtueshmërinë, përcaktimit të shkallës në të cilën zbatimi i reformave në prokurimin publik, do të ndikojë performancën e subjekteve.

1. Objekti, rëndësia dhe modeli i prokurimeve publike

Objekti i reformave të prokurimit është të harmonizojë proceset e prokurimit në institucionet publike për të siguruar një përdorim të zgjuar, ekonomik dhe efikas të burimeve shtetërore në prokurimin publik dhe të sigurojë që prokurimi publik është kryer në mënyrë të drejtë, transparente dhe jo-diskriminuese, duke promovuar një industri konkurruese lokale. Megjithatë disa gjetje në lidhje me parregullsitë në proceset e prokurimit janë ngritur kundër subjekteve publike dhe aktorëve të tjerë të përfshirë direkt ose indirekt në prokurimin. Këto akuza përfshijnë paaftësinë, vonesën në prokurim për shkak të proceseve të gjata të prokurimit, kosto të lartë të projekteve, mungesën e drejtësisë, transparencës dhe jo-diskriminimit në zgjedhjen dhe dhënien e kontratave qeveritare, si dhe ekzagjerim të kontratave. Subjektet publike janë përballur edhe me çështje të tjera të prokurimit siç janë profesionalizmi, mundësitë e kufizuara për zhvillim të karrierës për stafin e prokurimit në sektorin publik dhe menaxhimin e dobët të kontratës.

Rëndësia e prokurimit publik nuk mund të anashkalohet duke pasur parasysh angazhimin e madh financiar që është përfshirë në procesin e prokurimit. Prokurimi publik si blerja e mallrave, punëve dhe shërbimeve nga organet publike është parë veçanërisht e prirur për korrupsion dhe si një zonë me rrezik për praktika biznesi jo të

ndershme të tilla si konflikti i interesit, favorizimi dhe korrupsioni (Ireland Environmental Protection Agency, 2013; Krivinsh and Vilks, 2013). Për këtë arsye, nevoja për të vënë masa që sigurojnë se prokurimi publik sjell përfitime maksimale për publikun nuk mund të anashkalohen.


Auditimi i aktiviteteve të prokurimit është identifikuar si një nga mjetet për ta bërë prokurimin publik që të arrijë pritjet e dëshiruara (Mapesa dhe Kibua, 2006). Auditimi është një mënyrë për të përcaktuar nëse kriteret e vendosura janë plotësuar, përmes mbledhjes dhe vlerësimit të provave të mjaftueshme (Abdolmohammadi dhe Thibodeau (2007). Auditimi i prokurimit publik për këtë arsye mund të shpjegohet si procesi i përcaktimit nëse kriteret e vendosura të prokurimit publik janë përmbushur dhe rezultatet e pritshme të prokurimit janë arritur ose do të arrihen. Prokurimi publik është procesi me anë të të cilit organizatat sigurojnë mallrat, punimet dhe shërbimet duke përdorur fondet publike. Prokurimi është një proces gjithë përfshirës që fillon nga planifikimi i duhur i prokurimit, përcaktimi i buxhetit, ftesa e ofertave, vlerësimi i ofertave, bërja e kontratës, menaxhimi i kontratës, matja e performancës, monitorimi, auditimi dhe raportimi.

Weele (2010) ka përshkruar dhe grupuar procesin e prokurimit në gjashtë faza të ndryshme që specifikohen si zgjedhja e furnizuesit, dhënia e kontratës, porosia, zhvillimi dhe vlerësimi i tërë procesit të prokurimit. Monczka, Trent dhe Handfield, (2003) argumentojnë në të njëjtën linjë si Weele por e paraqesin procesin e prokurimit si cikli me pesë faza në vend të gjashtë. Këto faza do të ndryshojnë sipas natyrës së prokurimit dhe kërkesave individuale të organizatës. Emmett and Crocker (2008) sugjeroi se prokurimi ose procesi i prokurimit ka dhjetë faza nga identifikimi deri te pagesa e prokurimit përkatës. Ndodh kështu sepse organizatat kombinojnë disa faza në një për të reduktuar kohën e procesit dhe kosto të tjera administrative. Bazuar në këto fakte nuk ka numër unik të fazave të procesit të prokurimit. Shumica e autorëve në këtë fushë bien dakord se disa nga fazat nuk do të shfaqen në çdo aktivitet prokurimi disa nga këto faza do të hiqen nëse kemi një porosi që përsëritet.

Lyson dhe Gillingham, (2003) dhe Weele, (2010) paraqitën një mënyrë modern të kryerjes së aktivitetit të prokurimit duke përdorur mënyrën elektronike. Ata sugjeruan se procesi i gjatë mund të shkurtohet përmes përdorimit të prokurimit elektronik.

Modeli i procesit të prokurimit tregon hapat e ndryshme dhe fazat e veçanta që një aktivitet prokurimi ndjek në përmbushjen e kërkesave operationale. Këto faza kanë veprime të detajuara të cilat duhet të bëhen para se të përparojmë në fazën e ardhshme. Emmett dhe Crocker (2008), argumentojnë se modeli tradicional i prokurimeve për shumicën e sektorëve përshkruhet si në *figurën 1*. Baily (2005), është i mendimit se cikli i mësipërm nuk ka njohur kontributin strategjik të prokurimit modern që tregon aspektin taktik të funksionit.

Figura 1: Modeli i procesit të prokurimit



Burimi: Emmert dhe Crocket 2008

2. Auditimi i prokurimeve publike

Auditimi i prokurimit publik mund të shpjegohet si procesi i mbledhjes dhe vlerësimit të provave të mjaftueshme për aktivitetet e prokurimit të qeverisë për të verifikuar nëse procedurat e përcaktuara janë përmbushur apo jo. Auditimet e prokurimit publik janë parë si shumë të rëndësishme për realizimin e kësaj vlerë të prokurimit të qeverisë në drejtim të sigurimit të llogaridhënies, transparencës, parandalimit të praktikave të parregullta të prokurimit, dhe përmirësimit të performancës të prokurimit.

Një auditim efektiv i prokurimeve është një faktor vendimtar për qeverisje më të mirë të fondeve publike. Funkzioni i auditimit ka objektiv kryesor të japë siguri të arsyeshme se një grup i kriterëve të caktuara dhe të përcaktuara janë përmbushur dhe përfshin mbledhjen dhe vlerësimin e provave të mjaftueshme për të përcaktuar nëse një pohim përputhet me kriteret e përcaktuara. Objektivi kryesor për auditimin e prokurimeve publike është që të sigurojë që aktivitetet e prokurimit janë bërë në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike në kuadër të dispozitave, ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve. Një proces i auditimit të prokurimeve përfshin një sërë aktivitetesh duke përfshirë: një rishikim dhe vlerësim të plotë të politikave publike të prokurimit, procedurat dhe operacionet, dokumenteve të kontratës dhe raportet; intervistimi i personave që janë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit; mbajtja e diskutimeve me konsulentët e kontraktuar; informacioni i marrë analizohet dhe raportohet. Në dokumentin "Standardet e Auditimit të Qeverisë" përshkruhen procedurat e auditimit të mëposhtme si udhëzuese për auditimin e prokurimit publik si: Kontrolli i regjistrave kontabël; Shqyrtimi i dosjeve dhe dokumenteve; Vëzhgimi dhe inspektimi në vend; Kontrollimi nëse dispozitat ligjore përkatëse janë përmbushur.

Objektivat e përgjithshme të auditimit të prokurimit që synohen të arrihen mund të ndahen në katër kategoritë e mëposhtme:

- *Strategjike.* Arritja e qëllimeve të nivelit të lartë që mbështesin vizionin dhe misionin.
- *Operacionale.* Zbatimi etike, ekonomike, eficient dhe efektive i operacioneve të prokurimeve publike dhe mbrojtja e fondeve publike nga humbja për shkak të abuzimit, keqmenaxhimit, gabimeve, mashtrimeve dhe parregullsive të tjera.
- *Raportimi.* Zhvillimi dhe mirëmbajtja e menaxhimit të besueshëm të informacionit të prokurimit dhe raportimi i këtij informacioni në kohë, duke përmbushur obligimin e llogaridhënies.
- *Pajtueshmëria.* Të sigurojë se aktivitetet e prokurimit dhe proceset janë në përputhje me ligjin, udhëzimet dhe dokumente të tjera që rregullojnë fushën e prokurimit publik.

Proçesi i auditimit të prokurimit duhet domosdoshmërisht të përfshijë 4 hapat e mëposhtëm:

1. *Planifikimi i auditimit të njësisë që auditohet.* Një angazhim auditimi ka të bëjë me kontrollin dhe përfshin të gjitha punët e ndryshme të auditimit që duhet të kryhen për të përfunduar auditimin. Aktiviteti më i rëndësishëm i çdo auditimi është planifikimi. Sa më i mirë të jetë planifikimi aq më i saktë dhe efektiv do të jetë auditimi. Audituesi duhet të planifikojë kontrollin në një mënyrë, e cila siguron që një kontroll me cilësi të lartë kryhet në mënyrë ekonomike, efektive, eficiente dhe në kohën e duhur.

2. *Vlerësimi i rrezikut për të përcaktuar objektivin e auditimit dhe fushëveprimin.* Menaxhimi i riskut është një kërkesë thelbësore e sistemeve moderne të prokurimit. Mund të përkufizohet si një proces i identifikimit të rrezikut, vlerësimit të tij dhe marrjes së masave për të zvogëluar këtë risk në nivele të pranueshme. Në çdo vlerësim të gjendjes së sistemit të prokurimit domosdoshmërisht do të duhet të studiohet politika e administrimit të riskut e miratuar nga organi publik. Ekziston nevoja për auditim të detajuar dhe testim të hollësishëm, kur vlerësimi i riskut është i lartë dhe menaxhimi i tij është dobët. Një analizë e pavarur e riskut nga audituesi, jo

vetëm ndihmon identifikimin e fushave që do të shqyrtohen, po edhe përcakton objektivat e auditimit dhe mbështetjen e vendimeve të auditimit të bazuar në risk.

3. Përcaktimi i objektivave të auditimit dhe i fushëveprimit. Në bazë të vlerësimit të riskut dhe vlerësimit të kontrollit të sistemit të prokurimit të zgjedhur për auditim, përcaktohen objektivat e auditimit. Këto objektiva duhet gjithashtu të marrin në konsideratë objektivat e menaxhimit të entitetit për një sistem prokurimi. Edhe pse përcaktimi i qartë i objektivave është i domosdoshëm për fillimin e auditimit është e nevojshme të kuptojmë se gjatë auditimit këto objektiva mund të pësojnë modifikime apo zhvillime të mëtejshme. Fushëveprimi përcakton kufijtë e auditimit. Përcaktimi i fushëveprimit të auditimit është pjesë e planifikimit të auditimit. Ajo trajton aspekte të tilla si periudha dhe numrin e testeve të pavarur në varësi të nivelit të rrezikut dhe kontrollit të dobët. Shtrirja e auditimit mund të ndryshojë gjatë procesit të auditimit.

4. Ekzekutimi i auditimit. Arsyja themelore për kryerjen e auditimeve përfshirë edhe auditimin e prokurimeve publike është që të verifikohet se matësat e performancës janë brenda parametrave standarde. Arsyje të veçanta për auditimin e prokurimit publik janë: parandalimi i mashtrimit, të japë siguri në lidhje me efektivitetin dhe eficiencë e operacioneve, të sigurojë raportim financiar të besueshëm, të sigurojë pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat, të adresojë korrupsionin dhe të parandalojë gabimet në të ardhmen (Wayne State University, 2014; Petrovits, Shakespeare dhe Shih, 2009; Krivinsh dhe Vilks, 2013). Për më tepër, prokurimet publike auditohen për të verifikuar nëse ka pasur një nevojë reale për një prokurim të caktuar, nëse procedura e prokurimit ka arritur vlerën e parasë dhe për të vlerësuar nëse rregullat e prokurimit publik janë respektuar.

3. Metodologjia e përdorur në rastin studimor

Kumtesa fillon me prezantimin e popullsisë, teknikat e kampionimit si dhe procedurat e analitike. Kumtesa më tej trajton prezantimin e të dhënave të mbledhura, teknikat,

instrumentet për mbledhjen e të dhënave dhe burimet e të dhënave. Kumtesat merr në konsiderate të gjitha palët e interesuara në prokurimin publik. Popullsia e hulumtimit përkufizohet si tërësia e individëve apo objekteve që kanë karakteristika ose tipare të përbashkëta. Popullsia në këtë kumtese përbëhet nga të gjithë ata që janë të përfshirë në aktivitet e prokurimit publik. Arsyeja kryesore për përdorimin e kësaj kategorie të njerëzve është se aktivitet e tyre direkte ose indirekte kanë influencë në prokurimet publike. Madhësia e mostrës prej 55 njerëzve u konsiderua e përshtatshme dhe përfaqësuese për kumtesën. Target grupi i synuar i kumtesës janë institucionet lokale qeveritare, arsimore dhe shëndetësore që përfaqësojnë aktivitetet e prokurimit.

Metodat e mbledhjes së të dhënave, formon një pjesë të rëndësishme të këtij hulumtimi. Sipas Patton (2002) përdorimi i më shumë se një instrumenti për të mbledhur të dhënat forcon dhe i jep kredibilitet punimit. Përdorimi i më shumë se një instrument të mbledhjes së të dhënave paraqet një tablo të vërtetë të çështjes në shqyrtim. Për këtë arsye ne mblodhëm të dhëna nga dy burime të ndryshme. Në kumtese u përdoren burime të të dhënave primare dhe sekondare për të mbledhur informacionin e duhur. Instrumentet kryesore të hulumtimit të përdorura ishin pyetësorët, intervista dhe vëzhgimet në terren. Kjo është bërë duke pasur në fokus objektivat e vendosura në studim. Të dhënat primare janë mbledhur nga të anketuarit e përzgjedhur brenda kornizës së mostrës në popullatën e hulumtimit, ku u bazua kryesisht analiza e kumtesës. Për të mbledhur të dhënat sekondare i kemi referuar publikimeve të ndryshme me origjinë të huaj dhe vendore, libra, revista, artikuj, gazeta, raportet e marra nga biblioteka, entet publike, dhe internet, si dhe në subjekt për të marrë informacion shtesë për t'iu përgjigjur pyetjeve të përcaktuara në përkufizimin e problemit.

Pyetjet e hulumtimit janë zhvilluar nga ne dhe janë shqyrtuar nga disa ekspertë të fushës dhe që kanë eksperiencë me prokurimet. Më pas një test pilot i pyetësorit u krye për të identifikuar dhe eliminuar dykuptimësitë potenciale në pyetësor. Në

përgjithësi, pyetësi është projektuar për të mbledhur të dhëna të përgjithshme nga subjektet publike. Këto pyetje janë grupuar në kategori për të mbledhur të dhëna mbi natyrën e sistemeve të prokurimit, shkallën e pajtueshmërisë, si dhe efektin e reformave të prokurimit publik për subjektet. Strategjia e zgjedhur në këtë hulumtim është përcaktuar duke marrë parasysh tre kushte: llojin e pyetjeve kërkimore, kontrollin e studiuesit mbi ngjarjet aktuale të prokurimit publik dhe shkalla e vëmendjes në ngjarjet bashkëkohore. Kështu për tu përgjigjur bindshëm pyetjeve nën hetim në këtë studim është e nevojshme të merren prova relevante për të provuar pajtueshmërinë e prokurimeve publike me ligjin.

Në këtë studim të dyja metodat sasiore dhe cilësore janë përdorur në analizën e të dhënave. Përgatitja e të dhënave ishte hapi i parë për të kthyer të dhënat bruto në një format më të përshtatshëm për analizën. Të dhënat e mbledhura janë analizuar duke përdorur modele të ndryshme sasiore statistikore të tilla si tabelat, grafikët, për të ilustruar rezultatet.

Një nga problemet me të cilat u përballim gjatë hulumtimit ka qenë çështja e ndershmërisë dhe përgjigjeve të vërteta dhe të detajuara nga pjesëmarrësit. Shumica e pjesëmarrësve, të cilët punojnë në sektorin publik nuk dëshironin të japin identitetin e tyre dhe mendonin se përgjigjet që ata ofronin mund të përdoren kundër tyre. Ne mposhtëm këtë problem duke mos përmendur emrat e tyre ose duke u përpjekur për të mos ditur identitetin e tyre. Një tjetër problem i hasur ishte vështirësia në të pasur akses në institucione sepse shumica e të punësuarve nuk duan të flasin publikisht. Koha dhe mungesa e burimeve financiare ishin ndër të tjera probleme të hasura në hulumtim.

Ashtu si edhe çdo hulumtim tjetër, kumtesa nuk është pa kufizime dhe këto janë:

1. Hulumtimi është bërë vetëm në një qytet dhe gjetjet nuk mund të jenë një reflektim i drejtë apo përfaqësues i subjekteve publike në të gjithë vendin.

2. Kumtesa përdor një pyetësor me pyetje të mbyllura për mbledhjen e të dhënave dhe kjo çon në kufizimin e të dhënave të mbledhura. (Ka mundësi që të dhënat përkatëse mund të mos janë kapur për shkak të përdorimit të pyetësorit të mbyllur).

3. Periudha kohore e kufizuar dhe burime e faktorë të tjerë të hulumtimit (të tilla si fondet) janë të kufizuar.

Pavarësisht nga këto kufizime, rezultatet e kesaj kumtese janë menduar si provokimin dhe mund të konsiderohen si një bazë për punë më të detajuar dhe analitike në kumtesa të tjera në të ardhmen.

4. Analiza e të dhënave të rastit studimor

Mbledhja e të dhënave për këtë studim është përqendruar në institucionet publike të qytetit të Lushnjës ku përfshihen institucionet shëndetësore, arsimore, pushteti lokal etj. Kjo është bërë kryesisht për të vlerësuar shkallën e përputhshmërisë me ligjin të prokurimeve publike nga institucionet publike në këtë qytet. Është e nevojshme të marrim në konsideratë çështjet që shqetësojnë punën dhe sfidat me të cilat përballen subjektet publike duke analizuar të dhënat e mbledhura në terren me ndihmën e pyetësorëve dhe intervistave.

Një numër i përgjithshëm prej 55 pyetësorë janë shpërndarë në institucionet publike nga të cilat vetëm 41 janë marrë si të vlefshëm për analizën e të dhënave. Këto pyetësorë të vlefshëm të përdorur për analizën e të dhënave përbëjnë 74.54% të normës së përgjigjeve. Kjo tregon se shkalla e përgjigjeve është relativisht e lartë dhe pasqyron pikëpamjet e të gjithë popullsisë.

Seksioni 1: Niveli i pajtueshmërisë me ligjin

1.1 . Transparenca në prokurimet publike

Transparenca shërben si pasqyrë për procesin e prokurimit publik me qëllim që të rrisë besimin e krijuar.

Tabela 1.1- Vlerësimi i transparencës në prokurimet publike

Vlerësimi	1	2	3	4	5	Totali	Mesat
-----------	---	---	---	---	---	--------	-------

	Frekuenca						arja 2.5
	10	7	9	9	6	41	
Mundësitë e prokurimit reklamohen duke përdorur median e duhur	10	7	9	9	6	41	2.85
Hapja publike e dokumenteve të tenderit	20	12	5	3	1	41	1.85
Postimi në Website i të gjitha ofertave	17	5	1 0	4	4	41	2.39
Monitorim dhe auditim efektiv i aktivitetit të prokurimeve	15	10	1 0	3	3	41	2.24


Burimi: pyetësi për prokurimet publike, korrik, 2014

Me anë të kësaj pyetje kërkohet të gjejm nëse të njëjta rregulla zbatohen për të gjithë furnizuesit e mallrave, shërbimeve, punëve dhe nëse këto rregulla janë publikuar në bazë të vendimeve të prokurimit. Vlerat nën mesatare të treguesve tregojnë një nivel të ulët të kënaqësisë. Analizat tregojnë një përpjekje për të rritur transparencën duke përdorur mjetin e duhur të reklamimit e cila ka një vlerësim mbi mesatare me 2.85. Bërja publike e dokumentave të tenderit ka vlerësimin më të ulët me 1.85 që tregon se të anketuarit bien dakord që nuk ka transparencë maksimale ndaj publikut. Gjithashtu të anketuarit kanë dhënë një vlerësim nën mesatare me 2.24 për monitorimin dhe auditimin e aktivitetit të prokurimeve publike. Për këto arsye pyetjes nëse ka transparencë në procesin e prokurimeve publike të anketuarit kanë dhënë këto rezultate.

Figura 1.2- Transparenca në procesin e prokurimeve publike

A ka transparencë në procesin e prokurimit

■ asnjëherë ■ në disa raste ■ në shumicën e rasteve ■ gjithmonë




Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

Të anketuarit janë përgjigjur se nuk ka asnjëherë transparencë në rreth 19% të rasteve, me 17% se ka transparencë në disa raste, 37 % kanë vlerësuar se ka transparencë në shumicën e rasteve dhe 27 % janë përgjigjur se ka gjithmonë transparencë.

Figura 1.3- Vlerësimi i përgatitjes së dokumenteve të tenderit

Si e vlerësoni përgatitjen e dokumentave të tenderit



Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

Vihet re se pyetjes se si e vlerësonin përgatitjen e dokumenteve të tenderit u janë përgjigjur me një vlerë 12% se e vlerësonin shumë dobët, vetëm 29% e vlerësojnë mirë dhe 20 % shumë mirë. Kjo mund të ndikohet edhe nga fakti se rreth 30% e të anketuarve shprehen se në subjektet e tyre nuk përdoren gjithmonë dokumentet standarde edhe pse kjo është e parashikuar në ligj dhe kërkohet të zbatohet nga subjektet me qëllim që të rritet transparenca, e cila do të ndikojë në rritjen e besimit nga palët e interesuara. Ndër problemet që hasen më shpesh është se dokumentet nuk janë të plota.

1.2 . Efienca dhe vlera e parasë

Kërkimi ka për qëllim të gjejë nëse entitetet publike janë të shqetësuar për të ushtruar detyrën e tyre në mënyrë efikase për të arritur vlerën e parasë në praktikat e prokurimit publik.

Tabela 1.4- Vlerësimi i efektivitetit dhe vlera e parasë

Vlerësimi	1	2	3	4	5	Tot	Mes
	Frekuenca						2.5
Ka eficienc në procesi e PP	22	13	3	1	2	41	1.73
Shfrytëzim i mirë i fondeve nga SPP	19	11	5	4	2	41	2
Menaxhim efektiv i kontratës	17	14	4	4	2	41	2.024
Projektet që zhvillohen janë efektive	21	15	3	2	0	41	1.66
Projektet përfundojnë në kohë dhe nuk tejkalojnë kostot	25	14	2	0	0	41	1.44


Burimi: analiza e pyetësorit korrik, 2014

Të gjitha aspektet e përshkruara në tabelën 1.4 tregojnë një mosaprovim dhe një pakënaqësi në terma individual. Me një rezultat të ulët prej 1.73 për faktin nëse ka efikasitet në prokurimet publike tregon një mospajtim të anketuarve. Gjithashtu rezultati 2 tregon se nuk ka një përdorim efektiv të fondeve publike. Me një rezultat mesatar 2.024 dhe 1.44 tregon respektivisht se nuk ka një menaxhim efektiv të kontratës dhe projektet nuk janë përfunduar në kohën e përcaktuar dhe brenda

kostos. Të anketuarit gjithashtu nuk pajtohen me faktin se arrihet vlera e parasë. Analiza tregon se efienca dhe vlera e parasë nuk arrihen. Duhet të specifikohet blerja efiçente në mënyrë që subjektet të jenë proaktive në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tyre. Kjo mund të arrihet vetëm nëse subjektet janë përfaqësuar nga personel kompetent, të aftë për të vënë ligjin e prokurimeve në praktikë dhe të arrihet efiçenca dhe vlera e parasë. Rezultatet e mësipërme lidhen edhe me pyetjet rreth vlerësimit të tenderave dhe faktit nëse ky vlerësim bëhet nga persona përgjegjës dhe kompetent, të cilave të anketuarit i kanë dhënë përgjigjet e mëposhtme.

1.3. Vlerësimi i ofertave

Figura 1.5- Si është cilësia e vlerësimeve të tenderave




Burimi: analiza e pyetësorit korrik, 2014

Siç vihet re në figurë të anketuarit vlerësojnë me 42% se vlerësimi i ofertave është i dobët dhe vetëm 12% e vlerësojnë atë si shumë të mirë. Të anketuarit shprehen se duke qenë se shpesh dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe me mangësi çon në vonesa të procesit të vlerësimit të ofertave. Gjithashtu një problem tjetër është se duhet përzgjedhur gjithmonë oferta me çmimin më të ulët por jo gjithmonë kjo ofertë plotëson gjithmonë kushtet e cilësisë që kërkohen nga subjekti.

1.4 . Vlerësimi i tenderit nga persona kompetent

Figura 1.6- Vlerësimi i tenderit nga persona kompetent




Burimi: analiza e pyetësorit korrik, 2014

Rezultatet e mësipërme tregojnë një mungesë të eficiencës në prokurimet publike e cila vë në dilemë nëse vlerësimi i tenderave dhe i tërë procesi i prokurimit bëhet nga persona kompetent dhe të aftë për të kryer detyrën e tyre. Siç shihet nga të dhënat e grumbulluara nga përgjigjet e të anketuarve 54% e tyre janë përgjigjur se vlerësimi nuk bëhet nga persona kompetent. Të anketuarit bien dakord se stafi i prokurimit nuk ka aftësitë dhe eksperiencën e duhur për të arritur eficiencën në procesin e prokurimit. Në qoftë se e lidhim analizën dhe me dy pyetjet e fillimit, të gjithë të anketuarit kishin mbaruar arsimin e lartë dhe rreth gjysma e tyre, kishin më shumë se 5 vjet në këtë pozicion pune por asnjë prej tyre nuk kishte specializim në prokurimet publike.

1.5. Vlerësimi nëse ka vonesa në procesin e prokurimit

Figura 1.7- Vlerësimi nëse ka vonesa në procesin e prokurimit



Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014


Siç vihet re edhe nga analiza e këtij grafiku shohim se të anketuarit kanë vlerësuar në shumicën e rasteve ka vonesa në procesin e prokurimit, e cila ndikon edhe në efikasitetin e procesit të prokurimeve. Ato kanë vlerësuar se në 49% të rasteve ka gjithmonë vonesa në procesin e prokurimit dhe vetëm në 5% të rasteve janë shprehur se nuk ka vonesa.

1.6. Konkurrenca dhe barazia

Në këtë seksion analizojmë nëse subjektet publike demonstrojnë barazi. Sa nga ato janë duke inkurajuar pjesëmarrje të subjekteve në procesin e prokurimit përmes transparencës dhe bashkëveprimit me sektorin privat, për ta bërë atë konkurrues në procesin e prokurimeve.

Figura 1.8- Konkurrenca dhe barazia në prokurime

A është rritur nr i kompanive që konkurojne në prokurimet publike




Burimi: pyetësi për prokurimet publike, korrik 2014

Konkurrenca e drejtë dhe barazia janë kërkesa të ligjit që lejojnë që më shumë kompani të konkurojnë në projektet e prokurimit dhe të sigurojnë konkurueshmëri në tendera. 61% e të anketuarve janë përgjigjur që numri i kompanive është rritur. Kjo tregon se reformat në fushën e prokurimeve publike rritin konkurrencën dhe bashkëpunimin e bizneseve lokale me biznese të tjera për të konkurruar për kontratat.

1.7. Pajtueshmëria me ligjin e prokurimeve

Agjencia e prokurimit publik është krijuar nga ligji i prokurimeve publike për të siguruar performancën që çdo entitet do të arrije në përputhet me ligjin e prokurimeve. Kjo pyetje e kumtesës ka për synim të vërtetojë nëse subjektet përputhen me ligjin dhe rregullimet për prokurimet.

Figura 1.9- Shkalla e pajtueshmërisë me ligjin e prokurimeve




Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

Siç tregohet në figurën 1.9 të anketuarit mendojnë se subjektet publike veprojnë në përputhje me ligjin e prokurimeve publike në rreth 66% të rasteve. Subjektet aplikojnë metodat e duhura të prokurimit. Ato përdorin në shumicën e rasteve dokumentet standarde të tenderit siç tregohet edhe në këtë grafik.

1.8. Dokumentat e tenderit

Figura 1.10- Përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit




Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

Të anketuarit kanë konfirmuar se vetëm në 2.4% e subjekteve nuk përdorin dokumente standarde të tenderit kurse në 68% të rasteve ata janë shprehur se dokumentet standarde përdoren shpesh ose gjithmonë.

1.9. Planifikimi i prokurimeve publike

Figura 1.11- Planifikimi vjetor i prokurimeve publike dhe postimi i tyre në faqen e internetit



Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

Me një % prej 64 tregohet mosaprovimi i të anketuarve për një planifikim vjetor të prokurimeve publike dhe postimin e këtij plani. Subjektet publike e fillojnë procesin e tyre të prokurimit si kërkesë kur prokurimi është bërë (që është reaktiv dhe jo proaktive) kështu do të rezultojë në dështimin për blerjen e mallrave/shërbimeve në koha e duhur. Është e qartë, se edhe pse procesi mund të jetë i gjatë vonesa në prokurim është si rezultat i gabimeve në menaxhimin e prokurimit dhe jo e vështirësive në Ligjin e Prokurimit. Kjo mbështetet edhe nga World Bank Country Portfolio Performance Review (CPPR), 2010 e cila shprehet se, arsyeja e vërtetë e vonesave në prokurimet publike i atribuohen gabimeve administrative brenda subjekteve se sa ligjit të prokurimit. Pajtueshmëria me ligjin e prokurimeve është e rëndësishme për individët që merren me prokurimet publike në kryerjen e detyrave të tyre.


Seksioni 2: Auditimi i prokurimeve publike

1. Frekuenca e auditimit

Të gjithë të anketuarit treguan se aktivitet e tyre të prokurimit janë audituar. Vërehet se auditimet e këtyre institucioneve bëhen një herë në vit. Megjithatë, auditimet e

brendëshme dhe auditimet e veçanta janë kryer edhe kur është e nevojshme. Për këto të dhëna i referohemi grafikut të mëposhtëm, i cili është rezultat i analizës së të dhënave të mbledhura nga pyetësi.

Figura 1- Frekuenca e auditimit



Burimi: pyetësi për prokurimet publike, korrik 2014

2. Arsyet për auditimin e prokurimeve publike

Tabela 2- Arsyet për kontrollet e Prokurimit Publik

	Frekuenca	%
Për të konstatuar nëse ndiqet një proces i rregullt	7	17.1
Përmirësim i kontrollit të brendshëm	1	2.4
Promovimi i integritetit dhe llogaridhënies	5	12.2
Të sigurojë që procedurat e ndjekura sigurojnë efikasitet dhe vlerën e parasë	12	29.3
Të zbulojë dhe parandalojë mashtrimet me prokurimet	16	39.0
	41	100.0

Burimi: pyetësi për prokurimet publike, korrik 2014

Duke ju referuar tabelës 2 vëmë re se të anketuarit kanë dhënë një numër arsyesh pse auditimet e prokurimeve janë kryer. Të anketuarit janë përgjigjur në 39% të rasteve se arsyeja e auditimit është të zbulojë dhe parandalojë gabimet dhe mashtrimet në prokurimet publike.

3. A janë identifikuar probleme nga auditimi në procesin e auditimit

Figura 3- Identifikimi i problemeve gjatë procesit të auditimit

A janë identifikuar probleme gjatë auditimit




Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

Nga analiza vëmë re se në 54% të rasteve të auditimit janë gjetur problem dhe mashtrime në procesin e prokurimeve publike. Duke ju referuar edhe grafikut më poshtë, vëmë re se në 73% të rasteve këto gabime janë rregulluar.

4. Marrja e masave korrigjuese

Figura 4- Marrja e masave korrigjuese


A merren masat korrigjuese



Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

5. Kompleksiteti i procedurave të auditimit

Figura 5- Kompleksiteti i procesit të auditimit



Burimi: pyetësori për prokurimet publike, korrik 2014

Subjektet e prokurimit publik do të jenë në gjendje të kryejnë aktivitetet e prokurimit në mënyrë efektive në qoftë se ato janë të njohur me procedurat e prokurimit që duhet të ndjekin. Përcaktimi i politikave dhe procedurave të prokurimit janë shpesh baza e përdorur nga audituesi, për të verifikuar dhe kontrolluar aktivitetet e prokurimit publik të subjekteve. Treguesi se procesi i auditimit të prokurimit është i lehtë dhe i thjeshtë për tu kuptuar nënkupton se, të anketuarit kuptojnë se si procesi i prokurimit duhet të bëhet në mënyrë më të përshtatshme. Kjo më tej sugjeron se shkëlqja e rregullave të prokurimit mund të jetë nga arsye të tjera dhe jo prej injorancës. Nga përgjigjet e ofruara shumica e të anketuarve 51.2% janë të mendimit se procesi i auditimit të prokurimit është i thjeshtë dhe i lehtë për t'u kuptuar.

Konkluzione dhe rekomandime

Kumtesa zbuloi se subjektet e prokurimit publik kanë përkrahur në masë të madhe dispozitat e ligjit të prokurimeve dhe kërkesat e tjera ligjore.

1. *Strukturat dhe procedurat e prokurimit.* Ligji i prokurimeve specifikon ngritjen e strukturave të prokurimit që do të mbështesin dhe të forcojnë zbatimin dhe mbikëqyrjen e funksioneve të prokurimit. Kumtesa konstatoi se këto struktura sidomos njësia e prokurimit nuk ekziston në shumicën e subjekteve ose nuk performojnë, duke mos kryer siç duhet funksionet e tyre. Edhe pse shumica e

personelit në këto departamente kanë bërë disa trajnime të shkurtra në fushën e prokurimit, ata nuk kanë ekspertizën teknike për të ekzekutuar aktivitetet e prokurimit në mënyrë efikase dhe efektive për të rritur vlerën në para.

2. Përdorimi i procedurave të papërshtatshme të prokurimit. Është zbuluar se disa njësi ekonomike përdorin procedura prokurimi të papërshtatshme. Këto institucione nuk përdorin dokumentet standarde të tenderit. Disa njësi ekonomike nuk reklamojnë prokurimet dhe të tjerët nuk ndjekin procedurat e vlerësimit. Disa njësi ekonomike nuk arrijnë gjithashtu të postojnë tenderët e tyre dhe dhënien e kontratave në faqen e internetit të APP-së, edhe pse ata janë trajnuar se si të postojnë këto dokumente.

3. Subjektet publike supozohet se duhet të përgatisin dhe dorëzojnë planet vjetore të prokurimit. Këto plane duhet të postohen edhe në faqen e internetit. Në kumtesë vërtetojmë që kjo kërkesë nuk plotësohet dhe nuk përputhet me ligjin. Njësitë ekonomike kanë dështuar edhe në postimin e kontratave fituese.

4. Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të prokurimit nuk ka qenë efektive gjatë viteve. Theksi vihet në hapjen e tenderit, monitorimin dhe vlerësimin vjetor të prokurimit. Kjo ka potencial që subjektet të abuzojnë me procesin. Duke pasur parasysh që është rritur numri i subjekteve që konkurrojnë për prokurimet, ka konfidencë më të madhe dhe besim në institucionet e prokurimit publik në procesin e prokurimeve.

5. Nga analiza e të dhënave të të intervistuarve, asnjë prej punonjësve nuk ka specializime në prokurimet publike. Edhe pse shumica e këtyre praktikuesve të prokurimit kanë marrë trajnim të shkurtër (1-3 ditë), kjo ka pak ndikim në aktivitetet e prokurimit. Periudhat e trajnimit janë shumë të shkurtra dhe janë shumë teorike. Mungesa e zhvillimit të karrierës dhe pagave të ulëta të stafit të subjekteve publike janë dekurajim për të tërhequr personel të kualifikuar në subjektet publike. Rezultati ishte se korrupsioni ka zënë rrënjë në mesin e stafit të prokurimit në rajon. Prandaj ka sfida të shumta profesionale në zbatimin e reformave të prokurimit publik.

6. Të dhënat e mbledhura tregojnë se shumë subjekte përzgjedhin ofertat duke u bazuar vetëm në çmimin e tyre. Përzgjedhja e furnizuesit dhe kontraktuesit nuk e konsideron cilësinë e punës, angazhimin e kaluar, kushtet e pagesës, dhe kapacitetin organizativ. Kjo e kufizon fushëveprimin për efikasitetin dhe vlera për para në dhënie të kontratave. Vlerësimi i tenderit është i bazuar në çmimin më të ulët në vend të çmimit më të ulët të vlerësuar, që do të thotë se, nuk merr në konsideratë cilësinë e llogarisë, mënyrën e pagesës, periudhën e dërgesës, çmimin dhe aftësitë e burimeve financiare dhe teknike të ofertuesve.

7. Kumtesa konfirmon se subjektet publike kanë një nivel pajtueshmërie mbi 50% me ligjin e prokurimeve. Megjithatë kjo arritje nuk është pa sfida. Ajo varet nga dobësitë dhe kërcënimet e sektorëve të ndryshëm. Në kërkim të përmirësimit të pajtueshmërisë së subjekteve publike duhet të vendosen strukturat e kërkuara dhe të angazhohen profesionistë për të menaxhuar ato.

Proçeset e përfshira në auditimet e prokurimit të identifikuar në këtë studim, duken mjaft reaktive në vend që të jenë zbuluese dhe parandaluese. Nga anketimi përgjigjet e dhëna nuk tregojnë masa për verifikimin e kontratave nga audituesit për vlerësimin e drejtësisë para se kontratat janë dhënë. Duhet të rritet vlerësimi periodik i rreziqeve që lidhen me kontratën e prokurimit për të parandaluar humbjet dhe duhet fuqizimi i njësive të auditimit të brendshëm, për të miratuar mjete krijuese të zbulimit dhe parandalimit të mashtrimeve të prokurimit, abuzimit, parregullsitë dhe shkeljet e rregulloreve. Mënyra më e mirë e auditimit të prokurimeve është duke parandaluar parregullsitë e prokurimit në vend të raportimit të tyre. Teknikat e auditimit duhet të shqyrtohen vazhdimisht për të verifikuar nëse qëllimet e synuara janë arritur në mënyrë efektive dhe efçente. Këto teknika duhet të jenë një hap përpara për të zbuluar mashtruesit e prokurimit, mashtruesit me ofertat, ata që angazhohen në konflikt interesi, dhe praktika të tjera korruptive me prokurimet. Kjo do të rrisë efikasitetin, efektivitetin në procesin e prokurimit, integritetin dhe

përgjegjësitë, si dhe do të sigurojë taksapaguesit se paratë e tyre po shpenzohen në mënyrën më të mirë në interes të publikut

Referenca

1. *Baily et- al (2005) procurement principles and management 9th Edition: Person Education Limited, England.*
2. *Emmet and Crocker (2008) Excellence in Procurement. Cambridge Academic: Gt. Sheldford, Cambridge.*
3. *Ēeele Van J.A 2010 procurement and supply chain management, 5th Edition Cengage: learning, Singapore.*
4. *Ligj Nr.9643, datë 20.11.2006, Për prokurimin publik.*
5. *Vendim Nr. 1, më datë 10.01.2007 Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.*
6. *Ahmed,S., & Mahmood, I. (2010) Publik procurement and corruption in Bangladesh confronting the challenges and opportunities, Journal of publik administration and policy research Vol. 2(6) pp. 103-111.*
7. *Mlinga, R. (2009). Promoting integrity in publik procurement. Tanzania Procurement Journal, Vol. II No. 5, pp. 13-39.*
8. *Organization for Economic Committee Development/Development Assistance Committee (DAC)/ Ēorld Bank (2005), Guidelines and Reference Series. A DAC Reference Document Harmonizing Donor Practices for Effective Aid Delivery, Version 3: Strengthening Procurement Practices in Developing Countries.*
9. *Schapper, P. Veiga, Malta, & Gilbert, D.L. (2006) An analytical frameëork for the management and reform of publik procurement, Journal of publik procurement, vol. 6 No 1-2, pp 1-26.*
10. *Schapper, P.R., (2008). The impact of e-procurement on corruption: The potential of e-procurement for curbing corruption risks.*
11. *Abdolmohammadi, M.J. and Thibodeau, C.J. (2007) "Auditing", in Kaliski, B.S.(ed.) Encyclopedia of Business and Finance.2nd edn.*

Raportimi financiar në evoluim të vazhdueshëm

Përgatitur nga Prof. Dr. Jorgji BOLLANO

Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit

jorgji.bollano@kkk.gov.al



Në këtë kumtesë do të përpiqem të trajtoj disa probleme që kanë të bëjnë me raportimin financiar pa neglizhuar dhe problemet për auditimin, probleme që nuk janë trajtuar ose janë trajtuar jomjaftueshëm në konferencën e vitit të kaluar.

Kuadri konceptual për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare hartuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, përcakton se objektivi i pasqyrave financiare është t'u japë një gamë të gjerë përdoruesish, informacion rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të parasë të njësisë ekonomike. Ky informacion që japin pasqyrat financiare, ndihmon përdoruesit e tij të marrin vendime ekonomike më të drejta.

Fillimisht rregullimet lidhur me raportimin financiar kanë qenë me karakter lokal, pra çdo vend kishte rregullimin e tij duke siguruar kështu që të gjitha njësitë ekonomike të paraqesin pasqyrat e tyre financiare në një mënyrë të përcaktuar e cila ndër të tjera siguron edhe krahasueshmërinë. Ndërsa më vonë në epokën e tendencës drejt globalizimit u paraqit ndjeshëm nevoja për një krahasim në shkallë ndërkombëtare të pasqyrave financiare.

Me qëllim që të zbutet, apo më mirë akoma, të shuhej diferenca në raportimin financiar të njësive ekonomike në vende të ndryshme, nga organizmat ndërkombëtar

si Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në cilësinë e hartuesit ndërkombëtar, u hartuan standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, SNK / SNRF -të.

SNRF-të janë konsideruar nga ekspertët dhe profesionistët si një përfshirje e parimeve të përgjithshme të kontabilitetit, vlerësimit të elementeve të pasqyrave financiare dhe teknikave të raportimit financiar. SNRF-të si një set standardesh të mbështetura në parime, përmbledhin një sërë parimesh të gjera si parimet e njohjes, të matjes, të ç'regjistrimit, të paraqitjes në pasqyra dhe të shënimeve shpjeguese. Më shumë se 100 vende të botës raportojnë sipas SNRF-ve. Këto standarde sot shërbejnë si një gjuhë e vetme e unifikuar e raportimit financiar të cilat mund të interpretohen me lehtësi dhe në mënyrë të arsyeshme nga përdoruesit e pasqyrave financiare.

Megjithëse një set standardesh shumë i njohur dhe i pranuar në tregun global, vende të tilla si SH.B.A dhe Japonia akoma ngurojnë t'i përdorin ato në përgatitjen e pasqyrave financiare. Këto dy shtete kanë bërë përpjekje të vazhdueshme përmes bordeve të tyre standard hartues për të konverguar standardet e tyre lokale të kontabilitetit me SNRF-të.

Përfitimi kryesor i standardeve të mbështetura në parime është se ofrojnë për përdoruesit një udhëzues të gjerë dhe të përdorshëm në situata të ndryshme. Këto standarde u lejojnë kontabilistëve të ushtrojnë gjykimin e tyre profesional lidhur me thelbin e transaksionit dhe nuk ka një listë rregullash për t'u ndjekur si në rastin e standardeve të mbështetura në rregulla.

Evoluimi i standardeve të kontabilitetit

Gjatë vitit 2013, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, si i vetmi organizëm që ka detyrën dhe përgjegjësinë për hartimin e standardeve të kontabilitetit, vendosi t'i rishikojë këto standarde me synim përmirësimin e tyre. Varianti i SNK-ve mbi të cilat SKK-të e 2008 ishin hartuar, ishte ai i vitit 2002 dhe prej atij viti SNK-të kishin pësuar shumë ndryshime. Për më tepër, SNK-të janë hartuar për njësitë me përgjegjësi publike që

do të thotë se nuk përfshihen në përgjithësi njësi ekonomike të vogla dhe të mesme. Pjesë e diskutimeve për përmirësimin e SKK-ve ishte dhe objektivi i Shqipërisë për hyrje në BE që nënkupton një përputhje më të mirë të legjislacionit vendas me atë të BE. Në këtë kontekst standardet duheshin përmirësuar për të përfshirë në to kërkesat e Direktivës 34/2013/EU, kryesisht ato lidhur me paraqitjen e pasqyrave financiare.

Gjithashtu dhe evoluimet e tregut dhe biznesit shqiptar e bënë të domosdoshëm një rishikim të standardeve për të mundësuar zgjidhje të situatave të reja të krijuara. Me besimin se periudha e njohjes me SKK-të ekzistuese kishte mbaruar dhe se përgatitësit e pasqyrave financiare tashmë kishin njohuri të mjaftueshme për zbatimin e SKK-ve, u gjykua që përmirësimet e mundshme të standardeve për arsyet e mësipërme do të thitheshin lehtësisht nga përgatitësit e PF të njësive ekonomike dhe përdoruesit e informacionit financiar.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit vendosi që përmirësimet e SKK-ve të bëheshin me objektiv harmonizimin më të mirë të kërkesave të këtyre standardeve të përmirësuara me kërkesat e SNRF për NVM. Ky i fundit është standard i hartuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit me fokus njësitë e vogla dhe të mesme pa përgjegjësi publike. Ndërsa përsa i përket përmirësimin të SKK 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare” si objektiv ishte harmonizimi i këtij standardi me Direktivën e re për kontabilitetin, 34/2013/EU. Pjesë e përmirësimin të SKK-ve është dhe plotësimi i tyre me udhëzuesin për zbatim dhe bazën e konkluzioneve për përmirësimet e bëra. SKK e përmirësuara pasi u hartuan nga KKK, u shpallën të detyrueshme për zbatim nga Ministri i Financave. Këto standarde do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2015. Ndryshimet më të rëndësishme të standardeve të përmirësuara janë:

- Prezantohet koncepti i “Të ardhurave gjithëpërfshirëse”;
- Formatet e reja të pasqyrës së pozicionit financiar dhe performancës financiare;
- Nuk përdoret më metoda e vlerës së drejtë për vlerësimin e mëpasëm të instrumenteve financiare;

- Shpenzimet e zhvillimit trajtohen si shpenzime periudhe;
- Kostot e huamarrjes për AAM trajtohen vetëm si shpenzime periudhe;
- Njohja e menjëhershme e grandit si e ardhur nëse granti nuk ka kushte ose me plotësimin e kushteve, kur granti shoqërohet me kushte të caktuara;
- Standardi “Tatimi mbi fitimin” bëhet i detyrueshëm dhe zbatimi për herë të parë bëhet në prospektivë. Humbjet e akumuluar nuk zbriten në periudhat pasardhëse;
- Prezantohet i ri përkufizimi i monedhës funksionale dhe mjedisit primar ekonomik;
- Shtohen paragrafë për modelin e vlerësimit me vlerë të drejtë të aktiveve biologjike;
- Përveç sa më sipë, ka dhe ndryshime të tjera jo thelbësore, të cilat nuk janë mbajtur në konsideratë.

Edhe direktiva e re e kontabilitetit në BE është përfshirë në kuadrin tonë të raportimit financiar për aq sa i takon pjesës së kërkesave lidhur me paraqitjen e pasqyrave financiare. Të rejat që sjell kjo direktivë krahasuar me dy direktivat e mëparshme që u shfuqizuan prej saj, janë bërë pjesë e ndryshimeve të pritshme të ligjit për kontabilitetin.

Si konkluzion mund të thuhet se sistemi kontabël i një vendi përcaktohet nga mjedisi ku ai zhvillohet. Një nga pikëpamjet më të hasura në literaturë është ajo që pohon se kontabiliteti dhe raportimi financiar janë të dyja funksione të karakteristikave të mjedisit të brendshëm kombëtar.

Në të vërtetë literatura sugjeron se ka një numër faktorësh të mjedisit të jashtëm apo influenca të tjera ndërkombëtare që kanë ndikuar kontabilitetin dhe shënimet shpjeguese të vendeve të caktuara në zhvillim. Në kushtet kur vendi ynë synon të nxisë investimet vendase dhe të huaja, pra hapjen e tregjeve për investime dhe financime të huaja, është domosdoshmëri rritja e transparencës, krahasueshmërisë dhe vërtetësisë së informacionit. Të ndikuar më së shumti nga faktorë të jashtëm,

por edhe në kushtet e një eksperience në rregullimet e ekonomisë së tregut, Shqipëria e ka të domosdoshme ndjekjen e modeleve më të mira ndërkombëtare të raportimit financiar.

Një hap i parë ishte orientimi drejt standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të njësive ekonomike të vogla dhe të mesme. Ndërsa hapi i dytë i reformave në fushën e kontabilitetit ishte harmonizimi me Direktivën e kontabilitetit të BE. Megjithatë paraqitja e njëjtë e pasqyrave financiare me vendet e tjera evropiane dhe harmonizimi i pjesës më të madhe të politikave kontabël me ato ndërkombëtare, mbetet gjithësesi vetëm fillimi i procesit të transpozimit të kuadrit ndërkombëtar të raportimit financiar. Ndërhyrjet edhe amendimet e ligjit për kontabilitetin do të jenë hapi i tretë drejt harmonizimit të politikave kontabël dhe shënimeve shpjeguese të njësive ekonomike vendase me ato të vendeve të tjera të Evropës.

Përmirësimi në vetvete është një proces dinamik që do të thotë se gjithçka e bërë deri më sot është vetëm fillimi i të nesërmes. Përditësimi i vazhdueshëm i kuadrit të raportimit financiar në vendin tonë me të rehat më të fundit që ndodhin qoftë në nivel evropian qoftë në nivel ndërkombëtar, si dhe përshtatja e këtij kuadri raportimi me kulturën e përdoruesve të pasqyrave financiare dhe nivelin e edukimit të profesionistëve të praktikës, mbeten një sfidë për t'u përballur me sukses nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Mbi Auditimin

Është një e vërtetë e pamohueshme që si profesion i ri tek ne, auditimi ka arritjet e veta pozitive të cilat mund të referohen më tej në këtë Konferencë, nga ata që e drejtojnë ose e ushtrojnë këtë profesion. Unë do të përqëndrohem tek disa probleme që kanë të bëjnë me auditimin e jashtëm (të pavarur) dhe sidomos do të ndalem tek auditimi ligjor. Këto kanë të bëjnë:

- Me subjektet që auditojnë
- Me përmbajtjen e raportit të auditimit
- Kujt i shërbejnë

- Me kryerjen e shërbimeve të tjera nga audituesit
- Me kontrollin e cilësisë

Po ndalem fillimisht tek problemi i parë, ai i kritereve sasiorë që përcaktojnë detyrimin për auditimin. Sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, neni 41 i tij, përcaktohen personat juridikë që detyrohen për auditim ligjor të pasqyrave financiare. Sipas këtij neni subjekte të detyruara janë:

- Të gjitha shoqëritë tregtare të cilat zbatojnë për raportim financiar SNRF-të;
- Të gjitha shoqëritë aksionare të cilat zbatojnë për raportim financiar SKK-të;
- Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të cilat zbatojnë për raportim financiar SKK-të dhe në mbyllje të periudhës kontabël tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- Totali i aktiveve të bilancit arrin ose tejkalon shumën 40 milion lekë, rreth 285 mijë euro;
- Shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose kalon shumën prej 30 milion lekë, rreth 214 mijë euro;
- Ka mesatarisht 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Po t'i krahasojmë me vendet e rajonit dhe vendet e BE ku shpresojmë të anëtarësohemi, kemi:

Vendet e rajonit

Kosova	Nr. i punonjësve	Qarkullimi vjetor	Totali i aktiveve
Njësitë ekonomike të mëdha që plotësojnë dy nga tre kriteret	> 50	> 4 milion euro	> 2 milion euro
Njësitë ekonomike të mesme që	10 - 50	> 2 milion euro	1 - 2 milion euro

plotësojnë dy nga tre kriteret			
--------------------------------	--	--	--

Mali i Zi

Kriteret sipas Direktivës evropiane

Serbi

Njësiti e mesme	50 - 250	2.5 - 10 milion euro	1 - 5 milion euro
Njësiti e mëdha	Kur tejkalojnë dy nga kushtet e të mesmeve		

Vendet e BE	Nr. i punonjësve	Qarkullimi vjetor	Totali i aktiveve
Franca	> 50	> 1.55 milion euro	> 3.1 milion euro
Greqia	> 50	> 5 milion euro	> 2.5 milion euro
Belgjika	> 50	> 7.3 milion euro	> 3.65 milion euro
Gjermania	> 50	> 8.8 milion euro	> 4.4 milion euro
Italia	> 50	> 8.8 milion euro	> 4.4 milion euro

Nga pasqyra e mësipërme rezulton që tek ne kriteret e vendosura janë shumë të ulta pasi variojnë me 7 deri 20 herë më pak. A duhet të ndryshojnë këto kritere tek ne?

Për mendimin tim duhet të ndryshojnë sepse:

1. Auditimi ka një kosto jo të vogël për njësiti ekonomike;
2. Pasqyrat financiare të audituara nuk merren shumë parasysh nga dy përdoruesit kryesorë si bankat dhe tatimet, me arsyetimin se nuk kanë besueshmëri.

Mendoj që kriteret fillimisht të ndryshojnë si më poshtë:

- Numri i punonjësve të jetë mbi 50;
- Qarkullimi vjetor mbi 1,5 milion Euro;

- Aktivitetet e bilancit mbi 1 milion Euro.

Sot janë mbi 2,200 njësi ekonomike që auditohen nga 212 auditues. Duke rritur kriteret, numri i subjekteve që auditohen do të ulet ç'ka do të thotë mundësi për një auditim më cilësor, njëkohësisht lehtësohet barra financiare për njësitë ekonomike.

Problemi i dytë që ngre në këtë kumtesë është përmbajtja e raportit të auditimit.

Përmbajtja e raportit të auditimit dhe dhënia e opinionit përcaktohet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Mirëpo çfarë vërehet në praktikën e përgjithshme është që në opinion audituesit i referohen vetëm SNA 200, sipas së cilës objektivi i një auditimi të PF është t'i japë mundësi audituesit të shprehë një opinion se PF janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar. Ndërsa po t'i referohemi SNA 250 "Marrja në konsideratë e ligjeve dhe rregulloreve në një auditim të pasqyrave financiare" qëllimi i këtij standardi është të përcaktojë procedurat themelore dhe të japë udhëzimet mbi përgjegjshmëritë e audituesit, gjatë auditimit të pasqyrave financiare, lidhur me verifikimin e zbatueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera rregullatore nga njësia ekonomike.

Po në këtë standard jepen udhëzime për audituesin që për një planifikim të mirë, duhet që më parë të arrijë të kuptojë kuadrin ligjor dhe rregullues të zbatueshëm për njësitë ekonomike, sektorin e veprimtarisë së saj si dhe mënyrat si e zbaton njësia ekonomike këtë kuadër.

Në një paragraf të veçantë të këtij standardi flitet për tërheqjen nga angazhimi "Audituesi mund të arrijë në konkluzionin se tërheqja nga angazhimi përbën domosdoshmëri kur njësia ekonomike nuk ndërmerr veprime rregullatore, të cilat audituesi i konsideron të nevojshme për rrethanat madje edhe kur moszbatimi ligjor dhe aktet e tjera rregullatore nuk është material për pasqyrat financiare".

Në SNA 250 jepen shembuj të informacioneve që mund të tërheqin vëmendjen e audituesit të cilat mund të tregojnë se kemi të bëjmë me mosrespektim të ligjeve dhe akteve të tjera rregullatore siç mund të përmendim disa prej tyre:

- Investigimet nga departamentet qeveritare ose pagesat e gjobave apo të penaliteteve;
- Blerjet me çmime që dukshëm janë mbi apo nën çmimet e tregut;
- Pagesat pa kontrollin e duhur të shkëmbimit të dokumenteve;
- Transaksionet e paautorizuara ose transaksionet e regjistruara në mënyrë të papërshtatshme;
- Komentet e Medias.

Problemi i tretë që kam hasur është se kujt i shërbejnë këto raporte të auditimit. Gjatë punimit të kësaj kumtese munda të shoh disa raporte të auditimit të pavarur dhe disa raporte të audituara nga KLSH, për subjekte që auditohen nga të dyja palët (IEKA dhe KLSH). Nga kqyrja e tyre kam vërejtur se:

- KLSH kryen auditimin duke u përqëndruar në zbatimin e ligjeve dhe rregullave e kështu nuk angazhohet mjaftueshëm të vlerësojë besueshmërinë e pasqyrave financiare;
- Audituesit e IEKA gjithë vëmendjen e tyre e përqëndrojnë tek pasqyrat financiare duke anashkaluar zbatimin e ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Madje kam hasur gjatë ballafaqimit të raporteve të auditimit, që këto palë auditojnë të njëjtin subjekt, për të njëjtën periudhë dhe nuk i referohen raporteve të njëri tjetrit për t'u thelluar dhe saktësuar problemet e hasura nga njëri tjetri. Këtë fakt e vë në dukje më shumë për njësitë ekonomike të tipit sipërmarrje publike. Nga një evidencë që kam, janë mbi 50 njësi ekonomike publike nga të cilat 36 auditohen nga të dyja palët. Më poshtë po listoj disa nga këto subjekte, sipas informacionit që e kam marrë nga Buletini nr 2 i KLSH, për vitin 2014.

Shkelje me dëm ekonomik

1. Në fushën e prokurimeve

K.E.SH sh.a	9.155.000 lekë
Autoriteti Portual Durrës sh.a	8.489.000 lekë
Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a	2.840.000 lekë
Autoriteti i Aviacionit Civil	300.000 lekë

2. Në fushën e shpenzimeve operative

K.E.SH sh.a	2.637.000 lekë
Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a	7.963.000 lekë

3. Në fushën e Pagave

K.E.SH sh.a	34.356.000 lekë
Autoriteti Portual Durrës	271.000 lekë

4. Në fushën e Shpërblimeve

K.E.SH sh.a	1.939.000 lekë
-------------	----------------

5. Në mungesën e materialeve

Autoriteti i Aviacionit Civil	544.000 lekë
Autoriteti Portual Durrës	937.000 lekë

6. Të tjera shkelje të disiplinës financiare

Autoriteti Portual Durrës	112.077.000 lekë
K.E.SH sh.a	5.797.000 lekë

Vetëm këto fakte mjaftojnë për të argumentuar atë që përmenda më lart.

Në këtë kontekst ngre një pyetje shumë të diskutueshme: Mirë audituesit e IEKA nuk i shikojnë materialet e KLSH (që për hir të vërtetës kjo duhet të ndodhë dhe pse mund të hapë shumë punë) po audituesit e KLSH pse nuk i shikojnë raportet e audituesve të IEKAs?

Audituesit e KLSH me shumë seriozitet duhet t'i shohin këto raporte jo vetëm si një pikë referimi për shqyrtimin e disa probleme të konstatuara por dhe si vlera materiale për auditimin, ashtu si dhe pagesat e tjera në vlera të mëdha, pasi vlerat e pagesave për këto shërbime auditimi që kryejnë njësitë ekonomike publike janë të konsiderueshme.

Pa u ndalur më gjatë në këtë çështje, sepse së pari nuk jam këtu për të bërë një analizë të punës së IEKA apo KLSH, dhe së dyti sepse jam i bindur që mesazhi u përcoll qartë për të dyja palët, dua të kaloj në një tjetër çështje që e konsideroj me interes pasi përbën një konflikt interesi.

I referohem këtu faktit që audituesit ofrojnë shërbime kontabiliteti në njësitë ekonomike që nuk auditojnë. Pavarësisht këtij lejimi me kusht, për hir të së vërtetës, këtu jemi në kushtet e konfliktit të interesit për sa kohë komuniteti i audituesve shkëmben mes njëri tjetrit pasqyrat, ato për të hartuar me ato për të audituar. Ekziston një tjetër profesion i mirëfilltë që e zgjidh këtë situatë problematike. Janë kontabilistët e miratuar ata që hartojnë pasqyra e më pas audituesit kanë misionin e tyre për dhënë një siguri të arsyeshme tek palët e treta për besueshmërinë e këtyre pasqyrave.

Dhe së fundi dua të ndalem tek problemi i kontrollit të cilësisë. Auditimi si profesion nuk do të mund të rritet dhe të konsolidohet nëse nuk bëhet një reformë e thellë e që fillon me përgatitjen dhe vazhdon me trajnimet, testimet dhe kontrollin e cilësisë së dosjeve të auditimit. Viti 2014 ishte viti i parë i testimit të KM dhe EKR ku rezultatet ishin shumë të ulta, jo më shumë së 7-8% e atyre që hynë në provim mundën t'i përfundojnë me sukses ato. Theksoj se ky ishte viti i parë kur ndryshoi rregullorja e çertifikimit dhe u hartua një tezë e nivelit pasuniversitar.

Rezultati i provimeve tregoi sa të domosdoshme dhe të drejta gjithashtu ishin ndryshimet në rregulloren e çertifikimit dhe sa të dobta në të njëjtën kohë ishin trajnimet e organizuara nga shoqatat profesionale. Mendoj se reforma e filluar nga

çertifikimi duhet të vazhdojë me kontrollin e cilësisë së auditimeve nga vetë IEKA dhe sidomos nga Bordi i Mbikqyrjes Publike

Në fund të kumtesës desha të jap dhe disa rekomandime të cilat shpresoj se do të mbahen në konsideratë nga të gjitha palët e interesuara:

1. Audituesit e pavarur të IEKA's në punën e tyre duhet të mbajnë parasysh të dy standardet e auditimit, SNA 200 dhe SNA 250;
2. Audituesit e pavarur të IEKAs dhe audituesit e KLSH duhet jo vetëm të njohin raportet e njëri tjetrit por dhe t'i shfrytëzojnë ato duke i konsideruar si informacione plotësuese shumë të vlefshme;
3. Me qëllim që të ulët kosto e shërbimit të auditimit për subjektet publike rekomandoj që ky shërbim të kryhet vetëm nga KLSH, brenda së cilës të organizohet një njësi e posaçme me njerëz të aftë profesionalisht. Ky rregullim do të sigurojë jo vetëm besueshmërinë e çertifikimit të pasqyrave financiare por dhe cilësinë e punës;
4. KLSH dhe MZHETS mund ta diskutojnë së bashku këtë amendim të ligjit përkatës;
5. Të bëhet një riklasifikim në rritje i kufijve të njësive ekonomike që ligjërisht i nënshtrohen detyrimit për t'u audituar;
6. Shoqatat profesionale të përmirësojnë nivelin e trajnimeve jo vetëm për ata që hyjnë në profesion për herë të parë por dhe për ata profesionistë të praktikës që e ushtrojnë prej vitesh këtë profesion të nderuar.

E Drejta e Mjedisit midis të Drejtës Kushtetuese, Penale dhe asaj Administrative Rasti Auditi i Problematikave Pyjore në vend

Nga prof. asc. Sazan GURI, Ekspert mjedisi & pedagog në të Drejtën e Mjedisit;

Artan MANUSHAQE, Phd. Av.ass. Zyra Qytetare e Mbrojtjes së Mjedisit;

Msc. Marianthi GURI, Eksperte mjedisi, studio G&G Group



E Drejta e Mjedisit, sa e Drejtë Kushtetuese po aq e drejtë e njeriut

Administrimi publik mjedisor sipas ligjit ka si qëllim t'i shërbejë si qytetarisë, ashtu edhe interesit mjedisor. Prandaj, thirrja në bashkësinë ndër personale kërkon të ekzistojë realisht lidhja e së drejtës së mjedisit me të drejtën civile, me të drejtën administrative, por edhe me të drejtën penale. Në ditët e sotme ka ende shumë ekspert në fushën juridike, të cilët nuk kanë kontakte të drejtpërdrejta me të dhënat



mjedisore. Analiza mjedisore është vazhdimisht pjesë e përbashkët e një juristi dhe e një mjedisor. Kohë më parë, departamentet e tyre përkatëse, shpesh qëndronin në pozita të polarizuara, në dy kampe, të quajtura jurist dhe mjedisore. Sigurisht, të drejtat civile apo publike janë përmirësuar shumë dhe duken shumë herë më të ngjashme me ato të së drejtës së mirëfilltë ekologjike. Interpretimet juridike, së bashku me shumë teknologji të tjera, si p.sh. legjislacioni mjedisor, po përparojnë, gjithmonë në bashkësinë e një publiku më të gjerë mjedisor. Pothuajse, sot në botë, nuk ekzistojnë më mbrojtje publike apo civile, pa ndërhyrje të analizës së ngjarjeve apo çështjeve mjedisore. Drejt kësaj rruge po orientohet dhe procesi legjislativ shqiptar. Por, çfarë kërkon situata e re nga juristi, që nuk është vetëm dhe domosdoshmërisht thjesht një ekspert juridik? Detyra kryesore e një juristi, më parë ka qenë vetëm mbrojtja e së drejtave mbi kushtetutën, mbi të drejtat e njeriut dhe/ose mbi jetën civile. Kjo, jo se nuk të lejonte për t'u thelluar në njohuritë mjedisore, por mangësitë mbi shkencën e mjedisit, mbi të drejtën e mjedisit e kufizonin apo pothuaj e atrofizonin mbrojtjen e qytetarit në kësi kazuse. Kësisoj, eksperti jurist duhet të ketë njohuri mjedisore, në mënyrë që të vlerësohet potenciali i plotë i mbrojtjes së jetës së qytetarit nga pikëpamja mjedisore e shëndetësore.

E drejta mjedisore mes asaj civile, administrative dhe penale

Kjo bashkëjetesë e të drejtës së mjedisit me të drejtën civile administrative dhe penale, nuk mund të justifikohet me indiferentizëm ndaj sjelljeve të rrezikshme ndaj mjedisit. Dëmet ndaj mjedisit kryhen në shkelje të parimit të përgjegjshmërisë e të shkeljes së interesave të publikut nga subjekte të ndryshëm të shoqërisë sonë, por përderisa pas sjellin cënim të të drejtave civile të cilido shtetasi, duhet që patjetër të jenë subjekt të rregullave ligjore administrative, njëherazi, edhe të ligjit penal. Mirëpo, kushtet e së drejtës administrative, jo gjithmonë i shërbejnë të drejtës së mjedisit. Ne, duhet të kemi parasysh se, një krim mjedisor është një krim si çdo krim

tjetër, ndonëse është një krim i ri i lindur si pasojë e zhvillimit social, ekonomik dhe industrial. Për ta konsideruar atë si një krim, ne duhet të zgjerojmë përkufizimin penal për të kapur ata që e thyejnë këtë formë të re të gabimit social-ekonomik dhe industrial të krimit mjedisor, kundër shoqërisë. Në aplikim me masat penale mjedisore, ligji administrativ duhet të luaj një rol thelbësor në përcaktimin e veprave penale mjedisore. Në këto kushte, është shumë e rëndësishme që përgjegjësia penale të mos lidhet vetëm me pasojat aktuale në jetën dhe shëndetin e njerëzve, por edhe me dëmtimin apo prishjen e ekuilibrave biologjikë e natyrorë.

Krimi mjedisor, fenomen në rritje dhe kërcënim për komunitetin

Sot, përditë e më shumë po ndeshemi me lajme nga media e shkruar dhe elektronike për krimin mjedisor, gjithnjë e në rritje. Vrima e ozonit po dëmtohet, duke rrezikuar seriozisht



jetën tonë. Trafiku i paligjshëm i mbetjeve të rrezikshme nga një vend në tjetrin është kthyer në një fenomen normal, ndërsa shkatërrimi i pyjeve me zjarr nuk përbën më lajm.

Sot, në botë veprojnë aktivisht mjaft organizata ndërkombëtare lokale, rajonale e globale, të tilla si INTERPOL, Agjencia e Hetimit Mjedisor, Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara, Agjencia



Evropiane e Mjedisit, etj., të cilat ndërmarrin nisma dhe bashkëpunime për mbrojtjen e mjedisit në botë. Janë shumë vepra penale kundër mjedisit, të cilat parashikohen si kundravajtje penale, ndërkohë që për shkak të rëndësisë që ato kanë dhe të pasojave që ato sjellin, do të ishte me vend të kishte ndryshime në legjislacion për ashpërsimin e dënimeve.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme ekzistenca e një bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme për zbardhjen e këtyre veprave penale dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve, si dhe trajnimi i prokurorëve, gjyqtarëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në fushën e krimit mjedisor, në mënyrë që të specializohen për hetimin e këtyre lloj veprash penale.

Natyra i ka bërë vendit tonë dhuratë të çmuar, po njerëzit pse duhet t'i bëjnë dëm?

E Drejta Penale në mbrojtje të mjedisit

Së pari, duhet theksuar se Mjedisit natyror meriton mbrojtje të së drejtës civile, administrative dhe veçanërisht mbrojtje nëpërmjet së drejtës penale. Domosdoshmëria e kombinimit të legjislacionit në mbrojtje të mjedisit, është e lidhur me faktin që vetë jeta jonë është e ndërtuar mbi këtë mjedis. Por,



edhe të gjitha marrëdhëniet shoqërore të shtrira në planin politik, ekonomik, juridik, etj., lindin dhe zhvillohen, duke qenë të lidhura pazgjidhshmërisht me mjedisin ku jetojmë. Krimet mjedisore fusin një perspektivë krejtësisht të ndryshme në sistemin penal ligjor. Ndërsa kriminaliteti tradicional përbën një kërcënim për stabilitetin social, krimet e mjedisit nuk kërcënojnë aq shumë stabilitetin social se sa përbëjnë një kërcënim për mbijetesën e vetë qenieve njerëzore. Si rezultat, në qendër nuk është ruajtja e stabilitetit social, por mbijetesja e vetë shoqërisë. Është e rëndësishme të theksohet se krimet e mjedisit janë krime të vërteta. Ekziston një shqetësim i

madh në lidhje me natyrën kriminale të disa dëmtimeve të rënda mjedisore. Ky shqetësim pasqyron një etikë të re dhe të gjerë publike, që kërkon një përgjigje të fortë ndaj abuzimit mjedisor. Kjo është arsyeja, pse një numër i rëndësishëm vendesh kanë kriminalizuar shkelje të rënda të mjedisit, duke krijuar në këtë mënyrë një fushë të re e të specializuar, brenda sistemit të së drejtës penale, si një mënyrë për të ballafaquar dëmtimet e rënda mjedisore.

“Të mirës t’i përgjigjemi me të mirë, kurse të keqes me drejtësi”.

Krimi mjedisor, të pasurit e një ligji dhe mungesa e zbatimit të tij

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, veprave penale mjedisore u ka kushtuar një kre të veçantë. Konkretisht në kreun e katërt, duke filluar nga neni 201, parashikohen 9 vepra penale mjedisore:

1. Ndotja e ajrit, neni 201;
2. Transportimi i mbeturinave toksike, neni 202;
3. Ndotja e ujërave, neni 203;
4. Peshkimi i ndaluar, neni 204;
5. Prerja e paligjshme e pyjeve, neni 205;
6. Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë, neni 206;
7. Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, neni 206/a;
8. Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, neni 206/b;
9. Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve, neni 207.

Në pamje të parë, mund të thuhet që këto dispozita parashikojnë pak a shumë gjithçka nga ndotja si koncept. Por, këtu nuk parashikohet ndotja e tokës. E vetmja dispozitë që do të mund t’i përafrohej sadopak kësaj



mbrojtjeje do të ishte neni 199 “Shpërdorimi i tokës”, por që lidhet kryesisht me shpërdorimin e saj në kundërshtim me destinacionin e parashikuar.

E tillë figurë e veprës penale të parashikuar do të ishte, kur toka bujqësore përdoret për qëllime të tjera, si industriale apo urbanistike, pa u dhënë më parë lejet në vijim të studimeve përkatëse ose ndërtimet e paligjshme në zona bregdetare, sidomos ato që paraqesin bukuri të rrallë e që mund të quhen pa frikë si pasuri e tërë shqiptarëve, sepse ndikojnë drejtpërdrejt në të ardhurat tona kombëtare.

Të gjitha këto figura veprash penale janë dispozita “të bardha” (“blankete” siç edhe njihen nga e drejta penale).



Menaxhimi i mbetjeve.

Që prej 24 vjetësh

Djegia e plehrave prodhon furan dhe dioksinë

Kazan në anë të rrugës, pa këmbë,cila është zgjidhja për jetët

tona? A nuk kërkojnë këto auditimee?!

Nuk mund të ketë kurrsesi krim mjedisor të pashoqëruar me krime të tjera që konkurrojnë si vepra penale paralele. Të tilla do të ishin “shpërdorimi i detyrës”, “korrupsioni aktiv” dhe “korrupsioni



pasiv”, “ushtrimi i ndikimit të paligjshëm” dhe “falsifikimi i dokumenteve”, si edhe vepra të tjera penale që kryhen nga funksionarë apo njerëz në detyra shtetërore e publike.

Legjislacioni mjedisor dhe dënimet penale për shkeljet në mjedis

Vështirësitë për procedimin e veprave penale kundër mjedisit dhe numri i ulët i tyre, vijnë, ndër të tjera, si rezultat i një mos ndarje të artë në ligjin material të kundravajtjeve administrative dhe atyre penale. Nuk ka sanksione në kodin Penal për

kundravajtje penale, pra del e domosdoshme mendimi në Kodin Penal, duke transpozuar Direktivën dhe sipas vendit, duke shtuar sanksione apo duke i forcuar ato. Vendi ynë, ende nuk është bërë palë e Konventës së Këshillit të Evropës “Mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale”.

Procedime e raste të gjykuara të veprave mjedisore

Vepra penale e prerjes së paligjshme të pyjeve në periudhën 2005-2011

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Procedime të regjistruara	223	288	227	198	186	159	172

Numri total i çështjeve për periudhën 2004-2012

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Çështje të gjykuara	326	183	162	129	124	127	99	99	72

Vepra penale e prerjes së drurëve dekorativë dhe frutorë për periudhën 2008-2011

Viti	2008	2009	2010	2011
Procedime të regjistruara	8	9	8	5

Numri total i çështjeve për periudhën 2004-2012

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Çështje të gjykuara	18	0	0	0	1	1	0	3	2

Por, në bazë të të dhënave të marra nga Fondi i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për sa u përket kundravajtjeve penale gjatë periudhës 2005-2009, rezulton një tjetër tablo, me tregues më të lartë. Sipas këtyre të dhënave, gjatë pesë viteve të mësipërme janë kallëzuar 1714 kundravajtje penale, me një mesatare prej 342 çështje në vit, shifra këto që nuk përputhen me treguesit e Ministrisë së Drejtësisë, të cilat janë gati dy herë më të ulëta. Një nga arsyet e kësaj mospërputhjeje, përveç të tjerësh mund të jetë edhe fakti se çështjet e kallëzuara nuk kanë mundur të shkojnë deri në fazën e gjykimit, edhe për shkak të mos ndjekjes me profesionalizëm të kundravajtjeve penale, e sidomos zbulimit të autorëve dhe sigurimit të provave.



Rasti: audimi i administrimit të pyjeve në vend

- Gjatë sistemit të kaluar u shpyllëzuan 280 mijë ha pyje, toka buke, rreth 50 mijë ha për kullota
- polifite.
- Gjatë tranzicionit u prenë në mënyrë të pa restaurueshme edhe 100 mijë ha, në gjendje të shkatërruar zonat biokorridore të rëndësisë ndërkombëtare si:
 - Masivi PK Lurë, Dajt-Bizë-Martanesh, Bozdovec, Gërmenj-Shelegur, Riviera bregdetare, Shumica e kurorave të qyteteve.

Fondi pyjor e kullosor - në letër apo në realitet?!

- Punohet ende me kadastrën e vitit 1978 dhe pyje reale kane mbetur vetëm 400,000ha
- MM nxjerr në ankand rreth 100.000m³ dru zjarri/vit hiqen nga pyjet mbi 2,5 milionë m³ lende drusore, që shiten blihen dhe eksportohen me letrat e 100.000 m³ Jane djegur 2-3 vitet e fundit në mënyrë të pa rikthyeshme rreth 137,000ha pyje nga zjarret

A mund të “shpëtojnë” pyjet nga një moratorium?!

- Objektivat e Protokollit të Kioto-s mund të plotësohen me aktivitete pyjore, pasi në perspektivën e donatorëve, kostot për kredit karboni mund të kursehen (5€/t CO₂ ndaj 50 €/t CO₂ për proceset industriale).
- Gjatë vitit 2012 nga ana e policisë pyjore kanë rezultuar 118 kundërvajtje administrative, nga të cilat për 113 raste në pyje shtetëror, nga kjo në 64 raste në zonë mbrojtur.
- Gjatë vitit 2013 në Malin e Dajtit dhe Malin me Gropa-Bizë, nga drurët e prerë gjithsej 2,529 copë janë të mbuluar me procesverbale 376 copë dhe të pambuluar me procesverbale 2,153 copë.

Rast: Me VKM nr. 516, datë 06.07.2011 “Për heqje nga fondi pyjor e kullosor të ...

- Përcaktohet sipërfaqja që hiqet prej 27,55 ha për shkak të ndërtimit të rezervuarit & digës, si dhe 1,9 ha për ndërtim hidrocentrali.
- Është lënë detyrë që subjekti “hydro energji” sh.p.k. brenda 3 viteve të kryejë mbjelljen me fidanë të sipërfaqes prej 10ha.
- Deri në përfundim të procesit të auditimit konstatohet se nga ky subjekt nuk është mbjellë asnjë fidan.

Duke kuvenduar me pyjet

Një ndër nenet kryesorë në kushtetutën kanadeze është se nëse dikush pret një pemë i nënshtrohet një procesi gjyqësor për vepër kriminale dhe dënohesh pa avokat, në kuptimin që nuk ka avokat të të mbrojtë, dhe pretenca është e prerë, jo më pak se tre vjet heqje lirie. Ndërkohë që vendet e tjera perëndimore, e sidomos ato nordike e kanë shtrirë këtë lloj dënimi gjyqësor, edhe për rastet kur ti vret apo plagos një Ari apo një Qen.



Ndaj dhe kanë të gjitha shtetet e Evropës apo të botës, jo më pak se 60% të territorit të vendit, pyll e kullot, sikundër e kemi pasur dhe ne deri në vitet e pas luftës së dytë botërore, madje mbi 80%. Pylli, figuron në shifra zyrtare me një sipërfaqe prej 1,100,000ha që ndihmohen nga 400,000ha kullota dhe rrethohen nga

700,000ha tokë buke. Tokës i janë rrëmbyer 30% sipërfaqe për ndërtime urbane, dhe një 30% tjetër nën efektin e erozionit dhe rrëshqitjeve. Le të kthehemi o pyll i mjerë te dhimbja jote në këtë verë, që ka të ngjarë nëse vazhdojmë me këtë lloj sjellje s' do të kesh të sosur.

Qysh nga flakët e para, diku disa vjet më parë deri sot, Instituti Evropian i Zjarreve në Pyje ka matur nga ajri që ty pyll i dashur të janë shkrumbosur, jo pak, por 110,000ha (vetëm për vitin 2007, janë raportuar nga MM, 7000ha pyje të djegur në një situatë si kjo, po që më së shumti ishin kullota). Nga pyjet tanë dalin 2 milion ton dru qymyr me leje, 1 milion m³ dru që është e barabartë me aq biomasë drusore që rritet e cila do të kapte jo më pak se 1,5 milion ton CO₂. Nëse e përkthejmë në shifra financiare këtë tonazh gazi karbonik, duke e llogaritur, jo si në vendet nordike, me 70euro/ton/CO₂, as si në burse 50euro/ton, e as si në



vendet lindore me 25euro/ton-i, por le të themi 10 euro/ton-i, ne humbasim çdo vit të paktën 15milion euro që është kosto direkte mjedisore, pa folur për ato indirekte që më pastaj vijnë. 370 vatra zjarri këtë vit, filluan me kullotat përreth, e të vazhduan

mbi trungje e degë e fletë derisa u shkumbohen 37,000ha. 18 kompani të licensuara për qymyr dhe sipas rregullit të treshit 64 të tjera të paliçensuara iu duheshe post zjarrmum për katran me bojë. Nga pyjet u hoqën 500 vrojtuesit/sensorët që përbënin sistemin e paralajmërimit të hershëm për ty, u hoqën 60 foristrada, ku 10 prej tyre ishin në nivel zjarrfikësi.

Nuk kemi projekte se sa lëndë drusore duhet prerë apo nuk duhet prekur, se sa lëndë qymyrore duhet shitur dhe në ç'rast gatitet ajo, se sa dhe cilën pjesë të pyllit duhet prerë për kërnacka nga ai fshatari me lejen e Krye komunarit, apo sa duhet shitur. Parku si ai i Dajtit iu hoqën me VKM të datës 25 qershor 2009, një sipërfaqe pyjore prej 169ha. 60% të sipërfaqeve të tua po i jepen Komunave për administrim, madje do të arrijë deri në 90%. Shkolla për trajnimin e zjarrfikësve është mbyllur. 5 milion euro ishte dëmi i raportuar nga MM për vitin që shkoi. Po sivjet?! E thjesht fare. $37,000ha \times 2000 \text{ fidanë/ha} \times 2 \text{ euro/fidani zakonshëm} = 148,000,000 \text{ euro} \times 30 \text{ vjet}$ që të arrijë pjekurinë e sotme. Pse nuk krijohet një shtab me të përbashkët nga Ministria e Mjedisit, nga Ministria e Rendit dhe Ministria e Mbrojtjes. Po pse nuk më mbroni si në Francë që për një zjarr për barbecue merret leje duke paguar një taksë që nuk të leverdis kurrë? Pse nuk merren masa si në Turqi që për një zjarr me dashje apo pa dashje në pronën tënde pyll, ajo sekuestrohet nga shteti? Pse nuk merren masa si në Mal të Zi, që rrethohet pylli me një kanal ujqor? Po pse nuk bëhet si Gjermania që rrethon pyllin me një brez druri të lëngshëm? Pse nuk krijohet një Gjykatë dhe një Prokurori Mjedisore? Pse nuk hartohet një moratorium, ku për dhjet vjet, as mos të priten për kërnacka në dimër, e as mos të digjen për qymyr në verë, e as mos të kthehen për tokë urbane në vjeshtë dhe as mos të shkojnë dëm në pranverë?

Mangësitë e Kodit Penal shqiptar në fushën e mjedisit dhe nevoja për ndryshime

Është mëse e arsyeshme që në drejtim të mjedisit si interes, të bëhen përmirësime në legjislacionin shqiptar për garantimin e mbrojtjes juridike civile, administrative dhe penale, me qëllim që lidhja midis tyre të funksionojë në harmoni edhe më të drejtën e mjedisit si interes



i drejtpërdrejt i të gjithë shoqërisë. Në këtë vështrim, mund të themi se ndërgjegjja duhet të qëndrojë mbi dëshirën e njerëzve për përfitime materiale, duke shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme mjedisin. Vetë Kodi Penal ka mangësi në parashikimin e veprave penale në fushën e mjedisit. P.sh., shkatërrimi i zonave pyjore me



zjarr nuk parashikohet si një vepër e posaçme në kreun e veprave penale kundër pronës. Po ashtu, dënimet e parashikuara për disa vepra, si prerjet e paligjshme të pyjeve, ndotja e ujit dhe e ajrit, peshkimi i ndaluar janë shumë të ulëta, duke u cilësuar si kundravajtje penale, pavarësisht se dëmet që sjellin janë tepër të mëdha dhe lënë pasojë në kohë. Për sa i përket veprave që lidhen me ndotjen e ujit dhe të ajrit, kodi kërkon ardhjen e pasojave në jetën e njerëzve, ndërsa thjesht transportimi apo tranzitimi i mbetjeve toksike dhe radioaktive dënohet deri në 5 vjet burg. Këto masa dënimi janë të papërshtatshme, pasi pasojat që sjellin mbetjet toksike dhe radioaktive, apo ndotja e ujit dhe e ajrit, pavarësisht se mund të mos jenë të dukshme në një çast të parë, janë të shtrira në kohë. Në këto kushte, është shumë e rëndësishme që përgjegjësia penale të mos lidhet vetëm me pasojat aktuale në jetën dhe shëndetin e njerëzve, por edhe me dëmtimin apo prishjen e ekuilibrave biologjikë e natyrorë.

Me ligjin e ri, për importimin e mbetjeve në vendin tonë, është e domosdoshme futja e veprave penale konkrete, që lidhen me mosrespektimin e rregullave dhe të procedurave për përpunimin dhe trajtimin e këtyre mbetjeve. Shkelje të tilla nuk duhen lënë thjesht në kuadër të përgjegjësi administrative, por për to duhet të parashikohen edhe sanksione penale. Në lidhje me fushën e ndërtimit apo të shfrytëzimit të fondit pyjor ose të ujërave, Kodi Penal nuk parashikon vepra specifike, që lidhen me mos ushtrimin si duhet të detyrave nga punonjësit që kanë për detyrë zbatimin e ligjeve në këto fusha konkrete.

Në rast të mos ushtrimit të detyrës konform ligjit, Kodi Penal parashikon përgjegjësi vetëm për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo vepër, jo vetëm që është e përgjithshme dhe nuk lidhet me shkelje konkrete të punonjësve publikë, por njëkohësisht kërkon ekzistencën e disa elementëve, pa të cilët subjekti, me gjithë shkeljet që mund të ketë kryer, nuk mban përgjegjësi penale. Kjo bën që, shpesh herë, çështje të tilla të pushohen, me arsyetimin që të zgjidhen civilisht në Gjykatë dhe/ose si



shkelje administrative. Në fakt, dëmi më i madh që i vjen mjedisit lidhet pikërisht me ndërtime apo projekte, leje shfrytëzimi të burimeve tona natyrore, që jepen pikërisht nga këta punonjës publikë, duke shkelur ligjet specifike. Por, në disa raste është e vështirë të provohet lidhja shkakësore apo dashja, si element i anës subjektive të punonjësit publik, kur ka dhënë këtë leje, apo në disa raste kur bëhet fjalë për organe kolegjiale, gjë që ndihmon punonjësit të kalojnë përgjegjësinë tek njëri tjetri, duke iu shmangur të gjithë asaj. Në këtë kuptim, duhen futur vepra të posaçme ose të

shtohen paragrafë që si rrethanë cilësuese parashikojnë përgjegjësinë e punonjësve në shërbim publik për moszbatimin apo shkeljen e ligjit në dhënien e këtyre lejeve apo licencave. Kjo përgjegjësi e tyre nuk duhet të lidhet detyrimisht me ‘dashjen’, si element i anës subjektive. Mjafton që subjekti të ketë shkelur ligjin (si me dashje apo nga pakujdesia) për të mbajtur përgjegjësi. Kjo përgjegjësi penale e tyre duhet të parashikohet si paragraf më vete në secilën nga veprat e posaçme të parashikuara në Kodin Penal dhe që synojnë mbrojtjen e mjedisit, tokës, ujit, pyjeve, monumenteve me vlera kulturore, etj.

A është i ngopur qyteti ynë me ndërtime?

Po, i tejngopur e, si rezultat:

- kemi humbur më shumë se 30% të sipërfaqes së bukës;
- më shumë se 80% të sipërfaqes publike;
- më shumë se 90% të sipërfaqes së gjelbër;
- më shumë se 90% të sipërfaqeve sportive.

Problematikat kryesore të zbatimit të ligjit penal mjedisor

1. Zbatimi i ligjit penal mjedisor, nuk i përgjigjet realitetit të kriminalitetit mjedisor.
2. Treguesit e luftës për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e kriminalitetit mjedisor janë në parametra më të ulëta se ato të llojeve të tjera të kriminalitetit;
3. Zbatimi i ligjit penal mjedisor, nuk ka bërë të mundur të realizohen parimet bazë të ligjit për Mjedisin, parimi “ndotësi paguan”.
4. Si rezultat i efektivitetit të ulët të zbatimit të ligjit penal mjedisor shtetit dhe shoqërisë i janë shkaktuar dëme shoqërisht të rrezikshme, të pa kompesuara e të pa rikthyeshme.
5. Ndërsa për veprat penale tradicionale, treguesit e zbatimit të ligjit janë të bardha në të gjitha vitet.
6. Me përjashtim të strukturës së specializuar Polici Pyjore, mungojnë struktura e tjera të specializuara për parandalimin e veprave të tjera penale mjedisore

7. Në zonat urbane, ku ka ndikim të opinionit publik, veprat penale mjedisore janë në nivele më të ulëta se në ato zona rurale apo malore, ku mungojnë këta faktorë.

Shkaqet e problematikave të zbatimit të ligjit penal mjedisor

1. Mos njohja si e si duhet e veçorive të parandalimit të kriminalitetit mjedisor, nga punonjësit e strukturave përkatëse, e cila përfaqëson një teori e praktikë relativisht të re, me nocione, kategori e instrumente shkencore, profesionale e bashkëkohore.

2. Tërësia e ligjit mjedisor në përgjithësi është më e avancuar se sa ligji penal mjedisor;

3. Kapacitetet e strukturave të posaçme të luftës kundër krimit mjedisor, kanë mangësi në aspektin e aftësisimit profesional, kulturor e shkencor.

4. Policia Pyjore funksionon e fokusuar vetëm në ndjekjen e krimit tradicional, e shpesh herë kompetencat e saj përplasen me ato të Policisë së Shtetit.

5. Policia e Shtetit edhe pse me ligj ngarkohet të vlerësojë e ndjekë çdo lloj krimi, e quan veten të përjashtuar në këtë luftë.

6. Mungesa e një strukture të posaçme në Policinë e Shtetit për ndjekjen e krimit mjedisor.

7. Mungesa e zyrave të specializuar për ndjekjen e krimit mjedisor në Prokurori e Gjykata.

8. Shërbimet inteligjente shqiptare (SHISH e SHIU), nuk e vlerësojnë lidhjen e krimit mjedisor me Sigurinë Kombëtare.

9. Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellët kundër krimit mjedisor (midis MMPAU, Ministrisë së Brendshme, Pushtetit Vendor, Policisë së Shtetit, SHISH, etj), ose ka munguar, ose ka qenë në nivele formale.

10. Mungesa e strategjive dhe planeve të veprimit për parandalimin e krimit mjedisor, nuk ka bërë të mundur tërheqjen në këtë luftë të komunitetit, gjë që duket si në kallëzimet e rralla penale nga qytetarët, ashtu edhe në indiferentizmin e publikut.

11. Mos përcaktimi qartë dhe ekzaktësisht midis kundravajtjeve administrative dhe atyre penale, ka bërë që mjaft të tilla të ezaurohen si kundravajtje administrative.

12. Duke qenë se dispozitat e krimit mjedisor konsiderohet të bardha, mungesa e një sere ligjesh e aktesh nënligjore që ju referohen atyre, ka sjellë vështirësi në kualifikimin penalo-juridik të disa veprave penale mjedisore.

13. Inspektoriatet për monitorimin e veprave të reja penale mjedisore, janë ende të pa afta për t'ju kundërvënë sfidave të kohës.

Mendime për t'u marr parasys

1. Përafrimi i ligjit penal mjedisor me legjislacionin mjedisor, që konsiderohet në standarte optimale.
2. Përmirësime ligjore për vlerësimin dhe ndjekjen e krimit mjedisor në ligjet themelore të Policisë së Shtetit, SHISH dhe SHIU.
3. Ngritja e strukturave të specializuara në Prokurori, Gjykatë dhe Polici të Shtetit për ndjekjen e krimit mjedisor dhe trajnimin e personelit për të përvetësuar teorinë e praktikave bashkëkohore.
4. Kthimi i Policisë Pyjore në Inspektoriat të Pyjeve dhe ndarja e kompetencave të saj të policisë gjyqësore nga ana e Policisë së Shtetit.
5. Përcaktimi i kufijve të saktë midis kundravajtjeve administrative dhe atyre penale, duke u zëvendësuar nocioni "dëm material i lehtë" me vlerë reale konkrete material në bazë të indeksit tarifor.
6. Plotësimi sa më shpejtë i akteve ligjore e nënligjore që ju referohen veprat penale mjedisore.

Përfundime

1. Administrimi publik mjedisor sipas ligjit ka si qëllim t'i shërbejë si qytetarisë, ashtu edhe interesit mjedisor. Prandaj, thirrja në bashkësinë ndër personale kërkon të ekzistojë realisht lidhja e së drejtës së mjedisit me të drejtën civile, me të drejtën administrative, por edhe me të drejtën penale.

2. Kjo bashkëjetesë e të drejtës së mjedisit me të drejtën civile administrative dhe penale, nuk mund të justifikohet me indiferentizëm ndaj sjelljeve të rrezikshme ndaj mjedisit.
3. Vrima e ozonit po dëmtohet, duke rrezikuar seriozisht jetën tonë. Trafiku i paligjshëm i mbetjeve të rrezikshme nga një vend në tjetrin është kthyer në një fenomen normal, ndërsa shkatërrimi i pyjeve me zjarr nuk përbën më lajm.
4. Mjedisi natyror meriton mbrojtje të së drejtës civile, administrative dhe veçanërisht mbrojtje nëpërmjet së drejtës penale. Domosdoshmëria e kombinimit të legjislacionit në mbrojtje të mjedisit, është e lidhur me faktin që vetë jeta jonë është e ndërtuar mbi këtë mjedis
5. Nuk mund të ketë kurrsesi krim mjedisor të pashoqëruar me krime të tjera që konkurrojnë si vepra penale paralele. Të tilla do të ishin “shpërdorimi i detyrës”, “korrupsioni aktiv”, “korrupsioni pasiv”, “ushtrimi i ndikimit të paligjshëm” dhe “falsifikimi i dokumenteve”, si edhe vepra të tjera penale që kryhen nga funksionarë apo njerëz në detyra shtetërore e publike.
6. Vështirësitë për procedimin e veprave penale kundër mjedisit dhe numri i ulët i tyre, vijnë, ndër të tjera, si rezultat i një mos ndarje të artë në ligjin material të kundravajtjeve administrative dhe atyre penale.
7. Me ligjin e ri, për importimin e mbetjeve në vendin tonë, është e domosdoshme futja e veprave penale konkrete, që lidhen me mosrespektimin e rregullave dhe të procedurave për përpunimin dhe trajtimin e këtyre mbetjeve.

Qeverisja e mirë dhe SAI-et

Nga : Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm, ZAP



Parimet e qeverisjes së mirë duhet të aplikohen nga SAI-et duke:

- U sjellë me integritet, duke demonstruar përgjegjshmëri dhe besnikëri ndaj vlerave etike në respekt të shtetit ligjor.
- Siguruar angazhim gjithë përfshirës të të gjithë palëve të interesuara.
- Përcaktuar rezultate duke u bazuar në përfitimet e qëndrueshme ekonomike, sociale dhe mjedisore.
- Përcaktuar ndërhyrjet e nevojshme për të arritur rezultatet e synuara.
- Zhvilluar kapacitetet institucionale, përfshirë dhe aftësitë e lidershit dhe individëve brenda institucionit.
- Menaxhuar riskun dhe performancën përmes një auditi të brendshëm të fortë dhe fuqizimin e menaxhimit të financave publike.
- Implementuar praktikat më të mira të transparencës, auditimit dhe raportimit.

Një kosideratë e rëndësishme i është dhënë implementimit efektiv të parimit të pestë "Zhvillimi i kapaciteteve institucionale përfshirë dhe aftësitë e lidershit dhe individëve të institucionit" dhe se si ky parim mund të implementohet. Ky parim thekson se SAI duhet të kontribuoj në promovimin dhe implementimin e "parimeve të qeverisjes së mirë". SAI-et duhet të aplikojnë këto parime dhe "të jetojnë në mënyrën që predikojnë". Kjo të aplikohet nga çdo kush në të gjitha nivelet. Gjithësesi, ndryshimi fillon nga vetja! Duke pasur parasysh qasjen dhe ajo që është më e rëndësishmja, ne si menaxherë, duhet të jemi model.

Në duhet të stimulojmë dhe motivojmë punonjësit në vet-zhvillim, motivimin e vetes, rritjes profesionale dhe të zhvillojnë aftësitë bazë duke u bazuar në parimet e qeverisjes së mirë. Duhet të kemi një numër të madh njerëzish të motivuar, për të luftuar për institucionet tona dhe të demostrojnë atributet e përbashkëta duke përfshirë :

1. Ata duhet të jenë të vet-motivuar: Dëshira e tyre të jetë të jenë vetvetja dhe suksesi të udhëheq motivimin e tyre. Atë të jenë të shtyrë nga motivimi i brendshëm, sfidat e reja, udhëtimet dhe rezultatet- shijimi duke sfiduar veten, mësuar dhe eksploruar.

2. Ata nuk duhet të harxhojnë kohë duke gjykuar dhe bërë vërejtje suksesit dhe gabimeve të të tjerëve por të mësojnë nga ata duke i krahasuar me veten. Ata nuk duhet të harxhojnë kohën me paragjykime dhe duke përgojuar të tjerët.

3. Të jenë të përlulur: Të pranojnë që mund të kenë bërë një gabim dhe të kërkojnë falje. Të pranojnë vlerësimet e të tjerëve dhe ti pëdorin ato për të ecur në drejtimin e duhur.

4. Të shikojnë drejt pozitives: Në vend që të fokusohen në çfarë nuk është duke funksionuar dhe eksperienat e këqija ata të fokusohen tek puna dhe suksesi i tyre. Nëqoftëse ata mbikarkohen duke kryer llogaritje, ata duhet menjëherë të kthejnë faqen dhe të mendojnë për gjërat të cilat i kanë bërë mirë.

5. Të jenë autentik: Të jenë të sinqertë me vetveten pavaresisht çfarë mendojnë të tjerët - dhe mos të jetojnë për të kënaqur të tjerët.

6. Të kërkojnë sfidat: Njerëzit jashtëzakonisht të motivuar janë gjithmonë të sikletosur- ata asnjëherë nuk zgjedhin rrugën më të përshtatshme për të marrë atë që duan. Ata e nxjerrin veten nga zona e komfortit dhe çlirohen nga zërat e brendshëm që i thonë, "Ti nuk ke mundësi ta bësh këtë, ke një limit". Ata besojnë në afësitë e tyre dhe e dinë që do të arrijnë majën.

7. Vazhdojnë të mësojnë: Ata lexojnë shumë dhe janë vëzhgues brilant, gjithmonë kërkojnë për të renë, më eficienten dhe mënyrën më të shpejtë për të arritur diçka. Ata e kanë kuptuar që për tu rritur si person duhet gjithmonë të mësosh.

8. Ata e dinë se çfarë duan: Ata kanë një ide të qartë se çfarë duan dhe kush duan të bëhen. Zgjuarsia e tyre bën që të jenë të kthjellët dhe të dinë se cilat gjëra mund të shfrytëzohen dhe cilat duhet të evitohen. Motoja e tyre është " Kurrë mos thuaj kurrë" dhe " Çdo gjë është e mundur".

9. Ata nuk dorëzohen kurrë: Kur ata pengohen në pengesat proverbiale në rrugën e tyre, ata e zgjidhin problemin, vijnë me një plan, ndërmarrin një aksion dhe e kapërcejnë atë. Ata e kuptojnë që mënyra më e sigurt për të fituar një luftë nuk është të ndalen, fjalë e cila nuk është pjesë e fjalorit të tyre ose një opsion.

10. Ata nuk fajësojnë të tjerët: Ata nuk fajësojnë kurrë të tjerët për dështimet e tyre. Ata e kanë kuptuar që janë përgjegjësit kryesor të veprimeve të tyre dhe zgjedhjeve të tyre dhe asnjë tjetër.

11. Ata kërkojnë kohë për veten Ata e dinë që për të qëndruar të motivuar dhe në lojë duhet t'i kushtojnë kohë vetes. Kushtimi i kohës për veten, për ta është më e rëndësishme se sa pasja e gjërave materiale.

12. Ata e rrethojnë veten e tyre me njerëz të motivuar : Shokët e tyre janë të besuar, pozitivë, të suportueshëm dhe japin më të mirën e tyre pa kushte. Shokët e tyre i ndihojnë që ta shikojnë botën nga të gjitha anët, dhe kur është e nevojshme i ndihmojnë ata të kthehen në rrugën e duhur.

Në lidhje me atributet e mësipërme, ngrihen pyetjet :

1. Mundemi ne dhe si mund ti stimulojmë këto attribute?
2. Si mund të stimulojmë njerëzit të rrisin vet-motivimin?
3. Mundemi ne dhe si mund ti menaxhojmë situata me persona të mbimotivuar?
4. Si do ti trajtojmë këto situata të papërbalueshme me kërkesa të larta?

Shembujt u sollën në kontekstin se si Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës ka lehtësuar rritjen e motivimit të stafit. Është shumë e rëndësishme që stafi të hapet ndaj ndryshimeve dhe të marrë në zotërim proceset e zhvillimit. Futja në një kornizë e cilësive të kërkuara (në ZAP-in e Kosovës stafi duhet të jetë kompetitiv, kurioz, i komunikueshëm, kurajoz, i ndjeshëm dhe i angazhuar) sjell vetëm përfitime pozitive, të cilat duhet të lidhen me rezultatet vjetore dhe vetvlerësimin e stafit.

Këto janë të mbështetura në objektiva të qarta - paraqitja e rezultateve të të gjithë menaxherëve kontribuon në rritjen e rezultateve dhe përfitimeve dhe nevoja për tu prirur drejt ndryshimit. Një rezultat i paraqitjes së rezultateve është dhënë.

Nevoja për zhvillimin e kapaciteve duhet të mbështetet në një plan-biznesi, i cili fokusohet tek aplikimet e deritanishme në Kosovë. Strategjitë audituese dhe organizimi i strukturave është në linjë me politikat kryesore dhe axhendën e zhvillimit administrativ. Kjo siguron produkte efektive në një kohë të shkurtër, të fokusuar në auditim, mbështetjen në reforma, cilësi dhe besnikëri ndaj ISSAI-ve dhe një kuptim të qartë të konteksteve për cdo detyrë në nivel korporate.

Si përfundim zhvillimi i kapaciteteve, fokusimi në vlerat e shtuara dhe zhvillimi i kapaciteteve individuale duhet të bëhet me shpejtësi. Kjo duhet të bëhet sipas një kornize ku objektivat kryesore duhet të jenë :

- Zhvillimi i kapaciteteve për të menaxhuar ndryshimet;
- Rritjen e efikasitetit : duke bërë më shumë me të njëjtën sasi parash;
- Rritjen e cilësisë : jo vetëm të bësh gjërat siç duhet - por gjithashtu bërjen e gjërave të duhura;
- Rritjen e efektivitetit : krijimin e ndryshimit në kuptimin e gjërë dhe matjen e tij;
- Kujdesin për transparencën e brendshme dhe të jashtme.

Institucionet Supreme të Auditimit katalizatorë të inovacionit në sektorin publik

KLSH : Arritje, Mundësi dhe Sfida për të ardhmen

Nga: Luljeta Nano dhe Irena Islami, KLSH



Luljeta Nano



Irena Islami

Hyrje

Në ditët e sotme shoqëritë janë nën efektin e ndryshimeve të vazhdueshme globale duke u shndërruar në shoqëri të dixhitalizuara të udhëhequra nga zhvillimi i teknologjive të avancuara, përdorimi i pajisjeve kompjuterike, internetit, komunikimit mobil, etj.

Ndryshimet sociale që ndodhin në mënyrë të vazhdueshme afektojnë rolin e qeverive dhe marrëdhëniet e tyre me shoqërinë dhe është fakt i pamohueshëm që shoqëria po progreson më shpejt se autoritetet publike.

Shoqëria ka gjetur një mënyrë të re për tu organizuar, siç janë rrjetet sociale, etj., por konstatohet se autoritet publike kane mbetur pas këtyre ndryshimeve. Por kush janë ndryshimet kryesore sociale që sektori publik duhet t'u përshtatet? A është sektori publik duke u përshtatur në mënyrë eficiente dhe efektive?

Ajo çka shtrohet tashmë si sfidë është që gjerat duhen bërë ndryshe kur ambienti ndryshon dhe të bësh gjerat me mënyrat e vjetra sado mirë të kryhen ato, nuk është e mjaftueshme.

Fjalë Kyçe : inovacion, SAI, globalizimi, teknologjitë e reja, ndryshimet sociale, katalizatorë

Inovacioni: Ndryshim i mendimit, kulturës dhe veprimit njëkohësisht

Institucionet Supreme të Auditimit bëjnë pjesë në institucionet më të rëndësishëm të *Checks and Ballances* në sektorin publik.

Një SAI zotëron të gjitha mekanizmat dhe instrumentet për mobilizimin e sektorit publik në drejtim të inovacionit. Vetë Institucionet Supreme të Auditimit duhet të jenë në një hap dhe në një linjë me ndryshimin e shoqërisë.

Në këto kushte është detyrë e Institucioneve Supreme të Auditimit të zhvillojnë metoda të reja të auditimit dhe mënyra të reja të informimit të publikut dhe parlamentit rreth aktivitetit të punës së tyre. Institucionet e auditimit duhet që në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të plotësojnë nevojat dhe pritshmëritë e ndryshimit të shoqërisë. Vetëm në këtë mënyrë ato do të jenë relevante dhe do të bëjnë diferencën. Në një shoqëri që ndryshon vazhdimisht, institucionet e auditimit duhet ti kryejnë funksionet e tyre tradicionale në mënyrë të ndryshme dhe duhet të jenë inovativë.

Dilema : Standartizimi i veprimtarisë audituese dhe toleranca “zero” ndaj gabimeve.

Nga ana tjetër SAI-t përballen me dy zhvillime kontradiktore. Gjithnjë e më shumë procedurat e auditimit po standartizohen. Një forcë udhëheqëse mbrapa këtij zhvillimi është marrëveshja për implementimin e Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit. Por nga ana tjetër, inovacioni kërkon që institucionet e auditimit të veprojnë dhe të zhvillohen jashtë kornizave standarte rutinë të cilat rëndom janë kufizuese.

Inovacioni është një sfidë për institucionet e auditimit pasi njëkohësisht janë në kërkim gjithmonë e më shumë të standartizimit të procedurave dhe veprimtarisë së tyre por nga ana tjetër i gjithë ky proces duhet të shoqërohet me një tolerancë zero ndaj gabimeve.

Gjykata Evropiane e Auditimit e Holandës ka organizuar dy kongrese (EUROSAI Congres ne Nëntor 2013 dhe Qershor 2014) boshti kryesor i të cilave ishte tema e inovacionit me mesazhin kryesor: “Le të krijojmë sot inovacionet e së nesërme”.

Drejtimit kryesore të inovacionit me të cilat po përballen institucionet e auditimit:

1. Institucioneve të Auditimit u kërkohet ***të japin më shumë produkt por me më pak burime duke ndryshuar “modus operandi”.***

Shumë SAI janë koshientë për nevojën për të bërë me shumë, por me më pak burime, referuar edhe impaktit të klimës ekonomike për shtrëngimin e buxheteve. Qytetarët janë bërë më kritikë dhe kërkojnë gjithnjë e më shumë ndaj qeverive. Pra shoqëria dhe qeveria janë transformuar dhe janë bërë më komplekse dhe pa dyshim i tërë ky proces afekton edhe veprimtarinë e Institucioneve Supreme të Auditimit.

Sfida e tyre është që të marrin vendime cilësore mbi çfarë të auditojnë dhe si të auditojnë, *pra të ndryshojnë “modus operandi”.*

2. Globalizimi i shoqërisë shtron nevojën për bashkëpunim

Globalizimi e ka bërë shoqërinë pa dyshim gjithmonë e më komplekse. Por sfida është që Qeveritë e çdo vendi duhet të punojnë së bashku në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe hartimit të politikave kohezive. Të njëjtën gjë duhet të bëjnë edhe Institucionet Supreme të Auditimit, të punojnë së bashku dhe të mësojnë nga përvoja që institucionet analoge kanë në fusha të njëjta.

3- Gjenerimi i volumit të të dhënave

Zhvillimet më të fundit tregojnë që qeveritë po përpiqen të kontrollojnë rritjen gjithmonë e më shumë të trafikut dhe të dhënave dixhitale.

Të dhënat që mund të mblidhen në mënyrë të menjëhershme janë mjaft të ndryshme dhe po rriten në mënyrë marramendëse. Është vlerësuar se 44 herë më shume të dhëna do të prodhohen në 2020 se sa në 2009. Aktualisht të dhënat e gjeneruara nga sektori publik janë në rritje të vazhdueshme dhe këto të dhëna gjithmonë e më shumë po bëhen të aksesueshme për audituesit.

Në mënyrë të figurshme mund të thuhet se të dhënat e gjeneruara krijojnë oportunitete duke u shndërruar në **“Kolltukun e audituesve”**.

Por ende është e pasigurt nëse Institucionet Supreme të Auditimit do të jenë në gjendje të auditojnë të dhënat e gjeneruara. Në këtë aspekt SAI duhet të përmirësojnë njohuritë e tyre për përpunimin e të dhënave, të zhvillojnë metodat analitike, të identifikojnë trendet, zhvillimet e ardhshme dhe të përmirësojnë metodat selektuese të auditimit.

Të dhënat voluminoze, nuk janë ende në axhendën e SAI-ve, por nuk do të jetë e largët dita që këto të dhëna do të jenë objekt i veprimtarisë së tyre dhe për këtë duhet të mendojnë në mënyrë inovative me qëllim që të përballen me sukses me këtë sfidë.

4. Adresimi dhe dërgimi i mesazheve

Qe të jenë efektive mesazhet duhen adresuar drejt target grupit të cilit i përkasin. Institucionet Supreme të Auditimit tradicionalisht paraqesin raporte të detajuara në parlament. Në një epokë kur komunikimi gjithnjë e më shumë është në formë on/line, SAI duhet që të reagojnë në një mënyrë sa më të përshtatshme.

Sfida për institucionet e auditimit është që të adresojnë mesazhet e tyre sa me drejt në target grupin e duhur dhe ti prezantojnë sa më qartë ato dhe me mënyra të reja. Kështu gjatë zhvillimit të kongreseve u sugjerua që SAI-t duhet të raportojnë në një mënyrë sa më inovative dmth të përfshijnë në raportet e tyre sa më shumë imazhe, foto si dhe u artikulua dhe u vu theksi në vizualizimin e të dhënave si një mjet mjaft komunikativ, domethënës dhe shpjegues. Gjetjet e auditimit u sugjeruan që mund të përmbliidhen në një video apo në grafikë informativë.

II. Kontrolli i Lartë i Shtetit : Arritje, Mundësi dhe Sfida për të ardhmen

Adresimi i mesazheve

Në të njëjtën linjë me metodat inovative të cituara më sipër, KLSH gjate vitit 2014 në kuadër të përmbushjes së detyrimit kushtetues për paraqitjen ne Kuvend të Raportit të performancës së vitit 2013 publikoi dhe shpërndau për palët e interesit **broshura**

me karakter informues statistikor “ Performanca e KLSH nëpërmjet shifrave. Grafikë dhe Statistika 2013”.

Mbështetur edhe në sa më sipër mund të konfirmohet se Raporti i performancës së veprimtarisë së KLSH-së qoftë nga pikëpamja strukturore apo edhe vizive reflekton standartet dhe praktikrat më të mira të raportimit dhe u referohet modeleve të ndjekura nga SAI-t analoge Europiane duke përdorur instrumentet e të dhënave të vizualizuara si foto, imazhe, grafikë, etj.

Po kështu në kuadër të shqyrtimit të Draft ligjit të KLSH-së nga Komisionet parlamentare u publikua **dhe u shpërnda broshura** në përmbajtjen e të cilës u përfshinë ISSAI 1 *Deklarata e Limës si Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit*, ISSAI 10 *Deklarata e Meksikos* dhe Rezoluta e Kombeve të Bashkuara A-66 /209. Ky dokument shërbeu si një **instrument i shpejtë njohës dhe asistues** për palët e interesit me synim që të jepej mesazhi dhe njëkohësisht garancia që draft ligji i hartuar dhe i paraqitur në Kuvend ishte në përputhje të plotë me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit publik dhe që reflektonte praktikrat më të mira të fushës.

Dokumentet e mësipërme u botuan në dy versionet në Shqip dhe Anglisht me synim rritjen e target grupit të përdoruesve, duke synuar përdorimin e tyre edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

-Kryerja e auditimeve paralele . Në funksion të përçimit të ndërsjellë të përvojës midis SAI-ve –Departamenti i Performancës ka ndërmarë kryerjen e auditimeve paralele, konsideruar kjo si një praktikë risi për aplikimin e metodave të auditimit, sikurse edhe Institucionet Supreme të Auditimit.

Tashmë ka përfunduar auditimi për sigurinë rrugore, auditim paralel me ZAP-in e Kosovës nën drejtimin e SAI-t suedez, e gërshetuar kjo edhe me kryerjen e workshopeve me një profil teoriko-praktik.

Përveç kësaj, Departamenti i Përformancës ka ndërmarë edhe një auditim tjetër paralel por me një bashkëpunim trepalësh ZAP Kosovë, Zyra e Auditimit e Bosnjës

nën drejtimin e SAI-t suedez me objekt *eficencën e energjisë*, të cilat janë Projekte të mbështetura financiarisht nga SAI Suedez.

Krijimi Drejtorisë së Auditimit IT

Hartimi i një strukture organizative e cila reflekton ndryshimet dhe dinamizmin e sektorit publik në drejtim të përdorimit të sistemeve informatike. Tashmë është krijuar Drejtoria e auditimit IT si një strukturë e specializuar, e cila do të fokusohet në dy drejtime

- a) përdorimi i teknikave të IT gjatë auditimit, dhe
- b) auditimin e sistemeve të IT në entitetet e Sektorit Publik

Një nga objektivat e zhvillimit strategjik të KLSH-së (***Nën-Objektivi 4.2***) është edhe aftësimi i audituesve për përdorimin e teknikave kompjuterike gjatë procedurave audituese si dhe zhvillimi i auditimeve të IT-së.

Në fokus: Implementimi i një kulture institucionale inovative

Në të ardhmen përpara institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit shtrohet sfida që jo vetëm të jetë në një linjë me zhvillimet e inovacionet e shoqërisë në përgjithësi dhe sektorin publik në veçanti por të synojë që të mbajë dhe zhvillojë një kulturë inovative jo vetëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale ***por të jetë një institucion nxitës dhe katalizator për inovacionin*** edhe për institucionet e tjera në sektorin publik.

Bibliografi

EUROSAI Congres, nëntor 2013, <http://www.eurosai2014.nl/yes-2013>

EUROSAI Congres, qershor 2014, <http://www.eurosai2014.nl/>

“Strategjia e KLSH 2013- 2017;Strategjia INTOSAI 2011-2016;Strategjia EUROSAI 2011-2017”, Botim i KLSH-se, viti 2013

“Përdorimi i komunikimit on-line për forcimin e performancës së SAI-ve : një rast studimor nga SAI hungarez”, Erzsébet Németh, Zyra Kombëtare e Auditimit të Hungarisë,INTOSAI Journal, Prill 2013

Përmirësimi i mekanizmit operues të organizatave qeveritare

Auditimi mbi Bazë Sistemi- një qasje që mbështet ndryshimin pozitiv

Pergatitur nga : Albana Gjinopulli, MPA, CIPFA

K.Kondakçiu, KLSH



Albana Gjinopulli



Kozma Kondakçiu

Të angazhuar për të luftuar mashtrimin dhe korrupsionin, është thelbësore që organizatat (qofshin këto të sektorit publik, privat apo jo-fitim prurës) të kenë të ngritura sisteme të kontrollit të brendshëm . Problemet nuk kufizohen vetëm në risqet financiare me të cilat përballet një organizatë. Zhvillimet e fundit në botën e biznesit dhe të financave kanë treguar se ekziston nevoja për sisteme të qëndrueshme dhe efektive të menaxhimit të riskut të cilat nuk është e mjaftueshme të krijohen e vendosen por të testohen për efektivitetin e tyre e të ruhen e mbahen të përditësuara për të përmbushur një prej elementëve thelbësorë të qeverisjes së mirë. Deklarata e Pekinit për promovimin e qeverisjes së mirë nga Institucionet Supreme të Auditimit , e lëshuar në përfundim të punimeve të Kongresit të INCOASAI-t, në fundvitin 2013 , ndër të tjera në çështjen **2.2 “Roli i rëndësishëm i Auditimit Kombëtar në përmirësimin e Qeverisjes Kombëtare”** përcakton se : *Auditimi Kombëtar luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e qeverisjes efektive veçanërisht në performancë kryesisht nëpërmjet .. përmirësimin të mekanizmit operues të organizatave qeveritare.*

Përgjegjësia për përdorimin e fondeve publike, është gur themeli për një menaxhim financiar publik të mirë. Institucionet Supreme të Auditimit janë organet kombëtare përgjegjëse për vlerësimin e shpenzimeve publike dhe sigurimit të një opinion të pavarur mbi mënyrën se si ekzekutivi ka përdorur burimet publike. Të katër objektivat e auditimit të sektorit publik synojnë të nxisin:

- përdorimin e duhur dhe efektiv i fondeve publike;
- zhvillimin e menaxhimit të shëndoshë financiar;
- ekzekutimin e duhur i aktiviteteve administrative;
- komunikimin e informacionit të autoriteteve publike dhe publikut të gjerë nëpërmjet publikimit të raporteve objektive.

Këto objektiva themelore udhëheqin punën e të gjithë SAI-ve, por në mbarë botën ekzistojnë qasje të ndryshme të auditimit të cilat paraqesin herë herë përparësi apo dhe dobësi të mundshme të cilat mund të lidhen dhe me implikime të SAI-ve me tradita të ndryshme . Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve qasjet e auditimit adoptohen apo përzgjidhen në përshtatje me ndryshimet në nivel kombëtar , fushëveprimin e SAI-t apo dhe mënyrën se si auditimi organizohet.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ofrojnë udhëzime mbi përdorimin e metodave dhe qasjeve të ndryshme në hartimin dhe zbatimin e procedurave audituese. Standardet e INTOSAI-t lidhur me kompetencës 2.2.37 përcaktojnë se “ SAI duhet të pajiset me një sistem të plotë të përditësuar të metodologjive , përfshirë teknikat e bazuara në sisteme, metodat e rishikimeve analitike, përzgjedhjen statistikore dhe auditimin e sistemeve të automatizuara të informacionit”

Nga SAI-t sot pritet të identifikojnë shpejt trendet e reja të cilat akoma me më shumë shpejtësi gjenerojnë nga mjedisi kaq i ndryshueshëm dhe të shërbejnë si Institucione te modelit avantgard për admistratën publikë. Për të përmbushur kërkesat në zhvillim të klientëve –Publikut, Parlamentit dhe subjekteve të audituara – SAI-t duhet të adoptojnë qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike, të afta për të diagnostikuar qoftë të metat strukturore të programeve , sistemeve apo projekteve

por gjithashtu të mundësojnë paraqitjen e zgjidhjeve thelbësorë të problemeve. Qasje të tilla sigurojnë gjithashtu kalimin nga formati tradicional e i pakoordinuar dhe i fokusuar në aspekte mikro të zhvillimit në një qasje gjithëpërfshirëse , makroskopike të specializuar dhe shkencore të cilat çojnë në rezultate më të besueshme e cilësore të auditimit dhe që sigurojnë efikasitet në menaxhimin e auditimit në përgjigje të kërkesave në epokën e globalizimit dhe transparencës.

Në sektorin publik, viteve të fundit ka pasur rritje të kërkesës (nga politikanët, administratorët publikë, media, aksionarët publik dhe të tjerë) për sisteme më të mira të kontrollit të brendshëm dhe raportim vlerësues në funksionimin e tyre. Kontrolli i brendshëm shihet si mjet i ofrimit të zgjidhjeve për shumë risqe apo probleme të mundshme me të cilat organizatat përballen sot në demonstrimin e përdorimit të burimeve në mënyrë efikase, efektive, ekonomike, etike dhe ligjore. Auditimi mbi Bazë Sistemi i ofron auditimit mjete të përshtatshme për të vlerësuar :

- **Sigurinë se kontrollet e brendshme funksionojnë efektivisht.**
- **Këshillë se si të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i kontroleve.**

ABS mund të aplikohet në auditimin e sistemeve financiare dhe atyre *jo-financiare*. Prandaj audituesit kanë zgjeruar aktivitetet organizative mbi të cilat mund të kryejnë efektivisht vlerësim operacional të bazuar në auditim. Kjo ka sjellë përmirësimin në cilësinë e opinionit që mund të japë audituesi për organizatën e audituar, për rrjedhojë duke shtuar vlerën e shërbimit më gjithëpërfshirës në organizatë.

Nga audituesit sot kërkohet të përqëndrohen tek “rrënjët” dhe jo thjesht tek pema që është e dukshme dhe kushdo mund ta shohë, dhe qasja auditimit mbi bazë sistemi ofron mundësinë për ta bërë këtë.

Fjalët kyç: Auditim, qasje auditimit mbi bazë sistemi, sistemi i kontrollit të brendshëm, qeverisje e mirë.

HYRJE

Profesioni i auditimit ka nevojë për një hartë të saktë (ose metodë), dhe ndoshta fjalët e cituara në të kaluarën nga Mautz dhe Sharaf (1961: 17) tingëllojnë ende aktuale në procesin e vazhdueshëm të zhvillimit të qasjes së auditimit mbi bazë sistemi "Auditimi është një disiplinë e "aplikuar" dhe përderisa një disiplinë e aplikuar i tërheq apo merr "parimet" ose teoritë bazë nga shumë fusha të tjera, disa prej tyre të pastra dhe disa të zbatuara gjithashtu, ekziston gjithmonë mundësia që ajo të humbasë në harresë të lidhjes së saj dhe varësinë nga fushat më themelore ose abstrakte të të mësuarit. Kështu ajo mund të neglizhohet teorinë e saj dhe të japë një pjesë të vëmendjes së saj aspak proporcionale për aplikimet dhe problemeve të përditshme apo të menjëhershme.

Kjo është gjithmonë për të ardhur keq për shkak se forca e çdo disipline qëndron në themelet e saj.

Profesioni i auditimit duhet, që gjatë procesit të vazhdueshëm të ndryshimit të auditimit

standardet dhe udhëzimet, të konsiderojë ndryshimet dhe t'i bazojë këto ndryshime në teorinë themelore. Rrjedhimisht, zhvillimi i qasjes së auditimit bazuar në sistem duhet të konsiderohet dhe të vlerësohet kundrejt themelet të saj teorike e tij teorike për të mbështetur besueshmërinë procesit të auditimit.

Auditimi mbi bazë sistemi (SBA) është një nga metodologjitë më efektive të auditimit për të ofruar sigurinë se sistemet e kontrollit të brendshëm të vendosura nga menaxhimi po funksionojnë në mënyrë të përshtatshme. Në vitet e fundit, i është kushtuar vëmendje nevojës për sisteme kontrolli efektive, në mënyrë të veçantë si një reagim apo përgjigje e rasteve të skandaleve financiare të publikuara gjerësisht apo dështimit të vetë kontrolleve.

Gjithnjë e më shumë, drejtuesve dhe audituesve u kërkohet të sigurojnë për Vendimmarrësi, pra bordet, këshillat apo komitetet drejtuese deklarata se sistemet e kontrollit të brendshëm të vendosura nga drejtimi janë të përshtatshme dhe

efektive. Ligji “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin” vendos gjithashtu kërkesën që institucionet qeveritare e publike duhet të përgatisin dhe nënshkruajnë Deklaratën e Kontrollit të Brendshëm” dhe nën këtë këndvështrim Auditimi mbi Bazë Sistemi është një mjet shumë i vlefshëm për të mbështetur sigurinë e dhënë mbi përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshëm Brenda organizatës.

Auditimi mbi Baze Sistemi nuk është një qasje e re , kjo metodologji prej vitesh aplikohet nga organizma auditues, të brendshëm e të jashtëm, por disa prej organizatave nuk e kanë implementuar ende ashtu si duhet apo ka patur keqinterpretime apo kuptime jot ë drejta se çfarë është në të vërtetë auditimi mbi bazë sistemi.

SBA është një metodologji për të identifikuar dobësitë/risqet në sisteme dhe kontrollet që drejtimi ka vendosur për të adresuar këto dobësi apo risqe, dhe gjithashtu për të testuar kontrollet, për të provuar nëse ato funksionojnë efektivisht më qëllim që të ofrohet siguri për menaxhimin.

Objektivi kryesor i auditimit të sistemeve dhe auditimit të operacioneve është të verifikohet funksionimi efektiv i sistemeve të drejtimit dhe kontrollit të programit operacional dhe të verifikohen shpenzimet e deklaruara¹

Njëkohësh Neni 62 i Rregullores së Këshillit (Council Regulation) (EC) Nr 1083/2006 të 11 Korrikut y 2006 përcakton dispozitat e përgjithshme të Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal, Fondit Social Evropian dhe Fondit të Kohezionit duke iu referuar përgjegjësisë së autoritetit auditues për të siguruar auditimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit mbi bazën e një qasje të përshtatshme.

Auditimi i bazuar në sistem është një metodë/qasje audituese në të cilën audituesi kërkon të fitojë nivelin e duhur të sigurisë duke:

- Evidentuar ekzistencën e një sistemi efektiv të përpunimit dhe regjistrimit të transaksioneve.

¹ Article 62 (1) (c) of Council Regulation (EC) No 1083/2006 (OJ L210/25)

- Vlerësuar dhe testuar kontrollet e brendshme përkatëse.
- Kryer nëse është e nevojshme një testim thelbësor të një niveli të reduktuar .

Audituesit e brendshëm edhe ata të jashtëm aplikojnë ABS-në, edhe pse ka një dallim ndërmjet tyre. Këtu përfshihen:

1. Audituesit e brendshëm fokusohen në kontrollet e brendshme brenda organizatës për të siguruar :

- Mbrojtjen e aktiveve (mjeteve).
- Besueshmërinë e regjistrimeve(saktësinë dhe besueshmërinë e regjistrimeve)
- Ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin e operacioneve dhe se organizata i përmbahet legjislacionit, rregulloreve dhe direktivave tjera (kriteri i rregullsisë që përmendëm më lart).

2. *Audituesit e jashtëm* gjithashtu fokusohen në të njëjtat fusha por kryesisht janë të interesuar në formimin e opinionit të qartë nëse:

- Llogaritë e njësisë ekonomike paraqesin një pamje reale të aktiviteteve të tij.
- Njësia ekonomike vepron vetëm brenda të drejtave dhe autoritetet të saj statutor (rregullshmëria).

Auditimi mbi bazë sistemi i referohet një vlerësimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të ndërtuar dhe zbatuar nga drejtuesit e institucioneve për të siguruar përdorimin e ligjshëm etik, transparent, ekonomik efecient dhe efektiv të fondeve buxhetore. Në thelb auditimi me bazë sistemi është një vlerësim i detajuar i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm që ka vendosur menaxhimi lartë , duke synuar vlerësimin nëse ky sistem funksionon në mënyrë efektive dhe eficente si dhe kontribuon drejt arritjes së objektivave të institucionit.

Risqet e kontrolleve vlerësohen nëpërmjet auditimit të sistemeve , i cili konsiston në një rishikim të kontrolleve të brendshme mbi veprimtaritë e kontrollit dhe sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe përfshijnë teste e kontrolleve. Sistemet efektive të

kontrollit bazohen në aktivitetit e kontrollit por gjithashtu dhe në procedurat e menaxhimit të riskut, ambientin e kontrollit , komunikimin dhe informacionin për të cilat jepen detaje të hollësishme në Rregulloren Financiare të Këshillit , neni 28 a² dhe në Modelin COSO³.

Auditimi mbi bazë sistemi aplikohet mbi qasjen e auditimit ashtu dhe mbi subjektin e auditimit. Si një qasje auditimi, ABS përdor një metodë sistematike dhe shkencore për të identifikuar problemet kryesore, qasje kjo që ndryshon nga praktika tradicionale e ekzaminimit të operacioneve publike në mënyrë të rastësishme dhe duke u mbështetur kryesisht mbi intuitë. Me fjalë të tjera puna audituese fillon vetëm pasi janë identifikuar me kujdes pikët kyçe dhe kjo është bërë nëpërmjet studimeve të hollësishme paraprake dhe analizimit të të dhënave. Në lidhje me subjektin e auditimit, auditimi mbi bazë sistemi shkon përtej theksimit të gjetjeve individuale të auditimit. Ajo përfshin një ekzaminim të gjithë sistemit në fjalë për të identifikuar shkaqet e problemeve dhe për të dalë me një “kurë shërimi” themelore. Në aplikimin e auditimit mbi bazë sistemi theksohet akoma më shumë lidhja e logjikshme që ekziston ndërmjet identifikimit të shkakut me situatën apo gjetjet e konstatuara : “... Shkaku identifikon arsyen apo shpjegimin për gjetjen/situatën ose faktorin apo faktorët përgjegjës për ndryshimin midis situatës ekzistuese (kushteve/gjetjeve) dhe kërkesave apo pritshmërive (kriteret), e cila gjithashtu mund të shërbeje si një bazë për rekomandimet për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese. Faktorët që zakonisht identifikohen në pjesën më të madhe të rasteve përfshijnë :

² Council Regulation (EC, Euratom) N° 1995/2006 of 13 December 2006 amending Regulation (EC, Euratom) No 1605/2002 on the Financial Regulation applicable to the general budget of the European Communities. OJ L390/1.

³ COSO is one of the most important and well-known internal control frameworks. For further information please consult: www.coso.org.

hartimin e politikave të dobëta, të kriterëve apo procedurave; zbatimin e tyre jot ë plotë në përputhje me kërkesat apo dhe të gabuar; apo dhe faktorët që shkojnë dhe më tej kontrollit të menaxhimit të programit.”⁴

Audituesit mund të vlerësojnë nëse evidence ofron një argument të arsyeshëm apo bindës se përse ku shkak i deklaruar përbën dhe faktorin apo faktorët kyç që ka ndikuar në shmangien e situatës së gjetur dhe kriterit të pritshëm.

SBA shpesh krahasohet me paraardhësit e saj, të cilat në gjuhën e audituesve njihen si auditime mbi bazë produkti. Kjo qasje përfshin krahasimin e produkteve të arritura (modele të tyre) me standardet e vendosura. Dhe në vijim ajo që të gjithë kishin apo kanë parasysh në këto raste është pamja ë një audituesi me një listë kriteresh në dorë duke cekuar aspektet e ndryshme të pajtueshmërisë së produktit të marrë me kriteret e caktuara.

Problemi në këtë rast është natyrisht se audituesi e bën këtë vlerësim mbështetur në produktet e zgjedhura. Ai gjithashtu mund të konkludojë se dhe në të ardhmen produktet do të arrijnë standardet, por në të vërtetë audituesi nuk e ka vlerësuar realisht situatën se deri në c’pikë gjykimi i tij mund të shkojë. Dhe kjo është çfarë auditimi mbi bazë sistemi vendos ta bëjë. Duke parë apo vëzhguar vetë sistemin që e ka prodhuar produktin , audituesi bën një vlerësim mbi aftësinë operuese apo funksionale për arritjen në vazhdimësi të standardeve të kërkuara.

Kjo qasje vendoset në krye në rastet kur sistemet janë ende të brishta (sisteme te reja- ligje të reja, procedura të reja të pa aplikuara më parë) dhe që njëkohësisht mjedisi ku operohet nuk ka nxjerrë në pah ende ndonjë dobësi të sistemit. Kjo do të interpretohej si situatë kur produktet e sistemit kanë plotësuar të gjithë kërkesat e deri më tani, por mund të shihen apo vërehen probleme të cilat shumë shpejt mund të dalin në pah sikur edhe vetëm një hallkë e vogël e zinxhirit të veprimeve të dështojë se funksionuari siç duhet. Auditimi mbi bazë sistemi është gjithashtu shumë

⁴ The Yelloë Book, GAO

i dobishëm për sisteme të emergjencës pra që vihen në funksionim shumë radhe por funksionimi i tyre është i rëndësishëm jetike.

Semantika e Auditimit mbi Bazë Sistemi

Shpesh diskutimet mbi përkufizimin e sistemit përfundojnë në një tërësi kufizimesh sa mund të thuhet që ndeshemi në një dilemë semantike. Kjo sepse në varësi të arsimit, eksperiencës apo dhe vetë fushës në të cilin funksionon , ajo çfarë përbën apo me të cilën nënkuptohet një sistem ndryshon në mendjen e gjithsecilit. Ndonjëherë përkufizimi mund të jetë aq shumë i limituar sa që diskutimi mund të bëhet dhe i pamundur. Duke synuar një situatë të mesme ... “Një sistem është një formë e përpjekjes që kërkon për të kthyer disa të dhëna (s) në disa rezultate të paracaktuara), në një mënyrë të qëndrueshme dhe të parashikueshme.”

Nën këtë kuptim elementët e një sistemi konsiderohen:

- **Input-et** – Këto janë ato c’ka më pas konvertohen në rezultate apo produkte. Ato ndryshojnë thellësisht pas përpunimit dhe bëhen pjesë e output-it
- **Burimet** – Të cilat përdoren Brenda sistemit për të transformuar inputet në output-e. Ato nuk ndryshojnë nga përpunimi por ndërsa përdoren gjatë procesimit në një sistem nuk janë më të vlefshme për sistemet e tjera apo në pjesë të të njëjtit sistem;
- **Kontrollet** – Këto udhëheqin sistemin në procesin apo përpunimin e tij. Ato gjithashtu nuk ndryshojnë por mund të përdoren në disa sisteme apo dhe në disa pjesë të sistemit;
- **Output-et** – të cilat janë produktet primare apo kryesore të sistemit. Ato janë arsyeja e krijimit të sistemit “system’s raison d’être “dhe në një kuptim të gjerë duhet të plotësojnë apo arrijnë objektivat e sistemit;
- **Nën Produktet** – të cilat janë gjithashtu produkte të sistemit por nuk janë domozdoshmërisht në objektivat e sistemit.

Në aspektin e auditimit mbi bazë sistemi këto të fundit do të shërbejnë vetëm për të bërë lidhjen me sisteme të tjera apo pjesë të vetë sistemit.

Auditimi mbi bazë sistemi ka aftësinë të lidhë sëbashku të gjithë këto elementë të sistemit, përshkrimin e sistemit dhe më pas të kalohet duke humultuar nga lart – poshtë dhe duke e ndarë atë sipas nevojës në nën sisteme. Modelimi do të jetë gjithnjë një thjeshtëzim , ka të bëjë me arritjen e një ekuilibri midis shkallës së shtrirjes së sistemit dhe ndarjes së tij në pjesë më të thjeshta, përcaktimin e ndërlidhjeve midis tyre.

Implementimi i Qasjes së Auditimit mbi Bazë Sistemi

Qasja SBA presupozon më shumë vlerësimin e sistemeve dhe proceseve sesa vendeve ose degë. Në thelb SBA është një qasje horizontale më shumë se vertikale e shqyrtimit të një aktiviteti në të gjithë organizatën duke hetuar apo investiguar për zonat ku ka mospërputhje shmangie apo mospërputhje ose ndërfaqet nuk janë të plota. Pra auditimi i bazuar në sistem bazohet shumë pak në transaksionet përputhshmërisë , por ajo paraqitet si një qasje ku fraza “from the cradle to the grave” përdoret shpesh për të treguar apo përshluruar proceset e veçanta. Qasja është që të ndiqet nj numër i vogël transaksionesh përfaqësuese të popullsisë nëpërmjet sistemit për të provuar efektivitetin e sistemit.

Sistemi ofron një qasje universale e cila mund të përdoret thuajse në të gjithë format e auditimit. Megjithatë implementimi praktik i ABS mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme; ajo kërkon një modelim të qasjes sipas rrethanave të veçanta, duke marrë parasysh karakteristikat dhe veçoritë e sistemeve individuale dhe aktiviteteve të institucionit.

Ka tre parime udhëheqëse të auditimit mbi bazë sistemi:

1. Fokusimi në fushat më strategjike dhe me risk më të lartë,
2. Orjentimi drejt performancës dhe
3. ABS si Qasje proaktive

Së pari, duke përzgjedhur se çfarë do të auditohet qasja e auditimit mbi bazë sistemi fokusohet në fushat dhe aspektet me të rëndësishme dhe me risk më të lartë duke adresuar fushat të cilat kanë influencën apo që konsiderohen me ndikim dhe interes më të madh për shoqërinë. Në këtë mënyrë auditimi mbi bazë sistemi siguron njëkohësisht efektivitet të lartë në përdorimin e burimeve të auditimit.


Së dyti, nga perspektiva e kriterit të auditimit, auditimi mbi bazë sistemi vlerëson performancën e operacioneve qeverisëse në termat e tre E-ve (ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit) dhe jep rekomandimet për përmirësime.

Roli i qeverisjes sot, ndryshe nga e kaluara, është i drejtuar më shumë drejt nxitjes dhe mbështetjes për shërbime publike cilësore se sa në rregullimin dhe kontrollin e tyre, por njëkohësisht taksapaguesit janë të etur për të parë nëse taksat e tyre janë duke u shpenzuar në mënyrë efikase. Si pasojë, auditimi nuk mund të bëjë ndryshimin, nëse vazhdon të fokusohet në qasjen e izoluar, mikroskopike të auditimit e që thjesht thekson pajtueshmërinë. Qasja audituese vendos një theks të fortë në auditimin e orjentuar drejt performancës që vlerëson Tre E për të analizuar dhe të shqyrtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse ecurinë dhe zbatimin e programeve dhe sistemeve të audituara dhe për të zhvilluar masa dhe aktivitete për përmirësimin të cilat janë praktike dhe gjithëpërfshirëse.

Së treti, auditimi mbi bazë sistemi është një qasje proaktive. Nëpërmjet të tillë qasje kërkohet të veprohet paraprakisht për të trajtuar vështirësitë e parashikuara për të promovuar sipërmarrjen dhe krijimtarinë në sektorin publik. Në të kaluarën, auditimi shpesh është fajësuar për fokusimin vetëm në gjetjet dhe identifikimin e shkeljeve apo dobësive në interes të punës së tij, duke mos lejuar aspak kreativitetin dhe ndonjëherë duke edukuar vetëkënaqësi në mesin e zyrtarëve të qeverisë. Në përgjigje të kësaj kritike, përpjekjet e reja të auditimit vendosin theksin më të madh në mbajtjen e zyrtarëve qeveritarë përgjegjës për një punë që nuk e kanë bërë dhe në të njëjtën kohë, synohet të promovohen dhe të shpërndahen gjëresisht praktikatat më të mira në mënyrë që auditimi të bëhet pozitiv dhe të orientuar drejt së ardhmes.


Për më tepër, auditimi mbi bazë sistemi fokusohet dhe thekson përmirësimin e inefektivitetit institucional dhe largimin e faktorëve strukturorë dhe ambjentalë që gjenerojnë parregullsi, mashtrime apo vjedhje por njëkohësisht parandalimin e ndodhjes së problemeve përsëri.

Fazat e Auditimit mbi Bazë Sistemi:



Vlerësimi dhe regjistrimi i sistemit

Objektivat e Sistemit	Kontrollet	Identifikimi i Risqeve	Vlerësimi i Kontrolleve vs.vlerësimi të riqeve	Testi i pajtueshmërisë	Testet thelbësore /substancia le
-----------------------	------------	------------------------	--	------------------------	----------------------------------



Qëllimi i Përshkrimit të sistemit

Arësytet kryesore që të përshkruhet një system janë :

- Të konfirmohet kuptimi i subjektit/njesisë nga audituesi për të formuluar objektiva të qarta të sistemit/procesit;
- Të përcaktohet ndonjë ndërhyrje ndërmjet sistemeve;
- Të përcaktohet se si sistemet përshtaten Brenda organizatës;
- Të sigurohet një bazë për të vlerësuar se deri në çfarë mase kontrollet e brendshme zbulojnë dhe korrigjojnë gabimet.

Përshkrimi i sistemit formon bazat për gjukimin, konkluzionet dhe rekomandimet e audituesit. Ai gjithashtu do të duhet të sigurojë bazat edhe për vlerësimin e pikave të forta dhe dobësive të kontrollit të brendshëm.

Për shkak se “përshkrimi”i sistemit kërkon shume kohë, duhet të përjashtohen apo lihen mënjane ato aspekte te cilat nuk janë të rëndësishme për auditimin.

Audituesi duhet të vendosë se cilat teknika apo kombinim teknikash janë më të përshtatshme për të rregjistruar sistemin (teksti dhe ose diagram), duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e sistemit, objektivat e auditimit dhe cdo punë audituese të bërë më parë.

Burimet kryesore të informacionit mund të përfshijnë:

- Dosjet dhe letrat e punës nga auditimet e hershme;
- Rregulloret organizative dhe proceduriale ,, manualet, udhëzimet dhe akte të tjera që përdoren në organizatë;
- Intervistat dhe diskutimet joformale me drejtuesit dhe stafin;

- Vëzhgimin e ambjentit fizik dhe metodat e punës të përdorura. Kjo është vecanërisht e rëndësishme kur nuk ka prova fizike që dicka ka ndodhur , dhe të mbetet pas ndodhisë.

Kujtoni që të qenit present audiuituesit mund të ndikojë në sjelljen dhe qëndrimin e stafit dhe praktikrat e vëzhguara mund të mos jenë zakonisht të tilla. Mund të ketë vështirësi gjithashtu dhe në vërtetimin e provave.

Për të rregjistruar sistemin mund të përdoren dokumentat e mëposhtëm:

- Raportet e përgatitura nga Njësitë e Kontrollit dhe të Inspektimit;
- Cdo lloj tjetër raporti që lidhet me fushën që auditohet;
- Informacioni nga drejtimi.

2.2.2. Hapat e ndjekura në rregjistrimin e sistemit

Në këtë seksion do të trajtojmë hapat që kërkohet të ndiqen kur rregjistrohet një system. Nëse sistemi është dokumentuar që më parë, atëherë do të kërkohej më pak kohe për të diskutuar me menaxherët dhe stafin. Në mënyrë të ngjashme do të ndoshë dhe nëse sistemi nuk ka patur shume ndryshime. Hapat janë si më poshtë :

1. Krijimi i një Skice (pamje të përgjithsme) të sistemit për t'ju mundësuar nëse mund të përdorni shënimet e shkurtuara apo diagramat për të dokumentuar sistemin, dhe gjithashtu për të vendosur se cili prej nën/sistemeve kryesore do të jetë i përshtatshëm për të përshkruar në mënyrë të vecantë;
2. Marrja e një përshkrimi të hollësishëm sistemeve dhe llojeve të kontrolleve të brendshme nga diskutimet me stafin dhe personelin e departamenteve.

Kjo duhet të përfshijë një rregjistrim të :

- Cilët procese dhe procedura janë kryer dhe prej kujt;
- Cdo ndryshim në procedurat për lloje apo grupe të ndryshme transaksionesh– psh. ato transaksione që kanë vlerë më të madhe;
- Masat që merren për të ruajtur vazhdimësinë e procesit të punës (oret e pushimit të drekës, pushimet, vendet bosh të punës apo flukset në pikat kulm të operacioneve);

- Të gjithë dokumente e përdorura në proces;
 - Të gjitha raportet kompiuterike së bashku me qëllimin për të cilin janë hartuar dhe mënyrën e përdorimit të tyre.
3. Rregjistrimi i informacionit në një diagram apo shënime të përgjithshme. Nëse është e mundur të krahasohen me aktet që përshkruajnë procedurat e brendshme.
 4. Kryerja e testeve “ec-përmes”ose “hap pas hapi”për t’u siguruar që sistemi aktualisht funksionon ashtu si dhe është përshkruar.
 5. Përgatitja e dokumentacionit të përshkrimit të sistemit – shënime të shkurtuara ose /dhe diagram.
 6. Referencat kryq(të tërrthorta) të dokumentave dhe raporteve të sistemit në shënimet e shkurtuara ose/dhe diagramë.

Kur dokumentohet sistemi , audituesi duhet të kujtojë (mbaje në konsideratë) që volume i transaksioneve duhet të kufizohet deri në masën që është e nevojshme për të identifikuar dhe dokumentuar kontrollet e brendshëm.

2.2.3. Shtrirja/ Niveli i përshkrimit të sistemeve

Niveli i përshkrimit të sistemeve duhet të jetë i detajuar mjaftueshëm që të lejojë apo t’i mundësojë përdoruesit dhe personit që rishikon auditimin që të kuptojë se si punon sistemi dhe se si janë vendosur kontrollet e brendshme. Në varësi të objektivave të auditimit ne disa raste mund të jetë e nevojshme të regjistrohet i gjithë sistemi , dhe në disa raste mund të jetë e nevojshme që të regjistrohen vetëm fushat kyce të sistemeve.

Kur rregjistrohet një system është e rëndësishme që të :

- Rregjistrohet sistemi ashtu si ai funksionon aktualisht ;
- Identifikohen dhe rregjistrohen të gjitha llojet e procedurave dhe transaksioneve të mbuluara nga sistemi që auditohet (përfshirë përjashtime të tilla sikurse janë ditet e festive kombëtare , periudha e pushimeve të stafit, orë jashtë orarit etj);
- Shikohen me kujdes kur identifikohen kontrollet- ato jo gjithmone mund të jenë caktuar apo vendosur në mënyrë të qartë;

- Rrgjistrohen vetëm elementët e sistemit që janë thelbësorë për auditimin;
- Kopjohe nvetëm dokumente thelbësore. Kopjimet e panevojshme mund të jenë humbje dhe kanë tendencë të vështirësojnë rishikimin e dosjeve të auditimit;
- Kini paraqysh se përshkrimi i sistemit i gjetur në disa dokumentacione mund të mos jetë i përditësuar dhe jo i plotë.

Nëse ato ofrojnë shpjegim të përshtatshëm, kopje të dokumentimit standartd dhe raporte apo përmbledhje të rëndësishme atom und të bëhen pjesë e rregjistrimit të auditimit. Rregjistrimi i sistemeve duhet gjithashtu të tregojë burimin e informacionit si psh. Rregulloret, manualet, intervistat.

Dokumentimi i sistemit

Dokumentimi i sistemit normalisht ka formen apo bëhet në formën e përshkrimeve të shënimeve të shkurtuara , diagramave ose një kombinim id y teknikave.

Përshkrimet e shënimeve të shkurtuara

Një përshkrim me anë të shënimeve të shkurtuara ndihmon që të jepet një pamje e plotë e sistemit. Ai ofron nje rregjistrim apo dokumentim të detajuar të sistemit që do auditohet, dhe sëmbashku me format e tjera të rregjistrimeve të sistemit , ai duhet të mbulojë:

- Objektivat dhe synimet e sistemit;
- Lidhjet dhe ndërhyrjet me sistemet e tjera;
- Ambjentin në të cilin operon/funksionon sistemi;
- Ndarjen e autoritetit dhe përgjegjësive;
- Të gjithë kontrollet dhe proceset kyce të sistemit;
- Situata të jashtëzakonshme ose raste të cilat mund të kenë lidhje me sistemin;
- kontrollet e mënjhershme (ad-hoc) të tilla si rishimimet e menaxhimit.

Përshkrimet e shkurtuara mund të mbulojnë përshkrime të detajuara të flukseve të transaksioneve por në disa raste atom und të rregjistrohen më mire nëpërmjet diagramave . Shpesh është e dobishme të përdoret një kombinim i shënimeve të

shkurtuara dhe diagramave – duke përdorur diagramat për pjesët më komplekse të sistemit. Nëse përdoren si diagramat ashtu dhe shënimet e shkurtuara duhet të përdoren referencat e terthorta (kryq) me njëri tjetrin. Shënimet e shkurtuara ,mund të jetë e nevojshme të ndahen në :

- Një përmbledhje e përgjithshme e sistemit; dhe
- Përshkrimet e detajuara të ndara në pjesët kryesore përberëse të sistemit.

Duhet të përdoren titujt të cilët duhet të organizohen apo rradhiten në një mënyrë llogjike me qëllim që të jepet një pamje e qartë dhe për të bërë më të thjeshtë përdorimin dhe përditësimin e saj të mëvonshëm. Kurdo që është e mundur duhet të rregjistrohet burimi i informacionit si dhe emrat dhe pozicionet e njerëzve që janë intervistuar. Duhet të përgatitet një rregjistrim i qartë dhe konciz i sistemit.

Diagramat

Ndërtimi i grafikëve është një metodë e rregjistrimit dhe përshkrimit të sistemit më anë të diagramave, të cilat tregojnë rrjedhën e dokumentacionit ose informacionit si dhe kontrolleve të brendshëm të lidhura me to Brenda një sistemi.

Diagramat mund të ndihmojnë :

- Për të kapur një perspective të të gjithë sistemit;
- Për të fituar një kuptim të objektivave të subjektit që auditohet;
- Identifikuar ndarjen e detyrave;
- Për të ndihmuar personin mbikëqyrës të auditimit që të identifikojë fushat të cilat nuk janë mbuluar nga auditimi.

Ndërtimi i diagramave ka të ngjarë të jetë më efektiv nëse ndërmerret një qasje llogjike nga lart poshtë duke filluar me një diagram të përgjithshme ose përmbledhëse , e shoqëruar me diagrama të detajuara të proceseve specifike nëse është e nevojshme.

Ka metoda të ndryshme dhe sible të përgatitjes së diagramave. Këto simbole mund të gjenden në programet Microsoft Visio (mund të përdoren gjithahstu MS Excel ose Word) të cilat ofrojnë lehtësira për ndërtimin e diagrameve po ashtu ka dhe një

numer programesh kopierike (softëare) të vlefshme pikërisht për të ndërtuar diagrame.

Cështje të tjera që duhen marrë në konsideratë

Struktura Organizative

Struktura organizative e sistemit që auditohet duhet të dokumentohet dhe të nashkëngjitet sistemit. Kjo do të jetë struktura ekzistuese organizative e përditësuar deri në momentin e auditimit si dhe e përshkruar në mënyrë të përshtatshme dhe të kujdeshme.

Një strukturë organizative e përditësuar do të tregojë detaje të rrjedhjes së informacionit, lidhjet apo vartësinë organizative si dhe përgjegjësitë. Ajo është gjithahstu e dobishme për të identifikuar stafin dhe vendet ku duhet të behen testimet e auditimit. Gjithashtu dokumentimi duhet të përfshijë dhe datën se kur është përgatitur diagrama.

Diagrama mund të përfshijë:

- ✚ Strukturat/Departamentet/Drejtoritë kryesore dhe përshkrimin e funksioneve të tyre;
- ✚ Pozicionin, gradat dhe emrat e punonjësve si dhe përgjegjësitë e tyre;
- ✚ Te gjitha linjat e raportimit.

Dokumentimi i Sistemit (kërkesat minimale)

Pavarësisht se cfarë metode përdoret për të dokumentuar procedurat në një sistem, ka disa çështje të cilat duhet të përfshihen në dosjen e çdo sistemi. Te tilla çështje përfshijnë:

- Shembuj të dokumentave duke përshkruar qëllimin e tyre dhe përdorimin.

Këto dokumenta dhe raporte duhet të përfshihen në dosje me të njëjtin renditje sikurse janë përdorur në sistem si dhe të vendosen referencat sipas paragrafëve apo pjesëve të sistemit të cilat ato shpjegojnë, arsyetojnë apo përdshkruajnë sinë shpjegimet e shkurtuara apo në diagram.

Shembuj te raporteve (si te pergatitura ne menyre manual ashtu dhe te perpunuara ne kompjuter) si dhe qëllimin dhe përdormimin;

- Detaje të një numri transkacionesh që kalojnë nëpërmjet sistemit. Këto janë të rëndësishme për të siguruar një kuptim të plotë të sistemit në lidhje me veprimtarinë e përgjithshme të njësisë. Njëkohyësisht është shumë e rëndësishme të përmbliidhen dhe të dhëna të tjera si :

- Nuri i transaksioneve;
- Vlera e transaksioneve;
- Flukset sezonale;

Format e përdorura për të vlerësuar sistemin

Për audituesin mund të jetë e dobishme të njohë numrin e punonjësve apo ndarjen e transaksioneve sipas vlerave apo kohës se kur kanë ndodhur për të mbështetur procesin e vlerësimit të riskut kur vërehet njodnjë dobësi.

Kontrolli nëse sistemi është regjistruar në mënyrë korrekte

Është shumë e rëndësishme që të sigurohemi që sistemi është regjistruar në mënyrë korrekte dhe të kujdeshme për arsye sepse ai ofron bazat për vlerësimin e kontrolleve të brendshme po ashtu dhe përgatitjet dhe programin e testeve të auditimit. Nëse ka mungesë të procedurave të shkruajtura rreth procesit në sektorin public , duhet që audituesi të kërkojë drejtuesit të subjektit të audituar të konfirmojë dhe të nënshkruajë përshkrimin e sistemit të bërë nga vetë audituesi (pavarësisht formës që mund të jetë nëpërmjet shënimeve të shkurtuara apo diagramës).

Testimi ec-përmës (hap aps hapi) Ëalk-through testing

Kur kryen testimet ec-përmes audituesi kërkon kryesisht për evidencën e ekzistencës së kontrolleve. Kjo mund të përfshijë një munër të vogël transaksionesh të ndryshme të cdo faze të procesit apo dhe ndjekja hapa pas hapi i një transaksioni që nga fillimi/nisja deri në përfundim të tij.

Qëllimi i këtij lloji testimi është që vetë audituesi të sigurohet që sistemi më të vërtetë funksionon ashtu sikurse është kuptuar dhe paraqitur në përshkrimin e sistemit dhe njëkohësisht që të konfirmohen kontrollet që janë tashmë të ngritura apo të vendosura në cdo fazë .

Normalisht transkasionet mndiqen nga fillimin në fund (perpu nimi përfundimtra). Megjithatë ndonjëherë është më e përshtatshme , bindëse dhe praktike të fillohet nga përfundimi i perpunimit. Është e reëndësishme të merren në konsideratë dokumentet të cilat kolojnë nëpërmjet sistemeve të vogla/minististemeve dhe në nënsistemet e sistemit kryesor , dhe të shikohen më kujdes cdo dosje e dokumentave për të konfirmuar se ku dhe pse janë mbajtur në ato vende.

Cfarë të bëjmë nëse ka ndryshime apo difetrenca midis mënyrës së si e kemi regjistruar sistemin dhe rezultateve të tesimit ec përmes ?


Nëse kjo ndodh ka dy arësye të mundshme :


- Sistemi i regjistruar është i gabuar ose
- rregjistrimi është korrekt por sistemi nuk funksionon normalisht.

Nëse ka ndo një ndryshim apo informacion të identifikuar që nuk është në përputhje me përshkrimin e sistemit atëherë i duhet rikthyer burimit original të informacionit para se të kalohet në ndonjë fazë tjetër . Kjo është shume e reëndësishme pasi nëse ka ndrushime në system duhet të ndryshohen dhe teste ecpërmes.

Identifikimi i objektivave te sistemit

Elementi ky c për një auditim mbi baze sistemi efektiov eshte të identifikojë objektivat e sistemit të cilat përcaktojnë dhe objektivat e kontrollit përkundrejt të cilave kontrollet në sistem të mund të auidtohen. Nje sistem përmban pesë elemente kryesore:





Një auditim mba bazë sistemi përqëndrohet kryesisht në vendosjen e lidhjeve midis kontrolleve dhe objektivave me qëllim që të mbledhë evidencën për të mbështetur opinionin profesional të audtuesit mbi përshtatshmerine dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm në këtë sistem.

Në auditim termi *objektiva* përdoruret në shumë kontekste.

Fillimisht një *organizatë*. krijohet për arritjen e objektivave të specifikuara nga vetë themeluesit apo krijuesit e saj. Ndërmarrja në sektorin privat ka objektiv organizativ “ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për klientët për të krijuar fitim”. Subjekti i sektorit publik ka objektiv organizativ “dhënien e mallrave dhe shërbimeve për taksapaguesit/publikun për të përmirësuar mirëqenien e tyre, apo së paku për të lehtësuar funksionimin e rregullt të shoqërisë”. Objektivat e organizatës mund të specifikohen më tej sipas qëllimit specifik të cdo organizate , si për shembull: dhënia e kujdesit më të mirë shëndetësor, funksionimi më efikas i shërbimit urban apo ofrimi i shërbimit arësor në nivele të larta në të gjithë vendin. Objektiva të tilla janë të nivelit të lartë dhe për qëllime të auditimit, konvertimi i tyre në synime të realizueshme, mund të analizohet në objektiva më të fokusuara dhe të hollësishme. Njëri prej funksioneve të menaxherëve është të thjeshtësohen objektivat e përgjithshme të organizatës në objektiva më *specifike të menaxhimit*, siç janë

mirëmbajtja e shërbimit të urban me përpikëri në 90%, apo mbajtja e listës së pritjes me kohë për operimet në nivel minimal apo sigurimi i stafit në nivel në shkolla të mos bijnë nën nivel të specifikuar. Objektivat e menaxhimit konvertojnë objektivat organizative në tregues sasior , të matshme. Prandaj niveli I arritjes së këtyre treguesve ndihmon në vlerësimin e performancës së menaxhimit në arritjen e objektivave.

Për të arritur objektivat, menaxhimit i duhen njerëz dhe procese të cilat duke ndërvepruar sëbashku të punojnë si sisteme. Kështu që për shembull drejtuesve të sistemit shëndetësor do t'ju duhen sisteme të raportimit për përdorimin e burimeve kirurgjikale për tu siguruar se ata mund të përshtasin kërkesat e pacientëve dhe numrin e shtretërve. Drejtuesit e shërbimit arsimor do të kenë nevojë për sisteme që u japin informata se sa fëmijë kanë nevojë të mësojnë, sa mësues janë në dispozicion tani dhe sa do të dalin në pension në vitet të ardhshme, kështu që ata mund të parashikojnë numrin e duhur të mësuesve të rinj. Secila prej këtyre nevojave të menaxhimit përfaqëson objektiv *sistemi* dhe këto vendosen nga menaxhimi i lartë. Kjo është një pamje e vendosjes së objektivave të organizatës, menaxhimit dhe sistemit.

Për t'u siguruar se gjithshka kryhet sic duhet, se po veprohet në drejtim të plotësisht të objektivave të përgjithëshme të organizatës, menaxherët vendosin *kontrolle*, dmth. Mbajnë nën kontroll/monitorojnë, për t'u siguruar se janë kryer veprimet sipas parashikimit, për shembull, raportet që menaxhimi kërkon të bëhen në kohë. Pra p.sh. menaxherët e shëndetësisë do të kërkojnë person të caktuar për të parashtruar informatat e duhura mbi përdorimin e burimeve kirurgjike në një kohë të caktuar, çdo javë. Ky kontroll u mundëson atyre që të arrijnë objektivat e kontrollit duke pasur të dhënat përkatëse që të planifikojnë pranime në kirurgji. Në të njëjtën mënyrë edhe menaxherët e shërbimit arsimor do të kenë nevojë për informata demografike që të analizohen dhe raportohen në baza vjetore (kontrollohen) për t'u mundësuar

atyre të arrijnë objektivat e kontrollit për përditësimin e fakteve dhe shifrave me të cilat planifikohet trajnimi i mësuesve.

Prandaj objektivat e kontrollit mund të përkufizohen thjeshtë si nën-objektiva të cilët formohen duke zbërthyer elementet që përbëjnë objektivat e përgjithshme të sistemit. Këto nën-objektiva të identifikuara ndihmojnë audituesit të specifikojnë objektivat e kontrollit kundrejt të cilit kontrollet e sistemit do të vlerësohen.

Përcaktimi korrekt i objektivave të kontrollit është qenësor për një auditim efektiv. Gabimet në përcaktim mund të rezultojnë në konkluzione të gabuara dhe zhvlerësojnë punën e audituesit. Përcaktimi i objektivave të kontrollit duhet të diskutohet me menaxhimin e organizatës së audituar për të siguruar nëse janë kuptuar si duhet se për çfarë funksionesh janë projektuar dhe implementuar kontrollet. Objektivat e kontrollit duhet të shprehen qartë dhe të përmbledhura. Nuk duhet të jenë të paqarta apo të përgjithësuara. Për shembull do të ishte e vështirë të gjenden bazat e vlerësimit të kontrollit ku objektivat e kontrollit janë shprehur si “sigurim se pagesat janë kryer.” Ky objektiv nuk na tregon se çfarë lloj pagesash, apo kujt. Menaxhimi dëshiron të dijë nëse pagesat bëhen në mënyrë të saktë, në mënyrë të vlefshme dhe në kohë. Frazheologjia e lirshme – vepron si një pengesë për kryerjen e kësaj faze të rëndësishme të auditimit të bazuar në sisteme. Përgjithësimet sikurse “siguria që shërbimet mbështetëse janë adekuate” shkakton më shumë punë sepse duhet përgjigjur pyetjeve shtesë për të sqaruar saktësisht se çka nënkuptohet me perspektivën e audituesit.

Për shembull në një sistem prokurimesh objektivat mund të jenë:

- Të sigurojë që në hartimin dhe lidhjen e kontratave të plotësohen të gjitha kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe direktivave të BE –së për prokurimet publike;
- Të pakësojë koston e prokurimit deri në 5% për çdo vit;
- Të paguajë të gjithë detyrimet e ligjshme nga kontratat në kohe dhe shumën e caktuar.

Objektivat e sistemi mund të jenë si formale dhe të shkruara por gjithashtu dhe joformale. Pavarësisht kësaj në përcaktimin e objektivave duhet të konsiderohen se ka një hierarki objektivash të vendosura nga menaxhimi duke filluar nga menaxhimi i lartë duke zbritur poshtë në hierarki .

Objektivat e kontrollit duhet të përfshijnë kërkesa të përgjithshme të kontrollit sikurse:

- Ekonomia dhe efica
- Parandalimi dhe zbulimi i mashtrimit apo abuzimit
- Besueshmëria dhe përshtatshmëria e informaciveve
- Pajtueshmëria me ligjet, legjislacionin, politikat e menaxhimit dhe rregullat
- Sigurinë e asetëve , pasurisë intelektuale dhe të shënave
- Plotësinë dhe saktësinë e regjistrimeve dhe llogarive në organizatë.

Pasi ka identifikuar objektivat e kontrollit audituesi duhet të regjistrojë dhe të përfshijë ato në Programin e Auditimit

Identifikimi i Risqeve dhe vlerësimi i kontrolleve kundër risqeve

Risqet Kryesore/Titullare "headline risks"

Shpesh është shumë e dobishme të identifikohen risqet kryesore të cilat shoqërojnë çdo objektivë kontrolli dhe të regjistrohen . Kjo siguron që audituesi është i qartë në kuptimin se përse është vendosur objektiva e kontrollit dhe që regjistrimi i sistemit apo aktivitetit mbetet brenda përmasave të objektivave të kontrollit. Kjo mund të ndihmojë dhe në pakësimin e kohës së shpenzuar për përshkrimin e sistemit.

Faza tjetër e Auditimit mbi bazë sistemi përfshin identifikimin dhe vlerësimin e kontrolleve që ekzistojnë apo janë vendosur për të përballur me risqet që mund të ndodhin apo shoqërojnë arritjen e objektivave.

Elementet kryesore të kësaj faze janë :

- Përcaktimi i risqeve lidhur me çdo objektive kontrolli
- Identifikimi i kontrolleve që ekzistojnë aktualisht në sistem;

- Vlerësimi i efektivitetit të këtyre kontrolleve

Risqet duhet të identifikohen për cdo objektive kontrollidhe ato identifikohen mbi bazën e informacionit të mbledhur në fazat e mëprshme . Auidtuesi do te vlerësojë riskun në fazën e planifikimit por gjithashtu dhe hgjatë vetë auditimit.

Risqet klasifikohen në bazë të dy kritereve :

1. Mundësisë që një risk i caktuar të ndodhe në realitet;
2. Impaktit që ky risk do të ketë mbi organizatën nëse do të ndodhe

Klasifikimi i riskut			
	I ULËT	I MESËM	I LARTË
Impakti/ndikimi			
Mundësia/Probliliteti			
I LARTË	I Mesëm	I Lartë	I Lartë
I MESËM	I ulët	I Mesëm	I lartë
I ULËT	I Ulët	I Ulët	I Mesëm

Per tui përgjigjyur pyetjes nëse një risk do të klasifikohet si me impakt të lartë , të mesëm apo të ulët kjo mbete gjithnjë një çështje e gjykimit profesional të auidtuesit dhe rezultat i metodave apo teknikave që ai do të përdorë ne identifikimin dhe vlerësimin e riskut

Faktorët e mundur (karakteristikat, tiparet, cilësitë) të cilat kanë një rol në këtë drejtim janë prioritett e përcaktuara dhe politika e implementimit, risku potenciale i imazhit, si dhe interesat financiarë lidhur me to. Përlllogartija nëse shfaqja e një risku të caktuar është e mundshme apo jo , është rezultat i një gjykimi profesional të audituesit. Kompleksiteti i procesit të audituar dhe kuadri drejtues e administrativ në të cilin zhvillohet procesi janë gjithashtu faktorë të rëndësishmë në llogaritjen e mundëisë dhe impaktit për një risk të dhënë.

Është e rekomandueshme që audituesi të diskutojë me drejtuesit e subjektit të audituar për risqet e identifikuar prej tij si dhe mënyrën se si ai i ka klasifikuar , me qëllim që të sigurohet se nuk është lënë jashtë vëmendjes asnjë faktor risku dhe të shmngjet ndryshimi apo diferencat e panevojshme që mund të ketë midis audituesit dhe të audituarit lidhur me këtë proces.

Audituesi DUHET detyrimisht të përqëndrohet në fushta me risk më të lartë.

Identifikimi i kontrolleve kyce

Për cdo risk , duke përdorur sistemin e përshkruar në fazat e mëprshme të SBA duhet të identifikohen kontrolli apo kontrollet që synojnë të menaxhojnë riskun e identifikuar. Në këtë fazë është shumë e rëndësishme që të regjistrohen kontrollet aktuale që ekzistojnë dhe jo kontrollet ideale që duhet të ekzistonin për situatën apo ato që drejtimi do të dëshironte të kishte vendosur. Gjithashtu duhet të përfshihen dhe personat (klasa dhe pozicioni) i kujt kryen apo perfomon kontrollin dhe ku është vendosur ai.

Kontrollet janë veprime apo procedura të vendosura nga i audituari për të siguruar që objektivat e kontrollit do të arrihen. Edhe nëse arrihen objektivat pa vendosur kontrolle , besueshmëria nuk mund të vendoset apo të jepet për sisteme të cilat funksionojnë pa kontrolle të përshtatshme.

Audituesi ka përgjegjësi të përcaktojë në mënyrë të pavarur nëse kontrollet e sistemit, siç janë projektuar dhe zbatuar nga menaxhimi janë të mjaftueshëm, të përshtatshëm për përmbushjen e *objektivave të kontrollit* të sistemit. Për të

përmbushur objektivat e auditimit, audituesi duhet të kryejë teste të ndryshme mbi kontrollet e identifikuar për të mbledhur dëshmi mbi të cilat mund të bazohet opinioni i tij/saj auditues.

Testet e kontrollit normalisht *nuk* kryhen në të gjitha kontrollet; zakonisht testohen vetëm kontrollet *kyçe*. Këto janë kontrollet që audituesi ka synim t'i testojë për efektivitetin si element bazë për një auditim të besueshëm. Këto janë kontrolle që:

- Janë hartuar të parandalojnë apo zbulojnë keq-deklarimet materiale në *pohime* specifike të pasqyrave financiare. (Pohimet janë deklarime të kuptueshme bërë nga menaxhimi kur paraqesin pasqyrat financiare për shqyrtim. Ato ndërlidhen me konceptet e kontabilitetit të plotësisë dhe saktësisë së informatave, vlerësimi dhe pronësia e të drejtave dhe detyrimeve të deklaruara. Ato gjithashtu përfshijnë, në organizatat e sektorit publik, një vlerësim të *rregullshmërisë*.
- U adresohen të njëjtave probleme sikurse procedurat thelbësore të auditimit, aspektet e realizimit të të cilave mund të kufizohen, nëse kontrollet veprojnë në mënyrë efektive.
- Mund të testohen, d.m.th. të kenë evidencë për funksionimin e tyre në mënyrën e duhur.

Kontrollet kyçe janë identifikuar duke vlerësuar pohimet për të cilat duhet bërë opinion i auditimit. Nganjëherë është e domosdoshme të shikohet funksionimi i *më shumë se një* kontrolli për të dhënë siguri për pohimin. Për shembull nëse auditohet sistemi i arkës *dhe bankave* dhe duhet të shikohet nëse të gjitha hyrjet e parave janë regjistruar në bankë si duhet çdo ditë, nuk do të ekzaminohen vetëm të dhënat e shumave të depozituara. Të dhëna shtesë do të kërkohen duke testuar arkëtime ditore të arkëtarëve individualë për t'u siguruar se ato janë balancuar. Pastaj do të testohet për t'u siguruar se arkëtimet e arkëtarëve janë barazuar me totalin ditor të bankës. Kështu që janë tri teste të ndryshme të kontrollit që do të duhe të kryhen për të vlerësuar nëse të gjitha arkëtimet e parave janë proceduar në bankë / transaksionet e arkës me bankën janë përpunuar në rregull.

Anasjelltas, funksionimi efektiv i një kontrolli mund të ofrojë siguri në më shumë se një pohim. Kontrollet kyçe më shpesh janë kontrolle *zbuluese* sesa *parandaluese* p.sh. ato i tregojnë menaxhimit se diçka *ka* shkuar gabim dhe jo të veprojnë më parë për të ndaluar mosfunksionimin e një gjëje. Megjithatë disa kontrolle mund të veprojnë si parandaluese edhe si zbuluese.

Testet në qajsen e auditimit mbi bazë sistemi

Kur kryhet auditim me përdorim të ABS-së, zakonisht përdoren dy lloje kryesore të testeve të auditimit. Këto njihen si *teste të kontrollit/plotësuese* dhe *testime thelbësore/substanciale*. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit kërkojnë të përdoren *të dy* llojet e testeve për nivele të ndryshme kur kryejmë procedurat tona të auditimit, p.sh. ne s'mund ta bazojmë opinionin tonë vetëm në vlerësim të dhënave që mbledhim duke përdorur testimin e kontrolleve apo vetëm testimin thelbësor/substancial. Megjithatë, me rritjen e përvojës dhe gjykimit me kohë, ne mund të zhvillojmë aftësinë për të përdorur një lloj të testit në atë mënyrë që mund të jemi të aftë për të *reduktuar* sasinë e testimit që kërkohet duke përdorur llojin tjetër, objektivi për të audituar në mënyrë më efikase e efektive (p.sh. përdorimi i burimeve) kësajsoj demonstron shtimi i vlerës së organizatës.

Testet e kontrollit

Testet e kontrollit/plotësuese janë teste, të cilat synojnë t'u sigurojnë evidencë audituesve mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm të vendosur nga manaxhimi (dhe i identifikuar nga sistemet e vlerësimit të kontrollit), realizohen në përputhje me synimet dhe përshkrimet.

Kryesisht ato nuk synojnë të jenë mjete për identifikimin e gabimeve apo të dështimeve për të arritur objektivat. Nëse gjatë testeve të kontrollit/plotësuese vihen re mungesa, audituesit duhet të tregojnë interes për to, pasi identifikojnë pamjaftueshmërinë e mundshme të kontrollit. Gabimet e gjetura gjatë testeve plotësuese mund të tregojnë për dobësinë e kontrollit.

Testimi i kontrolleve mund të kryhet në katër mënyra kryesore:

1. **Monitorimi/vëzhgimi** i personeli në kryerjen e detyrave të zakonshme dhe intervistimi i tyre për të vlerësuar nivelin e njohurive të tyre për punët që menaxhimi u ka ngarkuar.
2. **Ekzaminimi** i evidencave të dokumentuara mbi funksionimin e kontrolleve.
3. **Realizimi i vëzhgimit/rikryerja e modelimit** në një grup transaksionesh (veprimesh) apo në elemente të tjera, të cilat kanë ‘kaluar’ nëpërmjet kontrolleve, dhe
4. **Përdorimi në masë i të dhënave të shkallëzuara/të ndryshme** (për të dhënat cilësore mund të përdoren shkallëzime për të marrë opinione sh.p.) për të përcaktuar, nëse kontrollet janë eficiente në zbulimin e gabimeve të tilla.

Shembujt e testeve të kontrollit në sistemin e blerjes mund të përfshijnë:

- Kontrollimin se porositë/urdhrat janë vendosur duke përdorur mjete të kontrolluara zyrtarisht.
- Sigurimi se porositë/urdhrat janë kontrolluar dhe autorizuar nga nënshkruesit e miratuar.
- Kontrollimi se porositë/urdhrat janë vënë vetëm me furnizuesit e miratuar apo, ku nuk respektohet kjo praktikë, tenderi më i ulët për furnizim është pranuar.
- Sigurimi se të gjitha dokumentet për mallrat e pranuar përputhen me urdhërblerjet dhe sasia/cilësia e artikujve të pranuar është sipas specifikimeve .
- Audituesi duhet të dokumentojë plotësisht, në dokumentet e auditimit, arsyen për propozim dhe plotësim të llojit të testit të kontrollit që është duke u përdorur. Kjo shërben për të treguar se audituesi kupton:
 - Cfarë evidence duhet të grumbullohet nga testi.
 - Se procedurat e kontrollit duhet të konsiderohen si objekt kontrolli në vetvete dhe jo vetëm transaksionet, dhe

- Detaje se si duhet të realizohen duke përfshirë dokumentat, personelin dhe procedurat e duhura.

- Për vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrolleve/plotësuese duhet të merren në konsideratë:

(1) A funksionojnë kontrollet në mënyrë të kënaqshme gjatë periudhës, së cilës audituesi i referohet?

(2) A janë plotësuar në mënyrë të kënaqshme objektivat e kontrollit?

Së fundi, audituesi, duke realizuar të gjitha këto teste, duhet të jetë i aftë të nxjerrë konkluzione mbi nivelin e besueshmërisë së kontrolleve kyc dhe, për rrjedhojë, mbi nivelin e testeve thelbësore që kërkohen.

Testimi thelbësor/substancial

Testet thelbësore/substanciale kanë të bëjnë me testimin e *transaksioneve dhe tepricave* në regjistrimet e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, e jo funksionimin e kontrolleve në sistem i cili regjistron dhe prodhon shifrat. Testet thelbësore (dhe teste të tjera të tilla si procedurat analitike thelbësore) janë testet e transaksioneve dhe të tepricave, të cilat synojnë t'i sigurojnë audituesit evidencë mbi plotësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e informacionit të përfshirë në regjistrimet kontabël ose në pasqyrat financiare. Ato janë të lidhura më shumë me rezultatin/outputin se sa me mjaftueshmërinë e kontrolleve, prandaj kanë një rol të kufizuar në krijimin e një opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve. Kështu, ato mund të jenë të dobishme për të treguar shkallën e ekzitencës së një dobësie nëse manaxhimi nuk bindet me mjetet e tjera. Nëse testimi tregon në mënyrë të suksesshme se transaksionet dhe tepricat janë korrekte, atëherë kjo mund të merret si dëshmi që shifrat në regjistrimet e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare me siguri janë korrekte materialisht

Nëse testet plotësuese provojnë një situatë të kënaqshme, d.m.th. kontrollet janë duke funksionuar sikurse përshkruhet, atëherë testet thelbësore do të kufizohen.

Testet thelbësore mund të grupohen në dy kategori:

- **Testet e detajuara**, të cilat përfshijnë testet e transaksioneve të vecanta apo të tepricave për t'u siguruar se ato janë të sakta, të vlefshme dhe të plota, dhe
- **Procedurat Analitike (PA)**, sipas të cilave krahasohen tendencat, tepricat duke u krahasuar me të dhëna të tjera financiare apo jofinanciare për periudha të ndryshme kohore apo midis rajoneve. Të dhënat mund të krahasojnë llojet e njëjta të gjendjeve/tepricave ndërmjet dy apo më shumë periudhave kontabël. Mund të krahasojë tepricat ndërmjet muajve brenda të njëjtës periudhë kontabël. Audituesit i kërkohet të përdorë gjykimin në zgjedhjen se cilat shmangie të veçanta të papritura nga tendenca për testim të mëtejshëm; ngjarjet e papritura, për shembull të ardhurat apo shpenzimet që nuk mund të shpjegohen nga faktorët e njohur duhet gjithashtu të nxisin audituesin për testime të mëtejshme.

Nxjerrja e Konkluzioneve

Kjo është faza në një auditim mbi bazë sistemi ku audituesi konsideron rezultatet e punës së bërë para se të raportojë për fushën e audituar. Është shumë e rëndësishme që të mendohet dhe të analizohen me kujdes gjetjejt dhe konkluzionet duke i analizuar ato përgjatë gjithë procesit të vlerësimit dhe testimit.

Rezultatet paraqiten në një strukturë të dibishme për administrimin e informacionit që është marrë dhe për të menduar në mënyrë llogjike kur përgatitet raporti i auditimit . Ajo përmban shkaqet e problemit apo të dobësisë që është identifikuar nga vlerësimi i sistimit të kontrollit dhe shërben për të zhvilluar rekomandimet e përshtatshme.

Së fundmi të gjitha sa më sipër paraqiten në Raportin e Auditimit.

PËRDORIMI I ABS

Vendimi për të përdorur Auditimin e Bazuar në Sisteme (ABS) duhet marrë në fazën e planifikimit dhe duhet të merren në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- ABS është e përshtatshme vetëm në *sistemet kryesore* të cilat janë materiale për organizatën. Ajo është më efiçiente për auditimin e sistemeve të vogla duke vëzhguar kontrollet bazë, pa të cilat regjistrimet kontabël do të ishin të pabesueshme (rakordimet e llogarisë "banka" me konfirmën bankare), dhe atëhere realizohen vetëm teste thelbësore.
- ABS, vecanërisht, është i përshtatshëm për sistemet që përpunojnë **volume të mëdha** transaksionesh. Shuma monetare e transaksioneve në total mund të jetë e lartë, por nëse numri i transaksioneve është i vogël, p.sh. disa sisteme të aktiveve të qëndrueshme, mund të jetë më efiçiente të realizohen teste thelbësore për transaksionet me volum të madh.
- Përpara se të vendosë të përdoret ABS, audituesi duhet të ketë **njohuri bazë** mbi sistemin për të përcaktuar nëse ai mund të bazohet në kontrollet.
- Nëse rikryerja/rikthimi i **auditimit** kërkon që të vlerësohen sisemet e kontrolleve, ABS është një metodë e dobishme, por nëse nuk është i nevojshëm vlerësimi, atëhere evidentimi i sistemit nuk duhet të jetë shumë i detajuar nëse ai nuk do të përdoret në vitet e ardhshme.

ASB, gjithashtu, mund të aplikohet në sistemet jofinanciare. Për shembull, ajo mund të aplikohet në sistemet e manaxhimit të personelit, sistemet e hartimit të politikave dhe në ndonjë aspekt tjetër të aktiviteteve që mund të lidhen me burimet, përpunimin dhe rezultatet.

Disa literatura rekomandojnë që auditimi i brendshëm duhet vetëm të vlerësojë sistemin dhe të nxjerrë konkluzione që kontrollet janë qarta (të plota). (Standartet e auditimit kërkojnë që audituesit e jashtëm të realizojnë disa teste thelbësore në formimin e opinionit të tyre megjithëse ata mund të përcaktojnë masën e testeve.)

Megjithatë, asnjë sistem nuk mund të jetë i garantuar që të parandalojë apo zbulojë cdo mashtrim apo gabim dhe asnjë sistem nuk mund të sigurojë ndaj fenomeneve të tilla si marrëveshjet midis personelit mashtrues. Për këtë arsye disa teste thelbësore gjithmonë duhet të realizohen nga auditimi i brendshëm. Audituesit e brendshëm dhe të jashtëm përcaktojnë objektiva të ndryshme kontrolli. Audituesit e jashtëm fokusohen më shumë në vërtetësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare dhe rregullsinë e transaksioneve, megjithëse ata do të paraqesin manaxherëve një letër ku të shprehin cdo dobësi (dhe rekomandimet e përmirësimeve) që ata kanë ndeshur. Audituesi i jashtëm në mënyrë të vecantë duhet të ndërmarri auditimin e vlerës (eficencës së përdorimit) së parash dhe ti raportojnë manaxhimit. Auditimi i brendshëm fokusohet më shumë në Vlerën e Parave të konsumuara gjatë punës së tyre audituese bazuar në sisteme se sa audituesit e jashtëm, por gjithashtu, mund të ndërmarri projekte të vecanta për të vëzhguar vlerën e parave të konsumuara në aspekte të vecanta.

AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E SBA-së

Një SAB vlerëson performancën e njësisë në lidhje me objektivat e drejtimit dhe pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat. Nëpërmjet saj adresohen papërshtatshmëritë dhe dobësitë për të siguruar që nuk ka shmangie material nga drejtimit e vendosura më parë. Rekomandimet ndihmojnë për të përmirësuar eficencën dhe efektivitetin dhe gjithashtu për të arritur qëllimet e organizatës.

Theksi vendoset gjithnjë mbi operacionet apo hallat inefficente.

Përdorim optimal të burimeve. Këto lloj qasjesh auditimi kërkojnë një kuptim të thellë të subjektit të audituar si dhe kontrollet e brendshme të përcaktuar për cdo veprimtari. Dhe këto njohje janë jetësore përderisa njësitë organizative janë të ndryshme. Gjatë auditimit mbi bazë sistemi identifikohen dhe u jepet prioritet pikërisht fushave me risk më të lartë dhe kjo siguron që shume prej burimeve ndoshta të kufizuara të auditimit të përdoren për fushat më problematike.

Megjithatë edhe kjo qasje ka anët e saj të papërshtatshme apo disavantazhe krahasuar me qasje të tjera:

- ❖ Vështirësi në marrje e evidencave . Një disvantazh është që kjo qasje kërkon evidencë domethënëse për të mbështetur matjen e pritshme të efikasitetit dhe performancës. Testet e përdoruar gjerësisht përfshijnë dokumentimin, vëzhgimin dhe analizat. Nëse auditimi ekzaminon aktivitet komplekse atëherë marrja e evidencës është e vështirë dhe kërkon ekspertizë teknike e cila ndoshta mund të mos jetë e disponueshme .

- ❖ Mungesa e standarteve të vlerësimit . Për cdo situatë duhet të përcaktohen apo zhvillohen kriteret e ndryshme . audituesi do t'i duhet të studiojë tendencat historike, ekzaminojë standarte të grupeve të ngjashme apo të përdorë standarte absolute dhe të negociuara për të përcaktuar një kriter të përshtatshëm. Pra nuk ekzistojnë standarte raportuese për një qasje auditimi mbi bazë sistemi pasi cdo auditim ka kërkesa dhe rezultate specifike.

KONKLUSIONE

Më sipër u diskutua mbi paraprirësit apo parakushtet dhe arësyet e qasjes së auditimit mbi bazë sistemi. Gjithashtu përshkruam bazën konceptuale dhe elementët krye të SBA. Vërejtëm gjithashtu se duke adoptuar qasjen e SAB auditues perception auditimit si një proces mbi bazë besimi, vlerësimi të riskut dhe të udhëhequr nga dëshmitë apo evidencat. Gjatë analizës u përshkrua se sa i rëndësishëm është njohja e subjektit që auditohet , identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të cilat më pas pritet të jenë menaxhuar në mënyrë efektive nga drejtimi i subjektit të audituar me qëllim rritjen e sigurisë së objektivat dhe qëllimet e organizatës do të parrihen.

Një mesazh i spikatur është që SBA ka ardhur si rezultat i përpjekjeve për të rritur cilësinë e auditimit si përgjigje apo në përshtatje të ndryshimeve në ambientin e auditimit. Në vijim një mesazh tjetër është që SBA vazhdon të ekujlibrojë dhe të adoptohet gjithnjë e më shumë ndaj ndryshimeve më të fundit dhe në mënyrë të

vecantë kërkesës së publikut dhe shoqërisë për një përgjegjshmëri më të madhe në përdorimin e fondeve publike. Megjithatë duhet theksuar se të tilla adptime kërkojnë investime intelektuale të vazhdueshme, të rëndësishme nga audituesit si dhe institucionet e auditimit.

Ndërsa drejtuesit kanë një detyrë të rishikojnë dhe të testojnë komntrollet e tyre, është shumë e rëndësishme që audituesit e pavarur të rishikojnë dhe vlerësojnë gjithahstu këto kontrole, SBA ofron metodologjinë për rishikim nga të dy palët, audituesit dhe drejtuesit. Po kështu si audituesit e brendshëm ashtu dhe audituesit e jashtëm janë të interesuar për kontrollet e brendshme dhe për kete kanë nevojë të testojë ato me qëllim që të fitojnë sigurinë e kërkuar. Megjithatë ka një dallim midis dy llojeve të audituesve që lind gjithashtu nevojën për një qasje të koordinuar të të dyve për të siguruar që të gjitha fushat nën përgjegjësinë e auditimit janë mbuluar .

Një metodologji e auditimit mbi bazë sistemi e cila synon të arrijë këtë qasje të koordinuar duhet të plotësojë apo përmbushë objektivat e auditimit dhe brendshëm dhe auditimit të jashtëm dhe të ndihmojë ata të pakësojnë përdorimin e burimeve të auditimit. Kjo është shumë më e lehtë se të dy auditimet të përdorin të njëjtën metodologji. Të tilla qasje duhet të përfshijnë:

- një auditim eficient dhe të koordinuar pa mbivendosje;
- audituesit e jashtë të vendosin besueshmëri maksimale të arëyetuar mbi auditimin e brendshëm
- përpyekjet e auditimit të fokusohen në mënyrë më efektive.

Në kushtet e KLSH SBA nuk ka filluar të zbatohet ende. Kanë filluar përpyekjet e para në përkrahjen e të tillë qasje por ndërmarrja e të tilla ndryshimeve kërkon zhvillimin e angazhimeve të përbashkëta dhe ndryshime në qëndrime dhe mentalitet krahasuar me qasjet ttradicionale të përdoruar der më tani nga audituesit e KLSH. Reformimi është një udhëtim i gjatë dhe i vështorë frutet e të cilit përfitohen vetëm nëse ai ndiqet në vijimësi dhe bazohet në një vision dhe strategji të mire përcaktuar.

Iniciativa e KLSH do të mundësojë që ky institucion të bëhet avokati i reformave i udhëhequr nga shembujt e praktikës së mirë ndërkombëtare. Këto përpjekje të vazhdueshme do të mundësojnë Institucionin tonë Auditues të krijojë dhe mbajë të lart besimin dhe besueshmërinë e qytetarëve të cilëve ai u shërben.

Efikasiteti i auditimit të brendshëm në Shqipëri

Nga Kesjana Halili, M.A në Bankë dhe Financë, PHD Kandidat

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatorë dhe Kontrolluese

Ministria e Financave



Abstrakti

Roli i rëndësishëm që ka auditimi i brendshëm në garantimin që përdorimi i parave të taksapaguesve bëhet me kursim, dobi dhe frytshmëri, varet ndjeshëm nga efikasiteti i këtij funksioni.

Ky punim vlerëson strukturat e auditimit të brendshëm në Shqipëri, për sa i përket nivelit të mbështetjes së tyre nga menaxhimi, pavarësisë, nivelit profesional të audituesve të brendshëm dhe cilësisë së auditimeve, elementë të cilët ndikojnë në efikasitetin e funksionit të auditimit të brendshëm.

Gjetjet e punimit nënvizojnë që auditimi i brendshëm në sektorin publik në Shqipëri mbështetet në nivelin e duhur nga menaxhimi. Ndërkohë, pavarësia jo e duhur e auditimit të brendshëm, profesionalizmi dhe cilësia relativisht e ulët e auditimeve, rrjedhojnë në konkluzionin që këto çështje duhet të adresohen për përmirësim, për të rritur performancën e auditimit.

Fjalë kyçe: *Auditimi i brendshëm, Efikasitet, Pavarësi, Profesionalizëm.*

1. Hyrje

Në mënyrë që auditimi i brendshëm të jetë sa më efikas dhe të përmbushë qëllimin e ekzistencës së tij, duhet të ketë tërësisht mbështetjen e menaxhimit, të jetë i pavarur, të gëzojëtribute profesionale të larta, duke rezultuar kështu dhe në një

punë cilësore auditimi. Kështu, mbështetja menaxheriale me burime të mjaftueshme si dhe angazhimi për të implementuar rekomandimet e auditimit të brendshëm është thelbësore në rritjen e efikasitetit të auditimit. Gjithashtu, parametrat organizative në të cilat operon auditimi i brendshëm, pra statusi organizativ i njësisë së auditimit, organizimi i saj i brendshëm si dhe politikat e procedurat e aplikuara për çdo njësi të audituar, duhet të mundësojnë një auditim efikas, që çon në gjetje dhe dhënie të rekomandimeve të dobishme, gjithmonë në funksion të përmirësimit të veprimtarisë dhe arritjes së objektivave të organizatës. Për më tepër aftësia profesionale, qëndrimi dhe niveli i bashkëpunimit të audituesve ndikon në efektshmërinë e auditimit. Kjo e fundit sigurisht çon në një proces auditimi cilësor, me gjetje dhe rekomandime të vlefshme, të cilat çojnë dhe në rritjen e interesit të menaxhimit në rekomandimet e auditimit.

Duke mbajtur në konsideratë faktorët e përmendur më lart dhe lidhjen ndërmjet tyre, mund të themi që efikasiteti i auditimit të brendshëm, duhet të shikohet si një proces dinamik, i cili vazhdimisht ndryshon formën e tij nga ndërveprimet mes katër elementëve.

Synimi këtij punimi është të trajtojë nëse strukturat e auditimit të brendshëm në sektorin publik në Shqipëri, kanë mbështetjen e duhur nga menaxhimi, kanë nivelin e duhur të pavarësisë, si dhe profesionalizmin dhe cilësinë e duhur për kryerjen e funksionit të auditimit.

Në pjesën e parë të punimit trajtohet rëndësia e këtyre elementëve në efikasitetin e auditimit, duke vijuar në pjesën e dytë me trajtimin e disa studimeve në këtë fushë. Pjesa e tretë përcakton metodologjinë dhe në pjesën e katërt trajtohen gjetjet dhe diskutime të punimit. Në përfundim, jepen disa konkluzione dhe rekomandime për rritjen e efikasitetit të auditimit të brendshëm në Shqipëri.

2. Studime mbi efikasitetin e auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm përkufizohet nga Instituti Ndërkombëtar i Audituesve të Brendshëm (IIA) si “Një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për menaxhimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e organizatës. Auditimi i brendshëm e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësisë publike”.

Van Gansberghe (2005) ka arritur në konkluzionin që efikasiteti i auditimit të brendshëm në sektorin publik, duhet të vlerësohet duke mbajtur në konsideratë nivelin e ndikimit të kryerjes së këtij funksioni në përmirësimin e efikasitetit dhe efijencës së ofrimit të shërbimeve tek publiku. Vetëm në këtë mënyrë del në pah dhe rëndësia që ka kryerja e funksionit të auditimit të brendshëm në çdo organizatë.

Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit nuk do të shërbejnë, nëse menaxhimi nuk është i angazhuar për zbatimin e tyre. Adams (1994) përdori teorinë e “agjencisë” për të shpjeguar se është në interes të menaxhimit mbajtja e një strukture të fortë të auditimit të brendshëm. Zbatimi i rekomandimeve të auditit është shumë i rëndësishëm për efektivitetin e auditimit (Van Gansberghe, 2005). Si rrjedhim, zotimi i menaxhimit për të përdorur rekomandimet e auditimit dhe mbështetja e tij për të forcuar auditin e brendshëm është thelbësore për efektivitetin e auditimit (Sawzer, 1995).

Parametrat organizativë i referohen profilit të organizatës, organizimit të brendshëm dhe statusit si dhe buxhetit të strukturës së auditimit të brendshëm; gjithashtu dhe organizimit të politikave dhe procedurave që udhëzojnë punën e njësisë të audituar. Si rrjedhim, parametrat organizativë ose e thënë ndryshe niveli i pavarësisë, mund të ushtrojnë influencë në efikasitetin e auditimit të brendshëm.

Efikasiteti i auditimit të brendshëm kontribuon gjerësisht në efikasitetin e secilit auditues të marrë në veçanti dhe organizatës në përgjithësi (Dittenhofer, 2001).

Dittenhofer (2001) gjithashtu ka vëzhguar se në qoftë se cilësia e auditit të brendshëm mbahet, kjo do të kontribuojë në përshtatjen e procedurave dhe operacioneve të njësisë së audituar dhe për këtë arsye auditimi i brendshëm kontribuon në efikasitetin e të audituarit dhe organizatës si e tërë. Po ashtu, duke përdorur teorinë e “agjencisë”, Xiangdong (1997) shpjegon rolin që auditimi i brendshëm luan në një ekonomi dhe nxjerr në pah se auditimi i brendshëm ka një avantazh përkundrejt auditimit të jashtëm në sigurimin e shpejtë të informacionit dhe kapjen e problemeve në një shkallë të hershme të zhvillimit të tyre. Gjithashtu dhe Spraakman (1997), duke aplikuar teorinë e kostos ekonomike të transaksionit, provon se si rekomandimet e auditimit të brendshëm, janë të rëndësishme për menaxhimin e institucioneve publike.

Cilësia e auditimit të brendshëm, e cila kushtëzohet nga kapaciteti i njësisë të auditimit të brendshëm për të siguruar gjetje dhe rekomandime të vlefshme, është thelbësore për efikasitetin e auditit të brendshëm. Auditimi i brendshëm duhet të provojë se është një vlerë e shtuar për organizatën dhe të fitojë një reputacion brenda kësaj të fundit (Sawyer, 1995). Auditimi i brendshëm duhet të vlerësojë performancën e tij dhe në mënyrë konstante të përmirësojë shërbimet e tij (Ziegenfus, 2000). Auditimi i brendshëm është funksion i shkallës së njohurive të stafit, fushës së shërbimeve të ofruara dhe nivelit se si auditimet janë të planifikuara, implementuara dhe të komunikuar.

Duke mbajtur në konsideratë gjetjet e studimeve të mësipërme, mbi faktorët që ndikojnë në efikasitetin e strukturave të auditimit të brendshëm, në vijim të këtij punimi do të trajtohet niveli i këtyre të elementëve në strukturat e auditimit të brendshëm në sektorin publik në vendin tonë.

3. Metodologjia

Punimi është bazuar në të dhëna primare të siguruar nga pyetësorët e vetëvlerësimit nga disa njësi të auditimit të brendshëm në sektorin publik (14 njësi auditimi në Ministrinë e Linjës dhe 20 njësi auditimi të pushtetit vendor). Pyetjet në


këtë pyetësor janë të grupuara në katër seksione, përkatësisht: mbështetja nga menaxhimi, pavarësia, profesionalizimi i audituesve dhe cilësia e auditimeve. Secili nga këto seksione përbëhet nga 5 deri në 10 pyetje, rreth këtyre katër elementëve. Të dhënat e punimit janë paraqitur të grupuara për gjithë njësitë e auditimit të përfshira dhe rezultatet për çdo faktor që ndikon në efikasitetin e auditimit janë trajtuar në seksionin në vijim.

Gjithashtu, në realizimin e këtij punimi janë përdorur dhe të dhëna sekondare të siguruar nga publikime të Ministrisë së Financave mbi vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik. Të dhënat sekondare kryesisht janë përdorur për të trajtuar cilësinë e auditimit si dhe aftësitë profesionale të audituesve.

4. Gjetjet dhe diskutime

Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur dhe udhëhequr ndryshime pozitive dhe përmirësime të mëtejshme. Një maksimizim i funksionit të auditimit të brendshëm do të thotë rezultate, përmirësim dhe vlerë.


Fillimisht, nga të dhënat e grumbulluara nga pyetësori i vetëvlerësimit rezulton që njësitë e auditimit të përfshira në punim, janë përgjigjur në masën më të madhe pozitivisht grupit të pyetjeve për çdo faktor që ndikon në efikasitetin e auditimit. Sikurse tregohet në grafikun më poshtë, niveli i mbështetjes nga menaxhimi është në masën 81% pozitiv dhe vetëm 19% të rasteve nuk gjejnë mbështetje nga menaxhimi. Pavarësia e auditimit rezulton në 76% të njësive të përfshira në punim. Ndërkohë, zhvillimi profesional dhe cilësia e auditimit, vetë vlerësohen nga strukturat e auditimit në nivele ende më të larta, përkatësisht 91% dhe 84%.



Krahas rezultateve të marra nga pyetësi i vetëvlerësimit, do të trajtohen këto elementë, sipas vlerësimit të Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, bazuar në raportimet dhe vlerësimet e cilësisë së punës audituese.

4.1. Mbështetja nga menaxhimi

Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi, rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara. Nëse menaxhimi nuk mbështet dhe merr në konsideratë rekomandimet e auditimit, atëherë struktura e auditimit do luante një rol pasiv, që do të konsistonte thjesht në dhënien e rekomandimeve, që jo rrallë rezultojnë të paqarta dhe të paaplikueshme dhe në këtë rast nuk do të bëhej fjalë për përmbushje të misionit dhe objektivave strategjike, pra për të shtuar vlerë apo përmirësim të veprimtarisë së subjektit të audituar. Për këtë arsye, vlerësimi i veprimtarisë së strukturave të auditimit nuk duhet kufizuar vetëm në paraqitjen e propozimeve për masa dhe rekomandime, por duhet konsideruar si tregues i rëndësishëm dhe niveli i zbatimit të tyre. Grafiku i mëposhtëm jep informacion mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë vitit 2013. Konstatohet se treguesi për zbatimin e rekomandimeve është pozitiv, pasi përveç faktit që ato janë pranuar 100%, zbatueshmëria e tyre është në nivele të pranueshme, 61% dhe pjesa tjetër është në proces zbatimi.



Krahas mbështetjes nga menaxhimi të strukturave të auditimit në pjesën më të madhe të njësive publike, mund të themi që në disa njësi të pushtetit vendor, nuk i kushtohet rëndësia e duhur funksionin të auditimit. Ky vlerësim mbështetet me faktin që disa njësi vendore, i kanë strukturat e auditimit me vetëm një pozicion pune auditues, çka bie ndesh me standardet e kryerjes së punës së auditimit. Po ashtu, ekzistojnë dhe institucione të pushtetit qendror të cilat nuk e realizojnë funksionin e auditimit të brendshëm (16 institucione të pavarura).

4.2. Pavarësia e Auditimit të brendshëm

Baza ligjore për auditimin e brendshëm në Shqipëri, përcakton qartë si një nga parimet bazë pavarësinë funksionale të veprimtarisë së auditimit të brendshëm si dhe linjën e raportimit të këtij funksioni drejtpërdrejt tek titullari i njësisë publike. Por a është funksioni i auditimit të brendshëm totalisht i pavarur në sektorin publik?

Të dhënat dhe vlerësimet e çdo viti nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, tregojnë se roli i audituesit të brendshëm nuk vlerësohet siç duhet dhe shpesh ky parim nuk respektohet, duke shkelur apo krijuar kushtet për shkeljen e pavarësisë në veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe në disa raste edhe të audituesve në ushtrimin e funksionit të tyre.

Kjo vërtetohet me faktin që në disa raste menaxhimi ende kërkon nga strukturat e auditimit të kryejë detyra që lidhen me inspektimin financiar. Njëkohësisht, nëse i referohemi realizimit të planit sipas llojeve të auditimit të brendshëm gjatë vitit 2013,

vërehen shmangie të realizimit të programeve nga ato të planifikuara dhe për këto devijime njësitë e auditimit paraqesin si faktorë: i) ndryshimin e prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut (fushat e konsideruara me risk të ulët gjatë fazës së planifikimit kanë rezultuar me risk të një shkalle më lartë dhe anasjelltas); ii) mbyllja dhe ristrukturimi i një numri të njëjësive; iii) ndërhyrja e titullarëve në implementimin e planeve të auditimit, duke kërkuar auditime të rëndësishme të veçantë jashtë planeve; iv) mbivendosja e misioneve të auditimit të parashikuara nga strukturat e auditimit të brendshëm me auditimet e kryera nga institucione të tjera audituese, veçanërisht nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.



Nisur nga ky konstatim vlerësohet që shmangiet e shpeshta nga planet vjetore, auditimet me urdhër të menaxhimit rrisin ndjeshëm riskun e prekjes së pavarësisë funksionale të njësisë së auditimit, që shprehet pikërisht në hartimin e pavarur të planeve të auditimit dhe në gjykimin mbi bazë risku të subjekteve dhe fushave që duhen audituar. Ky fenomen është konstatuar në shumicën e njëjësive të auditimit të vlerësuara e të monitoruara.

Bazuar në sa më sipër konkludojmë që funksioni i auditimit jo në të gjitha rastet operon në pavarësi të plotë, gjë e cila nuk krijon ambient të përshtatshëm për ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare.

4.3. Niveli Profesional i Audituesve të Brendshëm

Kryerja e funksionit të auditimit të brendshëm është e dobishme dhe e frytshme vetëm nëse ekzistojnë aftësitë, mjetet dhe burimet e nevojshme institucionale dhe profesionale për të mbështetur këtë funksion. Zhvillimi i vijueshëm profesional i audituesve është një kërkesë dhe e standardeve ndërkombëtare, sipas së cilave minimalisht çdo auditues duhet të ndjekë 80 orë trajnimi të vijueshëm çdo 2 vjet, për të mbajtur dhe zhvilluar më tej aftësitë profesionale.

Niveli aktual i formimit profesional dhe aftësive të punonjësve të strukturave të auditimit në sektorin publik, është larg standardeve të kërkuara. Zhvillimi i ulët profesional i audituesve të brendshëm në sektorin publik, është një problem që prek pothuajse gjithë strukturat e auditimit, ku problem më shqetësues paraqitet në strukturat e vartësisë dhe të pushtetit vendor, krahasuar me strukturat e qeverisjes qendrore, ku janë të përqendruara kapacitetet me aftësi më të larta profesionale. Të dhënat mbi profilin e edukimit dhe eksperiencën në punë të audituesve të punësuar në sektorin publik, paraqiten në grafikun më poshtë:



Sikurse paraqitet më lart rreth 57% e audituesve kanë një eksperiencë në profesion mbi 5 vjet dhe 43% kanë punuar më pak se 5 vjet në auditim.

Struktura përgjegjëse për grumbullimin e nevojave për trajnim të audituesve të brendshëm në sektorin publik si dhe, për organizimin e këtyre trajnimeve është Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave. Kjo njësi që nga miratimi i ligjit të ri të auditimit në vitin 2007 dhe i rishikuar në vitin 2010, është fokusuar në certifikimin e audituesve të brendshëm dhe vetëm në vitin 2011 është zhvilluar procesi i trajnimit të vijueshëm profesional për rreth 100 auditues. Pra një nga arsyt e mos kualifikimit të stafit të njësive të auditimit është dhe mos organizimi i trajnimeve nga kjo njësi.


Gjithashtu, sigurimi i qëndrueshmërisë së stafit profesional është një problem që ndeshet jo rrallë veçanërisht në strukturat audituese të brendshëm të subjekteve publike. Lëvizjet e pa arsyetuara të stafit të trajnuar sjellin jo vetëm humbjen e eksperiencës profesionale të fituar, por ndikojnë dhe në cilësinë e auditimeve të kryera.

4.4. Cilësia e Auditimeve

Cilësia e veprimtarisë audituese kushtëzohet nga shumë faktorë, që nga aftësitë profesionale të stafit të auditimit, ndjekjes dhe zbatimit të procedurave ligjore dhe rregullative në kryerjen e veprimtarisë së auditimit, niveli i pavarësisë si dhe mbështetja nga manaxhimi.

Sigurimi i një niveli të lartë të cilësisë së punës së strukturave audituese mbetet problem që shtrohet vazhdimisht për zgjidhje, si në analizën e punës së njësisë të auditimit në subjektet publike, po ashtu dhe e parë në kuadrin e gjithë sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Grafiku i mëposhtëm tregon auditimet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara nga strukturat e auditimit të brendshëm në vitin 2013 sipas llojeve të auditimeve:



Nga grafiku më lart, konstatohet që strukturat e auditimit të brendshëm, fokusohen gjerësisht në kryerjen e auditimeve të plota. Auditimet e plota të sistemeve vlerësohen

problematike, pasi konsumojnë dhe kërkojnë një përqendrim të shumë burimeve dhe njëkohësisht krijojnë ndërprerjen e shumë veprimtarive të organizatës. Gjatë një misioni të tillë auditimi, veprimtaria e auditimit rrezikon të mos rezultojë produktive, për shkak të punës voluminoze që duhet të kryhet. Auditimet e plota nuk e lejojnë auditimin të fokusohet në aspekte specifike të proceseve. Gjithashtu, kuadri i gjerë i auditimeve të plota, mund të rezultojë në nënvlerësimin e mangësive në procese të caktuara.

Veprimtaria e vlerësimit të riskut konsiderohet si një faktor i rëndësishëm, i cili ndikon pozitivisht në përmirësimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe sigurimin e cilësisë së punës audituese, pasi ky vlerësim siguron përmirësimin e kësaj veprimtarie në sektorin publik dhe mundëson një vlerësim më të plotë të sistemeve për veprimtarinë e subjekteve që auditohen dhe njëkohësisht siguron lidhjen midis vetë sistemeve, ku i njëjti faktor risku mund të ketë impakt zinxhir për disa nënsisteme të lidhura ndërmjet tyre.

Vlerësimi i riskut mbetet një proces ende shumë pak i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë nga audituesit e brendshëm. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut nuk janë praktika të zakonshme të punës audituese. Nga ana tjetër, për vetë drejtimin e subjekteve publike, koncepti i “Menaxhimit të Riskut” dhe vendosjes së kontrolleve, pikërisht si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje e re, nga produktet e së cilës nuk përfitohet.

Referuar vlerësimit të kryer nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, gjatë vitit 2013 faktorët të cilët nënvizojnë efikasitetin e ulët të strukturave audituese dhe paralelisht vështirësojnë punën në arritjen e objektivave të auditimit janë:

1. Cilësia e përgatitjes së materialeve vlerësohet jo në nivelet e kërkuara nga standardet, pasi raportet e auditimit nuk janë të plota dhe rrallë herë pasqyrojnë performancën e vetë subjektit. Mangësi këto të konstatuara më dendur në vlerësimin e njësive të pushtetit vendor.

2. Në disa prej strukturave të auditimit, konstatohet se audituesit nuk kanë njohuri të thella mbi konceptin dhe vlerësimin e plotë të kontrollit të brendshëm. Rezulton në jo pak raste se kur bëhet një vlerësim i sistemeve të kontrollit, në shumicën e tyre kjo bëhet duke i kushtuar më pak vëmendje vlerësimit real të riskut, ndërkohë që kjo duhet të jetë pikënisja për punën e audituesit.

3. Mostrajtimi si duhet dhe korrekt i gjetjeve, çon në dhënien e rekomandimeve të papërshtatshme dhe të pazbatueshme. Ky fakt jep një impakt negativ në rezultatet e punës audituese, pasi subjektet e audituara nga njësitë e tyre audituese, si dhe nga njësitë e auditimit të organeve të tyre qendrore, nuk bashkëpunojnë midis tyre në hartimin dhe zbatimin e një plani veprimi konkret, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga këto struktura.

4. Performancë jo në kërkesat e standardit e audituesve në kryerjen e funksionit të tyre, e theksuar kjo sidomos në stafin e punësuar rishtazi, pa eksperiencë, të patrajnuar e të paçertifikuar për njohuritë që kërkon profesioni. Një fenomen i tillë vlerësohet të ketë sjellë vonesa në kryerjen dhe përfundimin e misioneve të auditimit brenda afateve të caktuara.

Njëkohësisht dhe në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit “Mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2013”, në vlerësimin që i bëhet strukturave të auditimit të brendshëm, cilësohet që është konstatuar formalitet në mënyrën e planifikimit dhe realizimit të misioneve, si dhe fokus jo në përputhje me kërkesat ligjore të misioneve të auditimit të realizuara nga strukturat e auditimit të brendshëm si dhe anashkalim të misioneve që kanë të bëjnë me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Bazuar në sa më sipër, nga krahasimi i konkluzioneve përmbledhëse të të dhënave primare me ato sekondare vihet re një mospërputhje e rezultateve. Kryesisht kjo mospërputhje i dedikohet pyetësorit të vetëvlerësimit dhe tendencës që kanë të intervistuarit, për t’ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit jo realisht. Ata tentojnë të përgjigjen pozitivisht dhe jo të paraqesin situatën aktuale. Në këto kushte, nisur nga

të dhënat sekondare mund të konkludojmë se auditimi i brendshëm në sektorin publik në Shqipëri mbështetet në nivelin e duhur nga menaxhimi por, pavarësia jo e duhur e auditimit të brendshëm, profesionalizmi dhe cilësia relativisht e ulët e auditimeve, përbëjnë çështje që duhet të adresohen për përmirësim të mëtejshëm, për të rritur performancën e auditimit.

5. Konkluzionet

Ky punim u përqendrua në vlerësimin e efikasitetit të strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik, duke prezantuar nivelin e katër faktorëve që ndikojnë në rritjen e efikasitetit, përkatësisht mbështetjen e menaxhimit, pavarësinë, zhvillimin profesional dhe cilësinë e auditimit.

Nga ky punim konkludojmë që përgjithësisht strukturat e auditimit të brendshëm kanë mbështetjen e menaxhimit. Ndërsa pavarësia e këtyre strukturave nuk është arritur plotësisht. Po ashtu dhe niveli i kualifikimit profesional të audituesve është larg standardeve të kërkuara, çka ndikon dhe në një cilësi jo në nivelin e duhur të veprimtarisë audituese.

Pavarësisht kapaciteteve profesionale relativisht të dobëta të audituesve të punësuar në sektorin publik, roli i audituesit të brendshëm nuk vlerësohet siç duhet. Kjo vërtetohet me faktin që në disa raste menaxhimi ende kërkon nga strukturat e auditimit të kryejë detyra që lidhen me inspektimin financiar. Në këtë drejtim kërkohet më shumë punë për ndërgjegjësimin e menaxhimit, lidhur me rolin dhe funksionet e auditimit të brendshëm, në kuadër të sigurimit të pavarësisë, sikurse kërkohet nga standardet ndërkombëtare.

Si konkluzion, funksioni i auditimit të brendshëm në Shqipëri, në mënyrë që të promovojë një qeverisje të mirë, të ndikojë në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për të garantuar që paratë e taksapaguesve përdoren më kursim, dobi dhe frytshmëri, paraqet sfida të shumta në drejtim të garantimit të pavarësisë, rritjes profesionale të audituesve si dhe realizimit të veprimtarisë së tyre në përputhje me standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Në të ardhmen fokusi duhet të përqëndrohet në ndërgjegjësimin e menaxhimit mbi dobinë e funksionit të auditimit, rritjen e vazhdueshme profesionale si dhe kryerjen e veprimtarisë së auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

6. Referencat:

The Institute of Internal Auditors (IIA) (2012), "Supplemental Guidance: the role of auditing in public sector governance", 2nd Edition.

Arena, M., Azzone, G., (2009), "Internal Audit effectiveness: relevant drivers of auditees' satisfaction", International Journal of Auditing.

Cohen, A., Sayag, G., (2010), "The effectiveness of Internal Auditing: An Empirical Examination of its Determinants in Israeli Organizations", Australian Accounting Review, No. 54 Vol. 20 Issue 3.

Raporti vjetor "Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2013", publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

Raporti "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013", publikuar në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit: www.klsh.org.al, fq. 18-22.

Mihret, Dessalegn Getie and Yismaw, Aderajew Wondim (2007) Internal audit effectiveness: an Ethiopian public sector case study. Managerial Auditing Journal, 22 (5).

Van Gansberghe, C.N. (2005), "Internal auditing in the public sector: a consultative forum in Nairobi, Kenya, shores up best practices for government audit professionals in developing nations", Internal Auditor, Vol. 62 No.4.

Dittenhofer, M. (2001), "Internal audit effectiveness: an expansion of present methods", Managerial Auditing Journal, Vol. 16 No.8.

Ziegenfus, D.E. (2000), "Developing an internal auditing department balanced scorecard", Managerial Auditing Journal, Vol. 15 No.1/2.

Roli i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit

në kontekstin e praktikave më të mira të disa vendeve europiane

Nga : Albana Agolli, Brunilda Zeneli, Ermal Yzeiraj, KLSH



Albana Agolli



Brunilda Zeneli



Ermal Yzeiraj

Korrupsioni dëmton rëndë ekonominë dhe shoqërinë si një e tërë. Shumë shtete në mbarë botën vuajnë nga korrupsioni i rrënjosur thellë në çdo nivel të qeverisjes dhe që pengon zhvillimin ekonomik, minon demokracinë dhe dëmton drejtësinë sociale dhe sundimin e ligjit. Ai ndikon në mirëqeverisjen, menaxhimin e shëndoshë të parave dhe pronës publike si dhe në ekzistencën e tregjeve konkurruese. Madje në raste ekstreme, ai minon edhe besimin e qytetarëve në institucionet dhe proceset demokratike. Vendet anëtare të BE nuk janë imune nga ky realitet. Korrupsioni varion në natyrë dhe shtrirje nga vendi në vend por gjithsesi ai prek të gjitha vendet anëtare.

Ndonëse shtetet në përgjithësi kanë në dispozicion shumicën e instrumenteve dhe institucioneve të nevojshme ligjore për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, rezultatet që ato dhe opinioni i gjerë publik paraqesin në luftën kundër korrupsioni nuk janë të kënaqshme.

Ligjet dhe rregullat anti-korrupsion nuk zbatohen gjithmonë me rigorozitet, problemet sistematike nuk trajtohen në mënyrë efektive, institucione të caktuara nuk kanë kapacitetin e nevojshëm për të detyruar zbatimin e rregullave ndërsa institucionet përgjegjëse mbeten ende të distancuara nga rezultatet konkrete, madje në disa raste mungon vullneti i pastër politik për të çrrënjosur korrupsionin.

Korrupsioni është një fenomen kompleks me dimensione ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, i cili nuk mund të luftohet e aq më tepër të eliminohet lehtë.

1. Përse SAI-et duhet të angazhohen në luftën kundër korrupsionit?

Angazhimi i SAI-eve në luftën kundër korrupsionit, tashmë shikohet si një domosdoshmëri. SAI-et për vetë natyrën e punës së tyre të vazhdueshme audituese, kanë aftësinë dhe mundësinë e zbulimit të rasteve të korrupsionit dhe parregullsive, evidentimit të pikave të dobëta të sistemit nëpërmjet të cilave korrupsioni arrin të depërtojë dhe zhvillohet, dhënien e rekomandimeve konkrete në lidhje me eliminimin e risqeve, efekteve apo pasojave të korrupsionit, si dhe denoncimin në mënyrë të argumentuar të këtyre rasteve pranë organeve kompetente të procedimit penal.

Këto karakteristika i japin SAI-eve përparësi përse i përket efektivitetit të tyre në luftën kundër korrupsionit dhe për rrjedhojë SAI-et tashmë përfshihen si partnerë të rëndësishëm në çdo strategji kundër korrupsionit.

2. Lufta kundër korrupsionit në axhendën e INTOSAI-it

INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) pjesë e së cilës është edhe KLSH, prej kohësh është angazhuar në promovimin e një roli aktiv të SAI-eve në luftën kundër korrupsionit, duke i kushtuar asaj një vëmendje të vecantë që nga mesi i viteve 1990.

Referuar historikut të Kongreseve të INTOSAI-it, çështja e korrupsionit dhe çështje të tjera të lidhura me të kanë qenë vazhdimisht në vëmendjen e kësaj organizate e më konkretisht:

- Kongresi XVI - INCOSAI (Montevideo, 1998)

- a) Roli i SAI-eve në parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit
- b) Metodrat dhe teknikat e SAI-eve për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit (prezantuar raste studimore nga 70 SAI-e)
- c) Plan veprimi (12 pika)

- Kongresi XVII – INCOSAI (Seul, 2001)

Vlerësimi i Plan Veprimit

- Kongresi XVIII – INCOSAI (Budapest, 2004)

Ritja e shkëmbimit të eksperiencave, politikave dhe burimeve njerëzore në sektorin publik (punonjësit e ndershëm dhe kompetent)

- Kongresi XIX – INCOSAI (Meksikë 2007)

Grupi i punës për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave (EGFACML)

- Kongresi XXI – INCOSAI (Pekin 2013)

“SAI-it do vazhdojnë ti shërbejnë shoqërisë dhe publikut, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e qeverisjes kombëtare, forcimin e demokracisë, përmirësimin e shtetit ligjor, duke luftuar korrupsionin, ruajtur sigurinë kombëtare dhe nxitur reformat”.

Gjithashtu, referuar vizionit të Planit Strategjik 2011-2016 të INTOSAI-it, në të përcaktohet:

“Promovoje mirëqeverisjen duke i mundësuar SAI-eve që të ndihmojnë qeveritë e tyre respektive që të përmirësojnë performancën, rrisin transparencën, sigurojnë llogaridhënien, rruajnë kredibilitetin, luftojnë korrupsionin, promovojnë besimin e publikut dhe nxisin pranimin dhe përdorimin eficient dhe efektiv të resurseve publike në të mirë të popujve të tyre.”

Në mbështetje të katër qëllimeve të Planit Strategjik të INTOSAI-it (*standardet profesionale, kapaciteti institucional, shkëmbimi i njohurive dhe krijimi i një modeli si organizatë ndërkombëtare*), INTOSAI ka identifikuar gjashtë prioritetet strategjike për

ta ndihmuar atë në punën e tij gjatë viteve në vazhdim, të cilat konsiderohen si vendimtare në luftën e SAI-eve kundër korrupsionit dhe ndihmojnë në promovimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe mirëqeverisjes.

Ndër këto gjashtë prioritete, prioriteti i pestë ka të bëjë me *“thellimin e luftës kundër korrupsionit”*. Në lidhje me prioritetin e pestë (thellimin e luftës kundër korrupsionit), Plani Strategjik i INTOSAI-it shprehet:

“Korrupsioni është një problem i përhapur global i cili kërcënon financat publike, rendin ligjor dhe prosperitetin social; rrezikon sigurinë sociale dhe pengon reduktimin e varfërisë. INTOSAI duhet të udhëheqë përmes shembullit në luftën kundër korrupsionit dhe përmbush përgjegjësinë e tij për të siguruar transparencë dhe parandalim përmes një sërë aktiviteteve dhe masash.

Auditimi shtetëror i ushtruar nga SAI-et krijon transparencë, e bën riskun të dukshëm dhe ndërton kontrole të brendshme të fuqishme dhe efektive për të kontribuar veçanërisht në parandalimin e korrupsionit në linjë me frymën e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit. Për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, kërkohet një bashkëpunim i ngushtë i INTOSAI-it, përfshirë këtu edhe grupet e tij rajonale të punës dhe SAI-et, me organizatat ndërkombëtare dhe shoqëritë civile në një rrjet anti-korrupsioni dhe aktivitete të tjera të ngjashme.”

Aktualisht, një grup i posaçëm pune i INTOSAI-it, ka kohë që po punon dhe ka arritur të hartojë draftin e një standardi ndërkombëtar auditimi në lidhje me korrupsionin dhe më konkretisht standardi ISSAI 5700 – Udhëzime për auditimin e parandalimit të korrupsionit në agjensitë qeveritare.

Në këtë standart të INTOSAI-it, ndonëse ende në variantin e një drafti, janë përcaktuar katër komponentë të rëndësishëm në lidhje me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, të cilët janë:

- 1) Krijimi i njësisve speciale, permanente dhe të pavarura organizative brenda çdo agjencie e cila do të kenë për detyrë implementimin e masave parandaluese ndaj korrupsionit.
- 2) Vlerësimi i riskut dhe analizës së riskut në eliminimin e korrupsionit.
- 3) Krijimi i moduleve në parandalimin e korrupsionit: kufizimi i kompetencave, rotacioni i stafit dhe pozicioneve të punës, mbikëqyrja, vendimmarrja, kontrolli i brendshëm, bashkëpunimi me institucionet e tjera, kapitali njerëzor – trajnimi, kodi i sjelljes, etj.
- 4) Monitorimi dhe raportimi i fushave prioritare duke siguruar transparencë.

3. Lufta kundër korrupsionit në axhendën e KLSH-së

Në reflektim të përfaqësive të sipërcituara të INTOSAI-it por edhe SAI-eve të tjera homologe në luftën kundër korrupsionit, KLSH e ka reflektuar çështjen e korrupsionit dhe luftës ndaj këtij fenomeni jo vetëm në veprimtarinë e tij audituese (sidomos gjatë këtyre viteve të fundit) por edhe në vet Planin Strategjik të KLSH 2013-2017.

Më konkretisht, Piani Strategjik i KLSH 2013-2017, në objektivin e tij të pestë “Rritja e kontributit të KLSH-së për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit”, thekson:

“Institucioni do të vendosë më shumë theksin në analizën e rreziqeve dhe dobësive të sistemeve që auditon, duke synuar uljen e këtyre rreziqeve dhe parandalimin efektiv të korrupsionit, në bazë të standardit 1240, i cili përcakton qartë rolin e SAI-t. KLSH-do të vazhdojë të luajë një rol efektiv në forcimin e qeverisjes së mirë, zbatimin e standardeve të etikës, si dhe ngritjen e vetëdijes për rrezikun e mashtrimit dhe korrupsionit. Funkcioni kryesor i KLSH-së në këtë luftë është nxitja e një mjedisi parandalues kundër mashtrimit dhe korrupsionit, duke përfshirë sistemet e menaxhimit financiar vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe identifikimin dhe korrigjimin e mangësive”.

KLSH pjesë e task forcës së INTOSAI-it për Integritetin

Aktualisht KLSH është bërë anëtare e task forcës së INTOSAI-it për integritetin, për zbatimin e paketës SAINT, të bindur që forcimi i integritetit, që në thelb ka etikën dhe kulturën, ul korrupsionin.

KLSH pjesë e Njesisë së Përbashkët Hetimore

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 6 Maj 2009 të nënshkruar ndërmjet

Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, SHISH, ILDKP dhe KLSH, këto institucione janë pjesë e një Njësie të Përbashkët Hetimore me synimin e ritjes së cilësisë së hetimit dhe ndjekjes penale për veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit

KLSH pjesë e strategjisë kombëtare kundër korrupsionit

Aktualisht qeveria shqiptare është në fazën përfundimtare të miratimit të një strategjie kombëtare kundër korrupsionit në të cilën janë ftuar të marrin pjesë të gjitha institucionet shtetërore të cilat kanë një impakt në luftën kundër korrupsionit. Ndonëse kjo strategji në thelb mbetet dicka e mirë dhe tepër e domosdoshme në koordinimin dhe bashkërendimin e punës së secilit institucion në kuadër të luftës kundër korrupsionit, ne si KLSH prej kohësh i kemi paraqitur qeverisë (më sakt ministrisë përkatëse në lidhje me hartimin e kësaj strategjie) opinionin tonë në lidhje me të duke i sugjeruar gjithashtu kryerjen e disa ndryshimeve. Më konkretisht, sugjerimet tona kanë qenë:

- Në këtë strategji, e cila në të vërtetë do ishte më mirë të quhej ndër-institucionale sesa kombëtare, duhet të jetë një strategji gjithëpërfshirëse në të cilën të marrin pjesë të gjithë faktorët (qeveria sëbashku me ministrinë përkatëse dhe institucionet e tjera në varësi të saj, Kuvendi dhe opozita, institucionet e pavarura prokurori, KLSH, ILDKP, Autoriteti i Konkurrencës, etj, di dhe OJF me impakt në fushën e korrupsionit)
- Strategjia për aq sa në të do të angazhohen edhe institucione të tjera të pavarura kushtetuese, nuk mund të quhet më strategji e vetëm qeverisë. Kjo passjell si

rrjedhojë domosdoshmërinë e nënshkrimit dhe miratimit të saj nga cdo titullar apo drejtues i institucioneve të pavarura dhe jo kalimin e saj thjesht si një VKM.

- Rikonceptimi në kuadër të kësaj strategjie ose përfshirjen në të, të urdhrin nr. 70, datë datë 18.04.2006 të Kryeministrit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, duke ndikuar kështu në rritjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.
- Dhënies fund të pengesave joligjore që administrata tatimore vazhdon të krijojë ndaj auditimeve të KLSH duke mospranuar të vërë në dispozicion dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, ndonëse për këtë tashmë ekziston edhe një vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë i vitit 2013.
- Zhvillimin nga ana e KLSH-së të auditimeve të integritetit.

Marrëveshjet e bashkëpunimit


Në funksion të luftës kundër korrupsionit, KLSH ka nënshkruar gjatë këtyre viteve marrëveshje bashkëpunimi me institucione të caktuara shtetërore dhe shoqërinë civile dhe më konkretisht me Prokurorinë e Përgjithshme, ILDKP, **6 organizata të shoqërisë civile** etj.

Puna dhe rezultatet e KLSH në luftën kundër korrupsionit gjatë këtyre viteve të fundit
KLSH ka qenë tepër aktive, gjatë këtyre viteve të fundit, përsa i përket luftës kundër korrupsionit dhe për këtë flasin mjaft qartë shifrat në ritje përsa i përket rekomandimeve dhe kallëzimeve të këtij institucioni. Më konkretisht, KLSH gjatë viteve 2011-2012-2013 ka patur këto tregues:


Nr	Treguesit	2011	2012	2013
1	Auditime	152	153	153
2	Dëmi efektiv i përgjithshëm	7,027,566,000	13,522,392,000	15,089,825,000
3	Tre fusha kryesore:			
	Prona	352,232,000	637,997,000	11,992,177,000
	Prokurime	210,324,000	444,573,000	00
		184,104,000	62,006,000	354,099,000

	Dogana			377,141,000
4	Masat disiplinore dhe administrative	720	1221	1161
5	Kallzime penale	6	40	38


Dëmi efektiv i përgjithshëm në milionë/lekë



Masat Disiplinore dhe administrative



Kallëzimet penale.



Siç evidentohet dhe nga të dhënat e mësipërme, ka një rritje të ndjeshme të nivelit të dëmit efektiv të zbuluar me 92% dhe 114 %, në vitet 2012-2013, në krahasim me vitin 2011; rritje prej 69 % dhe 61 % të nivelit të dhënies së masave disiplinore dhe administrative në vitet 2012-2013, në krahasim me vitin 2011, si dhe rritje të nivelit të kallëzimeve penale në mbi 6 herë në vitet 2012-2013, në krahasim me vitin 2011.

Dhënia e rekomandimeve për përmirësime ligjore

KLSH vazhdimisht ka qenë aktive përsa i përket dërgimit të rekomandimeve pranë institucioneve dhe organeve kompetente në lidhje me kryerjen e përmirësimeve të ndryshme ligjore dhe nënligjore. I tillë është edhe propozimi ynë më i fundit në lidhje me miratimin e një ligji të ri “Për përgjegjësinë materiale të të nëpunësve publik”.

Nga auditimet e kryera, KLSH ka konstatuar mjaft probleme dhe shkelje të dispozitave ligjore në fonde të konsiderueshme publike, që kanë sjellë harxhimin e tyre pa kriter dhe efikasitet, ose edhe më keq, shkuarjen dëm të një pjese të tyre, nga keqmenaxhimi financiar. Jemi përpjekur të përcaktojmë përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë që kanë kontribuar në këto keqpërdorime të fondeve publike, duke propozuar masa në formën e sanksioneve, kundrejt parregullsive financiare të shkaktuara prej tyre dhe të konstatuara.

Për të gjitha këto arsye, KLSH, bazuar dhe në rekomandimin e lënë në kuadrin e auditimit të Buxhetit të Shtetit, ushtruar gjatë vitit 2013, ka rekomanduar që Ministria e Financave të ndërmarrë të gjitha masat për ngritjen e një grupi pune për

hartimin e Ligjit “Mbi përgjegjësinë materiale” në të cilën të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

4. Dimensionet ndërkombëtare të korrupsionit

Korrupsioni nuk është një fenomen apo sëmundje e cila ekziston vetëm në vendin tonë. Ai shfaqet në pothuajse të njëjtën formë dhe përmbajtje edhe vendet më të zhvilluara të cilat ashtu si dhe ne vazhdojnë prej vitesh përpjekjet për luftimin e tij. Për këtë arsye ne duhet të shfrytëzojmë eksperiencën më të mirë që vendet e zhvilluara mund të na ofrojnë, sidomos ato Europiane.

Statistikat dhe raportet për nivelet e korrupsionit janë të shumta por ashtu si dhe për çdo vepër tjetër penale ato asnjëherë nuk mundën që ta pasqyrojnë me saktësi realitetin, pasi krimi i korrupsionit ka gjithmonë tendencën që të qëndrojë i fshehur dhe madje i kamufluar edhe si një akt i ligjshëm. Pra në statistikat e korrupsionit gjithmonë do evidentohen rastet e konstatuara, rastet e dënuara dhe perceptimi i publikut në lidhje me të duke lënë jashtë përlllogaritjeve raste të fshehta të korrupsionit për të cilat janë në dijeni vetëm ata të cilët janë përfshirë në korrupsion. Gjithsesi, statistikat dhe raportet mbi korrupsionin, janë një ndihmesë e madhe për cilindo institucion të përfshirë në luftën kundër korrupsionit.

Nga gama e gjerë e këtyre statistikave dhe raporteve dëshiroj ti referohem CPI (Corruption Perception Index) të organizatës Transparency International dhe Raportit të Bashkimit Europian mbi Anti-Korrupsionin (Raport i Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Europian) 3 Shkurt 2014

Referuar shifrave të paraqitura nga *Transparency International* në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2013, Shqipëria paraqitet e 116 në renditjen botërore prej 177 vendesh duke qëndruar mbrapa të gjitha vendeve të rajonit si

Kroacia e 57, Maqedonia e 67, Mali i Zi i 67, Bosnia e 72, Serbia e 72, Greqia e 80 dhe Kosova e 111.

Totali prej 31 pikësh, na bën të qëndrojmë në nivelin e 23 % të vendeve Europiane të cilat shënojnë poshtë 50 pikëshit duke u futur kështu në një zonë e cila tregon prezencën dhe riskun e një korrupsioni serioz.

Nga ana tjetër Raporti i Bashkimit European mbi Anti-Korrupsionin, i 3 Shkurtit 2014, i pari i këtij lloji për vetë Bashkimin European, na paraqet të dhëna të reja dhe një perceptim të ndryshëm nga ai që jemi mësuar të dëgjojmë në lidhje me korrupsionin në vendet e Bashkimit European. Kështu në këtë raport cilësohet:

“Nën presionin e sfidave aktuale ekonomike në Evropë apo edhe jashtë saj, shtrohet si domosdoshmëri ekzistenca e garancive të forta të integritetit dhe transparencës së shpenzimeve publike. Qytetarët presin nga BE-ja që të luajë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar shtetet anëtare që të mbrojnë ekonominë e ligjshme nga krimi i organizuar, mashtrimi financiar dhe tatimor, pastrimi i parave dhe korrupsioni, aq më tepër në kohë krizash ekonomike dhe vështirësish buxhetore. Vetëm korrupsioni është vlerësuar se i kushton ekonomisë së BE-së rreth 120 miliard euro në vit, pothuajse sa buxheti vjetor i Bashkimit European.”

“Duke pasur parasysh nivelin e flukseve financiare të gjeneruara dhe një numër faktorësh të tjerë, prokurimi publik është një zonë e prirur ndaj praktikave korruptive. Sipas një studimi të bërë në vitin 2008 mbi prokurimin publik dhe korrupsionin, kostot që i shtohen një kontrate si pasojë e praktikave korruptive mund të përbëjnë rreth 20 % deri në 25 %, madje në disa raste edhe 50 % të kostos totale të kontratës.¹

Referuar një studimi të vitit 2013 mbi identifikimin dhe reduktimin e korrupsionit në prokurimin publik në BE, në vitin 2010 shpenzimet e përgjithshme direkte të korrupsionit në prokurimin publik për vetëm pesë sektor (rrugët dhe hekurudhat, uji

¹ http://www.nispa.org/files/conferences/2008/papers/200804200047500.Medina_exclusion.pdf

dhe mbetjet; ndërtimet urbane/shërbimeve, trajnimet, kërkimet dhe zhvillimet) në tetë vende anëtare² varionte nga 1.4 deri në 2,2 miliard euro.³”

Me mjaft interes janë edhe citimet e Raportit në lidhje me rëndësisë e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të kontrollit në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit brenda institucioneve publike, duke u shprehur:

“Disa shtete vendosin një barë më të madhe mbi institucionet e zbatimit të ligjit dhe atyre të procedimit penal apo dhe agjensitë anti-korrupsion të cilat shikohen si të vetmet institucione përgjegjëse për tui adresuar korrupsionit në vend. Ndërsa vepimtaria e këtyre institucioneve është shumë e rëndësishme, korrupsioni i rrënjosur thellë nuk mund të luftohet pa një përjasje gjithëpërfshirëse e cila synon që të risë parandalimin dhe mekanizmat e kontrollit përgjatë gjithë administratës publike, në nivel qendror dhe lokal.

Disa Gjykata Auditimi kanë luajtur një rol të rëndësishëm në shtyrjen përpara të reformave anti-korrupsion. Në pak vende anëtare, Gjykatat e Auditimit janë aktive në njoftimin e autoriteteve përkatëse për rastet e dyshuara të korrupsionit. Në disa raste, ato janë edhe institucioni përgjegjës për verifikimin e financimeve partiake dhe fushatave elektorale. Gjithsesi, pro-aktiviteti i tyre nuk përputhet me kontrolle efektive, të brendshme dhe të jashtme, në nivel qendror dhe lokal.

Në shumë shtete anëtare kontrollet e brendshme përgjatë vendit (veçanërisht në nivel lokal) janë të dobëta dhe të pakoordinuara. Ekziston një nevojë për ti përforcuar kontrolle të tilla dhe ti përputhim ato me politika të forta parandaluese në mënyrë që të japim rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme kundër korrupsionit.”

Shifrat e mësipërme të korrupsionit si dhe problematika e ngjashme në lidhje me të për pothuajse të gjitha vendet e BE-së na bën të jemi më realist në konceptimin që ne si shtet dhe si SAI duhet ti bëjmë luftës dhe rolit tonë kundër korrupsionit.

² France, Italy, Hungary, Lithuania, Netherlands, Poland, Romania and Spain.

³ ‘Identifying and Reducing Corruption in Public Procurement in the EU – Development of a methodology to estimate the direct costs of corruption and other elements for an EU-evaluation mechanism in the area of anti-corruption’, 30 June 2013, PriceëaterhouseCoopers and ECORYS.

Shifra të tilla kaq të mëdha dhe një dimension kaq i gjerë i korrupsionit përtej kufijve tanë territorial, shtron domosdoshmërinë jo vetëm të një bashkëpunimi ndërinstitucional brenda vetë shtetit por bashkëpunimi ndërkombëtar.

Përqasja që vende të ndryshme Europiane kanë pasur në drejtim të luftës kundër korrupsionit varion nga vendi në vend dhe në varësi të veçorive specifike të korrupsionit në to. Por në përgjithësi evidentohet fakti që në ato vende ku SAI-et kanë një rol aktiv në luftën kundër korrupsionit përqasja vazhdon të jetë më së shumti ajo tradicionale e cila pavarësisht nuancave parandaluese mbetet në vetvete një përqasje ndëshkimore.

Në vlerësim të këtyre përqasjeve, bie në sy përqasja parandaluese e SAI-it Holandez dhe atij Hungarez në lidhje me auditimin e integritetit.

5. Çfarë është auditimi i integritetit dhe ku qëndron efektshmëria e tij në luftën kundër korrupsionit?

Auditimi i integritetit është një temë shumë e gjerë por për lehtësi dhe për një krahasim të shpejtë të kësaj qasje të re kundër korrupsionit me qasjen tradicionale të shteteve kundër korrupsionit (nxjerrja e ligjeve, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi) kemi përgatitur një tabelë ilustruese si më poshtë:

Ndryshimi ndërmjet përqasjes tradicionale dhe asaj të integritetit në luftën kundër korrupsionit

KARAKTERISTIKAT	PËRQASJA TRADICIONALE	PËRQASJA E INTEGRITETIT
Objekti i luftës	Vetë korrupsioni	Risqet e korrupsionit
Qëllimi i luftës	Zbulimi i korrupsionit	Parandalimi I korrupsionit
Skena e luftës	I gjithë vendi	Institucioni, organizata

Aktorët kryesor	Autoritetet	Menaxherët e institucioneve/organizatës
Mjetet e luftës	Legjislacioni, ndëshkueshmëria	Kontrollet e integritetit
Rezultatet e luftës	Raste të ndryshme korrupsioni zbulohen dhe ndëshkohen	Forcohet integriteti i institucionit/organizatës

6. Auditimi i Integritetit në Hungari.

Hungaria nën ndihmën e SAI-it Holandez, të cilët tashmë njihen gjerësisht si krijuesit e auditimit të integritetit dhe metodës SAINT, ka arritur të implementojë me sukses, kjo falë edhe financimit nga Bashkimi Europian, auditimin e integritetit të pothuajse çdo institucioni shtetëror në nivel qendror dhe lokal në Hungari.

Rezultatet e këtij auditimi, me të cilin ne si KLSH jemi njohur në fillim të këtij viti janë tepër mbresëlënëse. Tashmë Hungaria ka një hartë të dixhitalizuar risku ku çdo institucion i grupuar sipas llojit të tij pasqyrohet në një sistem të caktuar gradimi përse i përket risqeve të korrupsionit. Kjo i ka bërë institucionet më të përgjegjshme karshi risqeve të evidentuara në lidhje me korrupsionit, pasi në kushtet e një gare pozitive ndërmjet tyre apo dëshirës për të mos u etiketuar si institucione me risk tepër të lartë, ato kanë përmirësuar me ritme tepër të shpejta situatën e konstatuar dhe për rrjedhojë kanë eliminuar në një kohë shumë të shkurtër nga institucionet e tyre risqe të cilat normalisht do të kërkonin vite për tu eliminuar.

Ne si KLSH jemi duke e studiuar me shumë interes mundësinë e aplikimit të këtij lloji auditimi në praktikë, i cili realisht kërkon një angazhim serioz të resurseve tona si institucion.

Auditimi i integritetit ka premisa të forta për të qenë një prej auditimeve të së ardhmes. Përsa kohë do ekzistoj korrupsioni do ekzistojë edhe lufta ndaj tij dhe përsa kohë kjo luftë do përfshijë edhe qasjen ndëshkimore kjo qasje duhet të shoqërohet edhe me qasjen parandaluese.

SAI-et si institucione të zgjuara, jo vetëm që duhet të luftojnë korrupsionin por edhe ta studiojnë atë, ta njohin, ta masin, ta analizojnë atë në imtësi. Kjo do ta bënte luftën tonë kundër korrupsionit një luftë të zgjuar.

Por aplikimi i kësaj përqasjeje parandaluese kërkon një vullnet dhe mirëkuptim të gjerë politik nga të gjitha forcat politike. Shumë nga rezultatet e auditimit të integritetit mund të keqinterpretohen ose përdoren për qëllime politike, duke etiketuar si të korruptuar institucione të caktuara të qeverisjes qendrore apo vendore të cilat mund të rezultojnë me një vlerësim të ulët apo jopozitiv përsa i përket integritetit të tyre. Ne tashmë jemi të familjarizuar me këtë fenomen i cili ndodh rëndom në politikën shqiptare ku në përgjithësi raportet tona të auditimit shfrytëzohen dhe përmenden sa herë që forca të ndryshme politike kanë nevojë për to, sidomos kur janë në opozitë, por sapo nderohen pushtetet e kanë shuam të lehtë të ndërrojnë rolet e tyre njësoj si dhe paraardhësit.

Mundësia që shumë institucione mund të rezultojnë me risqe tepër të larta të korrupsionit, pra me një integritet të ulët, nuk do të thotë detyrimisht që në këto institucione ka korrupsion, por në këtë qasje inteligjente dhe parandaluese ndaj korrupsionit ne si KLSH nuk mund dhe nuk duam të jemi ushqim për luftërat politike, pasi kjo do ta transformonte luftën kundër korrupsionit në një luftë politike duke cenuar rëndë qëllimin e vërtetë të angazhimit të KLSH në këtë iniciativë.

7. Përse KLSH dhe jo një institucion tjetër?

- KLSH është një institucion i pavarur “kushtetues”.

Pavarësia jonë është një faktor kyç në të qenit një institucion i besueshëm për të gjitha palët dhe objektiv në kryerjen e këtij auditimi. Çdo institucioni tjetër shtetëror

që brenda kompetencave të tij ligjore ka aftësinë për të ndërmarrë një nisëm të tillë i mungon kjo lloj pavarësie institucionale. Por edhe në rast se e ka ai nuk mund të shmangë konfliktin e interesit. Duke qenë se institucionet shtetërore janë vetë ambienti ku lind dhe zhvillohet korrupsioni, ato nuk mund të tregojnë të njëjtën shkallë objektiviteti në kryerjen e këtij lloj auditimi njësoj si KLSH.

- KLSH ka pavarësi përsa i përket përcaktimit të subjekteve të auditimit dhe kohës kur do zhvillohet ai.

Kjo pavarësi e KLSH-së, pjesë e pavarësisë së tij institucionale, është tepër e rëndësishme në kryerjen e auditimeve të integritetit. Auditimi i integritetit nga KLSH do të shmange rastet e kryerjes së auditimeve selektive dhe tendencioze.

- KLSH është e familjarizuar me përdorimin gjatë punës audituese të analizës së riskut.

I gjithë auditimi i integritetit në vetvete është një analizë e madhe dhe e detajuar risku. Për rrjedhojë vetëm një institucion i familjarizuar me analizën e riskut mund të angazhohet në kryerjen e auditimit të integritetit.

- KLSH ushtron auditime konstante në çdo institucion shtetëror.

Kryerja e auditimeve konstante nga KLSH në institucionet e nivelit qendror dhe lokal i jep mundësinë këtij institucioni që paralelisht me auditimet vjetore, por jo domosdoshmërisht të kryejë edhe auditimet e integritetit, çka do sillte një reduktim të kostove dhe resurseve të nevojshme në lidhje me këtë auditim.

- KLSH mund të bëjë rekomandime

Në përfundim të auditimeve të integritetit është e logjikshme që të hartohen me kujdes dhe përcillen për zbatim një sërë rekomandimesh drejtuar jo vetëm institucionit të audituar por edhe instancave të tjera eprore nën të cilat ai është në

varësi. Në këtë aspekt KLSH ka kompetencën e nevojshme ligjore për dhënien e rekomandimeve dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

8. Qasje ndëshkimore apo parandaluese?

Ndëshkimi është metoda më e vjetër e cila vazhdon të përdoret ende si metoda primare në lidhje me çfarëdolloj shkelje, administrative ose penale.

Arsyeja kryesore e përdorimit të kësaj metode apo përjasje, përveç faktit që publiku i gjerë kërkon gjithmonë shpagim dhe dënim, është edhe efekti parandalues, direkt dhe indirekt që aplikimi i ndëshkimit ka mbi ripërsëritjen e shkeljes, parregullsisë apo veprës penale.

Efekti parandalues direkt, shfaqet në lidhje me vetë autorin e këtyre shkeljeve i cili si pasojë e konstatimit të shkeljes dhe dënimit të tij frenohet në vazhdimin e kryerjes së kësaj shkeljeje apo në ripërsëritjen e saj. në rastin e dënimit me burgim ky frenim është edhe fizik.

Efekti parandalues indirekt, shfaqet në lidhje me shoqërinë e cila në dijeni të konstatimit dhe ndëshkimit të rasteve të tilla, frenohet në ripërsëritjen e të njëjtave shkelje me frikën e moskapjes dhe mosndëshkimit njësoj si personi i dënuar. Pra në vetvete qasja ndëshkimore ka efekte parandaluese.

Problemet në lidhje me qasjen ndëshkimore?

- Ngurimi për të denoncuar dhe penalizuar.

Kjo përbën vështirësi si për audituesit të cilët përveç kryerjes së një auditimi profesional nuk dëshirojnë të ndëshkojnë askënd për më tepër penalisht, ashtu edhe për vetë prokurorët dhe gjykatësit të cilët edhe ata rezervohen, për arsye të ndryshme në dhënien e një ndëshkimi penal.

- Zgjatja në kohë e procedurave dhe rezultateve të qasjes ndëshkimore.

Vonesat në aritjen e rezultateve pozitive të qasjes ndëshkimore apo dështimi i kësaj qasjeje duke rezultuar në mosndëshkimin e autorëve apo dhënien e pafajësisë ndaj tyre është një problem serioz i cili favorizon kulturën e pandëshkueshmërisë, dekurajon institucionet shtetërore dhe humb besimin e publikut. Në disa raste pafajësia që autorët e akteve korruptive arrijnë të fitojnë në një proces gjyqësor transformohet në ligjshmërinë e akteve të kryera prej tyre çka krijon një precedent të rrezikshëm për rastet e tjera të ngjashme dhe inkurajon përsëritjen e tyre.

- Nevoja për të bashkëpunuar dhe bashkëvepruar me shumë institucione.

Lufta kundër korrupsionit është një luftë zinxhir dhe stafetë. Institucionet brenda kompetencave të tyre ligjore ia përcjellin çështjen njëra tjetrës dhe puna e secilit prej tyre varet nga vazhdimësia e punës së tjetrit. Kështu në rastin e korrupsionit KLSH duhet të bashkëpunojë me institucionin në varësi të të cilit është shkelësi duke i kërkuar largimin apo pezullimin e tij nga detyra, me ILDKP për ti kërkuar verifikimin e pasurisë së tij, me Prokurorinë madje dhe me gjykatën në rastin e dëshmitarit apo animimit të vendimeve të mosfillimit apo pushimit të çështjeve penale. E gjithë kjo vështirëson arritjen e rezultateve.

- Ndikimi i influencave dhe ruajtja e balancave politike.

Sa më i rëndësishëm të jetë institucioni apo zyrtari tek i cili është konstatuar korrupsioni aq më i madh ka për të qenë presioni politik në lidhje me mosndëshkimin e tij apo transformimin e shkeljeve penale në shkelje administrative. KLSH vazhdimisht është përballur me këtë lloj presioni në dukje i padukshëm por prezent edhe në rastin e pengesave që kemi hasur për miratimin e ligjit të ri të KLSH-së.

Në këtë lloj ambienti, KLSH përveçse duhet të ruajë pavarësinë e tij institucionale dhe profesionale nga ky ndikim politik, ndonëse Kuvendit i shërbejmë, duhet të kujdeset që auditimet e tij dhe konstatimet e rasteve korruptive të mos interpretohen si luftë politike ndaj opozitës apo forcave politike në pushtet. Ruajtja e balancës së ngjyrave politike në rastin e korrupsionit në të vërtetë nuk ka sens pasi vetë korrupsioni ka vetëm një ngjyrë. Në rast se KLSH për hir të ruajtjes së këtyre balancave do zbatonte

parimin e ndëshkimit reciprok atëherë KLSH do rrezikonte të bëhej si UEFA ku për hir të të qenit asnjans ndëshkoi si fajtorin ashtu edhe të pafajshmin.

- Dështimi në rezultatet e qasjes ndëshkimore.

Në rast se dështon qasja ndëshkimore dështon edhe efekti parandalues i saj, madje ky dështim kalon në regres pasi ky dështim jo vetëm që nuk mundet të shkaktojë parandalim por rrit shkallën e kriminalitetit.

Përparësitë e qasjes parandaluese?

- Është gjithmonë rezultateve

Qasja parandaluese, pavarësisht pritshmërive ndaj saj, në një formë apo një tjetër është gjithmonë rezultateve. Kjo i jep asaj përparësi në raport me qasjen ndëshkimore.

- Është një ndihmesë e madhe ndaj qasjes ndëshkimore

Qasja parandaluese dhe sidomos auditimi i integritetit i shërben së tepërmi bërjes së një lufte të zgjuar dhe të studiuar mirë kundër korrupsionit. Evidentimi i mirë i risqeve e bën luftën kundër korrupsionit tepër efektive dhe ul mundësitë e dështimit. Korrupsioni nuk mund të luftohet më vetëm nëpërmjet indicieve që jep media, një ankesë apo arin të zbulojë rastësisht audituesi. Ashtu si check-upi i vazhdueshëm që bën një pacient apo skanimi i trupit ashtu dhe institucionet shtetërore duhet të skanohen nën skanerin e auditimit të integritetit. Kjo i jep përparësi mjekut për të evidentuar sëmundjen dhe gjetur kurën e përshtatshme.

- Është dhe duhet të jetë pjesë e punës së pothuajse çdo institucioni apo organizmi.

Ndryshe nga qasja ndëshkimore e cila në thelb është ekskluzivitet i vetëm organeve të procedimit penal ndërsa institucionet e tjera maksimumi mund të kenë rolin e denoncuesit, qasja parandaluese është e hapur dhe në të mund të kontribuojnë jo vetëm të gjitha institucionet apo organizmat e ndryshëm shtetëror ose jo shtetëror

por edhe e gjithë shoqëria. Masiviteti i aktorëve dhe faktorëve në këtë qasje e bën atë të aftë të përballojë një volum më të madh pune se qasja ndëshkimore dhe për rrjedhojë të arrijë rezultate pozitive edhe në rastin e dështimit të punës së ndonjërit prej institucioneve.

Kombinimi, përqasja më efektive.

Qëllimi i qasjes parandaluese është parandalimi i ndodhjes në realitet të rasteve të ndryshme të korrupsionit dhe në momentin që korrupsioni ndodh (evidentohet, konstatohet, vërtetohet) qasja parandaluese duhet t'ia lërë vendin qasjes ndëshkimore dhe efektit të saj parandalues nëpërmjet ndëshkimit. Në rast se qasja ndëshkimore do dështojë në efektin e saj ndëshkues dhe parandalues, kjo do të shkaktojë njëkohësisht edhe një dështim të punës së mëparshme të qasjes parandaluese.

Nga ana tjetër, nisur nga fakti që qasja ndëshkimore nuk mund të ushtrojë plotësisht efektet parandaluese të qasjes parandaluese, vetë qasja parandaluese nuk ka përse të pres apo të përqëndrohet vetëm në rezultatet pozitive të qasjes ndëshkimore dhe efektet e saj parandaluese. Për rrjedhojë qasja parandaluese duhet të jetë gjithmonë në fokusin e veprimtarisë së cdo institucioni shtetëror, sidomos atyre me impakt të drejtpërdrejtë në luftën kundër korrupsionit.

Duke qenë se qasja parandaluese është një qasje e zgjuar dhe qasja ndëshkimore është një qasje e fortë, kombinimi i tyre në luftën kundër korrupsionit është strategjia më e përshtatshme kundrejt një korrupsioni të zgjuar dhe të vështirë për tu luftuar.

Auditimi kombëtar dhe mirë administrimi i aseteve në interes të publikut

Nga Prof.As.Dr.Helga Vukaj & Bajram Lamaj, KLSH



Prof.As.Dr.Helga Vukaj



Bajram Lamaj

Auditimi kombëtar në shërbim të mirëqeverisjes kombëtare na bën të vetëdijshëm se, proceset audituese priren të sigurojnë përfaqëse e përputhshmëri tërësore me standardet ndërkombëtare, kjo vetëm duhet të ndikojë pozitivisht në përf forcimin e bindjes se veprimtaria audituese është e standardizuar, por njëkohësisht i paraprin edhe detyrimeve të vendit tonë për Integrimin Europian.

Pikërisht për të qenë në lartësinë e standardeve më të mira të një shteti ligjor, ku interesi publik është prevalent ndër parimet e së drejtës, e me qëllim përmbushjen me sukses të sfidave në të ardhmen, realiteti po tregon çdo ditë domosdoshmërinë e shtuar për prezencë të KLSH me auditimet e saj të pakushtëzuara, të pacunguara dheme akses të plotë, duke ***shmangur çdo keqkuptim apo keqinterpretim që mund të ndodhë në praktikë në lidhje me të drejtën e KLSH-së për të audituar administrimin pronës publike apo shtetërore dhe aseteve***, pra nga ku shteti synon të përfitojë të ardhura të cilat kanë destinacion rritjen e të mirave publike.

Gjithashtu të gjithë ne e dimë se prona publike jo vetëm nuk mund të tjetërsohet, por duhet të mbrohet, të përmirësohet, t'i shërbejë publikut dhe nuk mund t'i ndryshohet destinacioni në emër të interesit privat. Lind pyetja. Po si përkon të jetë realiteti?

Një nga shembujt që mund t'i referohemi për vet impaktin negativ në drejtim të pronës publike është dëmtimi urban i saj, ALUIZN; një tjetër shembull është ai i

keqadministrimit nga segmentet shtetërore të autorizuar, si p.sh Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, ZVRPP, njësitë e qeverisjes vendore të cilat në kuadër të një menaxhimi jo të mirë tjetërsojnë statusin e saj, zërin kadastral, shkallën e mbrojtjes dhe në fund destinacionin dhe regjimin juridik. Kjo është shumë e rrezikshme dhe me pasoja të rënda në ekonominë e vendit dhe interesin publik, impaktin negativ të së cilës do ta mbartin edhe brezat.

Edhe po të priremi të bëjmë një analizë shkencore ligjore referuar jurisprudencës e doktrinës të vet aseteve, **vullneti për t'i konsideruar shtyllë klasike të auditmit tonë vetëm do të rritej e përforcohej.**

Termi **Aset**, bazuar në origjinën e tij anglo-franceze asset (lexo:aset) ka kuptimin e **pronës ose tiparit të dobishëm**, ndërsa në fjalorin ekonomik merr kuptimin e **mjetit**.

Gjithashtu Aset (kapital) do të thotë çdo send me vlerë, qoftë ai i prekshëm ose i paprekshëm, dhe që përfshin :Pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, pronën e paprekshme dhe intelektuale, paratë, letrat me vlerë, koncesione ose licenca kërkesat ose të drejtën në para, fitimin e akumuluar, mallra, shërbime dhe përmbushjen e kontratës.

E gjithë kjo e sa sipër si iniciativë këmbëngulëse sigurisht që përlligjet nga vet pozitat kushtetuese të KLSH, për të garantuar përputhshmëri, ligjshmëri, rregullshmëri, mirëmenaxhim financiar dhe ekonomikitet, efektivitet si dhe efikasitet në administrim të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, por nevojitet që e gjithë kjo të ketë suport të gjithëanshëm administrativo ligjor. Pra, të ketë bashkëpunim dhe sens pozitiv ndaj çdo zbulimi e rekomandimi duke i vlerësuar në mënyrë moderne, të hapur, largpamëse e pa komplekse të drejtat dhe detyrat e KLSH.

Në mbështetjen edhe të normave ndërkombëtare do të citonim **ISSAI 200** "Pavarësia" i cili shpreh qartë se, KLSH mund të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me qëllim që tu tregojmë subjekteve që auditojmë se cili është funksioni ynë, citoj: "SAI(KLSH) duhet të mbetet i pavarur nga njësitë publike të audituara. Megjithatë

(KLSH) duhet të kërkojë, të mësojë njësitë publike të audituara për kuptimin e rolit dhe funksionit të tij, me qëllim ruajtjen e marrëdhënieve miqësore me to. Marrëdhëniet e mira e ndihmojnë SAI(KLSH) për të marrë informacione të lira e të sinqerta dhe për të zhvilluar diskutime në një atmosferë respekti dhe mirëkuptimi reciprok...”

Pra, përveç sa më sipër, të gjithë duhet të kuptojnë se në funksion të auditimit të jashtëm ku çdo rekomandim i shërben vetëm përmirësimit dhe rregullimit vijues, nevojitet që çdo përfitues të respektojë pozitivisht atë ç’ka synohet përmes akteve tona, pasi në të kundërt efekti për të qenë përmbushës të një misioni fisnik do të humbiste sens.

Një nga subjektet, ku mund të konkretizohet më mirë veprimtarinë, kontributin tonë në denoncim të paligjshmërive, abuzimeve dhe parregullsive dhe kontributin tonë në përmbushje të qëllimit e mirë për rritje të eficientë në mirëqeverisje dhe ndikim të mirë në respektim të interesit publik, janë njësitë e qeverisjes vendore. Këto njësi duhet të instalojnë një sistem efikas të menaxhimit financiar e kontrollit të brendshëm, (veçanërisht për Asetet), pasi sipas vlerësimeve tona nga auditimet e kryera, ka rënë ndjeshëm përgjegjësia menaxheriale në drejtim të administrimit të pronës publike dhe është kërkesë imediate që të rikthehet kujdesi i duhur e të krijohet një mjedis i besueshëm për komunitetin se këto pasuri sjellin të mira publike dhe për të realizuar misionin, qëllimin dhe objektivat, si në mbrojtjen e pronave, por dhe zbulimin e gabimeve dhe mashtrimeve apo veprime të tjera korruptive me këto prona.

Përgjegjshmëria menaxheriale është themeli mbi të cilin ngrihet dhe funksionon efektivisht sistemi i kontrollit të brendshëm në njësitë publike qofshin qendrore, lokale apo niveleve të tjera.

Mbështetur në konstatimet e bëra nga KLSH në auditimet e kryera në disa bashki e komuna gjatë vitit 2013-2014, rezultatet e pritura nuk janë arritur, por përkundrazi në ato njësi të qeverisjes vendore ku titullarët e tyre u ka munguar vizioni dhe

përgjegjësia ligjore në ushtrimin e kompetencave, janë kthyer në “pronarë” të këtyre aseteve/pronave.

Në kuadrin e decentralizimit nga qeveria, janë transferuar të gjitha pronat dhe asetet e qëndrueshme që kanë në territoret e bashkive dhe komunave, trajtimi i këtyre resurseve jo në mënyre ligjore dhe si një burim i rritjes së të ardhurave të bashkisë/komunës dhe mos administrimi i tyre sipas akteve ligjore në fuqi, na ka vënë përpara fakteve tepër shqetësuese, ku asetet janë “përvetësuar” nga persona që nuk kanë plotësuar kriteret për tjetërsim dhe posedim, pra duke arritur nga disa drejtues/administrator vendor që të veprohet në kapërcim të kompetencave e tagrave të autorizuar nga ligji, duke i transferuar ato në administrim të personave fizik të cilët i kanë kthyer në objekte përfitimi, duke kryer madje veprime haptazi të kundraligjshme për transferimin tek të tretët, pa pasur kompetencë ligjore për administrim e për më tej për tjetërsim pronësie.

Për ti paraprirë e sensibilizuar të gjithë administratorët e personat përgjegjës për administrim të këtyre pronave KLSH(Departamenti i ABPV,KT &AQ), ka kryer trajnim me audituesit e tij, duke evidentuar auditimet cilësore brenda KLSH, por dhe duke bashkëpunuar me Ministrinë e Mjedisit duke thirrur si lektorë specialistë të fushave përkatëse për asetet (pyje, kullota, pasuri të tjera natyrore dhe vepra ujore, etj) dhe ekspert të jashtëm, gjë e cila ka ndihmuar audituesit në rritjen e aftësive profesionale të auditimit në këtë fushë. kjo nisur dhe nga motoja që KLSH trumbeton “Përvoja e mirë u shërben të gjithëve”.

Nga auditimet e KLSH, janë konstatuar shumë shkelje ligjore dhe ka evidentuar përgjegjësi ligjore individuale nominative, duke kallëzuar edhe penalisht personat përgjegjës e duke informuar mbarë publikun për shkeljet e shkelësit. Sigurisht që në përmbushje të misionit tonë kemi rekomanduar masa të spikatura për përmirësimin e gjendjes për vlerësimin e aseteve dhe pasqyrimin me saktësi të vlerave reale të tyre duke bërë dhe sistemimin në kontabilitet, dhe jo mbetjen e tyre në dokumente ekstra jashtë bilancit. Siç e dimë prona vlerësohet sipas tregut dhe kjo ndjesi për

rritje vlere të çdo aseti në administrim, duhet të jetë detyrë për çdo person që ligji e ka ngarkuar me këtë detyrë.

Kjo, në dukje por, deficiencat në këto subjekte vijnë që në thelb. Ato administrojnë asetet pa ditur se ç'vlerë kontabël paraqesin, cila është pritshmëria për rritje të kësaj vlere apo pakësim të saj, cili është inventari real de facto dhe ç'raport ka ai me atë de jure, e më pas nga kjo të dalin konkluzione për planveprime të mundshme e marrje masash. Kjo vjen nga mungesa e seriozitetit dhe papërgjegjshmëria për të respektuar siç duhet interesin publik dhe përmbushjen e detyrës si administrator në funksion të zgjedhësve e komunitetit.

Në këtë pikëpamje Njësitë e Qeverisjes Vendore(Bashkitë) në kuadrin e decentralizimit dhe autonomisë kanë të drejtë që pas fuqizimit të tyre, të hyjnë në marrëveshje me bankat e nivelit të dytë për marrje kredi apo investime të përbashkëta, por siç dihet Bankat nuk pranojnë të kryejnë marrëdhënie me njësi vendore, kur nuk ekziston një bilanc i konsoliduar i saktë, e që i përputhet tregut.

Po cilat janë konstatimet si shkelje flagrante në këtë drejtim dhe çfarë ka rekomanduar KLSH për këto probleme.

1.Në shumë Njësi të Qeverisjes Vendore, ka munguar inventarizimi, administrimi, menaxhimi dhe vënia në efencë e aseteve që u janë transferuar nga Qeveria, pra nuk është kryer inventarizimi ligjor e fizik lidhur si me gjendjen fizike, funksionale dhe administrimin, për shkak të mos përmbushjes së procedurave të transferimit të titujve të pronësisë e përdorimit sipas urdhërimeve të VKM, duke krijuar hapësira për tjetërsime flagrante të pasurive shtetërore e publike në kapërcim të kompetencave ligjore ,apo duke kaluar deri në tjetërsim të zërave kadastralë me qëllim ndryshimin e statusit dhe krijimin e mundësive subjektive për përfitime nga tjetërsime të mundshme. Në këto raste KLSH ka propozuar jo vetëm ndjekjen penale nga organi i autorizuar por edhe rekomandime që shkojnë deri në përmirësime të akteve që kanë të bëjnë me këtë pjesë.

2. Në këto njësi, nuk janë krijuar Regjistrat e Aseteve ose “database”, të cilat janë një mënyrë e dokumentimit të tyre, ku duhet të evidentohen të gjithë treguesit e nevojshëm të tyre dhe pastaj mbi to mund të kryhen studime apo vlerësime për vënien në eficiencë sipas statusit juridik që kanë dhe hapësirat që lejon ligji për të vepruar mbi këto prona. Nga KLSH në këto raste, është rekomanduar të kryhet inventarizimi fizik dhe të përfshihen në inventarin kontabël dhe librin e AQT-ve, me vlerën që kanë ose që mund të vlerësohen sipas rregullave të caktuara, por zbatimi i këtij rekomandimi nuk është kryer plotësisht, megjithëse ai ndikon dukshëm në përmirësimin e punës tyre dhe shmangien e rrjedhjes së pronave “pa zot”. Ato duhet të evidentojnë e raportojnë gjendjen aktuale fizike dhe të vënë në eficiencë pronat e paluajtshme (Asetet) asetet e llojit ndërtesa, trojet dhe veprat ujore me aksesorët përkatës, këto në rakordim me listën e transferuar nga Këshilli i Ministrave me vendim të veçantë për çdo bashki/komunë. Këto kërkesa duhet të bëhen në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010” Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli(MFK), pjesa e “**Përgjegjësisë menaxheriale e nëpunësve zbatues**”, pika 2, Germa “ë e f”, ku citohet: “.....mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit.....ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar...”. Përgjegjshmëria e dokumentimit dhe ruajtjes së aktiveve rrjedh dhe si detyrim i zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , i ndryshuar me ligjin nr. 10110, datë 02.04.2009, neni 7 “ Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, ku citohet: “Njësitë ekonomike duhet të kontrollojnë , të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe evidencës së tyre mbështetëse..”

3. Në NJQV, funksionojnë Zyrat e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokave(ZAMT), por në shumë raste kanë funksionuar jo në përputhje me detyrimet ligjore gjë që ka sjellë që këto zyra të kryejnë deri veprime abuzive në ndryshimin e zërave kadastral

dhe transformimin e gjendjeve kadastrale. Si rrjedhojë duke shkuar edhe më tej duke plotësuar evidenca formale për gjendjen në natyrë dhe atë juridike të pronave në administrim të NJQV.

4. Një tjetër evidencë negative del në administrimin e pyjeve dhe sipërfaqeve pyjore e kullosore në posedim apo në pronësi të NJQV, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 106, datë 3.2.2008, ku planet e menaxhimit nuk përfshihen në buxhet me treguesit e tij si tek të ardhurat dhe tek shpenzimet, të cilat do të mundësonin dhe ndjekjen e kryerjes së këtyre shpenzimeve dhe analizën e të ardhurave që krijohen. Për këto, jo vetëm mungon inventarizimi fizik, kadastral por nuk ka asnjë përditësim të gjendjes së tyre për ndryshimet që ndodhin, pra nuk ka administrim dhe nuk zbatohet VKM nr. 22, datë 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të Administrimit të Pyllit Komunal”. Evidentimi i dëmeve është tejet jo profesional dhe shoqëruar me gjokat që vihen, për të cilat nuk ndiqen procedurat administrative dhe ligjore për ekzekutimin e tyre por mbeten të pa ekzekutuara si të kishin qëllim formal në aplikimin e tyre.

Jo vetëm kaq por ajo që është më e papranueshme e në këndvështrimin ligjor është përfitimi pa shkak i të ardhurave në konceptin komunal. Pyjet mund të kenë qenë në administrim e përdorim komunal (kullotje bagëtie apo përfitim nga të mirat e pyjeve e kullotave) që në vitin 1923 bazuar në ligjin për pyjet e kullosat por kjo e drejtë nuk mund të trashëgohet a-priori pa titull pronësie të deklaruar ligjërisht nga organet aktuale të autorizuara nga ligji. Kjo e drejtë si masë përfitimi nuk mund të jetë absolutisht tagër subjektiv dhe as i autorizuar e një pushtetari vendor, pasi në rastin më të paktë do të përkonte me shpërdorim detyre haptazi. Ky risk ndodh sidomos në zonat lindore të vendit.

5. Në administrimin e aseteve, në shumë raste kemi abuzime dhe nuk janë zbatuar kërkesat ligjore “Për tokat bujqësore të pandara”, dhe ato nënligjore “Për procedurat e dhënies me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore dhe tokave bujqësore të pandara”. Nga Ministria e

Bujqësisë dhe Ushqimit është nxjerre një Urdhër në vitin 2012 “Për ri inventarizimin e tokave bujqësore të pandara dhe të refuzuara të ish kooperativave bujqësore”, por aktualisht këto sipërfaqe janë kthyer në objekte abuzimi nga drejtuesit vendor, pasi jo vetëm nuk zbatohen procedurat e caktuara, por mbi to veprohet sikur të ishin “pronarë”, duke i dhënë me qira nga 35 deri 99 vjet me një copë letër ndërkohë për një shumë qesharake parash dhe njëkohësisht duke shkelur rëndë edhe vet dispozitat e Kodit Civil.

6. Po kështu dhe në administrimin e aseteve, në qendrat e urbanizuara dhe jashtë tyre, për asetet e llojit troje apo objekte, është konstatuar se mungon dokumentacioni inventarial, si për ndërtesat, objektet kulturore e sportive, por në shumë raste është lejuar përdorimi i paligjshëm e shfrytëzimi i tyre për ndërtime shtëpi e objekte shërbimi (lokale), dhe trualli është përdorur dhe për kultivime bujqësore pa ndërtuar më parë marrëdhënie ligjore (pronësie a qiraje), duke sjellë si pasojë përfitime të paligjshme nga persona të paautorizuar ligjërisht.

7. Janë evidentuar probleme e shkelje dhe në administrimin dhe vënien në eficiencë të aseteve të llojit vepra ujore, me aksesorët përkatës, pasi për to nuk ka akt marrje në dorëzim të rezervuarve me aksesorët përkatës, sisteme ujitëse, stacione pompimi, skema ujitëse e trojet e tyre, të dhënat teknike të skemave ujitëse, dhe nuk ka asnjë përcaktim të gjendjes aktuale teknike, pasi ato nuk janë përfshirë në kontabilitet në inventarin e AQT-ve dhe nuk janë vënë në eficiencë objektive ligjore.

8. Nga NJQV ka paaftësi të drejtuesve vendorë në lidhje me arkëtimin dhe përdorimin e taksës së tokës bujqësore? Megjithëse NJQV ngarkohen nga ligji që të konfirmojnë në rrugë zyrtare nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, klasifikimin e kategorive të tokës bujqësore, shumë komuna e bashki e nënvleftësojnë këtë.

Të shumta janë shkeljet jo vetëm në NJQV por edhe në segmente të tjera si ZRPP të cilat keqadministrojnë (magazinojnë) në mënyrë abuzive aktet dhe kryejnë procedura formale pa u ndalur përgjegjshmërisht në ligj e akte nënligjore. Abuzimet nuk reshtin as në Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, të cilat përlligjin me neglizhencën e tyre veprime të

subjekteve privatë në pyjet apo zonat e mbrojtura duke shkuar deri edhe në tjetërsime të statusit të atyre pasurive nga të paprekshme e monumente natyrore në të preکشme e mjet përfitimi. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe ALUIZN-at ,të cilët me veprimet e mosveprimet e tyre kanë shkelur rëndë qëllimet publike të shumë trojeve e pronave, duke legalizuar në kundërshtim me ligjin dhe duke bërë përfitues individë jashtë çdo kondicioni. Pa lënë mënjanë koston e madhe financiare të shkaktuar nga zvarritja e këtij procesi kaq të rëndësishëm për dinamizmin e një ekonomie. Po aq të ndikueshme në ekonominë dhe financat e vendit janë edhe veprimet te AKKP, jo vetëm në tjetërsimet abuzive të pronave shtetërore, por edhe në paaftësinë për të bërë vetëm rolin e një organi administrativ e jo të një gjykate ku njohja e së drejtës për kompensim konsiderohet si jo abuzive.... Ndërkohë që të gjithë e dimë që çdo vendim i tillë përkthehet në faturë financiare në dëm të interesit publik me pasoja të ndikueshme të disa brezave. Në fakt këto çështje meritojnë vëmendjen e teknicienëve dhe të politikëbërësve për të ndërhyrë pasi veprimet tona janë evidente dhe dëshmojnë qartë vullnet maksimal për të evidentuar, evidencuar dhe bërë transparent çdo abuzim duke rekomanduar zgjidhje optimale për përmirësimin e gjendjes, jo vetëm në subjektin konkret por edhe në autoritetet që kanë përgjegjësinë e përshkallëzuar.

Literatura:

Libri "Pronësia" Dr. Avni Shehu botim viti 2000

Libri "Ecuria Ligjore e Pronave të Paluajtshme, Retrospektive, E drejta e Pronës se Paluajtshme".

Libri "Përballja e korrupsionit: Elementet e një sistemi kombëtar Integriteti" nga Jeremy Pope, Botim nga "Transparenca ndërkombëtare", Korrik 2002

Karta Evropiane e Autonomisë Vendore

Burimet legjislativë; Kushtetuta, ligji organik i KLSH

Ligji 9235/2004, i ndryshuar

Standardet e Auditimit INTOSAI , botim i KLSH, viti 2012

Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe VKM përkatëse.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin(MFK),

Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 17.12.2011” Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Auditimi e performancës në funksion të mirëqeverisjes-Analizë krahasuese në KESH

Gjovalin Preçi, gjpreci@klsh.org, KLSH

Fatos Çoçoli, Ekspert i Jashtëm, KLSH



Abstrakt:

Situata ekonomike dhe financiare në botë dhe në Shqipëri, si dhe nevoja e domosdoshmëria e auditimeve të performancës.

- Historiku i lindjes dhe zhvillimit, përkufizimi i Auditimit të Performancës.
- Kuptimi i mirëqeverisjes dhe roli i SAI-eve në këtë drejtim, ndikimi nëpërmjet auditimit të performancës.
- Vlerat praktike të auditimit të performancës në mirëqeverisje-rasti i KESH Sh.a.

Në këtë kontekst, kumtesa synon të analizojë rolin e KLSH në nxitjen e mirëqeverisjes nëpërmjet auditimeve të performancës, duke u fokusuar në eficiencën e tregut të energjisë elektrike, veçanërisht të rolit të KESH Sha.

Fjalë kyçe: Auditim performance, Mirëqeverisje, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.

a) Situata ekonomike që ka diktuar domosdoshmërinë e auditimeve të performancës

Një numër i ngjarjeve sociale, ekonomike dhe teknologjike kanë ndikuar në rrjedhën e zhvillimit të auditimit në përgjithësi. Rreth katër dekada më parë, auditimi ka qenë përgjithësisht i lidhur vetëm me kontabilitetin dhe të dhënat financiare, me objektiv

që t'i mundësohet audituesit të shprehë një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizat e standardeve të raportimit financiar. Rreth viteve '70, disa vende filluan t'i kushtojnë vëmendje politikave shtrënguese të qeverisë të diktuar nga kufizimi i burimeve, për të përfituar sa më shumë edhe në kushtet e “shterimeve” ekonomike, duke bërë që auditimi të ndryshojë në metoda, qëllime dhe në procesin e zhvillimit, pasi lloji i auditimit të deri atëhershëm nuk mund të përmbushte të gjitha nevojat e qeverisë dhe kërkesat e taksapaguesve.

Që nga ajo periudhë e më vonë, natyrisht edhe sistemi i administratës publike pothuajse në të gjitha vendet, i është nënshtruar një procesi reformimi të thellë, duke riformatuar institucionet dhe modelet e menaxhimit publik. Megjithëse proceset e reformave të ndërmarra në vende të ndryshme janë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme nga konteksti ekonomik, social, politik dhe kultural, mund të identifikohen disa principe themelore të përbashkëta që kanë shoqëruar këtë model të ri të menaxhimit publik¹, si:

- Zvogëlimi i përmasave të administrimit qendror publik, si rezultat i transferimit të një pjese të këtyre funksioneve tek njësitë e qeverisjes lokale (procesi i decentralizimit), si dhe krijimi i agjencive të cilat ofrojnë një shkallë të lartë pavarësie;
- Rishikimi i përmasave të rolit të ndërhyrjes publike në sistemin ekonomik dhe social, nëpërmjet shtrirjes së procesit të privatizimeve;
- Futja e përqasjes konkurruese në të gjitha llojet e aktivitetet publike;
- Mbështetja e rritjes së përgjegjësisë dhe autonomisë së administratorëve të institucioneve publike dhe menaxherëve të tyre;
- Përshtatja e funksioneve dhe instrumenteve të huamarrjes shtetërore brenda dhe jashtë vendit, si investimet, projektet, shërbimet, produktet, përfituesit, kënaqësia e klientit etj;

¹ Proceedings of 22-nd International Business Research Conference Melia Galgos Hotel, Madrid, Spain, 9 - 10 September 2013, ISBN: 978-1-922069-30-6

- Theksi mbi matjen e performancës dhe menaxhimin, me një fokus të vazhdueshëm në minimizimin e shpenzimeve publike etj.

Aktualisht, pas daljes nga kriza financiare në SHBA dhe recesionit botëror të viteve 2008-2009, edhe disa vende të zhvilluara janë prezantuar me nivele të larta të borxhit publik, me mungesë të konkurrencës dhe ritme të ulëta të rritjes ekonomike. Qeveritë, të goditura rëndë nga situata përgjithësisht kritike, filluan zbatimin e politikave shtrënguese, duke e detyruar administratën publike të merret jo vetëm me shkurtime buxhetore, por edhe me kërkesën e përmirësimit të shërbimeve publike të ofruara (kryesisht për shkak të papunësisë në rritje dhe problemeve sociale), si dhe me “presionin” e taksapaguesve për llogaridhënie të qeverisë dhe qeveritarëve.

Kjo situatë ekonomike çoi në mënyrë të pashmangshme në zgjerimin e rolit dhe funksioneve të Institucioneve Supreme të Auditimit, të cilët sipas kuadrit institucional të çdo vendi, mbikqyrin dhe japin vlerësime se si entet qeverisëse përdorin fondet publike, se si ato japin llogari për ecurinë e përgjithshme të shërbimeve që ata ofrojnë dhe përgjegjësi që ata ushtrojnë. Pikërisht, ndryshimi i përmasave dhe llojeve të aktiviteteve të subjekteve të kontrolluara (dmth institucioneve publike) sjell për pasojë zhvillimin në të njëjtin drejtim edhe të aktivitetit kontrollues, për të ruajtur efektivitetin e kësaj veprimtarie në dobi të taksapaguesve dhe përparimit të vendit.

b) Auditimet e performancës në funksion të mirëqeverisjes

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), në Deklaratën e Limë-s të vitit 1977, përcakton se: “Auditimi i performancës orientohet drejt shqyrtimit të performancës së ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike. Auditimi i performancës mbulon jo vetëm operacione të veçanta financiare, por një gamë të plotë të aktiviteteve të qeverisë duke përfshirë edhe sistemin organizativ edhe atë administrativ.”²

² Deklarata e Limës mbi udhëzimet për rregullat e auditimit

Shtrirja dhe rritja e kërkesës për auditimet e performancës dhe cilësisë tyre, solli nevojën dhe domodoshmërinë e hartimit të Standarteve të Auditimit, që deri në atë kohë, kanë qenë të fokusuara kryesisht tek auditimi financiar, por ato kanë mbuluar gjithashtu dhe aspekte të auditimit të performancës. Shumë SAI-e evidentuan nevojën e udhëzimeve të veçanta në auditimin e performancës, për shkak të ndryshimit në formë dhe në përmbajtje me auditimin financiar. Diskutimi i parë është mbajtur në Londër dhe pas takimit të Lisbonës në vitin 2002, ju është dërguar anëtarëve të komitetit të INTOSAI-t për komente dhe drafti final është prodhuar dhe miratuar në takimin e Bratislavës në vitin 2003.

Edhe në deklaratën e Moskës të dalë nga Konferenca e dytë e përbashkët e ASOSAI-EUROSAI të shtatorit 2014, ndër të tjera është përcaktuar se aktivitetet e SAI-ve duhet të orientohen drejt përmirësimit të eficiencës së administratës publike, në veçanti kjo duhet të përmbushet nëpërmjet mekanizmave të cilët sigurojnë progresin e vazhdueshëm të auditimeve të qeverisë.³

Fokusi i aktiviteteve të SAI-eve varet nga sistemi politik, social dhe ai gjyqësor i çdo shteti, por në vitet e fundit institucionet kombëtare auditimit të vendeve të ndryshme në të gjithë botën, kanë shkuar gjithnjë përtej rolit të një "mbikqyrësi" (drejtimi i vëmendjes në përputhje me ligjin, rregullat dhe politikat), në auditimin e performancës së administratës publike, për më tepër duke e mbështetur dhe udhëzuar drejt praktikave më të mira. Aktualisht disa vende evropiane janë duke vënë theksin në mënyrë të veçantë auditimit të performancës, kështu në Gjykatën e auditimit të Kroacisë 20-22 % të auditimeve gjithsej e përbëjnë ato të performancës, në Hungari 10-12 %; Bullgari 13-15 % etj. Edhe për vendin tonë, SIGMA në Prioritetet e Reformimit të Administratës publike 2013-2020, ka përcaktuar midis të tjerave se për një periudhë 1-2 vjeçare duhet të forcohet auditimi i performancës, së bashku me Metodologjinë dhe Udhëzuesit e rinj për te tre llojet e auditimit.⁴

³ KLSH, Deklarata e Moskës

⁴ SIGMA, Priorities Albania May 2013, www.sigmapweb.org

Kryerja e auditimeve të performances në vendin tonë, nis një stad të ri me ardhjen në krye të KLSH të zotit Bujar Leskaj, i cili që në Projekt-idenë e paraqitur Komisionit të Kuvendit për Ekonominë dhe Financat me 14 dhjetor 2011 ka cilësuar se: KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Edhe në Strategjinë e zhvillimit KLSH 2013-2017⁵ është përcaktuar se përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës përbën një nga sfidat më madhore të KLSH, duke arritur që në vitin 2017 të bëhet një veprimtari e konsoliduar, me një vëllim të katërfishuar të numrit aktual të auditimeve të performancës (të vitit 2012), me një staf të mirë-trajnuar që ka demonstruar aftësi të spikatura në kryerjen e këtij lloji auditimi me ndikim në administratën publike shqiptare, duke përbërë një nga dy aktivitetet me të rëndësishme në gjithë veprimtarinë e institucionit.

Një prej çështjeve më të rëndësishme në rrugën e zhvillimit të demokracisë është dhe mbetet sundimi i ligjit dhe rritja e forcimi i aftësive qeverisëse dhe besimit publik, pra mirëqeverisja në tërësi. Liderët botërorë në vitin 2005, konkluduan se mirëqeverisja është përbërës i rritjes ekonomike, çrrënjosjes së varfërisë dhe urisë dhe përbërës i zhvillimit të qëndrueshëm. Edhe anëtarët e EUROSAI në kongresin e fundit të mbajtur në Lisbonë, kanë cilësuar se “transparenca dhe përgjegjësia janë dy vlerat demokratike themelore të mirëqeverisjes”.

Në demokraci, populli ja beson menaxhimin e burimeve kombëtare përfaqësuesve të zgjedhur të tyre për administrimin e veprimtarisë shtetërore. Për këtë kuvendi miraton buxhetin për qeverinë dhe në fund të vitit fiskal, i kërkohet të japë llogari mbi përdorimin e fondeve të vëna në dispozicion. Në vitet e fundit qeveria ka ndërmarrë një sërë hapash në zvogëlimin e kostos administrative dhe përmirësimin e administrimit eficient. Në përgjigje të këtyre kërkesave, Kontrolli i shtetit ka intensifikuar auditimet mbi administrimin, realizimin dhe përdorimin e të ardhurave e shpenzimeve, si dhe ka nxitur auditimet e performances në mënyrë të përshpejtuar

⁵ KLSH, Plani Strategjik 2013-2017, Objektivi nr.3;

dhe cilësore. Rritja cilësore e auditimit në përgjithësi, është në përputhje me adresimin e rritjes së kërkesës së taksapaguesve për administrim dhe menaxhimin më të mirë të fondeve publike.

“Mirëqeverisja” si një term relativisht i ri, përshkruan objektivat e dëshiruar të politikave shtetërore të zhvillimit. Megjithatë, parimet e mirëqeverisjes si përgjegjshmëria, pjesëmarrja, llogaridhënia, transparenca, antikorrupsioni etj. nuk janë të reja. Gjithashtu, në vijim të nxitjes të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm, një shtet efektiv duhet të jetë i aftë të mobilizojë burimet, të huazojë në mënyrë të matur, të planifikojë dhe të menaxhojë shpenzimet e parave publike në mënyrë efektive dhe eficiente, si dhe të analizojë përdorimin e fondeve me rezultatet e arritura dhe objektivat e synuara. Parimet e mirëqeverisjes - transparenca dhe llogaridhënia; drejtësia dhe barazia; eficensa dhe efektivitetit; respektimi i shtetit të së drejtës dhe standardet e larta të sjelljes etike - përfaqësojnë bazat mbi të cilat ndërtohet qeverisja e hapur⁶.

Mirëqeverisja kërkon mbikqyrje të vazhdueshme për të siguruar që politikat janë zbatuar sipas qëllimeve, janë përmbushur strategjitë dhe mbi të gjitha performanca e qeverisjes ka përmbushur pritshmërinë dhe nevojat brenda rregullave dhe politikave ligjore. Institucionet Supreme të Auditimit ndihmojnë qeveritë duke ushtruar mbikqyrje nëse entet qeveritare janë duke vepruar sipas programeve përkatëse, fondet shpenzohen sipas qëllimit dhe në përputhje me rregullat dhe ligjin, si dhe të vlerësojnë efektivitetin dhe eficiencën e zbatimit të programeve dhe aktiviteteve publike në nxitje të mirëqeverisjes.

Pikërisht, fuqizimi i praktikës së auditimeve të performancës rrit kërkesën për mirëqeverisje. Të bërit transparent të rezultateve të auditimit, i mundëson publikut të kuptojë se si kanë punuar institucionet dhe entet shtetërore në realizimin e funksioneve përkatëse dhe cila është ecuria e performancës tyre, duke e konsideruar një portal të rëndësishëm nëpërmjet të cilit publiku shikon dhe monitoron plotësimin

⁶ OECD, Policy Brief, Public Sector Modernisation Open Government,” 2005;

e të ardhurave, si dhe destinacionin dhe efektivitetin e shpenzimeve në veprimtarinë e qeverisë. Nëpërmjet ofrimit të shërbimit të mbikëqyrjes, Kontrolli i shtetit ndihmon në rritjen e sigurisë që zyrtarët e qeverisë që merren me menaxhimin e fondeve publike dhe burimeve të tjera, t'i përdorin në mënyrë transparente, të paanshme, të ndershme si dhe në punën e tyre të udhëhiqen nga integriteti dhe standardet e larta. KLSH në misionin e audituesit të jashtëm publik, synon rritjen e kontributit në mirëqeverisje, nëpërmjet kryerjes së auditimeve sa më cilësore mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare shtetërore, në të mirë të shtetit dhe publikut në tërësi, pra të nxitjes e progresit në sektorin publik edhe nëpërmjet auditimeve të performancës. Arritja e objektivave të njëjësive publike në mënyrë sa më efektive, eficiente dhe ekonomike përbën aktualisht kërkesën kryesore të mirëqeverisjes dhe mirëadministrimit publik. Të sigurosh opinionin publik që institucionet shtetërore janë efieciente, si dhe veprojnë me efektivitet dhe ekonomicitet, kërkon që audituesit të fokusohen përtej kontrollit të çështjeve financiare, nëpërmjet analizave vlerësuese, duke përdorur mjete, metoda dhe praktika të veçanta dhe që kërkojnë një përditësim të vazhdueshëm. Raportet e auditimit të performancës duhet të ofrojnë një vlerësim të pavarur të aktivitetit të sektorit publik, duke ju kërkuar agjencive qeveritare të përmirësojnë menaxhimin e burimeve dhe të shtojnë vlerën, nëpërmjet rekomandimeve mbi përmirësimin e procedurave dhe operacioneve, zbatimi i të cilave ju garanton institucioneve përgjegjëse, krahas të tjerave shmangien e të metave dhe mangësive të evidentuara. Auditimet e mirëfillta të performancës për herë të parë në vendin tonë kanë filluar të kryhen nga KLSH në vitin 2008 me çështjen “Vlerësimi i situatës mjedisore për ruajtjen e Liqenit të Ohrit”, nën kujdesin e Gjykatës të Llogarive të Hollandës, në kuadër të një projekti binjakëzimi. Deri në vitin 2012, auditimet e këtij lloji kanë qenë sipërfaqësore, të pakët në numër, me tema dhe çështje rastësore, të pastrukturuar mirë në dokumentet përkatëse, pa kohën e nevojshme në dispozicion për kryerjen e tyre, audituesit nuk kanë pasur përvojën e duhur, trajnimet në këtë fushë kanë qenë

të munguara ose më së shumti të fragmentarizuara etj., arsye të cilat kanë çuar që rezultatet e këtyre auditimeve jo vetëm modeste, por të kenë influenca të padukshme në subjektet e audituara. KLSH, deri në këtë vit ka vazhduar kontrollin tradicional të përputhshmërisë (ligjshmërisë dhe rregullshmërisë) dhe atë financiar, pa konsideruar me përparësi treguesit e efektivitetit, efikasitetit dhe rezultatin ekonomik të entit publik të kontrolluar.

Ky lloj auditimi, nëpërmjet studimit dhe analizës se si janë planifikuar, përdorur dhe monitoruar burimet për të arritur objektivat e politikave publike, konsiderohet të bëhet një nga kuptimet më efektive të përmirësimit të performancës qeverisëse, si mjet menaxhimi i përparuar dhe gjithnjë dhe më i sofistikuar për t'ju përshtatur problematikave të komuniteteve të ndryshme dhe niveleve të qeverisjes. Megjithëse në vitet e fundit, KLSH ka inkurajuar audituesit që ta konsiderojnë efektivitetin si një element të analizave kudo që të jetë e mundur gjatë auditimit, mbetet thelbësore përmirësimi i aftësive në kryerjen e auditimeve të performancës nëpërmjet qartësimin të aspekteve më të rëndësishme të tyre, ku nuk duhet të mungojnë “dora dhe mendja” e ekspertëve të fushës, shkëmbimi i eksperiencave dhe me kolegë të vendeve të tjera.

c) Performanca e KESH Sh.a ose rezultatet e qeverisjes nga auditimi

Auditimi i performancës së KESH sh.a, me tematikë liberalizimin e tregut të energjisë elektrike u fokusua në përpjekjet për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të tilla si:

- A janë marrëdhëniet tregtare midis KESH Sh.a dhe prodhuesve të vegjël e privatë të energjisë elektrike në përputhje me funksionin e kësaj shoqërie?
- Si është performanca e marrëdhënieve tregtare midis KESH Sh.a dhe CEZ Shpërndarje?
- Cila është performanca e Strategjisë Kombëtare të Energjisë në fushën e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike?
- A është kuadri ligjor ekzistues për energjinë elektrike në përputhje me direktivat e BE-së në këtë fushë?

Nga ky auditim doli mesazhi se, ngarkimi me funksionin e prodhuesit publik të energjisë, garantimi i blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et e dhëna me koncesion, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve kontraktuale me çmime të rregulluara (të diktuar ose nga ERE, ose nga qeveria në marrëveshjet koncesionare), sigurimi i importit (blerjes) së energjisë elektrike për llogari të OSHEE, jo vetëm që e kanë denaturuar funksionin themelor të një shoqërie publike (sigurimin e fitimit dhe rritjen e efektivitetit), por e kanë zhytur atë në detyrime financiare ndaj klientëve, duke e bërë domosdoshmëri ndryshimin e mënyrës se funksionimit, administrimit dhe menaxhimit, nëpërmjet ndarjes së përgjegjësive (prodhimi nga blerja: importi dhe/ose blerja e energjisë nga HEC-et e dhëna me koncesion), si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike, të cilat do të reflektohen në fund të fundit në cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

Në përfundim të auditimit të performancës së KESH Sh.a rezultoi se:

1. Modeli aktual i tregut të energjisë elektrike nuk ka arritur synimet e veta për të krijuar struktura konkurruese në tregun e shitjes me shumicë, si dhe ka dështuar në privatizimin e suksesshëm të industrisë elektro-energjitike, duke filluar me sektorin e Shpërndarjes;

- ka dështuar në liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, si dhe në zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve dhe njëkohësisht për rritjen e eficiencës së sistemit elektro-energjetik shqiptar;

- Si rezultat i shtimit të vazhdueshëm të futjes në rrjetin e shpërndarjes të HEC-eve të dhëna me koncesion, krahas përmirësimit potencial të qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve si rezultat i shtimit të prodhimit, aktualisht po përkeqësohet situata financiare të KESH Sha, për shkak të tarifës së blerjes prej tyre të energjisë, disa herë më të lartë sesa çmimi i shitjes tek Operatori i Shpërndarjes, madje në disa raste me tarifa blerjeje edhe më të larta sesa çmimet e importit;

- Një pjesë e stafit menaxhues dhe administrues të KESH Sh.a nuk ka një vizion të qartë mbi gjendjen aktuale ekonomike dhe financiare të shoqërisë, shkaqet, pasojat dhe ide mbi perspektivën e zhvillimit të shoqërisë, kjo për shkak dhe të ndryshimeve në nivelin e mesëm dhe të lartë menaxhues, i përcaktuar nga grupi i auditimit edhe si një nga risqet e suksesit të subjektit.

- Prodhimi publik i KESH Sh.a (p.sh në vitin 2013 prej 5.8 milion Mwh) është më se i mjaftueshëm për të garantuar furnizimin aktual me energji elektrike të popullatës (i cili për vitin 2013 ka pasur nevoja vjetore 2.2 milion Mwh), edhe me përfshirjen nivelit aktual të humbjeve (në vitin 2013 humbjet gjithsej kanë qenë 45,4%, nga të cilat humbje teknike 15,56 % dhe joteknike (abuzime në rrjet dhe pagesa) janë 29,84 %), i cili detyrimisht me ndryshimin e pronësisë së operatorit të shpërndarjes dhe përmirësimet në menaxhim dhe administrim do të vijë duke u zvogëluar. Prodhimi i kësaj sasive energjie nga KESH Sh.a me kosto shumë të ulët (1,14 lekë/kwh në vitin 2013), shitja me tarifë të caktuar nga ERE (2,3 lekë për vitin 2013) Operatorit të Shpërndarjes (CEZ-it, sot OSHEE) dhe blerja nga konsumatori me një çmim prej 7,7 dhe ose 13,5 lekë për kwh dëshmon për marzhe pozitive dhe të konsiderueshme fitimi të operatorëve të përfshirë, madje theksojmë se çmimi final që paguhet nga konsumatori është nga më të lartët në rajon, në një kohë që për nga niveli i mirëqenies (të ardhurave) vendi ynë renditet në fund. Sipas të dhënave të EUROSTAT, çmimi efektiv që paguhet nga familjet shqiptare për energjinë elektrike për vitin 2013 është 0,116 euro për kwh, një nga më të lartët në rajon (Mali i Zi 0,1 euro/kwh; Bosnja dhe Maqedonia 0,08 euro/kwh, etj.), në një kohë që Shqipëria renditet e fundit në Europë dhe rajon sa i përket GDP-së për banor, sipas standardeve të fuqisë blerëse (përqindjet për çdo shtet, krahasuar kjo me mesataren evropiane e vlerësuar si 100%), vetëm me 27%, ndërkohë që Mali i Zi e ka 43% Bosnjë-Hercegovina 30%, Maqedonia shënon vlerën 35%, etj., që do të thotë se nuk ka vend për rritjen e çmimit të energjisë për konsumatorët familjarë, së paku në periudhë afatshkurtër dhe pasi të jenë përmirësuar treguesit e tjerë.

II. Marrëdhëniet tregtare midis KESH Sh.a dhe prodhuesve të vegjël e privatë të energjisë elektrike nuk janë në përputhje me funksionin e kësaj shoqërie, pasi:

- Privatizimet pa kritere dhe në mungesë të një strategjie afat-gjatë, kanë sjellë si pasojë zvogëlimin e kapaciteteve prodhuese publike të energjisë elektrike me 14 %, si dhe efekte negative në gjendjen e saj financiare të KESH Sha, për shkak të nevojës së sigurimit në të ardhmen me çmime shumë herë më të larta se kostoja e prodhimit të tyre;

- Për shkak të modelit të tregut të rregulluar, KESH Sh.a blen energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et private dhe koncesionare me një tarifë shumë më të lartë (nga 6 në 9,3 lekë/kwh për vitin 2013) se kosto e prodhimit të vet (1.14 lekë/kah në 2013) dhe ia shet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes me një çmim të rregulluar nga ERE (2,2 lekë/kwh për vitet 2012 dhe 2013), disa herë më të ulët nga tarifa e blerjes, duke i shkaktuar kompanisë kosto financiare shtesë, të cilat për shkak të paqëndrueshmërisë së prodhimit, rriten vazhdimisht duke u bërë të papërbalueshme për këtë shoqëri;

- Metoda e vendosjes së tarifës së blerjes nga KESH Sh.a të prodhimit të koncesionarëve dhe prodhuesve të vegjël mbi bazën e çmimit të importit të një viti më parë, mbart riskun që tarifat e blerjes të jenë më të larta se çmimi aktual i importimit të energjisë elektrike, duke i shkaktuar KESH-it kosto financiare shtesë dhe përkeqësim të perspektivës së zhvillimit, si dhe ulje të eficiencës së prodhimit publik të energjisë elektrike;

- Pamundësia reale e parashikimit të sasisë së prodhimit të energjisë elektrike nga privatët dhe koncesionarët, për shkak të varësisë hidrologjike, si dhe detyrimi për blerjen me përparësi të prodhimit (edhe këta operatorë e prodhojnë energjinë elektrike nëpërmjet derivacionit, pra periudha e prurjeve të konsiderueshme në kaskadën e lumit Drin korrespondon për të gjithë në të njëjtën kohë), KESH Sh.a ka pasur raste që ka derdhur ujë nga HEC-et në administrim të saj, duke zvogëluar si

efektivitetin, ashtu edhe rezervën hidrike me pasoja negative financiare për shoqërinë.

III. Performanca e marrëdhënieve KESH Sh.a me kompaninë CEZ Shpërndarje është karakterizuar nga mangësi të shumta dhe mungesë strategjie nga ana e Ministrisë së linjës dhe asaj pronare të KESH Sh.a, pasi:

- Nuk ka pasur përpjekje nga ana e OSSH (më vonë CEZ Shpërndarje dhe aktualisht OSHEE) për mbledhjen e detyrimeve debitore të konsumatorëve para vitit 2006 në shumën 40.9 miliard lekë, pasi në periudhën 2008-2013 është arritur të arkëtohen për llogari të KESH Sh.a vetëm 509.405 mijë lekë, pa pasur të dhëna të sakta për shumën e arkëtuar në fakt nga CEZ-i; mungojnë gjithashtu të dhëna të detajuara për debitorët;

- KESH Sh.a ka shfaqur performancë të dobët për vjeljen e detyrimeve të mësipërme, pasi “Sektori i detyrimeve të prapambetura” me 19 punonjës, në periudhën 2010-2013 ka arritur të arkëtojë vetëm 3.5 milion lekë; nga mosveprimi për një kohë të gjatë dhe mungesa e bashkëpunimit në vitin 2016 parashkruhen plotësisht këto detyrime, duke rrezikuar që të mos arkëtohet asnjëherë ky detyrim financiar.

- Nga detyrimi i KESH Sh.a, për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje, i ka krijuar KESH-it detyrime debitore në shumën e së paku 19.3 miliardë, që duke shtuar dhe penalitetet për pagesë të vonuar, detyrimet e CEZ Shpërndarje ndaj KESH Sh.a për te dy rastet e mësipërme arrijnë në 53.7 miliard lekë.

- Nga konsiderimi që i ka bërë Ministria e Financave gjetjes së burimeve të financimit për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje, për KESH Sh.a duke lëshuar garanci huaje, ka bërë që në fund të vitit 2013, KESH Sh.a të ketë detyrime për hua dhe *overdraft*e në shumën 30.1 miliardë lekë.

IV. Performanca e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2003-2015, në fushën e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, rezulton se ka shfaqur:

- Mungesën e realizimit të planit të përbashkët të veprimeve me institucionet përkatëse, përgjegjëse për zbatimin, përditësimin dhe monitorimin e kësaj strategjie deri në vitin 2015, në kundërshtim me VKM Nr. 647, datë 11.9.2003;
- Jo vetëm që nuk janë siguruar kapacitete të reja gjeneruese të prodhimit të energjisë elektrike në periudhë afatgjatë pas vitit 2005, siç ishin parashikuar psh shtimi i kapaciteteve të tjera termike, HEC-i i Bratilës në 2009, HEC-i i Kalivaçit në vitin 2013, si dhe TEC-et, duke sjellë si pasojë mungesën e diversifikimit, si dhe cënimin e sigurimit të furnizimit në mënyrë të vazhdueshme me energji elektrike, por janë privatizuar disa HEC-e në pronësi publike: Hec Lanabregas në 2011, Bistrica 1 dhe 2, si dhe Ulzë e Shkopet në vitin 2012, pa qenë parashikuar në këtë Strategji, duke përkeqësuar peshën e prodhimit publik të energjisë elektrike në totalin e gjenerimit, si dhe situatën financiare të kompanisë publike KESH Sh.a.

V. Kuadri ligjor ekzistues për energjinë e elektrike, konstatohet se ka sjellë si pasojë problematikën aktuale të sektorit hidro-energjetik lidhur me:

- Ndryshimet e shpeshta dhe të shumta të ligjit që rregullon gjithë veprimtarinë e sektorit elektro-energjetik (që nga viti 2008 deri më sot është ndryshuar 11 herë, në përpjekje për të adoptuar zhvillimet e tregut), duke reflektuar pjesërisht dhe në mënyrë spontane sfidat e ndryshme të sektorit elektro-energjetik, të cilat deri tani nuk sigurojnë një përjasje të plotë me direktivat dhe praktikat më të mira evropiane;
- Ekzistencën e tregut të rregulluar të energjisë elektrike dhe jo të liberalizuar (në pjesën më të madhe dhe/ose plotësisht), i cili me tarifat e aplikuara në këtë sistem “ngarkon” financiarisht prodhuesin publik (KESH Sh.a) me kosto shtesë për përballimin e tarifave preferenciale kundrejt prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, si edhe për importin e saj në rast nevojë;

- Situatën e përkeqësuar financiare të të gjithë operatorëve tashmë publikë të sistemit elektro-energjetik: KESH, OST dhe OSHEE të cilët së bashku ndikojnë në cilësinë, garantimin e furnizimit me energji elektrike, si edhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike tek konsumatorët familjarë.

Bazuar në gjetjet e konkluzionet e cilësuara më lartë, KLSH midis të tjerave i ka rekomanduar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Entit Rregullator të Energjisë dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare:

- ✓ Ndryshimin e modelit të tregut të energjisë elektrike në funksion të kalimit gradual në një treg të liberalizuar, me synim rritjen e konkurrencës; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve; mundësimin për ndërhyrje me strategji dhe politika afatgjata; integrimin e këtij tregu në Tregun Rajonal dhe atë Evropian të Energjisë Elektrike, duke siguruar qëndrueshmëri dhe shërbim cilësor në furnizimin me energji elektrike.
- ✓ Pavarësisht ndryshimeve organizative dhe administrative që mund dhe duhet të ndërmerren në KESH Sh.a, ERE duhet të harmonizojë më mirë domosdoshmërinë e rritjes së burimeve elektro-energjetike nga Hece-t e dhëna me koncesion me interesin e biznesit pjesëmarrës në këtë aktivitet, nëpërmjet politikave të çmimeve, ku mbi bazën e madhësisë së investimit dhe sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike, të llogaritet për secilin prej tyre periudha e vetëshlyerjes së investimit dhe gradualisht prodhimi i këtyre subjekteve të kalojë në çmime tregu.
- ✓ MEI dhe ERE, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ndryshime në kuadrin ligjor e më pas edhe në atë rregullator, me qëllim që KESH ShA t'i hiqet detyrimi për blerjen e energjisë nga prodhuesit e vegjël dhe privatë të energjisë elektrike, në përmbushje të plotë të funksioneve të KESH Sh.a, për të vijuar rolin e rëndësishëm në sektorin energjetik, duke optimizuar teknikisht dhe ekonomikisht prodhimin vendas dhe shitjen/shkëmbimin e energjisë elektrike, për të siguruar

furnizimin e qëndrueshëm dhe me kosto të ulët për klientët tariforë, paralelisht me vënien në punë të burimeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese.

- ✓ Strategjia Kombëtare e Energjisë, nëpërmjet politikave të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të sigurojë rritjen e kapaciteteve të prodhimit të energjisë elektrike, diversifikimin e burimeve, liberalizimin e mëtejshëm të tregut, si edhe rritjen e efektivitetit të përdorimit në funksion të furnizimit me energji të lirë dhe të garantuar për konsumatorin.
- ✓ Bazuar në marrjen e masave për zvogëlimin e humbjeve të energjisë elektrike drejt nivelit të humbjeve teknike, si dhe koston e ulët të prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimin e lartë të shitjes konsumatorëve, në Strategjinë Kombëtare të Energjisë, ekzistojnë mundësitë e përfshirjes së uljes së çmimit të shitjes së energjisë konsumatorëve familjarë, masë e cila do të shoqërohet me përmirësim të arkëtimeve për shkak të rënies së motivit për të rrezikuar vjedhjen e energjisë, uljen e kostove të biznesit dhe përgjithësisht në rënien e çmimeve.

KONKLuzionet e Konferencës

Nga të 27 kumtesat e paraqitura, u konstatua se përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një mjet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtare të zhvillimit strategjik, është një sfidë kyçe në shumë vende. Duke përmirësuar proceset dhe institucionet buxhetore, cilësia e financave publike rritet. Eficienca, efektiviteti dhe transparencja janë tre objektivat themelore të buxhetimit modern. Rregullat fiskale, planet dhe kornizat afat-mesme dhe buxhetimi i performancës kanë provuar të jenë efektive në arritjen e këtyre objektivave.

Institucionet Supreme të Auditimit mund të nxisin më tej përmirësimin e jetesës së njerëzve, duke ndihmuar për të siguruar që fondet dhe projektet publike që kanë të bëjnë me jetesën e tyre, të jenë nën mbikëqyrje të rreptë dhe të arrijnë efektin e dëshiruar.



Institucionet Supreme të Auditimit mundën po ashtu të kontribuojnë në eficientë qeveritare, me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e aktiviteteve qeveritare dhe zbulimin e mangësive në qeverisjen dhe kontrollin kombëtar. Ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e mashtrimeve financiare, duke ruajtur interesat kombëtare, nëpërmjet sigurimit të informacionit objektiv, të

besueshëm dhe në kohë, për të zbuluar risqet në funksionimin ekonomik dhe social kombëtar.



Si konkluzione më konkrete, mund të citojmë:

- 1) Baza e të dhënave është themelore për njehsimin e riskut. Konferenca e ardhshme shkencore e KLSH duhet të përqendrohet në analizën e riskut për auditimin në sektorë të ndryshëm ekonomik-socialë, si në burimet energjetike, drejtësi, financë, arsim, shëndetësi, rend, mjedis, etj..
- 2) Të shikohet mundësia për ngritjen e një institucioni që të merret me standardet e burimeve njerëzore, natyrore, energjisë, mineraleve, etj, duke përfshirë rezervat, klasifikimin, etj deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e tyre, kontratat, etj. Në

funksionimin e këtij institucioni duhet pasur parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera.

3) Lufta ndaj ekonomisë informale kërkon përdorimin e instrumenteve të përshtatshme dhe përpjekje të përbashkëta jo vetëm të qeverisë e rregullatorëve, por edhe të kontabilistëve dhe audituesve, të cilët luajnë rolin e ndërmjetësuesit midis bizneseve dhe autoriteteve të shtetit dhe publikut në përgjithësi.

4) Formalizmi i ekonomisë lidhet ngushtë me vendosjen dhe zbatimin e sistemeve tatimore efektive stabile, që kanë në themel drejtësinë në përcaktimin të detyrimeve, trajtimin e pa diferencuar të bizneseve dhe mbajnë mirë parasysh si kërkesat lokale ashtu edhe ato ndërkombëtare.

5) Sektori publik duhet të adoptojë për raportimin financiar parimin e të drejtave e detyrimeve të konstatuara, pasi kjo i shërben mirëqeverisjes, transparencës e përgjegjshmërisë dhe rritjes së besimit publik.

6) Strategjia e re e Zgjerimit e Bashkimit Evropian e vendos në vijën e parë Qeverisjen Ekonomike dhe KLSH si Auditues i Jashtëm publik, është gur themeltar i përmirësimit të qeverisjes ekonomike.

7) Audituesit e KLSH dhe të IEKA, duhet jo vetëm të njohin raportet e njëri-tjetrit por dhe t'i shfrytëzojnë ato, duke i konsideruar si informacione plotësuese shumë të vlefshme.

8) Me qëllim që të ulët kosto e shërbimit të auditimit për subjektet publike, ky shërbim të kryhet vetëm nga KLSH, brenda të cilit të organizohet një njësi e posaçme me njerëz të aftë profesionalisht. Ky rregullim do të siguronte jo vetëm besueshmërinë e çertifikimit të pasqyrave financiare, por dhe cilësinë e punës.

9) Të bëhet një riklasifikim në rritje i kufijve të njësive ekonomike që ligjërisht i nënshtrohen detyrimit për t'u audituar.

10) Zhvillimi i mekanizmave dhe procedurave që lehtësojnë punën e secilit prej aktorëve në auditimin e jashtëm publik. Planifikimi i veprimtarisë dhe aktiviteteve, ndërtimi i strategjive të qarta dhe realiste, si dhe ndërtimi dhe zbatimi me rigorozitet

i proçeseve dhe kontrolleve ndihmojnë institucionet të përqendrojnë energjitë dhe resurset në përmbushjen me efikasitet të objektivave afatgjatë. Kjo mundëson që audituesit me punën e tyre të sjellin vlerë të shtuar në funksion të arritjes së objektivave të institucioneve publike.

11) Mirëqeverisja e institucioneve publike kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim strategjik të aktorëve kryesorë. Zbatimi i sistemeve të vlerësimit të performancës së secilit aktor në mirëqeverisjen publike, identifikimi paraprak dhe dakortësia mbi treguesit ku bazohet matja e performancës së institucioneve është e një rëndësie parësorë në nxitjen e institucioneve që të përqendrojnë energjitë dhe resurset e tyre në përmbushjen me efikasitet të objektivave afatgjatë.

12) Forcimi i kuadrit rregullator ligjor të shërbimeve sociale kërkon me forcë hartimin e akteve nënligjore dhe administrative në zbatimin e marrëdhënieve midis autoritetit kontraktor dhe subjektit të kontraktuar.

13) KLSH, në linjë me zhvillimet e inovacionet e shoqërisë në përgjithësi dhe sektorin publik në veçanti, të synojë që të mbajë dhe zhvillojë një kulture inovative jo vetëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale por të jetë një institucion nxitës dhe katalizator për inovacionin edhe për institucionet e tjera në sektorin publik.

14) Auditimi i performances është kërkim i mirëfillte shkencor, dhe për rrjedhojë duhet konceptuar e strukturuar si i tillë, në drejtim të metodologjisë.

15) Kontrolli i Larte i Shtetit do të vijojë traditën e mirë të këtyre tre viteve të fundit dhe do të organizojë gjate gjysmës së dytë të vitit 2015, Konferenca e IV-t Shkencore të tij që do të ketë si temë kryesore Auditimin e riskut në sektorët e ekonomisë publike.

Në vend të Pasthënies...

Në vijim të traditës pozitive të krijuar nga KLSH gjate dy viteve të fundit, në datat 29-30 tetor 2014 u organizua në Tiranë, Konferenca e Tretë Shkencore e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ajo vjen pas Konferencës së Parë Shkencore, të zhvilluar në dhjetor 2012, një forum kushtuar tërësisht historikut të KLSH në 77 vjetorin e themelimit të tij dhe në 100 Vjetorin e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. Konferenca e Dytë Shkencore, e dhjetorit 2013, u përqëndrua në rolin e institucioneve supreme të auditimit për një menaxhim financiar të përgjegjshëm në sfidat e sotme, duke e shpalosur të plotë karakterin e saj shkencor dhe duke sjellë punime me vlerë, gjetje e rekomandime cilësore nga studiues e profesionistë të auditimit privat e publik, si dhe të financave publike, nga jashtë dhe brenda vendit.

Këtë vit (2014), Konferenca e strukturoi, thelloi dhe konsolidoi më tej natyrën e saj kërkuese shkencore, hulumtuese e të dhënies së rekomandimeve, duke shtjelluar temën e saj qendrore: ***Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare.***

Ajo realizoi ndërveprimin me komunitetin shkencor të auditimit dhe të financave publike në Shqipëri, të përfaqësuar denjësisht në forum nga organizatat profesionale të fushës, si Këshilli Kombëtar i Kontabilistëve, IEKA, etj, por edhe nga akademikë të njohur, profesorati shqiptar dhe studiues të financave publike. Ky ndërveprim u zgjerua dhe shkoi më thellë, duke u ballafaquar me idetë, studimet, gjetjet dhe rekomandimet e ekspertëve të institucioneve supreme të auditimit(SAI-ve), partnere të KLSH-së dhe përfaqësuesve të lartë të institucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit(DG-Budget) e Komisionit Evropian, SIGMA, etj.

Ky forum shërbeu për të prezantuar tezat më të fundit dhe përqsasjet më efçiente të auditimit suprem modern, në përpjekjet për të ndihmuar qeverisjet kombëtare të dalin nga dara e pasojave të krizës mbarë-botërore ekonomike dhe financiare.

Konferenca solli eksperiencat më të reja të SAI-ve partnere në fushën e auditimit të jashtëm publik dhe përmirësimit të qeverisjes, duke thelluar luftën ndaj korrupsionit. Diskutuesit, sidomos përfaqësuesit nga SAI polak(NIK), nga Gjykata e Llogarive e Turqisë, SAI Kroat, Austriak, Malit të Zi, etj., dhanë përvojat e tyre gjatë auditimit, për të luftuar korrupsionin dhe mashtrimin financiar, duke treguar format më frytdhënëse të bashkëpunimit me institucione të tjera publike, me shoqërinë civile, mediat, etj., për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së administratës shtetërore. Aktiviteti u shndërrua në një forum shkëmbimi e ballafaqimi mendimesh, idesh dhe eksperiencash, pse studiuesit shqiptarë sollën realitetet e tyre në organizimin e kontabilitetit, financave publike dhe auditimit në Shqipëri.

Konferenca realizoi avokatinë e plotë të profesionit të financierit publik, kontabilistit dhe audituesit publik suprem, duke përcjellë mesazhin se pa financierë, kontabilistë dhe auditues të përgatitur mirë dhe me integritet të lartë, qeverisja e vendit humbet shumë në llogaridhënie, transparencë, efektivitet dhe efizienz. Audituesi suprem profesionist luan jo vetëm rolin e *watchdog* për financat publike dhe menaxhimin e fondeve të Shtetit, por edhe atë të “bilbilfryrësit(*wistle-blower*)”, duke denoncuar rastet e abuzimit me fondet publike dhe duke bashkëpunuar me institucionet e tjera të Shtetit, me shoqërinë civile dhe me mediat, për kufizimin e rasteve të mashtrimit financiar dhe korrupsionit, si dhe vendosjen e kulturës së ndëshkueshmërisë së funksionarëve publikë që abuzojnë.

Konferenca shkencore e KLSH-së është shndërruar tashmë në një forum të konsoliduar dhe takim të mirëpritur, ku debatohet gjerësisht dhe në thellësi për mënyrat e shëndoshjes së financave publike dhe rritjen e rolit të auditimit publik të jashtëm e të brendshëm, për forcimin e ndërveprimit mes tyre, etj. Ajo ka hyrë në kalendarin e aktiviteteve shkencore të SAI-ve të rajonit dhe në të ardhmen do të njohë një bashkëveprim më të gjerë me strukturat e EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, si me Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI-t me seli në Vjenë, me Institutin e Zhvillimit(IDI) të INTOSAI-t, me seli në Oslo, etj.

Duke perifrastuar vlerësimet e përfaqësuesve të lartë të Parlamentit Evropian, DG-Budget dhe Presidentëve të SAI-ve partnere të Kroacisë dhe Malit të Zi, Konferenca Shkencore e KLSH-së provoi të ishte dëshmi e qartë e modernizimit të institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik në Shqipëri, në bazë të standardeve profesionale të fushës të INTOSAI-t dhe motos së kësaj organizate “Experientia mutua Omnibus prodest(nga eksperiencia e përbashket përfitojnë të gjithë)”. Formimi shkencor për KLSH, me këtë aktivitet vjetor, vjen i institucionalizuar tashmë dhe është fryt i bashkëpunimit me homologët, si anëtarë të EUROSAI-t, me profesoratin shqiptar, me organizatat profesionale të fushës dhe me OJF-të aktive në luftën për transparencë dhe kundër korrupsionit në administratën publike.

Aktiviteti mori vlerësimin maksimal të shumë personaliteteve të vendit dhe të huaja që morën pjesë dhe përshëndetën, si Presidenti i Republikës SHTZ Bujar Nishani, Ambasadori i SHBA në Tiranë z.Aleksandër Arvizu, Kryetari në detyrë i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Z. Robert Wilton, Eurodeputeti i Parlamentit Evropian z.Igor Sholtes, përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, si deputetët Edmond Spaho dhe Anastas Angjeli, etj.

Profesorati shqiptar, i përfaqësuar denjësisht në Konferencë nga emra të njohur në fushën e analizës së riskut, financave publike, kontabilitetit dhe auditimit, etj, si Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Dr. Omer Stringa, Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Aurela

Anastasi, Prof.Ass. Dr.Sazan Guri, Prof.Ass. Dr. Hysen Çela, Dedë Kola, etj, dha ide, mendime dhe propozime konkrete për përmirësimin e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm publik në Shqipëri, të cilat përmbahen në materialet e këtij libri.

Kjo Konferencë u mundësua në sajë të suportit të gjerë të institucioneve supreme të auditimit(SAI-ve) partnere të KLSH, si SAI polak, kroat, malazes, austriak, etj, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) pranë Komisionit Evropian. Një falënderim i veçantë në këtë drejtim shkon për Presidentët e SAI-ve, z.Ivan Klesiç dhe z.Milan Daboviç, zv/Presidentin e SAI- polak,z.Wojciech Kutyla, z.Robert Gielisse nga DG Budget (BE), z.Igor Soltes, z.Jacek Jezierski, etj, të cilët me prezencën tyre aktive në Konferencë i dhanë frymë debatit dhe ngjallën diskutime me shumë interes.

Ndër mesazhet kryesore të aktivitetit, nga shumica e kumtesave të paraqitura, përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një mjet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtarë të zhvillimit strategjik, u prezantua si sfida kryesore në shumë vende. Konferenca dha tezën se, duke përmirësuar proceset dhe institucionet buxhetore, cilësia e financave publike rritet, ndërkohë që eficientia, efektiviteti dhe transparenca përbëjnë sot tre objektivat themelore të buxhetimit modern.

Nga ana tjetër, për herë të parë në Shqipëri hapet dhe mundësohet një debat i rëndësishëm, ai i analizës së riskut për auditimin. Diskutuesit në Konferencë e përcaktuan riskun dhe analizën e tij në auditim, si një nga faktorët më të rëndësishëm të financave dhe investimeve publike. Tre kumtesa në Konferencë iniciuan studimet për formalizimin e auditimit të riskut. Tema e Konferencës së Katërt Shkencore të KLSH, e cila do të zhvillohet gjatë vitit 2015, do të ketë pikërisht këto dy drejtime kyçe, analizën e riskut dhe formalizimin e tij deri në nivel standardi.

Në aktivitet u shpalos qartë realiteti i kërkimit shkencor në KLSH, i cili po konsolidohet më tej edhe me publikimin çdo katër muaj të Revistës Shkencore “Auditimi Publik”, tashmë në numrin e saj të tetë, si dhe me botimin gjatë viteve 2012-2013 të një sërë librash(përktihme dhe përshtatje) për standardet e INTOSAI-t, si “Standardet e Auditimit të INTOSAI-t”, “Manuali i Auditimit të Performancës”, “Udhëzuesi i Auditimit Financiar-Shënime praktike të ISSAI-ve 1000-2999”, “Udhëzuesi për Auditimin e Përputhshmërisë”, “Guidë për Raportimin e Auditimit”, “Standardet e Auditimit të Borxhit Publik-ISSAI-t 5410-5440”, “Numri Special i INTOSAI Journal për Kongresin INCOSAI XXI në Pekin, tetor 2013”, “Udhëzues i Auditimit të Mjedisit ISSAI 5110-5140”, “60 vjet INTOSAI, 50 vjet Sekretariat i Përgjithshëm”, etj

Ky botim që i paraqitet lexuesit shqiptar, është një përmbledhje në shqip dhe anglisht e 27 studimeve, kumtesave dhe referateve të paraqitura në këtë forum dy-ditor të auditimit të jashtëm publik. Bashkëpunimi i realizuar mes audituesve të KLSH-së dhe

ekspertëve të SAI-ve evropiane, si dhe me përfaqësuesit e botës akademike dhe profesionale shqiptare, solli propozime me vlerë për përmirësimin e menaxhimit të financave publike në Shqipëri dhe më gjerë.

Konferenca ishte në koherencë të plotë me Deklaratën e Kongresit të XXI-te të INTOSAI-t, zhvilluar në Pekin, tetor 2013, se **“Auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare për përmirësimin e menaxhimit publik financiar”**. Sipas prezantimit të Këshilltarit Kryesor të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian (DG-Budget) dhe Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, z. Robert Gielisse, i cili ishte njëkohësisht dhe bashkëdrejtues i aktivitetit, strategjia e zgjerimit e Bashkimit Evropian tani dhe për vitet që do të vijnë, do të përqendrohet në qeverisjen kombëtare të vendeve kandidate dhe në përmirësimin e saj. Në këtë drejtim, Konferenca e tretë shkencore e KLSH dha një sinjal të qartë për dobinë e progresit të auditimit të jashtëm publik të Shqipërisë, në agjendën integruese të vendit. Eurodeputeti Igor Soltes në kumtesën e tij theksoi se forcimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në arenën e financave publike mund të bëhet vetëm kur Institucionet Supreme të Auditimit janë themeluar mbi parimet kryesore të autonomisë, pavarësisë dhe transparencës.

Konferenca solli eksperiencë, gjetje dhe rekomandime në fushën e përpjekjeve të auditimit publik evropian për përmirësimin e qeverisjes dhe thëllimin e luftës kundër korrupsionit, nga kumtesat e ish-Presidentit Jaçek Jezierski (bashkëdrejtues i këtij forumi shqiptar), zv-Presidentit aktual Wojciech Kutyla të Zyrës Kombëtare të Auditimit (NIK) të Polonisë, si dhe të studiuesve të SAI-t Kroat, Gjykatës së Llogarive të Turqisë, të Gjykatës Austriake të Auditimit, të pranishëm dhe referues në Konferencë. Përqasjet e audituesve evropianë në këtë drejtim ishin me shumë vlerë dhe për bashkëpunimin e institucioneve shqiptare, për të përmirësuar qeverisjen, si Prokuroria e Përgjithshme, KLSH, ILDKPI, Autoriteti Kombëtar i Konkurrencës, etj.

Presidenti i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z. Milan Daboviç, solli nëpërmjet kumtesës së tij rëndësinë dhe lidhjen që ka mes pavarësisë së SAI-t dhe qeverisjes së mirë, duke theksuar se efektiviteti i administratës publike varet nga cilësia e planifikimit të shpenzimeve publike dhe përzgjedhjes së detyrave të programuara për t'u financuar nga fondet buxhetore. Vetëm auditimi i një SAI të pavarur garanton që rregullshmëria, saktësia dhe efiçienca e sistemit të administratës publike dhe përdorimi i fondeve publike të orientohet dhe të jetë në varësi të interesit më të mirë të qytetarëve, si dhe të zbulohet në një formë, e cila mundëson dënimin e fenomenit negativ në një mënyrë koherente dhe transparente.

Profesorati shqiptar dha në Konferencë propozime konkrete për përmirësimin e efektshmërisë së auditimit të jashtëm publik në Shqipëri. Ai e orientoi punën e

ardhshme shkencore të KLSH drejt përqendrimit në analizën e riskut për auditimin në sektorë të ndryshëm ekonomik-socialë, si në burimet energjitike, drejtësi, financë, arsim, minerale, shëndetësi, rend, mjedis, etj. Forumi propozoi ngritjen e një institucioni që të merret me standartet e burimeve njerëzore, natyrore, të energjisë, mineraleve, etj, duke përfshirë rezervat, klasifikimin etj., deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e tyre, kontratat koncesionare, etj. Ai nënvizoi gjithashtu se sektori publik duhet të adoptojë për raportimin financiar parimin e të drejtave e detyrimeve të konstatuara, pasi kjo i shërben mirëqeverisjes, transparencës e përgjegjshmërisë, si dhe rritjes së besimit publik. Konferenca propozoi që të bëhet një riklasifikim në rritje i kufijve të njësive ekonomike që ligjërisht i nënshtrohen detyrimit për t'u audituar. Një auditim i plotë i ndihmon institucionet të përqendrojnë energjitë dhe burimet në përmbushjen me efikasitet të objektivave afatgjatë. Kjo i mundëson auditimit të sjellë vlerë të shtuar, në funksion të arritjes së objektivave të institucioneve publike që auditon.

Në tre vitet e fundit, KLSH realizoi tre Konferenca Shkencore cilësore me pjesëmarrjen e shumë personaliteteve të fushës së Auditimit dhe të Ekonomisë, duke sjellë punime shkencore të mirëfillta dhe risi të padiskutueshme për institucionet publike shqiptare. Dëshirojmë të evidentojmë faktin që, që nga viti 1983¹ e deri në vitin 2012, është hera e parë që realizohen forume të tilla shkencore dhe kjo i dedikohet Kryetarit të KLSH-së, z.Leskaj, i cili duke drejtuar me moton "Tone at the Top", e ka orientuar institucionin drejt një pune profesionale në auditim, e cila prodhon risi, inovacion dhe kërkim shkencor.

Bashkim Spahija

Auditues në KLSH nga viti 1983 deri në vitin 2014

Ded Kola

Kryeredaktor i Gazetës "Ekonomia"

¹ Viti 1983, është viti në të cilin ka filluar punë z.Spahija në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

KREU III

Të ndryshme

Akvitetet social-kulturore të zhvilluara me rastin e Konferencës së III-të Shkencore të KLSH-së

Gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencës së tretë shkencore organizuar nga KLSH në datat 29-30 tetor, 2014 me temë “Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare”, për të gjithë të ftuarit, veçanërisht për përfaqësuesit e SAI-ve homologe dhe të Parlamentit European e DG Budget, si dhe për pjesëmarrësit e tjerë, u organizuan edhe disa aktivitete social-kulturore.

Në pasditen e datës 28 tetor, me mjaft interes u ndoq nga të ftuarit dhe pjesëmarrës të tjerë, projekcioni filmik “Here be dragons”, i regjisorit Marc Cousins dhe Producentëve Don Bozd & Genc Përmeti. Filmi dokumentar hidhte dritë mbi perceptimin e vetë regjisorit Cousins mbi të shkuarën dhe të tashmen në Shqipëri. Gjatë ditëve të qëndrimit të tij ne Shqipëri, Cousins ka filmuar atë që ka parë në këtë vend. Ai zbulon ndër të tjera se dhe arkivi i filmit po shkatërrohet. Gjatë hulumtimit rreth kësaj çështjeje, regjisorit Cousins ndeshet me pyetje të mëdha për historinë dhe kujtesën e këtij vendi. Pyetja kryesore që shtrohet është: Një vend, historia e të cilit gjatë shekullit të 20 është dominuar nga diktatura e Enver Hoxhës, a duhet të tolerojë venitjen e trashëgimisë kulturore? A është e mirëpritur harresa kombëtare? I ndikuar nga filmat e Chris Marker, filmi i regjisorit Cousins, merr në konsideratë arkitekturën e diktaturës dhe ikonat e piktorit të madh Onufri. Në të kaluarën, kur



hartografët dinin shumë pak për Shqipërinë ata shkruanin mbi harta “Këtu janë Dragonjtë”. Shqipëria ishte për dekada të tëra një nga vendet më pak të njohura në botë. Meditimi filmik i Cousins ka pasur parasysh këshillën e poetit Göthe: " Nëse ju dëshironi të kuptoni poetin, duhet të vizitoni vendlindjen e tij".



z.Genc Përmeti gjate ceremonisë së ndarjes se çmimeve ne *Valladolid International Film Festival*

Filmi u ndoq me shumë interes nga të gjithë të pranishmit, nga partneret e huaj të KLSH-së por edhe nga audituesit e shumtë që ishin të pranishëm, sepse patën mundësinë të “zbulojnë” vendin e tyre, parë nga një regjisor i huaj. Në përfundim, z.Genc Përmeti në cilësinë e producentit të filmit, i njohu të pranishmit me detaje dhe informacione mbi filluesin e kësaj ideje, perceptimet dhe eksperiencën e të punuarit me një regjisor të huaj mbi realitetin shqiptar, si dhe me të gjithë ecurinë e zhvillimit dhe realizimit të kësaj vepre artistike.



Aktivitetet përvijuan edhe në datën 29 tetor dhe takimi i radhës ishte **ekspozita e piktorit Arben Golemi** në mjediset e Fakultetit të Arteve të Bukura, me titull XXI. Të gjithë pjesëmarrësit në këtë rrugëtim shoqëroheshin nga vetë piktori Golemi. Aventura nga konkretja drejt abstraktes, për shumë artistë të shekullit të XX, ishte përkufizimi i vetë krijimtarisë së tyre artistike, ishte botëkuptimi i tyre filozofik për një shekull, gjatë të cilit njerëzimi disa herë u desh të ngrihet nga rrënojat e veta. Edhe për Arben Golemin krijimtaria artistike ngjizet në një format të tillë. Ajo nisët nga “gurët e themelit” drejt abstragimit të formave, linjave e strukturave arkitektonike, pa e humbur identitetin e vet.

Si një filozofi instiktive, ajo kthehet e rikthehet në përditshmërinë e tij, duke ri-proponuar forma e ngjyra që shpërhapen me forcë në sipërfaqe të mëdha, në një rend estetik të sprovuar, por me shijen e “herës së parë”, si një piktor që kërkon në subjektet e tij emocionin e parë të krijimit.



E kështu në aventurën e tij të 21-të personale, Golemi prezantohet me dy cikle të reja tablosh, realizuar mes viteve 2011 – 2013, atë të Nju Jorkut dhe atë të Pyllit. Në një vështrim të parë ato duket se nuk ndajnë asgjë me njëri – tjetrin, por pas një vështrimi analitik del e qartë se në të dy subjekte, Golemin e tërheqin të njëjtit elementë: madhështia, misterit, rendi estetik kapriçoz, ashpërsia që ato mbartin, por edhe emocionit që të kapërthen në përballje.

Cikli i parë lindi në Nju Jork në vitin 2011, kur Golemi vendos t'i dedikojë një seri të gjatë rrokaqiejve të qytetit. Këtë subjekt ai e servir në plan të parë si protagonist absolut të karakterit të vetë qytetit, duke theksuar stërzgjatjen e tyre vertikale, reflekset kromatike, supremacinë dhe kthjelltësinë arkitektonike. E si simbol i përzgjedhur i tij, sa edhe i vetë shpirtit kapitalist amerikan, ato dominojnë plotësisht hapësirën kompozicionale, me një linjë horizonti të mohuar, si për të mos i lënë asgjë konkurrencës. Herë si ushta a kama të ndryshkura, e herë si amalgama kromatike, ato propozohen si sinonim i kohës që shënuan, kur hekuri e betonarmeja sfiduan lartësitë dhe ligjin e gravitetit në emër të industrializimit. Përtej fasadës së latuar të këtyre përbindëshave bashkëkohorë Golemi në telajot e tij prej disa metrash, arrin të transmetojë tensionin e urbanizimit të skajshëm, të instiktit të ethshëm të botës

moderne, të konkurrencës së pashpirt, të urisë së pashuar të manjatëve të financës, e çdo vlere tjetër përcjellë me “besnikëri” nga arti i shtatë. (Tabloja Winter NY).

Në ciklin tjetër, propozohet kahu i kundërt i urbanizimit, ai i Pyllit të errët, që për çdo filozof a shkrimtar simbolizon “thjesht” natyrën e errët të shpirtit njerëzor. Shumë prej tablove të këtij cikli transmetojnë pikërisht tensionin dhe mistikën e natyrës së egër, ku trungjet ngushtohen me njëri-tjetrin duke reduktuar hapësirat në minimumin e domosdoshëm. Tërheqja e Golemit drejt subjektit të natyrës së egër është një udhëtim i të pandërgjegjshmes drejt instinktit primordial, atij të virilitetit, përballjes me frikërat dhe egërsinë e një botë me rregulla antike. Përfytyrimi i Pyllit në krijimtarinë e tij është shpesh i egër, “pa doreza”, ndërsa herë të tjera përqendrohet tek ritmi i shfrenuar i trungjeve të errët, përndezur në sfond nga një perëndim dielli i flakëruar.

Në esencë, të dy ciklet i thërrasin një bote larg realitetit të përditshëm urban. Golemi i përzgjedh ato si “oaz” i ri inspirimi, të largët por domethënës, për të servitur pikërisht atë që e përditshmja nuk ofron. Si një vëzhgues i kujdesshëm ai e ushqen veten me simbolikën e tyre, duke i ofruar ato “thatë”, pa prezencë njerëzore, si zgjedhje e ndërgjegjshme, për të mbetur koncentrat i mesazhit që mbartin. Në pjesën më të madhe të tyre gjesti piktorik është “i rëndë”, nënvizuar me forcë, duke lënë një sipërfaqe të vrazhdë, jehonë e prekjeve informale. Në raste të tjera ai shtohet nga elementë të jashtëm, si në rastin e Winter NY, ku një rrjetë metalike ngarkon të gjithë pikturën në peshë reale e simbolike. Përveç tyre ekspozita ofron tablo të tjera të artistit realizuar në vitet e mëparshme, ku struktura arkitektonike, karakteristike e qytetit të tij të lindjes, Beratit, apo pjesë e repertorit botëror të shprehisë arkitektonike, plotëson profilin e tij artistik të dhjetë viteve të fundit. Prezent prej më se dy dekadash në sistemin e artit, brenda dhe jashtë vendit, Golemi përbën tashmë një realitet të konsoliduar, me një gjuhë vizive personale të identifikueshme, e cila sipas kritikes Jeannie McCormack, “demonstron gamën e gjerë të ngjyrave, si dhe energjinë e gjesteve, me të cilat ai nxjerr në pah pasuritë e trashëgimisë së tij kulturore, duke krijuar kompozime që menjëherë tërheqin vëmendjen për vrullin dhe fuqinë me të cilat janë janë paraqitur. Në të vërtetë, pesha dhe pa epshmëria e formave të paraqitura prej tij, vendosmëria e penelatave të hedhura, syri i

pagabueshëm për ngjyrat, dhe penelatat ritmike të kompozimeve të tij e mbushin pikturën e Arben Golemit me fuqi të pamohueshme”.

Presidenti Nishani dekoron zotin Robert Gielisse me titullin “Për merita të veçanta civile”

Presidenti i Republikës së Shqipërisë , Shkëlqesia e Tij, Zoti Bujar Nishani i akordoi më datë 30.10.2014, zotit Robert Gielisse titullin “Për merita të veçanta civile” me motivacionin: *“Për ndihmesën e çmuar në përparimin e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*



Në ceremoninë e dekorimit mori pjesë Kryetari i KLSH-së z.Bujar Leskaj, Deputeti i Parlamentit European, z.Igor Soltes, Presidenti i SAI-t Kroat, z.Ivan Klesić, Presidenti i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z.Milan Daboviç, Asistentja e Auditorit të Përgjithshëm të SAI-t Kroat, zj.Lidija Pernar, Sekretarja e Përgjithshme e KLSH, znj. Luljeta Nano dhe familjarë të z. Gielisse , etj.



Zoti Gielisse ka dhënë mbështetje të plotë dhe profesionale në përgatitjen e projektligjit të ri të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t dhe ndihmë konkrete dhe cilësore për KLSH-në, mbi bazën e nevojave praktike të institucionit për modernizimin e kapaciteteve audituese të KLSH-së, referuar praktikave më të mira të BE-së. Zoti Gielisse ka dhënë kontribut të rëndësishëm edhe në përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit të institucionit 2013-2017.





Mini Muzeu i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Aktiviteti kulturor përmbyllës i zhvilluar në pasditen e 30 tetorit, i njohu të ftuarit me zhvillimet dhe evoluimin institucional të KLSH-së përgjatë gjithë historikut të krijimit të këtij institucioni. Në mjediset e KLSH-së, ku vitin e kaluar u përrua mini-muzeu historik i institucionit, të ftuarit mundën këtë herë, siç edhe ishte premtuar një vit më parë, të njiheshin me më shumë detaje dhe zhvillime të shpalosura në stendat e reja që e kishin pasuruar këtë mini-muze. Historiana e njohur, Prof. Dr. Kaliopi Naska, edhe një herë, u përcolli pjesëmarrësve një ekspozë dokumentare dhe fotografike të hapave kryesorë të zhvillimit 89-vjeçar të institucionit.



EUROPEAN
CURRICULUM
VITAE
FORMAT



GJENERALITET

Emri **DR. ROBERT GIELISSE, CIA, CGAP**
Adresa **41, HOLLANDSTRAAT – 3090 OVERIJSE, BELGIUM**
Telefon **00 32 2 295 96 49 – Mobile: 00 32 476 45 25 30**
Fax **00 32 2 299 45 96**
E-mail **Robert.gielisse@ec.europa.eu**

ombësia Hollandeze
Datëlindja 18-02-1952
Gjendja Civile I MARTUAR

EKSPERIENCA NË PUNË

- Periudha (nga– deri) **01-02-2008 –**
Komisioni Evropian, Bruksel
- Emri dhe adresa e punëdhënësit
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit-Njësia B4 Kontrolli i TVSH dhe Burimeve te veta GNI, Kontrolli i Brendshëm Publik dhe Sekretariati ACOR
- Lloji i punës ose sektori
Përgjegjës i Njesisë (grada AD14-7)
Njësia përbehet nga 14 vete (9 veta me grade A, 3 me B dhe 3 me gradën C) me dy fusha aktiviteti:

1. Menaxhimi i TVSH dhe Burimeve vetjake të GNI, duke u përqendruar ne veçanti ne detyrat e mëposhtme:

- *Mbikëqyrja.* Unë mbikëqyr dhe bashkërendoj aktivitetet e kontrollit me qëllim për të ofruar siguri se kontributet
- Detyra ose Pozicioni i mbajtur
•Aktiviteti kryesor dhe përgjegjësitë

financiare nga Shtetet Anëtare në bazë të TVSH-së dhe burimet vetjake të GNI janë të përcaktuara në mënyrë korrekte dhe vihen në dispozicion të buxhetit të BE-se. Jam emëruar në fillim të vitit 2008, objektivi im i parë ka qenë modernizimi dhe ristrukturimi i njësisë në përputhje me standardet e kontrollit të brendshëm të Komisionit Evropian.

- *Përfaqësimi.* Si Kryetar i Komitetit Këshillues mbi Burimet vetjake, seksioni TVSH, jam përgjegjës për funksionimin normal të Komitetit dhe të siguroj se është ruajtur transparenca e plotë dhe janë respektuar procedurat.. Para vitit 2008, kam kryesuar Seksionin e Burimeve Tradicionale të Komisionit Evropian për mbi 14 vjet

2. Mbikëqyrja e procesit të rigjenerimit të mjedisit të kontrollit të brendshëm në Vendet Kandidate (gjatë negociatave të pranimit), vendet kandidate potenciale dhe vendet që përfitojnë nga Politika Evropiane e Fqinjësisë së mirë.

Objektivi është futja e konceptit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nga rigjenerimi i mjedisit tradicional të Kontrollit të Brendshëm, në drejtim dhe bazuar në kornizat ndërkombëtare dhe standardet dhe praktikën e mira evropiane (të krahasueshme me mjedisin IC brenda Shërbimeve të Komisionit). Në veçanti, në promovimin e përgjegjshmërisë menaxheriale si një mjet për menaxhimin financiar dhe kontrollin, një funksion të pavarur të decentralizuar të auditimit të brendshëm, si dhe një njësi qendrore të harmonizimit, si një mjet i përhershëm për ndryshim. Ky aktivitet përfshin:

- Negociata Menaxhimi

Nën patronazhin politik të Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit, DG ELARG: menaxhimi në nivele të ndryshme i negociatave për anëtarësim në lidhje me Kontrollin Financiar (Kapitulli 32) dhe burimet vetjake (Kapitulli 33). Si për vendet kandidate ashtu edhe për ato potenciale, aktiviteti ynë konsiston në përgatitjen e vendeve përfituese në përputhje me Kapitullin 32. Që prej viti 2003 e në vazhdim, kam kontakte operative me Shqipërinë, Serbinë, Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë. Kontakti është edhe me vendet, pjesë e Politikës Evropiane për Fqinjësinë e mire, sidomos me Armeninë, Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Ukrainën, ku ne jemi të përfshirë në mënyrë aktive në reformimin e sistemit të tyre të kontrollit të brendshëm në përputhje me kapitullin përkatës të Planit të Veprimit mbi të cilin është rënë dakord më parë.

- Përfaqësimi

Aktivitetet tona me vendet kandidate, vendeve kandidate potenciale dhe vendeve të Politikës Evropiane për Fqinjësinë e mirë kërkojnë kontakte të shpeshta të nivelit të lartë, që përfshijnë Ministra, Sekretarë e Shteti dhe Kryetarë të Institucioneve Supreme të Auditimit, ku unë përfaqësoj Buxheti DG. Gjithashtu, unë kam qenë i emëruar si pikë kontakti e DG Budget për Marrëveshjet e Bashkëpunimit Administrativ të lidhura me këto vendeve në nivelin e DG..

- Koordinim & mbikëqyrje

Detyrat e treguara më sipër janë ekzekutuar në bashkëpunim të ngushtë me delegacionet e BE-së në vendet në fjalë, me të cilat kam mbajtur kontakte të mira operationale për të siguruar shkëmbimin efektiv të informacionit dhe për të mbajtur ata të përditësuar me përparimin e mundshëm.

ARSIMIMI DHE TRAJNIMET

- Periudha (nga – deri) 07-11-2011 -11-01-2013
 - Emri dhe lloji i organizatës Instituti i Auditimit të Brendshëm, SHBA
 - Temat kryesore/ Auditimi i Brendshëm i Sektorit Publik, Auditues i Brendshëm i Certifikuar (Flagship Certification)
- Titulli i kualifikimit të përfituar Certifikim CGAP and Çertifikim CIA

- Periudha (nga – deri) 01-02-2004 - 1-12-2004
 - Emri dhe lloji i organizatës Demos, Bruksel
 - Temat kryesore/ Kurs individual trajnimi për të rritur njohuritë menaxhuese
- Titulli i kualifikimit të përfituar

- Periudha (nga – deri) 12-05-2002 to 17-05-2002
 - Emri dhe lloji i organizatës London Business School, Londër, Mbretëri e Bashkuar
 - Temat kryesore/ Trajnim i menaxherëve të Lartë
- Titulli i kualifikimit të përfituar Certifikatë LBS

- Periudha (nga – deri) 09-12-1995 to 17-12-1995
 - Emri dhe lloji i organizatës The Mastery of Management Institute, Nevada,SHBA
 - Temat kryesore/ Kurse trajnimi
- Titulli i kualifikimit të përfituar Certifikate

- Periudha (nga – deri) 01-09-1979 to 31-7-1980
 - Emri dhe lloji i organizatës Instituti i Taksimit Publik, Lejden, Holandë & Universiteti i Lajdenit, Fakulteti i Ligjit Fiskal
 - Temat kryesore/ Kurs pas universitar për taksimin indirekt (Taksat Doganore dhe TVSH)
- Titulli i kualifikimit të përfituar Dëshmi
- Niveli në klasifikimin kombëtar Niveli pas universitar

- Periudha (nga – deri) 01-09-1978 to 04-07-1979

<ul style="list-style-type: none"> • Emri dhe lloji i organizatës që siguron arsimimin dhe trajnimin • Temat kryesore/ • Titulli i kualifikimit të përfituar 	<p>Universiteti i Amsterdemit</p> <p>E drejta Civile, E drejta Administrative dhe e Drejta Penale</p> <p>Diplomë bachelor në Drejtësi</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Periudha (nga – deri) • Emri dhe lloji i organizatës që siguron arsimimin dhe trajnimin • Temat kryesore • Titulli i kualifikimit të përfituar • Niveli në klasifikimin kombëtar 	<p>01-09-1972 to 13-10-1977</p> <p>Universiteti Erasmus i Roterdamit</p> <p>Biznes, Ekonomi & Drejtësi</p> <p>Diplomë Master</p> <p>Diplomë Universiteti</p>

AFTËSITË DHE KOMPETENCAT

GJUHA AMTARE

HOLANDISHT

GJUHE TË TJERA

	ANGLISHT	FRËNGJISHT	GJERMANISHT
• Leximi	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm
• Shkrimi	Mirë	Mirë	Mjaftueshëm
• Gjuha e folur	Mirë	Mirë	Mirë

AFTËSITË SOCIALE DHE KOMPETENCAT

- ✓ Që prej vitit 1983 punoj për Komisionin Evropian, ku aftësia për të vepruar në një dimension multi kulturor është kërkesë bazë.
- ✓ Që prej vitit 1993, unë mbaj një pozicion drejtues në të cilin unë kam zhvilluar më tej aftësitë e mija sociale dhe jam i aftë të motivoj individët

AFTËSITË ORGANIZATIVE DHE
KOMPETENCAT

- ✓ Unë mbaj pozicionin e drejtuesit të mesëm personelin e Komisionit që prej 1993 dhe në vazhdim. Kjo punë përkon aftësi organizative për të përballuar me një mjedis të ndryshueshëm administrative i cili përqendrohet në aktivitetet me bazë menaxhimin.
- ✓ Me kërkesë të ministrisë së Brendshme të Holandës dhe të Universitetit HUB kam trajnuar dhe kamë qenë drejtues i kurseve në fushën e rekrutimit.
- ✓ Përveç kësaj, unë kam qenë një anëtar dhe (Zëvendës) President i disa bordeve të zgjedhura (COM/23T/XIX/99, COM/24T/XIX/99, COM/A/01, COM/A/02), COM/B/02 dhe AST/2/04). Aktualisht nuk e ushtroj më këto aktivitetet.
- ✓ Unë herë pas here jap kurse në Universitetin e Brukselit, si dhe kurse individuale trajnimit, për të cilat unë kam marrë autorizim paraprak (neni 12 Rregullore)

AFTËSITË TEKNIKE DHE KOMPETENCAT.

Të gjitha njohuritë e përgjithshme kompjuterike. Përvojë operationale në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave.

AFTËSITË ARTISTIKE DHE KOMPETENCAT

- ✓ Publikime të ndryshme në fushën e e ligjit doganor dhe mbrojtjen e konsumatorit.
- ✓ Bashkautor i botimit "Dogana – Hyrje në të drejtën doganore", 1986, Gouda Quint
- ✓ Autor i botimit "Krahasimi i konkurrencës në nivel Evropian", 2003, Business Reed, The Hague, NL (Një libër që përqendrohet në procedurat e rekrutimin në nivelin e BE).
- ✓ Autor i procedurave të rekrutimit në BE, një udhërrëfyes drejt suksesit, Shtator 2006, Bouar nga *l'Ecole Nationale d'Administration/CEES* në Strasburg, në Frëngjisht dhe në Anglisht.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

AXHENDA

Konferenca e III-të Shkencore Vjetore

“Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare”

Hotel “Tirana”

Tiranë, 29 - 30 Tetor 2014

E mërkurë, 29 Tetor, 08:30 – 17:00

Regjistrimi në Konferencë, 08:30-9:00

Paneli 1 – Moderator z. Jacek Jezierski	
09:00-09:05	Fjala e hapjes dhe e mirëseardhjes nga z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së
09:05-09:25	Z. Robert Gielisse, DG-Budget, <i>“Mënyrat se si duhet të operojë Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe çështjet që duhet të mbahen parasysh në qasjen me dokumentacionin që trajton tatimin mbi të ardhurat dhe statusi i rekomandimeve të auditimit”</i>
09:25-09:45	Z. Igor Soltes, Deputet i Parlamentit Evropian
09:45-10:05	Phd. Milan Daboviç, President i Senatit, SAI i Malit të Zi, <i>“Lidhja midis pavarësisë së SAI-eve, performancës dhe mirëqeverisjes”</i>
10:05-10:25	Zj. Verica Akrap, SAI i Kroacisë, <i>“ Arritja e rezultateve dhe qëllimeve të biznesit në ndërmarrjet publike”</i>
10:25-10:45	Z. İsmail Cengiz EREK, SAI i Turqisë, <i>“Roli i SAI-t për implementimin e llogaridhënies dhe transparencës dhe efekti në mirëqeverisje”</i>
10:45-11:15	<i>Pushim kafe</i>
11:15-11:35	Prof. Dr. Skënder Osmani, Universiteti Politeknik i Tiranës & Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së, <i>“Zvogëlimi i riskut, një potencial i mundshëm i zhvillimit të vendit”</i>
11:35-11:55	Z. Wojciech Kutyla, Zv/President, SAI i Polonisë, <i>“Roli i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë në luftën kundër korrupsionit”</i>
11:55-12:15	Z.Turan Yasar, SAI i Turqisë, <i>“ Pavarësia e SAI-t dhe si e forcon kjo mirëqeverisjen”</i>
12:15-12:35	Prof. Dr.Omer Stringa, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, <i>“Roli i Audituesve në Mirëqeverisjen Kombëtare – Përjasje Strategjike”</i>
12:35	Pyetje dhe Diskutime
13:00	<i>Pushimi i Drekës</i>

Paneli 2 – Moderator z. Robert Gielisse	
14:00-14:25	Z. Jacek Jezierski, SAI i Polonisë, <i>“Etika si një mjet për sigurimin e llogaridhënies”</i>
14:25-14:45	Prof. Dr.Lindita Lati & Msc.Pajtim Melani, Autoriteti i Konkurrencës <i>“Instrumentet për përmirësimin e qeverisjes publike”</i> .
14:45-	Prof. Assoc. Dr.Hysen Çela, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar <i>“Reduktimi i ekonomisë informale kërkon një</i>

15:10	<i>sistem tatimor efektiv dhe përpjekje te përbashkëta nga shume aktorë”.</i>
15:10	<i>Pushim kafe</i>
15:30-15:55	Prof. Assoc. Dr. Manjola Naço (KLSH) & Dr.Blerta Zilja & Dr. Greta Angjeli, Universiteti Mesdhetar i Tiranës, <i>“KLSH midis pavarësisë dhe të qenit lojtar kryesor në sigurimin e mirëqeverisjes “</i>
15:55-16:15	Z.Wolfgang Wiklicky, Gjykata Austriake e Audituesve & Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t, <i>“ Pavarësia, ngritja e kapaciteteve të SAI-t dhe përmirësimi i sistemeve të llogaridhënies publike për një zhvillim të qëndrueshëm”</i>
16:15	Pyetje dhe Diskutime
17:00	Mbyllja e ditës së parë

E enjte, 30 Tetor, ora 09:00 – 18:00

Paneli i 3 – Moderator, Kryetar i KLSH-së	
Këtë seancë e nderon me pjesëmarrjen e Tij, Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij, Zoti Bujar Nishani	
09:00-09:45	Përshëndetje nga personalitete të njohura në fushën e Auditimit të Jashtëm dhe të Financave Publike (çdo përshëndetje do të zgjasë 3-5 minuta)
	Z. Robert Gielisse, DG-Budget
	Z. Robert Wilton, Kryetari në detyrë i Prezencës së OSBE në Shqipëri
	Prof.Dr.Anastas Angjeli, Anëtar i Akademisë së Shkencave, Sekretar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
	Z.Edmond Spaho, Nën-Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë
	Përshëndetje nga Z. J. Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t & President i Gjykatës Austriake të Audituesve

	Z. Ivan Klesiq, Auditues i Përgjithshëm, SAI i Kroacisë
	Z. Milan Daboviq, President i Senatit, SAI i Malit të Zi
	Z. Igor Soltes, Deputet i Parlamentit Evropian
	Z. Aleksandër Arvizu, Ambasador i SHBA në Shqipëri
09:45	Përshëndetje nga Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij, Zoti Bujar Nishani
10:00-10:05	Pushim
10:05-10:25	<i>“Një rishqyrtim i çështjeve të kontraktimit të organizatave jofitimprurëse për shërbimet sociale”</i> , Prof.Dr.Aurela Anastasi, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës
10:25-10:40	Dr.Reinald Muça, KLSH <i>“Metodologjia e kërkimit dhe auditimi i performancës”</i> .
10:40-11:00	Prof. Dr. Vjollca Ibrahimiq & Msc. Anxhela Çela & Msc. Elton Karapici, Universiteti i Tiranës <i>“ Prokurimet publike dhe pajtueshmëria me ligjin e prokurimeve”</i> .
11:00-12:00	Pushim Kafe

Paneli i 4 – Moderator Z. Jacek Jezierski	
12:00-12:20	Prof.Dr. Jorgji Bollano, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, <i>“Raportimi Financiar në evoluim të vazhdueshëm”</i>
12:20-12:45	Prof. Assoc. Dr.Sazan Guri, “G&G Group” Institut & Msc. Marianthi Guri, Shoqata Mjedisore “MENV Group” & PhD. Artan Manushaqe, Jurist <i>“E drejta e mjedisit midis të Drejtës Kushtetuese, Penale dhe asaj Administrative”</i>
12:45-13:05	Z.Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm i ZAP Kosovë , <i>“Risitë e Auditimit në ZAP Kosovë “</i>
13:05-13:25	Zj. Luljeta Nano & Znj. Irena Islami, KLSH <i>“Institucionet Supreme të Auditimit si katalizatore të inovacionit në Sektorin Publik”</i> .
13:25-13:45	Zj.Albana Gjinopulli & Z. Kozma Kondakçiu, KLSH <i>“Auditimi mbi bazë Sistemi- një qasje që mbështet ndryshimin pozitiv “</i> .

13:45	<i>Pushimi drekës</i>
--------------	-----------------------

Paneli i 5 – Moderatore Zj Luljeta Nano & zj. Manjola Naço	
15:00-15:20	Zj.Kesjana Halili, Ministria e Financave, <i>“Efikasiteti i auditimit të brendshëm në Shqipëri”</i>
15:20-15:40	Zj.Albana Agolli & Znj. Brunilda Zeneli & Z.Ermal Yzeiraj, KLSH, <i>“Roli i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit, në kontekstin e praktikave më të mira të disa vendeve Europiane”</i> , KLSH
15:40-16:00	Z. Bajram Lamaj & Zj. Helga Vukaj & KLSH, <i>Auditimi kombëtar dhe mirë administrimi i aseteve në interes të publikut”</i>
16:00-16:20	Z.Gjovalin Preçi & Z.Fatos Çoçoli, <i>“Auditimi Performances ne funksion te mirëqeverisjes-Analize krahasuese ne KESH sh.a “</i>
16:20-16:30	Z. Shkëlqim Ganaj, Inspektor i Përgjithshëm dhe Z. Flori Karaj, Sekretar i Përgjithshëm, ILDKPKI, Përshëndetje <i>“ Mbi bashkëpunimin ILDKPKI- KLSH në funksion të përballje me sfidat në luftën kundër korrupsionit”</i>
16:30-16:40	Z. Joop Vrolijk- SIGMA, <i>Fjalimi përshëndetës për Konferencën e 3^{të} Shkencore të Kontrollit të Lartë të Shtetit.</i>
16:40-17:00	Pyetje & Diskutime
17:00-17:30	Konkluzione – Z. Robert Gielisse & Z. Jacek Jezierski & Z. Bujar Leskaj
17:30	Mbyllja e Konferencës – Z. Bujar Leskaj

Përshëndetje në Konferencë

1	SH.T.Z Bujar Nishani	President i Republikës së Shqipërisë
2	Aleksandër Arvizu	Ambasador i SHBA-se në Shqipëri
3	Dr.Igor Soltes	Deputet i Parlamentit European
4	Milan Dabovic	SAI i Malit të Zi, President i Senatit
5	Ivan Klesic	SAI i Kroacisë, Auditues i Përgjithshëm
6	Wolfgang Wiklicky	Drejtor i Përgjithshëm , ACA (Në emër të Z.Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI dhe President i ACA)
7	Edmond Spaho	Nën Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë
8	Prof.Dr.Anastas Angjeli	Sekretar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë
9	Robert Wilton	Kryetari në detyrë i Prezencës së OSBE në Shqipëri
10	Robert Gielisse	DG Budget, Këshilltar Kryesor në Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm Publik
11	Joop Vrolijk	SIGMA, Këshilltar i Lartë
12	Shkëlqim Ganaj	Inspektor i Përgjithshëm, ILDKPKI

Referuesit në Konferencë

Emër mbiemër

Institucioni, pozicioni

1	Dr.Robert Gielisse	DG Budget ,Këshilltar Kryesor në Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm Publik
2	Dr.Igor Soltes	Deputet i Parlamentit European
3	Milan Dabovic	SAI i Malit të Zi, President i Senantit
4	PhD.Verica Akrap	SAI i Kroacisë, Asistente e Audituesit të Përgjithshëm
5	Lars Lage Olofsson	SAI i Kosoves, Auditues i Përgjithshëm
6	Wojciech Kutyla	SAI i Polonisë, Zëvendës President
7	Jacek Jezierski	SAI i Polonisë, Këshilltar i Presidentit
8	Wolfgang Wiklicky	ACA, Drejtor i Pergjithshëm
9	Ismail Cengiz EREK	SAI i Turqisë, Auditues i Lartë
10	Turan Yasar	SAI i Turqisë, Auditues i Lartë
11	Prof.Dr. Omer Stringa	KLSH , Fakulteti Ekonomisë dhe Ekspert i Jashtëm
12	Prof.Dr.Skender Osmani	KLSH, Fakulteti Gjeologji Miniera dhe Ekspert i Jashtëm
13	Prof.Dr.Jorgji Bollano	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Kryetar
14	Prof. Dr. Lindita Lati	Autoriteti i Konkurrencës , Kryetar
15	Prof.Dr.Aurela Anastasi	Fakulteti Juridik , Universiteti i Tiranës
16	Prof.Dr.Vjollca Ibrahim	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
17	As. Prof. Dr. Hysen Çela	IEKA, Kryetar
18	Prof.Assoc.Sazan Guri	Instituti "G&G Group", Drejtor Ekzekutiv
19	Dr.Blerta Zilja	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
20	Dr.Greta Angjeli	Universiteti Mesdhetar
21	Msc.Anxhela Cela	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
22	Msc.Elton Karapici	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
23	Msc.Marianthi Guri	Instituti "G&G Group"
24	PhD.Artan Manushaqe	Jurist
25	Msc.Pajtim Melani	Autoriteti i Konkurrencës
26	Kesjana Halili	Ministria e Financave, Drejtore
27	Dr.Bujar Leskaj	KLSH, Kryetar
28	Luljeta Nano	KLSH, Sekretare e Përgjithshme
29	Prof.Ass.Dr.Manjola Naço	KLSH, Drejtor Departamenti
30	Dr.Reinald Muca	KLSH, Drejtor Departamenti
31	Irena Islami	KLSH, Përgjegjëse Sektori
32	Albana Gjinopulli	KLSH, Përgjegjëse Sektori

33	Kozma Kondakciu	KLSH, Drejtor Drejtorie
34	Albana Agolli	KLSH, Drejtore Departamenti
35	Brunilda Zeneli	KLSH, Audituese
36	Dr.Ermal Yzeiraj	KLSH, Drejtor Drejtorie
37	Prof.Assoc.Dr.Helga Vukaj	KLSH, Drejtore e Pergjithshme
38	Bajram Lamaj	KLSH, Drejtor Departamenti
39	Gjovalin Preçi	KLSH, Kryeauditues
40	Fatos Çoçoli	KLSH, Ekspert i Jashtëm

Pjesëmarrësit në Konferencë

SH.T.Z Bujar Nishani	President i Republikës së Shqipërisë
Aleksander Arvizu	Ambasador i SHBA-se në Shqipëri
Edmond Spaho	Nën Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë
Prof.Dr.Anastas Angjeli	Sekretar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë
Robert Wilton	Kryetari në detyrë i Prezencës së OSBE në Shqipëri
Robert Gielisse	DG Bugdet, Këshilltar Kryesor në Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm
Wojciech Kutyla	SAI i Polonisë, Zëvendës President
Igor Soltes	Deputet i Parlamentit Europian
Milan Dabovic	SAI i Malit të Zi, President i Senatit
Lars Lage Olofsson	SAI i Kosovës, Auditues i Përgjithshëm
Ivan Klesic	SAI i Kroacisë, Auditues i Përgjithshëm
Jacek Jezierski	SAI i Polonisë, Këshilltar i Presidentit
Johann Rieser	Ministria e Financave, Austri
Wolfgang Wiklicky	Drejtor i Përgjithshëm , ACA
Gregorz Haber	SAI i Polonisë, Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë
Nikola Kovacevic	SAI i Malit të Zi, Anëtar i Senatit
Lidija Pavica Pernar	SAI i Kroacisë, Asistente e Audituesit të Përgjithshëm
PhD.Verica Akrap	SAI i Kroacisë, Asistente e Audituesit të Përgjithshëm
Turan Yasar	SAI i Turqisë, Auditues i Lartë
Ismail Cengiz EREK	SAI i Turqisë, Auditues i Lartë
Flori Karaj	Sekretar i Përgjithshëm, ILDKPKI
Kesjana Halili	Ministria e Financave, Drejtore
Majlinda Bufi	Deputete, Kuvendi i Shqipërisë
Dr.Bujar Leskaj	KLSH, Kryetar
Lindsay Westley	DG Budget, Koordinatore e Drejtësisë së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
Prof.Dr.Skender Osmani	KLSH, Fakulteti Gjeologji Miniera dhe Ekspert i Jashtëm
Prof.Dr. Omer Stringa	KLSH , Fakulteti Ekonomisë dhe Ekspert i Jashtëm
Prof. Dr. Lindita Lati	Autoriteti i Konkurrencës , Kryetare

Msc.Pajtim Melani	Autoriteti i Konkurrencës
Mustafa Kerçuku	Ish Kryetar i KLSH
Teuta Baleta	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare
Mitro Çela	Analist
Ded Kola	Gazeta Ekonomia, Drejtor
Prof.Dr.Ago Nezha	Analist
Prof.Dr.Tonin Kola	Fakulteti Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Geraldina Prodani	Ministra e Financave, Sekretare e Përgjithshme
Mimoza Dhembli	Ministria e Financave , Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit
As. Prof. Dr. Hysen Çela	IEKA, Kryetar
Dr.Blerta Zilja	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Dr.Greta Angjeli	Universiteti Mesdhetar
Prof.Dr.Aurela Anastasi	Fakulteti Juridik , Universiteti i Tiranës
Prof.Dr.Vjollca Ibrahim	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Msc.Anxhela Çela	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Fatos Çoçoli	KLSH, Ekspert i Jashtëm
Msc.Elton Karapici	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Prof.Dr.Jorgji Bollano	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Kryetar
Prof.Assoc.Sazan Guri	Instituti "G&G Group", Drejtor Ekzekutiv
Msc.Marianthi Guri	Instituti "G&G Group"
PhD.Artan Manushaqe	Jurist
Luljeta Nano	KLSH, Sekretare e Përgjithshme
Prof.Ass.Dr.Manjola Naço	KLSH, Drejtor Departamenti
Dr.Reinald Muca	KLSH, Drejtor Departamenti
Dr.Ermal Yzeiraj	KLSH, Drejtor Drejtorie
Bajram Lamaj	KLSH, Drejtor Departamenti
Xhafer Xhoxhaj	KLSH, Drejtor Departamenti
Albana Agolli	KLSH, Drejtore Departamenti
Gezim Zilja	KLSH, Drejtor Drejtorie
Kozma Kondakçiu	KLSH, Drejtor Drejtorie
Irena Islami	KLSH Përgjegjëse Sektori
Dëshira Huqi	KLSH Përgjegjëse Sektori

Albana Gjinopulli	KLSH, Përgjegjëse Sektori
Sali Agaj	KLSH, Përgjegjës Sektori
Ibrahim Ndreu	KLSH, Përgjegjës Sektori
Adela Sollaku	KLSH, Juriste
Albert Thoma	KLSH, Kryeauditues
Aldona Sylaj	KLSH, Juriste
Aleksander Tereziu	KLSH, Auditues i I
Alfons Gabili	KLSH, Auditues i I
Alfred Zyfi	KLSH, Auditues i Lartë
Alkida Llakaj	KLSH, Audituese e II
Alma Shehu	KLSH, Audituese e I
Alush Zace	KLSH, Kryeauditues
Amantja Patozi	KLSH, Specialiste
Andrea Kristo	KLSH, Auditues i I
Anest Gjika	KLSH, Auditues i I
Armanda Begaj	KLSH, Specialiste IT
Artan Mirashi	KLSH, Auditues i Lartë
Artan Topjana	KLSH, Auditues i Lartë
Artur Hasanbelliu	KLSH, Kryeauditues
Aulona Jonuzi	KLSH, Audituese e I
Bashkim Harizaj	KLSH, Auditues i I
Bedri Çoku	KLSH , Zëdhënës
Benard Haka	KLSH, Auditues i II
Besmir Pajaj	KLSH, Auditues i II
Bexhet Zeqiri	KLSH, Auditues i Lartë
Blerin Shkurti	KLSH, Auditues i II
Brunilda Zeneli	KLSH, Audituese
Dalina Demi	KLSH, Audituese e II
Dorino Meçe	KLSH, Auditues i II
Dr.Edvin Stefani	KLSH, Auditues i I
Dritan Kore	KLSH, Auditues i I
Elfrida Agolli	KLSH, Audituese e I
Elira Cukalla	KLSH, Audituese e II
Elisa Metaj	KLSH, Audituese e II

Enejda Seraj	KLSH, Auditues i II
Ergys Dharni	KLSH, Jurist
Ermira Vojka	KLSH, Audituese e I
Evis Kreshpaj	KLSH, Audituese e I
Fadil Dekovi	KLSH, Auditues i I
Gentian Leva	KLSH, Auditues i II
Gjovalin Preçi	KLSH, Kryeauditues
Halil Isufi	KLSH, Auditues i I
Idlir Dervishi	KLSH, Auditues i I
Ina Sokoli	KLSH, Audituese e II
Joniada Gocaj	KLSH, Audituese e II
Jorida Zhegu	KLSH, Audituese e II
Julian Adili	KLSH, Auditues i II
Klodian Gllava	KLSH, Auditues i I
Livan Hoxha	KLSH, Auditues i I
Ludmilla Sulaj	KLSH, Audituese e I
Luljeta Shtylla	KLSH, Audituese e Lartë
Marvin Karalli	KLSH, Auditues i II
Milo Pano	KLSH, Auditues i I
Mimoza Bedini	KLSH, Audituese e I
Mimoza Lloji	KLSH, Kryeaudituese
Miranda Haxhia	KLSH, Audituese e Lartë
Muhamet Kavaja	KLSH, Kryeauditues
Orges Livani	KLSH, Auditues i II
Pjeter Beleshi	KLSH, Auditues i Lartë
Pranvera Doçi	KLSH, Audituese e I
Qemal Shehu	KLSH, Auditues i I
Rajmond Koci	KLSH, Auditues i I
Redina Karapici	KLSH, Auditues i II
Rezart Golemaj	KLSH, Auditues i II
Selime Bregu	KLSH, Audituese e Lartë
Skender Muça	KLSH, Auditues i I
Valdete Berisha	KLSH, Audituese e I
Valentina Golemi	KLSH, Audituese e I

Valentina Sulo	KLSH, Audituese e I
Vladimir Rizvani	KLSH, Auditues i I
Xhemal Luka	KLSH, Auditues i Lartë
Xhuljeta Celaj	KLSH, Audituese e II
Yllka Dede	KLSH, Audituese e Lartë
Ymer Stafa	KLSH, Auditues i I
Yrjada Jahja	KLSH, Audituese e II

Falënderime për të gjithë personat që mundësuan realizimin e Konferencës

Realizimi i Konferencës u bë i mundur falë përkushtimit të shumë punonjësve të KLSH-së, të cilët krahas punës së tyre të përditshme, kontribuan me profesionalizëm për përmbylljen me sukses të saj.

Falenderimet shkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për zj.Luljeta Nano dhe zj.Irena Islami që rakorduan punën me strukturat e KLSH-së dhe me aktorët jashtë institucionit për realizimin e suksesshëm të Konferencës; **për përkthyeset** : zj.Dëshira Huqi, zj,Xhuljeta Çelaj, zj.Dalina Demi, zj.Aulona Jonuzi dhe zj.Enejda Seraj, që realizuan me cilësi përkthimin simultan nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas; **për Stafin Mbështetës** : z.Kozma Kondakçiu, zj.Armanda Begaj, zj.Amantja Patozi, zj.Elisa Metaj, zj.Alma Shehu, zj.Yrjada Jahja dhe z.Bernad Haka; dhe për **Shoqëruesit e Delegacioneve të Huaja që nderuan Konferencën me pjesëmarrjen e tyre** : z.Marvin Karalli, zj.Redina Karapici, zj.Ina Sokoli, z.Idlir Dervishi, z.Julian Adili, z.Alfons Gabili dhe z.Orgest Levani.

Gjithashtu një falënderim i veçantë për Prof.Dr. Kaliopi Naska, z.Gëzim Zilja dhe z.Tonin Vuksani, të cilët mbështetën plotësimin dhe përditësimin e Mini Muzeut të KLSH-së.

Respekt dhe vlerësim për televizionet kombëtare, lokale dhe gazetatat e përditshme, të cilët pasqyruan në kohë dhe me korrektesë zhvillimin e punimeve të kësaj Konference.

Faleminderit!

Bujar LESKAJ



REVIZIJA E SHTABIT
2014/25-11/2014
BY. JUDIT SOLTES / 26
MEMBER OF THE EUROPEAN PARLIAMENT
Chair of the Budgetary Control

Supreme State Audit Institution
Dr Bujar Leskaj
Chairman
Boulevard Dëshmorët e Kombit No3
Tirana, Albania

Brussels, 2 November 2014

Dear Dr Leskaj, my dear friend,

Allow me to thank you cordially for your kindness and hospitality that was extended to me during the 11th Scientific Conference at the end of October this year at ALSAI in Tirana. The Conference was organized in an excellent manner, with speakers and topics on the highest level which enabled us a deep insight in the progress made by SAIs and relevant stakeholders. Allow me to stress that I was honored and privileged to be able to meet and address once again His Excellency the President Bujar Nishani.

I am convinced that my new assignments as the vice-chair of the European Parliament Committee for the Budgetary Control will contribute to our further successful cooperation. This can be affirmed also by the fact that I participate in the Delegation to the EU-Albania, which I see as an excellent opportunity for strengthening our overall close relations. Our mutual cooperation which was built on continuous exchange of best practice and expertise has to my delight evolved to the level of friendship and will develop even further in the years to come.

I am looking forward to meeting you in the near future!

Respectfully yours,

OFFICE

ASP 111204 - Rue Wiertz 64 - B-1047 Brussels - T +32 224 47814
[eud-act@ec.europa.eu] <http://asp.mpp.eu> - www.spaalshiba.eu

Seria: botime KLSH - 13/2014/34

ISBN: 978-9928-159-27-4



Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: klsh@klsh.org.al